



Muhammed Asad

# Rruga për në Mekë



**Kryeredaktor  
Husamedin Abazi**

**Recensentë të botimit shqip:  
Milazim Krasniqi, Muhidin Ahmeti, Xhevat Xhoxha**



Copyright © LogosA, 2003

Shënimi për CIP katalogun e këtij libri ndodhet në  
Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare - Shkup  
ISBN 9989-90-477-4



9 789989 904776

Këtë libër gjithashtu mund ta gjeni edhe në bibliotekën elektronike të SHB "Logos-A"  
në adresën e internetit  
<http://www.logos-a.com.mk>

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.  
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të  
kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi,  
transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të SHB "Logos-A".

Biblioteka: Divan



Përktheu  
Nexhat S. Ibrahim

Titulli i originalit  
The road to Mecca-Muhammed Asad  
Dar al-Andalus, Tanger, 1974

Titulli në gjuhën boshnjake:  
Muhammed Asad, Put u Meku,  
Botimi III, El-Kalem, Sarajevo

# Rruga për në Mekë



## Përmbajtja:

Udhëtimi i M. Asadit deri te ujërat e kthjellëta .....	11
Muhammed Asadi (1900 - 1992).....	19
Fillimi i një rrëfenje .....	21
I. Etja.....	33
II. Fillimi i rrugës.....	80
III. Erërat .....	111
IV. Zëra .....	155
V. Shpirti dhe trupi .....	199
VI. Ëndërrimet.....	236
VII. Në gjysmë të rrugës .....	265
VIII. Xhinët .....	310
IX. Letra persiane .....	351
X. Dexhxhalli .....	394
XI. Xhihadi .....	434
XII. Fundi i rrugës .....	477
P. S. i përkthyesit!.....	519
P. S. i mëvonshëm: .....	522



## **Udhëtimi i M. Asadit deri te ujërat e kthjellëta**

Asokohe, kur u paraqit botimi i parë i veprës "Rruga për në Mekë" e Muhammed Asadit, kemi theksuar rëndësinë e saj për rrethanat tona. Pavarësisht nga fakti që ajo, ja, po përjeton botimin e dytë (në gjuhën boshnjake - N. I) nuk mund të thuhet se vepra ka pasur jehonë të merituar dhe gjurmë të lexuesit tanë.

Edhe sot konsiderojmë se vepra e Asadit (e shkruar më 1952) është shembull i shkëlqyeshëm i letërsisë bashkëkohore islame, dëshmi e fuqishme, e pashlyeshme e një intelektualit perëndimor për Islamën dhe për popujt që ai në pikëpamje kulturore dhe qytetërimi i ka formësuar. Do të orvatem në vijim të ofroj arsytetime.

Muhammed Asadi ka kaluar në Islam si njeri i ri. Ka qenë korrespondent i "Frankfurter Zeitung-ut" nga Lindja e Afërt. Hebre, erudit, me frymë subtile, ai i është afruar Islamit dhe botës muslimane ngadalë dhe çka është më e rëndësishmja, pa paragjykime. Nuk duhet këmbëngulur në faktin që M. Asadi është i konvertuar në Islam, me qindra të ashtuquajtur intelektualë muslimanë sot e mohojnë Islamën dhe vlerat që ai pashlyeshëm i ka futur në jetën e popujve të tyre. Nga ana tjetër, pikërisht M. Asadi, intelektual kulminant i njohur në tërë botën islame, është përkrahës i dialogut, i dialogut të mirëfilltë ndërmjet muslimanëve dhe ehlul-kitabëve ("ithtarëve të Urdhëresës

Hyjnore"- shprehje e Asadit), hebrenjve, kristianëve dhe monoteistëve tjerë, dhe askund nuk i ka mohuar vlerat e judaizmit ose të kristianizmit; ka theksuar shekullarizimin e Perëndimit dhe pasojat e tij. Një shkrimtar tjetër, i famshëm kristian, Deni de Ruzhmon, ka shkruar në librin e tij të njohur "Dashuria dhe Perëndimi" se Evropa jeton vetëm "me shenjën formale të kristianizmit".

Ajo që e ka gjetur në udhën e vet shpirtërore Leopold Vajsi ka qenë feja natyrore e njeriut, el-fitrah kur'anore (30:30). Lexuesit i kujtohet Zh. Zh. Rusoi dhe Besimi i famulltarit savojas. Ka të bëjë me kërkimin e njëjtë të të vërtetave të fesë të pashtrembëruara dhe me kurrfarë ndërmjetësish të errësuar. Rugën e Asadit, ose një pjesë të rrugës, para dhe pas tij, e kanë kaluar, pos Rusoit, perëndimorët e njohur mendjelirë: Kanti, Tolstoji, Jaspersi, Garodi etj.

Ata monoteizmin e kanë kuptuar dhe përjetuar si liri të mirëfilltë të qenies së njeriut, por asnjëri për këtë nuk ka dëshmuar si Muhammed Asadi.

Asadi pa dyshim dëshmon. E theksoj shprehjen "dëshmim" për shkak se "Rruga për në Mekë" është jetëshkrim në domethënien e Fraut të kësaj forme specifike të prozës narrative "formës së rrëfimit", që në letërsinë evropërendimore mban prejardhjen e vet prej Shën Augustinit.

"Rruga për në Mekë" është jetëshkrim i njeriut që erdhi deri tek Islami dhe në të mbeti sinqerisht dhe përgjithmonë. Ky jetëshkrim ka peizazhet, koloritet dhe karakteristikat e udhëpërshkrimit, tendosjen e romanit kriminalistik dhe - që është më e bukura në të - esetë në mënyrë kulminante të suksesshme, të shpërndarë. Por, për shkak se "çdo kulturë ka të drejtë në llojet vetjake letrare" (Frye), më me dëshirë këtë vepër do ta klasifikoja në letërsinë islame ende teoretikisht të papërkufizuar por ekzistu-

ese. Kjo don të thotë se "Rruga për në Mekë" i përket familjes së veprave, në të cilat autorët e tyre dëshmojnë për raportin e vet ndaj Zotit, Islamit, muslimanëve dhe fatit të tyre dhe në këtë kontekst, për botën në të cilën jetojnë.

Autorët muslimanë nuk duan të flasin vetëm bukur, "stolisur", por edhe të vërtetën dhe aktualen.

Shkaqet e kësaj këtu, natyrisht, nuk mund t'i shtrojmë, por mendoj se themelori është në karakterin e Islamit, fesë që aq shumë këmbëngul në të vërtetën dhe realitetin dhe e cila e përshkon tërë qenien e njeriut dhe jetën e tij.

Në lirinë në të cilën është shkruar dhe të cilën e përvetëson, vepra e letërsisë islame i rrënoi rrethojat që e pengojnë, e për këtë shkak autorët islamë nuk shprehin dëshirë për miratim as për abstenim nga konvencionet trajtësuese të traditës letrare vetjake ose "të huaj".

E vërteta, disa forma (e përdorim këtë fjalë për shkak të qartësisë duke e lënë anash postulatit strukturalist dhe semiotik mbi "njëllojësinë" e formës dhe përmbajtjes së veprës letrare) nuk janë jetësuar në letërsinë islame (p. sh. tragjedia) që shkakun e vet e ka në botëkuptimin islam. Nëse, sikundër dhe ndodh, vepra e letërsisë islame është e angazhuar, ajo është e angazhuar parësisht me "shtresën e vet tematike". Ajo është e angazhuar në mënyrën islame (jo në mënyrën zhdanoviste!): e zgjon dhe zhvillon shijen estetike dhe "thelbin metafizik" islam dhe të ngre moralisht.

Çka është më e rëndësishme, heronjtë e letërsisë islame nuk jetojnë në "botën" të lënë "pa Zot" (Llucaçi), por Zoti është mik i tyre, i pranishëm në çdo çast dhe në çdo hap.

Të gjitha karakteristikat e sipërme i ka "Rruga për në Mekë", proza që zbulon dhe ngre, herë - herë sjell deri në

dëshpërim (rrëfimi për Omer Muhtarin e tmerrshëm dhe eseja mbi sytë e dëshpëruar iraniene), e herë - herë gëzon.

Bota muslimane nëpër të cilën udhëton Asadi viteve njëzet të këtij shekulli është e trazuar, si përherë. Fati heshtak dhe barrat e hidhëta ndërrohen nga koha në kohë, nga krahina në krahinë. Populli që e deshi Asadin si vëlla dhe në të cilin Asadi e hodhi poshtë gëzhjojen e mundimshme të të huajit dhe të vetmuarit, është paraqitur në mënyrë realiste, pa idealizim. Do t'i lusja lexuesit tanë që të mos zemërohen nga ndonjë përshtkrim të vallëzueses, të pirët e opiumit dhe të arakut edhe në disa vende të tjera. Asadi do të gabonte sikur të mos na kishite folur edhe për këtë.

Mbase këtë është dashur ta bëjë në masë më të madhe. Bota muslimane nuk duhet dhe nuk mund të ikë nga fotografia dhe fati i vet, nëse dëshiron ta ruajë vetëdijen e vet.

Siç thashë, faqet më të bukura të Rrugës për në Mekë, të cilat vetë Asadi i ka shkruar në ese që spontanisht ndërpresin (flash-backs) udhëpërshtkrimin. Autori thjesht është i magjepsur me Islamin që nuk e ndan "të shenjtën dhe profanen", shpirtin dhe trupin, individualen dhe shoqëroren, që e ka krijuar "njerëzinë që nuk nxiton", botën "plotësisht të rrethuar në vete - e megjithatë të hapur në të gjitha anët", me Islamin i cili është "harmoni organike e arsyes dhe ndjenjës" - "t'i dëftojë njeriut jo vetëm si të ndiejë, por po ashtu si të jetojë drejtësisht".

Ai Islamin e ka kuptuar kësisoj: të gjitha elementet janë në vendin e vet natyror dhe funksionojnë ashtu si i përgjigjet natyrës së njeriut. Islami këtu është feja e lirisë shpirtërore (përgjigje kaptinës përfundimtare të "Ikjes nga liria" të Fromit) dhe sintezës, për Asadin personalisht "rrugë-e jo fund".

Pastaj do t'i cekja disa ese të tjera: të menduarit e Asadit për të dërguarin, Muhamedin, me rastin e ardhjes së tij e të Zejdit në Medine ("Madje edhe pas trembëdhjetë shekujsh prania shpirtërore e Pejgamberit këtu është pothuaj po ashtu e gjallë sikur që ka qenë atëherë. Vetëm për të grupi i shpërndarë i fshatrave, që dikur quheshin Jethrib, u bë qytet të cilin e duan të gjithë muslimanët deri më sot, si asnjë qytet askund në botë nuk është dashur ndonjëherë... kurrë asnjë njeri, i vdekur tashmë mbi trembëdhjetë shekuj, nuk është dashur aq personalisht dhe prej aq shumë njerëzve, sikur ai që është varrosur nën kupolën e madhe të gjelbër" - fq. 204, 205), të kuptuarit e Asadit të marrdhënies Perëndim - Zot (f. 119), rënies politike dhe kulturore të muslimanëve (f. 159) dhe, veçan, eseja për Ka'ben me të cilin shkëlqyeshëm e mbaron këtë vepër.

Këtu janë disa personalitete historike të botës muslimane me të cilët autori është njoftuar: Ibn Saudi, mbreti i atëhershëm i Arabisë Saudite, Riza Kani, dhe më përshlyelëni dhe më i dashuri Seid Ahmed, senusi i madh me mëngën që ngrihet si "krahu i shqiponjës", trimi tragjik nga shkretëtirat libiane.

Asadi për ta flet me korrektesë, nuk i predimensionon por as nuk i nënçmon meritat e tyre dhe veprimet e tyre politikisht të papjekura, të dëmshme, herë - herë fatale.

T'i shtojmë edhe disa gojëdhëna që kanë jetuar me shpirtin musliman (Haruti dhe Maruti, Dexhxhalli, dashi i Ibrahimit, Hasani dhe Husejni) dhe kjo do të ishte pothuaj tërë bota e "Rrugës për në Mekë".

Një metaforë: uji që rrjedh e për këtë është gjithnjë i kthjellët, përsëritet dy-tri herë. Është e shkëlqyeshme dhe harmonikisht është përshtatur në strukturën e veprës. Domethënia e tij është e gjerë; "ujërat e kthjellët" janë: Islami në të cilin njeriu gjithnjë lëviz dhe përparon ("të

bëhemi të vetëdijshëm se jemi pjesë të lëvizjes në orbitë" - f. 297), muslimanët të cilëve udhëtimi u paraqet akt devotshmërie (Kur'ani, 6: 11) dhe për të cilët çdo skutë në tokë është "vend i sexhdes", i kulturës së popujve muslimanë me "gramatikën" e vet statike dhe "fjalorin" rotativ, Ka'ba si simbol i tevhidit, monoteizmit islam, rreth së cilës lëviz Ruhi ynë dhe trupi ynë, namazi që përbëhet prej qetësisë dhe lëvizjes fizike, kurse edhe Muhammed Asadi ka udhëtuar deri te "ujërat" që nuk janë shënuar as në mënyrë raciale as nacionale, as gjeografike, por prej pafillimit rrjedhin për njeriun si qenie më e lartë në krijimin e pandërprerë të Zotit të vetëm, i cili është mëshirues.<sup>1</sup>

Xhemaludin Llatiq

## **Shkëputje nga recensionin: Post Scriptum i recensentit.**

Ishte një kënaqësi e veçantë për mua leximi i kësaj vepre të jashtëzakonshme të autorit Muhammed Asad, për të cilën nuk kisha ditur më parë. Vërtet, është dëm i madh që “Ruga për në Mekë”, e botuar para gjysmë shekulli, nuk ka qenë e botuar në gjuhën tonë dhe nuk e ka kryer atë funksion fisnik që kryejnë veprat e mëdha të artit dhe të ideve të mëdha. Por, më mirë vonë se kurrë, thotë një fjalë. Prandaj, ju përgëzoj për punën kolosale që keni bërë për përkthimin e kësaj vepre dhe uroj që sa më parë të botohet.

Ruga për në Mekë është një udhëtim/kërkim për të njohur vetveten, për të rizbuluar kuptimin e vërtetë të misionit që ka njeriu në këtë jetë. Njeriun Zoti e krijoi si mëkëmbës të vetin në Tokë dhe që njeriu ta adhurojë Krijuesin e vet dhe ta kënaqë me vepra të mira. Kjo është aksioma e ekzistencës së njeriut. Mirëpo, në historinë konfuzë dhe shpërfytyruese të njerëzimit, mbi këtë detyrim të parë të njeriut, janë sedimentuar shumë gjëra, që e kanë shformuar natyrën e drejtë të njeriut. Muhammed Asadi me veprën e tij jetësore dha provën e njeriut të guximshëm që kthehet në identitet, në besimin e drejtë, ndërsa me veprën artistike Ruga për në Mekë, la një dëshmi të një përkushtimi të sigurtë ndaj jetës dhe ndaj Islamit si kuptimi më suprem i jetës së njeriut.

Vepra është një gërshetim i veprimeve të bujshme të personazheve, i ngjarjeve konkrete historike, i kujtimeve, i meditimeve dhe i ideve, që së bashku konstituojnë një botëkuptim unik për jetën dhe për besimin. Të marra së bashku, ato krijojnë idenë qendrore se Ruga për në Me-

kë, është rrugë për të hyrë në udhën e jetës dhe të besimit, për të përmbushur misionin njerëzor ndaj Krijuesit.

Kushdo që do të ketë kureshtjen dhe durimin që ta lexojë këtë vepër, do të fisnikërohet më shumë, do të kuptojë diçka më shumë për jetën e vet dhe për mrekullinë e Islamit.

08. 04. 2001, Prishtinë,  
Milazim Krasniqi

## **Muhammed Asadi** **(1900 - 1992)**

Muhammed Asadi (para kalimit në Islam Leopold Weiss), është lindur më 1900 në Llavovo, që atë kohë hynte në përbërje të Austro-Hungarisë (ndërsa tash qyteti Llavovë bën pjesë në Ukrainë, N. I.). Në vitin e njëzet e dytë të jetës, si korrespondent i gazetave gjermane, e veçan i gazetës së njohur "Frankfurter Zeitung", filloi udhëtimet e veta të gjata nëpër vendet islame. Në korrespondencën e vet, që është vlerësuar lart, është dalluar për talent të jashtëzakonshëm të vrojtimit dhe me mënyrën origjinale të shikimit të problemeve të asaj bote, pa ato paragjykimet e shpeshta Evropiane që e errësojnë gjykimin e shëndoshë.

Duke u njohur me parimet e Islamit dhe me stilin e jetës në vendet islame, e pranoi Islamit dhe tërë jetën ia kushtoi studimit të kësaj feje aktivisht duke marrë pjesë në shumë veprime dinamike. Pas themelimit të Pakistanit është emëruar drejtor i Seksionit për rimëkëmbjen islame, e më vonë si përfaqësues i Pakistanit në Kombet e Bashkuara. Pas tërheqjes nga këto detyra jeton në Marok dhe i përkushtohet veprimtarisë publicistike. Shkruan në gjuhën angleze, arabe e gjermane.

Veprat e tij më të rëndësishme janë: "Islami në udhëkryq" (Islam on the Crossroads), "Rruga për në Mekë" (The Road to Mecca) dhe përkthimi jashtëzakonisht i suk-

sesshëm i Kur'anit në gjuhën angleze me titull: "Porosia e Kur'anit" (The Message of the Qur'an). Përveç artikujve të shumtë ka botuar edhe mujorin "Arafat".

Për kalimin e tij në Islam Muhammed Asadi thotë:

"Nga kalimi im në Islam pandërprerë më janë shtruar pyetjet: "Përse e keni pranuar Islamin?" "Ç'ju ka tërhequr veçan në të?" Duhet pranuar se nuk kam përgjigje që kënaq. Ky nuk ka qenë kurrfarë mësimi i veçantë që më ka tërhequr, por tërë struktura e shkëlqyeshme, pashpjegueshëm koherente e mësimit moral dhe programit praktik të jetës. Nuk do të mund ta thoja, madje as tash, se cili aspekt më tërheq më shumë se tjetri. Islami më duket si vepër e përkryer arkitektonike. Të gjitha pjesët e tij janë të konceptuara harmonikisht që ta plotësojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën; asgjë s'është e tepërt dhe asgjë nuk mungon, që rezulton me baraspeshën dhe qetësinë e përkryer. Mbase pikërisht kjo ndjenjë se çdo gjë në mësimet dhe postulatet e Islamit është "në vendin e vet" më ka impresionuar tejet fuqishëm. Ka mundur krahas kësaj të ketë edhe mbresa tjera që sot e kam vështirë t'i analizoj. Më në fund, kjo është çështje e dashurisë, kurse dashuria është më komplekse se shumë gjëra: dëshirat tona dhe vetmia jonë, caqet tona të larta dhe mangësitë tona, fuqia jonë dhe dobësia jonë. Kështu ka qenë edhe me mua. Islami ka hyrë tek unë heshturazi dhe fshehtazi, por përgjithmonë".

Përkushtuar shkëlqesisë së tij Fejsalit, mbretit të Arabisë Saudite, si shenjë kujtimi për dyzet e pesë vjet miqësie dhe me respekt të thellë për çdo gjë që ka bërë për popullin e vet dhe për fenë tonë të përbashkët.

## Fillimi i një rrëfenje

Rrëfenja që do të parashtroj në këtë libër nuk është jetëshkrim i njeriut të dalluar sipas rolit të vet në punët publike; kjo nuk është rrëfenjë për ndonjë aventurë - sepse ndonëse kam përjetuar shumë aventura të çuditshme, ato gjithnjë kanë qenë vetëm përcjellje të asaj që ndodhte tek unë; nuk është kjo madje as rrëfenjë për kërkimin e qëllimtë të fesë - sepse kjo fe më ka ardhur gjatë viteve, pa kurrfarë përpjekjesh nga ana ime për ta gjetur atë. Rrëfenja ime është tregimi i thjeshtë i një Evropiani për zbulimin e tij të Islamit dhe kyçjes në bashkësinë muslimane.

Kurrë nuk kam menduar ta shkruaj, sepse as nuk më ka shkuar mendja se jeta ime do të mund të ishte veçan interesante për këdo qoftë pos për mua. Por, njëzet e pesë vjet pasi jam larguar nga Perëndimi, kur kam ardhur në Paris, e pastaj në Nju-Jork, në fillim të vitit 1952, kam qenë i detyruar ta ndryshoj këtë pikëpamje. Duke punuar si ministër i autorizuar pakistanez në Kombet e Bashkuara, kam qenë natyrisht i ekspozuar opinionit dhe miqtë e të njohurit e mi Evropianë e amerikanë kanë qenë shumë kureshtarë. Fillimisht ata kanë parë tek unë rastin e "ekspertit" Evropian të punësuar në ndonjë qeveri lindore me detyrë speciale, që në mënyrë përkatëse që përshtatur me traditat e vendit për të cilin punon, por kur veprimi im në Kombet e Bashkuara ka dëftuar qartazi se jo vetëm në aspektin "funksional", por edhe në atë emocional e intelektual pajtohem me synimet

politike e kulturore të botës muslimane përgjithësisht, ata thjesht kanë qenë të magjepsur.

Përherë më shumë njerëzit kanë filluar të më pyesin për përvojat e mia të kaluara. Kanë mësuar se herët e kam filluar karrierën si korrespondent i huaj i gazetave Evropiane dhe se, pas disa vjet udhëtimesh gjithëpërfshirëse nëpër Lindjen e Mesme, në vitin 1926 jam bërë musliman, se pas kalimit në Islam kam jetuar gati gjashtë vjet në Arabi dhe kam gëzuar miqësinë e mbretit Ibn Saud, se pas largimit nga Arabia, kam shkuar në Indi dhe atje kam takuar poetin, filozofin e madh musliman dhe babain shpirtëror të idesë për Pakistanin - Muhammed Ikbali. Pikërisht ai më ka bindur të heq dorë nga planet për udhëtim në Turkistanin lindor, Kinë dhe Indonezi dhe të qëndroj në Indi që të ndihmoj në shpjegimin e supozimeve intelektuale të shtetit të ardhshëm islam, që atëherë ka qenë mezi diç më shumë se ëndrra në mendimin vizionar të M. Ikbali.

Për mua, sikur edhe për Ikbali, kjo ëndërr ka parqitur rrugën, në realitet rrugën e vetme drejt ngjalljes së sërishme të të gjitha shpresave të përgjumura të Islamit, drejt krijimit të bashkësisë politike të popullit të lidhur jo me prejardhjen e përbashkët por me përkatesinë ndaj ideologjisë së përbashkët. Me vite i jam përkushtuar këtij ideali duke studiuar, shkruar dhe duke mbajtur ligjërata nga kultura. Kur u themelua Pakistani në vitin 1947, qeveria e këtij vendi më ka ftuar të organizoj dhe të drejtoj Seksionin e Rimëkëmbjes Islame që përfshinte diskutime mbi përpunimin e koncepteve ideologjike islame të shtetësisë dhe përbashkësisë mbi të cilat do të mund të zinte fill organizata politike e sapolindur. Pas dy vjet të kësaj veprimtarie veçan stimuluese, jam transferuar në Ministrinë pakistaneze të Punëve të Jashtme dhe jam emëruar shef i Seksionit për Lindjen e Mesme ku i jam

përkushtuar përforcimit të lidhjeve ndërmjet Pakistanit dhe pjesëve tjera të botës muslimane; më në fund, pas një kohe, u gjenda në misionin pakistanez në Kombet e Bashkuara në Nju - Jork.

E gjitha kjo ka qenë shumë më tepër se sa përshtatje e thjeshtë e jashtme e Evropianit në bashkësinë muslimane në të cilën jeton, kjo më tepër ka dëftuar në përcjelljen e vetëdijshme, plotësisht të sinqertë të përkushtimit nga një mjedis kulturor në tjetrin, krejtësisht ndryshe. Pikërisht kjo u dukej e çuditshme miqve të mi në Perëndim. Ata nuk kanë mundur t'ia bëjnë të ditur vetes se si ishte e mundur që një njeri i lindur dhe i edukuar në Perëndim, ashtu plotësisht dhe qartë, pa kurrfarë rezerve shpirtërore, të identifikohet me botën muslimane, si ka qenë e mundur ta ndërrojë trashëgiminë e vet kulturore perëndimore me atë islame dhe çka ka qenë ajo që e shtyri ta pranojë ideologjinë religjioze dhe shoqërore e cila - ata, si duket, këtë e marrin si fakt krejt të gatshëm e të mirëqenë - është shumë më e ulët nga të gjitha perceptimet Evropiane.

E përse, pyesja veten, miqtë e mi perëndimorë duhej këtë ta merrnin si fakt të mirëqenë? A thua cilido prej tyre kurdoherë vërtet është angazhuar të fitojë shikim direkt të Islamit apo mendimet e tyre kanë qenë të bazuara vetëm në varg klisheesh dhe konceptesh të shtrembëruara që u qenë përcjellë nga brezat e mëparshëm? A mos mbase ajo mënyra e vjetër e mendimit greko-romak, që e ka ndarë botën në grekë dhe romakë në një anë dhe "barbarët" në anën tjetër, ka qenë aq thellë e rrënjosur në frymën perëndimore, që ajo nuk është në gjendje madje as teoretikisht ta pranojë vlerën e çkad tjetër që është jashtë sferës së tij vetjake kulturore?

Qysh prej kohëve greke dhe romake mendimtarët dhe historianët Evropianë kanë prirje ta vështrojnë historinë botërore vetëm nga aspekti dhe me ndihmën e histo-

risë Evropiane dhe përvojës kulturore perëndimore. Qytetërimet joperëndimore hyjnë në lojë vetëm nëse ekzistimi i tyre, ose lëvizjet e veçanta në ta, kanë ose kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në njeriun perëndimor; për këtë, në sytë e perëndimorëve, historia botërore dhe kulturat e ndryshme në fund shpien në diç më tepër nga sa është historia e zgjeruar e Perëndimit.

Natyrisht, këndi ashtu i ngushtuar i shikimit medoceshtë është dashur të sjellë deri te soditja e shtrembëruar e gjërave. I mësuar në pyetjen që tregon ose diskuton problemet e qytetërimit të tij vetjak deri në hollësitë më të vogla dhe në ngjyra të gjalla, mezi me diç më shumë nga vështrimi sipërfaqësor kalimthi aty këtu në pjesën e mbetur të botës, Evropiani dhe amerikani i zakonshëm i nënshtrohet lehtë iluzionit se përvojat kulturore të Perëndimit jo vetëm që janë superiore por janë jashtë të gjitha përpjestimeve në raport me përvojat e tilla të botës së mbetur. Prej këndeje pason se mënyra perëndimore e jetesës është norma e vetme e vlefshme me të cilën mënyrat tjera të jetës mund të maten, duke nënkuptuar, natyrisht, që cilado ide intelektuale, cilido institucion shoqëror ose vlerë etike që nuk pajtohet me "normën" perëndimore tashmë me vetë këtë i përket shkallës më të ulët të jetës. Duke ndjekur hapat e grekëve dhe romakëve, perëndimori më me dëshirë mendon se të gjitha qytetërimet e tjera kanë qenë vetëm orvatje me plot pengesa në rrugën e përparimit që Perëndimi pagabueshëm e ndjek, ose, në rastin më të mirë (siç ka të bëjë me qytetërimet e "stërgjyshërve" që janë në vijë të drejtpërdrejtë i kanë paraprirë qytetërimit të Perëndimit modern) jo më tepër se kaptina e parë të njëjtut libër në të cilin, natyrisht, qytetërimi perëndimor është kaptina përfundimtare.

Kur këtë pikëpamje ia kam shtruar një miku amerikan, njeri me arsimim të lartë intelektual dhe shkencërisht i orientuar, ai në fillim ka qenë pak skeptik.

"Edhe nëse e marrim si fakt të mirëqenë", - tha ai, - "se grekët e vjetër dhe romakët kanë qenë të kufizuar në qasjen e tyre ndaj qytetërimeve të huaja, a thua kjo kufizueshmëri nuk ka qenë rezultat i pashmangshëm i vështirësive në komunikim ndërmjet tyre dhe botës tjetër? A thua kjo vështirësi nuk është kapërcyer në masë të madhe në epokën moderne? Përfundimisht, ne perëndimorët pa dyshim sot kujdesemi për atë çka po ndodh jashtë sferës sonë kulturore. Më duket se harroni shumë libra për artin dhe filozofinë lindore që janë botuar në Evropë dhe Amerikë gjatë njëzet vjetëve të fundit, për idetë politike që i preokupojnë shpirtrat e popujve të Lindjes? Nëse dëshirojmë të jemi të drejtë, assesi nuk guxojmë të mos e përfillim këtë dëshirë të perëndimorëve që të kuptojnë çka do të mund të ofronin kulturat e tjera".

"Në njëfarë kuptimi do të mund të kishit të drejtë", - u përgjigja. - "Nuk ka dyshim se botëkuptimi primitiv greko-romak nuk është më plotësisht praktik sot. Depërtueshmëria është topitur në një masë të konsiderueshme - nëse jo për shkaqe tjera, atëherë për atë shkak se mendimtarët më të pjekur perëndimorë janë liruar nga iluzionet dhe janë bërë skeptikë në shumë aspekte të qytetërimit vetjak dhe filluan t'u drejtohen pjesëve të tjera të botës në kërkim të frymëzimeve kulturore. Disave prej tyre u është bërë e qartë se mbase nuk ekziston vetëm një libër dhe një rrëfenjë për përparimin njerëzor, por disa syresh: thjesht për faktin që njerëzimi, në kuptimin historik, nuk është tërësi homogjene, por shumësi grupesh me ide të gjerë divergjente në aspekt të domethënies dhe qëllimit të jetës njerëzore. Megjithatë, nuk mendoj se Perëndimi është bërë më i mirë ndaj kulturave të vjetra nga sa kanë qenë

grekët dhe romakët; është bërë vetëm më tolerant. Por kini kujdes, jo ndaj Islamit por ndaj disa kulturave tjera lindore që i afrojnë një lloj joshjeje shpirtërore Perëndimit të etshëm për shpirt, kurse në të njëjtën kohë janë mjaft të larguara nga pikëpamja perëndimore mbi botën që të mund të paraqesin çfarëdo provokimi real vlerave të tij".

"Çfarë doni të thoni me këtë?"

"Eh", - u përgjigja, - "kur perëndimori diskuton, të themi, për hinduizmin ose budizmin, ai gjithnjë është i vetëdijshëm për dallimet themelore ndërmjet këtyre ideologjive dhe atij vetjak. Ai mund të mahnitet me këtë apo atë ide të tyre, por, natyrisht, kurrë nuk do ta shqyrtonte mundësinë që ato ta ndërrojnë ideologjinë e tij vetjake. Kjo ndodh nga fakti se ai e përvetëson apriori këtë pamundësi; ai ka mundësi t'i shqyrtojë kulturat e tilla vërtet të huaja plotësisht i qetë dhe shpesh me mirëkuptim ngushëllues. Mirëpo, nëse është në pyetje Islami, i cili assesi nuk është aq i huaj për vlerat perëndimore siç është filozofia hindu apo budiste, kjo qetësi perëndimore pothuaj detyrimisht çrregullohet me paragjykimet emocionale. Ndoshta kjo është, herë-herë, mendoj, për shkak se vlerat e Islamit janë aq të afërta me ato perëndimore saqë paraqesin provokim potencial për shumë koncepte perëndimore të jetës shpirtërore dhe shoqërore?"

Kam vazhduar kështu t'a parashtroja teorinë time prej para disa vjetësh, teorinë që mbase do të mund të ndihmonte që të kuptohet më mirë paragjykimi i thellë i mbjellë ndaj Islamit, që aq shpesh e gjejmë në literaturën perëndimore dhe mendimin bashkëkohor.

"Që të gjejmë vërtet shpjegim bindës të këtij paragjykimi", - kam thënë, - "duhet të shikojmë larg, pas në histori dhe të tentojmë ta kuptojmë prapavijën psikologjike të raporteve më të hershme ndërmjet botës perëndimore dhe islame. Atë që mendojnë dhe ndjejnë perën-

dimorët për Islamin sot është e rrënjosur në mbresat e tyre që janë krijuar gjatë kryqëzatave".

"Kryqëzatat" - klithi miku im. - "Nuk besoj se synoni të shprehni idenë se diçka që ka ndodhur para gati një mijë vjetësh ka mundur ende të ndikojë në njerëzit e shekullit të njëzetë?"

"Po, pa dyshim ka ndikuar! E di se kjo duket e pabesueshme, por a nuk u kujtohet dyshimi me të cilin janë pritur zbulimet e para të psikoanalistëve kur tentuan të dëftojnë se shpjegimi i pjesës së mirë të jetës emocionale të personalitetit të pjekur mund të gjendet në përvojat e kohës së tij të formimit, do të thotë fëmijërisë së tij të hershme? Po a nuk janë pikërisht kombet dhe qytetërimet personalitete kolektive? Zhvillimi i tyre po ashtu është i lidhur me përvojat e fëmijërisë së tyre të hershme.

Sikur të fëmijët, këto përvoja kanë mundur të jenë të këndshme dhe të pakëndshme; ato kanë mundur të jenë përsosurisht racionale, por edhe e kundërta me të për shkak të shpjegimit naiv fëmijëror të gabueshëm të ndonjë dukurie; modelimi i kontributit të çdo përvoje të tillë varet pikësisht nga intensiteti i tij burimor. Shekulli që drejtpërdrejt u ka paraprirë luftërave kryqtare, do të thotë fundi i mijëvjeçarit të erës së re, do të mund plotësisht të përshkruhet fare mirë si fëmijëria e hershme e qytetërimit perëndimor..."

Kështu vazhdova t'i risillja ndërmend mikut tim, i cili edhe vetë ka qenë historian, se ky ka qenë shekullin në të cilin Evropa për herë të parë pas shekujve të errët që kanë pasuar pas rrënimit të Perandorisë romake, ka filluar ta gjejë rrugën vetjake kulturore. Pavarësisht nga trashëgimia gati e harruar romake, pikërisht atëherë kanë filluar të paraqiten letërsitë e reja në gjuhët Evropiane; të frymëzuara nga përvojat religjioze të kristianizmit perëndimor, shkallërisht janë zgjuar artet figurative nga letar-

gjia të shkaktuar me shpërnguljet luftarake të Gotëve, Hunëve dhe Avarëve; nga kushtet e papjekura të Mesjetës së hershme ka muguulluar bota e re kulturore. Pikërisht në atë pikën kritike, jashtëzakonisht të ndjeshme të zhvillimit të vet, Evropa ka pësuar goditje të tmerrshme - duke folur me gjuhën bashkëkohore, "traumën" në formën e kryqëzatave.

Kryqëzatat lanë përshtypjen më të fuqishme kolektive mbi atë qytetërim që pikërisht bëhej i vetëdijshëm për veten. Duke folur historikisht, ato kanë paraqitur përpjekjen më të hershme - dhe plotësisht të suksesshme - të Evropës që ta shohë vetveten si tërësi kulturore. Asgjë nga ajo që Evropa e ka shijuar më parë apo më vonë nuk mund të krahasohet me entuziazmin që solli deri te kryqëzata e parë. Vala e entuziazmit kaloi nëpër Kontinent, hareja dhe krenaria për herë të parë kaluan kufijtë ndërmjet shteteve, të fiseve dhe klasave. Para kësaj ishin Frankët, Saksonët dhe Gjermanët, Burgunditët dhe Sicilianët, Normanët dhe Llambardianët - përzierja e fiseve dhe racave me mezi kishin diçka të përbashkët përveç faktit se shumica e mbretërive dhe principatave të tyre feudale ka paraqitur mbeturinat e mbretërisë romake dhe se të gjithë kanë predikuar fenë kristiane; mirëpo, në fushatat kryqtare, dhe nëpërmjet tyre, lidhja religjioze është ngritur në rrafsh të ri, çështje e përbashkët për të gjithë Evropianët, koncepti politiko-religjioz i "kristianizmit" që solli deri te koncepti kulturor i "Evropës". Kur papa Urbani II, në fjalimin e vet të njohur në Klermant, në nëntor të vitit 1095, i ftoi krisianët në luftë kundër të "pafeve" që e mbajnë Tokën e shenjtë, ai pati shpallur-sigurisht as vetë këtë duke mos e supozuar-kartën e qytetërimit perëndimor.

Përvoja traumatike e kryqëzatave i ka dhënë Evropës vetëdijen kulturore dhe unitetin, por po kjo përvo-

jë ka qenë e gjykuar që prej atëherë të japë ngjyrë të rrejshme në të cilën Islami është paraqitur në sytë e Perëndimit. Jo thjesht për atë që kryqëzatat kanë qenë derdhje e gjakut. Aq shumë luftëra kanë ndodhur ndërmjet kombeve, e pastaj janë harruar, e aq shumë urrejtje armiqësore, të cilat në kohën e tyre janë dukur të paçrrenjosura, shkallërisht janë kthyer në miqësi. Dëmi që e kanë shkaktuar kryqëzatat nuk është kufizuar vetëm në ndeshjen e armëve. Kjo para së gjithash ka qenë dëmi intelektual-helmimi i shpirtit perëndimor kundër botës muslimane me paraqitjen e qëllimit të gabueshëm të mësimin dhe idealit të Islamit. Sepse, që thirrja në kryqëzatat të jetë e suksesshme, Pejgamberi dhe muslimanët është dashur medoemos të njollosen si antikristianët, kurse religjioni i tij është paraqitur me shprehjet më të zbehta si burim i jomoralit dhe perversionit. Pikërisht në kohën e luftërave kryqtare, të kuptuarit qesharak se Islami është religjioni i sensualitetit të egër dhe forcës brutale, kryerja e ritualit në vend të pastrimit të zemrës, ka hyrë në frymën perëndimore dhe atje ka mbetur; pikërisht atëherë Evropianët emrin e pejgamberit, Muhammedit-po atë Muhammed që ka insistuar që ithtarët e tij t'i nderojnë pejgamberët e religjioneve tjera-me përbuzje e kanë shndërruar në "Mahound".

Shekulli në të cilin fryma e hulumtimit të pavarur ka mundur ta ngrëjë kokën e vet ka qenë ende larg në Evropë; ka qenë lehtë për ata në pushtet ta mbjellin farën e errët të urrejtjes ndaj religjionit dhe qytetërimit, i cili është aq tjetërfare nga religjioni dhe qytetërimi i Perëndimit. Prandaj nuk është fare e rastit që "Vargjet mbi Rolanin" të zjarrta, që e përshkruan fitoren legjendare të kristianizmit ndaj "paganëve" muslimanë në Francën Jugore, është shkruar jo gjatë kohës së atyre betejave por tre shekuj më vonë – me fjalë të tjera, drejtpërdrejt para

luftës së parë kryqtare – menjëherë u bë një lloj i "himnit nacional" të Evropës; po ashtu, nuk është fare e rastit që ky ep luftënxitës shënon fillimin e literaturës Evropiane, për dallim prej letërsive më të hershme, të lokalizuara; qartë, armiqësia ndaj Islamit ka qëndruar mbi djepin e qytetërimit evropian.

Do të mund të dukej si ironi e historisë që kjo urrejtje shumë e vjetër ndaj Islamit, që është me prejardhje religjioze, ende në ndërdije të mos vazhdojë në kohën kur religjioni e ka humbur pjesën më të madhe të ndikimit të vet në frymën e Evropianëve. Mirëpo, kjo nuk është befasuese. E dimë, e dikush mund plotësisht t'i humbë besimet religjioze që i janë dhënë në fëmijëri e që megjithatë disa emocione të veçanta të lidhura me ato besime të mbeten edhe racionalisht në fuqi gjatë tërë jetës së tij të mëvonshme. "E kjo është pikërisht ajo", - kam përfunduar, - "që i ka ndodhur këtij personaliteti kolektiv, do të thotë qytetërimit perëndimor. Hija e luftërave kryqtare pezullon mbi Perëndimin edhe sot, dhe të gjitha reagimet ndaj Islamit dhe botës muslimane bartin gjurmë të shprehura të kësaj vegullie, që vështirë vdes".

Miku im për një kohë të gjatë heshti. Ende mund ta shoh shfaqjen e tij të gjatë, thatanike se si hapëron andej-këndej nëpër dhomë, me duar në xhepa të palltos, duke bërë gjestikulacione me kokë sikur në habitje. Më në fund tha:

"Mund të ketë diç në këtë që thoni... Pa dyshim do të mund të kishte, ndonëse nuk kam mundësi ta vlerësoj "teorinë" tënde i papërgatitur... Por sidoqoftë, në dritën e asaj që ju vetë pikërisht ma thatë, a nuk po kuptoni se jeta juaj, që juve ju duket aq e thjeshtë dhe e pandërlikuar, duhet të duket mjaft e çuditshme dhe e pazakonshme për perëndimorët? A thua nuk do të mund t'i ndani disa për-

voja të juaja vetjake me ta? Përse nuk e shkruani jetëshkrimin? Jam i sigurt se ky do të ishte tekst tërheqës!"

Duke u qeshur jam përgjigjur: "E, mbase do të mund ta bindja vetveten ta lëshoj Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe ta shkruaj librin e tillë. Më në fund, shkrimi është preokupimi im më i hershëm..."

Gjatë javëve dhe muajve vijues përgjigjja ime në shaka pahetuar e humbi pamjen e shakasë. Fillova seriozisht të mendoj për shkrimin e rrëfenjës për jetën time në mënyrë që ashtu, qoftë edhe në masë të vogël të ndihmoj që të ngrihet perdja e rëndë që e ndanë Islamin dhe kulturën e tij nga fryma perëndimore. Rruga ime deri në Islam në shumë aspekte ka qenë unike. Unë nuk jam bërë musliman për shkak se kam jetuar për një kohë të gjatë në mesin e muslimanëve, përkundrazi, kam vendosur të jetoj në mesin e tyre për shkak se e kam përfaqëuar Islamin. A nuk do të mundja, duke ua komunikuar pikërisht përvojat e mia vetjake lexuesve perëndimorë, t'i kontribuoj më shumë të kuptuarit reciprok ndërmjet botës islame dhe perëndimore se sa që do të mundja duke vazhduar punën në pozitën diplomatike të cilën njëjtë mirë do të mund ta plotësonte ndonjë tjetër bashkatdhetar i imi? Më në fund, cilido njeri inteligjent do të mund të ishte ministër pakistanez në Kombet e Bashkuara, por sa do të ishte në gjendje t'u fliste perëndimorëve për Islamin siç do t'u flisja unë? Kam qenë musliman, por po ashtu jam me prejardhje perëndimore dhe për këtë arsye do të mund të flisja me gjuhët intelektuale si të Islamit, ashtu edhe të Perëndimit...

Dhe kështu, nga fundi i vitit 1952, u tërhoqa nga Ministria pakistaneze e Punëve të Jashtme dhe fillova ta shkruaj këtë libër. A është ky "tekst tërheqës" si ka supozuar miku im amerikan, nuk mund të them. Kam mundur vetëm të orvatem sërish të kaloj në mendime nga

kujtimi - me ndihmën e vetëm disa shënimeve të vjetra, shkrimeve jo të lidhura në ditar dhe disa artikujve gazetareskë që i kam shkruar në atë kohë - të vijës së ngatërruar të zhvillimit që ka rrjedhë shumë vjet në viset e gjeogra gjeografike.

Dhe ja këtë rrëfenjë; jo rrëfenjën e tërë jetës sime, por vetëm të atyre viteve para se prej Arabisë kam shkruar në Indi - atyre viteve interesante të kaluara në udhëtime nëpër gati të gjitha vendet ndërmjet shkretëtirës libiase dhe majave të mbuluara me barë të Pamirit, ndërmjet Bosforit dhe Detit arab. Duhet pasur parasysh se ajo është rrëfyer në kuadër dhe në rrafshin kohor të udhëtimit tim të fundit kohor nga brendia e Arabisë në Mekë nga fundi i verës 1932, sepse pikërisht gjatë kohës së atyre njëzet e tri ditëve fotografia e jetës sime më është bërë e qartë.

Arabia e paraqitur në faqet që vijojnë nuk ekziston më. Izolimi dhe paprishmëria e saj janë shkatërruar nga guximi i fuqishëm i naftës dhe arit që nafta e solli. Thjeshtësia e saj e shkëlqyeshme është zhdukur, e me këtë edhe shumë nga ajo që ishte njerëzisht e thjeshtë. Me dhembjen që ndiej për diç të çmueshme, pakthyeshëm të humbur, e kujtoj atë udhëtim të gjatë të fundit shkretinor, kur kemi kalëruar, ne të dytë, në deve, nëpër dritë vezëlluese...

## I. Etja

- 1 -

Ne të dytë udhëtojmë, udhëtojmë hipur mbi deve. Përcëllimi diellor mbi kokat tona. Çdo gjë është drita vezulluese, shkëlqyese dhe vibruese. Bregoret ranore të ngjyrosura kuqërremtë dhe ngjyrë portokalli, bregore pas bregore, vetmia dhe heshtja përcëlluese, dy njerëz në deve në atë ecje lëkundëse që u bënë të përgjumur, ashtu që e harroni ditën, diellin, erën e zjarrtë dhe rrugën e gjatë. Shkurret e barit të verdhë rriten rrallë në majat e bregoreve ranore, e aty - këtu gajushat gunga-gunga të hamdit gjarpëronin mbi rërë si gjarpërinj viganë. Shqisat janë të përgjurmura, lëkundeni në shalë dhe mezi dëgjoni çkado tjetër pos krikëllimës së rërës nën këmbët e deveve dhe fërkimit të shalës për gjurin tuaj. Fytyrën e ke të pështjellur që të mbrohet nga dielli dhe ju ndiheni sikur bartni vetminë tuaj vetjake, si njëmendësi të prekshme, nëpër gjithë këtë, drejt nëpër këtë... deri te pusët e Tajmes... deri te pusët e errëta të Tajmes që u afrojnë ujë të etshmëve... "...Drejt nëpër Nufud deri në Tajme..." dëgjoj zërin dhe nuk e di a mos është ky zë nga ëndrra ose nga zëri i përcjellësit tim.

"A mos the diç, o Zejd?"

"Kam folur", - ma kthen përcjellësi im, - "se si pak njerëz do të mësyenin të nisen nëpër Nufud vetëm që t'i shohin pusët e Tajmes..."

Zejdi dhe unë kthehemi prej Kasr Atajmimit në kufi ndërmjet Nexhdit dhe Irakut, ku kemi shkuar me kërkesë të mbretit Ibn Saud. Pasi e kam kryer detyrën time, e Zejdi, përcjellësi i autorit duke pasur mjaft kohë të lirë në disponim, vendosa ta vizitoj oazën e largët, të lashtë Tajmën, rreth treqind kilometra drejt jugperëndimit (Temën nga Dhjata e Vjetër për të cilën Isaia ka thënë "që banorët e krahinës së Temës i ofrojnë ujë atij që është i etshëm"). Uji me bollëk në Tajm, pusët e saj të mëdhenj që nuk i gjenë në tërë Arabinë, kanë bërë që në epokën paraislamike oaza të bëhet qendër e tregtisë së karvaneve dhe qendër e kulturës së hershme arabe. Një kohë të gjatë kam dëshiruar ta shoh, dhe kështu, duke i mospërfillur rrugët indirekte të karvaneve, kemi mësyre nga Kasr Atajmini drejt zemrës së Nufudit të Madh, shkretëtirës së kuqërremtë ranore që shtrihet aq pushtetshëm ndërmjet rrafshlartës së Arabisë qendrore dhe shkretëtirës së Sirisë. Nuk ka gjurma as shtigje në këtë pjesë të djerrinës së tmerrshme. Era kujdeset për atë që kurrfarë shputash të njerëzve dhe kafshëve të mos lënë gjurmë të përhershme në rërën e butë, të përkulshme, dhe që kurrfarë shenjë treguese mos të mbetet gjatë kohë si paralajmërim syrit të udhëtarit. Nën goditjet e erës bregoret ranore vazhdimisht ndërrojnë format e veta; duke u derdhur në lëvizjen e lehtë, të pahetueshme nga forma në formë, bregoret shndërrohen në lugina, e luginat rriten në bregore të reja të shënjua me barin e thartë, të vdekur, që pafuqishëm fërshtërinë në erë, i idhët si hiri madje edhe për gojën e deves.

Ndonëse e kam kaluar këtë shkretëtim disa herë në shumë drejtime, nuk do të mbështetesha në vetvete që mos të humbi nëpër të, prandaj jam i kënaqur që Zejdi është me mua. Ky vend është vendlindja e tij; ai i përket fisit Shamar që jeton në skajet jugore dhe lindore të Nufu-

dit të Madh, dhe kur shirat e bollëkshëm të dimrit befasisht t'i shndërrojnë bregoret ranore në luadhe të këndshme, ata i kullojnë devet e veta në të, gjatë disa muajve të vitit. Tabiatet e shkretëtirës janë në gjakun e Zejdit dhe zemra e tij u rrahë atyre.

Zejdi sigurisht është mashkulli më i këndshëm që ndonjëherë e kam njohur: me ballë të gjerë e trup të thatë, trupmesëm, bukur i zhvilluar, plot forcë të gjallë. Në fytyrën e ngushtë ngjyrë drithi, me eshtra rreptë të trajtësuar të fytyrës dhe me buzët e rrepta dhe në të njëjtën kohë të ndijshme pezullon ai dinjitet plot pritje, aq karakteristik për Arabinë shkretinore - dinjiteti dhe qetësia të bashkuara në harmoni intime. Ai është kombinim i lumtur i racës së pastër beduine dhe jetës qytetare të Nexhdit, krahas sigurisë së ruajtur beduinase të instinktit, pa mosekzistimin emocional beduinase, krahas urtësisë së fituar praktike të qytetarëve duke mos iu nënshtruar çoroditjeve të tyre. Ai, sikur edhe unë, kënaqet në aventura duke mos ngarendur pas tyre. Prej rinisë më të hershme jeta e tij ka qenë e mbushur me përjetime dhe mallëngjime: si kalorës - djalosh në korpusin jo të rregullt të deveve që e ka ngritur qeveria turke në fushatë në Siujdhesën e Sinait gjatë kohës së Luftës së Madhe, si mbrojtës i vendlindjes së vet të shamarëve kundër Ibn Saudit, si kontrabandist i armëve në Gjirin Persik, dashnor i zjarrtë i shumë grave në shumë pjesë të botës arabe (natyrisht, me të gjitha sipas ligjit i martuar në këtë apo atë kohë, e pastaj po ashtu sipas ligjit është ndarë), tregtar me kuaj në Egjipt, mercenar në Irak dhe, më në fund, gjatë pothuaj pesë vjetëve, përcjellësi im në Arabi.

Tash nga fundi i verës së vitit 1932, ne udhëtojmë së bashku, siç kemi udhëtuar më herët, duke gjarpëruar rrugës sonë të vetmuar ndërmjet bregoreve ranore, duke u ndalur në ndonjë prej puseve të rralla, kurse duke pushu-

ar gjatë natës nën yje. Krikëllima e vazhdueshme e rërës përcëlluese nën këmbët e kafshëve; nganjëherë, gjatë kohës së marshimit, kënga e zërit të ngjirur të Zejdit në ritmin e të ecurit të devesë; kampimi i natës, zierja e kafesë dhe orizit dhe ndonjë lojë e vrazhdë; flladi i freskët i erës nëpër trupin tonë derisa jemi të shtrirë natën në rërë; mbi bregoret ranore lindja e diellit, që e shpërthen të kuqen, papritmas si fushqetë, e nganjëherë, sikur sot, çudi e jetës që zgjohet në bimë e cila rastësisht është ujitur me ujë.

Qemë ndalur që ta falim namazin e drekës. Derisa i kam larë duart, fytyrën dhe këmbët, nga rrësheka u derdhën disa pika ujë përtej plisave të tharë të barit, bimëve të mjera të vogla, të verdha, të thara dhe të pajetë nën rrezet e pamëshirshme të diellit. Por pasi uji pikonte nëpër të, dridhmja i kaloi nëpër kërcyllin e vyshkur dhe pashë se si ato ngadalë, duke u dridhur, zhvillohen. Edhe disa pika dhe kërcenj të ri u nisën e u lidhën e pastaj u drejtuan ngadalë, duke pritur, duke u dridhur... E kam mbajtur frymën derisa kam derdhur edhe pak ujë mbi plisin e barit. Tash lëvizte më shpejt, më gjallë, sikur ndonjë fuqi e fshehtë e ka zgjuar nga ëndrrat e tij vdekjeprurëse. Kërcyllët e tij - çfarë kënaqësie është të shikohet kjo! - janë mbledhur dhe janë shtrirë si rremat e yllit të detit, në shikim të kapërcyer me krenosjen e turpërueshme por të papërmbajtur, orgjia e vogël e mirëfilltë e kënaqësisë shqisore; dhe jeta ngadhënjeshëm sërish hyn në atë që një çast më parë ka qenë e vdekur, hyn dukshëm ephërisht, papërkulshëm në madhërinë e vet dhe jashtë çdo të kuptuari.

Jeta në madhësinë e vet... këtë gjithnjë e ndieni në shkretëtirë. Për atë që është aq e rëndë, që është rëndë të mbahet, ai gjithnjë është si dhuratë, thesar dhe befasi. Sepse shkretëtira është gjithnjë befasuere, madje nëse edhe me vite e kemi njohur. Nganjëherë, kur mendoni

se mund ta shihni në tërë vrazhdësinë dhe shkretërinë e saj, ajo zgjohet nga gjumi i saj, e zbulon frymën e vet - e butë, e zbehtë; bari i gjelbër paraqitet befas atje ku ka pasur vetëm rërë dhe pllakëza zhuri. Ajo e zbulon sërish frymën e vet - tufa e zogjve të vegjël valëvitet nëpër ajër - prej kah? ku? - me shtat të thatë, krahë të gjatë, të gjelbra zymryde; ose tufa e karkalecëve ngrihet mbi tokë me hov të papritur, vrershëm, vegullisht dhe pafund duke gumëzhitur, si hardhi të luftëtarëve të uritur...

Jeta në madhësinë e vet, madhësinë e skamjes, gjithnjë është befasuese. Këtu qëndron tërë aroma e pamër e Arabisë, shkretëtirave ranore siç është kjo dhe shumë peizazheve tjera të ndryshueshme.

Nganjëherë dhe është i përbërë prej llavës, të zezë e të dhëmbëzuar, nganjëherë bregoret ranore pa fund, herë-herë kjo është "vadi", shtrat i tharë i lumit, ndërmyet kodrinave gurore të mbuluara me ferra nga të cilat kërcen lepurit i frikësuar para jush, herë - herë kjo është rërë e shkrifët me gjurmat e gazelës dhe disa shkëmbinj nga zjarri të skuqur mbi të cilët udhëtarët kaheerë të harruar kanë zier ushqimin e vet në ditët kaheerë të harruara. Nganjëherë hasni në fshatin nën palma dhe rrotat e drurit mbi puse u bëjnë muzikë e ju këndojnë pa pushim. Rrallë hasni në pus të vetmuar në mes rrafshit të shkretëtirës, me barinj të beduinës se si ngarendin rreth tij që t'u japin ujë dhenve dhe deveve të veta të etshme - ata këndojnë në kor derisa e nxjerrin ujin me kofat e mëdha prej lëkure dhe i derdhnin në koritat e lëkurta në kënaqësinë e kafshëve të entuziazmuara. Atëherë sërish vetmia në stepe mbi të cilat zotëron dielli pa mëshirë; balluket e barit të fortë, të verdhë dhe shkurret e gjethuara që zvarriten nëpër dhe në degët gjarpërore duke iu ofruar kullotë mirëseardhëse deveve tuaja; druri i vetmuar i akacies i shtrinë gjerë degët e veta drejt qiellit të për-

himtë në të kaltër; ndërmjet bregoreve nga dheu dhe shkëmbijve shfaqet, duke shkuar, majtas e djathtas, e pastaj zhduket si fantazmë, hardhuca me lëkurë ari për të cilën thonë se kurrë nuk pi ujë. Në luginë janë tendat e zeza nga leshi i dhisë; kopeja e deveve në kthimin e pasditshëm në shtëpi, barinjte u hipin në shpinë të thatë deveve të reja, e kur u bërtasin kafshëve të veta, qetësia e anës i pi zërat e tyre dhe i gëlltitë pa jehonë.

Nganjëherë shihni hijet shkëlqyese në horizont; a janë ato vranësira? Ato pezullojnë ulët shpesh duke e ndërruar ngjyrën dhe pozitën, tash duke ngjasuar në malet e murme e të gështenjta - por në ajër, pak mbi horizont - e tash, që secili mund të shohë, në prozimet shkëmbore të pishave të gurëzuara; por - në ajër. E kur zbresin më poshtë dhe shndërrohen në liqene dhe lumet në rrjedhës që vezullueshëm reflektojnë malet dhe druritë në ujërat e veta tërheqëse, papritmas zbuloni ç'është: miklimi provokues i xhindit, mashtrimet që aq shpesh i kanë shpjerë udhëtarët drejt shpresave të rrejtshme e nëpërmjet kësaj deri në vdekje; dora juaj vetvetiu shkon kah rrësheka me ujë në shalën e juaj... Netët janë përplot rreziqe të tjera, kur fiset janë në përzierje luftarake dhe udhëtarit nuk e ndez zjarrin derisa kampon në mënyrë që mos ta vërejnë nga largësia, derisa është ulur me orë të tëra me pushkë mes gjunjëve. E atëherë ditët e qetësisë kur, pas endjes së gjatë vetmuese, e takoni karvanin dhe në parambrëmje dëgjoni kuvendimin e njerëzve seriozë, të djegur në diell rreth zjarrit të kampit. Ata flasin për gjërat e thjeshta të rëndësishme të jetës dhe vdekjes, për urinë dhe ngimësinë, për krenarinë, dashurinë dhe urrejtjen, për këndjet e trupit dhe qetësinë e tij, për luftërat, për shkurret e palmave, në fshatin e largët të lindjes - e kurrë nuk dëgjoni llomotitje boshe për shkak se në shkretëtirë nuk mund të llomotitet...

Ju e ndieni ftesën e jetës në ditët e etjes, kur gjuha ngjitet për qiellzë si copë druri të thatë, kurse horizonti në vend të shpëtimit ofron erën e zjarrtë samum<sup>2</sup> dhe vorbullën e rërës. E ato ditë të gjata, kur jeni musafir në tentat beduinase e njerëzit ju sjellin enët plot qumësht - qumësht të deveve të trasha në fillim të pranverës, kur stepet dhe bregoret ranore, pas shirave të shumtë, janë të gjelbra si kopshte, kurse kafshët mjelëse të rënda e të rumbullakëta; nga këndi i tendës mund të dëgjoni të qeshurit e femrës derisa për nderin tuaj u ziejnë mish deleje në zjarr të hapur.

Dielli zhduket pas kodrinave sikur metali i kuq; qielli plot yje natën është më i lartë se kudo tjetër në botë, thellë dhe pa ëndrra fleni nën yje; mëngjeset gdhihen të zbehta e të përhimta dhe të freskëta. Netët e dimrit janë të ftohta, erërat e ashpra e godasin zjarrin e kampit rreth të cilit me bashkudhëtarët jeni struktur duke kërkuar ngrohtësi, ditët e verës janë përcëlluese kur udhëtoni, udhëtoni në deve që përkundet andej - këndeje në orët e pafund, fytyrat e pështjellura që t'i mbronin nga era e thatë, me shqisa të përgjumura, derisa lart mbi ju në nxehtësinë përvëluese të drekës fluturon rreth e rrotull pretarja...

## - 2 -

Pasditja me bregoret e veta ranore, me qetësinë dhe vetminë ngadalë po na ik.

Së shpejti vetminë e ndërpret grupi i beduinëve që e ndërpresin rrugën tonë. Katër apo pesë meshkuj dhe dy femra udhëtojnë me deve, prej të cilave njëra është e ngarkuar me tendën e zezë, tenxheret për zierje dhe përgatitjen tjetër të jetës nomade, e mbi të gjitha këto edhe disa fëmijë. Si afroheshin, i ndalnin kafshët:

"Es-selamu alejkum! - Paqja qoftë me ju! Dhe përgjigja:

"Ve alejkum'us-salam ve rahmetullah". - Edhe me ju qoftë paqja dhe mëshira e Zotit!"

"Ku jeni nisur, o udhëtarë?"

"Në Tajmë, nëse don Zoti".

"Nga Kasr Atajmimi, vëllezër", - u përgjigja. Pastaj qetësi. Njëri prej tyre, i dobët, njeri pak i vjetër me vija të mprehta të fytyrës dhe me mjekër të vrazhdë të zezë, sigurisht se është udhëheqës. Shikimi i tij po ashtu është i zi dhe i rreptë derisa kalon prej Zejdit dhe ndalet dyshimshëm te unë, të huajit natyrë bardhë që ashtu papritmas është paraqitur prej askund në këtë shkretëtirë të paudhë; i huaji që thotë se vjen nga drejtimi i Irakut, të cilin e mbajnë britanezët, do të mund kreytësisht lehtë (pothuajse mund t'i lexojë mendimet e fytyrës së mprehtë) të jetë ndonjë pabesimtar që pa leje hyn në vendin arab. Dora e plakut luan, sikur në hutesë, me mollën e shalës së vet derisa njerëzit e tij, tash të shpërndarë, të grupuar rreth nesh, qartë presin që të flasë. Pas disa çasteve, ai sikur më nuk është në gjendje ta durojë heshtjen, më pyeti:

"Nga cilët arabë je ti?" - duke menduar se cilit fis ose krahinë i përkas. Por, madje edhe më parë se që jam në gjendje të përgjigjem, krahas buzëqeshjes pason edhe njohja:

"Ah, tash të njoh! Të kam parë me Abdulazizin! Por, kjo ka qenë kaheerë - para katër viteve të gjata..."

Ai e shtriu dorën miqësisht kah unë dhe i kujtohet koha kur kam jetuar në kështjellën e mbretit në Rijad, kurse ai atje ka arritur në përcjellje të kryeparit nga Shamari që ka ardhur të shprehë respektin e fisit të vet ndaj Ibn Saudit, të cilin beduinët gjithnjë e quajnë me emrin Abdulaziz, pa kurrfarë titulli formal të nderit; në mirësjelljen e vet të lirë njerëzore ata shohin te mbreti vetëm njeriun që, pa dyshim, duhet nderuar, por jo më tepër prej asaj që njeriu meriton. Dhe kështu një kohë u kuj-

tua, duke folur për këtë apo atë, duke i ndërruar anekdotat për Rijadin, në të cilin dhe rreth të cilit deri në një mijë musafirë në ditë jetojnë nga bujaria e mbretit, duke pranuar në shkuarje dhurata në pajtim me pozitën e çdo njeriu - prej duarve plot para argjendi ose abasë (zhguni) deri te qeset e rënda me para ari, kuaj ose deve që shpesh ua ndanë prijësve.

Por bujaria mbretërore nuk është aq çështje e qeses sa është çështje e zemrës. Mbase më shumë se çdo gjë tjetër është ngrohtësia e ndjenjës, që i shtynë njerëzit rreth tij që ta duan duke mos e përjashtuar as vetë mua.

Gjatë kohës së të gjitha viteve që i kam kaluar në Arabi, miqësia e Ibn Saudit ka pezulluar si vezullim i ngrohtë mbi jetën time.

Ai më quan mik të vetin, ndonëse ai është mbret e unë vetëm gazetar. Edhe unë atë e quaj mik - jo vetëm për atë që gjatë viteve që kam jetuar në mbretërinë e tij ka dëftuar shumë miqësi, sepse këtë ai ia dëfton shumë njerëzve; e quaj mik timin për shkak se në rast nevoje m'i zbulon mendimet e veta më të sinqerta, sikur që ua hap qesen e vet shumë të tjerëve. Dëshiroj ta quaj mik timin sepse, përkundër të gjitha gabimeve të veta - e ato nuk janë të vogla - ai është jashtëzakonisht njeri i mirë. Jo thjeshtë "zemërmirë", sepse mirësia e zemrës mund nganjëherë të jetë gjë e lirë. Sikur që me admirim do të thoshit për shpatën e vjetër dimiskite se është armë "e mirë", sepse i posedon të gjitha vetitë që mund t'i pritni nga arma e llojit të tillë, kështu unë vërtet e konsideroj Ibn Saudin njeri të mirë. Ai është i rrethuar në vete dhe gjithnjë e ndjek rrugën e tij vetjake, e nëse shpesh edhe hamendet në aksionet e veta, kjo është për atë që kurrë nuk orvatet që të jetë çkado tjetër përveç ai vetë.

Për herë të parë jam takuar me mbretin Abdulaziz Ibn Saudin në Mekë në fillim të vitit 1927, disa muaj Pasi kam kaluar në Islam.

Vdekja e papritur e paradokohshme e gruas sime, që më ka përcjellë në këtë haxhin tim të parë, më ka bërë të dëshpërueshëm e të pashoqërueshëm. Me pikëllim jam përpjekur që të nxirrem nga terri dhe pikëllimi skajor. Pjesën më të madhe të kohës e kam kaluar në dhomën time, kam mbajtur lidhje vetëm me disa njerëz dhe me javë nga njerëzishmëria i jam shmangur madje edhe vizitës së rëndomtë mbretit.


Një ditë, derisa isha në vizitë te njëri prej mysafirëve të huaj të Ibn Saudit - më kujtohet, ky ishte Haxhi Agos Salimi nga Indonezia - qesh njoftuar se sipas urdhëresës së mbretit, emri im që kyçur në regjistrin e mysafirëve të tij! Duket se ka qenë njoftuar për shkakun e ngurrimit tim dhe se këtë e ka pranuar me kuptueshmëri memece. Dhe kështu, sikur mysafir që ende kurrë nuk e ka parë fytyrën e shtëpiakut të vet, u nisa drejt shtëpisë së shkëlqyeshme në pjesën jugore të Mekës, afër ngushticës shkëmbore nëpër të cilën kalon rruga për Jemen. Nga tarrat kam mundur të shohë pjesën më të madhe të qytetit, minaren e xhamisë së madhe, mijëra kube të bardha shtëpish me parmakë kulmorë të punuar nga tullat e ngjyrosura, kodrinat e vdekura shkretinore mbi të cilat shkëlqen qielli si metal i kulluar.

Megjithatë, kam mundur ende ta vazhdoj shtyrjen e vizitës sime Mbretit sikur rastësisht mos ta kisha takuar emirin, Fejsalin, djalin e dytë të tij, në bibliotekë nën harknajat e xhamisë së madhe. Ka qenë e këndshme të ulesh në atë dhomë të gjatë, të ngushtë të rrethuar me libra të vjetër arabë, persikë e turk, heshtja dhe errësira e saj më kanë mbushur me qetësi. Mirëpo, një ditë heshtja e zakonshme që ndërprerë me hyrjen shushuritëse të grupit të

njerëzve të cilëve u ka paraprirë roja e armatosur trupore; ky ishte emiri Fejsal, me suitën e vet në kalim nëpër bibliotekë drejt Ka'bes. Ka qenë i gjatë dhe i hollë me dinjitet që larg i kalonte njëzet e dy vitet e tij dhe fytyrën e tij qose. Përkundër rinisë, i qe besuar pozitë me rëndësi të vice mbretit të Hixhazit, Pasi babai i tij e pushtoi vendin dy vjet më herët (vëllai më i vjetër i tij, princi trashëgimtar Sa-udi, ka qenë vice - mbret i Nexhdit, derisa vetë mbreti ka kaluar gjysmë viti në Mekë, kryeqytetin e Hixhazit, kurse gjysmën e dytë në kryeqytetin e Nexhdit, Rijad).



۱۹۷۵/۱۰/۳



۱۹۷۵/۱۰/۳

Mbreti Fejsal

Bibliotekari, dijetari i ri mekas me të cilin prej para do kohe jam miqësuar, më prezantoi para princit. U përshëndet me dorë me mua, e kur iu përkula, ai me lehtësi e ngriti kokën time me gisht dhe fytyrën e tij e ndriçoi buzëqeshja e ngrohtë.

"Ne nga Nexhdi mendojmë se njeriu nuk guxon të përkulet para njeriut, ai duhet të përkulet vetëm para Zotit në namaz!"

Dukej i këndshëm, ëndërrimtar dhe ngapak i përmbajtur e i marrshëm - përshtypje që është konfirmuar viteve të mëvonshme të njohjes sonë. Qëndrimi i tij fisnik nuk ishte artificial, dukej sikur po rrezaton prej tij. Derisa kam biseduar me të atë ditë në bibliotekë, befasisht kam ndier dëshirë të fuqishme që të takohem me babain e këtij djaloshi.

"Mbreti do të ishte i kënaqur të të shihte", - tha emir Fejsali. "Përse po i shmangesh?"

Mëngjesin vijues sekretari i emirit erdhi te unë me veturë dhe më përcolli deri te pallati i Mbretit. Kaluam nëpër rrugën tregtare El-Mala ngadalë duke depërtuar nëpër rrëmujën e zhurshme të deveve, beduinëve dhe shitëve të zëshëm të të gjitha llojeve të mallrave beduinase, - shala për deve, vithanike, qilima, rrësheka për ujë, shpata të dekoruara me argjend, tenda dhe enë mesingu për kafe - pastaj rrugës së gjerë, të qetë e të hapur derisa në fund nuk arritëm deri te shtëpia e madhe në të cilën ka banuar Mbreti. Shumë deve të shaluara e mbushnin hapësirën e hapur para tij dhe robërit e shërbëtorët e shumtë lëviznin rreth shtyllës hyrëse. Më futën në dhomën e gjerë me shtylla, dyshemeja e së cilës ishte e mbuluar me qilima të lirë. Shillet e gjera, të mbuluara me pëlhurë të përhimtë në të verdhë, shtriheshin përgjatë mureve, kurse gjethet e gjelbra mund të shiheshin nëpërmjet

dritareve: fillimi i kopshtit që është kultivuar me mund të madh në trollin e thatë të Mekës. U shfaq robi i zi.

"Mbreti po të thërret".

Kam hyrë në dhomën që i ngjasonte asaj parapra-kes, vetëm që ishte shumë më e vogël dhe e ndritshme, nga një anë plotësisht e hapur kah kopshti. Qilimët e pasur persikë e mbulonin dyshtemenë; në dritaren e madhe të ballkonit të kthyer kah kopshti ishte i ulur Mbreti me këmbë të kthyer në shilte, e te këmbët e tij në dyshteme sekretari shkruante sipas diktatit. Kur hyra, mbreti u ngrit, i shtriu të dy duart dhe tha:

"Ehlen ve sehlen" - që do të thotë "Keni arritur tash në familjen tuaj dhe ju qoftë trolli i lehtë dhe i rrafshhtë nën këmbë"- shprehja më e vjetër dhe më e përshtatshme arabe për mirëseardhje.

"Vetëm një çast, shkresa gati është mbaruar".

Derisa në qetësi vazhdoi të diktojë, e filloi bisedën me mua duke mos i përzier kurrë dy tema. Pas disa fjali-ve formale, ia kam dorëzuar rekomandimin me shkrim. Ai e lexoi atë - çka do të thotë, duke i bërë tri gjëra në të njëjtën kohë - e pastaj, duke mos e ndërprerë diktimin as të pyeturit e tij për gjendjen time, e porositi kafënë.

Deri në atë çast tashmë kam pasur rast që më për së afërmi ta vështroj. Ka qenë aq harmonishëm i formuar sa që dimensionet e tij të mëdha - është dashur të jetë i lartë së paku dy metra - janë bërë të dukshme vetëm kur ka qëndruar në këmbë. Fytyra e tij, e kornizuar me kufi-në tradicionale të karituruar kuq e bardhë me ar e thurur në krye, ishte e dallueshme burrërore. Kishte mjekër dhe mustaqe të shkurtuara shkurt sipas modës në Nexhd; ki-shte ballë të lartë, hundë të fortë si të shqiponjës, buzët e plota nganjëherë dukeshin pothuaj femërore në njomësi-në e vet sensuale, e megjithatë nuk kanë qenë të buta. Derisa fliste, vijat e tij të fytyrës ngjallehin me lëvizsh-

mërinë e parëndomtë, por në qetësi fytyra e tij ishte disi e pikëlluar, sikur është tërhequr në ndonjëfarë izolimi të brendshëm; ndoshta sytë e tij thellë të vendosur kishin ndonjë lidhje me këtë. Bukuria madhështore e fytyrës së tij ishte lehtë e cunuar me shprehjen e turbullt të syrit të tij të majtë në të cilin dallohej njolla e bardhë. Më vonë kam mësuar tregimin për këtë lëndim që shumica e të pa-informuarve ia kanë përshkruar shkaqeve natyrore. Mirëpo, në realitet deri te kjo ka ardhur nën rrethana tragjike.

Para disa viteve, një nga gratë e tij, me rekomandimin e dinastisë rivale Ibn Rashid, pat qitur helm në enën me aromë - kemtarin e tagarit të vogël që përdoret në tubimet ceremoniale në Nexhd - me qëllim të qartë që ta mbysë. Sikur edhe rëndom, tagari së pari iu afrua Mbretit, para se të fillojë të qarkullojë ndër mysafirët. Te marrja e parë e aromës Ibn Saudi menjëherë hetoi se diç nuk është në rregull me aromën dhe e hodhi enën në dysheme. Kujdesi i tij ia shpëtoi jetën, por megjithatë syri i majtë iu dëmtua dhe pjesërisht iu verbua. Por, në vend që t'i hakmerrej gruas tradhtare, që shumë pushtetarë tjerë në vendin e tij sigurisht do ta binin, ai ia fali - ishte i bindur se ajo ka qenë sakrificë e ndikimeve të pashmangshme të familjes së vet, e cila ishte në lidhje gjinore me shtëpinë e Ibn Rashidit. Ai thjesht bëri divorc me të dhe e përcolli te familja e saj në Hail, duke i dhënë me bollëk ari e dhurata.

Pas këtij takimit të parë, Mbreti ka dërguar dikë tek unë gati çdo ditë. Një mëngjes kam shkuar me qëllim që ta lusë, pa shpresë të madhe se do të më lejojë, për leje të udhëtoj në brendi të vendit, sepse Ibn Saudi, sipas rregullit, nuk u ka lejuar të huajve ta vizitojnë Nexhdin. Megjithatë, pikërisht kur dëshiroja ta shtroj problemin, Mbreti papritmas hodhi shikimin e shkurtër, të mprehtë kah unë - shikim i cili sikur kishte depërtuar deri te mendimet e mia të pashqiptuara - buzëqeshi dhe tha:

"A do të niseshe, ti, o Muhammed, me ne në Nexhd, dhe të mbetesh disa muaj në Rijad?"

Mbeta gojëhapur, qartë, edhe të pranishmit e tjerë. Ftesa ashtu spontane të huajit ka qenë pothuaj e panjohur.

Ai vazhdoi: "Do të dëshiroja të udhëtosh me mua me veturë muajin vijues".

Mora frymë thellë dhe u përgjigja: "All-llahu le të ta zgjasë jetën, o imam, por çfarë dobie do të kisha unë nga kjo? Çfarë dobie do të kisha që të udhëtoj pesë apo gjashtë ditë prej Mekkes deri në Rijad, e që prej tokës të shohë vetëm shkretëtirën, disa bregore ranore dhe, mbase, diku në horizont, njerëzit si shkëmbinj... Nëse nuk kundërshton, o Jetëgjatë, deveja më mirë do të më përgjigjej se sa të gjitha veturat tuaja".

Edhe Ibn Saudi u qesh: "A vërtet ke shumë dëshirë që t'i shohësh në sy beduinët e mi? Që më parë më duhet të të paralajmëroj: ata janë popull i prapambetur, kurse Nexhdi im është vend i shkretë pa joshje; shala në deve do të jetë e fortë, kurse ushqimi i njëtrajtshëm në rrugë - vetëm oriz dhe hurma, e herë - herë mish. Por, ashtu qoftë. Nëse këtë ta do zemra, do të shkosh. Më në fund, ndoshta edhe nuk do dëshpërohesh që e ke njohur popullin tim; ai është i varfër, nuk di gjë dhe s'është asgjë - por zemra e tij është plot përkushtim dhe besim".

Disa javë më vonë, i furnizuar me deve të mbretit, gjëra ushqimore, tendë dhe udhëheqës, jam nisur rrugës rreth e rrotull në Rijad ku kam arritur pas dy muajve. Ky ishte udhëtimi im i parë në brendi të Arabisë, i pari prej shumë udhëtimeve, sepse disa muaj për të cilët ka folur Mbreti, janë shndërruar në vite - sa lehtë shndërrohen në vite - të kaluara jo vetëm në Rijad, por gati në çdo pjesë të Arabisë. Kurse shala më nuk ishte e fortë...

"I dhashtë jetë All-llahu Abdulazizit", - tha fytyra e mprehtë. "Ai i don beduinët, kurse beduinët e duan atë".

E përse edhe jo - pyetesha unë. Bujaria e mbretit ndaj beduinëve të Nexhdit qe bërë karakteristikë e përhershme e administratës së tij: ndoshta jo shumë e denjë për admirim për shkak se dhuratat e rregullta në të holla që Ibn Saudi ua ndanë prijësve fisnorë dhe shokëve të tyre bërë që të bëhen aq të varur nga bujaria e tij sa që kanë humbur çdo motiv për t'i përmirësuar kushtet e veta jetësore me angazhimin vetjak, shkallërisht duke u fundosur në gjendjen e marrësit të sadakasë, të kënaqur për të mbetur injorantë dhe përtacë.

Gjatë tërë bisedës sime me Fytyrën e mprehtë, Zejdi dukej i padurueshëm. Derisa fliste me njërin prej njerëzve, sytë e tij shpesh kthehen drejt meje sikur dëshiron të më kujtojë se para nesh është rrugë e gjatë dhe se ngjallja e kujtimeve dhe përsiatja nuk i shpejtojnë hapat e deveve.

Shkojmë. Beduinët shamaras udhëtojnë drejt lindjes dhe së shpejti zhduken pas bregoreve ranore. Qysh prej atëherë mund të dëgjojmë se si njëri prej tyre këndon ndonjë këngë njëtrajtëshe nomade, çfarë këndon kalorësi i deveve që ta motivojë kafshën dhe ta thejë monotoninë e udhëtimit të vet. Derisa Zejdi dhe unë vazhdojmë rrugën tonë drejt perëndimit, Tajmës së largët, melodia gradualisht zhduket dhe kthehet heshtja.

### - 3 -

"Shiko!" Zëri i Zejdit e ndërpreu heshtjen. "Lepuri!"

E ktheva shikimin drejt tufës së gëzofit të përhimtë që kërcen nga grumbulli i shkurreve, derisa Zejdi rrëshqiti nga shala dhe e hoq shkopin e drurit. Ai kërcëu pas lepurit dhe mori hov me shkop mbi kokën e vet që ta hedhë, por pikërisht kur dëshiroi që ta rrotullojë këmba i zuri në rrënjë të hamdit, ai u përul në tokë - kurse lepurit u zhduk...

"Na iku darka e mirë!", - qeshëm, derisa po ngrihej ngushëllueshëm duke shikuar në shkopin e vet. "Por nuk është me rëndësi Zejd, ky lepur nuk qe nafaka jonë..."

"A je lënduar, Zejd?"

"Eh, kjo s'është asgjë. Vetëm e kam përdredhur këmbën. Së shpejti do të jetë më mirë".



Mbreti Ibn Saud

Por nuk është mirë. Pas një ore udhëtimi me deve shoh kokrrat e djersës në fytyrën e Zejdit, e kur e shikova shputën e tij, pashë se nyja rrezikshëm është përdrethur dhe mjaft është ënjtur.

"Është e padobishme të vazhdohet kështu, Zejd. Po ndalemi këtu. Një natë pushim do të të pushojë".

Duket se Zejdi tërë natën ishte jo i qetë për shkak të dhembjeve. Zgjohet shumë para mëngjesit dhe shpurdhja e tij e papritur më zgjon edhe mua nga gjumi i parëhatuar.

"Po shoh vetëm një deve", - tha ai e kur shikuaam përreth, zbuluam se një kafshë - e Zejdit - vërtet që zhdukur. Zejdi dashti të niset me timen për ta kërkuar atë, por shputa e tij e lënduar mezi i lejonte edhe të qëndrojë, e të mos flitet për ecjen, ose për hipjen dhe ecjen me të.

"Pusho, Zejd, unë do të shkoj në vendin tënd; nuk do të jetë vështirë të kthehem duke i përcjellë gjurmët e mia".

Mu në gdhirje u nisa me deve duke i ndjekur gjurmët e deveve të humbur që gjarpërojnë nëpër luginën ranore dhe zhduken pas bregoreve.

Udhëtova përafërsisht një orë, e pastaj dy, e tre, por gjurmët e kafshës së humbur shkojnë e vijnë sikur qëllimisht është endur. Mëngjesi tashmë mirë ka shkuar, prandaj u ndala, zbrita nga deveja, i hëngra disa hurma dhe piva ujë nga rrësheka e vogël e varur për shale.

Dielli është larg dhe disi e ka humbur shkëlqimin e vet. Retë e murrme, jo të zakonshme për këtë kohë të vitit, pezullojnë palëvizshëm në qiell; çuditërisht ajri i rëndë e mbulon shkretëtirën dhe i zbutë tiparet e bregoreve ranore më shumë se që rëndom janë të zbutura.

Njëfarë përkulje misterioze në maje të bregut të lartë ranor para meje e tërheq shikimin tim - a mos është kjo

ndonjë shtazë? Mbase deveja e humbur? Por kur shikoj pak më mirë, shoh se kjo përkulje nuk është mbi breg por në vetë bregun, në maje. Maja lëviz, krejtësisht ngadalë, shkëlqyeshëm, përpara - e pastaj duket sikur pikon përgjatë shpatit drejt meje si maja e valës që ngadalë thehet. E kuqja e mbyllur ngjitet në qiell pas bregut; me këtë të kuqe tiparet e tij e humbin rreptësinë e tij dhe bëhen të mjegulluar, sikur papritmas është vënë një perde; muzgu i kuqërremtë fillon shpejt të përhapet mbi shkretëtirë. Reja e rërës vorbullon drejt fytyrës sime dhe rreth meje dhe përnjëherë era fillon të ulurojë nga të gjitha anët, përgjatë e përgjerë luginës, me goditje të fuqishme. Lëvizja në formë të derdhjes në majen e parë të bregores kalon në të gjitha bregoret ranore në horizont. Për disa çaste qielli u errësua dhe fitoi ngjyrën e mbyllur, të keqe të zezë, kurse ajri u mbush me pluhur të shakullisur i cili, si mjegull e kuqërremtë e terroi diellin dhe ditën. Kjo është shtrëngata ranore, nuk ka dyshim.

Deveja ime, e shqetësuar, nga pozita në gjunjë dëshiron të ngrihet. Unë e tërheq poshtë, për frerë, duke luftuar që edhe vetë të mbahem drejt në erë që tashmë e ka fituar fuqinë e shtrëngatës, dhe arrita t'i pengoj këmbët e para të saj, që ta bëj më stabile, e pastaj edhe të mbamat. Atëherë edhe vetë hedhem në tokë dhe e tërheq abajën time mbi kokë. E shtypi fytyrën time pranë sqetullës së devesë, në mënyrë që të mos më asfiksoj rëra që godet me fiskaja. Ndiej se si kafsha e shtyp turirin e vet në supet e mia, pa dyshim nga shkaku i njëjtë. Ndiej se si rëra po grumbullohet në mua nga ana që nuk jam i mbrojtur me trupin e deves dhe duhet të lëviz nga vendi kohë pas kohe që t'i shmangem që mos të më mbulojë.

Nuk jam pa arsye i bregosur, sepse kjo nuk është hera e parë që më zë shtrëngata ranore në shkretëtirë. Duke qëndruar ashtu shtrirë në tokë, fortë i mbështjellur

në abajën time, mundem vetëm të pres që shtrëngata të pushojë, duke e dëgjuar uluritjen e erës dhe valëvitjen e gujës sime - si kumbim i velit të shkëputur. Jo, sikur flamuajt në erë, sikur valëvitje të bajraqeve fisnore që në drunjtë e lartë i mban armata beduinase në marshim: pikërisht si kanë valëvitur e kumbuar para gati pesë viteve mbi shumësinë e beduinëve - kalorësve nga Nexhdi - mijëra prej tyre e unë në mesin e tyre - duke u kthyer nga Arefati në Mekë pas haxhit. Ky ka qenë haxhi im i dytë. E pata kaluar vitin në brendi të Siujdhesës dhe arrita të kthehem në Mekë pikërisht në kohë që të marr pjesë në namazin e përbashkët të haxhinjve në Arefat, në lindje të qytetit të shenjtë. Në kthim prej Arefatit jam gjendur midis shumësisë së beduinëve të veshur me të bardha nga Nexhdi, duke kalëruar në galop të tendosur nëpër rrafshirën e pluhurt - det i njerëzve të veshur në të bardhë me deve ngjyrë mjalti në të verdhë, të arit, gështenje dhe të kuqe gështenje - në galop mijëra deve që si murmurima e trondisnin tokën duke ngarendur përpara në valën e pashmangshme - kurse bajraqet fisnore valëviten në erë, britmat fisnore me të cilat njerëzit lajmërojnë fiset e veta të ndryshme dhe veprat luftarake të të parëve të vet mbizotërojnë në valë mbi secilin grup. Sepse, për njerëzit nga Nexhdi, njerëzit e rrafshlartave qendrore arabe, lufta dhe haxhi dalin nga burimi i njëjtë... Haxhinj të shumtë nga vendet tjera - nga Egjipti dhe India, nga Afrika Veriore dhe nga Java - të paadaptuar në harresën tonë të këtyllë skajore, u shpërndanë në panikë para fillimit tonë, sepse askush që do të qëndronte në rrugë të kësaj vale shtrëngate nuk do të mund ta mbijetonte, - pikërisht sikur që vdekja momentale do ta gjente edhe kalorësin që do të binte nga shala midis mijëra kalorësve në galop.

Sado që ky udhëtim është dukur i marrë, unë edhe vetë kam marrë pjesë në atë budallallëk dhe i jam lëshuar situatës, fërshëllimës, hovit, kumbimit, me fat të egër në zemër - kurse era që ka fërshëlluar para fytyrës sime ka kënduar: "Kurrë më nuk do të jesh i huaj... kurrë më, në mesin e popullit të vet!"

Derisa ashtu isha i shtrirë në rërë nën abanën që valëvitet, ulërima e shtrëngatës ranore sikur po përsërit:

"Kurrë më nuk do të jesh i huaj..."

Unë më nuk jam i huaj; Arabia është bërë atdheu im. E kaluara ime perëndimore është si ëndërr e largët - jo mjaft joreal që të harrohet, as mjaft real që të jem pjesë e tanishmërisë sime. Nuk jam bërë ai që i jepet kënaqësisë së këndshme. Përkundrazi, sa herë që gjendem disa muaj në qytet - sikur, për shembull, në Medinë, ku kam gruan arabe dhe djalën e vogël dhe bibliotekën plot libra për historinë e hershme islame - po bëhem i shqetësuar dhe po mallëngjehem për aksion dhe lëvizje, për ajrin e thatë, të rreptë të shkretëtirës, për erën e devesë dhe për shalën. Për çudi, dëshira për bredhje që më ka bërë aq të shqetësuar gjatë pjesës më të madhe të jetës sime (tash kam mezi diç më shumë se tridhjetë e dy vjet) dhe më tërheq gjithnjë rishtazi drejt të gjitha llojeve të rreziqeve dhe takimeve të papritura, nuk buron aq nga etja për aventura sa nga mallëngjimi që ta gjejë vendin tim të qetësisë në botë - të arrij deri te pika ku do të mundesha disi ta lidhë krejt atë që mund të më ndodhë me atë që mendoj, ndiej dhe dëshiroj. Nëse këtë e kuptoj drejt, pikërisht ky mallëngjim për zbulim të brendshëm me vite më ka shtyrë në botën plotësisht tjetër, si për nga pikëpamjet e veta ashtu edhe për nga format e jashtme, nga çdo gjë që është dukur se më është gjykuar me lindjen dhe edukimin tim evropian.

Kur shtrëngata më në fund u dobësua, u shkunda dhe u lirova nga rëra që ishte grumbulluar rreth meje. Deveja ime deri në gjysmë ishte futur në rërë, por kjo nuk është më e keqja nga ajo që ka përjetuar shumë herë. Vetë shtrëngata, do të thuhej në shikim të parë, nuk na ka bërë kurrfarë dëmi pos që m'i ka mbushur gojën, veshët dhe vrimat e hundës me rërë dhe e ka marrë lëkurën nga shala. Por, së shpejti zbuloj mashtrimin tim.

Të gjitha bregoret rreth meje i kanë ndryshuar format, gjurmët e mia, sikur edhe ato të devesë së humbur, qenë fshirë. Qëndroj në tokën virgjërore.

Tash ka mbetur vetëm të kthehem prapa në kamp - ose së paku të provoj të shkoj prapa - me ndihmën e diellit dhe ndjenjës së përgjithshme të orientimit, që pothuaj është instinkt tek ata që janë adaptuar në udhëtime në shkretëtirë. Por, këto dy ndihmesa këtu nuk janë krejtësisht të sigurta, sepse brigjet ranore nuk u lejojnë të shkoni në vijë të drejtë dhe kështu ta mbani drejtimin që e keni zgjedhur.

Shtrëngata ma ka nxitur etjen por, duke mos pritur se do të jem jashtë kampit më shumë se disa orë, tashmë kaheerë e kam pirë gllënkën e fundit nga rrësheka e vogël për ujë. Mirëpo, nuk mund të jetë larg deri në kamp, e, edhe pse deveja ime nuk ka pirë ujë prej pushimit tonë të fundit te një pus para dy ditësh, ajo është veteran me përvojë dhe mund të mbështetem në të se do të më sjell prapa. Ia ktheva turirin në drejtim ku mendoj se duhet të jetë kampi dhe u nisëm me hapa të rreptë.

Kaloi një orë, dy orë, e pastaj tri orë, por as shenjë prej Zejdit as kampit tonë. Asnjë prej brigjeve ngjyrë portokalli nuk paraqet pamje të njohur, vërtet do të jetë rëndë të zbulosh çkado të njohur te ato madje edhe sikur të mos kishte shtrëngatë.

Vonë pasdite arrita deri te disa shkëmbinj graniti që mugullojnë nga toka, që është aq e rrallë midis këtyre shkretëtirave ranore, dhe menjëherë i njofta; i kemi kaluar, Zejdi dhe unë, dje pas dite, jo shumë para se sa që jemi ndalur të kalojmë natën. Ndiej lehtësi të madhe, sepse, edhe pse është e qartë se jam larg nga vendi ku kam shpresuar se do ta gjejë Zejdin - pasi s'ia kam qëlluar sigurisht për disa kilometra - duket se tash nuk do të duhet ta kem vështirë që ta gjejë thjesht duke shkuar në drejtim të jugperëndimit, sikur që kemi bërë dje.

Më kujtohet, ka pasur reth tri orë ndërmjet shkëmbinjve dhe kampit tonë të natës, por tash kur tashmë jam hipur në deve më shumë se tri orë, nuk ka gjurmë as të kampit as të Zejdit. A nuk ia kam qëlluar sërish? Nxitoj para, gjithnjë në drejtim të jugperëndimit, duke e marrë parasysh kujdesshëm lëvizjen e diellit; kaluan edhe dy orë, por as është kampi as Zejdi. Kur ra nata, përfundova se do të ishte absurde të nisem më tej, më mirë të pushoj e të pres dritën e mëngjesit. Zbrita nga deveja, ia lidha këmbët devesë dhe po përpiqem t'i ha disa hurma, por së tepërmi jam i etshëm, dhe ia dhash devesë, dhe e shtriva kokën të mbështetur pranë trupit të saj.

Rashë në kotësi jostabile, as në gjumë të plotë, as në zgjim të plotë, por në vijën e gjendjeve ëndërruese që e sjell lodhja, të ndërprera me etjen që shkallërisht bëhet e mundimshme. Diku në ato thellësi, që nuk duam t'ia zbulojmë vetvetes, shpurdhi frika e murrme, e ligshhtë: çdo të ndodhë me mua nëse nuk e gjej rrugën deri te Zejdi dhe rrësheqet tona me ujë? Sepse, sa e di, nuk ka ujë as çfar do vendbanimi disa ditë ecje në cilindo drejtim.

Në agim po filloj sërish. Gjatë natës kam llogaritur se kam shkuar së tepërmi nga jugu dhe se, për këtë, kampi i Zejdit duhet të jetë diku drejt veri-verilindjes nga vendi ku e kam kaluar natën. Dhe kështu shkojmë drejt

veri-verilindjes, të etshëm, të lodhur e të uritur, gjithnjë duke depërtuar në vijat valore prej luginës në luginë, duke iu shmangur bregoreve ranore tash majtas, tash djathtas. Në drekë pushojmë. Gjuha më ngjitet për qiellzë dhe e ndiej si lëkurë të vjetër, të shpërthyer; fyti më dhemb, e sytë janë ndezur. I mbështetur në barkun e devesë me abanë të qitur mbi kokë, po tentoj të fle, por nuk mundem. Pasdite sërish jemi në lëvizje, këtë herë në drejtëm nga lindja - sepse tash e di se kemi shkuar tepër larg drejt perëndimit - por ende s'është as Zejdi as kampi.

Po vjen edhe një natë. Etja është bërë mundim, kurse dëshira për ujë mendimi i vetëm, i pashmangshëm në tru që më nuk mund ta mbajë rendin në mendime. Posa agimi e ndriçoi qiellin, po udhëtoj më tej, tërë mëngjesin, drekën dhe pasdrekën edhe një ditë. Bregoret ranore dhe përvëlimi. Bregore pas bregore pa fund. Ose ndoshta ky është fundi - fundi i të gjitha udhëtimeve të mia, të gjitha synimeve dhe zbulimeve të mia? Ardhjes sime në popull në mesin e të cilëve më nuk do të jem i huaj...? "O Zot", po lutem, "mos lejo që kështu të zhdukem..."

Pasdite ngjitem në kodrinën e lartë, me shpresë të fitoj shikim më të mirë të rrethinës. Befasisht vërejta pikën e errët larg në lindje dhe do të doja të bërtas prej gëzimit, por jam shumë i dobët për këtë: ky duhet të jetë kampi i Zejdit dhe rrësheku me ujë, dy rrësheqe të mëdha plot ujë! Gjunjtë më dridhen derisa përsëri ngjitem në deve. Ngadalë, me kujdes, nisem në drejtëm të asaj pike të zezë e cila sigurisht mund të jetë kampi i Zejdit. Këtë herë, me vëmendje të madhe, përpiqem që t'ia qëlloj, udhëtoj me deve në vijë të drejtë, nëpër bregoret ranore, përgjatë luginës ranore, në këtë mënyrë duke e dyfishuar, trefishuar përpjekjen tonë, por i motivuar nga shpresa se së shpejti, më së shumti gjatë dy orëve, do ta arrij cakun tim. Përfundimisht, pasi e kaluam ma-

jen e bregores së fundit ranore, cakun qartë po e shoh; devenë po e mbaj për freri dhe shikoj poshtë në diç të errët, më pak se një kilometër larg, kurse zemra ime vdes sikur do të pushojë së rrahuri. Atë që e shoh para vetes është shkëmbi i zi i granitit që del nga toka, pranë të cilit kam kaluar para tri ditësh me Zejdin dhe sërish para dy ditësh vetë...

Dy ditë kam ecur në rreth.

#### - 4 -

Kur rrëshqita nga shala, kam qenë plotësisht i rras-kapitur. Nuk përpiqem madje as t'i lidhë këmbët e deve-së por kafsha është shumë e lodhur që të mendojë për ikje. Po qajë, por lotët nuk rrjedhin nga sytë e thatë, të ënjtur.

Sa ka kaluar prej kur kam qarë... Por, përfundimisht, a nuk është tashmë krejt qysh moti e kaluar? Krejt është e kaluar dhe nuk ka tanishmëri. Ekziston vetëm etja. Edhe përcëllimi. Edhe vuajtja.

Gati tashmë tri ditë jam pa ujë, e pesë ditë që kur de-veja ime për herë të fundit ka pirë ujë. Do të mund sigu-risht kështu të vazhdoj edhe një ditë, ndoshta dy, por unë nuk mundem, këtë e di, të duroj aq gjatë. Ndoshta do të çmendem para se të vdes, sepse dhembja në trupin tim është gërshetuar me tmerrin në mendimet e mia, kurse njëra tjetrën e forcon, duke përvëlur, dihatur, copëtuar...

Dëshiroj të pushoj por në të njëjtën kohë e di se, nëse tash pushoj, kurrë më nuk do të jem në gjendje që sërish të ngrihem. Mezi ngjitem në shalë dhe e detyroj devenë me të rame që të çohet. Përpak të bie nga shala kur kafsha shkoj përpara derisa ngrihej në këmbët e veta të mbrama dhe sërish, kur shkon mbrapa, duke i drejtuar këmbët e para. Fillojmë të ecim, ngadalë, mundimshëm,

drejt perëndimit. Drejt perëndimit, çfarë ironie! Ç'do të thotë "drejt perëndimit" në këtë det mashtrues, valëvitës të bregoreve ranore? Por, unë dua të jetoj. Dhe kështu shkoj më tej. Me mund të madh, me fuqinë e mbetur, tërhiqem nëpër natë. Është dashur të jetë mëngjes kur jam rrëzuar nga shala. Nuk rashë në të fortë, sepse rëra është e butë dhe më pranon. Deveja qëndroi një kohë, pastaj me ofshamë lëshohet në gjunjë, pastaj në këmbë të mbrame dhe shtrihet e skrupullorur pranë meje, me qafë të shtrirë në rërë.

Jam i shtrirë në rërë në hijen e ngushtë të trupit të devesë, i pështjellur në abajën time kundër përcëllimit nga jashtë dhe dhembjes, etjes e tmerrit në mua. Nuk mund më të mendoj. Nuk mund as sytë t'i mbylli. Çdo lëvizje e qepallave të syve është si metal përvëlues në kërdhokullat e syve. Etja dhe heshtja që dërrmon, hesh-tja e vrazhdë që është mbështjellë me pëlhurën e vet të vetmisë dhe dëshpërimit dhe sjell deri te ajo që shushur-itja e gjakut në veshët tuaj dhe ofshama e përkohshme e devesë vazhdojnë, duke u kërcënuar, sikur që këto janë zërat e fundit në tokë, kurse ju të dytë, njeriu dhe kafsha, qeniet e fundit të gjalla, qeniet e gjykuara në tokë.

Lart mbi ne, në ngrohtësinë dredhëse, ngadalë xhiron grabitqari, kurrë duke mos u ndalur. Pika në zbehtësinë e vrazhdë të qiellit. I lirë dhe mbi të gjitha horizontet...

Fyti më është ënjtur, mbledhur, kurse çdo frymë nisë mijëra gjilpëra të dhembshme në rrënjën e gjuhës si-me - atë gjuhë të madhe që nuk guxonte të lëvizë, por nuk mund që të mos lëvizë në dhembje, mbrapa, para, si limë nëpër zbrazëtirën e thatë të gojës si-me. Tërë bren-dia më është valë dhe e shtangur në përqaqimin e pan-dërprerë të agonisë. Në çast qielli i çeliktë bëhet i zi në sytë e mi gjerë të hapur.

Dora ime lëviz, sikur vetvetiu, dhe prek kundakun e fortë të karabinës të varur për shalë. Dora është në qetësi derisa me qartësinë befasuese të mendimit shoh pesë fishkë të mirë në rrethator dhe fundin e shpejtë që do të mund të sillte shtypja në këmbëz.... Diç në mua pëshpërit: Shpejt, merre karabinën para se të vish në atë gjendje kur më nuk do të mund të lëvizësh!

Pastaj ndiej se si buzët më lëvizin dhe formojnë fjalë pa ton që vijnë nga ndonjë skutë e errët e mendjes sime: "Ne do t'u sprovovjmë... vërtet do t'u sprovovjmë..." Edhe fjalët e mjegulluara ngadalë po e marrin formën - ajeti nga Kur'ani: "Vërtet do t'u sprovovjmë me frikë, uri, mospasje dhe me mungesën e fryteve të punës. Por, përgëzoji ata që durojnë, dhe kur i godet ndonjë fatkeqësi, thonë: 'Ne i përkasim Zotit dhe Atij pa dyshim do t'i kthehemi'".

Është vapë dhe terr, nga terri ndiej frymë të freskët dhe dëgjoj si shushuritë - era shushuritë, sikur në dru - mbi ujë - kurse uji është rrjedhë e qetë ndërmjet brigjeve me barë të mbuluara, afër shtëpisë nga fëmijëria ime. Jam i shtrirë në breg, djalosh prej nëntë ose dhjetë vjetësh, brej kërcyillin e barit duke ngulur sytë në lopën e bardhë që kullotë jo larg meje me sytë e mëdhenj ëndërrues dhe me çiltërinë e kënaqësisë. Në largësi disa fshatare punojnë në fushë. Njëra prej tyre mbanë shami të kuqe në krye dhe fustan të kaltër me vija të gjera të kuqe. Shelgjet rriten në breg të përroit, kurse mbi sipërfaqen e tij rrëshqiti pata e bardhë duke bërë hulli të ujit të bardhë. Era e butë shushuritë nëpër fytyrën time si dihatje e shtazës. Po si jo, kjo është dihatje e shtazës, lopa e madhe e bardhë me njolla gështenje erdhi krejtësisht afër meje dhe tash duke më turfulluar më shumë me turinin e vet dhe unë ndiej lëvizjen e këmbëve të saj pranë vetes...

I hapa sytë dhe dëgjoj turfullimin e devesë sime dhe ndiej lëvizjen e këmbëve të saj pranë vetes. Ajo tashmë

deri në gjysmë është ngritur në këmbë të mbrame, me qafë të shtrirë e kokë të ngritur, me vrima të zgjeruara të hundës sikur i merr erë aromës së papritur, të mirëseardhur në ajrin e drekës. Derisa ajo turfullon, ndiej se si kalon vala e entuziazmit përgjatë qafës së saj të gjatë drejt supeve dhe trupit të madh, në gjysmë të ngritur. Kam parë devetë se si kështu marrin erë dhe turfullojnë kur ndiejnë ujin pas ditëve të gjata të udhëtimit shkretinor, por këtu nuk ka ujë... Ose, ndoshta, ka? Ngrej kryet dhe përcjell me sy drejtimin nga i cili e ktheu kokën e vet deveja. Ky është bregu më i afërt ranor, maja e ulët drejt zbehtësisë çelikore të qiellit, pa kurrfarë lëvizje ose zëri. Por, ka një zë! Zëri i dobët si vibracion i ndonjë harfe të vjetër, zëri shumë delikat dhe i lartë i dobët; zëri i lartë i dobët i beduinëve që këndojnë në ecje, në ritmin e luhatjes së devesë, pikërisht pas majes së bregut ranor, relativisht krejtësisht afër. Bëhem i vetëdijshëm për këtë në një pjesëz të çastit: Atje janë njerëzit, por unë nuk mund të depërtoj deri tek ata. Jam shumë i dobët madje edhe të ngrihem. Orvatem të bërtas, por vetëm gurgullimë e ngjirur dilte nga fyti im. Pastaj dora ime, sikur vetvetiu, hasi në kundakun e fortë të karabinës në shalë... në mendime po i shoh pesë fishekë të mirë në rrethator...

Me përpjekje të fundit arrita ta heq armën nga mollëza në shalë. Shkrepja e këmbëzës është sikur ngritja e bjeshkës, por më në fund arrita. E vendosa karabinën në kundak dhe kërcita vertikalisht në ajër. Fisheku sokëlliu në zbrazëtirë, fatkeqësisht me zë të dobët. E ngreha këmbëzën sërish dhe e shkrehja, e pastaj dëgjoj. Këndimi që i ngjasonte muzikës me harf pushoi. Për një çast asgjë pos heshtjes. Papritmas mbi majen e kodrinës shfaqet koka e njeriut e pastaj supet e tij, pastaj edhe një njeri pranë tij. Ata një kohë shikojnë poshtë, pastaj kthehen prapa dhe diçka u bërtasin disa shokëve të papashëm. Ai

i pari ngjitet me ta e pastaj gjysmën e vrapon e gjysmën e rrëshqet poshtë shpatisë drejt meje.

U bë tollovi rreth meje: dy, tre njerëz - sa njerëz rreth meje pas asaj vetmie! Përpiqen të më ngrisin, lëvizjet e tyre janë përzierje e pakuptueshme e duarve dhe këmbëve... Ndiej se si diç e akullt, si zjarr dhe akull, i përvëlton buzët e mia dhe shoh fytyrën me mjekër të beduinit të zgjatur mbi mua, kurse dora e tij e shtyp leckën e ndytë të lagur në gojën time. Dora tjetër e tij e mban të hapur rrëshekun e ujit. Bëj një lëvizje instinktive drejt saj, por beduini me butësi e largoi dorën time, e lagi leckën me ujë dhe sërish i shtrydhi disa pika në buzët e mia. Fort i shtrëngova dhëmbët që ta pengoj që uji mos ta djeg fytyrë tim, por beduini me forcë i hapi dhëmbët e mi dhe sërish pikoi pak ujë në gojën time. Ky nuk është ujë, ky është hekur i shkrirë. Përse ma bëjnë këtë? Dua të ikë nga kjo vuajtje, por ata djaj më mbajnë... Lëkura më digjet. Tërë trupi im është në flakë. A duan të më mbysin? Oh, sikur të kisha fuqi ta kap pushkën time e të mbrohem! Por ata madje nuk më lejojnë as të ngrihem; më mbajnë më tej në dhe dhe e hapin sërish gojën time dhe pikojnë ujin në të, e unë duhet ta përbijë këtë. Dhe, njëmend, çudia: më nuk më përvëlton aq rreptë si pak më parë, kurse lecka e lagur në kokën time më pëlqen, dhe kur e derdhin ujin mbi trupin tim, kontakti i teshave të lagura më sjell dridhjet e kënaqësisë...

Pastaj çdo gjë bëhet terr e unë rrëzohem, rrëzohem poshtë në pus të thellë; shpejtësia e rënies sime nxiti shushuritjen e ajrit në veshët e mi, shushuritja shndërrohet në gjamë të territ, të zezë, të murrme...

E zeza, terri, terri i butë pa zë, errësira e mirë e miqësore, që mbështillet si mbulesë e ngrohtë dhe te ju nxitë dëshirën që gjithnjë të mbeteni ashtu, aq shkëlqyeshëm të lodhur, të përgjumur dhe përtacë. Vërtet nuk ka nevojë t'i hapni sytë tuaj ose ta lëvizni dorën, por ju njëmend e lëvizni dorën dhe i hapni sytë, vetëm të shihni terrin mbi vete, terri i leshtë i tendës beduinase i bërë nga qimet e zeza të dhisë, me vrimën e ngushtë përpara që u dëfton një pjesëz të qiellit hyllësor të natës dhe vijat e buta të bregores ranore që ndriçon në shkëlqimin yjor... Pastaj vrima në tendë errësohet, figura e ndonjë njeriu qëndron në të, vijat e gujës së tij valëvitëse rreptë skicohen në qiell dhe dëgjoj Zejdin se si bërtet: "U zgjua, u zgjua!" Fytyra e tij serioze u afrua krejt afër meje, kurse dora më kap për supe. Një njeri tjetër hyn në tendë, nuk mund ta shoh qartë, por posa foli me zë të ngadalshëm, solemn, e di se është beduini shamaras.

Sërish ndiej etjen e valë, shkatërruese dhe fuqishëm e kapi enën me qumësht që ma ofron Zejdi. Por, më nuk ndiej kurrfarë dhembje duke e përcjellë, derisa Zejdi rrëfen se si ky grup i beduinëve me kampin e tyre u gjet afër kur filloi shtrëngata ranore dhe se, kur deveja e humbur gjatë natës qetësisht vetë u kthye, të gjithë u bënë të shqetësuar dhe u nisën të më kërkojnë. Dhe se, pas gati tri ditëve, kur tashmë e kishin humbur çdo shpresë, u dëgjua krisma nga pushka ime pas bregut ranor...

Tash e ngritën tendën mbi mua dhe aty duhet të qëndroj sonte dhe nesër. Miqtë tanë beduinë aspak nuk nxitojnë; rrësheqet e tyre janë plot ujë, madje kanë qenë në gjendje t'ia japin tri kova të plota devesë sime, sepse e dinë se një ditë udhëtimi drejt jugut do të na sjell deri te oaza ku është pusi. Në ndërkohë devetë do të kenë mjaft ushqim në gajushën e hamdit që rritet kudo përreth.

Pas pak kohe, Zejdi më ndihmon të dal nga tenda, e shtroi shtrojen mbi rërë, e unë shtrihem në të dhe mbe-tem nën yje.

Disa orë më vonë zgjohem nga cingërima e enëve të Zejdit për kafe; aroma e kafesë së freskët është sikur përqaftim i gruas!

"Zejd!" - e thërras, kurse këndshëm jam befasuar që zëri im, ndonëse ende i lodhur, e ka humbur të ngjirurit e vet. "A do të më japësh pak kafe?" - duke iu drejtuar ashtu njeriut ndaj të cilit dëshiron të tregojë respekt.

"Dua, për Zotin, dajo!" - u përgjigj Zejdi, sipas zakonit të tregojë respekt, pa marrë parasysh se a është ai më i ri ose më i vjetër prej tij (rastësisht jam disa vjet më i ri se Zejdi). "Do të kesh sa të të dëshiroj zemra!"

Pi kafe dhe buzëqeshi në shprehjen e gëzimit në fytyrë të Zejdit. "Përse, o vëlla, ua ekspozojmë veten gjërave të këtilla, në vend që të mbesim në shtëpitë tona si njerëz të mençur?"

"Për shkak se nuk është për të atillë siç jemi unë dhe ti", qeshet Zejdi me mua, - "të presim në shtëpi derisa gjymtyrët nuk na ngurtësohen dhe pleqëria nuk na arrinë. Përveç kësaj, njerëzit a nuk po vdesin po ashtu edhe në shtëpitë e tyre? A nuk e bartë njeriu gjithnjë fatin e vet për qafën e tij, kudo që të jetë?"

Fjalën që Zejdi e përdor për "fatin" është kismet - "ajo që është ndarë" - më mirë e njohur në Perëndim në trajtën e vet turke "kismet". Derisa po e pi filxhanin e dytë me kafe, më bie ndër mend se kjo shprehje arabe ka edhe domethënien tjetër, më të thellë: "atë në çka kemi pjesëmarrje".

Atë në çka kemi pjesëmarrje...

Këto fjalë sikur i godasin telat e paqartë që i ikin mbamendjes sime... Qe buzëqeshja që i ka përcjellë... buzëqeshja e kujt? Buzëqeshja pas reve të tymit, tymit të

rreptë, si tym i hashishit. Po, ky ka qenë tym i hashishit, kurse buzëqeshja i ka takuar njërit prej njerëzve më të çuditshëm që kurdoherë e kam takuar - e e kam takuar pas njërit prej përjetimeve më të çuditshme në jetën e tij. Derisa kam tentuar ta evitoj rrezikun, i cili dukej - vetëm dukej - i drejtpërdrejtë në kërcënimin e vet, jam vërsulur, duke mos ditur, në rrezikun tjetër, shumë më real, shumë më të drejtpërdrejtë nga ajo që kam tentuar t'i shmangem, kurse të dy rreziqet, edhe ai real edhe ai joreal, më kanë ndihmuar ta evitoj të tretin...

Tërë kjo ka ndodhur para pothuaj tetë vjetësh, kur kam udhëtuar në kalë, në përcjellje të shërbëtorit tim Tatar Ibrahimit nga Shirazi në Kirman në Iranin Jugor - vis i shkretë, dobët i banuar dhe i parrugë pranë liqenit Niris. Atëherë, dimrit, ky ka qenë moçal, djerrinë e baltë pa fshatra në afërsi, e kufizuar në jug me Kuh - Gjushnegan, "Bjeshkët e urisë", kurse nga veriu çdo gjë humbej në moçalet që e rrethojnë liqenin. Pasdite, derisa e vizitonim njëfarë bregu të vetmuar, liqeni papritmas u dëftua. Sipërfaqja e palëvizshme e gjelbër pa frymë ose pa zë të jetës, sepse uji ishte aq i njelmët saqë kurrfarë peshqish nuk do të mund të jetonin në të. Përveç disa drunjve të sakatosur dhe shkurreve shkretinore, trolli i njelmët i bregut nuk ka lejuar kurrfarë vegjetacioni. Toka ka qenë lehtë e mbuluar me barishte baltore, kurse mbi këtë, në largësi prej rreth dyqind metrash prej bregut, ka shpënë shtegu dobët i shënuar.

Bie nata, kurse karvansaraji Khani Khet - caku ynë për atë, atë - askund në dukje. Mirëpo, është dashur të vijë në të me çdo kusht; gjerë e gjatë nuk kishte kurrfarë strehimore tjetër, kurse afërsia e moçaleve bënte çdo përparim në terr tepër të rrezikshëm. Në realitet, atë mëngjes na kanë paralajmëruar që të mos shkojmë vetë, sepse vetëm një hap i gabueshëm lehtë mund të thotë

vdekje e papritur. Përveç kësaj, kuajt tanë kanë qenë mjaft të lodhur pas marshit të gjatë ditor nëpër tokën baltore dhe duhej që të çlodheshin dhe ushqeheshin.

Me ardhjen e natës filloi shi i fortë. Kalëronim hesh-tazi, të lagur e të mërzitur, duke u mbështetur më shumë në instinktin e kalit se sa në sytë tanë të padobishëm. Kaluan orë të tëra, e karvansaraji nuk u shfaq. Mbase në terr e kemi kaluar dhe tash duhet ta kalojmë natën jash-të, nën shi të madh që gjithnjë shtohet... Patkonjtë e ku-ajve tanë kanë shllapuritur nëpër ujë, rrobat tona plot ujë rëndë vareshin në trupat tonë. E zezë dhe e patejduk-shme, pezullonte rreth nesh nata në velat e fiskajave të ujit; qemë ftohur deri në asht, por njoftimi se moçali është aq afër futi ethe edhe më të mëdha. Nëse kuajt ve-tëm një herë nuk ia qëllojnë tokës së fortë - "atëherë Zoti na mëshiroftë", na kanë paralajmëruar atë mëngjes.

Kalëroja përpara, kurse Ibrahimimi më ndiqte pas nja dhjetë hapa. Gjithnjë e më shpesh është shfaqur mendimi tmerrues: a mos, mbase e kemi lënë Khani Khetin pas vete në terr? Çfarë fati i keq do të ishte të kalohet nata në shi të ftohtë, e nëse do ta vazhdonim - ç'është puna me moçalin?

Papritmas ndieva zë të butë, fërshëllues nën pat-konjtë e kalit tim; ndieva se si kafsha rrëshqiste në baltë, po fundosej, tërheq furishëm një këmbë, rrëshqet prap-dhe mendimi shkëlqen: moçali! E shtrëngova fuqishëm frerin dhe i shtypa me mamuze anët e kalit. Ai lart e ho-dhi kokën dhe filloi me tërbim të luajë. Djersa e ftohtë plotësisht më përshkoi. Nata ishte aq e errët sa nuk munda t'i dalloj duart e mia, por në lëvizjen e rreptë të trupit të kalit ndieva luftën e tij pikëlluese kundër përqa-fimit të moçalit. Pothuaj pa menduar, e kapa kamxhikun i cili, rëndom i papërdorur, ishte i varur në gishtat e mi dhe e godita kalin vithefe me tërë fuqinë, me shpresë që

ashtu ta nxisë në përpjekjen e fundit, sepse nëse tash ndalet, do të zhytej, e edhe unë me të, gjithnjë thellë e më thellë në baltë... E pamësuar në aso kamxhikimi të rreptë, kafsha e gjorë - hamshor kashagai me shpejtësi dhe fuqi të jashtëzakonshme - ngrihet në këmbët e mbrame, e godet sërish tokën me të katrat, dhe me përpjekjen e furishme kundër baltës kërcen, rrëshqet, ngrihet përsëri përpara dhe sërish rrëshqet - kur tërë kohën patkonjtë e tij shpresëhumbur goditnin për baltën e butë, fërshëlluese...

Njëfarë objekti misterioz me fishkëllimë kaloi me furi mbi kokën time... E ngrita dorën dhe mora goditje të fuqishme e të pakuptueshme... Prej çkahit? Koha dhe mendimi u ngatërruan njëra mbi tjetrën dhe u përzien... Nëpër shiun e madh dhe dihatjen e kalit kam mundur të dëgjoj, në sekonda që ishin sikur orë, një zë të pamëshirshëm të thithjes së moçalit... Fundi i etheve është afër. I lirova shputat e mia në zengji, i gatshëm të kërcëj nga shala dhe ta provoj fatin tim vetë - ndoshta do të mund të shpëtoja nëse shtrihem rrafshatas në tokë, kur, papritmas, e pabesueshme, patkonjtë e kalit goditën përsëri në tokë të fortë, një herë, dy... dhe, me psherëtimën e lehtësimit, i tërhoqa frerët dhe e qetësova kafshën që dridhej. Qemë të shpëtuar...

Vetëm tash më kujtohej përcjellësi im dhe, krejt në frikë, bërtita: "Ibrahim!" Kurrfarë përgjigje. Zemra m'u bë akull.

"Ibrahim...!" Por rreth meje ishin vetëm nata e errët dhe shiu i madh. A ka pasur ai mundësi të shpëtojë? Me zë të ngjirur bërtita përsëri: "Ibrahim!"

Atëherë, gati e pabesueshme, u dëgjua një zë i dobët nga largësia e madhe: "Këtu... këtu jam!"

Tash ishte radha në mendjen time të qetësohet: si jemi larguar aq shumë?

"Ibrahim?"

"Këtu... këtu!"

Dhe duke e ndjekur zërin, duke e kapur kalin tim për freri dhe duke provuar çdo pëllëmbë të tokës me këmbët e mia, kam ecur ngadalë, mjaft kujdesshëm drejt zërit të larguar; atje ishte Ibrahim, ishte i ulur në qetësi në shalën e vet.

"Ç'ndodhi me ty, Ibrahim? A nuk u fute edhe ti në moçal?"

"Në moçal...? Jo, thjesht kam qëndruar kur ju befasisht, nuk e di përse, ngarendët".

Ngarenda... Misteri që zgjidhur. Lufta me moçalin ka qenë fryt i imagjinatës sime. Kali im është dashur thjesht të ketë shkelur në pjesën e rrugës me baltë, kurse unë, duke menduar se patëm hyrë në moçal, e kam xhikovat dhe e kam detyruar në galop të tërbuar dhe, i mashtruar me terrin, gabimisht e kam kuptuar lëvizjen e tij përpara si luftë shpresëhumbëse me moçalin dhe verbërisht jam vërsulur gjatë natës, i pavetëdijshëm që ka shumë drunj me hullunga të shpërndarë nëpër rrafshirë... Ky dru, e jo moçali, ka qenë rreziku i drejtpërdrejtë, real: dega e vogël që ka goditur në dorën time ka mundur po ashtu të jetë edhe degë më e madhe, që ka mundur të ma thejë kafkën dhe kështu ta sjellë udhëtimin tim deri te fundi vendimtar, në varrin e pashënuar në Iranin Jugor...

Kam qenë i çartur ndaj vetvetes, dyfish i çartur, sepse tash e kemi humbur çdo orientim dhe më nuk mundeshim ta gjejmë shtegun. Tash më kurrë nuk do ta gjejmë karvansarajin.

Por, përsëri nuk kam pasur të drejtë.

Ibrahimi zbriti nga kali ta prekë terrenin me dorë dhe kështu ndoshta ta gjejë shtegun, dhe derisa ai kështu është zvarritur në të katrat, koka e tij papritmas goditi në mur - murin e errët të karvansarajit Khani Khet!

Sikur të mos ishte koklavitja ime e imagjinuar në moçal, ne do të vazhdonim, do ta kalonim karvansarajin dhe vërtet do të humbeshim në moçal i cili fillon, si mësuam së shpejti, mezi dyqind metra para nesh...

Karvansaraji ka qenë një prej shumë gjërave të rrënuara nga epoka e shahut, Abasit të Madh - blloqet e fuqishme të mureve me korridoret e mbuluara, me dyert e hapura dhe vatrat e rrënuara. Aty - këtu kenë mundur të vëreni gjurmët e gdhendjes së vjetër mbi dyer dhe pllakat e pëlcitura të porcelanit; disa dhoma të përdorura kanë qenë të lëna pasdore, me kashtë të vjetër dhe bagla kali nëpër dysheme. Kur Ibrahimimi dhe unë hymë në partikun kryesor, e takuam mbikëqyrësin e karvansarajit se si është ulur pranë zjarrit të hapur në dysheme të zhveshur. Pranë tij ishte edhe një njeri i vogël këmbëzbathur i mbuluar me batani të grisur. Të dytë kërcyen në këmbë kur hymë ne, kurse i panjohuri i vogël u përkul solemnisht me lëvizje të gjallë, gati teatrore, me dorën e djathtë mbi zemër. Guja e tij qe e mbuluar me arna të shumta shumëngjyrëshe; ishte i ndytë, plotësisht i lënë pasdore, por sytë e tij shkëlqenin, kurse fytyra i qe e kthjellët.

Mbikëqyrësi doli nga dhoma që të kujdeset për kuajt tanë. E hoqa nga vetja gujën përplot ujë derisa Ibrahimimi menjëherë filloi të merret me përgatitjen e çajit në zjarrin e hapur. Me njerëzishmërinë e bujarit të madh që nuk humb asgjë nga dinjiteti i tij nëse është i sjellshëm ndaj më të ultëve se vetja, njeriu i vogël i çuditshëm me këndje e mori gotën e çajit që ia afroi Ibrahimimi.

Pa kurrfarë kërsërie të pavend, sikur po e fillon bisedën në sallon, ai u kthye drejt meje: "Ju jeni anglez, xhanabi-ali?"

"Jo, unë jam austriak".

"A do të ishte e pavend nëse ju pyes a puna ju sjell në këto vise?"

"Unë jam korrespondent i një gazete", - u përgjigja.  
- "Udhëtoj nëpër vendin tuaj që t'ia përshkruaj njerëzve tanë. Ata dëshirojnë të mësojnë si jetojnë të tjerët dhe çka mendojnë".

Ai tundi kokën me buzëqeshje të miratimit në fytyrë dhe heshti. Pas një kohe e nxori nargjilën e vogël prej argjile dhe shkopin e bambusit nga një palë e gujës së vet, e vuri shkopin në enën e argjilës, pastaj fërkoj diç që i ngjasonte duhanit midis shuplakave të tij dhe e vuri këtë me kujdes, si t'ishte qenë më e vlefshme se ari, në pjesën e thelluar të llullës, duke e mbuluar me gaca. Me përpjekje të qartë tërhoqi tymin me anë të shkopit të bambusit, duke u kollitur rreptë dhe duke e pastruar fytin. Uji në nargjilë gurgulloi, kurse aroma e rëndë filloi ta mbushë dhomën. Vetëm atëherë kam kuptuar: ky ishte hempi indian, hashishi, kurse atëherë kam kuptuar edhe artificialitetin e çuditshëm të këtij njeriu; ai ishte narkotik, shfrytëzues i drogës dehëse. Sytë e tij nuk ishin të hijesuar sikur sytë e përdorësit të opiumit; ata shndrisnin me një lloj thellësie indiferente, amorge, duke shikuar në largësi që është e pafund, e larguar nga bota reale rreth tyre.

Shikoja në heshtje. Kur më në fund e thithi llullën e vet, më pyeti:

"Vallë, nuk do ta provonit edhe ju?"

Refuzova duke u falënderuar; e kam shijuar opiumin një apo dy herë (pa kurrfarë kënaqësie të veçantë), por kjo me hashishin më dukej tepër e mundimshme dhe e pashije madje edhe të tentoj. Narkomani qeshej pa zë, sytë e tij të picërruar rrëshqitën mbi mua me ironi qesharake:

"E di ç'mendoni, mik i nderuar. Ju mendoni se hashishi është punë dreqi, dhe ia keni dronë. Absurd! Hashishi është dhuratë e Zotit. Shumë i mirë - sidomos për shpirtin, shihni, hazret, më lejoni që këtë t'ua sqaroj. Opiumi është i keq - për këtë nuk mund të ketë dyshim -

sepse te njeriu zgjon lakminë për gjëra të paarritura, e futë në ëndrrat e tij lakminë sikur te kafshët. Hashishi, ndërkaq, e qetëson çdo lakmi dhe na bënë indiferent ndaj të gjitha gjërave të kësaj bote. Ky është ky: na bënë të kënaqur. Do të mund ta vëni një grumbull ari para narkomanit - jo vetëm derisa ai e thithë (e pi), por kurdo qoftë - e ai madje nuk do ta zgjasë as gishtin e vogël për këtë. Opiumi i bënë njerëzit të dobët e frikacakë, kurse hashishi e mbytë çdo frikë dhe bënë që njeriu të bëhet i guximshëm si luan. Nëse do të kërkonit që narkomani të futet në ujën e akullt midis dimrit, ai thjeshtë do të futej e do të qeshej... Ai ka mësuar që të jeshë pa lakmi, do të thotë të jeshë pa frikë - dhe që, nëse njeriu është mbi frikën, ai po ashtu shkon edhe mbi rreziqe, duke e ditur, çkado që t'i ndodh, se kjo është pjesë e tij në atë çka po ndodh..."

Ai përsëri qeshet, duke u shkundur me atë qeshjen e shkurtër, të pazë ndërmjet përbuzjes dhe dashamirësisë; pastaj pushoi së qeshuri dhe vetëm shikonte pas resë së vet të tymit, me sy shkëlqyes të drejtuar në largësinë e paluatshme.

"Pjesa ime në tërë këtë që po ndodh..." Mendoj derisa jam i shtrirë nën yjet miqësorë arabë. "Unë - ky grumbull mishi e ashti, ndjenjash e vrojtimesh - jam vënë në arbitën e Qenies dhe jam në çdo gjë që ndodh..." Rreziku është vetëm mashtrim, nuk mundet kurrë të më "ngadhënjë", sepse çdo gjë që më ndodh i përket rrjedhës gjithëpërfshirëse, pjesë e së cilës jam edhe unë vet.

A do të mundet, mbase, që rreziku dhe siguria, vdekja dhe gëzimi, fati dhe realizimi të jenë vetëm forma të ndryshme të këtij grumbulli të imtë, madhështor i cili jam unë? Çfarë lirie të pafund, o Zot, i ke dhuruar njeriut..."

Duhet t'i mbylli sytë, aq e rreptë është dhembja gjatë këtij mendimi, kurse krahët e lirisë më prekin qetë nga larg, në frymën e erës që kalon nëpër fytyrën time.

Ndihem mjaft i fuqishëm që tash mund të ulem dhe Zejdi më solli një shalë deveje që të mbështetem në të. "Vendosu mirë, dajo. Zemra ime gëzohet kur shoh që je mirë Pasi tashmë të kam vajtuar".

"Ti ke qenë për mua mik i mirë, Zejd. Ç'do të bëja unë pa ty këto vite sikur mos ta kishe pranuar ftesën time e të vije?"

"Kurrë nuk i kam vajtuar këto vite me ty, dajo. Ende më kujtohet dita kur e kam pranuar letrën tënde, para më shumë se pesë vjet, me të cilën më ke ftuar në Mekë... Mendimi se sërish do të shoh ka qenë i këndshëm, sidomos për atë që në ndërkohë je lumturuar me bekimin e Islamit. Pikërisht atëherë qesh martuar me vashën nga fisi Muntafik, virgjëreshë, kurse dashuria e saj jashtëzakonisht më ka kënaqur. Ato vasha irakiane kanë shtat të ngushtë dhe kraharor të fortë, sikur kjo" - dhe, duke u qeshur në kujtesë, ai e shtrëngon gishtin tregues në mollën e fortë të shalës në të cilën jam mbështetur. - "Dhe vështirë të ndahesh nga përqaftimi i tyre... Atëherë i kam thënë vetes: Do të shkoj, por jo menjëherë, të presë disa javë. Por javët kanë kaluar, edhe muajt, e edhe pse së shpejti jam shkurorezuar me atë grua - bija e qenit ia ka shkelur syrin një kushëriri të vet të largët - nuk kam mundur që të vendosë ta lëshojë shërbimin tim në korpusin vullnetar irakian, miqtë e mi dhe kënaqësitë e Bagdadit dhe Basrës, dhe gjithnjë i kam folur vetvetes: Jo tash, pak më vonë... Një ditë kam kalëruar nga kampi ku pikërisht e kam pranuar rrogën mujore dhe kam menduar ta kaloj natën me një mik, kur papritmas ti më re në mend dhe u kujtova që më ke thënë në letrën time për vdekjen e bashkëshortes sate të dashur - Zoti e mëshiroftë atë - dhe mendova se si duhet të jesh i vetmuar pa të dhe përnjëherë kuptova se duhet të vij te ti. Në atë

çast pikërisht këtu e këputa yllin irakian nga buza ime dhe e hodha; atëherë, e që nuk kam shkuar madje as në shtëpi t'i marrë teshat e mia, e ktheva devenë time drejt Nufudit, drejt Nexhdit dhe u nisa, duke u ndalur vetëm në fshatin e parë të blej rrëshekën për ujë dhe diç ushqim. Kështu kam kalëruar e kalëruar derisa nuk të kam takuar në Mekë, katër javë më vonë..."

"A të kujtohet, o Zejd, udhëtimi ynë i parë në brendi të Arabisë, drejt jugut deri te kopshtet e palmave dhe fushat e drithërave të Vadi Bishit, e pastaj deri te shkretëtirat ranore të Ranisë, në të cilat kurrë më parë nuk ka shkelur as një joarab?"

"E si nuk më kujtohet, dajo! Ti ke dëshiruar aq shumë që ta shohësh shkretëtirën Rub'el-Kali, ku xhindët bëjnë që rëra të këndojë nën diell... E ata beduinë që jetojnë në skajin e saj, të cilët kurrë në jetën e vet nuk patën parë xham dhe kanë menduar që syzet tua janë bërë nga uji i ngrirë? Ata vetë kanë qenë si xhindë, duke i lexuar gjurmët në rërë sikur që të tjerët e lexojnë librin, kurse duke ndier sipas qiellit dhe sipas ajrit ardhjen e shtrëngatës ranore me ajër më herët para se të vije... A të kujtohet, dajo, ai udhëheqësi të cilin e kemi huazuar në Ranij - atë beduinin e djallit të cilin ke dashur ta mbysësh kur ia mësyri që të na lërë midis shkretëtirës? Sa i tërbuar qe, për shkak të aparatit me të cilin fotografoje!"

Të dytë qeshemi për përjetimet që qenë larg pas nesh. Por atëherë fare nuk na ka mbetur deri te qeshja. Kemi qenë gjashtë deri shtatë ditë udhëtimi në jug prej Rijadit kur ky udhëheqës, beduin fanatik nga vendbanimi i ihvanëve të quajtur Er-Rajn, mori sulm të rreptë të tërbimit kur i shpjegova për çka shërben fotoaparati im. Dëshiroi që atë çast aty të na lërë për shkak se ai fotografimi i tillë heretik e rrezikon shpirtin e tij. Aq shumë edhe nuk do të ankohesha që do ta shporri sikur mos të

ishim pikërisht në territorin të cilin as unë as Zejdi nuk e njihnim dhe ku sigurisht, të lënë vetvetes, përgjithnjë do të humbeshim. Më parë jam përpjekur ta bind "beduinin djallëzor", por pa sukses; ai mbeti i papërshtatshëm dhe e ktheu devenë e vet mbrapa drejt Ranisë. I kam shpjeguar se kjo do t'i kushtojë me jetë po të na lërë në duart e vdekjes së sigurt nga etja. Kur përkundër kësaj vërejtjeje i grahte deves së vet, ia kam drejtuar pushkën dhe i jam kërcënuar se do ta qëlloj - me qëllim të njëmendtë që këtë edhe ta bëj. Kjo përfundimisht, si duket, e ngadhënjeu brengën e mikut tonë për shpirtin e tij. Pas murmuritjes, pranoi të na çojë deri te vendbanimi i parë më i madh, larg rreth tri ditë, kur kontestin tonë mund ta shtrojmë para kadiut që ai të vendosë. Zejdi dhe unë e kemi çarmatosur dhe shkëmbyerazi natën kemi pasur kujdes që ta pengojmë që mos të na ikë. Kadiu në Kuvaij, të cilit iu drejtuam pas disa ditësh, së pari e solli vendimin në dobi të udhëheqësit tonë, "sepse", tha ai, "është turp të fotografohen qeniet e gjalla" (duke e bazuar këtë në komentimin e gabueshëm të thënies së Pejgamberit, sepse përkundër besimit aq të shtrirë në mesin e shumë muslimanëve deri më sot se fotografimi i qenieve të gjalla është i ndaluar, ligji islam nuk përmban kurrfarë ndalese shprehimore në atë kuptim). Në këtë kadiut ia kam treguar shkresën e hapur të mbretit "emirëve të vendit dhe secilit kush mundet këtë ta lexojë". Fytyra e kadiut u bë më e thartë derisa lexonte: "Muhammed Asadi është musafir dhe mik i yni dhe na është i dashur, dhe çdokush që dëfton miqësi ndaj tij ka dëftuar edhe ndaj nesh, e çdokush që shpreh armiqësi ndaj tij do të konsiderohet se e ka dëftuar edhe ndaj nesh..." Fjalët dhe faksimili e Ibn Saudit patën ndikim magjik te kadiu dhe ai përfundimisht vendosi që "nën rrethana të caktuara"

mund të lejohet fotografimi... Megjithatë e lëshuam udhëheqësin tonë dhe e morëm tjetrin që të na çojë në Rijad.

"A të kujtohen ato ditë në Rijad, dajo, kur ishim musafirë të mbretit dhe kur ti qe jo i lumtur duke i parë shtallat e pallatit plot automobila të rinj të shndritshëm? A të kujtohet bujaria e mbretit ndaj teje?"

"A të kujtohet, Zejd, se si na ke dërguar t'i hetojmë shkaqet e kryengritjes së beduinëve dhe se si shumë net kemi udhëtuar dhe u vodhëm në Kuvajt dhe më në fund kemi konstatuar të vërtetën për kutitë e rijalëve shkëlqyeshëm të ri dhe pushkëve që kanë arritur deri të rebeluesit nëpërmjet detit...?"

"E atë misionin tjetër, dajo, kur Seid Ahmedi - Zoti i dhashtë jetë - të dërgoi në Sirenaik - dhe se si fshehtas kemi kaluar nëpër det në Egjipt me velanije - dhe se si arritëm në Xhabel Akdar, duke iu shmangur rojes italiane - Zoti i mallkoftë ata - dhe iu bashkangjitëm luftëtarëve që i udhëhiqte Omer el-Muhtari? Këto kanë qenë ditë interesante!"

Kështu vazhdojmë ta përkujtojmë njëri - tjetrin në shumë ditë, ditë të shumta që i kemi kaluar bashkë dhe e jona "a po të kujtohet, të kujtohet?" na shpiu neve në natë të thellë, derisa zjarri i kampit ngadalë fiket dhe mezi mbetën disa copë drunj që të digjen dalëngadalë, kurse fytyra e Zejdit ngapak fundoset në hijet dhe vetë bëhet si kujtesë e largët për sytë e mi të përgjumshëm.

Në qetësinë hyllësore të shkretëtirës, me erën e butë, të lehtë që me valë e lëviz rërën, fotografitë e të kaluarës dhe ardhmërisë takohen, sërish ndahen dhe e ftojnë njëra tjetrën me zëra të çuditshëm të kujtesës, mbrapa nëpër vite, mbrapa deri te fillimi i viteve të mia arabe, deri te haxhi im i parë Mekës dhe territ që i ka hijesuar ato ditë të para: deri te vdekja e gruas që e kam dashur sikur që nuk e kam dashur asnjë grua tjetër deri atëherë, kurse

tash është e varrosur në Mekë, nën gurin e thjeshtë pa mbishkrim, që shënon fundin dhe fillimin e rrugës sime të re për mua: një fund dhe një fillim, ftesë dhe jehonë, çuditërisht e gërshtuar në luginën gurore të Mekës...

"Zejd, a ka edhe pak kafe?"

"Gjithsesi, dajo," - u përgjigj Zejdi. Ai e ngriti pa nguti enën e lartë, të ngushtë prej bakri për kafe në të majtën dhe dy filxhana të imtë pa dorëza që cingërojnë në dorën e tij të djathtë - një për mua e një për të - qiti pak kafe në filxhanin e parë dhe ma ofroi. Nën hijen e kufisë kuq e bardhë të kariruar sytë e tij më shikojnë me vëmendje solemne, sikur kjo është shumë më serioze se sa filxhani i kafesë. Këta sy - thellë të vendosur dhe me qerpikë të gjatë, seriozë dhe të pikëlluar në qetësi, por gjithnjë të gatshëm të shkëlqejnë me hare të papritur, flasin për qindra gjenerata jetash në stepe dhe liri: sytë e njeriut stërgjyshërit e të cilit kurrë nuk i kanë eksploatuar dhe të cilët kurrë nuk i kanë eksploatuar të tjerët. Por më e bukur tek ai janë lëvizjet e tij: të kthjellëta, të vetëdijshme për ritmin e vet, kurrë në nxitim, kurse kurrë duke mos humbur kohë: saktësia dhe economiciteti që ju përkujton në harmoninë e instrumenteve në orkestrën mirë të udhëhequr simfonike. Lëvizjet e tilla mund shpesh t'i shihni te beduinët; varfëria e shkretëtirës manifestohet tek ata. Sepse, pas disa qyteteve dhe fshatrave, jeta në Arabi është aq pak e trajtësuar me duart njerëzore që natyra në njëmendësinë e vet e ka detyruar njeriun t'i shmanget çdo zvarritjeje në mirësjellje dhe t'i reduktojë veprimet të diktuar me vullnetin e tij ose me domosdoshmërinë e jashtme në disa forma mjaft të përcaktuara, themelore që kanë mbetur të njëjta gjatë gjeneratave të shumta dhe me kohë kanë arritur mprehtësinë e lëmueshme të kristalit.

"Më thuaj, Zejd, ku shkojmë nesër?"

Zeidi më shikon me buzëqeshje: "Po, dajo, natyrisht, drejt Tajmës...?"

"Jo, vëlla, dëshirova të shkoj në Tajmë, por tash këtë më nuk e dua. Shkojmë në Mekë..."



## II. Fillimi i rrugës

- 1 -

Pikërisht binte mbrëmja, disa ditë pas takimit tim me etjen, kur Zejdi dhe unë arritëm në një oazë të vogël të vetmuar ku kemi pasur për qëllim ta kalojmë natën. Nën rrezet e diellit perëndues bregoret ranore në lindje shkëlqyen si masat e agatit që derdhen në ngjyrat e ylberit me hijet gjithnjë të ndryshueshme të pastalit dhe shkëlqimet e zbutura të ngjyrave të dritës, ashtu të rafinuara që madje edhe syri sikur i përdhosi derisa i përcjell kalimet mezi diktuese të hijeve drejt monotonisë dhe territ që pushton. Ende mund t'i shihni qartë kurorat prej puplash të palmave dhe, në gjysmë të fshehura pas tyre, shtëpitë modeste, të përhimta prej argjilës dhe muret kopshtare, kurse rrotat e drunjta mbi pus ende bëjnë muzikë.

I lëshojmë devetë të shtrihen në largësi të caktuar nga fshati, në pemishten prej palmave, i shkarkojmë thasët tanë të rëndë dhe i heqim shalat nga shpinat e ngroh-ta të kafshëve. Disa rrugaçë tubohen rreth të huajve dhe një prej tyre, djalosh i vogël me sy të mëdhenj, me gujë të grisur, i ofron Zejdit që t'i tregojë ku mund të gjejë drunj për mdezje. Ata të dytë u nisën atje, kurse unë i çoj devetë në pus. Derisa po e lëshoj kovën time prej lëkure dhe e nxjerr plot, disa gra vijnë nga fshati për ujë me enë bakri dhe shtambë dheu që i bartin lirisht në kokat e tyre,

me të dy duart të shtrira anash e të kthyer lart - në mënyrë që më mirë ta baraspeshojnë barrën e vet - duke i mbajtur me duar skajet e veleve të veta që valëviten si krahë.

"Es-selamu alejkum - Paqja qoftë me ty", - thanë ato.

"Ve alejkum'us-selam ve rahmet'ull-llah - unë përgjigjem - edhe me ju qoftë paqja dhe mëshira e Allahut."

Rrobat e tyre janë të zeza, kurse fytyrat - sikur që gati gjithnjë te gratë e beduinëve dhe fshatarëve të kësaj pjese të Arabisë - janë të zbuluara, ashtu që mund të shihen sytë e tyre të zinj. Edhe pse kanë banuar në oazë gjatë shumë gjeneratave, ende nuk e patën humbur shprehjen serioze të fytyrës nga ditët nomade të stërgjyshërve të vet. Lëvizjet e tyre janë të qarta e të përcaktuara, kurse përmbajtja e tyre është pa kurrfarë turpi derisa pa zë marrin litarin e kovës nga duart e mia dhe nxjerrin ujin për devetë e mia.

"Allahu i bekoft e duart e juaja, motra, dhe ju ruajt në siguri".

"Edhe ty të ruajt Allahu, o udhëtar" - përgjigjen ato dhe u kthehen shtambave dhe enëve të tyre që t'i mbushin me ujë për shtëpitë e veta.

Pas kthimit në vendin e kampimit tonë, i lëshoj devetë të shtrihen dhe ua lidh këmbët e para që natën mos të largohen. Zejdi tashmë e ka nderur zjarrin dhe po bën kafe. Uji po vlon në tenxheren e thellë prej bakri me fyt të gjatë, të shtrembër; tenxherja më e vogël me formë të ngjashme qëndron e gatshme pranë Zejdit. Në dorën e majtë ai mban lugën e madhe, të cekët të hekurt me dorëzën e gjatë mbi gjysmë metri, në të cilën fërgon një grusht kafe në zjarr të qetë, sepse në Arabi kafeja çdoherë fërgohet freskët. Posa kokrrat të marrin ngjyrë gështenje të çelë, ai i vë në havanin e mjaltit dhe i thyen. Pastaj fut pak ujë të valë nga ena më e madhe në të voglën, e fut kafënë e grimtuar në të dhe ia afron zjarrit që të vlojë

ngadalë. Kur pija të jetë thuajse e gatshme ai ia fut disa fara kardamoni që të idhëtohet, sepse, si thuhet në Arabi, kafeja, që të jetë e mirë, duhet të jetë "e idhët si vdekja, kurse përvëluese si dashuria".

Unë, ndërkaq, ende nuk jam i gatshëm të dëfrehem me kafënë time në kënaqësi. I lodhur dhe i djersitur pas orëve të gjata, të ngrohta në shalë, me rrobat që pakëndshëm ngjiten për trupi, mallëngiej për banjo. Për këtë shkoj deri te pusi nën palma.

Tashmë është terr. Palmishtet janë shkretuar, vetëm në largësi, te shtëpitë, lehë një qen. I hoqa rrobat e mia dhe lëshohem në pus, duke u mbajtur me duar dhe duke rezistuar me këmbë në gungat dhe plasaritjet në mur, kurse duke u ndihmuar me kanape në të cilat pezullojnë kovat prej lëkure, deri në fund te uji i murrmë, dhe në të. Është i ftohtë dhe më depërton deri në gjoks. Në terr pranë meje pezullojnë kanapet, vertikalisht të shtrënguarra me barrën e kovave të mëdha prej lëkure, tash të zhytura që gjatë ditës shërbejnë për ujtitjen e pemishtes. Nën thembrat ndiej rigim të lehtë të ujit; ai depërton kah lart nga burimi nëntokësor, që e mbush pusin me fiskajë të lehtë të përtëritjes amshuese.

Ngre kokën dhe shoh rrethin e qiellit mbi skajin e pusit dhe yjeve. Derisa ashtu qëdroj i palëvizshëm, një kohë të gjatë, më duket se shoh se si ngadalë ndërrojmë pozitën tonë, duke lëvizur, në mënyrë që ta përmbushim vargun e miliona, miliona viteve për të cilat nuk ka fund. Atëherë, duke mos dashur, duhet të mendoj për vargun e vogël të viteve që i kam përjetuar - për të gjitha ato vite të paqarta të kaluara në sigurinë e ngrohtë të fëmijërisë, në qytetin ku e kisha të njohur çdo skutë dhe çdo rrugë; pastaj në qytetet tjera plot mallëngjim, përmallim dhe shpresë çfarë vetëm rinia e hershme mund t'i dijë; pastaj në botë të re në mesin e njerëzve, fytyrat dhe sjelljet e të

cilëve më parë për mua ishin të huaja, por me kohë sollën afërsi të re dhe ndjenjë të re se jam në shtëpi; pastaj në vise të çuditshme e më të çuditshme, në qytete të vjetra si mbamendja e njeriut, në stepet pa horizonte, në malet egërsia e të cilave na përkujton në egërsinë e zemrës njerëzore, dhe në vetminë përvëluese shkretinore. Edhe rritja e ngadalshme e të vërtetave të reja - për mua të reja - e pastaj ajo ditë në barat e Hindu-Kushës kur, pas bisedës së gjatë, një mik, afganistanez, habitshëm bërtiti: "Po ti je musliman, vetëm ti këtë ende edhe nuk e di...!" Pastaj ajo dita e dytë, me muaj më vonë, kur këtë edhe vetë e kam mësuar; haxhi im i parë, vdekja e grues sime dhe pashpresa që këtë e ka përcjellë. Ajo kohë e amshueshme ndër Arabët prej atëherë, vitet e miqësisë së thellë me mbretin i cili me shpatën e vet e ka gdhendur për vete shtetin nga asgjë dhe përpak që nuk e ka arritur madhësinë e vërtetë; vitet e bredhjes nëpër shkretëtirë dhe stepë; shëtitjet e rrezikshme ndër beduinët ndërluftues arabë dhe në luftën libiase për pavarësi; qëndrimet e gjata në Medinë ku jam përpjekur ta plotësoj dijen time për Islamit në xhaminë e Pejgamberit, haxhi i përsëritur, martesat me beduinët, e pastaj divorcet; marrëdhëniet e ngrohta njerëzore dhe ditët e zbrazëta të vetmimit; diskutimet e rafinuara me muslimanët e arsimuar nga të gjitha anët e botës dhe udhëtimet nëpër fushat e pahulumtuara; të gjitha këto vite të depërtimit në botë larg nga mendimet dhe caqet e ekzistencës perëndimore.

Si gjatë gjithë këtyre viteve...

Të gjitha këto vite të fundosura tash dalin në sipërfaqe, i zbulojnë fytyrat e veta edhe një herë dhe më thërrasin me shumë zëra. Papritmas, në rekëtimin e shtanigur të zemrës sime, e kuptoj sa e gjatë, sa e pafund ka qënë rruga ime. "Gjithnjë vetëm ke shkuar dhe ke shkuar", i them vetvetes. "Ende nuk e ke ndërtuar jetën tënde në

diç që do të mund të kapet me duar dhe kurrë nuk ka pasur përgjigje në pyetjen: ku?... Gjithnjë vetëm ke ecur e ecur, endacak nëpër shumë vende, musafir në shumë zemra, por mallëngjimi kurrë nuk është qetësuar, e edhe pse më nuk ke qenë i huaj, ende nuk ke lëshuar rrënjë..."

Përse, madje edhe pasi e kam gjetur vendin tim ndër njerëzit që besojnë në atë që edhe vetë e kam pranuar për besim, nuk mund të lëshoj rrënjë?

Para dy vjetësh, kur e kam marrë për grua araben nga Medina, kam dëshiruar ta kem një djalë. Nëpërmjet këtij djali, Talalit, që na lindi para disa muajsh, kam filluar të ndiej se arabët janë gjini e imja, sikur që tashmë kanë qenë për mua vëllezër prej feje. Do të dëshiroja që ai t'i ketë rrënjët e veta thellë në këtë tokë dhe të rritet i vetëdijshëm për trashëgiminë e vet të madhe, si në gjak ashtu edhe në kulturë. Do të mund të mendohej se kjo do të duhej të mjaftonte të zgjojë te njeriu dëshirën që të qetësohet përgjithnjë, të ndërtojë për veten dhe familjen e vet shtëpi të përhershme. E përse atëherë bredhjet e mia ende nuk mbaruan dhe përse duhet të vazhdoj rrugës? Përse jeta që e kam zgjedhur vetë nuk më kënaq plotësisht? Ç'është ajo që më mungon në këtë fat? Pa dyshim, këto nuk janë përparësitë intelektuale të Evropës. I kam lënë pas vetes. Ato nuk më mungojnë. Vërtet, unë jam aq i larguar prej tyre që m'u bë gjithnjë e më rëndë të shkruaj për gazetat Evropiane të cilat më furnizojnë me mjete për jetë; çdoherë kur e dëgjoj ndonjë artikull, më duket sikur po hedh gurin në pus pa fund: guri zhduket në zbrazëtinë e errët, e nuk arrinë madje as jehona të më thotë se e ka arritur cakun e vet...

Derisa ashtu mendoj në paqetësi dhe konfuzion, përgjysmë i fundosur në ujën e errët të pusit të një oaze në Arabi, papritmas dëgjoj zërin nga terri i kujtesave, zërin e nomadit të vjetër, Kurdit: Nëse uji qetësohet i palëviz-

shëm në kënetë, ai bëhet bajat dhe i baltuar, por nëse lëviz dhe rrjedh, bëhet i kthjellët; po ashtu edhe njeriu në bredhjet e veta. Pas kësaj, sikur me ndonjë magji, çdo konflikt më lëshon. Filloja të shikoj në vetveten nga largësia, sikur që do të duhet të shikoni faqet e librit që ta lexoni rrëfenjën nga ai; fillova të kuptoj që jeta ime nuk ka mund të ketë rrjedhë tjetërfare. Sepse, kur e pyes vetveten: "Ç'është shuma e përgjithshme e jetës sime?" diç në mua sikur përgjigjet: "Ke vendosur ta ndërrosh një botë me tjetrën - të fitosh botën e re në ndërrim për të vjetrën të cilën kurrë realisht nuk e ke poseduar". Po mësoj me qartësi hutuese, se ndërmarrja e tillë vërtet ka mund të kërkojë tërë jetën.

Ngjitem nga pusi, e veshva tunikën e pastër, të gjatë, që e kam sjellë me vete, e shkoj deri te zjarri, Zejdi e devja, pij kafënë e idhët që ma ofron Zejdi, e pastaj shtrihem, i freskuar dhe i ngrohur në dhe, pranë zjarrit.

## - 2 -

Me dorë nën kokë shikoj, shikoj në këtë natën arabiane që më ka mbuluar krejtësisht, e zezë dhe e hyllësuar. Ylli i shkëlqyeshëm kalon në harkun kolosal, e pastaj ai tjetri, e edhe një; harqet e dritës që e copëtojnë terrin. A janë ato vetëm pjesë të planetëve të thyer, fragmente të ndonjë katastrofe kozmike, që tash pa cak fluturojnë nëpër pafundet e kozmosit? O, jo! Nëse e pyetni Zejdin, ai do t'ju thotë se këto janë shtiza të flakta me të cilat melekët i largojnë shejtanët që për disa netë ngjiten lart qiellit t'i zbulojnë fshehtësitë e Zotit... A ka qenë ky mbase vetë Iblisi, mbreti i të gjithë shejtanëve, që pikërisht e ka pranuar atë shtizën e fuqishme, të zjarrtë atje në lindje...?

Legjendat lidhur për këtë qiell dhe ujët e tij më janë më të afërta se sa shtëpia e fëmijërisë sime...

Dhe si do të mund të jetë tjetërfare? Prej kur kam ardhur në Arabi, kam jetuar si arab, jam veshur vetëm si arab, kam folur vetëm me gjuhën arabe, i kam ëndërruar ëndrrat e mia arabisht; traditat arabe dhe të shprehurit figurativ pahetueshëm i kanë trajtësuar mendimet e mia, nuk më kanë penguar përmbajtjet shpirtërore që rëndom e pamundësojnë të huajin - sado mirë qoftë i udhëzuar në mirësjelljen dhe gjuhën e vendit përkatës - që ta gjejë qasjen e mirëfilltë ndjenjave të popullit të saj dhe që botën e tyre ta përvetësojë si botën time. Papritmas më duhet të qeshi zëshëm me qeshje fati dhe lirie - aq zëshëm saqë Zejdi me habi shikon kah unë, kurse deveja ime e kthen kokën drejt meje ngadalë, ngapak me lëvizje përbuzëse; vetëm tash shoh sa e thjeshtë dhe e drejtë, përkundër gjatësisë së vet, ka qenë rruga ime - rruga ime nga bota që realisht nuk e posedoja, në botën njëmend time.

A nuk ka qenë ardhja ime në këtë vend, në realitet, ardhja në shtëpi? Ardhja në shtëpinë e zemrës që e ka zbuluar shtëpinë e vet të vjetër mbi një varg mijëra vjetësh dhe tash e njeh këtë qiell, qiellin e vet me gëzimin e dhembshëm? Sepse, ky qielli arab - aq shumë më i errshëm, më shumë, më solemnisht dhe më i pasur me yje se sa cilido qiell tjetër - ka mbuluar vargun e gjatë të stërgjyshërve të mi, ata endacakë barinj luftëtarë, kur, para një mijë vjetësh, u nisën të magjepsur me lakmi për tokë e plaçka, drejt tokës së plleshme Kaldeje në ardhmërinë e panjohur; ai fisi i vogël beduin i hebraikëve, stërgjyshit te atij njeriu që do të lindet në Ur në Kaldej.

Ky njeri, Ibrahim, në të vërtetë nuk ka qenë pjesëtar i Urit. Ai ka qenë pjesëtar i vetëm njërit prej shumë fiseve arabë që në këtë ose atë kokë kanë gjetur rrugën e vet nga stepet e uritura të Siujdhesës drejt vendeve veriore të ëndrrave, për të cilat është folur që në to është vend i bollëkut - vendet e banuara të Gjysmëhënës së Frytshme, Siri

dhe Mesopotami. Nganjëherë fiset e tilla kanë arritur t'i ngadhënjejnë banorët që gjendeshin atje dhe t'iu imponohen si zotërinj të tyre, shkallërisht duke u përzier me popullin e mundur dhe duke dalur, tok me ta, si popull i ri - si Asirianët dhe Babilonasit, që i kanë ngritur mbretëritë e veta mbi gërmadhat e qytetërimit të hershëm sumer, apo Kaldejët që erdhën në pushtet në Babiloni, apo Amaritët, që më vonë kanë qenë të njohur si Kanaanët në Palestinë dhe si Fenikasit në brigjet e Sirisë. Në ndonjë epokë tjetër nomadët ardhacakë kanë qenë tepër të dobët që t'i fitojnë ato që kanë arritur më herët dhe kanë qenë të absorbuar, ose banorët i kanë kthyer nomadët prapa në shkretëtirë, duke i detyruar të kërkojnë kullota tjera dhe ndoshta vende tjera që do t'i nënshtrojnë. Fisi i Ibrahimit - emri origjinal i të cilit, sipas Librit të Zanafillës, ka qenë Ab-Ram - që në gjuhën e vjetër arabe do të thotë "Dëshirë e Madhe" - ka qenë qartë njëri prej atyre fiseve më të dobëta. Rrëfimi biblik për qëndrimin e tyre në Ur, në skaj të shkretëtirës, ka të bëjë me kohën kur kanë konstatuar se nuk mund t'i pushtojnë shtëpitë e reja në vendin e Lumenjve Bineq dhe pikërisht kanë pasur për qëllim të nisen drejt veriperëndimit përgjatë Eufratit drejt Haranit, e prej këtu në Siri.

"Dëshira e Madhe", ky stërgjyshi im i hershëm të cilin Zoti e ka shtyrë të shkojë drejt viseve të panjohura dhe kështu ta zbulojë vetveten, do të mund mirë ta kuptojë përse jam këtu - sepse edhe ai është dashur të breddhë nëpër shumë vende para se ka mundur të ndërtojë jetën e vet në diç të kapshme, dhe ka qenë musafir i shumë zemrave të panjohura para se i është lejuar të lëshojë rrënjë. Përvojës së tij, që nxitë respekt, hutia ime e imët nuk do t'i paraqiste enigmë. Ai do ta dinte - sikur që këtë unë tash e di - se domethënia e të gjitha bredhjeve të mia qëndron në dëshirën e fshehur që ta takoj vetveten, duke

e takuar botën, qasja e të cilit pyetjeve më të fshehura të jetës, vetë realitetit, ka qenë e ndryshme nga çdo gjë në çka kam qenë i mësuar në fëmijërinë dhe rininë time.

### - 3 -

Sa rrugë e gjatë është kjo, nga fëmijëria, rinia ime në Evropën Qendrore, deri te tanishmëria ime në Arabi, por sa rrugë e këndshme është kjo për kujtesë të udhëtoj prapa...

Aty janë ato vite të fëmijërisë së hershme në qytetin, Lovov - atëherë nën sundimin e Austro - Hungarisë - në shtëpinë që ka qenë po aq e qetë dhe e denjë sa edhe rruga në të cilën ka qenë. Rruga e gjatë me elegancë ngapak të bezdisshme, e kornizuar me gështenja dhe e shtruar me blloqe druri që e kanë zbutur çukurmimin e patkonjve të kuajve dhe e kanë shndërruar çdo çast të ditës në pasdite të plogshhtë. E kam dashur atë rrugë të këndshme me vetëdijen tejet larg viteve të fëmijërisë si me dhe jo vetëm për atë që kjo ishte rruga e shtëpisë si me; e kam dashur, mendoj, për shkak të pamjes së matur fisnike me të cilën ka rrjedhë nga qendra e hareshme e atij qyteti më të hareshëm drejt qetësisë së thellë të pyjeve në skaj të qytetit dhe varrezave të mëdha që shtrihen fshehtazi në mal. Karrocat e shkëlqyeshme nganjëherë kalonin në rrotat e heshtura me përcjelljen e çukurmimit të rreptë, ritmik të patkonjve të dekoruar apo, nëse ky do të ishte dimri dhe rruga do të zbardhohej me borë të thellë, sajat rrëshqitnin mbi të dhe avulli në re dilte nga hunda e kuajve, kurse zilet e tyre cingërronin nëpër ajrin e akullit. E nëse edhe ju do të uleshit në saje dhe do ta ndienit shushuritjen e akullit se si i han faqet tuaja, zemra juaj fëmijërore do të dinte që kuajt galopë po u bartin në lumturinë që nuk ka as fillim as fund.

Këtu janë muajt e verës në fshat, ku babai i nënës, bankier i pasur, posedonte tokë të madhe për pushim e rekreim për familjen e vet të pasur. Përroi i vogël i qetë me një varg shkurresh përgjatë brigjeve të tij, shtallat plot lopë të qeta, terri në mënyrë misterioze i përmbushur me erën e kafshëve dhe të kashtës dhe me qeshjen e vashave të fshatit të preokupuara në mbrëmje me mjeljen e lopëve, do të pinit qumësht të ngrohtë me shkumë drejtpërdrejt nga kovat - jo për shkak se jeni të etshëm, por për atë se është interesant të pish diç që është aq afër burimit të vet shtazarak... Ato ditë përvëluese gushti të kaluara në fusha me fshatarët që korrin drithin dhe me gratë që e tubojnë dhe e lidhin në duaj, gratë e reja, me pamje të bukura, me shtat të rëndë, kraharorplote, me duar të forta të ngrohta, fortësinë e të cilave keni mund ta ndieni kur, duke luajtur në drekë juve t'ju zvarrisin nëpër shtregë; natyrisht, keni qenë atëherë tepër të rinj që të kishit nxjerrë ndonjë përfundim nga ato përqaftime me qeshje...

Këtu janë udhëtimet me prindërit e mi në Vjenë dhe Berlin, Alpe dhe malet e Çekisë, në Detin Verior dhe Baltik; vende aq larg sa gati dukeshin si botë të reja. Çdoherë nisjet në udhëtimet e tilla, fishkëllima e parë e lokomotivës dhe lëkundja e parë e rrotave e ndalë të rrahurit e zemrës në pritjen mallëngjyese të çudive që duhet të ndodhin... Kanë qenë edhe shokët në lojë, djelmoshat dhe vashat, vëllai dhe motra dhe shumë kushërinj, javët shumë të bukura të lirisë pas njëtrajtshmërisë - por jo njëtrajtshmërisë tepër të padurueshme - të ditëve në shkollë; ecja nëpër fusha, takimet e para të fshehta me vashëzat e dashura të rritjes së vet dhe shkëlqimi i hutuesisë së parë nga e cila vihet në veti vetëm nëse kalojnë orë e orë...

Kjo ka qenë fëmijëri e lumtur, që më mbushë me kënaqësi edhe në kujtesë. Prindërit e mi kanë jetuar në rrethana të përshtatshme, kurse kanë jetuar kryesisht për

fëmijët e vet. Rehatia e nënës sime dhe qetësia e papërzier kanë mund të kenë diç me lehtësinë me të cilën më vonë kam qenë në gjendje që t'u përshtatem kushteve jo të rëndomta dhe, nganjëherë, krejtësisht të kundërta; ndërkaq, joqetësia e brendshme e babait sigurisht është shprehur në qetësinë time vetjake.

Nëse do të duhej ta përshkruaj babanë tim, do të thosha se ky njeri i shkëlqyeshëm, i zhdërvjelltë, me shtat të mesëm, me natyrë të errët dhe me sy të mbyllur epsharak, nuk ka qenë krejtësisht në pajtim me rrethin e vet. Në rininë e vet të hershme ka ëndërruar që t'i kush-tohet shkencës, sidomos fizikës, por kurrë nuk ka qenë në gjendje ta sendërtojë atë ëndërr dhe është dashur të kënaqet dhe të bëhet avokat. Edhe pse plotësisht i suksesshëm në këtë profesion, në të cilin fryma e tij e rreptë ka mund të gjejë provokim mirëseardhës, ai kurrë me këtë plotësisht s'është pajtuar; pamja e izolueshmërisë që e ka rrethuar ka mund të shkaktohet me vetëdijen gjithnjë të pranishme, se profesioni i vërtetë e ka anashkaluar.

Babai i tij ka qenë rabin ortodoks në Czrenoëitz, kryeqytetin e provincës austriake të Bukovinës. Ende më kujtohet si plak i këndshëm, me duar dhe fytyrë shumë të butë të kornizuar me mjekër të gjatë të bardhë. Përveç interesit të tij të thellë për matematikë dhe astronomi - që i studionte në kohën e lirë tërë jetën e vet - ai ka qenë njëri nga shahistët më të mirë të tërë krahinës. Kjo sigurisht ka qenë bazë e miqësisë së tij afatgjate me kryepeshkopin ortodoks grek, i cili edhe vetë ka qenë shahist i njohur. Të dytë kalonin shumë net së bashku mbi tabelën e shahut, kurse i mbaronin ndejt e tyre me diskutimin për postullatet metafizike të religjioneve të tyre. Do të mund të parashtrohet që, me atë prirjen e këtillë të shpirtit, gjyshi im me gëzim do ta priste prirjen e të birit të vet - babait tim - ndaj shkencës. Por qartë, ai tashmë

pat vendosur prej vetë fillimit që i biri i tij më i vjetër ta vazhdojë traditën rabinore, që në familje shtrihej gjatë disa gjeneratave, dhe ka refuzuar që fare edhe të shqyrtojë çfarëdo profesioni tjetër për babanë tim. Në këtë këmbëgulësi ai ka mund të përkrahet edhe me sekretin e turpshëm familjar: me kujtimin në një dajë të vetin - do të thotë stër-stër-dajën tim - i cili në mënyrë krejtësisht jo të rëndomtë "ka tradhtuar" traditën familjare dhe madje e ka lëshuar religjionin e të parëve të vet.

Ai stër-stër-daja thuajse mitik, emri i të cilit kurrë nuk është cekur zëshëm, duket se ka qenë i edukuar në traditën e njëjtë rigoroze familjare. Në vitet e hershme është bërë rabin plotësisht i pavarur, i martuar me gruan që qart nuk e dashuronte. Pasi profesioni prej rabini në atë kohë nuk i ofronte të ardhura të mjaftueshme, ai i plotësonte me tregtim gëzofash, që çdo vit kërkonte udhëtim në tregun qendror evropian me gëzofë, në Lajpcig. Një ditë, kur i kishte rreth njëzet e pesë vjet, ai u nis me qerre kuajsh - kjo ishte në gjysmën e parë të shekullit XIX-në një prej atyre udhëtimeve të gjata. Në Lajpcig i shiti gëzofët sikur edhe rëndom, por, në vend që të kthehet në shtëpi, ai e shiti edhe qerren dhe kuajt, e rroi mjekrën dhe zylyfet dhe, duke e harruar gruan e tij të padashur, shkoi në Angli. Një kohë jetoi duke kryer punë shërbyese, duke studiuar astronominë dhe matematikën natën. Njëfarë zotëriu duket se ka zbuluar talentin e tij intelektual dhe i ka mundur t'i vazhdojë studimet e veta në Oksford, prej nga pas disa vjetësh doli si dijetar që premtonte shumë, i konvertuar në kristianizëm. Së shpejti pasi ia dërgoi gruas së vet dokumentin Hebraik me të cilin me të shkurorëzohet, u martua me vashën prej "besimshtrëmbëtit". Pak ka ditur familja jonë për jetën e tij të mëvonshme, pos që ka arritur autoritet të

konsiderueshëm si astronom dhe profesor universiteti dhe se ka mbaruar si kalorës.

Ky shembull tmerrues duket se e ka bindur gjyshin tim që të marrë qëndrim tejet rigoroz në aspekt të simpatisë së babait tim ndaj studimit të diturive të "jobesimtarëve"; është dashur të bëhet rabin dhe është bërë. Mirëpo, babai im nuk ka qenë i gatshëm që të dorëzohet aq lehtë. Derisa gjatë ditës e ka studiuar Talmudin, ka kaluar një pjesë të netëve të veta duke e studiuar fshehtazi, pa ndihmën e mësuesit, programin e gjimnazit humanist. Megjithatë më vonë i ka treguar nënës. Ndonëse studimet e ndalueshme të birit të saj kanë mund t'ia ngarkojnë ndërgjegjen, natyra e saj fisnike e ka shtyrë të kuptojë se do të ishte vrazhdësi të privohet nga rasti që ta ndjek dëshirën e zemrës së vet. Me njëzet e dy vjet, Pasi për katër vjet mbaroi kursin tetëvjeçar të gjimnazit, babai im hyri në provimin e maturës dhe maturoi me sukses të jashtëzakonshëm. Me diplomë në dorë, ai dhe nëna e tij morën guxim tash që t'ia komunikojnë lajmin e tmerrshëm gjyshit tim. Mund ta imagjinoj skenën dramatike deri te e cila erdhën, por rezultat i kësaj ishte që gjyshi im më në fund lëshoi pe dhe u pajtua që babai im t'i lërë studimet rabinore dhe në vend të kësaj të hyjë në universitet. Rrethanat financiare në familje, ndërkaq, nuk i kanë lejuar që t'i përkushtohet studimit të tij të dashur të fizikës; u detyrua t'i kthehet profesionit juridik më të levërdishëm, dhe gjatë kohës u bë avokat. Disa vjet më vonë u vendos në Lavov, në Galicinë lindore, dhe u martua me nënën time, me njëjërë prej katër vajzave të bankarit të pasur vendor. Atje, në verë të vitit 1900, jam lindur si fëmijë i dytë prej tre fëmijëve.

Dëshira e dëshpëruar e babait tim gjenë rrugëdalje në leximin e tij për lëndët shkencore dhe ndoshta po ashtu në simpatinë e tij të çuditshme, edhe pse skajërisht

të përmbajtur, të veçantë ndaj djalit të tij të dytë - mua - i cili si duket, po ashtu më shumë ka qenë i interesuar për gjërat që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura për fitimin e parave dhe për "karrierë" të suksesshme. Megjithatë, shpresat e tij që prej meje të bëjë dijetar qenë të gjykuara të mbesin të paplotësuara. Ndonëse jo i marrë, kam qenë mjaft indiferent ndaj mësimit. Matematika dhe shkencat natyrore kanë qenë për mua sidomos të mërzitshme; kam gjetur kënaqësi të paskajshme në leximin e romaneve interesante historike prej Sjenkieviqit, në fantazitë e Zhyl Vernit, në rrëfimin për indianët të Xhejms Fenimor Kuperit dhe Karl Majit dhe, më vonë, në vargjet prej Rilkes dhe ritmeve të zëshme Kështu fliste Zaratustra. Fshehtësitë e gravitetit të Tokës dhe elektricitetit, jo më pak se gramatika latine dhe greke, më kanë lënë plotësisht të ftohtë, ashtu që gjithnjë mezi jam nxjerrë. Kjo është dashur të nxisë dëshpërim të thellë te babai im, por ka mund të gjejë njëfarë ngushëllimi në faktin se mësuesit e mi kanë qenë mjaft të kënaqur me prirjen time ndaj literaturës - si asaj polake ashtu edhe asaj gjermane - sikur edhe ndaj historisë!

Në pajtim me traditën në familjen tonë, kam pranuar, me mësuesit privatë në shtëpi, baza të themelta nga shkencat religjioze hebraike. Për këtë nuk është dashur t'i falënderojmë çfarëdo religjioziteti të theksuar të prindërve të mi. Ata i kanë takuar gjeneratës që, derisa me fjalë të zbrazëta ka shprehur përkatësinë e këtij apo atij besimi religjioz që i ka trajtësuar jetët e të parëve të tyre, kurrë nuk ka bërë as përpjekjen më të vogël ta harmonizojë jetën e vet praktike ose madje etikën edhe mendimet e veta me ato mësim. Në shoqërinë e tillë edhe vetë ideja e religjionit ka qenë reduktuar në njërën prej dy gjërave: rituali i mërzitshëm i atyre që janë lidhur me trashëgiminë e vet religjioze me shprehinë - dhe vetëm

me shprehinë - ose indiferentitetin cinik të atyre "liberalë", që religionin e kanë konsideruar supersticion të vjetruar me të cilin mund nganjëherë formalisht të pajtohet, por të cilit fshehtazi i është turpëruar si diç intelektualisht te pambrojtur. Sipas të gjithave, prindërit e mi i kanë takuar kategorisë së parë, por nganjëherë kam pasur parandjenjë jo të qartë se babai im së paku ka anuar kah tjetra. Megjithatë, për dallim nga babai dhe vjehri im, ai ka kërkuar që të kalojë orë të tëra mbi tekstet e shenjta. Në këtë mënyrë në vitin e trembëdhjetë, jo vetëm që me lehtësi kam mundur të lexoj hebraisht por edhe kam folur rrjedhshëm dhe krahas kësaj kam arritur njohje të mirë të gjuhës aramite (së cilës sigurisht mund t'i falënderohem për lehtësinë me të cilën më vonë e kam mësuar arabishten). E kam studiuar Dhjatën e Vjetër në origjinal. Mishna dhe Gemara - do të thotë teksti dhe komentet e Talmudit - më janë bërë të afërta. Kam mund të diskutoj me shumë vetëbesim për dallimet ndërmjet Talmudit babilonas dhe jerusalemas, jam thelluar në ngatërreshmërinë e komentimeve biblike, të quajtura Targum, pikërisht sikur kam qenë i paracaktuar për karrierën rabinore.

Përkundër gjithë këtij lulëzimi të urtësisë religjioze ose ndoshta pikërisht për këtë shkak, së shpejti tek unë u zhvillua ndjenja e përbuzjes ndaj shumë postullateve të besimit hebraik. Natyrisht, unë nuk i kam mohuar mësimet për drejtësinë morale aq fuqishëm të theksuar në shkresat hebraike, as vetëdijen e lartësuar për Zotin e të dërguarve hebraikë, por më dukej se Zoti, sipas Dhjatës së Vjetër dhe Talmudit, për së tepërmi është i preokupuar me ritualet që besimtarët e Tij duhet ta adhurojnë. Po ashtu, më erdhi ideja se ky Zot çuditërisht është i preokupuar me fatin e një populli të veçantë, hebrenjve. Vetë lënda e Dhjatës së Vjetër, si histori e pasardhësve të Ibrahimit, synon që Zotin ta paraqesë jo si atë që krijon

dhe e mbanë tërë njerëzinë, por më tepër si hyjni fisnore që të gjitha krijimet ua përshtatë kërkesave të "popullit të zgjedhur"; duke e shpërblyer me fitore nëse është i drejtë, kurse duke e ndëshkuar me duart e të pafeve kurdo që shtrembëronte nga shtegu i caktuar. I shikuar në dritën e këtyre mangësive themelore, madje edhe flaka etnike e të dërguarve të mëvonshëm, sikur Isait dhe Jeremiut, është dukur i privuar nga porosia universale.

Ndonëse efekti i atyre studimeve të mia racore është i kundërt nga ai për çka ai ka qenë destinuar - duke më larguar nga religjioni i të parëve të mi më shumë se sa duke më afruar tek ai - shpesh mendoj se ato në vitet e mëvonshme më kanë ndihmuar ta kuptoj synimin kryesor të thelbit të religjionit, çfarëdo qoftë forma e tij. Mirëpo, në atë kohë, dëshpërimi im me judaizmin nuk më ka shpënë drejt kërkimit të të vërtetave spirituale në drejtimet tjera. Nën ndikimin e rrethit agnostik i jam kthyer, si aq shumë fëmijë të epokës sime, refuzimit të njëmendtë të religjioneve institucionale; Pasi religjioni im kurrë tek unë nuk ka pasur domethënie më të madhe se disa rregulla kufizuese, nuk jam ndier më keq për shkak se jam larguar nga ai. Idetë teologjike dhe filozofike ende realisht nuk më kanë njohur; ajo për çka jam gëzuar nuk ka dalluar shumë nga shpresat e shumicës së djelmoshave tjerë: aksioni, aventura, mallëngjimët.

Nga fundi i vitit 1914, kur Lufta e Parë Botërore tashmë qe tërbuar, rasti i parë i madh që t'i përmbush ëndrrat e mia djaloshare duket se ishte shumë afër. Në vitin e katërbëdhjetë kam ikur nga shkolla dhe kam hyrë në armatën austriake me emër të rrejshëm. Kam qenë mjaft i gjatë për vitet e mia dhe lehtë pranuan se i kam tetëmbëdhjetë, minimumi për regrutim. Por, qart, unë nuk kam bartur shkopin e mareshalit për çantën time. Pas përafërsisht një jave, babai im i gjorë arriti që me

ndihmën e milicisë të më bie në gjurmë dhe unë i turpëruar jam kthyer në Vjenë, ku familja ime diç më herët qe vendosur. Gati katër vjet më vonë unë vërtet, edhe ligjërisht, jam marrë në armatën austriake, por deri atëherë tashmë pata pushuar të ëndërroj për lavdinë ushtarake dhe kam qenë në gjurmë drejt rrugëve tjera që shpiejnë drejt përmbushjes së ëndrrave tjera. Sidoqoftë, disa javë pas regrutimit tim ndodhi revolucioni, u thye Mbretëria Austriake dhe erdhi fundi i luftës.

Gjatë kohës prej rreth dy vjetësh pas Luftës së Parë Botërore kam studiuar, në mënyrë pak sipërfaqësore, historinë e artit dhe filozofinë në Universitetin e Vjenës. Zemra ime nuk ishte në ato studime. Karriera e qetë akademike nuk më tërhiqte. Kam ndër përballim që të kapem më drejtpërdrejt me jetën, të hyj në të pa kurrfarë mbrojtjesh artificiale me kujdes të paramenduar, që rreth vetes dëshirojnë ta ndërtojnë njerëzit me shpirt të kthyer kah siguria; kam dëshiruar që vetë ta gjej hyrjen drejt rregullimit shpirtëror që, këtë e kam ditur, duhet të ekzistojë, por të cilin ende nuk kam mundur ta kuptoj.

Nuk është lehtë me pak fjalë të sqaroj ç'kam menduar ato ditë me rregullimin shpirtëror; gjithsesi nuk më ka rënë në mendje të mendoj për problemin në nocionet konvencionale religjioze ose, nga ato shkaqe, për çfarëdo nocionesh përgjithësisht. Mospërcaktimi im, të bëhet i drejtë ndaj vetvetes, nuk ka qenë prodhimi im vetjak. Kjo ka qenë mosgjeturit e tërë gjeneratës.

Dhjetëvjeçarët fillestarë të shekullit njëzet kanë qenë në shenjë të vakuimit shpirtëror. Të gjitha vlerat etike në të cilat Evropa me shekuj qe mësuar, u patën bërë amorfe nën goditjen e tmerrshme të asaj që ka ndodhur ndërmjet vitit 1914 dhe 1918, kurse kurrfarë tubimi i ri i vlerave ende nuk ishte askund në horizont. Ndjenja e dhembjes dhe pasigurisë ka qenë në ajër - parandjenja e

kthesave shoqërore dhe materiale që ka nxitur dyshime se a mund ndonjëherë të ekzistojë çfarëdo permanence në mendimet dhe përpjekjet e njeriut. Krejt dukej sikur derdhet në amorfitet, kurse mosrehatia shpirtërore e rinisë nuk ka mundur askund të gjejë mbështetje.

Në mungesë të çfarëdo standardeve të sigurta morale, askush neve, njerëzve të rinj, nuk ka mund të na japë përgjigje të kënaqshme në shumë pyetje që na hutonin. Shkenca ka thënë se dituria është çdo gjë, por ka harruar që dituria, pa cak etik, mund të shpie vetëm në kaos. Reformatorët shoqërorë, revolucionarët, socialistët - të gjithë që dëshiruan të ndërtojnë botën më të mirë e më të lumtur - kanë menduar vetëm në suaza të rrethanave të jashtme, shoqërore dhe ekonomike. Që ta kapërcejnë këtë mungesë, ata e ngritën konceptimin materialist të historisë së vet në nivel të një lloji të ri, të metafizikës antimetafizike. Njerëzit tradicionalisht religjiozë, nga ana tjetër, nuk kanë ditur asgjë më mirë se sa t'i përshkruajnë Zotit të vet vetit të nxjerra nga shprehitë vetjake të mendimit, që tashmë ka herë është bërë e vrazhdë dhe absurde, e kur ne, njerëzit e ri, kemi parë se këto cilësi gjoja hyjnore shpesh kanë qenë në kundërshti të rreptë me atë çka ka ndodhur në botën rreth nesh, i kemi thënë vetvetes: "Fuqitë lëvizëse të fatit qartë janë tjetërfare nga cilësitë që i përshkruhen Zotit, për këtë shkak - nuk ka Zot". Vetëm disave prej nesh u ka rënë në mend se shkaku i tërë kësaj rrëmuje mbase ka mund të qëndrojë në autokracinë e ruajtësve të fesë të cilët veten e kanë konsideruar të virtytshëm dhe i dhanë vetes të drejtë ta mbrojnë Zotin dhe, duke u veshur me uniformën e vet, e kanë ndarë nga njeriu dhe fati i tij.

Te ndonjë personalitet ky labilitet etik ka mund të shpie ose në kaosin e plotë moral dhe cinizëm ose në

kërkim të kreatives, me qasje personale asaj që do të mund të paraqiste jetë të mirë.

Të kuptuarit instinktiv të kësaj ka mundur indirekt të jetë shkak për zgjedhjen time të historisë së artit, si lëndë kryesore në universitet. Funkzioni i vërtetë i artit, kam parandier, edhe është të krijojë vizionin e fotografisë së harmonishme, unike e cila duhet të jetë në themel të fotografive fragmentare të ndodhive që na zbulon vetëdija jonë, dhe të cilat, më dukej, mund të jenë në mënyrën jopërkatëse të shprehura me mendimet konceptuale. Mirëpo ligjëratat në të cilat kam asistuar nuk më kënaqën. Profesorët e mi - disa prej tyre, si Strzytowski dhe Dvorzhaku, autoritativë në fushat e veta të studimeve - dukeshin më shumë të preokupuar me gjetjen e ligjeve estetike që dominojnë në krijimin artistik se sa me zbulimin e impulseve të tij më të thella: me fjalë të tjera, qasja e tyre artit ka qenë, sipas mendimit tim, tepër ngushtë e kufizuar në pyetjen e formave në të cilat ai manifestohet.

Përfundimet e psikoanalizës, të cilën e kam njohur në ato ditë të konfuzionit rinor, më kanë lënë, edhe pse nga shkaqet tjera, të pakënaqur. Pa dyshim, psikoanaliza në atë kohë ka qenë revolucion intelektual i rendit të parë dhe kemi qenë krejtësisht të sigurt se hapja e gjerë ndaj këtyre dyerve të reja deri tash të harruara të njohjes, duhet të ketë ndikim të thellë - e mbase edhe tërësisht ta ndërrojë - mendimin e njeriut për vetveten dhe shoqërinë e tij. Zbulimi i rolit që e luajnë instinktet e pavetëdijshme në formësimin e personalitetit të njeriut ka hapa, pa kurrfarë dyshimi, rrugët drejt të vetëkuptuarit më të thellë se që na kanë ofruar teoritë psikologjike të kohëve më të hershme. Tërë këtë kam qenë i gatshëm ta pranoj. Në realitet, nxitja e ideve frejdiane ka qenë po aq dehëse për frymën time të re sa edhe vera e fortë, dhe shumë net kam kaluar në kafenetë vjenase duke dëgjuar

diskutime mallëngjyese ndërmjet disave nga pionierët e rinj të psikoanalizës sikur që është Alfred Adleri, Hermann Steckli dhe Otto Grossi. Por, derisa vërtet nuk kam kontestuar vlefshmërinë e parimeve të saj analitike, kam qenë i shqetësuar me arrogancën intelektuale të shkencës së re, që ka tentuar t'i reduktojë të gjitha fshehtësitë e Unit të njeriut në vargun e reaksioneve neurogjenetike. Përfundimet filozofike deri te të cilat kanë ardhë themeluesit dhe ithtarët e saj janë dukur disi tepër të përshtatshme, të vetvetëdijshme dhe të thjeshtësuara që të mund të jenë madje edhe afër të vërtetave përfundimtare, e ata vërtet nuk kanë dëftuar në kurrfarë rruge të re drejt jetës më të mirë.

Ndonëse problemet e tilla shpesh e kanë preokupuar shpirtin tim, në realitet, nuk më kanë penguar. Kurrë nuk kam anuar tepër drejt përkopjeve metafizike dhe gjurmimit të vetëdijshëm për të vërtetat abstrakte. Interesimi im ka qenë më tepër në drejtim të gjërave që shihen dhe ndjehen: njerëzit, aktiviteti dhe marrëdhëniet. Pikërisht atëherë kam filluar t'i zbuloj raportet me femrat.

Në procesin e përgjithshëm të shkatërrimit të traditave standarde shoqërore, që pasoi pas luftës botërore, shumë kufizime ndërmjet meshkujve dhe femrave janë këputur. Ajo që ka ndodhur ka qenë, mendoj, jo aq rebelim i rreptësisë së tepruar të shekullit nëntëmbëdhjetë, sa ikje pasive nga gjendja e gjërave në të cilën disa standarde morale janë konsideruar të përhershme e të pakontestueshme në kushtet shoqërore në të cilat çdo gjë që kontestuar: lëkundja lavjerëse prej besimit të mbrëmshëm ngushëllues në mosndërprejjen e ngjitjes së njeriut deri te dëshpërimi i hidhur i Shpenglerit, deri te relativizmi moral i Niçes dhe deri te nihilizmi shpirtëror që e ka nxitur psikoanaliza. Duke shikuar mbrapa në ato vitet e hershme të pasluftës, ndiej se njerëzit e rinj dhe femrat që kanë folur dhe shkruar me aq shumë entuziazëm për

lirinë e trupit, kanë qenë vërtet mjaft larg nga fryma përvëluese e Panit të cilin aq shpesh e kanë ftuar: entuziazmet e tyre kanë qenë tepër të vetvetëdijshme që të jenë luksoze, kurse tepër mendjelehtë që të jenë revolucionare. Marrëdhëniet e tyre seksuale kanë pasur, në rregull, njëfarë karakteri të rastit - njëfarë butësie të menduar mirë që shpesh ka shpënë deri te promiskuiteti.

Madje nëse edhe jam ndier i lidhur me të mbeturat e moralitetit konvencional, do të ishte jashtëzakonisht rëndë të mos tërhiqesh me rrjedhën e përgjithshme që është bërë ashtu e shtrirë. Si qëndronin gjërat, unë më me dëshirë jam mburrur, si shumë të tjerë nga gjenerata ime, me atë që konsiderohej rebelim kundër konvencioneve boshe. Gleri lehtë ka kaluar në marrëdhënie më të afërta, kurse ato në epshe. Nuk mendoj, ndërkaq, se kam qenë i shfrenuar, sepse në të gjitha ato dashuritë e mia rinore, sado që të jenë sipërfaqësore dhe afatshkurtëra, ka qenë gjithnjë theks i shpresës, të paqartë por të qëndrueshme, që ai izolim i tmerrshëm, që aq qartë e ka ndarë njeriun prej njeriut, të mund të thyhet me bashkimin e mashkullit dhe femrës.

Jorehatia ime është rritur dhe për mua bëhej gjithnjë e më rëndë që t'i përcjell studimet e mia universitare. Përfundimisht kam vendosur që përgjithnjë t'i lëshoj dhe ta provoj fatin tim në zhurnalizëm. Babai im, sigurisht me më shumë arsytim se sa që atëherë kam qenë i vullnetshëm të pranoj, rrept ka kundërshtuar veprimin e tillë, duke konsideruar se duhet t'i dëshmoj vetvetes se mund të shkruaj; "kurse, sidoqoftë", ka përfunduar pas njërit prej diskutimeve tona të rrepta, "titulli i doktorit të filozofisë ende kurrë nuk e ka penguar cilindo të bëhet autor i suksesshëm". Rezonimi i tij ka qenë i shëndoshë, por unë kam qenë mjaft i ri, plot shpresë dhe mjaft i parahatshëm. Kur kam kuptuar se ai nuk do ta ndërrojë

mendimin e vet, dukej se nuk ka zgjidhje tjetër pos ta filloj jetën time të mëvetshme. Duke mos i folur askujt për qëllimet e mia, u përshëndeta me Vjenën, një ditë vere të vitit 1920 dhe u nisa për në Pragë.

Çdo gjë që kam pasur, përveç gjërave të mia personale, ka qenë unaza prej diamanti që ma ka lënë nëna, e cila kishte vdekur një vit më parë. E kam shitur nëpërmjet një kamerieri në kafenenë kryesore literare pragjane. Është e sigurt se në këtë transaksion themelësisht më kanë plaçkitur, por shuma e parave që e mora më dukej si pasuri. Me këtë pasuri në xhep vazhdova në Berlin, ku disa miq vjenas më futën në rrethin magjik të letrarëve dhe artistëve në Cafe des Westens të vjetër.

E kam ditur se prej tash do të duhet më tej që të gjendem vetë pa ndihmën e askujt, më kurrë nuk do të pres as pranoj ndihmë financiare prej familjes sime. Disa javë më vonë, kur u ul zemërimi i babait tim, ai më ka shkruar: "Tashmë mund të shoh se si një ditë do të mbarosh si kopuk në hendek pranë rrugës". Iu përgjigja atij: "Nuk ka pranë rrugës hendek për mua - do të notoj në sipërfaqe". Si do të notoj në sipërfaqe fare nuk e kam pasur të qartë, por e kam ditur se dua të shkruaj dhe kam qenë, natyrisht, i bindur që bota literare pret në mua me duar të hapura.

Pas disa muajve paratë e mia të gatshme u shterën dhe kam filluar të shoh për ndonjë punë. Për njeriun e ri me aspirata zhurnaliste, një nga gazetat e mëdha ditore do të ishte zgjidhje e qartë, por kam konstatuar se unë nuk kam qenë zgjidhje për ta. Këtë nuk e konstatova menjëherë. M'u deshën javë të brezhjeve të lodhshme trotuareve të Berlinit - sepse madje edhe pagesa e hekurdhës nëntokësore ose tramvajit tashmë u pat bërë problem - dhe numër të madh të intervistave nënçmuese me kryeredaktorët, redaktorët e lajmeve dhe ndihmësit e redaktorëve, të kuptoj që, duke e përjashtuar çudinë,

sqepverdhi pa asnjë rresht të botuar dhe përvojës vetjake nuk ka kurrfarë gjase t'i afrohet mbretërisë shuguruese të gazetave. Kurrfarë çudie nuk më erdhi në ndihmë. Në vend të kësaj, e njoha urinë dhe i kalova disa javë duke u mbajtur pothuaj vetëm me çaj dhe dy kiflet që në mëngjes m'i shërbente zonja ime. Miqtë e mi letrarë në Cafe des Westens nuk kanë mund të bëjnë shumë për të paditurin dhe të papërvojën "i cili do të dëshironte të bëhet diç", përndryshe, shumica e tyre kanë jetuar në rrethanat jo shumë tjetërfare prej të miave, duke jetuar prej sot deri nesër në skaj të shkatërrimit dhe vështirë duke luf-tuar për mbajtjen e jetës. Herë - herë, në hovin e bollëkut të shkaktuar me pranimin e fatshëm të artikullit ose fotografisë së shitur, ndonjëri prej tyre organizonte gosti me birrë e virshle dhe më ftonte të kënaqem në bujarinë e papritur; ose ndonjë snob i pasur e ftonte grupin tonë, endacakët e çuditshëm intelektualë të darkonim në bane-sën e tij, e shikonte në ne me respekt-frikë derisa ne hedhnim në lukthet tona të zbrazëta havjar canapes dhe shampanjë, duke e shpërblyer bujarinë e shtëpiakut tonë me oratori inteligjente dhe me shikim në jetën boeme. Rregulli i ditëve të mia ka qenë uria e vrazhdë - netët më ishin të përmbushura me ëndrra për copat e prera të mi-shit, suxhukë dhe rriskat e trasha të bukës të lyera me gjalpë. Disa herë kam rënë në sprovë t'i shkruaj babait e t'i lutem për ndihmë, që ai pa dyshim nuk do të refuzonte por çdoherë dilte krenaria ime dhe në vend të kësaj i shkruaja për punën e shkëlqyeshme dhe rrogën e mirë që e kam...

Më në fund erdhi kthesa fatlume. Qesh prezentuar te F. M. Murnau, që pikërisht atëherë ishte ngritur në famë si regjisor filmi (kjo ishte disa vjet para se Holivudi ta tërhiqte te fama edhe më e madhe dhe deri te vdekja e parakoshme, tragjike). Murnau, me atë impulsivitetin te-kanjor që e bënte të dashur te të gjithë miqtë e tij, me-

njëherë u entuziazmua me njeriun e ri të ballafaquar me fatkeqësi, që ka shikuar me aq dëshirë dhe me aq shumë shpresa drejt ardhmërisë. Më ka pyetur se a dëshiroj të punoj me të në filmin e ri që pikërisht synon ta fillojë. Edhe pse puna është dashur të jetë vetëm e përkohshme, kam parë se si para meje po hapen dyert e qiejve kur bëlbëzova: "Po, do të dëshiroja..."

Gjatë dy muajve të lavdishëm, i liruar nga të gjitha brengat financiare dhe plotësisht i preokupuar me shumësinë e përvojave të shkëlqyeshme tjetërfare prej çdo gjëje që kurdoherë kam ditur, kam punuar si ndihmës i Murnaut. Vetëbesimi im u rrit pakufishëm; ai pa dyshim nuk u zvogëlua nga fakti që zonja kryesore në film - artistja mirë e njohur dhe shumë e bukur - nuk tregoi simpati ndaj të flertuarit me ndihmësin e ri të regjisorit. Kur filmi u mbarua dhe Murnau duhej të shkonte jashtë shtetit në detyrë të re, u përshëndeta me të me bindje se ditët e mia më të këqija kanë kaluar.

Së shpejti pas kësaj, miku im i ngushtë Anton Kuh - gazetar vjenas i cili para do kohësh qe dalluar në Berlin si kritik teatri - më ftoi të bashkëpunoj me të në skenarin filmik shkruarja e të cilit i qe besuar. E pranova idenë me mallëngjim dhe mendoj se kam dhënë mjaft angazhim në dorëshkrim; sidoqoftë, producenti që e pat porositur me kënaqësi e pagoi sasinë e kontraktuar, që Antoni dhe unë e ndamë në pjesë të barabarta. Që ta festojmë "hyrjen tonë në botën e filmit", kemi organizuar ndejë në njërin prej restoranteve më të mira në Berlin; kur e morëm llogarinë, konstatuam se praktikisht tërë fitimi ynë ka shkuar në langustë, havjarë dhe vera franceze. Por fati ynë ka zgjatur. Menjëherë kemi filluar të shkruajmë skenarin tjetër - fantazinë e thurur rreth figurës së Balzakut dhe përjetimit të tij të çuditshëm, plotësisht të imagjinuar - dhe gjetëm blerësin pikërisht atë ditë kur

skenari ishte i gatshëm. Këtë herë, ndërkaq, refuzova të kremtojmë suksesin tonë dhe në vend të kësaj kam shkuar në pushim disajavor në liqe në Bavari.

Edhe pas një viti plot ngritje e rënie aventuriere në qytetet e ndryshme të Evropës Qendrore, të përmbushur me çdo lloj të punëve afatshkurtëra, më në fund arrita të depërtoj në botën e zhurnalizmit.

Këtë depërtim e sendërtova në vjeshtë të vitit 1921, pas edhe një periudhe të krizës materiale. Një pasdite, derisa isha i ulur në Cafe des Westens, i lodhur dhe i dëshpëruar, një mik u ul pranë tavolinës sime. Kur ia prezentova vështërsitë e mia, ai më propozoi:

"Do të mund të ketë ndonjë shans për ty. Dammerti e fillon agjencinë e tij në bashkëpunim me United Pressin nga Amerika. Do të quhet United Telegraph. Jam i sigurt se do t'i nevojitet numër i madh i botuesve ndihmës. Nëse dëshiron, do të të prezentoj".

Dr. Dammerti ka qenë personalitet mirë i njohur në qarqet politike berlinase në vitet njëzet. I dalluar në radhët e Partisë katolike të qendrës, i pasur dhe i pavarur, gëzonte autoritet të jashtëzakonshëm; ideja të punoj tek ai më tërhoqi.

Ditën vijuese miku im më solli deri te zyra e dr. Dammertit. Elegant, njeri i moshës mesatare ishte i njerëzishëm dhe miqësor kur na ofroi të ulemi:

"Z. Fingali" (ky ishte emri i mikut tim) "më ka folur për ju. A keni punuar ndonjëherë më parë si gazetar?"

"Jo, zotëri", - u përgjigja, - "por kam shumë përvojë tjetër. Unë jam një lloj eksperti për vendet e Evropës Lindore dhe i njoh disa gjuhë." (Në realitet, gjuha e vetme e Evropës Lindore që kam mundur ta flasë ka qenë polonishtja, kurse kam pasur vetëm idenë e paqartë për atë që po ndodh në atë pjesë të botës, por kam qenë i

vendosur që mos të lejoj që shansi të më priset me modestinë time të tepëruar).

"Ah, kjo është interesant"; - vërejtje dr. Dammerti me buzëqeshje. - "Unë kam shije për ekspertët. Por, për fat të keq, nuk mund pikërisht tash ta shfrytëzoj ekspertin për punët e Evropës Lindore".

Është dashur ta ketë parë dëshpërimin në fytyrën time sepse menjëherë ka vazhduar: "Megjithatë, do të mundesha të kem për ju diç për fillim - edhe pse kjo do të mund të ishte diç nën aftësitë e juaja, mendoj..."

"E çka do të ishte fillimi, zotëri?" - kam menduar me dëshirë duke menduar për qiranë time të papaguar.

"Po... më duhen edhe disa telefonistë... Ah, jo, jo, jo, mos u brengosni, jo në centralin telefonik, mendoj në telefonistët që i përcjellin lajmet e gazetave provinciale..."

Kjo vërtet ishte shkatërrim nga lartësia e shpresave të mia. E shikoja Dammertin, kurse ai më shikonte mua. Kur vërejtja shtrëngimin e rrudhave të të qeshurit rreth syve të tij, e kam ditur se loja ime lavdëruese ka mbaruar.

"E pranoj, zotëri", - u përgjigja duke marrë frymë e duke u buzëqeshur.

Javën vijuese fillova të punoj punën time të re. Nga ishte punë e bezdisshme, larg nga karriera zhurnaliste për të cilën kam ëndërruar. Tërë puna ime përbëhej në të përcjellurit me telefon, disa herë në ditë, të lajmeve nga fletat e shumëzuara të shumë gazetave provinciale që ishin të parapaguara në shërbimin e tillë; por unë kam qenë telefonist i mirë, kurse edhe rroga ka qenë e mirë.

Kjo zgjati rreth një muaj ditë. Kah fundi i muajit rasti i paparashikuar m'u ofrua vetvetiu.

Në vitin 1921 Bashkimi Sovjetik qe goditur me uri të përmasave të papara. Miliona njerëz vuanin prej urisë, kurse qindra e mijëra prej tyre vdisnin. Tërë shtypi evropian ishte përplot përshkrime tmerruese të situatës; qenë

planifikuar disa aksione të huaja për ndihmë, ndër ta edhe një prej Herbert Hooverit, i cili pat bërë shumë për Evropën Qendrore pas luftës botërore. Aksionin e përmasave të mëdha në Rusi e ka udhëhequr Maksim Gorki; thirrjet e tij dramatike për ndihmë e kanë tronditur tërë botën; kishte fjalë se gruaja e tij së shpejti do t'i vizitojë qytetet kryesore të Evropës Qendrore e Perëndimore, me tentim që ta mobilizojë opinionin për ndihmë më efikase.

Pasi kam qenë vetëm telefonist, drejtpërsëdrejti nuk kam marrë pjesë në mbulimin e këtij episodi senzacional, derisa vërejtja e një të njohuri tim të rastit (të tillë kam pasur shumë në vendet më të çuditshme) nuk më tërhoqi në vetë qendrën e saj. I njohuri ishte portier i natës në hotelin Esplanadi, njërin prej më elegantëve në Berlin, kurse vërejtja ishte: "Kjo zonja Gorki është mjaft damë e këndshme, kurrë s'do të thuhej se është bolshevi-ke..."

"Zonja Gorki? Po ku, pashë Zotin, atë e keni parë?"

Informatori im e uli zërin deri në pëshpëritje: "Është vendosur në hotelin tonë. Ka ardhur dje, por është regjistruar me emër kamuflues. Vetëm drejtori e di kush është ajo vërtet. Nuk dëshiron që ta bezdisin reporterët."

"E si e dini ju këtë?"

"Ne portierët dimë çdo gjë që ndodh në hotel", - u përgjigj ai duke i ngërdhesh dhëmbët. - "A mendoni se do të mund ta ruanim punën tonë gjatë kohë si kur mos të dinim?"

Çfarë tregimi ky do të ishte të marr intervistë ekskluzive me zonjën Gorki - aq më tepër që asnjë fjalë për praninë e saj në Berlin ende nuk pat depërtuar në shtyp... Përnjehërë flakërova.

"A do të ma mundësonit", - e pyeta mikun tim, - "disi që ta shoh?"

"Po, nuk e di... Ajo qartë është e vendosur që të mbetet e mbrojtur prej opinionit... Por do të mund ta bëja atë, nëse do të jeni para mbrëmjes në hajat, do të mundesha t'ua tregoj".

Kjo ishte përgjigjja. Nxitova në zyrën time në United Telegraph; pothuaj të gjithë tashmë kishin shkuar në shtëpi në atë kohë, por, për fat, redaktori i lajmeve të reja ende ishte në tavolinën e vet të punës. E mbajta.

"A dëshironi të ma jepni legjitimacionin e gazetarit nëse premtoj të sjell tregim senzacional?"

"Çfarë lloj tregimi?" - pyeste me dyshim.

"Ma jepni legjitimacionin, kurse unë do t'ua jap tregimin. Nëse nuk e sjell, ende mund ta merrni legjitimacionin tuaj".

Më në fund horri i vjetër gazetaresk pranoi, kurse unë nxitova nga zyreja si poseduesi i krenosur i legjitimacionit, i cili më përcakton si përfaqësues të United Telegraphit.

Disa orë vijuese kam kaluar në hajatin e Esplanadës. Në ora nëntë miku im arrin në detyrë. Ma shkeli syrin nga dyert hyrëse, u zhduk pas pulit për recepcion dhe përsëri u shfaq pas disa minutave me lajmin se zonja Gorki është jashtë.

"Nëse aty do të ulemi gjatë kohë, sigurisht do ta shihni kur të kthehet".

Rreth orës njëmbëdhjetë e vërejta sinjalin e mikut tim. Vjedhazi më dëftoi në një zonjë që sapo hynte në dyert lëvizëse: e vogël, grua e rafinuar e viteve të dyzeta, e veshur në fustanin e zi jashtëzakonisht bukur të qepur, me gujën e gjatë të zezë të mëndafshtë që tërhiqej nëpër dysheme pas saj. Qëndrimi i saj ishte aq mirëfilltë aristokrat saqë ishte vërtet vështirë të mendohet si grua e poetit të punëtorëve, e edhe më vështirë si qytetar të Bashkimit Sovjetik. Duke i dalë përpara, u përkula dhe iu drejtova me ton sa më të këndshëm: "zonja Gorki..."

Vetëm në çast u duk e mahnitur, por menjëherë qeshja e butë i shndëriti sytë e saj të bukur, të zi dhe ajo u përgjigj në gjermanishte që kishte gjurma të dobëta të theksin sllaven: "Unë nuk jam zonja Gorki... ju po gaboni - emri im është kështu e kështu" (duke e thënë një emër rus që e kam harruar).

"Jo, zonja Gorki", - qëndrova, - "e di se nuk po gaboj. Po ashtu e di se nuk dëshironi që reporterët t'ju shqetësojnë - por do të thoshte shumë, tepër shumë për mua nëse më lejoni që me ju të flas disa minuta. Ky është rasti im i parë që të konfirmohem. Jam i sigurt se nuk do të dëshironit që këtë rast ta shkatërronit...?" Ia tregova legjitimacionin tim të gazetarisë. "E kam marrë vetëm sot, kurse duhet ta kthej nëse nuk përgatis intervistë me zonjën Gorki".

Zonja aristokrate edhe më tej buzëqeshje. "E nëse do t'ua jepja fjalën e nderit se unë nuk jam zonja Gorki, a do të më besonit atëherë?"

"Nëse do të më thonit çkado në fjalën tuaj të nderit, unë këtë do ta besoja".

Ajo shpërtheu së qeshuri. "Ju, duket, jeni djalosh i këndshëm". (Koka e saj e përshtatshme mezi arrinte deri te supet e mia). "Nuk do t'u gënjej më tej. Fituat. Por nuk mund ta kalojmë pjesën tjetër të mbrëmjes këtu në hajat. A do të ma plotësonit dëshirën dhe të pini çaj me mua në apartmentin tim?"

Dhe kështu pata kënaqësinë të pij çaj me zonjën Gorki në apartmentin e saj. Gjatë gati një ore ajo gjallërisht i përshkroi tmerret e urisë, e kur u ndava prej saj pas mesnatës, e kam pasur fletoren plotë shënime.

Ndihmësit e redaktorit në shërbimin e natës në United Telegraph u shtangën kur më panë në atë kohë të pazakonshme. Nuk u përpoqa të shpjegoj sepse kam pasur të kryej punë të ngutshme. Duke e shkruar intervis-

tën time sa më shpejt që kam mundur, kam lajmëruar, duke mos pritur pëlqimin e redaktorit, thirrjet urgjente të gjithë gazetarëve që i kemi shërbyer me informata.

Mëngjesi i ardhëm ishte shpërthim. Derisa asnjë prej ditarëve të mëdhenj të Berlinit nuk e kishte madje as lajmin për qëndrimin e zonjës Gorki në qytet, të gjitha gazetatat provinciale që i furnizon agjencia jonë kanë pasur në faqet e para intervistën ekskluzive me zonjën Gorki nga përfaqësuesi special i United Telegraphit. Telefonisti ka përgatitur lajm të klasit të parë.

Atë pasdite është mbajtur mbledhja e redaktorëve në zyrën e Dammertit. Qesh ftuar dhe, pas qortimit hyrës në të cilin më është sqaruar se kurrfarë lajmi me rëndësi nuk guxon të dërgohet pa pëlqimin paraprak të redaktorit të lajmeve, u njoftova se jam avancuar për reporter.

Më në fund kam qenë gazetar.

#### - 4 -

Hapat e butë në rërë: ky është Zejdi që kthehet nga pusi me rrëshekën plot. Ajo pëlçiti kur ai e lëshoi në tokë pranë zjarrit, kurse ai filloi përgatitjen e darkës sonë: oriz dhe mish qengji të ri që e ka blerë para mbrëmjes në fshat. Pas përzierjes së fundit me goruzhdë, ai më drejtohet:

"A do të hash tash, dajo?"- dhe pa pritje në përgjigjen time, që, ai këtë e di, mund të jetë vetëm pohuese, e vuri përmbajtjen e tenxheres në enën e madhe, e vuri pranë meje dhe më solli një prej legenëve tanë prej bakri, të mbushur me ujë t'i lajë duart.

"Bismi'l-lahi dhe Allahu na ruajt"

Iu sulëm gjellës, duke ndenjtur ulur me këmbë të kryquara njëri përballë tjetrit, duke ngrënë me gishta të dorës së djathtë.

Hamë në heshtje. Asnjëri prej nesh kurrë nuk ka qenë aq llafazan. Përveç kësaj, disi jam futur në kënaqësinë e kujtesës, duke menduar për kohën që ka kaluar para se sa të vijë në Arabi, madje më herët se që e kam takuar Zejdin, ashtu që nuk mund të flas zëshëm; flas vetëm lehtë në vete dhe vetvetes, duke ndier disponim të tanishmërisë sime nëpër shumë disponime të të kaluarës sime.

Pas ushqimit, derisa jam ulur në shalën time, duke luajtur me gishta me rërën dhe duke shikuar në yjet e qetë arabë, mendoj se si do të ishte mirë ta kesh dikënd pranë vetes me të cilin do të mund të bisedosh për çdo gjë që më ka ndodhur në ato vitet e largëta. Por s'e kam kënd pos Zejdit. Ai është njeri i mirë dhe i ndershëm dhe është bashkudhëtar imi gjatë shumë ditëve të vetmisë; ai është inteligjent, i ndieshëm në vrojtim dhe mirë i udhëzuar në veprimet e meshkujve. Por, derisa e shikoj nga ana fytyrën e tij - atë fytyrë me vija të rrepta të kornizuar me flokë të gjata, tash i përkulur me thellim serioz mbi enën për kafe, tash i kthyer drejt deveve të cilat pushojnë në tokë pranë nesh dhe qetësisht jetojnë - e di se më duhet dëgjues krejtësisht tjetër: i atillë që jo vetëm që nuk ka marrë pjesë në atë të kaluarën time të hershme, por ai që po ashtu do të ishte larg nga shikimi, aroma dhe zëri i ditëve dhe netëve të sotshme: i atillë para të cilit do të mund t'i zgjidh nyjet e kujtesës sime një nga një, ashtu që sytë e tij të mund t'i shohin, a edhe të mitë sërish, dhe i cili kështu do të më ndihmonte ta kap jetën time në rrjetin e fjalëve të mia.

Por s'ka askush pos Zejdit. Kurse Zejdi është tanishmëri.

### III. Erërat

- 1 -

Udhëtojmë, udhëtojmë, ne të dytë hipur në dy deve dhe mëngjesi tashmë po na largohet.

"E çuditshme është kjo, mjaft e çuditshme", - zëri i Zejdit e ndërpreu qetësinë.

"Ç'është e çuditshme, Zejd?"

"A nuk është e çuditshme, dajo, që vetëm para disa ditësh kemi ecur në drejtim të Tajmes, kurse tash kokat e deveve tona janë të kthyera drejt Mekës? Jam i sigurt, këtë as vetë nuk e ke ditur para asaj nate. Ti je i çuditshëm si beduin... sikur edhe unë vetë. A ishte ai xhind, dajo, që më shtyri në atë vendim të papritur, para katër viteve, të vijë te ti në Mekë - dhe të shtyri tash ty të shkosh në Mekë? A lejojmë ne veten ashtu që të na bartin erërat, për shkak se nuk dimë ç'po dëshirojmë?"

"Jo, Zejd - ti dhe unë, ne lejojmë që erërat të na ndjekin për arsye se ne vërtet dimë ç'po dëshirojmë: zemrat tona këtë e dinë, madje edhe nëse mendimet tona nganjëherë janë të ngadalshme që këtë ta ndjekin - por në fund ato megjithatë i arrijnë zemrat tona dhe atëherë ne mendojmë se kemi marrë vendimin..."

Ndoshta kjo zemra ime e ka ditur madje edhe atë ditë para dhjetë vjetësh kur qëndroja në kuvertë të anijes që më barte në udhëtimin tim të parë në Lindjen e Afërt,

drejt jugut nëpër Detin e Zi, nëpërmjet territ të mjerimit, netët e pafund të mjegullta, nëpër mëngjesin e mjegullt, drejt Bosforit. Deti ishte i zi hekur, nganjëherë shkuma e stërpikte kuvertën, goditjet e makinave ishin sikur të rrahurit e zemrës.

Kam qëndruar pranë rrethojës duke shikuar në terrin e zbehtë. Nëse do t'më pyetnit çkam menduar atëherë, ose çfarë shpresash në vete kam bartur në këtë aventurë të parë drejt Lindjes, mezi do të isha në gjendje të jap çfarëdo përgjigje të qartë. Kureshtja, mbase: por kjo ishte kureshtja që nuk e ka kuptuar veten e vet tepër seriozisht për arsye se dukej se synon drejt gjërave të rëndësisë jo të konsiderueshme. Mjegulla e parahatisë sime, e cila sikur ka pasur disa lidhje me mjegullën që shtrihej mbi dete, nuk ishte e orientuar drejt vendeve dhe njerëzve të huaj në ditët që vijnë. Fotografitë e ardhmërisë së afërt, qytetet dhe pamjet e panjohura, petkat dhe sjelljet e huaja që duheshin që aq shpejt t'i zbuloheshin shikimit tim, mezi që i preokuponte mendimet e mia. E kam menduar këtë udhëtim si diç të rastit dhe e kam marrë atë, siç ka ndodhur, në ecjen time, si interlud të këndshëm, por megjithatë jo shumë të rëndësishëm. Në atë çast mendimet e mia kanë qenë të penguar e të hutuara me atë që e kam konsideruar preokupim me të kaluarën time.

E kaluara? A kam pasur çfarëdo të kaluare? Kam pasur njëzet e dy vjet... Gjenerata ime - gjenerata e atyre që kanë qenë të lindur në kthesë të shekullit - ka jetuar ndoshta më shpejt se cilado tjetër para saj dhe më dukej sikur po shikoj prapa në rrjedhën e gjatë të kohës. Të gjitha vështirësitë dhe përjetimet e atyre viteve qëndronin para syve të mi, të gjitha ato mallëngjime, përpjekjet dhe dëshpërimet - edhe femrat - edhe vërsuljet e mia të para në jetë... Ato net të pafund nën yje, kur nuk kemi ditur

krejtësisht ç'dëshirojmë dhe kur kemi shëtitur me mikun rrugëve të shkreta, duke folur për gjërat e mëdha kurse krejtësisht duke e harruar se si xhepat na janë të zbrazur dhe se si është e pasigurt dita që vjen... Pakënaqësia e lumtur që vetëm rinia mund ta ndiejë dhe dëshira që të ndërrohet bota dhe të ndërtohet rishtazi... Si duhet bashkësia të jetë e formësuar që njerëzit të mund të jetojnë drejt dhe në bollëk? Si duhet të jenë të rregulluara marrëdhëniet e tyre që ata të mund ta thyejnë vetminë që e rrethon çdo njeri, dhe njëmend të jetojë në bashkësi? Ç'është e mirë, e ç'është e keqe? Ç'është fati? Ose, e shprehur tjetërfare: ç'duhet punuar që të bëhemi njëmend, e jo vetëm në mënyrë iluzore, identikë me jetën tonë ashtu që të mund të themi: "Unë dhe fati im jemi një?" Diskutimet që kurrë nuk morën fund... kafenetë literare në Vjenë dhe Berlin me diskutimet e veta të pafund për formën, stilin dhe shprehjen, për domethënien e lirisë politike, për takimin e mashkullit dhe gruas... Të uritur për të kuptuar e nganjëherë edhe për ushqim... Netët e kaluara në epshe pa kufizim: shtrati i tollovitur në agim, kur mallëngjimi i natës kalonte dhe ngadalë bëhej i përhimtë, i vrazhdë dhe i shkretë. Por kur vinte mëngjesi, harrohej në hirin e agimit dhe përsëri ecej me hapa të hovshëm dhe ndihej se si toka gëzueshëm dridhet nën këmbët tona... Mallëngjimi i librit të ri ose fytyrës së re, kërkimi dhe gjetja e gjysmëpërgjigjeve, e ato çastet e rralla kur bota papritmas, për një çast, duket se është ndalur, i shndritur me shkëlqimin e të kuptuarit që premtion të zbulojë diç që kurrë nuk është prekur, përgjigjen në të gjitha pyetjet.

Këto ishin vite të çuditshme, ata dy dhjetëvjeçarët e parë në Evropën Qendrore. Atmosfera e përgjithshme e pasigurisë shoqërore dhe morale ka nxitur shpresën dëshpëruese që është shprehur në eksperimentet e rëndësi-

shme në muzikë, pikturë dhe teatër, sikur edhe në kërkimin, shpesh hulumtimin revolucionar të morfologjisë së kulturës. Por, dorë për dorë me këtë optimizmin e theksuar, ka shkuar zbrazëtia shpirtërore, relativizmi i paqartë, cinik, i lindur nga pashpresa në rritje në aspekt të ardhmërisë së njeriut.

Përkundër rinisë sime, nuk më ka mbetur e fshehtë që pas katastrofës së luftës botërore gjërat më nuk kanë qenë si duket në botën e lartësuar Evropiane të thyer, të pakënaqur, emocionalisht të tendosur. Hyjnia e saj e vërtetë, e kam parë, nuk ka qenë më e llojit shpirtëror: ajo ishte Komfor. Ka pasur pa dyshim edhe shumë asosh që kanë ndier dhe menduar në mënyrë religjioze dhe bënin përpjekje pikëlluese që t'i pajtojnë besimet e veta morale dhe frymën e qytetërimit të vet, por ata kanë qenë vetëm përjashtim. Evropiani mesatar - qoftë ai demokrat ose komunist, punëtor fizik ose intelektual - duket se ka njohur vetëm një besim pozitiv: adhurimi i përparimit material, besimi se në jetë nuk mund të ketë cak tjetër përveç që vetë kjo jetë vazhdimisht të bëhet më e lehtë apo, si flitej atëherë, "të pavarur prej natyrës". Tempujt e asaj feje kanë qenë fabrikat gjigante, kinematë, laboratorët kimikë, sallat për vallëzim, centralet hidroelektrike; priftërinjtë e saj kanë qenë bankarët, inxhinierët, politikanët, yjet e filmit, statistikanët, udhëheqësit industrialë, asët ajrorë dhe komisarët. Vënia në lojë e etikës ka qenë e qartë në mungesë të përgjithshme të pajtimit për domethënieën e të Mirës dhe të Keqes dhe në nënshtrimin e të gjitha përfundimeve shoqërore dhe ekonomike rregullit të përshtatshmërisë - asaj damës së ngjyrosur nga rruga, të gatshme që t'i jepet kujtdo, në cilëndo kohë, kurdo që është ftuar... Lakmia e pangopur për fuqi dhe kënaqësi domosdo ka çuar deri te thyerja e shoqërisë perëndimore në grupe armiqësore të armatosura

deri në dhëmbë dhe të vendosura ta shkatërrojnë njëra - tjetrën kurdo dhe kudo që interesat e tyre të ndeshen. E në anën kulturore rezultati ka qenë krijimi i tipit të njeriut, moraliteti i të cilit sikur është kufizuar vetëm në çështjen e interesit praktik dhe kriteri më i lartë i së cilës për këtë është çka është e drejtë e çka nuk është sukses material.

Kam parë se si jeta jonë është bërë e pashtjelluar dhe e pafatshme, se si ka pasur pak përbashkësi ndër-mjet njeriut dhe njeriut, përkundër insistimit gati hysterik në përbashkësi dhe nacion; Pasi larg kemi hedhur nga instiktet tona, e sa të ngushtë, sa të mykur janë bërë shpirtrat tanë. Kam parë tërë këtë, por disi kurrë seriozisht nuk më ka rënë në mend - sikur që duket se nuk i ka rënë në mend askujt rreth meje - që përgjigjja, ose së paku përgjigjet e pjesërishme në këto fatkeqësi, mbase do të mund të merren nga përvojat kulturore jashtevropiane. Evropa ka qenë fillim dhe fund i çdo mendimi tonë, madje as zbulimi im i Lao Tsea-s, kur kam qenë shtatëmbëdhjetë vjeç, nuk e ka ndërruar shikimin tim në këtë kuptim.

Ky ka qenë zbulim i vërtetë; kurrë më parë nuk pata dëgjuar për Lao Tsean as që çfarëdo kam mësuar për filozofinë, kur një ditë hasa në përkthimin gjermanisht të Tao-te-kingut në pultin e një librerie vjeneze.

Emri dhe titulli i çuditshëm nxitën tek unë kuresh-tjen mallëngjyese. Duke e hapur librin kuturu, kalimthi shikova një nga kaptinat e tij të shkurtra aforistike dhe ndjeva ngazëllim të papritur, si sulje të fatit, që ka bërë të harroj çdo gjë rreth vetes dhe më ka mbajtur të ngujuar atje ku kam qëndruar, të mallëngjyer, me libër në duar; e kam parë në të jetën njerëzore në tërë kthjelltësinë e vet, pa çfarëdo përçarjesh dhe konfliktesh, duke u ngritur në atë harenë e qetë që gjithnjë i hapet zemrës njerëzore kurdo që ai kujdeset që të shërbehet me lirinë e vet

vetjake... Kjo ishte e vërtetë, e kam ditur këtë: e vërteta që gjithnjë ka qenë e vërtetë, edhe pse e patëm harruar, kurse tash e kam njohur me kënaqësi me të cilën i kthehet shtëpisë kaherë të humbur...

Së andejmi, gjatë disa viteve, Lao Tse për mua ka qenë dritare nëpër të cilën kam mund të shikoj në fushat si kristali të pastra të jetës, e cila është larg prej çdo ngushtësie dhe frike, i lirë nga mania fëmijërore që pandërprerë na detyron që gjithnjë rishtazi ta sigurojmë ekzistencën tonë me anë të përparimit "material" me çdo kusht. Përparimi material nuk më është dukur i gabuar ose madje i panevojshëm; përkundrazi, edhe më tej e kam konsideruar të mirë e të nevojshëm, por në të njëjtën kohë kam qenë i bindur që ai kurrë nuk mund ta arrijë qëllimin e vet - ta rrisë fatin e përgjithshëm njerëzor përveç nëse është përcjellë me riorientimin e qëndrimit tonë shpirtëror dhe me besim të ri në vlerat absolute. Si mund të arrihet riorientimi i tillë dhe i çfarë lloji do të duhej të jetë ky përcaktim i ri i vlerave, nuk e kam pasur plotësisht të qartë. Do të ishte gjithsesi e kotë të pritet se njerëzit do ta ndryshojnë cakun e tyre - dhe në këtë mënyrë edhe orientimin e përpjekjes së vet - posa dikush fillon t'u predikojë, sikur që ka vepruar Lao Tse, se duhet të hapemi ndaj jetës në vend që të tentojmë që ta ndërtojmë për vete dhe kështu t'i bëjmë dhunë. Vetëm predikimi, vetëm ekspozimi intelektual qartë nuk mund të sjellin deri te ndryshimi në qëndrimin shpirtëror të shoqërisë Evropiane; duhej besim i ri i zemrës, dorëzim pasionues vlerave që nuk durojnë kurrfarë nëse as por. E prej nga ta marrim fenë e tillë...?

Kurrsesi nuk më ka ardhë në vetëdije që kjo nxitje e fuqishme e Lao Tseut nuk ka qenë e orientuar vetëm ndaj qëndrimit intelektual kalimtar e për këtë edhe relativ, por ndaj njerëzit prej nocioneve më elementare nga të

cilat qëndrimi mugullon. Sikur këtë ta kisha ditur, do të detyrohesha të përfundoj se Evropa ndoshta as që do të mund ta arrijë atë kthjelltësi të lehtë të shpirtit për të cilën ka folur Lao Tse, nëse nuk do të mblidhte guxim të dyshojë në rrënjët e veta shpirtërore dhe morale. Natyrisht, kam qenë tepër i ri që vetëdijshëm kam ardhur deri te përfundimi i tillë; tepër i ri që ta kuptoj nxitjen e mentarit kinez me gjithë domethënien e tij më të thellë dhe në tërë madhësinë e tij. E vërteta, porosia e tij më së thelli më ka prekur; ma ka zbuluar shikimin në jetë në të cilën njeriu do të mund të bëhej një me fatin e vet dhe kështu me vetveten, por pasi nuk kam parë qartë si filozofia e tillë do të mund ta ngadhënjente përsiatjen e pastër dhe të zbatohet në realitet në tërësi të mënyrës Evropiane të jetës, dalëngadalë kam filluar të dyshoj se a është ajo fare e realizueshme. Ende nuk e pata arritur pikën ku madje do të pyesja veten time se a është mënyra Evropiane e jetës, në bazat e veta, mënyra e vetme e mundur. Me fjalë të tjera, sikur edhe të gjithë të tjerët rreth meje, tërësisht qesh thelluar në pikëpamjen egocentrike kulturore Evropiane.

Dhe kështu, edhe pse zëri i tij kurrë nuk është heshitur krejtësisht, Lao Tse është tërhequr, hap pas hapi, në prapavinë e ëndërrimeve ideore dhe më në fund ka mbetur vetëm bartës i poezisë joshëse. Vazhdova që ta lexoj nganjëherë dhe çdoherë ndieja valën e vizionit të lumtur, por çdoherë e shtyja librin me keqardhje të ndieshme se kjo është thirrje ëndërruese në ndonjë fortesë të fildishtë.

E edhe pse kam qenë fort në konflikt me botën e paharmonizuar, të hidhët, gllabëruese të cilës edhe vetë i kam takuar, megjithatë nuk kam dashur të jetoj në fortesën e fildishtë.

Megjithatë, nuk kam qenë i zjarrtë në asnjë nga ato caqe dhe synime që atëherë kanë rrymuar në atmosferën intelektuale Evropiane dhe kanë mbushur literaturën, ar-

tin dhe politikën e saj me zhurmën e kontesteve të rrepta; sepse, sado që shumica e atyre caqeve dhe synimeve kanë qenë në kundërshti të ndërsjellë, ato qartë kanë pasur një të përbashkët: supozimin naiv se jeta mund të nxirret nga pështjellimi i vet i tanishëm dhe të përmirësohet nëse vetëm kushtet e saj të jashtme-ekonomike dhe politike-përmirësohen. Edhe atëherë qartë kam ndier që përparimi material, vetvetiu, nuk mund të ofrojë zgjidhje, kurrë nuk kam qenë në gjendje ta zbuloj në vete atë mallëngjim që e kanë pasur bashkëkohësit për progres.

Nuk mund të them se kam qenë i pafatshëm. Kurrë nuk kam qenë i futur në vete e pikërisht atëherë, në masë më të madhe se rëndom, kam gëzuar sukses në punët e mia praktike. Ndonëse nuk kam prirje t'i jap shumë rëndësi "karrierës" si të tillë, puna në United Telegraph - ku, duke iu falënderuar njohjes sime të gjuhës, tash kam qenë redaktor i obliguar për shërbimin e lajmeve për shtypin skandinav - dukej se hapë shumë mundësi në botë më të gjerë. Café des Westens dhe trashëgimtari i saj shpirtëror, Romanisches Café - vendtubimi i shkrimtarëve, artistëve, gazetarëve, aktorëve, producentëve më të dalluar të asaj kohe - paraqiste për mua një lloj të shtëpisë. Kam qenë në raporte miqësore, e nganjëherë madje edhe shumë të afërta me njerëzit e emrave të njohur dhe jam konsideruar - së paku në pamje nëse jo sipas autoritetit - njëri prej tyre. Kam pasur miqësi të thella dhe dashuri kaluese. Jeta ka qenë interesante, plot shpresa dhe plot laramani në llojlojshmërinë e përshtypjeve të mia. Jo, unë vërtet nuk kam qenë i pafatshëm - vetëm thellë i hidhëruar, i pakënaqur, duke mos ditur pas çkaje realisht synoj, kurse njëkohësisht i bindur, me egërsinë absurde të rinisë se këtë një ditë do ta di. Kështu kam bredhur poshtë e lart varësisht nga ajo se a e kam pasur zemrën të kënaqur apo jo, pikërisht siç kanë punuar edhe shumë

djelmosha tjerë në ato vite të çuditshme; sepse, ndonëse askush prej nesh nuk ka qenë realisht i pafatshëm, vetëm të rrallët janë dukur se kanë qenë të lumtur me vetëdije.

Nuk kam qenë jo i lumtur, por paaftësia ime të marrë pjesë në shpresat e ndryshme shoqërore, ekonomike dhe politike të atyre rreth meje - janë rritur gjatë kohës në ndjenjë të paqartë që mos t'iu përkas krejtësisht, i përcjellë, përsëri me dëshirën e paqartë t'i përkas - kujt? - të jem pjesë e diçkaje - çkahit?

E atëherë, një ditë, në pranverë të 1922, e pranova shkresën nga daja im Dariani.

Dariani ishte vëllai më i ri i nënës sime. Marrëdhëniet tona gjithnjë kanë qenë më tepër marrëdhënie miqësie se sa të dajës dhe nipit. Ai ka qenë psikiatër - një prej nxënësve të parë të Frojdit - dhe në këtë kohë ka udhëhequr spitalin për sëmundjet shpirtërore në Jerusalem. Pasi ai vetë nuk ka qenë cionist, kurse nuk është pajtuar veçan me caqet e cionizmit - as që, për këtë shkak, u është ofruar arabëve - ndjehej i vetmuar dhe i izoluar në botën që nuk ka pasur çka të ofroj pos punës dhe fitimit. Pasi ka qenë i pamartuar, ka menduar për nipin e vet sikur për shokun e mundshëm në vetminë e vet. Në letrën e vet më ka përkujtuar në ato ditët interesante në Vjenë kur më ka futur në botën e re të psikoanalizës. Ka përfunduar: "Përse nuk vjen dhe nuk qëndron disa muaj me mua këtu? Do ta paguaj biletën kthyesë për udhëtim dhe do të jesh i lirë që të kthehesh në Berlin kurdo që të dëshirosh. Derisa të jesh këtu, do të jetosh në shtëpinë e këndshme, të vjetër arabe prej guri e cila është e freskët verës (kurse djallëzisht e ftohtë dimrit). Do t'i kalojmë ditët miqësisht së bashku. Këtu kam shumë libra, e kur të lodhesh me vështrimin e pamjeve fantastike rreth vetes, mund të lexosh deri në pikë të qejfit..."

Kam marrë vendim pa u hamundur, që gjithnjë i ka karakterizuar veprimet e mia të rëndësishme. Mëngjesin tjetër e njoftova dr. Dammertin në United Telegraph që shkaqet e rëndësishme zyrtare më detyrojnë të shkoj në Lindjen e Afërt dhe se për këtë do të duhet ta lëshoj agjencinë pas shtatë ditësh.

Sikur atëherë dikush të më kishte thënë se njohja ime e parë me botën e Islamit do të shkojë larg përjetimit shëtitës dhe, në realitet, do të bëhet kthesë në jetën time, do ta përqeshja këtë ide si skajshmërisht absurde. Nuk do të mund të thuhet se kam qenë i papërshtatshëm për joshjet e vendeve të lidhura në mendimet e mia - sikur edhe në mendimet e shumicës së Evropianëve - për atmosferën romantike të netëve arabe; unë gjithsesi kam pritur kolorit, tradita ekzotike, takime figurative, por kurrë nuk më ka ra ndër mend të pres përjetime edhe në fushën shpirtërore, kurse udhëtimi i ri nuk dukej se ofron çfarëdo premtimi të veçantë të natyrës personale. Të gjitha mendimet dhe përshtypjet që i kam pasur më herët instinktivisht i kam lidhur me botëkuptimin perëndimor mbi botën, me shpresë se do ta arrij aftësinë e gjerë të të ndierit dhe të kuptuarit në një rreth të një mjedisi kulturor që e kam ditur. E nëse për këtë mendoj, si edhe mund të ndieja tjetërfare? Kam qenë vetëm evropian mjaft, mjaft i ri, i edukuar në bindje se Islami dhe çdo gjë që ai paraqet është vetëm shteg i tërthortë romantik i historisë njerëzore, i cili madje nuk është krejtësisht i përshtatshëm nga pikëpamja shpirtërore dhe morale, prandaj edhe nuk duhet as të përmendet së bashku, e edhe më pak krahasues, me vetëm dy fetë që Perëndimi i konsideron të denja të merren seriozisht: kristianizmin dhe hebraizmin.

Me këtë paragjykim të paqartë evropian ndaj Islamit (edhe pse natyrisht jo sipas pamjes së jashtme të roman-

tizuar të jetës muslimane), jam nisur në verë të 1922 në rrugë. Nëse, të bëhem i drejt ndaj vetvetes, nuk mund të them se kam qenë i preokupuar me vetveten në kuptimin personal, kam qenë megjithatë, duke mos e ditur këtë, thellë i fundosur në atë mendësinë e preokupuar me veten, kulturo - egocentrik, aq karakteristik për Perëndimin në çdo kohë.

Kështu kam qëndruar në kuvertë të anijes në rrugë për në Lindje. Udhëtimi i këndshëm më solli deri në Konstancë, e pastaj në këtë mëngjesin e mjegullt.

Veli i kuq doli nga perdet e mjegullta dhe afrohet plotësisht afër anijes. Pasi u bë e pashme, mund të dihej se dielli së shpejti do ta depërtojë mjegullën. Disa rreze të zbehta, të holla si penjtë, ranë mbi shiun e imtë e të ftohtë përtej detit. Zbehtësia e tij ka pasur diç nga fortësia e metalit. Nën presionin e tij masat qumështore të mjegullës u qetësuan lehtë dhe rëndë mbi ujë, pastaj u copëtuan dhe më në fund u ngritën majtas dhe djathtas nga rrezet diellore, në harqet gjerë të zhvilluara që janë ngritur si krahë.

"Mirëmëngjes". U ktheva dhe e njoha petkun priftëror të përcjellësit nga mbrëmjet e kaluara dhe buzëqeshjen miqësore në fytyrë që më pëlqeu gjatë disa orëve të njohjes sonë. Prifti jezuit ishte gjysmë polonez, gjysmë francez, dhe ka ligjëruar historinë në një kolexh në Aleksandri; tash atje kthehej nga pushimi. Pas hipjes e kaluam natën në bisedë të gjallë. Edhe pse së shpejti u bë e qartë se dallojmë mjaft në shumë përfundime, kishim megjithatë shumë pika me interes të përbashkët, në ndërkohë tashmë isha mjaft i pjekur që të dalloj se këtu po manifestohet frymë e shkëlqyeshme, serioze dhe në të njëjtën kohë e kthjellët.

"Mirëmëngjesi, at Feliks, shikojeni detin..."

Drita ditore dhe ngjyrat dolën me diellin. Qëndronim në pjesën e prapme të anijes nën erën e mëngjesit. I nxitur,

jam përpjekur ta përcaktoj për vetveten lëvizjen e ngjyrës në valë që thyhen. E kaltër? E gjelbër? E përhimtë?

Kjo tek unë ka nxitur gati ndjenjën fizike të shqetësimit që kurrsesi nuk mund ta kuptoj këtë lojë të ngjyrave në ritmin e saj përherë të ndryshueshëm. Nga kjo fatkeqësi, kjo huti çuditërisht mallëngjyese, paraqitet një mendim me qartësi të madhe - ose së paku mua ashtu m'u duk - dhe thashë, gati duke mos dashur:

"Kush do të ishte në gjendje ta përfshijë tërë këtë me shqisat e veta, ai do të ishte në gjendje të sundojë me fatin".

"E di ç'mendoni", - u përgjigj at Feliksi, - "por, përse do të dëshironim të dominojmë me fatin? Që t'i shmangemi durimit? A nuk do të ishte më mirë t'i lirohemi fatit?"

"Ju flitni gati si budist, at Feliks. A e konsideroni edhe ju nirvanën për cak të tërë qenies?" "E, jo, kurrsesi jo... Ne kristianët nuk synojmë fikjen e jetës dhe ndjenjave - ne vetëm dëshirojmë ta ngrisim jetën nga mbretëria materiale e sensuale në shpirtërore".

"Por a nuk është ky abstenim?"

"Ky nuk është abstenim, miku i ri. Kjo është rruga e vetme drejt jetës së vërtetë, kah qetësia..."

Bosfori u hap para nesh, rruga e gjerë ujore e rrethuar nga të dy anët me brigjet gurore. Aty-këty mund të shihen pallatet e tejdukshme në shtylla, kopshtet në tarraca, selvitë që ngrihen në lartësinë e vet të murrme dhe fortesat e vjetra jeniçere; masat e rënda gurore të vëna mbi ujë si çerdhe të zogjve grabitqarë. Sikur nga largësia e madhe, e dëgjoj zërin e at Feliksit se si vazhdon:

"Shihni, simboli më i thellë i mallëngjimit - mallëngjimit të të gjithë njerëzve - është simboli i parajsës; e gjeni në të gjitha religjionet, gjithnjë në paraqitje tjetërfare, por domethënia është gjithnjë e njëjtë - me fjalë të tjera, dëshira që t'i lirohet fatit. Njerëzit e parajsës nuk kanë pasur fat;

ata e kanë marrë vetëm Pasi kanë lëshuar pe para sprovës së trupit dhe kështu kanë rënë në atë që e quajmë mëkati i parë: gjunjëzimi i shpirtit ndaj ndikimeve të trupit, të cilat janë vërtet vetëm mbeturina shtazarake në natyrën njerëzore. Pjesa qenësore, njerëzore, njerëzore-hyjnore e njeriut është vetëm shpirti i tij. Shpirti synon drejt dritës, e cila është frymë (ruh), por për shkak të mëkatit të parë rruga e saj është penguar me pengesa që ngrihen nga përbërja materiale, johyjnore e trupit dhe nevojave të saj. Ajo nga synon mësimi i kristianëve është për këtë lirimi i njeriut nga aspektet jothelbësore, kaluese shqisore të jetës së tij dhe kthimi trashëgimisë së tij shpirtërore".

Shfaqet fortësia e lashtë Rumeli hisar me dy pyrgjet e veta; njëri nga muret e tij me frangji pjerrshëm lëshohej gati në skaj të ujit; në tokë, ndërmjet gjysmërrathëve të formuar me muret e fortësës, qëndrojnë varrezat e vogla ëndërruese turke me nishanet e thyera.

"Kjo mund të jetë ashtu, at Feliks. Por unë ndiej - e këtë e ndiejnë shumë nga gjenerata ime - ndiej se ka diç të gabueshme në dallimin ndërmjet "thelbësore" dhe "jothelbësore" në strukturën e njeriut dhe në ndarjen e shpirtit dhe trupit... shkurtimisht, nuk mund të pajtohem me mohimin tuaj të çdo arsyeshmërie të nevojave fizike, të natyrës njerëzore, fatit të lidhur për tokën. Dëshira ime shkon diku më thellë: unë ëndërroj për formën e jetës - edhe pse duhet të pranoj se këtë ende qartë nuk e shoh - në të cilin njeriu, me shpirt e me trup, do të synonte kah përmbushja gjithnjë thellë e më thellë e Unit të vet - në të cilin shpirti dhe shqisat nuk do të jenë armiq të njëri - tjetrit dhe në të cilin njeriu do të mund të arrinte unitetin në veten e vet dhe me domethënien e fatit të vet, në mënyrë që në fund të ditëve të veta të mund të thotë: "Unë jam fati im".

"Kjo ka qenë ëndërr helene", - u përgjigj at Feliksi, - "e ku shpuri ajo? Së pari deri te misteret orfejase dhe di-oniziasë, pastaj deri te Platoni dhe Plotinusi dhe kështu, përsëri, deri te të kuptuarit e pashmangshëm se shpirti dhe trupi janë në kundërshti me njëri tjetrin... Të lirohet shpirti nga dominimi i trupit: kjo është domethënia e shpëtimit kristian, domethënia e besimit tonë në sakrifikimin vetjak të Hyjit në Kryq..." Ai këtu e ndërpreu dhe m'u kthye mua mprehtësisht duke më shikuar: "Oh, unë nuk jam gjithnjë misionar... më falni nëse ju flas për fenë time, e cila nuk është e juaja..."

"Por unë nuk kam kurrfarë", - e bindsha atë.

"Po", - tha at Feliksi, - "e di, mungesa e fesë, ose thënë më mirë, mosaftësia e besimit, është sëmundja themelore e kohës sonë. Ju, sikur edhe shumë të tjerë, jetoni në mashtrim që është i vjetër mijëra vjet: mashtrimi që vetë arsyeja mund t'i japë orientim synimit të njeriut. Por arsyeja nuk mund ta arrijë vetvetiu njohjen shpirtërore për shkak se ajo është tepër e preokupuar me arritjen e çaqeve materiale; feja, dhe vetëm feja, mund të na çlirojë nga preokupimi i tillë".

"Feja...?" - pyeta. - "Ju sërish e përmendni këtë fjalë. Ka një gjë që nuk e kuptoj: thoni se është e pamundur vetëm me arsye të arrihet deri te njohja dhe jeta e drejtë, thoni, duhet feja. Pajtohem me ju plotësisht. Por si ta arrijmë fenë nëse kurrfarë nuk kemi? A ka çfarëdo rruge deri te ajo - mendoj rrugë të hapur sipas vullnetit tonë?"

"Mik i dashur - vullneti vetë nuk mjafton. Rruga hapet vetëm me mëshirën e Zotit. Por ajo gjithnjë është e hapur për atë kush nga thellësia e shpirtit të tij lutet për iluminim".

"Të lutemi! Por nëse për këtë jemi në gjendje, at Feliks, atëherë do të thotë e kemi fenë. Ju më shpieni në rreth, sepse nëse dikush lutet, ai tashmë duhet të jetë i

bindur në ekzistimin e Atij të cilit po i lutet. Si erdhi ai deri te kjo bindje? Me arsyen e vet? A nuk do të thotë kjo të pranohet se feja mund të arrihet me arsye? E përveç kësaj, a ka çfarëdo domethënie "mëshire" për dikënd që kurrë nuk ka pasur përvojë të tillë?"

Kleriku mblodhi supet me keqardhje, si m'u duk: "Nëse dikush nuk ka qenë në gjendje që ta përjetojë Zotin vetë, ai duhet të lejojë që ta shpiejnë ato që e kanë përjetuar..."

Disa ditë më vonë arritëm në Aleksandri dhe pasditën e njëjtë shkova në Palestinë.

Treni nxitonte drejt sikur shtiza nëpër peizazhin e këndshëm, të lagshhtë të pasditës së Deltës. Kanalet e Nilit, të hijesuar me velat e barkave të shumta transportuese, na patën prerë rrugën. Qytezat, grumbull shtëpish përhimtë të pluhurosura dhe me minare të gjata, vinin e shkonin. Afroheshin fshatrat të përbëra nga kasollet në formë kutishë prej argjilës. Fushat e vjelura të pambukut, fushat e mbira me kallam sheqeri, palmat gjallë të rritura mbi xhaminë e fshatit; buajt, të zi, me gjymtyrë të rëndë, shkojnë tash pa udhëheqës në shtëpi nga kënetat e baltuara nëpër të cilat janë shkërryer gjatë ditës. Në largësi, njerëzit me petka tjera: dukeshin sikur po fluturojnë, aq i ndritshëm e i qartë ishte ajri nën qiellin e lartë, të kaltër, prej xhami. Nëpër brigjet e kanalit ngjyrat shtriheshin prej erës; gratë në gujat e zeza prej ajdësit bartnin ujë në shtambat prej dheu: gra të shkëlqyeshme, shtatgjata, këmbëgjata; në ecjen e tyre më përkujtonin në bimët me trung të gjatë që valëviten ndjeshëm në erë e megjithatë plot fuqi. Vashat e reja dhe gratë e martuara kishin të ecurit e njëjtë valëvitës.

Muzgu binte dhe rrymonte sikur fryma e ndonjë qenie të madhe të gjallë që pushon. Derisa njerëzit shkonin nga fusha në shtëpi, lëvizjet e tyre dukeshin të shtan-

gura dhe në të njëjtën kohë të ngritura nga dita që ngadalë po shkon; çdo hap dukej se ka jetën e vet vetjake, ndërmjet amshimit dhe amshimit gjithnjë ky ai hapi. Kjo pamje e lehtësisë dhe njomësisë ka mundur mbase t'i përshkruhet dritës gazmuese të mbrëmjes së deltës së Nilit - mbase po ashtu jorehatisë sime vetjake gjatë shikimit në aq shumë gjëra të reja - por çkado të jetë shkaku, papritmas ndjeva në vetvete tërë peshën e Evropës, peshën e cakut të qëllimtë në të gjitha aksionet tona. Mendova në vete: "Sa vështirë e kemi ta arrijmë realitetin. Ne gjithnjë përpiqemi ta grabisim, por, ai nuk dëshiron të jetë i grabitur. Vetëm atje ku ai e ngadhënjën njeriun, ai vetë i dorëzohet".

Hapi i bujqve egjiptianë, tashmë të humbur në largësi dhe terr, edhe më tej valëvitej në mendimet e mia si himni i të gjitha gjërave të mëdha.

Erdhëm deri te Kanali i Suezit, u kthëm në kthesë të drejtë dhe një kohë rrëshqitëm drejt veriut përgjatë pendës të përhimtë - të shkretë. Kjo vijë e gjatë e kanalit natën bënte sikur melodi e zvarritur. Drita e hënës e ka shndërruar këtë rrugë ujore në diç ngjasuese në rrugën e gjerë nga ëndrrat, shiritin e errët të metalit të shndritshëm. Toka e ngime e luginës së Nilit me shpejtësi çuditëse ia ka lëshuar vendin vargut të bregoreve ranore që në të dy anët e mbyllin kanalën me zbehtësi dhe rreptësi çfarë rrallë mund të shihen në cilindo peizazh tjetër të natës. Në heshtjen memece qëndronte aty-këtu skeleti i ekskavatorit. Në anën tjetër, në pendën tjetër, u vërsul i hipuri në deve, u largua - mezi mund të shihet dhe tashmë e gëlltiti nata ... Çfarë rrjedhë e madhe, e thjeshtë: prej Detit të Kuq, nëpër liqenin Gorka, deri te Deti Mesdhe - drejt nëpër shkretëtirë - në mënyrë që Oqeani Indian të mund të përplaset në brigjet Evropiane...

Në Kantar udhëtimi për një kohë që ndërprerë dhe trapi i ngadalshëm i kalonte udhëtarët përtej ujit të qetë. Kishte pothuaj edhe një orë të tërë deri në nisje të trenit për Palestinë. Jam ulur para ndërtesës së stacionit. Ajri ishte i ngrohtë dhe i thatë. Shkretëtirë ishte edhe djathtas edhe majtas. E përhimta vezulluese kalonte në terr nëpër të cilin depërtonte lehja e kohëpaskohshme - ndoshta këto kanë qenë çakejtë, ndoshta qentë. Njëfarë beduini, rëndë i ngarkuar me trasta të punuara nga thurjet e qilimave, arriti nga trapi dhe shkoi drejt grupit në largësi, të cilët vetëm tash i kam njohur si njerëz të palëvizshëm dhe deve të ulura, të shaluara e të gatshme për nisje. Dukej se ardhacakun e ri e kanë pritur. Ai i hodhi trastat e tij mbi njëren prej kafshëve, i ndërruan disa fjalë, të gjithë u hipën (deveve) dhe, po atë çast devet u ngritën, së pari në këmbët e mbrame, pastaj në këmbët e para - kalorësit u luhatën para, e prapa - pastaj u nisën me zëra të butë fishkëllues. Edhe një kohë mund të ndiqeshin dritat, trupat luhatës të kafshëve dhe gujat e gjera, ngjyrë gësh-tenje në të bardhë me vija të beduinëve.

Një hekurudhor erdhi deri tek unë. Ishte i tëri në të kaltër dhe dukej i gjymtë. Ai e ndezi cigaren e vet për timen, e pastaj më pyeti me një frëngjishte të keqe:

"Po shkoni në Jerusalem?". Kur u përgjigja pohimisht, ai vazhdon: "Për herë të parë?"

Tunda kokën pohimisht. Sa u nis për të shkuar, kthehet dhe thotë: "A e keni parë atje karvanin e madh nga shkretëtira e Sinajit"... Jo? - Atëherë ejani që t'i vizitjmë. Keni kohë".

Shollat e këmbëve tona krikëlluan në rërë derisa ngjiteshin nëpër zbrazëtinë e qetë në shtegun e ngushtë, mirë të shkelur që shpiente drejt bregoreve ranore. Një qen lehte në terr. Derisa ecnim, duke u penguar për shkurret e vogla therrorë, deri tek unë depërtonin zëra të përzier, të

asfiksuar, sikur vinin prej shumë njerëzve së bashku me aromën e rreptë por të butë të trupave të kafshëve që pëshonin, e përzier me ajrin e thatë shkretinor. Papritmas - pikërisht si mund të shihni në qytet, gjatë kohës së natës së mjegullt, vezullimi i njëfarë llambe deri atëherë të pashme se si shfaqet pas këndit të rrugës dhe ndriçon vetëm mjegullën - pak dritë u shfaq nga poshtë, sikur nga dheu, dhe u ngrit pjerrtas në hapësirën e errët. Ky qe shkëlqimi i zjarrit që vinte nga thellësia e grykës ndërmjet dy ngrehirave ranore, aq dendur i mbuluar me shkurra therrorë sa nuk mund të shihej fundi i tij. Tash kam mundur qartë të dëgjoj zërat e atyre që ende ishin të padukshëm. E dëgjova frymëmarrjen e deveve dhe se si kruhen njëra për tjetrën në hapësirën e ngushtë. Hija e madhe, e zezë njerëzore ra përtej dritës, fluturoi në bregoren e kundërt, e pastaj përsëri u lëshua. Edhe pas disa hapave kam mund këtë krejt ta shoh - rrethi i madh i deveve që gjunjëzohet me grumbuj shalash dhe thasësh kudo përreth, kurse ndër to figurat e njerëzve. Era e kafshëve ishte e mirë dhe e rëndë si vera. Ndonjëherë ndonjë deve e luante trupin e vet dhe humbte tiparet e veta në terr, e çonte qafën dhe e shtrinte në ajrin e natës, duke fërshëlluar sikur po merr frymë; kështu, për herë të parë dëgjoja frymëmarrjen e deveve. Një dele lehtë blegëronte, një qen lehte, kurse kudo jashtë grykës nata ishte e zezë dhe pa yje.

Tashmë ishte vonë, duhej të shkoja prapa në stacion. Lëshohem ngadalë shtegut drejt të cilil kemi ardhur, i hutuar dhe çuditërisht i prekur, si me ndonjë përjetim misterioz që e ka grabitur këndin e zemrës sime dhe nuk më lëshon...

Treni më bartte nëpër shkretëtirën e Sinajit. Isha i rraskapitur, pa gjumë, prej të ftohtit të natës shkretinore dhe lëkundjes së trenit mbi binarë të vënë nëpër rërën e pashtypur. Në anën tjetër pranë meje ishte i ulur një be-

duin në abajën e gjerë gështenje. Edhe ai kishte të ftohtë dhe fytyrën e vet e kishte mbështjellë me mbulesën e kokës. Ishte i ulur këmbëkryq në karrige, e në gjunjë të tij shtrihej shpata në millin e dekoruar me argjend. Mëngjesi ishte afër. Keni mundur pothuaj t'i njihni jashtë trajtat e bregoreve dhe drizat e kaktusëve.

Ende më kujtohet si u gdhi agimi - përhimtë në të zezë duke i skicuar format, ngadal duke i skicuar tiparet - dhe se si shkallërisht nxirrte prej territorit të ngrehirës ranore dhe prej tyre trajtësonte masa të harmonishme. Në gjysmëdritën në rritje u shfaq grupi i tendave dhe soditësve, kurse pranë tyre, terej rrjeta e peshkatarëve, e argjenditë në të murrme, si perde e mjegullt në erë, e gozhduar vertikalisht ndërmjet shtyllave; rrjetat e peshkatarëve në shkretëtirë - duke u valëvitur në erën e mëngjesit - valët e ëndrrave, të tejdukshme, joreale, ndërmjet natës dhe ditës.

Nga ana e djathtë ishte shkretëtira, nga e majta deti. Në breg udhëtari i vetmuar mbi deve; ndoshta ka udhëtuar tërë natën. Tash dukej sikur ka fjetur, i lëshuar në shalë dhe të dytë luhaten, njeriu dhe deveja, në ritëm të përbashkët. Sërish tendat e zeza beduinase. Tashmë ishin jashtë femrat me shtambat prej dheut mbi kokat e veta, të gatshme të shkojnë në pus. Nga muzgu që kalonte në dritë doli bota e tejdukshme, e lëvizshme me impulse të padukshme, çudi e mbrëmjes prej të gjithave për shkak se është e thjeshtë dhe kurrë nuk mund të ketë fund.

Dielli doli përtej rërës me rrezet gjithnjë e më të gjera, kurse ngjyra e përhimtë dhe muzgu u shndërruan në fushçetë portokalli të artë. Patëm mësyre nëpër oazën El-Arish, nëpër kolonadat e palmave madhështore me mijëra harqe të rrepta të gjetheve të palmave dhe me rrjetin gështenj në të gjelbër të dritës dhe hijes. Shikoja gruan me kënatën plot mbi kokë se si kthehet nga pusi

dhe ec ngadalë shtegut nën palma. Mbante fustanin e gjatë të zi e të kaltër dhe ishte si zonjë e lartë nga legjenda.

Palmishtet e El-Arishit u zhdukën papritmas sikur që edhe janë shfaqur. Tash udhëtojmë nëpër dritën e qumshtë të shndritshme. Jashtë, jashtë prangave të dritareve që dridhen, heshtja e thellë çfarë kurrë nuk kam mundur as ta mendoj. Të gjitha format dhe lëvizjet kanë qenë të privuara edhe dje edhe nesër - kanë qenë thjeshtë këtu, në thjeshtësinë dehëse. Rëra e mirë, që era e ka formësuar në bregore të buta që nën diell kanë përvëluar zbehtë-portokalltë, si pergamenti mjaft i vjetër, vetëm më të butë, më të lehtë në kthesat e veta, duke u valëvitur në kthesat e rrepta, vendimtare në maje, pafund të lehtë në skaje, në hijet e tejdukshme të postalit - purpurisht, vjollce dhe kuqërremtë - në thellësimet dhe uljet e cekta. Retë që derdhen sikur opali, shkurret e kaktusëve aty-këtu dhe nganjëherë bari i gjatë i fortë. Një ose dy herë pashë beduinët e rrallë, këmbëzbathur dhe karvanin e deveve të ngarkuar me degët e palmave të cilat prej diku, diku i bartnin. U ndjeva i përfshirë me peizazh të shkëlqyer.

Disa herë jemi ndalur në stacionet e vogla, rëndom vetëm disa baraka prej trarëve dhe teneqeve. Djelmoshat zeshkanë të leckosur vraponin përreth me shporta dhe ofronin për shitje fiq, ve të ziera fortë dhe bukë të vogla të freskëta, shpatuke për shitje. Beduini në anën tjetër të rrugës nga unë ngadalë u ngrit, e shpaloi mbështjellësin e vet për koke dhe e hapi dritaren. Fytyra e tij ishte e dobët, zeshkane, me vija të rrepta, një nga ato që përkujtojnë në petritin i cili gjithnjë tendosshëm shikon përpara. Ai bleu një kulaç, u kthye dhe pikërisht dëshiroi të ulej kur shikimi i shkoi tek unë; atëherë, pa fjalë, e theu kulaçin e vet në dysh dhe ma afroi gjysmën. Kur pa ngurrimin dhe habinë time, ai u qesh - po, pashë se ajo buzëqeshje e ëmbël i përshtatej fytyrës së tij po ashtu sikur

edhe tendosja prej pak më herët - dhe e tha një fjalë që nuk munda ta kuptoj atëherë, por tash e di se ajo ka qenë tefedda" - "urdhëroni" (ma plotësoni dëshirën). E mora kulaçin dhe iu falënderova me tundje koke. Një udhëtar tjetër - bartte, pos fesit të vet të kuq, petka Evropiane dhe mund të ketë qenë tregtar i vogël - u përzie si përkthyes. Me ndërprerje, tha në anglishte:

"Ai thotë, ju udhëtar, ai udhëtar, rruga juaj dhe rruga e tij së bashku".

Kur tash mendoj për këtë ndodhi të vogël, më duket se tërë dashuria ime për karakterin arab është dashur të jetë nën ndikimin e këtij beduini i cili, përkundër të gjitha pengesave të mosnjohjes, e ndjen mikun në bashku-udhëtarin e rastit dhe e ndanë me të bukën. Është dashur patjetër tashmë ta ndiej frymën dhe hapin e njerëzishmërisë pa ngarkesë.

Së shpejti erdhi Gaza e vjetër, si kështjellë prej baltes, që jeton jetën e vet të harruar në bregun ranor ndërmjet mureve prej kaktusit. Beduini im i mblodhi trastat e veta, më përshëndeti me buzëqeshje të denjë dhe me tundjen e kokës dhe doli nga vagoni, duke e fshirë dyshe-menë pas vetes me skajin e gjatë të gujës së vet. Dy beduinë tjerë qëndronin jashtë në peron dhe u përshëndetën me të duke u kapur për dore dhe me puthje në të dy faqet.

Tregtari që fliste anglisht e vuri dorën e vet në timen: "Eja, edhe një çerek ore kohë".

Pas ndërtesës së stacionit që ndalur karvani; këta janë, më njoftoi përcjellësi im, beduinët nga Hixhazi Vërior. Kishin fytyra të skuqura, të pluhurosura, të vrazhda e të ngrohta. Miku ynë qëndronte në mesin e tyre. Doli se ai ishte person me njëfar rëndësi, sepse të gjithë qëndronin rreth tij dhe përgjigjeshin në pyetjet e tij. Tregtari

iu drejtua, kurse ata u kthyen ndaj nesh, miqësisht - dhe, mendova, disi me përbuzje - ndaj jetës sonë qytetare.

I rrethonte atmosfera e lirisë dhe ndjeva dëshirën e fortë që ta njoh dhe kuptoj jetën e tyre. Ajri ishte i thatë, vezullues dhe dukej se po depërtonte në trup. Ai e zbuste çdo jonatyrshmëri, e lironte çdo mendim dhe e bënte të ngathtë e të qetë. Kishte diç jokohore në atë që çdo gjë shihej, dëgjohej dhe lëshonte aromë dhe dukej se merrte vlerë të veçantë, në mënyrën e vet. Filloi të më bëhet e qartë se ata njerëz që vijnë nga trevat shkretinore duhet të ndiejnë jetën në mënyrën krejt tjetërfare nga ajo se si e ndiejnë njerëzit nga të gjitha trevat tjera; ata duhet të jenë të liruar nga të gjitha fikat - mbase po ashtu edhe nga shumë ëndrra - karakteristike për popujt e vendeve më të ftohta, më të pasura dhe gjithsesi shumë kufizimeve të tyre; e Pasi më intimisht duhet të mbështeten në vrojtimet e tyre, këta banorë shkretinorë duhet të konstatojnë shkallë krejtësisht tjetërfare të vlerave të gjësendeve në botë.

Ndoshta pikërisht ka qenë një parandjenjë e kthesës që po vjen në jetën time që më ka kapur atë ditën e parë në tokën arabe gjatë shikimit në beduinët: parandjenja e botës që është pa kufij përcaktues, por, përkundër kësaj, kurrë nuk është e patvojtshme; e cila është plotësisht e rrethuar në vetvete - e megjithatë e hapur në të gjitha anët: bota që duhej së shpejti të bëhej e imja personale. Nuk mund të thuhet se atëherë kam qenë i vetëdijshëm për atë që ardhmëria ka pasur të përgatitur për mua; natyrisht jo. Ka qenë kjo më tepër sikur kur hyni në shtëpinë e panjohur për herë të parë dhe njëfarë arome e pashpjegueshme në hajatin hyrës paqartë ju paralajmëron gjërat që do të ndodhin në atë shtëpi e të cilat do t'ju ndodhin juve. E nëse këto duhet të jenë gjëra të hareshme, ju ndieni sulmin e magjepsjes në zemrën tuaj - dhe do të kujtoheni për këtë shumë më vonë, kur të gjitha

ato ndodhi tashmë të ndodhin dhe do t'i thuani vetvetes: "Tërë këtë unë kaherë e kam parandier; ashtu dhe kurr-sesi tjetërfare, atë çastin e parë në atë hajat".

## - 2 -

Era e fuqishme frynë shkretëtirës dhe një kohë Zej-di mendon se sërish do të kemi shtrëngatë ranore. Por edhe pse kurrfarë shtrëngate ranore nuk vjen, era nuk na lëshon. Na ndjek në hove të përhershme, kurse hovet shkrihen në oshëtimë unike, të pandërprerë derisa zbre-sim në luginën ranore. Fshati i palmishtes në mjedisin e tij, i përbërë prej disa vendbanimeve të ndara, e gjithësesi i rrethuar me murë dheu, është i mbuluar me mjegullën e vogël të pluhurit të trazuar ranor.

Kjo trevë është një lloj strofulle e erës: çdo ditë prej agimit deri në perëndimin e diellit era këtu rrahë me kra-hë të rreptë, duke u qetësuar natën, që të ngrihet përsëri mëngjesin vijues me forcën e përtëritur; kurse trupat e palmës, amshueshëm të shtrënguar poshtë nga goditjet e saj, nuk mund të rriten deri në lartësinë e vet të plotë por mbesin shkurtabiqe dhe të atrofizuara, me gjethin gjerë të hapur, gjithnjë në rrezik prej ngrehirave ranore që vijnë. Fshati kaherë do të varrosej në rërë sikur bano-rët mos të kishin mbjellë radhët me tamariskë nga çdo pemishte. Ky dru i lartë, më i qëndrueshëm se palmat me trungjet e veta të forta dhe me degët amshuese të gjelbra fërshëritëse, formon murin e gjallë rreth plantaci-oneve, duke iu ofruar mbrojtje jo të sigurt.

Zbritëm nga devet para shtëpisë nga dheu të emirit të fshatit, me qëllim që këtu të pushojmë gjatë kohës së vapës së drekës. Ndërtesa anash është pa kurrfarë mobi-liesh, varfërore dhe ofron vetëm hasurën e vogël para oxhakut guror për kafe. Por, sikur edhe rëndom, mik-

pritja arabe ngadhënjen çdo varfëri. Sepse, posa u ulëm në hasurë, zjarri miqësor prej degëzave kërcet në vatër; zëri cingërues i havanit të mjalit në të cilin shtypet kafeja freskët e fërguar krijon ndjenjën e këndshmerisë në hapësirë; tabakaja e madhe përplot hurme shkëlqyese të zeza e zbutë urinë e udhëtarëve.

Shtëpiaku ynë - plaku i vogël e i dobët, me sy të rreptë, të picërruar, i veshur vetëm në fustanin e pambukut me mbulesën e kokës - na thërret që të shërbehemi:

"Zoti ju dhashtë jetë; kjo shtëpi është shtëpia juaj, hani në emër të Zotit. Kjo është e tërë çka kam", - dhe ai kërkon falje me lëvizje të dorës, me lëvizje unike në të cilën është shprehur tërë pesha e fatit të tij, me atë forcën jo të artificializuar të shprehjes aq karakteristike për njerëzit që jetojnë krejt afër instinkteve të veta - "por hurmet nuk janë të këqija. Hani, udhëtarë, nga ajo çka mund t'ju ofrojmë..."

Hurmet vërtet janë ndër më të mirat që kurdoherë i kam ngrënë, kurse shtëpiaku qartë është i kënaqur që mund ta zbusë urinë tonë. Ai vazhdon:

"Era, era, ajo po na vështirëson jetën; por ky është vullneti i Zotit. Era rrënon të mbjellat tona. Gjithnjë duhet të luftojmë që t'i ruajmë mos t'i mbushë rëra. Gjithnjë nuk ka qenë kështu. Dikur nuk ka pasur këtu aq shumë erë, kurse fshati ka qenë i madh dhe i pasur. Tash është zvogëluar; shumë djelmosha tanë po shkojnë, sepse çdonjëri nuk mund ta durojë jetën e tillë. Rëra po na shtynë nga dita në ditë. Së shpejti më nuk do të ketë vend për palma. Kjo erë... Por ne nuk ankohe mi... Sikur që e dini, i Dërguari i Zotit, Zoti e bekoftë atë - na ka thënë: "Zoti thotë, mos e fajëso fatin, sepse, ki kujdes, Unë jam fati..."

Është dashur të jem trembur, sepse plaku u ndal në të folur dhe më shikoi me kujdes; dhe, sikur kupton përse jam trembur, u qesh gati me buzëqeshje të ëmbël, që

ishte e çuditshme të shihet në atë fytyrë të lodhur, të rraskapitur, dhe përsëriti lehtë, sikur për vetë:

"...ki kujdes, Unë jam fati" - dhe në tundjen e kokës me të cilën i përcjell fjalët e veta qëndron denjësisht, pranimi i qetë i vendit të vet në jetë. Kurrë nuk kam parë, madje as te njerëzit e lumtur, "Po" e thënë me aq prehje dhe bindje. Me lëvizjen e gjerë, të papërcaktuar, gati sensuale të dorës së vet ai e përshkruan rrethën në ajër, rrethën që përfshinë çdo gjë që i përket kësaj jete: dhomën e varfër të errët, erën dhe askëtimën e saj amshuese. Përparimin e pamëshirshëm të rërës; mallëngjimin për fat, lojalitet asaj që nuk mund të ndërrohet; tabakaja përplot hurme; pemishtet në luftë të amshueshme pas pritës së tyre nga tamariskat; zjarrin në vatër; të qeshurit e gruas së re diku në oborr pas dhomë. Në të gjitha këto gjëra dhe në gjestin me të cilin i shtroi dhe i hartoi, më duket se dëgjoj këngën e shpirtit të fortë që nuk njeh pengesat e rrethanave dhe i cili është në qetësi me vetveten.

Jam përcjellë në të kaluarën, në atë kohën e kahershme, në atë ditën vjeshtare në Jerusalem para dhjetë vjetësh - kur një plak tjetër i varfër më ka folur për lojalitetin ndaj Zotit, i cili i vetmi mund të bëjë që njeriu të jetë në qetësi me Të dhe kështu në qetësi me fatin e vet.

Atë vjeshtë kam jetuar në shtëpinë e dajës tim Darianit pikërisht në qytetin e vjetër të Jerusalemit. Shiu binte pothuaj çdo ditë dhe, si nuk kam mundur shpesh të dalë, shpesh jam ulur pranë dritares që shikonte në oborrin e gjerë pas shtëpisë. Ky oborr i takonte një arabi të vjetër të cilin e quanin haxhi për shkak se ka pelegrinuar në Mekë; merrte gomarë për hipje me qira dhe kështu oborrrin e kishte shndërruar në një lloj karvansaraji.

Çdo mëngjes, menjëherë pas agimi, ngarkesat e perimeve dhe pemëve silleshin me deve nga fshatrat përreth dhe me gomarë dërgoheshin në rrugët e ngushta të baza-

rit të qytetit. Ditën mund të shiheshin trupat e rëndë të deveve se si pushojnë në tokë; njerëzit gjithnjë zëshëm kujdeseshin rreth tyre dhe gomarëve, nëse rigat e shiut nuk i detyronin të kërkojnë strehim në stalla. Këta ishin njerëzit e varfër, të leckosur, ata grahësit e deveve e gomarëve, por sillëshin si zotërinj të mëdhenj. Kur uleshin së bashku dhe hanin bukë të vogla shpatuke prej gruri me pak djath dhe disa ullinj, nuk kam mundur e të mos i admirohem bujarisë dhe lehtësisë së sjelljes së tyre, si dhe rahatisë së tyre të brendshme; keni mundur të shihni se kanë respekt ndaj vetvetes dhe gjërave të përditshme të jetës së vet. Haxhiu, duke çaluar përreth me shkop - sepse vuante nga kallja e nyjeve dhe i kishte gjunjët e ënjtur - ishte një lloj kryepari në mesin e tyre; duket se i ishin nënshtruar pa kurrfarë kundërshtimi. Disa herë në ditë ai do t'i tubonte në lutje dhe, nëse nuk binte shi shumë i fortë, ata luteshin jashtë: të gjithë në një rresht të gjatë, kurse ai si imam para tyre. Ishin sikur ushtarë në saktësinë e lëvizjeve të tyre - përkuleshin së bashku në drejtim të Mekës, prap ngriheshin, e pastaj gjunjëzoheshin dhe e prekin tokën me ballin e tyre. Duket se i ndiqnin fjalët e padëgjueshme të udhëheqësit të tyre, i cili ndërmjet ramjes në gjunjë qëndronte i zbathur në sexhaden e vet, me sy të mbyllur, me duar të lidhura në kraharor, pa zë duke lëvizur me buzë dhe qartë i humbur në preokupimin e thellë: keni mundur të shihni se lutet nga thellësia e shpirtit të vet.

Disi më pengonte të shoh lutjen aq reale të kombinuar me lëvizjet pothuaj mekanike të trupit, dhe një ditë e pyeta haxhiun, i cili diçka kuptonte anglisht:

"A besoni ju vërtet se Zoti nga ju pret që T'i shprehni respektin tuaj me përkulje, kërrusje dhe duke lëshuar ballin në tokë të përsëritur? A nuk do të ishte më mirë vetëm të shikoni në vete dhe T'i luteni në qetësi të zemrës suaj? Për çka të gjitha këto lëvizje të trupit tuaj?"

Posa i shqiptova këto fjalë, ndjeva pendim, sepse nuk kisha qëllim t'i ofendoja ndjenjat fetare të plakut. Por haxhiu nuk dukej as më së paku i ofenduar. Ai u qesh me gojën e tij pa dhëmbë dhe u përgjigj:

"Si atëherë ndryshe do të duhej t'i robërojmë Zotit? A nuk i ka krijuar ai të dytë, edhe shpirtin, edhe trupin, së bashku? E pasi kjo është kështu, a nuk duhet njeriu të lutet edhe me trupin e vet, njëjtë sikur edhe me shpirtin? Dëgjoni, do t'u them përse ne muslimanët lutemi ashtu si lutemi. Kthehemi kah Ka'beja, tempulli i shenjtë i Zotit në Mekë, duke e ditur se fytyrat e të gjithë muslimanëve, kudo që të jenë, janë të drejtuara drejt saj në lutje dhe se jemi sikur një trup, me Të si qendër të mendimeve tona. Më së pari qëndrojmë dhe recitojmë nga Kur'ani i Shenjtë, duke përkujtuar se këto janë fjalët e Tij që ia ka drejtuar njeriut që të jetë i ndershëm dhe stabil në jetë. Pastaj themi "Zoti është më i madhi", duke i përkujtuar vetvetes se askush nuk meriton që t'i falemi pos Atij; përkulemi thellë sepse e lavdojmë mbi të gjitha dhe e madhërojmë mëshirën dhe fuqinë e Tij. Pastaj bijmë me ballë në tokë për atë se ndjejmë se jemi vetëm pluhur: asgjë para Tij, dhe se Ai është Krijues dhe Ushqyes. Pastaj i ngremë fytyrat nga toka dhe rrimë ulur, duke u lutur që të na i falë Ai gabimet tona dhe të na dhurojë me mëshirën e vet, të na udhëheqë në rrugë të drejtë dhe të na japë shëndet e mbështetje. Pastaj përsëri bijmë me ballë në tokë dhe e prekim pluhurin me ballin tonë para pushtetit dhe lavdisë së të Vetmit. Pas kësaj, rrimë ulur dhe lutemi që Ai ta bekojë pejgamberin Muhammed që na solli porosinë e Tij, pikërisht siç i ka bekuar edhe pejgamberët para tij, dhe të na bekojë po ashtu edhe neve dhe të gjithë ata që ndjekin udhëzimin e drejtë; e lusim që të na japë të mira në këtë botë dhe të mira në botën që pason. Në fund e kthejmë kokën djathtas e

majtas, duke shqiptuar: "Shpëtimi, mëshira dhe begatia e Zotit qoftë mbi ju" - dhe kështu i përshëndesim të gjithë ata që janë të drejtë kudo që të jenë.

Pikërisht ashtu u lutë edhe Pejgamberi ynë dhe i ka mësuar ithtarët e vet që ashtu të luten për të gjitha kohët, që në mënyrë të gëzueshme t'i dorëzohen Zotit - çka pikërisht do të thotë - në Islam - dhe kështu të jenë në paqe me Të dhe me fatin e vet vetjak".

Plaku, natyrisht, nuk i ka përdorur pikërisht ato fjalë, por ky ka qenë kuptimi i tyre dhe kështu mua më kujtohen. Vite më vonë kam kuptuar se haxhiu me këtë shpjegim të thjeshtë m'i ka hapur dyert e para drejt Islamit; por madje edhe atëherë, shumë më herët se çdo ide tjetër se Islami do të bëhet feja ime, kam filluar të ndiej pendimin e pavetëdijshëm kurdo që shihja, e që ka qenë shpesh, njeriun se si qëndron këmbëzbathur në sexhaden e vet, ose në hasurë, ose në tokë pa asgjë, me duar të lidhura në kraharor, kokulur, krejtësisht të thelluar në vete, duke harruar ç'po ndodh rreth tij, qoftë kjo në xhami ose në trotuar të rrugës frekvente: njeriu në paqe me veten e vet.

"Shtëpia gurore arabe" për të cilën ka shkruar Daria-ni ka qenë vërtet e përshtatshme. Ishte në fund të qytetit të vjetër afër portës së Jafës. Dhomat e saj të mëdha, me tavane të larta, sikur ishin të ngopura me kujtimet e jetës fisnike që ka kaluar nëpër to në brezat e hershëm, kurse muret jehonin me tanishmërinë e gjallë që buron nga bazari<sup>3</sup> fqinjësor - pamjet, zërat dhe aromat që nuk ngjasojnë në asgjë tjetër që deri atëherë kam shijuar.

Nga tarraca në kulm kam mund të shoh territorin rreptë të skicuar të qytetit të vjetër me rrjetin e tij të rrugëve dhe kalimeve të parregullta të copëtuara në gur. Në skajin tjetër, në pamje afër në hapësirën e vet të fuqishme, ishte vendi i tempullit të Solomonit. Xhamia El-Aksa - më e shenjta pas atyre në Mekë dhe Medine -

qëndronte në skajin e saj më të largët, kurse kupola në shkamb në vetë qendrën. Pas kësaj, muret e qytetit të vjetër binin drejt luginës Kidron; atje më larg lugina lehtë rrethohej me kodrina të vogla të zhveshura, shpatijet e të cilave janë të laruara me ullinj. Nga lindja ishte diç më e pllëshme dhe atje keni mundur të shihni kopshtet që pjerrtazi lëshohen drejt rrugës, të mbyllura në të gjelbër, të rrethuara me mure. Kopshtet e Getsemanes. Midis tyre shkëlqenin në mesin e muslimanëve dhe selvive kupolat e arta të kishës ruse.

Sikur pija shkumbuese përvëluese nga retarta e alkimistit, e ndritshme e megjithatë plot me mijëra ngjyra të papërcaktuara, jashtë mundësive të fjalëve, madje edhe jashtë të kapurit të mendjes: të tillë nga Kodra e ullirit keni mundur ta shihni luginën e Jordanisë dhe Detin e Vdekur. Kodrinat e vogla valore, njëra pas tjetrës të vijëzuara, sikur tym, në ajrin qumështor, me shiritin e mbyllur të kaltër të Jordanisë dhe me rrumbullakimin e Detit të Vdekur në largësi - e edhe më tej pas kësaj, një botë tjetër vetvetiu, kodrinat e mbyllura të Moabit; peizazhi i bukurisë aq i pakuptueshëm, i llojlojshëm që zemra të dridhet nga mallëngjimi.

Jerusalemi ishte botë krejtësisht e re për mua. Kishte kujtime historike që buronin në çdo hap të qytetit të lashtë: rrugët që kanë dëgjuar predikimet e Isait, kalldrëmi nëpër të cilin ka ecur Krishti, muret që ishin të vjetra qysh atëherë kur prej tyre është dëbuar ushtria e hapave të rëndë të legjionarëve romakë, qemerët mbi porta që mbajnë mbishkrimet nga epoka e Salahudinit. Ishte këtu kaltërsia e thellë e qiejve, që nuk është dashur të jetë e huaj për dikënd kush i ka njohur vendet tjera mesdhetare; por për mua, që jam rritur në klimë shumë më armiqësore, kjo kaltërsi ka qenë si thirrje dhe si premtim. Shtëpitë dhe rrugët sikur janë të mbuluara me

zmaltin e butë, vibrues; njerëzit plot lëvizje spontane dhe gjeste madhështore. Njerëzit - do të thotë arabët, sepse pikërisht ata prej vetë fillimit i janë imponuar vetëdijes sime si popull i atij vendi, populli që është rritur nga dheu i saj dhe historia e tij dhe ka qenë një me ajrin lokal. Veshja e tyre ishte me ngjyra luksoze dhe me shenja biblike, kurse secili prej tyre, felah ose beduin (sepse keni mundur shpesh t'i shihni beduinët që kanë ardhur në qytet të blejnë ose shesin ndonjë mall), e bartte në mënyrë krejtësisht karakteristike, qoftë edhe pak tjetërfarë prej të tjerëve, sikur e ka gjetur modën personale, duke ndjekur instinktin e pashpresuar të çastit.

Para shtëpisë së Darianit, në largësi prej ndoshta tri dhjetë metrash, ngriheshin muret e rrëpishme, të harxhuara të kështjellës së Davudit, që ka qenë pjesë e bedemit të qytetit të vjetër - kështjellës tipike mesjetare arabe, sigurisht të ngritura në themelet herodiane, me kullën e gjatë për vrojtim të ngjashme me minaren. (Edhe pse ai nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me mbretin Davud, hebrenjtë gjithnjë e kanë quajtur sipas tij për shkak se këtu në malin Cion, si thonë, ka qenë pallati i mbretit). Në anën e qytetit të vjetër ishte pyrgu i ulët, i gjerë në të cilën ka qenë porta, kurse ura e gurit në liman lidhte hendekun e vjetër drejt portës. Kjo urë e limanit ka qenë qartë vend i rëndomtë i takimit të beduinëve kur vinin në qytet. Një ditë e hetova një beduin të lartë se si atje qëdron palëvizshëm, si siluetë drejt qiellit të argjendtë të përhimtë, figurë nga ndonjë legjendë e vjetër. Fytyra e tij, me mollëza të rrepta, e kornizuar me mjekrën e shkurtër, të kuqe në të zezë, kishte shprehje të njëmendësisë së thellë; ishte i hidhërueshëm, sikur priste dikë, kurse megjithatë nuk dukej sikur ai që pret. Guja e tij e gjerë, gështenjëbardhë me vija ishte e bartur dhe e leckosur - dhe më erdhi mendimi i çuditshëm, nuk e di

përse, se ai është rreckosur gjatë shumë muajve të rrezikut dhe ikjes. A mos ai, ndoshta, ka qenë njëri prej atij grushti luftëtarësh që e kanë përcjellë Davudin e ri në ikjen e tij nga xhelozia e errët e Saulit, mbretit të tij? Ndoshta tash Davudi pikërisht ka ëndërruar, duke u fshëhur diku në ndonjë shpellë të brigjeve judeje, kurse ky njeriu këtu, ky miku besnik dhe trim, fshehtazi ka ardhur me përcjellës në qytetin mbretëror të vëzhgojë se si është disponuar Sauli ndaj liderit të tyre dhe se a e ka të sigurt që të kthehet. Dhe tash, ky mik i Davudit këtu e pritte shokun e vet, plot paralajmërime të errëta: nuk kishte lajme të mira që do t'ia çonte Davudit...

Papritmas beduini u nis, filloi të ecë drejt pjerrinës kurse imagjinata ime u ndërpre. Atëherë papritmas u kujtova: ky njeri është arab, derisa ata të tjerët, ato figurat nga bibla - kanë qenë hebrej! Por çudia ime ishte me kohë të shkurtër; sepse menjëherë kuptova, me atë qartësinë e cila nganjëherë shkëlqen në ne si vetëtimë dhe e ndriçoi botën vetëm aq sa zgjatë një rrahje zemre, se Davudi dhe epoka e Davudit, sikur edhe Ibrahimimi dhe epoka e Ibrahimit, janë më afër rrënjës arabe - e po ashtu edhe beduinët e sotëm - se sa hebrejntë e sotshëm që pohojnë se janë pasardhës të tyre.

Shpesh jam ulur në bregun guror të portës së Jafës dhe vështroja shumësinë e njerëzve se si hyjnë në qytetin e vjetër ose dalin nga ai. Këtu janë fyer këta e ata, e kanë shtyrë njëri - tjetrin, arabët dhe hebrejntë, të gjithë variantet e mundshme edhe të këtyre edhe të atyre. Kishte felahë ashtmëdhenj me mbulesat e bardha ose ngjyrë gështenje për kokë ose me turbanët ngjyrë portokalli. Ka pasur beduinë me fytyra të rrepta, qartë të formuara dhe, pothuaj pa përjashtim, të dobëta, që i kanë bartur gujat e tyre në mënyrën çuditëse vetëmohuese, shpesh me duar në bel e me krahë hapur, sikur pranojnë për fakt të

gatshëm se çdokush do t'u shmanget nga rruga. Kishte fshatare në fustana të zinj ose të kaltër me qëndisje të bardhë mbi kraharor, shpesh duke bartur shporta mbi kokë dhe duke lëvizur me njerëzishmëri të shkathët, të natyrshme. Shikuar nga mbrapa, shumica prej grave në të gjashtëdhjetat do të mund të konsiderohej vashë e re. Sytë e tyre dukeshin se po mbesin të kthjellët e të peprekur me vite - pos nëse ka ndodhur që janë goditur me trakomë, me atë sëmundje të keqe egjiptiane të syve, që është fatkeqësi e të gjitha vendeve në lindje prej Mesdheut.

Ka pasur edhe hebraikë: hebraikë vendas, që mbanin tarbushë dhe gujën e gjerë të hapur, në fytyrë mjaft të ngjashëm me arabët; hebraikët nga Polonia dhe Rusia, të cilët sikur me vete kanë bartur aq shumë cikrimësi dhe ngushtësi të jetës së vet të kaluar në Evropë, sa ka qenë befasuese të mendohet se ata pohojnë për veten se janë të prejardhjes së njëjtë sikur edhe hebraikët krenarë nga Marokoja ose Tunizia në burnusët e vet të bardhë. Por, edhe pse hebraikët Evropianët kanë qenë aq qartë në joharmoni me fotografinë që i ka rrethuar, pikërisht ata kanë përcaktuar tonin e jetës dhe të politikës hebraike dhe kështu si duket kanë qenë përgjegjës për ngatërresat pothuaj të qarta ndërmjet hebraikëve dhe arabëve.

Ç'dinte evropiani mesatar për arabët e atyre ditëve? Praktikisht asgjë. Kur ka ardhur në Lindjen e Afërt, ka sjellë me vete disa botëkuptime romantike e të gabuara. Nëse ka qenë qëllim mirë dhe intelektualisht i ndershëm, është dashur të pranojë që fare nuk ka pasur lidhje për arabët. As unë, para ardhjes në Palestinë, kurrë nuk kam menduar për të si vend arab. Papërcaktueshëm, natyrisht, kam ditur se atje jetojnë diçka arabë, por i kam menduar vetëm si nomadë në tentat shkretinore dhe si banorë të oazave idilike. Pasi shumicën e asaj që më herët e pata lexuar për Palestinën e kanë shkruar cionistët - që

natyrisht kanë pasur kujdes për problemet e tyre vetjake, unë nuk kam kuptuar se edhe qytetet janë përplot arabë - që në realitet në vitin 1922 në Palestinë kanë jetuar gati pesë arabë për çdo hebraik dhe se kjo, për këtë shkak, është shumë më tepër vend arab se hebraik.

Kur këtë ia kam thënë këtë z. Usishkinit, kryetarit të Komitetit cionist, me të cilin jam takuar në atë kohë, kam pasur përshtypjen se cionistët nuk kanë disponim ta marrin në shqyrtim faktin e shumicës arabe, as që dukej se i jep çfarëdo rëndësie të vërtetë opozitës arabe, cionizmit. Përgjigjja e z. Usishkinit dëftonte vetëm përbuzje ndaj arabëve.

"Nuk ka lëvizje të njëmendtë arabe kundër nesh këtu; do të thotë, kurrfarë lëvizje të rrënjësuar në popull. Çdo gjë që ju e konsideroni si opozitë, në të vërtetë është vetëm britma e disa agjitorëve të pakënaqur. Kjo do të thuhet në vete për disa muaj ose më së shumti disa vjet".

Ky argument që nga ajo që të më kënaq. Nga fillimi kam pasur ndjenjën se tërë ideja e popullzimit hebraik në Palestinë është e panatyrshme, kurse, ç'është edhe më keq, ajo kërcënon që të përcillen të gjitha komplikimet dhe problemet e pazgjidhuara të jetës Evropiane në tokën që ka mund të jetë më e fatshme pa ata. Hebraikët në të realisht nuk vinin sikur që kthehen në vendlindjen e vet; ata më shumë kanë qenë të preokupuar me atë që prej saj të bëjnë vendlindjen të menduar sipas modeleve Evropiane dhe me caqet Evropiane. Shkurtimisht, ata kanë qenë të huaj brenda portave. Kështu nuk kam parë asgjë të gabueshme në rezistencën arabe të vendosur idesë së atdheut hebraik në mjedisin e tyre; përkundrazi, menjëherë kam kuptuar se pikërisht arabët kanë qenë të mashtruar dhe me të drejtë janë mbrojtur nga mashtrimi i këtillë.

Në Deklaratën e Balfouroit nga viti 1917, që u premtonte hebraikëve "atdheun nacional" në Palestinë,

kam parë manovër të vrazhdë politike të menduar që ta nxisë parimin e vjetër, të përbashkët për të gjitha forcat kolonialiste: "përçaj e sundo". Në rastin e Palestinës ky parim ka qenë më eklatant kur më 1916 britanezët i patën premtuar sunduesit të atëhershëm të Mekës, Sherif Huseinit, si vlerë për ndihmën e tij kundër Turqisë, shtetin e mëvetshëm arab që është dashur t'i përfshijë të gjitha vendet ndërmjet Detit Mesdhe dhe Gjirit Persik. Ata jo vetëm që kanë thyer premtimin e vet vetëm një vit më vonë, duke lidhur me Francën marrëveshjen e fshehtë Sykes-Picat (me të cilën është përcaktuar dominimi francez në Siri dhe Liban), por po ashtu, heshtazi, e kanë përjashtuar Palestinën nga obligimet që i patën marrë në pikëpamje të arabëve.

Ndonëse edhe vetë jam me prejardhje hebraike, prej fillimit rreptë i jam kundërvënë cionizmit. Përveç simpatisë sime personale ndaj arabëve, e kam konsideruar jo të moralshme që ardhacakët, me ndihmën e palës së fuqive të mëdha, vijnë nga anash me qëllim të qartë që ta arrijnë shumicën në vend dhe kështu t'ua marrin pushtetin atyre të cilëve ky vend u ka takuar prej kohësh. Në pajtim me këtë, kam qenë i prirë të jem në anën e arabëve kurdo që vinte deri te diskutimi për çështjen hebraiko-arabe - që, natyrisht, ndodhte shumë shpesh. Ky qëndrim imi ka qenë i pakuptueshëm pothuaj për të gjithë hebraikët me të cilët kam ardhë në kontakt gjatë atyre muajve. Nuk kanë mundur të kuptojnë çka kam parë tek arabët të cilët janë, sipas mendimit të tyre, vetëm masë e popullit të prapambetur mbi të cilin ata kanë shikuar me ndjenjën jo shumë tjetërfare nga ajo që e kanë ardhacakët Evropianët në Afrikën Qendrore. Nuk kanë qenë as më së paku të interesuar për atë çka mendojnë arabët; pothuaj askush prej tyre nuk është angazhuar të mësojë arabisht;

secili e ka miratuar pa kurrfarë hulumtimi parimin se Palestina është trashëgimi e ligjshme e hebraikëve.

Ende më kujtohet diskutimi i shkurtër të cilin për këtë çështje e kam pasur me dr. Chaim Weizmannin, liderin e njëmendtë të lëvizjes sioniste. Pat ardhur në njërën prej vizitave të veta të kohëpaskohshme Palestinës (vendqëndrimi i tij i përhershëm ka qenë, mendoj, Londra), kurse e takova në shtëpinë e një miku hebraik. Njeriu duhej të impresionohej me energjinë e tij tepër të madhe - energji që madje shprehet në lëvizjet e tij trupore, në hapat e gjatë, elastikë me të cilët maturisht hapëron lart-poshtë nëpër dhomë - sikur edhe me fuqinë e mendjes që zbulohet në ballin e gjerë dhe shikimin depërtues të syve të tij.

Fliste për vështirësitë materiale që e mundojnë ëndërrën për atdheun nacional hebraik dhe për ftesën e pamjaftueshme për këtë ëndërr në mesin e njerëzve jashtë vendit; kam pasur përshtypje shqetësuese se madje edhe ai, sikur edhe shumica e cionistëve të tjerë, anon nga ajo që përgjegjësinë morale për çdo gjë që po ndodh në Palestinë ta hedhë në botën e jashtme. Kjo më shtyri ta ndërpres qetësinë servile në të cilën të gjithë të pranishmit e dëgjonin dhe të pyes:

"E ç'është me arabët?"

Duket se veprova në mënyrë jotaktike, duke futur kështu natën jo të hormonishme në bisedë, sepse dr. Weizmanni ngadalë u kthye kah unë, e lëshoi gotën që e mbante në dorë dhe e përsëriti pyetjen time:

"Ç'është me arabët...?"

"E në ç'mënyrë mund të shpresoni që prej Palestinës ta bëni atdheun tuaj përkundër kundërshtimit të rreptë të arabëve, që, megjithatë, janë shumicë në këtë vend?"

Lideri cionist rrudhi supet dhe u përgjigj thatë: "Presim se nuk do të jenë shumicë pas disa vitesh".

"Ndoshta kjo është kështu. Ju merreni me këto pyetje vite me radhë dhe duhet ta njihni gjendjen më mirë se unë. Por, krejt pavarësisht për vështirësitë politike që opozita arabe mund ose nuk mund të paraqesë në rrugën tuaj - a kurrë nuk ju shqetëson aspekti moral i kësaj çështjeje? A nuk mendoni se është jokorrekte nga ana juaj të ndiqet populli që përgjithmonë ka jetuar në këtë vend?"

"Po ky është vendi ynë", - u përgjegj dr. Weizmanni, duke i ngritur vetullat. - "Ne vetëm po e marrim prapë atë nga e cila padrejtësisht kemi qenë privuar".

"Por, ju jeni jashtë Palestinës gati dy mijë vjet! Para kësaj keni sunduar me këtë vend, dhe këtë mezi ndonjëherë me të tërin, më pak se pesëqind vjet. A nuk mendoni se arabët do të mundeshin, me po atë të drejtë, ta kërkojnë për vete Spanjën - sepse, më në fund, ata kanë sunduar në Spanjë gati shtatëqind vjet dhe plotësisht e kanë humbur vetëm para pesëqind vjetësh?"

Dr. Weizmanni u bë dukshëm i padurueshëm: "Absurd. Arabët vetëm e kanë nënshtruar Spanjën; ajo kurrë nuk ka qenë atdheu i tyre i njëmendtë, dhe më në fund ka qenë edhe e drejtë që të largohen nga Spanja".

"Më falni", - ia ktheva, - "por më duket se këtu është në pyetje gabimi historik. Përndryshe, hebraikët po ashtu kanë ardhur në Palestinë si pushtues. Para tyre ka pasur shumë fise semite dhe josemite të banuara këtu - Amoritët, Edomitët, Filistinët, Moabitët, Hititët. Këto fise kanë jetuar këtu madje edhe në kohën e mbretërisë së Izraelit dhe Judës. Ata kanë vazhduar të jetojnë këtu Pasi romakët i larguan të parët tanë. Ata jetojnë këtu edhe sot. Arabët që u vendosën në Siri dhe Palestinë pas pushtimit të tyre në shekullin e shtatë, kanë qenë gjithnjë vetëm pakicë e vogël e popullësisë; ata që kanë mbetur e

që sot i quajmë "Arabë" palestinezë dhe sirianë janë në realitet vetëm banorë autoktonë të arabizuar të vendit. Disa prej tyre janë bërë muslimanë gjatë shekujve, të tjerët kanë mbetur kritianë. Muslimanët natyrisht janë martuar me bashkëbesimtarët e vet nga Arabia. Vallë, a mund ta mohoni se shumica e popullit në Palestinë, që e flet arabishten, pa marrë parasysh a janë muslimanë apo kristianë, janë pasardhës të drejtpërdrejtë të banorëve burimorë, burimorë në kuptim që kanë jetuar në këtë vend para ardhjes së hebraikëve në të?"

Dr. Weizmanni njerëzisht u buzëqesh në sulmin tim të papritur dhe e drejtoi bisedën në temë tjetër.

Nuk qesh i kënaqur me rezultatin e ndërhyrjes sime. Natyrisht, nuk kam pritur që kushdo nga të pranishmit - e më së paku vetë dr. Weizmanni - të pajtohet me bindjen time se ideja sioniste është shumë e paarsyeshme nga aspekti moral; por kam shpresuar se mbrojtja ime e çështjes arabe së paku do të nxisë një lloj të pakëndshmërisë të liderët cionistë - pakënaqësia që do të mund të sjellë deri te të menduarit më të madh dhe në këtë mënyrë, mbase, deri te gatishmëria më e madhe që të pranohet ekzistimi i të drejtës së mundshme morale në konfrontimin e arabëve ... S'pati asgjë nga kjo. Në vend të kësaj, u gjenda para murit të pashprehur të syve të zgurdulluar: gjykimi i rreptë i guximit tim, që kam marrë guxim të dyshoj në të drejtën e pakontestueshme të hebraikëve në vendin e të parëve të tyre...

Si ka qenë e mundur, kam pyetur veten, që njerëzit të talentuar me intelektin e tillë krijues siç janë hebraikët, të mendojnë për konfliktin cionisto-arab vetëm nga pikëpamja hebraike? A nuk kanë kuptuar që problemi i hebrenjve në Palestinë mund në fund të zgjidhet vetëm në bashkëpunim me arabët? A kanë qenë pashpresë të verbër kundrejt ardhmërisë së dhembshme që politika e

tyre duhet patjetër të sjellë - ndaj luftërave, idhtësisë dhe urrejtjes që ujdhesa hebraike, madje nëse përkohësisht do të jetë edhe e suksesshme, gjithnjë do të mbetet e ekspozuar midis detit armiqësor arab?

Dhe kështu është e çuditshme, mendova, që populli që ka pësuar aq shumë padrejtësi gjatë diasporës së vet të gjatë e të pafatshme, tash është i gatshëm që në synimin shpirtngushtë drejt cakut vetjak, t'i shkaktojë padrejtësi të madhe popullit tjetër - e krahas kësaj popullit që është i pafajshëm në të gjitha pësimet e kaluara hebraike. Shfaqja e tillë, e kam ditur, nuk ka qenë e panjohur për historinë; por kjo, megjithatë, ka nxitur tek unë dëshpërim duke parë se kjo po ndodh para syve të mi.

Në atë kohë thellimi im në skenën politike në Palestinë ka qenë bazuar jo vetëm në simpatinë time ndaj arabëve dhe brengosjes rreth eksperimentit cionist, por po ashtu edhe me preokupimin tim të zhurnalistikës: qesh bërë korrespondent special i gazetës Frankfurter Zeitung, atëherë njëres prej gazetave më të vjetra në Evropë. Deri te kjo lidhje erdhi pothuaj rastësisht.

Një mbrëmje, derisa i rregulloja letrat e vjetra në njërën prej valixheve të mia, e gjeta legjitimacionin gazetaresk që m'u pat dhënë në Berlin para një viti si përfaqësues i United Telegraphit. Pikërisht dëshirova që ta shqyej, kur Dariani e rrëmbeu dorën time dhe në shaka briti:

"Jo! Nëse e tregon këtë legjitimacion në zyrën e Komisarit të lartë, disa ditë më vonë do ta pranosh thirrjen për drekë në Ndërtesën drejtuese... Gazetarët janë mjaft të dëshirueshëm në këtë vend".

Ndonëse e kam grisur legjitimacionin e padobishëm, shakaja e Darianit pati jehonë në frymën time. Nuk kam qenë, natyrisht, i interesuar për thirrje për drekë në Ndërtesën drejtuese - por përse mos ta shfrytëzoj rastin e rrallë që jam në Lindjen e Afërt, në kohën kur aq pak

gazetarë nga Evropa Qendrore mund të udhëtojnë atje? Përse sërish mos ta filloj punën time gazetareske - por jo te United Telegraphi por te ndonjë prej gazetave të mëdha? Dhe, sikur tashmë që e pata bërë zakon që papritmas t'i marr vendimet me rëndësi, tash vendosa të hyj në gazetarinë e mirëfilltë.

Edhe përkundër punës sime njëvjeçare te United Telegraphi, nuk kam pasur lidhje të drejtpërdrejta me asnjë gazetë të rëndësishme, e pasi kurrë asgjë nuk kam botuar me emrin tim, kjo ka qenë plotësisht e panjohur për shtypin ditor. Kjo, ndërkaq, nuk më dekurajoi. Shkrova një artikull për disa përshtypje të mia nga Palestina dhe i dërgova kopjet e tij në adresa të dhjetë gazetave gjermane me propozim që të shkruaj një sërë artikujsh për Lindjen e Afërt.

Kjo ka qenë muajve të fundit të vitit 1922- në kohën e inflacionit katastrofal në Gjermani. Shtypi gjerman vështirë luftonte të mbijetojë dhe vetëm disa gazeta kanë mundur t'i paguajnë korrespondentët e huaj në valutë të huaj. Kështu nuk ishte fare befasuese që njëra pas tjetrës prej atyre dhjetë gazetave, të cilave ua pata dërguar ekzemplarën e artikullit, u përgjigjën, pak a shumë, me fraza të njerëzishme negativisht. Vetëm njëra prej tyre e pranoi propozimin tim dhe, qartë e impresionuar me atë çka kam shkruar, më emëroi për korrespondent special shëtitës të vetin në Lindjen e Afërt, duke ia bashkangjitur kësaj edhe kontratën për librin që duhet ta shkruaj pas kthimit tim. Kjo e vetmja gazetë ka qenë Frankfurter Zeitung. Pothuaj se nuk kam mundur të gjendem kur kam parë se jo vetëm që arrita sukses të vë lidhje me një gazetë - dhe atë çfarë gazetë! - por tashmë me goditjen e parë e arrita statusin për të cilin do të ma kishte zili gazetari shumë më i vjetër.

Ka qenë, natyrisht, në këtë një kleçkë. Për shkak të inflacionit Frankfurter Zeitung nuk mund të më paguajë

në valutë të fortë. Honorarët që duke kërkuar falje m'i dërgonin ishin në marka gjermane; kurse unë e dija po ashtu mirë sikur edhe ata se kjo mezi do të mjaftojë ta paguajë pullën në zarfin që do t'i ketë artikujt e mi. Por, të jesh korrespondent special i Frankfurter Zeitungit ishte nder që e kapërcente hendikepin e përkohshëm se për këtë nuk paguhesha. Kam filluar të shkruaj artikuj për Palestinën, duke shpresuar se më herët apo më vonë ndonjë kthesë e fatshme e fatit do të më mundësonte të udhëtoja kudo nëpër Lindjen e Afërt.

Tash kam bërë shumë miq në Palestinë, edhe hebraikë edhe arabë. Cionistët, e vërteta, më shikonin me një lloj dyshimi befasues për shkak të simpatisë ndaj arabëve që ishin aq të dukshme në shkrimet e mia të Frankfurter Zeitung. Qartë nuk mund të vendosnin a më kanë blerë arabët (sepse në Palestinën sioniste njerëzit tashmë patën bërë zakon që pothuaj çdo gjë që ndodh e shpjegojnë me para) ose jam thjesht intelektual tekanjor i dashuruar në ekzotikë. Por, nuk kanë qenë të gjithë hebrenjtë që jetonin në Palestinë cionistë. Disa prej tyre patën ardhur atje, jo me dëshirë për caqe politike por nga mallëngjimi religjioz për vendin e shenjtë dhe asociacionet biblike të tij.

Këtij grupi i takonte edhe miku im holandez Jacob de Haan, njeri i shkurtë e i rrastë i viteve të dyzeta, me mjekër bionde, që më herët ka ligjëruar të drejtën në njërën prej universiteteve udhëheqëse në Holandë, kurse tash ishte korrespondent special i Handelsbadit amsterdams dhe Daily Expressit londinez. Njeri me bindje të thellë religjioze - ortodoks si çdo hebraik nga Evropa Lindore-ai nuk e ka miratuar idenë e cionizmit, sepse besonte se kthimi i popullit të tij në vendin e premtuar duhet ta presë ardhjen e Mesiut. "Ne hebrenjtë", - më ka folur në shumë raste, - "jemi larguar nga vendi i shenjtë dhe jemi shpërndarë nëpër botë sepse nuk e kemi kryer detyrën që Zoti

na pat besuar. Ai na pat zgjedhur ta predikojmë fjalën e Tij, por ne në çapkëninë kokëforte kemi filluar të besojmë se Ai na ka bërë "popull të zgjedhur" të vetin për hir tonin-dhe kështu e kemi tradhtuar. Tash na mbetet vetëm që të pendohemi dhe t'i pastrojmë zemrat tona; e kur sërish të bëhemi të denjë për Porosinë e Tij, Ai do të na dërgojë Mesium t'i udhëheqë shërbëtorët e Tij në Vendin e premtuar..."

"Vallë, a nuk është kjo ideja mesioniste bazë edhe për lëvizjen sioniste?", - e pyeta atë. "Ju e dini se me këtë nuk pajtohem, por a nuk është dëshira natyrore e çdo populli që ta ketë atdheun e tij të vet, nacional?"

Dr. de Haani më shikoi nënçmueshëm: "A mendoni se historia është vetëm një varg ngjarjesh? Unë jo. Nuk ka qenë kjo pa qëllim kur Zotë ka bërë ta humbim vendin tonë dhe kur na ka shkapërderdhur; por cionistët këtë nuk duan t'ia pranojnë vetvetes. Ata po pësojnë nga verbëria e njëjtë shpirtërore që ka sjellë deri te rënia jonë. Dy mijë vjet e mërgimit dhe fatkeqësia hebraike nuk i ka mësuar ata me asgjë. Në vend që të tentojnë t'i kuptojnë shkaqet më të fshehta të fatkeqësisë sonë, ata tash përpiqen që këtë, thënë ashtu, ta kapërcejnë me ndërtimin e "atdheut nacional" në themelet që na ofron politika e forcës perëndimore, kurse në procesin e ndërtimit të atdheut nacional ata kryejnë krim të privimit të popullit tjetër nga atdheu i tij".

Pikëpamjet politike Jacob de Haanin, natyrisht, e kanë bërë mjaft jopopullor ndër cionistët (në të vërtetë, së shpejti pasi e kam lëshuar Palestinën, jam tmerruar kur mësova se terroristët një natë e kanë pushkatuar). Kur e kam njoftuar, shoqërimi i tij që kufizuar në numrin shumë të vogël të hebrenjve që kanë menduar sikur edhe ai, disa Evropianët dhe arabë. Dukej se ndaj arabëve ndiente simpati të madhe, e ata, nga ana e vet, e kanë vlerësuar lart

dhe shpesh e kanë ftuar në shtëpitë e tyre. Në realitet, në atë kohë ata ende nuk kanë pasur paragjykime të përgjithshme ndaj hebrenjve si të tillë. Vetëm pas Deklaratës së Balfourit - do të thotë, pas shekujve të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe vetëdijes për afërsinë racore - arabët filluan të shikojnë te hebrenjtë si në armiqtë politikë. Madje edhe në rrethanat e ndërruara të atyre viteve të hershme të njëzeta, ata ende qartë kanë bërë dallimin ndërmjet cionistëve dhe hebrenjve të cilët i kanë miqë sikur dr. Haanin.

Ata muaj vendimtar të qëndrimit tim të parë në mesin e arabëve kanë nisur një varg të tërë përshtypjesh dhe përsiatjesh; disa shpresa të padukshme të natyrës personale kanë depërtuar deri te vetëdija ime.

Jam ballafaquar me domethënien jetësore që ka qënë krejtësisht e re. Fryma e ngrohtë, njerëzore sikur ka rrymuar nga gjaku i këtyre njerëzve në mendimet dhe lëvizjet e tyre, pa asnjë prej atyre çarjeve të dhembshme të shpirtit, atyre fantomëve të frikës, makutërisë dhe pengesave që e bënin jetën Evropiane aq të shëmtuar dhe me aq pak shpresë. Tek arabët kam filluar të gjej diç që gjithnjë jovetëdijshëm e kam kërkuar: lehtësinë emocionale qasjes të gjitha pyetjeve jetësore - domethënien e shëndoshë supreme të ndjenjës, nëse këtë do të mund ta quanim kështu.

Gjatë kohës m'u bë jashtëzakonisht e rëndësishme që ta kuptoj frymën e këtij populli musliman; jo për shkak se më tërhiqte religjioni i tyre (sepse në atë kohë dija shumë pak për tël) por për shkak se tek ata kam zbuluar atë harmoninë organike të arsyes dhe ndjenjës që ne Evropianët e kemi humbur. A mos, mbase, do të ishte e mundur që të kuptuarit më të mirë të jetës së arabëve të zbulohet lidhja e fshehtë ndërmjet tolerancës sonë perëndimore - mungesës kaustike të tërësisë së brendshme - dhe rrënjëve të tyre? Ndoshta ta gjejmë ç'ka qënë

ajo që neve perëndimorëve na ka larguar nga liria solemne jetësore që dukej se e kanë arabët, madje edhe në shkaktërrimin e vet shoqëror dhe politik, të cilin edhe ne më herët është dashur ta kemi? Ose, si përndryshe kemi mundur t'i japim artet e mëdha të së kaluarës sonë, katedralat gotike të Mesjetës, gëzimin luksoz të renesansës, chiaroscuro e Rembrantit, fugat e Bahut dhe ëndrrat e kthjellta të Mocartit, krenarinë e bishtit të pubzës në artin e fshatarëve tanë dhe murmurimën e Betovenit, ngjitjen mallëngjyese drejt apogjeve të megjulluara, mezi të kuptueshme në të cilat do të mund të thuhej "unë dhe fati im jemi një..."

Pasi nuk jemi të vetëdijshëm për natyrën e tyre të mirëfilltë, më nuk kemi mundur korrektësisht t'i shfrytëzojmë fuqitë tona shpirtërore; kurrë më ndërmjet nesh nuk do të ngrihet një Betoven ose një Rembrant. Në vend të kësaj, tash e dimë vetëm atë kërkimin pikëllues "të formave të reja të të shprehurit" në art, sociologji, politikë dhe atë luftën hidhëruese ndërmjet parullave rivale dhe parimeve të bazuara cikrimtare; të gjitha makinat dhe rrokaqiejt tanë nuk mund të na ndihmojnë aspak që sërish të vëmë tërësinë e shpirtrave tanë... E megjithatë, a është humbur njëmend përgjithmonë ajo lavdia e humbur shpirtërore e të kaluarës Evropiane? A nuk ka qenë e mundur sërish të përvetësohet diç nga ajo me gjetjen e përgjigjes ç'ka ndodhur me ne?

Ajo që në fillim ka qenë mezi diç më shumë se simpatia për caqe politike të arabëve, për pamjen e jashtme të jetës arabe dhe sigurinë emocionale që e kam vërejtur tek ata, pahetueshëm është ndërruar në diç që ka ngjasuar në kërkim personal. Gjithnjë e më shumë jam bërë i vetëdijshëm për dëshirën e paevitueshme të mësoj ç'është ajo çka qëndron në rrënjën e kësaj sigurie emocionale dhe çka e bën jetën arabe aq tjetërfare nga ajo Evropia-

ne; kurse kjo dëshirë sikur ka qenë fshehtësisht e lidhur për problemet e mia, më intime. Fillova ta kërkoj rastin që do të më jepte shikim më të mirë në karakterin e arabëve, në idetë që i kanë formësuar dhe i kanë bërë shpirtërisht aq tjetërfare prej Evropianëve. Kam filluar intensivisht të lexoj për historinë, kulturën dhe religjionin e tyre. Në zellshmërinë që e kam ndier për zbulim çka është ajo që i lëvizë zemrat e tyre, i përmbushë shpirtat e tyre dhe u jep orientim, sikur kam ndier zellshmërinë të zbuloj fuqitë e fshehta që më lëvizin mua vetë, më përmbushin dhe premtojnë se do të më japin orientim...

## IV. Zëra

-1-

Kalërojmë, kurse Zejdi këndon. Ngrëhinat ranore tash janë më të ulëta dhe më të rralla. Aty-këtu rëra ua lëshon vendin brezave zhuror dhe bazaltit të brishtë, kurse para nesh, larg nga ana jugore, ngrihen konturat gurore të zinxhirit kodrinor: kodra Xhebeli Shamar.

Vargjet e këngës së Zejdit depërtojnë me nebulozitet në përgjumësinë time, por pikërisht ashtu që fjalët më ikin, sikur fitojnë kuptim më të gjerë, më të thellë plotësisht të pavarur për kuptimin e tyre të jashtëm.

Kjo është njëra prej këngëve të kalorësve të deveve që aq shpesh e dëgjoni në Arabi - këngë monotone të cilën e këndojnë njerëzit që kafshët e tyre t'i mbajnë në hap të harmonishëm, të shpejtë, kurse vetë ata mos t'i marrë gjumi - këngë e njerëzve të shkretëtirës të mësuar në hapësira që nuk njohin as kufij as oshëtimë: gjithmonë në shkallën dur në një nivel tonik, i lirë dhe ngapak i ngjirur, duke ardhur thellë prej fytit, me butësi duke u zhdukur në ajër të thatë; frymë shkretëtire e kapur në zërin njerëzor. Askush që ka udhëtuar nëpër vendet shkretinore kurrë nuk do ta harrojë këtë zë. Ai përherë është i njëjtë aty ku është toka e shkretë, ajri i nxehtë dhe gjerë e gjatë i hapur, kurse jeta e ngjeshur.

Ne kalërojmë, kurse Zejdi këndon ashtu, sigurisht, siç ka kënduar babai i tij para tij dhe të gjithë njerëzit e tjerë nga fisi i tij dhe shumë fise tjera me mijëra vite; sepse janë dashur mijëra vjet të formësohen këto melodi monotone, intensive dhe t'u jepet forma përfundimtare. Përkundër muzikës polifone perëndimore, që gati përherë synon të shprehë ndjenjat individuale, këto melodi arabe, me rrjedhën e tyre tonike që përsëritet në mënyrë të amshueshme, duken vetëm si simbol tonik për njohurinë emocionale që shumë njerëz e kanë të përbashkët - të menduara jo të shkaktojnë disponim, por t'ua përkujtojnë përvojat tuaja shpirtërore. Ato janë të lindura shumë herët prej atmosferës shkretinore, ritmeve të erës dhe jetës nomade, ndjenjave të hapësirave të gjera, meditimeve mbi tanishmërinë e amshueshme; dhe siç mbeten gjërat thelbësore të jetës së njeriut përherë të njëjta, këto melodi janë të përhershme dhe të pandryshueshme.

Meloditë e këtilla është vështirë të përfytyrohen në Perëndim, ku polifonia është dukuri jo vetëm e muzikës por edhe e dëshirave dhe ndjenjave njerëzore. Klima e ftohtë, ujërat rrjedhës, vazhdimësia e katër stinëve të vitit; këto elemente i japin jetës aq kuptime të ndryshme dhe aq shumë drejttime saqë njeriu perëndimor duhet doemos të ketë shumë synime dhe, sipas kësaj, shumë nevojë që diçka të punojë, vetëm atë ta bëjë. Ai duhet përherë të krijojë, ndërtojë dhe dominojë kështu që përherë rishtazi të vërtetohet në ndërlíkueshmërinë e formave jetësore të tij; kjo ndërlíkueshmëri e përhershme relative shprehet edhe në muzikën e tij. Prej këndimit melodik perëndimor, me zë që vjen nga kraharori dhe përherë në nivele më të larta, bën fjalë ajo natyrë faustiane e cila bën që njeriu perëndimor shumë të ëndërrojë, shumë të dëshirojë, të synojë pas çdo gjëje me dëshirë të nënshtrijë - por ndoshta edhe të humbë shumë, dhe

humbë dhembshëm. Sepse, bota e perëndimorit është botë historie; përherë lindje, ndodhi, zhdukje. I mungon rehatia e qetësisë; koha është armik të cilin vazhdimisht duhet shikuar me dyshim, kurse tanishmëria asnjëherë nuk bartë zërin e amshueshmërisë...

Arabin e shkretëtirës dhe stepave, nga ana tjetër, peizazhin e tij nuk e shpie në ëndërrime: ai është i mprehtë si dita dhe nuk njih kurrfarë muzgu ndjenjash. E Jashtnja dhe e Brendshnja, Unë dhe Bota nuk janë në kundërshtim me të dhe tërësi kundërshtish ndërmjet veti, por vetëm forma të ndryshme të tanishmërisë së pandryshueshme; me jetën e tij nuk sundojnë frika sekrete, kurse çdoherë kur bën diçka, ai atë e bën nga nevoja e jashtme e jo për atë pse dëshira për sigurimin e brendshëm kërkon aksion. Si rezultat i kësaj, ai nuk ka përparuar në të arriturat materiale aq shpejt sikur perëndimori - por e ka ruajtur shpirtin e tij të plotë.

Sa gjatë, vallë, e pyeta veten gati me rrëqethje fizike, Zejdi dhe populli i Zejdit do të jetë në gjendje ta mbajë shpirtin e tij të bashkuar në takim me rrezikun i cili në mënyrë aq perfide, aq mizore pështjellohet mbi ta? Jetojmë në një kohë në të cilën më Lindja nuk mund të qëndrojë pasive në takim me Perëndimin depërtues. Mijëra forca - politike, shoqërore dhe ekonomike - trokasin në dyert e botës muslimane. Vallë, a do t'i nënshtrohet kjo botë trysnisë perëndimore të shekullit njëzet dhe në këtë proces të humbë jo vetëm format e veta tradicionale por edhe rrënjët e veta shpirtërore?

- 2 -

Gjatë viteve që kam kaluar në Lindjen e Mesme - si një i huaj qëllimpirë prej 1922 deri më 1926, kurse prej atëherë e këndej si musliman me qëllimet dhe shpresat e

botës islame - kam qenë dëshmitar i trysnisë së vazhdueshme Evropiane në jetën kulturore të muslimanëve dhe pavarësinë politike; e kurdoherë që populli mudohej të mbrohej prej kësaj trysnie, opinioni evropian pa përjash-tim rezistencën e tyre e shënonte, në dukje të virgjërisë së lënduar, si ksenofobi".

Evropa gjatë kohë ishte mësuar që në një mënyrë të këtillë harbute ta shkatërrojë tërë atë që ndodh në Lindjen e Mesme dhe ta shikojë historinë e saj rrjedhëse vetëm nga aspekti i sferave të interesit perëndimor. Për-derisa çdokund në Perëndim (jashtë Britanisë) opinioni tregoi mjaft mirëkuptim ndaj luftës irlandeze për pavarë-si ose jashtë Rusisë dhe Gjermanisë për ëndrrën polake për rilindjen kombëtare, asnjëherë kurrfarë mirëkuptimi nuk është treguar ndaj synimeve të njëjta në mesin e muslimanëve. Argument kryesor i Perëndimit përherë është përçarja politike dhe prapambeturia ekonomike e Lindjes së Mesme, kurse çdo intervenim aktiv perëndi-mor autorët e tij e përshkruajnë me hipokrizi kinse ka për qëllim jo vetëm mbrojtjen e interesave legjitime pe-rëndimore, por njëkohësisht edhe sigurimin e përparimit të vetë popujve vendas.

Duke harruar se çdo intervenim nga jashtë, madje edhe ai qëllimmirë, mund vetëm ta pengojë zhvillimin e popullit, perëndimorët që e studiojnë gjendjen në Lindjen e Mesme përherë janë të gatshëm ta injorojnë kërkimin e të drejtave të këtilla. Ata shohin vetëm hekurudha të reja që i ndërtojnë fuqitë koloniale, e jo shkatërrimet e indit shoqëror të tokës; ata numërojnë kilovat-orët e energjisë së re elektrike, por jo edhe goditjet krenarisë kombëtare. Njerëzit e njëjtë të cilët kurrë nuk do ta kishin pranuar misionin qytetërues të Perandorisë austriake si pretekst valid për intervenimin e saj në Ballkan, në mënyrë indul-gjente e pranojnë arsyetimin e ngjashëm në rastin e brita-

nezëve në Egjipt, të rusëve në Azinë Qendrore, francezëve në Marok ose italianëve në Libi. Asnjëherë nuk u ka shkuar në mend se shumë prej të këqijave shoqërore dhe ekonomike prej të cilave Lindja e Mesme duron pasoja të drejtpërdrejta janë pikërisht të këtij interesi perëndimor; dhe se, veç kësaj, intervenimi perëndimor në mënyrë të pashmangshme synon t'i përjetësojë dhe zgjojë përçarjet e brendshme tashmë ekzistuese dhe në këtë mënyrë t'ua bëjë të pamundshme atyre popujve ta gjejnë rrugën e vet.

Këtë kam filluar ta kuptoj për herë të parë në Palestinë në vitin 1922, duke vështruar rolin dyfytirësh të administratës britaneze në lidhje me konfliktin e arabëve dhe cionistëve; kjo m'u bë plotësisht e qartë në fillim të 1923, kur pas udhëtimit me muaj nëpër Palestinë erdha në Egjipt, i cili në atë kohë ishte gati vazhdimisht kundër protektoratit britanez. Shpesh janë hedhur bomba nëpër vendet publike të cilat i vizitonin ushtarët britanezë, kurse përgjigje kanë qenë masat e ndryshme represive - gjykimet ushtarake, burgosjet politike, përndjekjet e udhëheqësve, ndalimi i revistave. Por asnjëra prej këtyre masave, sado e ashpër të kishte qenë, nuk ka mundur ta shuajë dëshirën e popullit për liri. Nëpër tërë popullin egjiptian sikur ka kaluar vala e rënkimit plot afsh. Jo në dëshpërim; ai më tepër ka qenë rënkim entuziazmor që janë zbuluar rrënjët e fuqisë së tij të mundshme vetjake.

Vetëm pashallarët e pasur, pronarët e pasurive të mëdha, ato ditë kanë qenë të pajtuar me qeverinë britaneze. Masat e gjera popullore, duke inkuadruar felahët e mjerë - të cilëve një jutë tokë u dukej si pasuri e madhe për tërë familjen, e kanë ndihmuar lëvizjen për liri. Një ditë shitësit e gazetave rrugës do të bërtitnin: "Të gjithë prijësit e Vafdit janë arrestuar me urdhër të guvernatorit ushtarak", por tanimë ditën tjetër prijësit e ri do t'i zinin vendet e tyre. Zbrazëtirat përherë kanë qenë të plotësuara

rishtazi; uria për liri dhe urrejtja dita - ditës shtoheshin. Kurse Evropa për atë kishte vetëm një fjalë - ksenofobia.

Ardhja ime në Egjipt ato ditë ka qenë pasojë e dëshirës sime që ta zgjeroj fushën e veprimtarisë sime për Frankfurter Zeitungun në vendet e tjera veç Palestinës. Mundësitë nuk i lejonin Dorianit që të financojë një udhëtim të tillë, por kur e pa se dëshira ime është e madhe, më huazoi një sasi të vogël që mjaftonte për të udhëtuar me tren prej Jerusalemit deri në Kajro dhe për një qëndrim dyjavor atje.

Në Kajro e gjeta dhomën e rregulluar në njëfarë rruge, në lagjen ku banonin kryesisht zanatlinjtë arabë dhe tregtarët e vegjël grekë. Zonja e shtëpisë ishte një triestane e moshuar, e lartë, e ushqyer, maloke, e zymtë; pinte verë të rëndë greke prej mëngjesi deri në mbrëmje dhe kalonte prej njërit disponim në tjetrin. Natyrën e kishte të ngutshme, plot afsh, kurse dukej se kurrë nuk e ka gjetur vetveten; por ndaj meje sillej mirë që të ndihem mirë në praninë e saj.

Përafërsisht pas një jave, paratë e mia filluan të harxhohen. Pasi nuk doja aq shpejt të kthehem në Palestinë dhe për shkak të sigurisë së shtëpisë së dajës tim, fillova të interesohem për të siguruar mjete të tjera për ekzistencë.

Shoku im prej Jerusalemi, dr. Haani, ma kishte dhënë porosinë e shkruar për njëfarë njeriu afarist në Kajro. Shkova tek ai që të më japë ndonjë këshillë. U tregua se ai është shpirtmirë, holandez i dashur me interesim intelektual që larg e kalon fushën e tij personale të aktiviteteve. Prej letrës së Jacob Haanit e mori vesh se jam korrespondent i Frankfurter Zeitungut; e kur ia tregova, në kërkesë të tij, disa artikuj që sapo i kisha përgatitur, ai i çoi vetullat nga habia:

"Më thuaj, sa vjet i ke?"

"Njëzet e dy".

"Atëherë, të lutem, më thuaj edhe diçka: kush ju ka ndihmuar në këta artikuj? Haani?"

E bëra buzën në gaz. "Natyrisht jo. I kam shkruar vetë. Unë përherë punën time e bëj vetë. Por pse dyshoni në këtë?"

Ai e tundi kokën pak i habitur: "Mirëpo kjo është e çuditshme... Ku jeni aftësuar të shkruani gjëra të këtilla? Si arrini që në gjysmë të fjalisë t'u jepni gjërave gati kuptim mistik të cilat në mënyrë të qartë janë aq të përditshme?"

Kam qenë i përkdhelur pamasë, kurse vetërespektimi im u shtua në pajtim me të. Gjatë bisedës sonë u tregua se miku im i saponjoftuar nuk kishte vend të lirë në punën e vet individuale, por, shpresoja, sikur të kishte mundësi të më vendoste te ndonjë firmë egjiptiane me të cilën punon.

Zyra ku më dërgoi ai ishte në njërën prej lagjeve të vjetra të Kajros, jo shumë larg prej vendit ku banoja unë; rrugicë e ngushtë e ndytë anembanë me shtëpi të dikurshme të aristokratëve tash të shndërruara në zyra dhe banesa të lira. Punëdhënësi im i ardhshëm, egjiptiani i moshuar, tullac, me fytyrë lëkurërrjepur të pjekur me kohë, kishte nevojë për nëpunës me honorar që do ta udhëhiqte korrespondencën franceze; arrita ta bindë se do të mund ta kryej detyrën edhe pse nuk kisha kurrfarë përvoja pune. Shpejt u morëm vesh. Do të punoja vetëm tri orë në ditë; pagesa do të ishte ekuivalent kësaj e ulët, por e mjaftueshme ta paguaj qiranë dhe të jetoj në kohëzgjatje të pacaktuar me bukë, qumësht dhe ullinj.

Ndërmjet banesës sime dhe zyrës së punës ishte pjesa e qytetit të Kajros me shumë bordelë - labirint i ngatërruar i rrugicave ku prostitutat e vogla dhe të mëdha i kalonin ditët dhe netët e tyre. Pasdite, kur shkoja në punë, rrugicat ishin të zbrazëta dhe mbretëronte qetësi. Në hije të ndonjë strofke mund të shihej trupi i gruas i shtrirë shkujdes-

shëm, pranë tavolinave të vogla, para kësaj apo asaj shtëpie, vajzat rehat pinin kafe me mjekroshët seriozë dhe bisedonin, siç dukej me plot seriozitet, mbi gjërat për të cilat do të thoja se janë larg çdo përmallimi dhe harrese fizike.

Mirëpo, në mbrëmje, kur kthehesha në shtëpi, lagjja ishte më e zgjuar se kurdoherë tjetër, oshëtinte me akordet e buta të lahutave dhe daulleve arabe dhe qeshjet e grave. Sikur të shkonit nën shkëlqimin e llambave të shumta elektrike dhe të fenerëve me ngjyra të ndryshme, në çdo hap do t'ju pështillej dora e butë rreth qafës; dora mund të ishte e errët ose e bardhë - por ajo përherë vringëllonte me zinxhirë dhe bylyzykë të artë e të argjendte dhe përherë e erodur me mushk, parfum të rëndomtë dhe trupin e ngrohtë njerëzor. Duhej të jesh shumë i vendosur për t'u liruar prej të gjitha këtyre thirrjeve dhe përqaftimeve të buzëqeshura ja habibi (ah i dashur) dhe sadatak (fati yt). Duhej të kalonit ndërmjet ekstremiteteve vezulluese që më shumë kanë qenë lakmuese dhe tërheqëse për shikim dhe ju përmallonin me rrumbullakësitë e tyre motivuese. I tërë Egjipti ndeshet me ty; Maroko, Algjeria si dhe Sudani dhe Nubia, pastaj Arabia, Armenia, Siria, Irani... Njerëzit në kostume të gjatë, të mëndafshit rrinin ulur njëri pranë tjetrit në bankat përgjatë mureve të shtëpisë, të përmalluar këndshëm, duke qeshur, duke iu lëshuar fjalë vajzave ose qetë duke thithur nargjilët e tyre. Ata nuk ishin të gjithë mushterinj: shumë prej tyre kishin ardhur të kalojnë një-dy orë të rehatshme në disponimin e rrethit jokonvencional argëtues... Ndonjëherë duhej patjetër të tërhiqesh para dervishit zhelan nga Sudani, i cili i këndonte këngët e tij lypësi me fytyrë në dalldi dhe me duart e zgjatura drejt. Retë e temjanit prej kemtari që e lëkund shitësi i parfumeve në rrugë ua puhit fytyrën. Ndonjëherë dëgjoni duke kënduar në kor dhe filloni të kuptoni domethënien e disa zëra-

ve valëvitës arabë... Sërish prej fillimit dëgjoni çurlikimën e pastër të zërave të kënaqësisë - kënaqësisë ndijore të këtyre vashave (sepse ato pa dyshim kënaqeshin) në fustanët e tyre prej mëndafshit të hollë, ajdës, pëlhurës ose kumashit me ngjyrë të kaltër të çelë, të verdhë, të kuq, të gjelbër, të bardhë, të shkëlqyer ari - kurse qeshja e tyre sikur pupas me hapa të vegjël maceje nëpër trotuarin prej kalldrëmi, duke u ngritur dhe ulur, e pastaj duke u rritur sërish me gojë tjera...

Si mundnin vetëm të qeshen këta egjiptianë! Sa të gëzueshëm ata shkonin rrugëve të Kajros duke ecur plot entuziazëm në galabitë e tyre të gjata, që u ngjanin këmishave, me vija në të gjitha ngjyrat e ylberit, pa brenga, pa djallëzime - kështu që mund të mendohej se e gjithë varfëria, pakënaqësia dhe trazirat politike merren seriozisht vetëm në kuptimin relativ. Përmallimi rrëmbyes, shpërthyes i këtyre njerëzve sikur përherë ishte i gatshëm që, pa kurrfarë kalimi të dukshëm, t'ia lëshojë vendin kthjelltësisë së përkryer dhe madje gjakftohtësisë, sikur asgjë nuk ka ndodhur kurrë, kurrëgjë nuk ka të keqe. Për shkak të kësaj, shumë Evropianët i kanë konsideruar (e sigurisht i konsiderojnë edhe tash) arabët sipërfaqësorë. Bile edhe atëherë, në fillim, e kam kuptuar se kjo urrejtje ndaj arabëve doli nga përpjekjet e Perëndimit t'i mbivlerësojë përmallimet të cilat duken të thella, kurse ta shpallë sipërfaqësore tërë atë që është e lehtë, e gjallë, e papeshuar. Arabët, e kam nuhatur, kanë mbetur të lirë prej atyre trysnive dhe tendosjeve të brendshme aq karakteristike për Perëndimin. Atëherë, si mund t'i zbatojmë kriteret tona në ta? Po qe se janë dukur sipërfaqësorë, ajo ndoshta është për atë se përmallimet e tyre pa vështirësi derdhen në sjelljet e tyre. Mbase edhe ata, nën trysinë e "perëndimizimit", gradualisht do ta humbin lumturinë e drejtpërdrejtë të kontaktit të vet me realitetin; sepse edhe pse ky ndikim perëndimor ka

vepruar në shumë mënyra si motivacion dhe element mbarësues në mendimin bashkëkohor arab, ai në mënyrë të pashmangshme ka synuar që tek arabët të shkaktojë problemet e njëjta të mundimshme që mbizotëronin me skenën shpirtërore dhe shoqërore të Perëndimit.

Përtej rrugës së shtëpisë sime, aq afër saqë gati keni mund ta arrini, ka qenë një xhami me minare të vogël prej të cilës pesë herë në ditë jehonte thirrja për namaz. Njeriu me turban të bardhë do të paraqitej në galeri, i çonte duart e veta dhe fillonte: "Allahu ekber - Allahu është më i madhi. Dëshmoj se Muhammedi është i dërguar i Zotit..." Ashtu si rrotullohej ndaj katër anëve të botës, toni i zërit të tij ngjitej lart, rritej në melodi të qartë, duke i nxjerrë zërat e thellë, me fyt, të gjuhës arabe, duke lëvizur, duke përparuar dhe duke u tërhequr. Zëri ka qenë bariton i thellë, i butë dhe u fuqishëm, i aftë për largësi të mëdha; por mund të vërehej se dalldia e bënte aq të bukur, e jo arti.

Kjo thirrje e muezinit ishte motiv i ditëve dhe mbrëmjeve të mia në Kajro - pikërisht ashtu siç ka qenë edhe në qytetin e vjetër të Jerusalemit dhe ka qenë e caktuar të mbetet në të gjitha udhëtimet e mia të mëvonshme nëpër tokat muslimane. Kumbonte çdokund njësoj, përkundër të gjitha dallimeve të dialektit dhe intonimit që kanë mund të jenë të qarta në të folmen e përditshmërisë njerëzore; zëri i njëjësuar i cili më ka shtyrë ta kuptoj, ato ditë në Kajro, sa i thellë është uniteti i brendshëm i të gjithë muslimanëve, kurse sa artificiale dhe të parëndësishme janë vijat kufizuese midis tyre. Ata ishin një në mënyrën e vet të menduarit dhe të gjykuarit çka është e drejtë dhe çka është e shtrembët, dhe një në të koceptuarit e vet në lidhje me atë se në çka përbëhet jeta e mirë.

Më dukej se për herë të parë kam hasur bashkësinë në të cilën afërsia midis njerëzve nuk është pasojë rastësie e interesave të përbashkëta racore dhe ekonomike,

por diç shumë më e thellë dhe shumë më stabile; afërsia e pikëpamjeve të përbashkëta që i ka mënjanuar të gjitha pengesat e vetëmsisë midis njerëzve.

Në verë të 1923, i pasuruar me perceptimin më të mirë të jetës dhe politikës së Lindjes së Mesme, u ktheva në Jerusalem.

Përmes shokut tim të mirë Jacob Haanit u njoftova me Emirin Abdullah nga Transjordanianë fqinjë, i cili më thirri ta vizitoj vendin e tij. Atje për herë të parë kam parë vendin e vërtetë beduinas. Kryeqyteti, Amani, është ndërtuar në rrënimet e Filadelfisë, koloni greke e Ptolemeut Filadelfus, që në atë kohë ka qenë qytezë me mezi diç më tepër se gjashtë mijë banorë. Rrugët e tij ishin plot me beduinë, beduinë të vërtetë prej shkretëtirës së lirë, e cila rrallë shihej në Palestinë, luftëtarë të lirë dhe kultivues të deveve. Kuajt e bukur galoponin rrugëve; çdo njeri ishte i armatosur, duke bartur kamë të ngjeshur për brezi dhe pushkë në krahë. Qetë e mbrejtur të vendasve që aty u vendosën Pasi rusët e nënshtruan atdheun e tyre në shekullin nëntëmbëdhjetë, rëndë tërhiqeshin nëpër bazar, i cili, edhe pse mjaft i vogël, ishte plot tollovi dhe përzierje që i ka hije një qyteti shumë më të madh.

Mbasi nuk kishte ndërtesa të përshtatshme në qytet, Emiri Abdullah atëherë jetonte në kamp nën tendë, në bregoren prej së cilës shtrihej shikimi drejt Amanit. Tenda e tij ishte diç më e madhe se të tjerat dhe përbëhej prej disa dhomave të formuara me ndihmën e zdatkut prej pëlhurës së tendës, jashtëzakonisht të thjeshta. Në njërën prej tyre lëkura e zezë e ariut paraqitte shtratin në dysheme në qoshe; në dhomën pritëse disa shala devesh mjaft të bukura me mollëza të skalitura argjendi shërbenin si mbështetje kur do të uleshin në qilim.

Kur me dr. Riza Teufik-beun, këshilltarin kryesor të Emirit, hyra në tendë e takova vetëm shërbëtorin e zi, boll

mirë të veshur në armaç, me kamë ari të ngjeshur për brezi. Riza Teufik-beu ishte turk, dikur profesor universiteti, kurse gjatë tre vjetëve, para Kemal Atatürkut, ka qenë ministër për arsim në qeverinë turke. Emiri Abdullah, më tha ai, do të kthehet për disa minuta; pikërisht në këtë moment është duke kuvenduar me disa kryeparë beduinë mbi invazionin e fundit prej Nexhdit në Transjordaninë Jugore. Ata vehabitë prej Nexhdi, më sqaroi dr. Rizau, në Islam lozin rolin e ngjashëm me rolin e reformatorëve puritanë në botën kristiane, Pasi ashpër e kundërshtojnë çdo adhurim të shenjtorëve dhe shumë besëtytni mistike të cilat janë futur në Islam gjatë shekujve; ata po ashtu janë armiq të papajtueshëm me familjen sherifiane, kryepar i së cilës ka qenë babai i Emirrit, mbreti Husein nga Hixhazi. Sipas mendimit të Riza Teufik-beut, pikëpamjet religjioze vehabite nuk mund të hedhen lehtë; ato, në realitet, më shumë i janë afruar frymës kur'anore se sa pikëpamjet që mbizotërojnë në masat e shumicës së vendeve tjera muslimane, andaj për këtë arsye gjatë kohës mund të kenë ndikim të volitshëm në zhvillimin kulturor islam. Fanatizmi skajor i këtyre njerëzve, megjithatë, ngapak ua ka rënduar muslimanëve tjerë që plotësisht ta vlerësojnë lëvizjen vehabite, kurse kjo mungesë, theksoi ai, mund të jetë e mirëseardhur për disa, për të cilët uniteti i mundshëm i popujve muslimanë është rrugëdalje e mrekullueshme.

Diç më vonë hyri Emiri - njeri i moshës katërdhjetë vjeçe, me shtat mesatar, me mjekër të shkurtër bjonde - duke ecur butë në papuçet e vogla, të zeza prej lëkurës së lyster me vernik, i veshur me tesha të lehta arabe prej mëndafshit të bardhë shushuritës me gati abajën e bardhë të tejdukshme prej leshi mbi to. Ai tha:

- Ehlen ve sehlen, - dhe kjo ishte hera e parë që kam dëgjuar këtë përshëndetje të këndshme arabe.

Në personalitetin e Emirit Abdullah kishte diçka tërheqëse dhe thuaja mahnitëse, njeri me kuptim vizuel për humor, me ngrohtësi në shprehje dhe me gatishmëri për spirituozitet. Nuk ka qenë vështirë të shihet pse ishte aq i dashur në atë kohë te populli i tij. Edhe pse shumë arabë nuk ishin të kënaqur me rolin e tij në kryengritjen kundër turqve të cilën e udhëhoqi familja Sherif, e që e nxitën britanikët, andaj këtë e konsideronin tradhti ndaj muslimanëve, ai prapëseprapë arriti njëfarë autoriteti duke përkrahur çështjen arabe kundër cionizmit; tashmë duhej të vijë dita kur kthesat dhe bastardimet në politikën e tij do ta bëjnë emrin e tij që të urrehet në tërë botën arabe.

Duke pirë kafe prej filxhanëve të vegjël që na i ofroi shërbëtori i zi, bisedonim - me ndihmën e kohëpaskohshme të dr. Rizait, i cili rrjedhshëm e fliste frengjishten - për vështirësitë administrative në këtë vend të ri të Transjordanisë, ku secili ishte mësuar të mbajë armë dhe t'iu nënshtrohet vetëm ligjeve të fisit të vet. "Por", - tha Emiri, - "arabët kanë mjaft arsye të shëndoshë; bile edhe beduinët tash fillojnë ta kuptojnë se duhet patjetër t'i lëshojnë rrugët e vjetra arbitrare po qe se dëshirojnë të jenë të lirë prej dominimit të huaj. Armiqësitë ndërfishnore për të cilat është dashtë aq shpesh të dëgjosh tash gradualisht qetësohen".

Filloi t'i përshkruajë fiset e padëgjueshme, shqetësuese beduine që grinden në mes vete nën pretekstin më të vogël. Armiqësitë e tyre fisnore shpeshherë kanë vazhduar brez pas brezi, kurse ndonjëherë janë përcjellë prej babës në djalin, madje edhe me shekuj, duke shkaktuar gjakderdhje dhe hidhërimet e reja Pasi shkaku fillestar ishte harruar. Ka qenë vetëm një rrugë që të arrihet deri te zgjidhja paqësore: nëse djaloshi i fisit dhe i familjes së viktimës së fundit e grabitë një vajzë prej fisit dhe familjes së fajtorit dhe martohet me të. Gjaku i natës martesore - gjaku i fisit të vrasësit - simbolikisht, dhe përfundimisht,

shpaguean gjakun që është derdhur në vrasje. Ka ndodhur që dy fise gati janë zhytur në hakmarrjen e gjakut e cila ka vazhduar me gjenerata duke shterur fuqitë e të dy palëve. Në rastin e tillë grabitjen shpeshherë e ka rregulluar ndërmjetësi nga fisi i tretë.

"Unë kam vepruar bile më mirë se kjo", - më tha Emiri Abdullah. "Kam themeluar 'komisione të drejta për armiqësinë e gjakut' të përbëra prej njerëzve besnikë të cilët udhëtojnë nëpër vendin tonë dhe rregullojnë rrëmbime simbolike dhe martesë midis fiseve armiqësore. Por", - këtu sytë e tij shkëlqyen, - "përherë ua kam theksuar anëtarëve të komisioneve të jenë shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e vajzës, sepse nuk do të dëshiroja të vijë deri te armiqësia e brendshme familjare për shkak të dëshpërimit të mundshëm të dhëndrit..."

Një djalosh dymbëdhjetëvjeçar u paraqit pas stomi, vrapoi nëpër dhomën e muzgët të tendës me hapa të shpejtë pa zhurmë dhe kërcëu pa zengji mbi kalin që ngruhej, jasht tendës, derisa shërbëtori e mbante të gatshëm; ai ishte Talali, djali më i madh i Emirrit. Në trupin e tij të hedhur, në kërcimin e tij të shpejtë mbi kalë, në sytë e tij shkëlqyes e pashë sërish atë lidhje të drejtpërdrejtë me jetën time personale e cila aq shumë e ndanë arabin nga e gjithë ajo që kam ditur në Evropë.

Kur e hetoi admirimin tim të haptë ndaj djalit të tij, Emiri tha: "Ai, si çdo fëmijë tjetër arab, rritet vetëm me një mendim: liria. Ne arabët nuk konsiderojmë se jemi pa të meta dhe gabime; por ne dëshirojmë t'i pranojmë gabimet tona para vetes sonë dhe kështu mësohemi t'iu shmangemi atyre - pikërisht ashtu sikur rritet druri duke u rritur ose sikur uji duke rrjedhur e gjenë drejtimin e kahës së vet. Ne nuk dëshirojmë të na udhëheqin nga urtësitë ata që atë vetë nuk e posedojnë - ata që kanë vetëm

fuqi, topa, të holla dhe vetëm dinë si t'i humbin shokët që kanë mundur shumë lehtë t'i mbajnë..."

Nuk kam pasur për qëllim të qëndroj përherë në Palestinë; përsëri më ndihmoi Jacob Haani. meqë edhe vetë ka qenë gazetar i pranuar autoritativ, ka pasur shoqëri në mbarë Evropën. Rekomandimi i tij më siguroi kontratën me dy revista të vogla; njëra në Holandë, kurse tjetra në Zvicër, për një varg artikujsh që do të paguheshin në para të Holandës, në realitet, të Zvicrës. Pasi këto ishin revista krahinore pa autoritet të madh, nuk kanë mund t'i lejojnë vetes të paguajnë honorar të majmë; por për mua, nevojat e të cilit ishin të thjeshta, paratë që i pranoja prej tyre ishin plotësisht të mjaftueshme ta financojnë udhëtimin tim të planifikuar nëpër Lindjen e Afërt.

Së pari doja të shkoj në Siri; mirëpo, pushteti francez, që kohë më parë ishte vendosur aty midis popullit armik, nuk kishte dëshirë t'i japë vizë austriakut "ish - armikut". Kjo ishte një goditje e rëndë, por nuk kam mund të bëj asgjë; kështu që vendosa të shkoj në Haif dhe atje të hypi në anije për në Stamboll, udhëtim ky që gjithsesi ishte i përfshirë në programin tim.

Në tren prej Jerusalemi deri në Haif më goditi një fatkeqësi e madhe; e humba pallton me kuletën dhe pasaportën. E gjithë ajo çka më mbeti ishin ca para të imta argjendi në pantallone. Për udhëtimin në Stamboll, në rrethana të tilla, nuk mund të bëhej fjalë pa pasaportë dhe pa të holla. Më mbeti të kthehem në Jerusalem vetëm me autobus; biletën e udhëtimit do të duhej ta paguaj pas kthimit me para të huazuara, si zakonisht, prej Dorianit. Në Jerusalem duhej patjetër të pres me javë që të marr pasaportë tjetër prej konsullatës austriake në Kajro (sepse atëherë nuk ka pasur në Palestinë) dhe ato pak para që duhej të më arrinin prej Holande dhe Zvicre.

Ashtu edhe ndodhi, të nesërmen në mëngjes u gjeta në stacionin e autobusëve në paralagjen e Haifes. Bisedimet rreth pagesës së biletës qenë përfunduar. Kishte edhe një orë që autobusi të nisej, dhe që ta harxhoj kohën, ecja lart-poshtë përgjatë rrugës, thellë i pikëlluar në vetveten dhe fatin i cili më detyronte në një tërheqje të tillë degraduese. Pritja është përherë gjë e keqe, kurse mendimi rreth kthimit në Jerusalem, i ngadhënjyer, me bishtin e kërrusur, ishte mjaft i dhimbshëm - aq më tepër nga se Doriani ishte përherë i dyshimtë në aspektin e aftësive të mia se do t'i realizoj planet e mia me një sasi aq të mjerueshme të parave. Veç kësaj, tash nuk do ta shihja Sirinë, kurse Zoti e di se a thua ndonjëherë sërish do të vija në këtë vend të botës. Natyrisht, gjithmonë ka pasur mundësi që më vonë Frankfurter Zeitungu ta financojë udhëtimin tjetër në Lindjen e Mesme, kurse një ditë francezët do të mund t'ua hiqnin ndalesën ish - armiqve; por kjo nuk ishte e sigurt, kurse në ndërkohë unë nuk do ta shihja Damaskun... Pse, e pyeta veten i hidhëruar, më është ndaluar mua Damasku?

A thua me të vërtetë ka qenë i ndaluar? Natyrisht - nuk ka pasaportë, nuk ka para. Por, a thua do të ishte absolutisht e domosdoshme të kihet pasaportë dhe para...?

Me të arritur këtu në mendimet e mia, befasisht u ndala. Do të mund, sikur të kesh mjaft guxim dhe duke shfrytëzuar mikpritjen e fshatarëve arabë, të udhëtosh në këmbë; ndoshta do të mund disi të kalohej kufiri fshehurazi duke mos u brengosur për pasaportat dhe vizat...

Para se të isha i vetëdijshëm për këtë, vendimi që marrë: do të shkoj në Damask.

Mjaftuan disa çaste që atyre të autobusëve t'ua sqaroj se e kam ndërruar mendimin dhe se nuk shkoj në Jerusalem. Më duhej edhe aq kohë që t'i ndërroj teshat dhe të veshi tesa të kaltra pune dhe kufinë arabe

(mbrojtjen më të mirë të mundshme prej diellit arab); ta rrasi në trastë atë më të domosdoshmen dhe ta rregulloj që trasta ime t'i dërgohet me kundërpagesë Dorianit. Pastaj u nisa në udhëtimin tim të gjatë për në Damask.

Ndjenja e pashmangshme e lirisë e cila më përmbushte nuk mund të dallohej prej lumturisë. Kisha vetëm ca para të imta në xhep. U nisa në një punë ilegale e cila mund të më çonte në burg. Problemi i kalimit të kufirit ishte para meje pasiguri e paqartë; çdo gjë kam vënë në rrezik të shkathtësisë sime, por vetëdija se çdo gjë kam vënë në një letër më bënte të lumtur.

Kam shkuar rrugës drejt Galilesë. Pasdite rrafshina e Esdrelonit shtrihej në të djathtë nën mua, e ngjyrosur lara-lara me dritë dhe hije. Kalova nëpër Nazaret dhe para se të më zërë nata arrita në një katund arab në hije të drurit të biberit dhe selvisë. Para dyerve të shtëpisë së parë rrinin ulur disa burra dhe gra. U ndala, pyeta se a është kjo Er-Rajna dhe pasi pranova përgjigje pozitive pikërisht desha të nisem kur një grua më thirri:

"Zotëri, a nuk do të freskohesh?" - dhe, sikur ia qëllloi se jam i etshëm, ma zgjati shtambën me ujë të ftohtë. Mbas piva derisa u ngopa, njëri prej burrave, sigurisht burri i saj, më pyeti:

"A dëshiron ta ndash bukën me ne dhe ta kalosh natën te ne?"

Nuk më pyetën se kush jam, ku shkoj dhe çka punoj, kalova natën tek ata si musafir i tyre.

Të jesh musafir i ndonjë arabi - madje edhe fëmijët e shkollës dëgjojnë për atë në Evropë. Të jesh musafir i ndonjë arabi do të thotë të hyshë për disa orë, për një kohë, me të vërtetë dhe plotësisht, në jetën e njerëzve të cilët dëshirojnë të bëhen vëllezërit dhe motrat tua. Kjo nuk është vetëm traditë fisnike që u mundëson arabëve të bëhen mikpritës në një mënyrë aq të përzemërt; kjo

është liria e tyre e brendshme. Ata janë aq të lirë prej dyshimeve ndaj vetvetes saqë lehtë mund t'ia hapin jetët e tyre njeriut tjetër. Nuk kanë nevojë për kurrfarë sigurie të rrejshme të mureve të cilët në Perëndim çdokush i ndërton midis vetes dhe fqit të tij.

Darkuam së bashku, burrat dhe gratë, duke qëndruar ulur këmbëmbledhur në hasër rreth një sahani të madh të mbushur me qull prej gruri të bluar trashë me tëmbël. Nikoqirët e mi shkëputnin copa të vogla prej pogeçave të mëdha të bukës, si letër të holla, me të cilat në mënyrë të shkathët e rrëmbenin qullin bile edhe duke mos e prekur me gishtat e tyre. Mua më dhanë lugë; por unë e refuzova dhe u mundova, jo pa sukses, dhe qartë duke i kënaqur shokët e mi, ta imitoj mënyrën e tyre të vetme, mënyrën e hajeve fisnike.

Kur u shtrimë të flemë - dymbëdhjetë veta në një dhomë të vetmen - i zgurdullova sytë në trerët e drunjtë mbi mua në të cilët qëndronin varur vargjet e biberëve të thatë dhe të patëllxhanëve të zi, në separetë e shumënumërta në mure me gjërat e nevojshme prej bronci dhe dheu të kuzhinës, në trupat e burrave dhe grave që flejnë dhe e pyeta veten se a thua edhe në shtëpinë time do të mund të ndjehesha ndonjëherë më si në shtëpi.

Në ditët vijuese, malet judaïke sikur ndryshku të zeza, me hijet e tyre të përhimta në të kaltër dhe ngjyrë vjollce, shkallërisht kaluan në bregore më të hareshme dhe më të pasura të Galilesë. Burimet dhe përrenjtë papritmas filluan të paraqiten. Vegjetacioni filloi të bëhet më i pasur. Në grupe paraqiten ullinj në kurora të pasura dhe selvi të larta, të errëta; lulet e fundit të verës ende mund të shiheshin nëpër shpatiet e kodrinave.

Ndonjëherë shkoja me grahësit e deveve dhe kënaqesha në ngrohtësinë e tyre të rëndomtë; pinim ujë prej mataresë sime, thithnim cigaren së bashku, pastaj vazh-

doja vetë. Netët i kaloja në shtëpitë arabe dhe me ta haja bukë. Me ditë kam shkelur nëpër gurrën e letargjisë rreth liqenit Hul i cili është sikur pasqyrë prej metali. Mjegulla e hollë ngjyrë argjendi, e skuqur butë prej rrezeve të diellit të mbrëmjes, qëndronte pezull mbi ujë. Pranë brigjeve jetonin peshkatarët arabë nëpër kasolle të ndërtuara prej hasrave të kallamit të mbështjellë dobët rreth skeletit prej degëve. Ishin mjaft të varfër - por nuk dukej se ju duhej diçka më tepër se kasollet e tyre të tejdukshme, ca tesha të zbardhura në supet e tyre, ca grushta grurë që të bëjnë bukë dhe peshq që vetë i gjuajnë; e prapëseprapë, si duket, kanë mjaft t'i ofrojnë udhëtarit të hyjë dhe të hajë me ta.

Pika më veriore e Palestinës ishte kolonia hebraike Metulla e cila, siç kam qenë i njoftuar më parë, ka qenë një lloj zone kufitare ndërmjet Palestinës britanike dhe Sirisë franceze. Në bazë të marrëveshjes ndërmjet dy qeverive, kjo dhe dy koloni fqinje është dashur së shpejti t'i bashkangjiten Palestinës. Gjatë kohës së atyre disa javëve kalimtare Metullën nuk e mbikëqyrte në mënyrë efikase asnjëra qeveri, prandaj më dukej vend ideal prej të cilës mund të depërtoj në Siri. Tashmë vonë e kam marrë vesh se pasaportat i kërkojnë prej udhëtarëve vetëm në rrugët kryesore. Më thanë se kontrolli sirian është mjaft rigoroz; është praktikisht e pamundshme të arrish larg e të mos ju ndalin xhandarët. Pasi Metulla zyrtarisht ende konsiderohej pjesë e Sirisë, të gjithë banorët e moshërritur, sikur edhe tjetërkund në vend kanë letërnjoftime që ua jep pushteti francez. Puna ime parësore ka qenë që ta gjej një letër të tillë për vetë.

Me kujdes jam informuar dhe më në fund më sollën deri te shtëpia e një njeriu i cili do të mund të jetë i gatshëm të heq dorë prej letërnjoftimit të vet për kompensimin e caktuar. Ai ishte trupmadh, tridhjetëvjeçar dhe ashtu i përshkruar në dokumentin e zhubrosur dhe të

përlyer që e nxori prej xhepit në kraharor; por Pasi në të nuk kishte fotografi, problemi nuk ishte i pazgjidhshëm.

"Sa kërkon për atë?", - e pyeta unë.

"Tri funta".

Prej xhepit i mora të gjitha paratë e metalta që i kisha dhe i numërova: kishte pesëdhjetë e pesë piasterë, do të thotë diç më tepër se gjysmë funte.

"Kjo është e gjithë çka kam", - i thash, - " e Pasi duhet patjetër të mbaj diç për udhëtimin e mëtejshëm, nuk mund t'ju jap më tepër se njëzet piasterë" (që saktësisht përbënin të pesëmbëdhjetën e asaj që ai kërkoj).

Pas pazarllëkut disaminutësh u morëm vesh për tridhjetë e pesë piasterë dhe dokumenti u bë i imi. Përbëhej prej fletës së shtypur me dy kolona - njëra franceze e tjetra arabe - ku ishin të futura të dhënat gjegjëse me të zezë në vijat e vizatuara. Përshkrimi individual nuk më brengoste shumë sepse, siç është zakon te përshkrimet e tilla, ai ishte në mënyrë të shkëlqyeshme i papërcaktuar. Por, vjetët ishin të futura: tridhjetë e nëntë - derisa unë kisha njëzetetë vjet, kurse dukej se kam njëzet. Madje edhe polici më i pakujdesshëm menjëherë do ta hetonte mospajtimin; andaj duhej ndryshuar vjetët e regjistruara. Së paku të ishin regjistruar vetëm në një vend, ndryshimi nuk do të ishte aq i rëndë; por për fat të keq ishin të regjistruara edhe frëngjisht edhe arabisht. Me gjithë kujdesin më të madh kam arritur falsifikimin më të pabesueshëm; çdokush me sy në kokë do ta kishte të qartë se të dhënat në të dy kolonat janë të ndryshuara. Mirëpo nuk kisha rrugëdalje tjetër. Duhej patjetër të mbështetem në fatin tim dhe pakujdesinë e xhandarëve.

Të nesërmen herët në mëngjes shoku im i punës më përcolli deri te gryka e malit pas fshatit, m'i tregoi disa shkëmbinj në largësi prej disa qindra metrash dhe tha: "Atje është Siria".

Kalova nëpër grykën e malit. Edhe pse ishte herët, ishte shumë nxehtë. Patjetër është nxehtë edhe për plakën arabe e cila qëndronte ulur nën dru afër shkëmbinjve pas të cilëve shtrihej Siria; më thirri me zë të dobët, të ngjirur:

"A do t'i japësh, biro, një hurbë ujë plakës?"

Ia dërgova mataren që sapo e kisha mbushur dhe ia dhash. Piu me makutëri e pastaj ma ktheu duke thënë:

"Zoti të bekoftë, biro, Ai të ruajt dhe të çoftë atje ku të do zemra".

"Ju falemnderit, loke, nuk dëshiroj më tepër asgjë". Kur u ktheva dhe e shikova atë, e pashë se si buzët e plakës lëvizin sikur gjatë faljes dhe ndjeva një ngazëllim të çuditshëm.

Arrita deri te shkëmbinjtë dhe i kalova; tash ndodhesha në Siri. Lugina e gjerë, lakuriqe shtrihej para meje; larg në horizont i pashë konturat e drunjve dhe diç që ngjasonte në shtëpi; ai duhet të jetë qyteti Benias. Nuk më pëlqeu pamja e kësaj lugine e cila nuk kishte as drunj as shkurre pas të cilave do të mund të fshihej, kurse kjo, aq afër kufirit, lehtë mund të ishte e nevojshme. Por nuk kishte rrugëdalje tjetër. Ndjehesha sikur që ndjehemi ndonjëherë në ëndërr në të cilën duhet të shkojmë lakuriq nëpër rrugën plot njerëz...

Ishte gati dreka kur arrita deri te një përrua që e ndante luginën më dysh. Kur u ula t'i zbathi këpucët dhe çorapët, i pashë në largësi katër kalorës që vinin drejt meje. Me pushkë mbi supe, dukeshin të kobshëm si xhandarë. Ata ishin xhandarë. Nuk kishte kurrfarë kuptimi të mundohem të ikë; në këtë mënyrë e qetësoja veten se do të ndodhë ajo çka duhet patjetër të ndodhë. Po që se më kapin tash, me siguri do të më japin disa goditje me kondak pushke dhe do të më përcjellin prap deri te Metulla.

E kalova përroin, u ula në anën tjetër të tij dhe fillova ngadalë t'i fshij këmbët duke pritur xhandarët të afro-

hen më afër. Ata erdhën dhe shikuan nga unë me dyshim, sepse, edhe pse isha i veshur me tesha arabe, ishte e qartë se jam evropian.

"Prej nga vjen?", - më pyeti vrazhdë njëri prej tyre arabisht.

"Prej Metulle".

"Ku shkon?"

"Në Damask".

"Pse shkon?"

"Ashtu, udhëtim për t'u argëtuar".

"A ke ndonjë dokument?"

"Natyrisht..."

E nxora letërnjoftimin tim, kurse zemra m'u ngjit në fytyrë. Xhandari e hapi dokumentin dhe e shikoi - kurse zemra ime u kthye në vend dhe filloi sërish të rrahë; e pashë se dokumentin e mban mbrapsht, qartë se është i paafatë ta lexojë... Dy ose tri vula zyrtare të mëdha qartë e kënaqën sepse ai me mërzi e paloi dhe ma ktheu.

"Po, në rregull është. Shko".

Në moment ndjeva një dëshirë që t'ia jap dorën, por pastaj mendova se më mirë është që marrëdhëniet tona të mbeten rreptësisht zyrtare. Të katërtit i kthyen kuajt dhe shikuan, kurse unë e vazhdova rrugën time.

Te Beniasi e humba rrugën. Ajo që në hartën time ishte e përshkruar si rrugë për automobilë u tregua si rrugë mezi e dukshme që gjarpëronte nëpër shkretëtirë, tokë moçalike dhe nëpër përrenj, kështu që më në fund u zhdruk plotësisht te disa shkurre të mbuluara me zhavorr. U rrotullova rreth këtyre shkurreve disa orë, lart-poshtë, derisa më në fund, pasdreke, nuk i takova dy arabë me gomarë, të cilët bartnin rrush dhe djathë në Benias. Rruga që më kishte mbetur e kaluam së bashku; më dhanë rrush për të ngrënë kurse u ndamë kur arritëm te bahçet e para në hyrje të qytetit. Përroi i kthjellët, i ngushtë, i shpejtë

gurgullonte pranë rrugës. U shtriva në bark, e zhyta kokën deri në veshë në ujin e ftohtë dhe piva, piva...

Edhe pse isha shumë i lodhur, nuk kisha për qëllim të mbetem në Benias, i cili si qyteti i parë në anën siriane, patjetër duhej të ketë stacion policor. Takimi im me xhandarët më qetësoi në aspektin e policëve të rëndomtë sirianë sepse mund të mendohej se shumica e tyre janë analfabetë dhe për atë nuk janë të aftë ta zbulojnë falsifikimin tim; por stacioni policor me nëpunësin e vet do të ishte rrëfim në vete. Prandaj u nisa me hapa të shpejtë rrugëve të ngushta dhe shkurtimoreve duke e anashkaluar rrugën kryesore tregtare ku me siguri një stacion i tillë mund të jetë. Në njërin prej sokaqeve dëgjova zëra zemërimi dhe zërin e njeriut si këndon në përcjellje të duartrokitjeve. I thelluar në të, u ktheva pas qoshit dhe u ndala: m'u përballë meje, në largësi prej mezi dhjetë hapash, ishin dyert me mbishkrimin Stacioni policor, me disa policë sirianë, në mesin e tyre oficeri, të cilët qëndronin ulur në karrige në diellin e pasditës dhe argëtoheshin në muzikën e njërit prej shokëve të tyre. Ishte shumë vonë që të tërhiqem, sepse tashmë më kishin parë, kurse oficeri - sigurisht edhe ai sirian - më thirri:

"Hej, eja kënde!"

Më mbeti vetëm ta dëgjoj. U nisa ngadalë, e pastaj më shkëlqeu ideja. Duke nxjerrë fotoaparatin tim, njerëzishëm e përshëndeta oficerin frëngjisht dhe vazhdova, duke mos pritur pyetjet e tij:

"Vij prej Metulle t'i bëj një vizitë të shkurtër këtij qyteti, por nuk do të isha kthyer me dëshirë e të mos e bëj këtu një fotografi me ty dhe shokun tënd, kënga e të cilit shumë më ka magjepsur".

Arabët kanë dëshirë t'u bësh lajka, kurse veç kësaj mjaft gëzohen kur i fotografon; kështu që oficeri pranoi me dëshirë dhe kërkoi që t'ia dërgoj fotografinë (gjë të ci-

lën e bëra më vonë me përshëndetje). Më nuk i ra në mend t'i kërkojë dokumentet e mia. Në vend të saj më ofroi një filxhan me çaj të ëmbël dhe më dëshiroi rrugë të mbarë kur më në fund u çova të "kthehem prapë në Metullë". U ktheva rrugës nëpër të cilën kisha ardhur, bëra një qark rreth qytetit dhe vazhdova rrugën time drejt Damaskut.

Tamam dy javë Pasi e lëshova Haifin, arrita në katundin e madh, gati qytet, Maxhal Ash-Shams, i banuar kryesisht me druzë dhe një numër të vogël kristianësh. E zgjodha shtëpinë e cila dukej mjaft e pasur dhe i thash djaloshit i cili e hapi derën në trokitjen time se do të jem falënderues ta kaloj natën këtu. Me përshëndetjen e zakonshme ehlen ve sehlen dyert u hapën gjerë dhe pas disa çastesh isha i pranuar në familjen e vogël.

Pasi tash isha thellë në Siri, me disa rrugë të mundshme që shpiejnë në Damask, vendosa t'i rrëfhem nikoqirit tim druzian dhe të kërkoj prej tij këshillë. Duke e ditur se asnjë arab nuk do ta tradhtonte kurrë musafirin e vet, të gjitha ia tregova haptas duke përfshirë edhe faktin se udhëtoj me letërnjoftim të rrejshëm. Më tha se do të ishte mjaft rrezik të shkoj rrugës kryesore sepse prej këtu e tutje patrollojnë xhandarët francezë, të cilët nuk do të më lejonin të kaloj ashtu lehtë siç e bënë atë sirianët.

"Mendoj ta dërgoj djalin tim me ty", - tha nikoqiri im duke treguar kah djaloshi që m'i hapi dyert, - "kurse ai do të udhëheqë nëpër male dhe do të ndihmojë t'iu shmangesh rrugëve".

Pasi darkuam u ulëm në tarracën e hapur para shtëpisë dhe biseduam për rrugën që do të duhej ta ndjekim të nesërmen në mëngjes. Në prehërin tim ishte e shtrirë harta gjermane e Palestinës dhe Sirisë në tavolinën e vogël të cilën e kisha sjellë prej Jerusalemi dhe mundohesha që në të ta ndjek rrugën të cilën ma tregonte shoku im druzian.

Derisa në këtë mënyrë ishim të preokupuar me hartën, një njeri në uniformë të oficerit policor - me siguri sirian - u afrua duke kaluar rrugës së fshatit. U paraqit aq befasisht pas këndit saqë mezi arrita ta paloj hartën por jo edhe ta fsheh prej shikimit të tij. Si duket më diktoi se jam i huaj sepse, Pasi e kaloi tarracën tonë duke ia tundur kokën nikoqirit, u kthye te këndi tjetër dhe ngadalë u nisë drejt nesh.

"Kush jeni ju?", - më pyeti frëngjisht, jo plotësisht me zë të ëmbël.

E përsërita rrëfimin tim të zakonshëm për atë se jam kolonist prej Metulle në udhëtim argëtues. Kur kërkoi ta shohë letërnjoftimin tim, duhej patjetër t'ia japë. I shikoi dokumentet me kujdes, kurse buzët e tij u shtrembëruan në të qeshur.

"E çka është ajo çka e mbani në dorë?" - vazhdoi ai duke treguar në hartën e paluar gjermane. I thashë se ajo nuk është me rëndësi, por ai ishte këmbëngulës që ta shohë, e shpaloj me gishtat e shkathtë të njeriut të mësuar në përdorimin e hartave, i hodhi një shikim të shkurtër, e paloi me kujdes dhe ma ktheu me buzëqeshje. Pastaj tha në gjuhën e keqe gjermane:

"Gjatë kohës së luftës kam shërbyer në armatën turke krah për krahu me gjermanët". Përshëndeti në mënyrë ushtarake, buzëqeshi edhe një herë dhe shkoi.

"Ai mendon se je gjerman. Ata i pëlqejnë, kurse i urrejnë francezët. Ai nuk do të shqetësojë".

Të nesërmen në mëngjes, në përcjellje të druzianit të ri, u nisa në marshin më të rëndë të jetës sime. Udhëtua më se njëmbëdhjetë orë, vetëm me një ndërprerje prej rreth njëzet minutash në drekë, nëpër kodra gurore, nëpër gryka të thella, shtretër të thatë lumenjsh, sërish nëpër kodra, nëpër zhavorr; nëpër gurishten e mprehtë, përpjetë, tatëpjetë, përpjetë, tatëpjetë, derisa nuk e ndje-

va se më nuk mund të ecë. Kur pasdite erdhëm deri te qyteti El-Katane në rrafshinën para Damaskut, isha plotësisht i rrskapitur, këpucët më ishin shqyer, kurse thembra më ishte ënjtur. Këtu kisha dëshirë ta kaloj natën, por shoku im i ri këtë e kundërshoi ashpër; aty pranë kishte jashtëzakonisht shumë policë francezë, e Pasi ai ishte qytet e jo fshat, nuk do të mund të gjeja lehtë bujtinë e të mos tërheq vëmendjen e tyre. Mundësia e vetme ishte të siguroj transport në ndonjë automobil që jepet me qira prej aty e deri në Damask. Ende i kisha me vete njëzet pjasterët (gjatë tërë rrugës prej Haifi nuk kam pasur nevojë të harxhoj asnjë para); njëzet pjasterë rastësisht ishte pikërisht çmimi i biletës së udhëtimit deri në Damask.

Në zyrën e vjetër të qerraxhinjve, në sheshin kryesor të qytetit, më lajmëruan se do të duhet të pres rreth gjysmë ore deri në nisjen e automobilëve tjerë. U ndava me shokun tim udhërrëfyes, i cili më përqafoi si vëlla dhe menjëherë u kthye prap për në shtëpi. Duke ndenjtur ulur, me trastën pranë vetes, pranë derës së zyrës, më mori gjumi në rrezet e diellit të pasdites së vonshme kur papritmas dikush më zgjoi duke më shkundur brutalisht për supesh: xhandari sirian. Ranë pyetjet e zakonshme kurse vijuan përgjigjet e zakonshme. Por, me siguri ai nuk ishte plotësisht i kënaqur andaj më tha:

"Eja me mua në stacionin policor dhe atje sqaroja policit kujdestar".

Isha i lodhur saqë nuk më bëhej vonë se a do të më zbulojnë apo jo.

U pa se oficeri në stacion ishte trupmadh, kapter i rrastë, i cili, me bluzë të shpërthyer, rrinte ulur pranë tavolinës në të cilën qëndronte shishja e arakut (pije alkooolike lindore) gati e zbrazët dhe gota e ndytë. Ishte plotësht i pirë, i zemëruar dhe i zgurdulloi sytë e kuq ngjyrë gjaku në policin që më sollti.

"Ç'është tani?"

Polici ia shpjegoi në gjuhën arabe se më ka parë mua, të huaj, duke qëndruar ulur në sheshin kryesor, kurse unë ia shpjegova në gjuhën franceze se nuk jam i huaj por qytetar i ndershëm.

"Qytetar i ndershëm!" - bërtiti kapteri. - "Ju jeni vagabont dhe endacak që endet andej-këndej nëpër vend vetëm që të na bezdisë. Ku e keni dokumentin?"

Derisa i shkujdesshëm provoja me gishta të ngurtësuar ta gjej letërnjoftimin tim në xhep, ai e goditi me grusht tavolinën dhe ulëriu:

"Nuk ka rëndësi, humb prej këtu!", - dhe derisa e mbyllja derën pas vetes, e pashë duke e kapur gotën dhe shishen.

Pas një marshimi të gjatë, të gjatë, çfarë lehtësimi, çfarë komoditeti të udhëtosh - jo, gati të rrëshqasësh - në automobil prej El-Kantari nëpër autorrugën e gjerë në rrafshinën e Damaskut të mbuluar me pemishte! Në horizont shihej disi caku im: det i paskajshëm i kurorave të drunjve, me disa kupola dhe minare shkëlqyese mezi të dukshme drejt qiellit. Në largësi, diç në të djathtë, qëndronte e vetmuar kodra lakuriqe, maja ende e ndriçuar me diell, derisa hijet e buta tashmë ishin zvarrisur deri te themelet e saj. Mbi kodrinë, një re e vetme, e ngushtë, e gjatë, e errët; lart, qielli i përthimtë i largët; mbi rrafshinën ngjyra e artë, kuqërreme e përhimtë, drejt bjeshkëve në anën tonë të majtë dhe të djathtë; erë e lehtë.

Pastaj: pemishtet e larta të rrethuara me mure prej balte; kalorësit, qerret, automobilat, ushtarët (ushtarët francezë). Muzgu u bë i gjelbër si uji. Një polic kaloi në motoçikletë me syzet e mëdha që ngjasonte në ndonjë peshk nga deti i hapët. Pastaj: shtëpia e parë, Damasku, goditja e oshëtimës pas qetësisë në rrafshinë. Dritat e

para u kallën në dritare dhe rrugë. Ndjeva një gëzim që nuk mbaj mend ta kisha ndier më parë.

Gëzimi im shpejt u zhduk kur automobili u ndal pas stacionit policor në hyrje të qytetit.

"Ç'është ajo?", - e pyeta shoferin pranë vetes.

"Oh, asgjë. Të gjithë automobilat që hyjnë duhet patjetër kur të vijne t'i paraqiten policisë..."

Polici sirian doli prej stacioni dhe pyeti:

"Prej nga vini?"

"Vetëm prej El-Kantari", - u përgjigj shoferi.

"Oh, atëherë mund të shkoni" (sepse ky sigurisht ishte komunikacion lokal). Shoferi i dha kontakt automobilat me buzëqeshje. U nisëm, e unë edhe një herë mora frymë shlrshëm. Por në atë çast dikush thirri prej rruge: "Kapaku është i hapur!" - disa hapa pas stacionit policor shoferi e ndali automobilin e vjetër që të kujdeset për kapakun e hapur i cili ishte varur nga njërën anë. Derisa ai merrej me të, polici na u afrua sërish me përtaci, sigurisht i interesuar vetëm për problemin mekanik të shoferit. Megjithatë, shikimi i tij u drejtua kah unë dhe unë e hetova, me rrudhje të tërë trupit, që shikimi i tij të bëhet vigjilent. Më shikoi prej kresë deri te këmbët, u afrua më afër dhe e lëshoi shikimin në tokë ku qëndronte trasta ime.

"Kush je ti?" - pyeti i dyshimtë.

Unë fillova: "Prej Metulle...", por polici e tundi kokën duke mos besuar. Ai pastaj i pëshpëriti diç shoferit; munda t'i kuptoj fjalët "ushtar anglez, dezertor". Për herë të parë më ra në mend se pantallonat e mia të kaltra ushtarake, kufia ime ngjyrë gështenje me tegjela ari e qëndisur dhe trasta ime e tipit ushtarak (çka e kisha blerë në dyqanin e vjetërsirave në Jeruzalem) krijonin fotografi mjaft të ngjashme me veshjen e policisë irlandeze që përdorte asokohe qeveria në Palestinë; atëherë m'u kuj-

tua edhe marrëveshja midis qeverisë franceze dhe britanike për dorëzimin e ndërsjellë të të arratisurve...

Unë u mundova që me arabishten time të keqe t'i sqaroja policit se nuk jam i ikur; por ai e refuzoi sqarimin tim:

"Këtë sqaroja krejt inspektorit".

Kështu isha i detyruar të shkoj në stacionin policor kurse shoferi, duke pëshpëritur falje që nuk mund të më presë, e nisi automobilin dhe u zhduk... Inspektori, më thanë, është jashtë dhe në çdo çast mund të kthehet. Duhej patjetër ta pres në një dhomë në të cilën kishte vetëm banka dhe, përveç hyrjes kryesore, edhe dy dyer të tjera. Mbi njërën qëndronte mbishkrimi roja e burgut, kurse mbi tjetrën thjesht burgu. Në këtë mjedis të pakëndshëm kam pritur më tepër se gjysmë ore, çdo çast gjithnjë e më tepër i bindur se ky është fundi i udhëtimit tim; sepse, inspektor tingëllonte shumë më kobshëm se thjesht oficer. Po që se tash më zbulojnë, patjetër të kaloj një kohë, ndoshta edhe javë, në burg nën hetime. Pastaj do të ma jepnin dënimin e zakonshëm prej tre muajsh; pas mbarimit do të duhej të udhëtoja në këmbë - në përcjellje të xhandarit hipur në kalë - prapë deri te kufiri palestinez kurse, mbi të gjitha, mund të më priste edhe dëbimi prej Palestine për shkak të shkeljes së rregullave të pasaportës. Vrerësia në paradhomë nuk ishte asgjë në krahasim me thyerjen time shpirtërore.

Befasisht dëgjova zhurmën e automobilit. U ndal para hyrjes në stacion. Menjëherë pas kësaj një njeri në tesha civile me tarbush në krye hyri në dhomë me hapa të shpejtë, në përcjellje të policit i cili i hutuar mendohej diç t'i sqarojë. Inspektori sigurisht shpejtonte shumë.

Nuk e di saktësisht se si ndodhi kjo, por mendoj se ajo çka kam bërë në atë çast vendimtar është pasojë e njërit prej atyre shkëlqimeve geniale të cilët në rrethana

të ndryshme - dhe ndoshta te njerëzit e ndryshëm - shpiejnë deri te ndodhitë të cilat ndërrojnë historinë. Me një kërcim iu afrova inspektorit, iu sula me akuza në gjuhën franceze kundër pakujdesisë fyese të policit i cili mua, qytetar i pafajshëm, më ka konsideruar të arratisur dhe më ka fajësuar që ta braktis udhëtimin për në qytet. Inspektori disa herë u mundua të më ndërpresë por për këtë nuk i dhashë rast dhe e zura duke e vërshuar me fjalë prej të cilave, mendoj, mezi ishte në gjendje të kuptonte një të dhjetën e tyre - ndoshta vetëm emrat "Metulla" dhe "Damasku", që i kam përsëritur shumë herë. Ishte dukshëm në telashe që u pengua të bëjë diç që ishte urgjente; por unë nuk i lejova të flasë dhe kam vazhduar, pa pushim, me shkrehjen e fjalëve të mia. Në fund ai i ngriti duart i dëshpëruar dhe thirri:

"Ndaluni, për hir të Zotit! A keni ndonjë dokument?"

Dora ime automatikisht hyri në xhep dhe ende duke derdhur fjalinë pas fjalisë pandërprerë, ia shtyva letërnjoftimin e rrejshëm në dorë. I mjeri duhej të kishte parandjenjë se i zihej fryma, sepse shpejt vetëm e ktheu këndin e letres së paluar, e pa vulën zyrtare dhe ma ktheu:

"Mirë, mirë, shkoni, vetëm shkoni!", - kurse unë nuk e prita që ta përsëriste.

Para disa muajsh, në Jeruzalem pata takuar një mësues prej Damasku i cili më thirri të jem musafir i tij sa herë që të shkoja në Damask dhe pikërisht tash interesoheja për shtëpinë e tij. Një djalosh më ofroi të më udhëheqë dhe më kapi për dore.

Nata e thellë. Qyteti i vjetër. Rrugicat e ngushta të cilat verandat e zgjatura i bënin më të errëta se sa do të mund t'i bënte vetë nata. Aty-këtu mund të shihje në dritën e verdhë të llambave shitoren e frutave me grumbullin e shalqinjve dhe shportat e rrushit. Njerëzit si hije.

Ndonjëherë, pas dritareve me grila, zëri i lartë i gruas. Kurse pastaj djaloshi tha: "Këtu". Trokita në derë. Dikush prej brenda u përgjigj dhe e tërhoqa shulin dhe hyra në oborrin e shtruar me pllaka. Në errësirë munda të dalloj drurin e grejpfrutit të lakuar nën frutat e rëndë të gjelbër dhe pishinën e gurit me fontanë. Dikush thirri prej lart:

"Urdhëroni, zotëri", - dhe unë u ngjita në shkallët e ngushta pranë njërit prej mureve të jashtëm, kalova nëpër llogjën e hapur dhe u gjeta në përqaftimin e mikut tim.

Isha mjaft i lodhur, plotësisht i rraskapitur dhe u lëshova pa kundërshtuar fare në shtratin që më ofruan. Era fëshfërinte në kurorat e drunjve në oborrin përpara dhe në kopshtin pas shtëpie. Nga largësia depërtonin shumë zëra të ngjirur: zëri i qytetit të madh arab që përgatitet për pushim.

Me entuziazëm, syhapur për gjësendet që më parë as që i kam pritur, jam endur ato ditë verore rrugëve të ngushta të pazarit të vjetër në Damask dhe kam zbuluar rehatinë shpirtërore në jetën e njerëzve të tij. Siguria e tyre e brendshme mund të hetohet në mënyrën e sjelljes së tyre ndaj njëri - tjetrit, në qëndrimin e ngrohtë me të cilin takohen dhe ndahen, në mënyrën se si dy njerëz kalojnë bashkë, duke u kapur përdore si fëmijë - thjesht për atë pse ndjejnë miqësi ndaj njëri - tjetrit; në mënyrën në të cilën shitësit sillen ndaj njëri - tjetrit. Këta shitës në dyqanet e vogla, këta thirrës të pakompromisë të kalimtarëve, sikur nuk kanë pasur frikë makutërie as xhelozi kështu që pronari ua ka lënë dyqanin e vet në ruajtje fqinjve dhe konkurrentit të tij kurdo që ka pasur nevojë të largohet prej dyqanit duarthatë, qartë në dilemë a të presë në kthimin e shitësit ose të ndërrohet deri te tjetri - dhe përherë tregtari fqinj, konkurrenti, është afruar të konstatojë çka dëshiron myshteriu dhe t'ia shesë mallin e kërkuar - jo të vetin, por mallin e fqinjit të vet që nuk

është aty i pranishëm - dhe paratë t'ia lërë në arkë fqinjit. Ku, në Evropë, do të mund të bëhesh dëshmitar i një transaksioni të ngjashëm?

Disa rrugë të pazarit vlonin me figurat e gjalla të beduinëve në veshjet e tyre të gjera, valëvitëse; njerëz që përherë dukeshin sikur e bartin jetën e tyre me vete dhe sikur shkojnë përherë rrugës së tyre gropa-gropa. Njerëz të lartë, me sy të flaktë, seriozë qëndronin në këmbë ose ulur në grupe para dyqanit. Ata nuk bisedonin shumë në mes veti - një fjalë, një fjali e shkurtër, e shqiptuar me kujdes dhe po ashtu, e pranuar me kujdes ka mjaftuar për bisedë të gjatë. Këta beduinë, kisha ndjenjën, nuk dinë për llomotitje, atë bisedë boshe, pa kurrfarë përmbajtje, shenjë e shpirtrave të shterur; më përkujtuan në fjalët e Kur'anit, ku përshkruhet jeta në parajsë: "...dhe aty nuk do të dëgjosh llomotitje boshe..." Shihej qartë se heshtja është veti e beduinëve. Ata pështillen në pelerinat e tyre të gjera, të përhimta ose të zinj dhe heshtin; kalojnë pranë jush me shikimin e heshtur fëmijëror, krenarë, modestë dhe mendjempërtë. Kur u drejtoheni në gjuhën e tyre, sytë e tyre të zezë shkëlqejnë me buzëqeshjen e befasishme, sepse ata nuk janë të preokupuar me vetveten dhe dëshirojnë që i huaji t'i kuptojë. Ata janë zotërinj të mëdhenj, plotësisht të përmbajtur, e prapëseprapë të hapur ndaj të gjitha gjërave të jetës...

Të premtën mund të hetohej ndryshimi në ritmin jetësor të Damaskut - dredhja e vogël e entuziazmit dhe, në të njëjtën kohë, solemnitetit të gëzuar. Mendova për të dielat tona në Evropë; për rrugët e qeta të qytetit dhe shitoret e mbyllura; i përkujtoja të gjitha ato ditë të zbrazëta dhe ankthet që i shkaktonte ajo zbrazëti. Pse vallë duhej të ishte ashtu? Tash kam filluar që ta kuptoj: për shkak se për shumicën e njerëzve në Perëndim përditshmëria e jetës ka qenë barrë e rëndë nga e cila vetëm të

dielat mund t'i lirojnë, kurse e diela nuk është më ditë pushimi por është bërë arrati në jorealen, harresë relative pas së cilës, dyfish më rëndë dhe kërcënuese, dalin ditët tjera të javës.

Nga ana tjetër, e premtja për arabët sikur nuk është rast t'i harrojnë ditët e tyre të punës. Frytet e jetës kanë rënë lehtë dhe pa mundime në krahët e këtyre njerëzve, por thjesht punët e tyre, bile edhe ato më të rëndat, nuk bien ndesh me dëshirat e tyre individuale. S'ka mjeshtri për vetë mjeshtrinë; në vend të saj ekziston lidhja e ngushtë midis punëtorit dhe punës së tij; kështu që pushimi bëhet i domosdoshëm vetëm nëse lodhet. Harmoninë e këtyre midis njeriut dhe punës së tij Islami duhet ta ketë pasur parasysh si gjendje të natyrshme të gjërave dhe për këtë arsye nuk e ka caktuar të xhumanë pushim të detyrueshëm. Zanaçinjtë dhe tregtarët e vegjël në pazar në Damask punonin disa orë, i lëshonin dyqanet e tyre disa orë, në atë kohë do të shkonin në xhami në namazin e xhumasë, kurse pastaj shkonin me shokët e tyre në kafene; pastaj sërish do të ktheheshin në dyqanet e tyre dhe do të punonin sërish disa orë në çlirjen e gëzueshme, secili mu ashtu si i pëlqen. Vetëm disa dyqane do të ishin të mbyllura, kurse përveç kohës së namazit, kur të gjithë tubohen në xhami, krejt rrugët do të vlonin sikur edhe ditët e tjera.

Një të xhumaje shkova me mikun dhe nikoqirin tim në Xhaminë emevite. Shtyllat e shumta të mermerit që e mbanin kuben shkëlqenin në rrezet diellore të cilat depërtonin nëpër dritaret e epërme. Në ajër ndjehej aroma e mushkut, kurse dysHEMEJA ishte e mbuluar me qilima të kuq dhe të kaltër. Në rende të gjata, të drejta qëndronin qindra njerëz pas imamit i cili e udhëhiqte lutjen; ata përkuleshin, uleshin, preknin tokën me ballin e tyre, kurse pastaj sërish çoheshin; krejt në harmoni të disiplinuar, si

ushtarë. Mbizotëronte qetësia. Derisa të tubuarit qëndronin në këmbë, mund të dëgjohej zëri i imamit të moshuar, prej largësisë së thellë të sallës së madhe, si i shqipton ajetet e Kur'anit, kurse kur përkulej ai ose lëshohej në sexhde, të gjithë të tubuarit e ndjekin si një njeri, duke u përkulur dhe duke rënë në sexhde para Zotit sikur Ai të jetë i pranishëm para syve të tyre...

Pikërisht në atë moment u vetëdijësova se si këtyre njerëzve u është afër Zoti i tyre dhe besimi i tyre. Lutja nuk dukej se është e ndarë prej ditës së tyre të punës; ajo është pjesë e saj - jo e menduar që t'iu ndihmojë ta harrojnë në jetën, por ta kujtojnë më mirë duke e përkujtuar Zotin.

"Sa e çuditshme dhe e mrekullueshme është kjo", - i thashë shokut tim ndërsa po largoheshim nga xhamia, - "të ndjehesh se e ke aq afër Zotin. Do të dëshiroja edhe unë të ndjehem ashtu".

"Si do të mund të ishte ndryshe, vëlla? A nuk të është Zoti, siç thuhet në Librin tonë të Shenjtë, më afër se arteria jote?"

I motivuar me njohurinë time të re, kam kaluar shumë kohë në Damask duke lexuar të gjitha llojet e librave për Islamit që më binin në dorë. Arabishtja ime, edhe pse më mjaftonte për biseda, nuk më mjaftonte për leximin e Kur'anit në origjinal, kështu që duhej patjetër të mbështetem në përkthimet - në gjuhën frëngjishte dhe gjermanishte - që i kam huazuar prej biblioteke. Për gjërat e tjera më duhej patjetër të mbështetem në veprat e orientalistëve Evropianë dhe në shpjegimet e shokut tim.

Këto studime dhe biseda, sado fragmentare, kanë qënë sikur ngritja e ndonjë perdeje. Filllova ta kuptoj botën e ideve për të cilën deri atëherë nuk kam pasur njohuri.

Islami nuk dukej aq si religjion në kuptimin e popullarizuar të fjalës se sa si mënyrë jete; jo aq si sistem teologjik se sa si program i sjelljes individuale dhe shoqërore i

themeluar në vetëdijen mbi Zotin. Askund në Kur'an nuk kam mundur të gjej thirrje në nevojën "e shpëtimit". Kurrfarë mëkati i parë, i trashëguar nuk qëndronte midis personalitetit dhe fatit të tij - sepse "asgjë nuk mund t'i mveshet njeriut përveç asaj që ai vetë e ka merituar". Nuk është kërkuar kurrfarë asketizmi që të hapet dera e fshehtë e dëlirësisë; sepse dëlirësia është e drejtë e njeriut e fituar me lindjen, kurse mëkati nënkupton vetëm devijimin prej cilësive të natyrshme, pozitive me të cilat Zoti e ka pajisur çdo qenie njerëzore. Nuk kishte gjurmë të çfarëdo dualizmi në vrojtimin e natyrës njerëzore: trupi dhe shpirti, si duket, janë marrë si tërësi e vetme.

Në fillim kam qenë disi i topitur me brengën e Kur'anit jo vetëm për gjërat shpirtërore por, po ashtu, edhe për shumë aspekte jetësore të kësaj bote, në pamje të parë të parëndësishme; por gjatë kohës kam filluar ta kuptoj se, nëse njeriu vërtet është tërësi e vetme e trupit dhe shpirtit - siç pohon Islami - asnjë aspekt i jetës së tij nuk mund të jetë tepër "i parëndësishëm" që të mos vijë në suaza të religjionit. Krahas gjithë kësaj, Kur'ani asnjëherë nuk ka lejuar që pjesëtarët e tij të harrojnë se jeta e kësaj bote është vetëm një shkallë në rrugën e njeriut drejt ekzistencës më të lartë dhe se qëllimi i tij i fundit është nga natyra shpirtërore. Përparimi material, është thënë, është i dëshirueshëm, por jo si qëllim i vetvetes; për atë orekset njerëzore, edhe pse vetvetiu të arsyetueshme, duhet të frenohen dhe të kontrollohen me vetëdijen morale. Kjo vetëdije duhet të përkojë jo vetëm me qëndrimin e njeriut ndaj Zotit, por po ashtu edhe me qëndrimin e tij ndaj njerëzve; jo vetëm në përsosmërinë shpirtërore të personalitetit por po ashtu edhe në krijimin e kushteve të tilla shoqërore që do të mund të favorizonin zhvillimin shpirtëror të të gjithëve, kështu që të gjithë të mund të jetojnë jetën e plotë.

Krejt kjo në aspektin intelektual dhe moral ka qenë shumë më e "pranueshme" se e gjithë ajo që kisha dëgjuar dhe lexuar më parë për Islamin. Ofrimi i tij problemeve shpirtërore dukej se është më i thellë se sa ai që bëhet nga Dhjata e Vjetër, kurse krahas kësaj nuk ka pasur kurrfarë simpatie ndaj ndonjë popullate të veçantë. Ofrimi i tij problemeve trupore, për dallim nga Dhjata e Re, ka qenë shumë më i theksuar pozitivisht. Shpirti dhe trupi qëndronin, secili në mënyrën e vet, si forma të dyfish-ta të jetës njerëzore që e ka krijuar Zoti.

A thua nuk është ndoshta ky mësim, e pyeta veten, themel i atij sigurimi emocional të cilin gjatë kohë e kam ndjerë tek arabët?

Një natë nikoqiri im më thirri të shkoj me të në fshat, në shtëpinë e një miku të pasur i cili kishte festë me rastin e lindjes së djalit të tij.

Kaluam nëpër rrugicat zigzage të pjesës qendrore të qytetit, të cilat ishin aq të ngushta saqë verandat e zgjatura dhe tarracat e mbyllura me grila nga anët e kundërta të rrugës gati takoheshin njëra me tjetrën. Hijet e thella dhe prehja e qetë dremiteshin midis shtëpive të vjetra gurore; ndonjëherë pranë nesh kalonte ndonjë grua me velin e zi, me hapa të shpejtë, të imtë, ose ndonjë njeri mjekrosh, i veshur me kaftanin e gjatë, paraqitej prapa njërit kënd dhe ngadalë zhdukej prapa tjetrit. Përherë të njëjtat kënde dhe këndet jo të drejta, përherë të njëjtat rrugica të ngushta të cilat e presin njëra - tjetrën në të gjitha drejtëmet, përherë premtojnë se shpiejnë në zbulime të çuditshme kurse përherë hapen ndaj rrugicës tjetër, të njëjtë.

Mirëpo, vërtet, në fund zbulimi erdhi. Shoku dhe udhërrëfyesi im u ndalën para një dere të drunjtë, pa mbishkrim, të vënë në murin e pastër, të suvatuar dhe tha: "Arritëm", duke trokitur me dorë në derë.

Dera u hap me kërcëllimë, një plak na uroi mirëseardhje duke pëshpëritur pa dhëmbë, "ehlen, ehlen ve seh-len", dhe nëpër një rruginë të shkurtër me dy kthesa në të djathtë hyjmë në oborrin e shtëpisë e cila nga jashtë mezi ngjasonte në kasolle të lyer me baltë.

Oborri ishte i gjerë dhe i ndritshëm, i shtruar me pllaka sikur tabela e madhe e shahut me pllaka të bardha dhe të zeza mermeri. Në pishinën e ulët, tetëkutëshe në midis lëshonte ujë curril fontana në lojë të gëzuar. Drunjtë e limonit dhe shkurret e oleandrit të mbjella në gropa në shtresën e mermertë i zgjatnin degët e tyre të thata dhe të rënduara me fruta çdokund nëpër oborr dhe përgjatë mureve të shtëpisë, të cilët prej majes e deri në fund ishin të mbuluar me relieve në alabastër të përpunuar në mënyrë më elegante, duke treguar forma të përbëra gjeometrike dhe arabeska me gjethe, të ndërprera vetëm në dritaret me korniza të gjera të bedenit në mermer. Në njërën anë të oborrit muret ishin të thelluara në mënyrë të tillë që, në lartësi prej një metër mbi tokë, ishte formuar ndarësja e thellë në madhësi të dhomës komode, deri te e cila ngjiten shkallët e gjera prej mermeri. Përgjatë tre mureve të kësaj separeje - të quajtur livan - është vënë minderit i ulët i mbuluar me armaç, kurse dysHEMEJA ishte e shtruar me qilimin e shtrenjtë. Muret e separese ishin të stolisura me pasqyra të mëdha deri në lartësi prej rreth pesë metrash, kështu që i tërë oborri me pemët e veta, shtresën e vet bardhë e zi, kornizat e dritareve, dyert e skalitura që të shpienin në brendësi të shtëpisë si dhe larminë e shumtë të musafirëve të cilët rrinin ulur në mindere ose shëtitnin rreth fontanës, dyfishohej në pasqyrat e livanit. Kurse kur shikoni në to zbuloni se muri në anën e kundërt të oborrit është i mbuluar me pasqyra të ngjashme në mbarë gjerësinë e tij ashtu që tërë skena pasqyrohej dy herë, katër herë, njëqind herë

dhe shndërrohej në vijën e pafund, magjike të mermerit, alabasterit, fontanës, njerëzve të shumta, drunjve të limonit, shkurreve të oleandrit - toka e pafund e ëndrrave që shkëlqente nën qiellin e mbrëmjes ende e skuqur prej rrezeve të diellit në perëndim...

Shtëpia e tillë - e thjeshtë dhe e pazbukuruar nga ana e rrugës, e pasur dhe e mrekullueshme përbrenda - ishte për mua diçka krejtësisht e re; por gjatë kohës e kam kuptuar se ajo është mënyra tipike e banimit të të pasurve jo vetëm në Siri dhe Irak por njashtu edhe në Iran. As arabët e as persianët në fillim nuk janë kujdesur për ballinën; shtëpia ka qenë e dedikuar për jetesë dhe funksioni i saj ka qenë i kufizuar në brendësinë e saj. Kjo ka qenë diçka krejtësisht ndryshe prej funksionalizmit të ofruar, pas të cilit shumë vrapohet në arkitekturën moderne perëndimore. Perëndimorët, të ngatërruar me një lloj romantizmi të mbrapshtë, jo të sigurt në ndjenjat e tyre, edhe sot e kësaj dite ndërtojnë probleme; arabët dhe persianët ndërtojnë - ose së paku deri dje kanë ndër-tuar - shtëpi.

Nikoqiri më vendosi në anën e tij të djathtë në mindere, kurse shërbëtori këmbëzbathur më shërbeu kafe me tabakanë e vogël prej bakri. Tymi i nargjilëve që çurlikonin përzihej me ajrin e parfumosur me aromën e trëndafilut dhe notonte në re të vogla drejt qirinjve të hijesuar që sapo ishin ndezur, njëri pas tjetrit, përgjatë mureve dhe ndërmjet gjelbërimit të errët të drunjve.

Shoqëria - të gjithë burra - ishte shumë e llojlojshme: njerëz në kaftanë prej kumashi shushuritës, me vija ose prej mëndafshi të papërpunuar kinez ngjyrë fildishi, në xhube komode prej leshi elegant të ngjyrosur me pastel, me turbanë të bardhë të qëndisur me ari nëpër tarbushë të kuq; njerëz të veshur në tesha Evropiane por dukej qartë që ishin plotësisht komode dhe pa shtrë-

ngesë në pozitë me këmbët e mbledhura në mindere. Disa krerë beduinas prej stepeve, me përcjellësit e tyre, ishin aty; syzinj dhe për mrekulli të shkathtë, me mjekra të vogla të zeza rreth fytyrave të dobësuara, ngjyrë gësh-tenje. Teshat e tyre të reja shushuritnin në çdo lëvizje, kurse të gjithë mbanin shpata me këllëf të argjendtë. Ata ishin të shkujdesshëm dhe plotësisht të pashtrengueshëm; aristokratë të vërtetë - vetëm se pashtrengueshmë-ria e tyre, ndryshe nga ajo e aristokratëve Evropianë, nuk ishte shkëlqim i butë i edukuar brez pas brezi me për-pjekje të kujdesshme dhe jetesë të mirë, por sikur zjarri i ngrohtë i cili buron prej sigurisë së përkopjes së tyre. Ajri i mirë, atmosfera e thatë dhe e pastër - i njëjti ajër të cilin njëherë vërtet e kam ndier në skaj të shkretëtirës; ju përqafton në dëlirësinë e vet, por nuk imponohet. Ata kanë qenë si shokët e largët, si vizitorët kalimtarë në këtë vend; jeta e tyre e lirë, jetë pa qëllim, i priste diku tjetër.

Valltarja doli prej një dere dhe vrapoi plot gjallëri shkallëve në livan. Ishte shumë e re, me siguri jo më shumë se njëzet vjeçe, dhe shumë e bukur. E veshur në pantallona me palë prej njëfarë materiali shushuritës, vezullues të mëndafshhtë, një palë papuçe të arta, jelek të qëndisur me inxhi i cili më tepër e theksonte se sa e fshihte gjoksin e saj të ngritur, të drejtë. Lëvizte me hije-shi sensuale, ishte mësuar që të jetë e admiruar dhe e dëshiruar; mund të dëgjoje shpejt valën e ngazëllimit si e përshkoi tubimin e njerëzve kur e panë shtatin e saj të hedhur dhe trupin joshës ngjyrë elefanti.

Në përcjellje të dajres që i binte një njeri me moshë mesatare, i cili hyri në livan menjëherë pas saj, ajo vallë-zonte njërën prej atyre valleve tradicionale, epshendjellë-se shumë të dashur në Lindje - atyre valleve të dedikuara për stimulimin e dëshirave dremitëse dhe premtimin e përmbushjes së asaj çka e ndal frymën.

"O ti bukuroshe, o ti madhështore", - pëshpëriti nikoqiri im. Pastaj me shkathtësi më preku në gju dhe tha: "A nuk është, vallë, kjo si melhemi që e shëron varrën...?"

Valltarja u zhduk, po ashtu, shpejt siç qe paraqitur; asgjë prej saj nuk mbeti përveç shkëlqimit të paqartë në sytë e shumë njerëzve. Vendin e saj në qilimin e livanit e zunë katër muzikantë - ndër më të mirët në tërë Sirinë, siç më tha njëri prej musafirëve. Njëri prej muzikantëve e mbante lahutën qafëgjatë, tjetri daullen shpatuke me cipë vetëm nga njëra anë - sikur dajreja pa tingëllimë - i treti njëfarë instrumenti që ngjason me citerën, kurse i katërti daullen egjiptiane - diç e ngjashme me poçin shumë të gjerë prej bronzi me fundin prej lëkurës së shtrënguar.

Ata filluan t'u bien veglave muzikore dhe të trumbe-tojnë lehtë, së pari shpejt, pa kurrfarë harmonie të dukshme, në shikim të parë secili për vete, sikur i rregullonin instrumentet e tyre në përgatitje për të filluar bashkërisht. Ai me citerën i tërhoqi gishtat e tij disa herë nëpër tela, prej të lartëve deri te të ultit me efekt amortizues sikur në harfë, daulltari trumbetonte qetë, ndalej dhe sërish trumbetonte; ai me lahutën iu ra, sikur të mos ishte prezent me shpirt, disa tingujve të ulët, të fortë të cilët sikur fare rastësisht u pajtuan me të rënat e thata, monotone të përsëritura të dajres dhe ta infiltrojnë daullen në thirrjen e luhatshme të zërit të telave, herë të lahutës, herë të citrës - dhe para se të bëhesh fare i vetëdijshëm për këtë, ritmi i përbashkët i lidhi të katër instrumentet harmonishëm dhe melodja e fitoi formën e vet. Melodia? Nuk do të mund të thojë. Më tepër më dukej se jam dëshmitar i njëfarë ndodhie tronditëse se sa dëgjoj tone muzikore. Nga çercërima e toneve të instrumenteve me tela rritej ritmi i ri, duke u ngjitur në spiralën e tendosur kurse pastaj, befasisht, duke rënë - si ngritje dhe rënie ritmike e ndonjë objekti të metaltë, shpejt dhe ngadalë,

butë dhe fortë; në qëndrueshmërinë e urtë, në variacionet e paskajshme, kjo ndodhi e pandërprerë, ky fenomen akustik që dridhet në dalldinë e përmbajtur, rritej, zgjerohet fuqishëm, pushtonte. Kurse kur papritmas u ndërpre në mes crescendo (si herët, si tepër herët!), e kam ditur: kam qenë i robëruar. Kërshëria e kësaj muzike më kaploi në mënyrë të pahetueshme; kam qenë i zhytur në këta tinguj të cilët me monotoninë e tyre të qartë ndillnin përkujtimet mbi amshueshmërinë e paraqitjes së sëri-shme të gjithë asaj që ekziston, dhe trokitnin në dyert e ndjenjave tuaja dhe thirrnin, pak nga pak, të gjithë atë që ka lëvizur në ju e të mos e keni ditur... zbulonin diçka që përherë ka qenë e pranishme kurse tash u është bërë e qartë me një qartësi të atillë që zemra u dridhet...

Unë isha mësuar me muzikën perëndimore në të cilën e tërë prapavija emocionale e kompozitorëve është e inkuadruar në çdo kompozim veç e veç, dukë shprehur në çdo disponim të tij të gjitha disponimet e tjera të mundshme; por kjo muzikë arabe sikur ka rrjedhur prej një niveli të vetëm të vetëdijes, prej një kërshërie të vetme e cila ka qenë vetëm kërshëri dhe për atë ka mundur të motivojë disponime vetjake të çdo dëgjues...

Pas disa çastesh qetësie daullja trumbetoi sërisht, kurse instrumentet e tjera e përkrahën. Hovi më i butë, ritmi më i ndieshëm se më parë; tonet individuale rregulloheshin gjithë e më afër njëri - tjetrit, ngrohtë e përfshinin njëri tjetrin dhe, sikur me qenë të lidhur bashkë me ndonjë magji, bëheshin gjithnjë e më tronditës; ndesheshin në mes vete, rridhnin njëri përreth tjetrit në vija të lehta, valëvitëse të cilat më parë ndesheshin, disa herë, me oshëtimën sikur me ndonjë pengesë të fortë, por gradualisht u bënë më agresivë, e mbizotëruan daullen dhe e robëruan, duke e tërhequr me vete në ngjitjen e përbashkët spirale; kurse daullja, në fillim pa zemër, gati u

bë pre e dalldisë së përgjithshme dhe, e ngashnjyer iu bashkangjit të tjerëve; vija valëvitëse e humbi lehtësinë e vet femërore dhe mori hov me rritje frenetike, shpejt, më tepër, më ashpër, në furinë më të ftohtë të gjakimit të vetëdijshëm që u lirua prej të gjitha shtërngimeve dhe tash u bë ngjitje ditirambi deri në majat e papara të fuqisë dhe pushtetit; nga rrjedha rrotulluese e deritanishme e tingujve njërit përreth tjetrit shpërtheu rrotullimi madhështor në njëtonshmëri - gjëmimi i rrotave prej paskajshmërie në paskajshmëri, pa masë ose kufij ose qëllim, pa brenga dhe pa frymë me vrap nëpër litarin e ngrëhur mbi gremina të pafunda, nëpër të tashmen e amshueshme, drejt vetëdijes e cila është liri dhe fuqi, jashtë gjithë asaj çka mund të paramendohet. Pastaj, befasisht, në mes fluturimit ngazëllyes, pushim dhe qetësi e vdekur. Brutalisht. Singërisht. Pastër.

Sikur fëshfërima e gjetheve, fryma iu kthye dëgjuesve, kurse murmuritja e zgjatur: "Ja Allah, ja Allah", i përshkoi ata. Ishin sikur fëmijët e kuptueshëm të cilët lozin lojërat e tyre për të cilat qysh moti janë pajtuar dhe të cilat përherë rishtazi i tërheqin. Buzëqeshnin në lumturi...

### - 3 -

Ne kalërojmë, kurse Zejdi këndon: përherë të njëjtin ritëm, përherë melodia e njëjtë monotone. Sepse shpirti i arabit është monoton - por jo në kuptimin e varfërisë së imagjinatës; ai imagjinatë ka boll; por instinkti i tij nuk synon, sikur te perëndimorët, pas gjerësisë, hapësirës tredimensionale dhe njëjesisë së shumë nuancave ndijore. Përmes muzikës arabe flet dëshira që, çdoherë, të sillet një përjetim i vetëm ndjenjash deri në skajshmërinë e realizimit. Karakteri arab, pikërisht kësaj monotonie të pastër, kësaj dëshire gati sensuale që të përjetohen ndje-

njat e forcuara në linjën e pandërprerë ngjitëse, ia ka borxh fuqinë e vet dhe dobësitë e veta. Dobësitë e tij: bota duhet të përjetohet, emocionalisht dhe në hapësirë. Kurse fuqia e tij: besimi në mundësinë e ngjitjes së pas-kajshme drejt njohurisë emocionale mundet në sferën e shpirtit të shpjerë deri te Zoti. Vetëm në themelet e këtyre synimeve të natyrshme, aq karakteristike për popullin e shkretëtirës, ka mundur të mbijë monoteizmi i hebrenjve të vjetër dhe përmbushja e tij triumfale, feja e Muhamedit. Pas kësaj ka qëndruar shkretëtirë mëmësore.



## V. Shpirti dhe trupi

- 1 -

Ditët kalojnë, netët janë të shkurtra, kurse ne udhëtojmë drejt jugut me hapa të përshpejtuar. Devetë tona janë në formë të shkëlqyer - kohë më parë kanë pirë ujë, kurse dy ditët e fundit kanë kullotur boll. Ka edhe katërmbëdhjetë ditë deri në Mekë, e ndoshta madje edhe më tepër, gjë që është e besueshme, po që se e kalojmë një pjesë të kohës në qytetet Hail dhe Medine, që shtrihen në rrugë e sipër.

Më kaploi një padurim i çuditshëm: nxitimi për të cilin nuk kam shpjegim. Deri më tash u kënaqa në udhëtimin e ngeshëm, pa ndonjëfarë motivi të veçantë për të arritur shpejt në vendin e caktuar; ditët dhe javët e kaluara në udhëtim kishin secila veç e veç përmbushjen e vet, kurse qëllimi gjithmonë dukej i rastësishëm. Por tash kam filluar të ndiej diç që kurrë më parë nuk e kam ndier gjatë krejt këtyre viteve në Arabi; njëfarë padurimi që sa më shpejt të arrij në fund të kësaj rruge. Në cilin fund? Ta shoh Mekën? Kam qenë aq shpesh në Qytetin e Shenjtë dhe e kam njohur aq me themel me jetën e tij sa që nuk më premtan më kurrfarë zbulimi të ri. Ose kjo, ndoshta, është një lloj zbulimi i ri të cilin e parandiej? Doemos të jetë kështu - sepse çuditshëm diçka më tërheq drejt Mekës, pritje vetjake, sikundër kjo qendër shpirtërore e

botës muslimane, me tubimin e saj shumëkombësh të njerëzve prej të gjitha viseve, është njëfarë premtimi, portë drejt botës, më e gjerë nga kjo në të cilën tash jetoj. Nuk mund të them se më është bezdisur Arabia; jo, unë i dua shkretëtirat e saj, qytetet, zakonet e njerëzve të saj ashtu siç i kam dashur deri më tash; ajo parandjenjë e parë e jetës arabe në shkretëtirën e Sinait para dhjetë vjetësh kurrë nuk më ka zhgënjyer, kurse vitet që kanë pasuar vetëm i kanë vërtetuar pritjet e mia fillestare. Megjithatë, prej asaj natës sime në pus para dy ditësh, m'u shtua bindja se Arabia ma ka dhënë tërë atë që ka patur për ta dhënë.

Jam i ri, i fortë, i shëndoshë. Mund të kalëroj shumë orë pandërprerë e të mos lodhem shumë. Mund të udhëtoj - dhe atë e bëj tashmë me vite - si beduin, pa tendë dhe pa ndonjë komoditet të imët që banorët e qyteteve në Nexhd e konsiderojnë të domosdoshëm në udhëtimet e gjata shkretinore. Jam mësuar me të gjitha mjeshtritë e vogla të jetës beduinase, kurse i kam përvetësuar, gati pa hetuar, sjelljet dhe zakonet e arabëve të Nexhdit. Por, a thua e gjithë kjo është ajo që duhet të jetë? A thua kam jetuar aq gjatë në Arabi vetëm që të të bëhem arab? - ose ndoshta kjo është përgatitje për diçka që tashmë duhet të vijë?

Padurimi që tash e ndiej disi është i afërt me padurimin e shqetësuar që e kam përjetuar kur jam kthyer në Evropë pas udhëtimit tim të parë në Lindjen e Afërt; ndjenja se kam qenë i detyruar ta ndërpres zbulimin e madh që do të më ofrohej sikur vetëm të kishte pasur më shumë kohë...

Përshtypja e parë e kalimit prej botës arabe përsëri në Evropë ka qenë disi e zbutur me muajt e kaluar në Turqi pasi jam larguar nga Siria në vjeshtë të vitit 1923. Turqia e Mustafa Kemalit ato ditë ende nuk kishte hyrë në fazën e saj "reformiste" të imitimit; ende ishte Turqia

jo e falsifikuar në jetën dhe traditat e saj dhe sipas kësaj, për shkak të lidhjeve të ngushta të saj me Fenë Islame, ende ishte më e afërt me rrjedhën e përgjithshme të jetës arabe; por ritmi i brendshëm i Turqisë dukej disi më i rëndë, më pak transparent, më pak i gjallë - dhe më tepër perëndimor. Kur kam udhëtuar prej Stambolli deri në Sofje dhe Beograd nuk ka qenë kalimi i menjëhershëm prej Lindjes në Perëndim; pamjet janë ndërruar gradualisht, njëri element është tërhequr e tjetri në mënyrë të pahetueshme e ka zënë vendin e tij - kishte gjithnjë e më pak minare, kaftanët e gjatë të burrave ua lëshonin vendin bluzave të ngjeshura katundare, drunjtë e rrallë dhe shkurret e Anadollit kaluan në malet serbe me drunj bredhi - derisa papritmas, në kufirin italian, e gjetëm sërish veten në Evropë.

Ndërsa qëndroja në trenin që më bartte prej Triestes për në Vjenë, përshtypjet e mia të mëparshme nga Turqia filluan ta humbin tërë gjallërinë e tyre dhe i vetmi realitet që mbeti ishin ato tetëmbëdhjetë muaj që i kalova në tokat arabe. Kam qenë i habitur kur e kam kuptuar se në këto vise kaq të njohura të Evropës shikoj me sytë e të huajit. Njerëzit dukeshin aq të shëmtuar, lëvizjet e tyre të shtrënguara dhe harbute, pa raporte të drejtpërdrejta me atë që vërtet e ndjejnë dhe e dëshirojnë; menjëherë e kam kuptuar se, përkundër pamjes së jashtme të qëllimit në çdo veprim të tyre, ata jetojnë, e as që janë të vetëdijshëm për të, në botën e fantazmës... Dukshëm, kontakti im me arabët e ndryshoi plotësisht, pa kthim qëndrimin tim ndaj gjithë asaj që e kam konsideruar qenësore në jetë. Diç e ngjashme me habinë m'u kujtua se edhe Evropianët e tjerë e kanë përjetuar jetën arabe para meje, andaj si ka qenë e mundur që ata të mos e përjetojnë këtë tronditje njëlloj? Ose - e kanë përjetuar? A thua ndoshta dikush prej tyre ka qenë thellë i tronditur siç jam unë tash...?

(Tanimë disa vjet më vonë, në Arabi, e kam pranuar përgjigjen për këtë pyetje; erdhi prej dr Van der Meulenit, përfaqësuesit të atëhershëm diplomatik holandez në Xhide. Njeri me kulturë të gjerë dhe universale, ishte i dhënë pas besimit të tij kristian me aq dëshirë të flaktë saqë sot është gjë e rrallë në mesin e perëndimorëve dhe për atë, kuptohet, nuk ishte mik i Islamit si religjion. Prapëseprapë, e pranoi se e don Arabinë më tepër se çdo vend tjetër duke mos përjashtuar as vendin e vet. Kur shërbimit të tij i afrohej fundi në Hixhaz, ai me një rast më tha: "Besoj se asnjë individ me ndjenja nuk mund të mbetet gjithnjë i imunizuar në hijeshitë e jetës arabe ose t'i shkëputë nga zemra e vet pasi të jetojë një kohë në mesin e arabëve. Kur të shkoni, gjithmonë do ta mbartni në vete atmosferën e këtyre viseve shkretinore dhe do të shikoni në të me përmallim - bile edhe nëse e keni shtëpinë në ndonjë vend më të pasur dhe më të bukur...").

Qëndrova disa javë në Vjenë dhe e festova pajtesën me babain tim. Tashmë i kishte kaluar hidhërimi për shkak të ndërprerjes së studimeve të mia dhe largimit në mënyrë joceremoniale nga shtëpia e prindit. Tashmë isha sërish korrespondent i Frankfurter Zeitung-ut - emër të cilin njerëzit e Evropës Qendrore atëherë e shqiptonin gati me frikëe respekt - dhe kështu e arsyejoja pohimin tim mburrës se do të "notoj deri në majë".

Prej Vjene vazhdova drejt për në Frankfurt që vetë t'i prezentohem gazetës për të cilën kam shkruar më tepër se një vit. Atëherë kam punuar me vetëbesim të madh, sepse sipas letrave nga Frankforti shihej qartë se e çmonin punën time; me ndjenjën se më në fund "arrita", hyra në ndërtesën e moderuar, të errët, të Frankfurter Zeitung-ut dhe ia dërgova kartëvizitën kryeredaktorit, të dëgjuar në botë, dr. Heinrich Simon-it.

Kur hyra, ai për një çast më shikoi me habi, pa zë, gati i harlisur që të çohet prej karriges; por shpejt e mblodhi veten, u çua dhe ma zgjati dorën mua:

"Uluni, uluni. Ju kam pritur juve". Megjithatë, vazhdoi të më shikojë pa fjalë derisa unë fillova të ndihem jo i rehatshëm.

"Diçka nuk është në rregull, dr. Simon?"

"Jo, jo, në rregull është ose, më mirë thënë, asgjë nuk është në rregull..." Pastaj qeshi dhe vazhdoi: "Në njëfarë dore kam pritur se do të takoj njeriun mesoburr me syze ari të kornizuara - kurse tash e takoj djaloshin... oh, më fal; sa vjet keni?"

Befasisht m'u kujtua tregtari i dashur holandez në Kajro i cili ma parashtrroi po të njëjtën pyetje para një viti: u shkula së qeshuri:

"Kam mbi njëzet e tre vjet, zotëri - gati njëzet e katër". Pastaj shtova: "Mendoni se jam shumë i ri për Frankfurter Zeitungun?"

"Jo...", - m'u përgjigj ngadalë Simoni, - "jo për Frankfurter Zeitungun, por për artikujt tuaj. Në njëfarë mënyre kam konsideruar se vetvetiu kuptohet se vetëm njeriu shumë i moshuar do të ishte në gjendje ta zotërojë dëshirën e vet natyrore për t'u dalluar dhe ta lërë personalitetin e vet, ashtu siç keni vepruar ju, plotësisht nën hijen e tekstit të vet. Kjo, siç e dini ju, është fshehtësi e gazetarisë së pjekur: të shkruhet në mënyrë objektive për atë çka shihet, dëgjohet dhe mendohet, pa i ndërlidhur këto përvoja drejtpërdrejt me përvojat individuale, vetjake... Nga ana tjetër, kur mendoj tash për atë, vetëm njeriu shumë i ri ka mund të shkruajë me aq shumë entuziazëm, me aq shumë - si të them - me aq shumë admirim...!" Pastaj mori frymë thellë: "Shpresoj se kjo nuk do të zbehet dhe nuk do të bëheni mburravec dhe i zbrazët sikur të tjerët..."

Zbulimi se jam shumë i ri sikur e forcoi bindjen e dr. Simonit se tek unë ka gjetur korrespondentin që premtion shumë; plotësisht u pajtua se duhet të kthehem sa më parë në Lindjen e Mesme - sa më parë aq më mirë. Financiarisht, nuk kishte më kurrfarë pengesash për një plan të tillë, sepse inflacioni gjerman më në fund u tejkalua kurse stabilizimi i parave pas pak kohësh menjëherë solli valë përparimi. Frankfurter Zeitungu sërish ishte në gjendje të financojë udhëtime të korrespondentëve të vet specialë. Megjithatë, para se të mund të shkoja sërish, duhej të shkruaja librin për të cilin qysh më parë kisha lidhur kontratë me gazetën; ishte vendosur që gjatë asaj kohe t'i bashkangjitem redaksisë në mënyrë që të njoftohem themelësisht me punën e gazetës së famshme.

Me gjithë padurimin tim që sërish të shkoj, ata muaj në Frankfurt qenë stimul i fuqishëm. Frankfurter Zeitungu nuk ishte vetëm gazetë e famshme; ai ishte gati institut hulumtimesh. Kishte të punësuar rreth katërdhjetë e pesë redaktorë mjaft të aftë, duke mos llogaritur redaktorët ndihmës dhe ndihmësit e shumtë. Puna redaktuese ka qenë lart e specializuar, kështu që çdo zonë botërore dhe çdo lëndë më e madhe politike dhe ekonomike i është besuar profesionistit të shquar në atë fushë; e gjithë kjo ka qenë në pajtim me traditën e vjetër që artikujt dhe lajmet e Frankfurter Zeitungut duhet të jenë jo vetëm shprehje kalimtare e ndodhive, por më tepër evidencë e dokumentuar në të cilën mund të mbështeten edhe politikanët edhe historianët. Të gjithë e kanë ditur se në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Berlin kryeartikujt dhe analizat politike të Frankfurter Zeitungut i kanë shënuar me të njëjtin respekt sikur edhe notat verbale të qeverive të huaja. (Në të vërtetë, pohohet se Bizmarku një herë ka thënë për shefin e atëhershëm të zyrës berlinase të gazetës: "Dr. Steini është ambasador i Frankfurter

Zeitungut në oborin berlinas"). Të jesh anëtar i një organizate të tillë vërtet ka qenë gjë mjaft e këndshme për njeriun e moshës sime, aq më tepër sepse vrojtimet e mia për Lindjen e Mesme hasën në vërejtje serioze të redaktorëve dhe shpesh kanë qenë lëndë e konferencave ditore të redaksisë; triumfi përfundimtar arriti atë ditë kur kërkuan të shkruaj një kryeartikull për problemet aktuale të Lindjes së Mesme.

Puna ime te Frankfurter Zeitung-u ka qenë nxitje e fortë e mendimit tim të vetëdijshëm. Me qartësinë më të madhe se kurrë më parë, fillova t'i ndërlihdh përvojat e mia nga Lindja me botën perëndimore, pjesë e së cilës sërish u bëra. Pikërisht ashtu siç e zbulova para disa muajsh lidhjen ndërmjet sigurisë emocionale të arabëve dhe fesë të cilën e predikonin, ashtu filloi tash të më vijë në vetëdije se mungesa e brendshme e tërësisë së Evropës dhe gjendja kaotike e etikës së saj mund të jetë pasojë e humbjes së lidhjes së saj me besimin religjioz i cili ia ka dhënë formën qytetërimin perëndimor.

Këtu, e kam parë, ka qenë një shoqëri në hulumtim pas orientimit të ri shpirtëror Pasi e ka lënë Zotin; por është e qartë se pak perëndimorë e kanë kuptuar se për çfarë bëhet fjalë këtu. Shumica, si duket, kanë menduar, të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm, pak a shumë kështu: Pasi arsyeja jonë, eksperimentet tona shkencore dhe parallogaritë tona nuk zbulojnë përfundimisht asgjë për prejardhjen e jetës njerëzore dhe fatin e tij pas vdekjes fizike, ne duhet ta përqëndrojmë tërë energjinë në zhvillimin e potencialeve tona materiale dhe intelektuale. Nuk guxojmë të lejojmë që të na pengojnë etika dhe tezat morale të bazuara në hipoteza, të cilat i rezistojnë verifikimit shkencor. Në këtë mënyrë, edhe pse shoqëria perëndimore nuk e ka mohuar kategorikisht Zotin, ajo thjesht nuk ka pasur më vend për Atë në sistemin e vet intelektual.

Më parë, Pasi i humba shpresat në religjionin e gjy-shërve të mi, mendova për kristianizmin. Në sytë e mi, koncepti kristian mbi Zotin ishte shumë më superior se ai në Dhjatën e Vjetër, ngase nuk e kufizonte përkujdesjen e Zotit në ndonjë grup njerëzish, e preferonte Atësinë e Tij për tërë njerëzinë. Megjithatë, ka qenë një element në pikëpamjen religjioze kristiane që ka devijuar nga ofrimi universal i tij: dallimi të cilin e bënte midis shpirtit dhe trupit, botës së besimit dhe botës së punëve praktike.

Falë ndarjes së vet të hershme prej të gjitha tendenca-ve të cilat synojnë afirmimin jetësor dhe aspiratat e kësaj bote, kristianizmi, e kam ndier, që moti ka pushuar t'i japë motivim moral qytetërimit perëndimor. Pjesëtarët e tij tashmë ishin mësuar me mendimin se religjioni nuk duhet të përzihet në jetën praktike. Kënaqeshin që besimin reli-gjioz ta konsiderojnë për konventë lehtësuese qëllimi i të cilit tashmë është që ta motivojë kuptimin e paqartë të moralitetit vetjak - sidomos të moralitetit seksual - tek in-dividi, mashkulli dhe femra. Në këtë drejtim u ka ndihmu-ar edhe qëndrimi i lashtë i Kishës, i cili duke ndjekur pari-min e ndarjes midis "asaj që i takon Zotit dhe asaj që i ta-kon Qezarit", e ka lënë gati të paprekur tërë fushën e akti-viteteve shoqërore dhe ekonomike - gjë që ka stimuluar zhvillimin e punëve dhe politikës kristiane në drejtim krej-tësisht të kundërt me krejt atë që e pat menduar Krishti. Duke mos u ofruar besimtarëve të vet orientim konkret në gjërat e kësaj bote, religjioni të cilin e predikon bota pe-rëndimore e ka gabuar atë që më duket se ka qenë misioni i parë i Krishtit dhe, në të vërtetë, detyrë parësore e çdo religjioni: t'i tregojë njeriut jo vetëm si të ndjejë por edhe si të jetojë në mënyrë të drejtë. Me ndjenjën e instinktit se religjioni i vet në njëfarë mënyre e ka lënë në baltë, njeriu perëndimor tashmë shekuj me radhë e ka humbur tërë besimin e vet të vërtetë në kristianizëm. Me humbjen e

këtij besimi, ai e ka humbur edhe bindjen se gjithësia është shprehje e një Projektuesi Inteligent dhe sipas kësaj e kultivon tërësinë organike; e Pasi e ka humbur këtë bindje, tash po jeton në një vakuum moral dhe shpirtëror.

Në largimin e shkallërishtëm perëndimor nga kristianizmi kam vërejtur pakënaqësinë kundër urrejtjes ndaj jetës me anë të së cilës shën Pali aq moti, dhe aq rrënjësisht, i ka mjegulluar mësimet e Krishtit. Andaj, si mundet që shoqëria perëndimore ende të konsiderojë se kristianizmi është shoqëri? Si mund të shpresohet se, pa besim konkret, do ta mbizotërojë kaosin e vet të tashëm moral?

Bota në kryengritje dhe në përpëlitje, kjo ka qenë bota jonë perëndimore. Gjakderdhje, shkatërrime, dhunime me përmasa të papara; thyerje e aq konventave shoqërore, ndeshje ideologjish, në të gjitha anët luftëra të rrepta për rrugë të reja jetësore: ato kanë qenë shenja të kohës sonë. Prej tymit dhe thertores së luftës botërore, luftërave të vogla të panumërta dhe shumë revolucioneve dhe kundërrevolucioneve, nga krizat ekonomike që ua kapërcenin të gjitha atyre deri atëherë të shënuara, nga të gjitha këto ndodhi tmerruese doli në shesh e vërteta se përqëndrimi i tashëm perëndimor në përparimin teknik e material kurrë nuk mund vetvetiu ta zgjidhë kaosin ekzistues dhe të shpie në diçka që i ngjanë rendit. Bindja ime instinktive, djaloshare se adhurimi i tashëm "i përparimit" është vetëm kompensim i dobët, i zbehtë për besimin e mëparshëm në vlerat absolute - besimi i rrejshëm i njerëzve të cilët e kanë humbur tërë fuqinë e brendshme të besojnë në vlerat absolute dhe tash e mashtrojnë vetveten me anë të besimit se njeriu disi, me impulsin e rastësishëm të evolucionit, do t'i mbizotërojë të gjitha vështirësitë e veta të tanishme... Nuk kam parë se si do të vepronin sistemet e reja ekonomike që lindin prej këtij besimi mashtrues, do të mund të paraqiste diç më

tepër se ilaçin e përkohshëm për shoqërinë e mjerueshme perëndimore; ata, në rastin më të mirë, do të mund t'i shërojnë disa prej simptomeve të tij, por kurrë shkaktarin.

Ndërsa isha duke punuar në redaksinë e Frankfurter Zeitung-ut, shpesh kam shkuar në Berlin, ku jetonin shumica e shokëve të mi; pikërisht në njërin prej këtyre udhëtimeve e takova femrën e cila më vonë do të bëhet bashkëshortja ime.

Prej momentit kur i jam prezentuar Elzës midis fëshfërimës së mejhanes romane, fort më tërhoqi jo vetëm shfaqja e bukurisë së saj të njomë - fytyra e saj e ngushtë, bukur e formësuar, me sytë e kaltër të përhimtë dhe me buzët e njoma që shprehnin humor dhe qëndrim miqësor - por bile edhe diç më tepër kualiteti intuitiv i ndjeshëm, i brendshëm i afrimit të saj njerëzve dhe gjësëndeve. Ishte fotografe. Puna e saj, që e kam njohur më vonë, mbase nuk ka qenë e theksuar, por ka bartur të njëjtin tipar të intensitetit të kthjellët i cili theksohej në të gjitha lëvizjet dhe fjalët e saj. Edhe pse ishte pesëmbëdhjetë vjet më e vjetër se unë - do të thotë në gjysmën e dytë të dhjetëvjetshit të tretë - fytyra e saj e njomë dhe trupi i hedhur, i zhdërvjelltë i jepnin pamje shumë më të re. Ajo me siguri ka qenë përfaqësuesi më elegant i llojit të pastër "nordian" që kam takuar ndonjëherë, me tërë kthjelltësinë dhe qartësinë e vijave, por pa asnjë mprehtësi dhe disharmoni të cilat aq shpesh e ndjekin. Prejardhjen e kishte nga njëra prej atyre familjeve të vjetra Holsteine të cilat kanë mund të përshkruheshin si ekvivalent gjermanoverior i pronarëve të vegjël anglezë. Liria jokonvencionale e sjelljeve të saj i fshinte të gjitha gjurmët e prejardhjes fshatare që ia lëshonin vendin krejtësisht ngrohtësisë dhe mendjemprehtësisë jonordiane. Ishte e vejë dhe kishte një djalë gjashtëvjeçar të cilit ia kushtonte tërë kujdesin e vet.

Simpatia është dashtë të jetë e ndërsjellë që nga fillimi, sepse pas këtij takimi të parë jami takuar shpesh - herë. Përshtypjet e mia të mëparshme nga bota arabe, natyrisht ia kam rrëfyer Elzës; kurse ajo, ndryshe nga shokët e tjerë të mi, tregonte mirëkuptim dhe simpati të jashtëzakonshme për ndjenjat dhe idetë e fuqishme por ende të pazhvilluara të cilat këto përshtypje i kishin motivuar tek unë, dhe atë aq shumë, sa që, kur shkruaja ndonjë kryeartikull në të cilin përshkruaja udhëtimet e mia në Lindjen e Afërt, ndjehesha sikur i drejtohem asaj:

"Kur evropiani udhëton në cilindo vend të Evropës që më parë nuk e ka parë, ai edhe më tej lëvizë në qarkun e vet edhe pse ndoshta pak më të zgjeruar dhe mund lehtë të kuptohet dallimi midis gjërave që shprehia ia ka bërë të afërta dhe të rejave që tash i hasë. Sepse, çkado që të jemi, gjermanë ose anglezë, kudo që të udhëtojmë nëpër Francë, Itali ose Hungari, fryma Evropiane neve të gjithëve na bashkon. Duke jetuar në zonën qartë të definuar të asociacioneve, ne jemi në gjendje ta kuptojmë njëri - tjetrin dhe të tjerët të na kuptojnë përmes këtyre asociacioneve sikur përmes gjuhës së përbashkët. Këtë fenomen e quajmë "bashkësi e kulturës". Të qenët e saj pa dyshim është përparësi; por sikur edhe të gjitha përparësitë që dalin nga shprehia, kjo nganjëherë është edhe mangësi; nganjëherë zbulojmë se jemi të përshkuar me atë shpirt universal sikur me pambuk, se me këtë jemi të përkundur në përtacinë e shpirtit, se kjo na ka shpënë deri tek ajo që ta harrojmë ecjen nëpër tërkuzën e kohëve tona të mëparshme, kreative - atë kapjen për realitetet e pakapshme. Në ato kohë të mëparshme ato ndoshta do të quheshin "mundësi të pakapshme", kurse njerëzit që janë vënë gjurmëve të tyre - qofshin shpikës, qofshin aventuristë ose artistë kreativë - gjithmonë kanë kërkuar vetëm burimet më të fshehura të je-

tës së tyre. Ne që kemi ardhur më vonë po ashtu kërkojmë jetën tonë individuale - por ne jemi të magjepsur nga dëshira që ta sigurojmë jetën tonë individuale para se ajo vetë të zbulohet. Kurse ne në mënyrë të paqartë parandajmë mëkatën e fshehur në një përpjekje të tillë. Shumë Evropianët një gjë të tillë sot fillojnë ta ndjejnë: rrezikun tmerrues nga shmangia rrezikut.

Në këtë libër përshkruaj udhëtimin në vendet të cilat kanë "dallim" mjaft të madh prej Evropës që të mund lehtë të kalohen; kurse dallimi, në një mënyrë, është më i afërt me rrezikun. E lëshojmë sigurinë e rrethit tonë mjaft monoton, në të cilin pak ka nga ajo çka është e panjohur, e kurrëgjë nuk ka çka të befason dhe hyjmë në çudinë e tmerrshme të një bote "tjetër".

Të mos e mashtrojmë veten; në këtë botën tjetër mbase do të kuptojmë këtë apo atë prej përshtypjeve të shumta pitoreske të cilat i përjetojmë, por nuk mundemi kurrë - siç do të mundeshim në rastin e ndonjë vendi përrëndimor - ta konceptojmë në mënyrë të vetëdijshme pikturën e plotë. Ajo çka na ndanë ne prej asaj botës "tjetër" është diç më shumë se hapësira. Si të komunikohet me ta? Nuk mjafton ta flasësh gjuhën e tyre; që ta kuptojmë ndjenjën e tyre të jetës do të duhej plotësisht të hyjmë në mesin e tyre dhe të fillojmë të jetojmë në bashkësitë e tyre. A është e mundshme një gjë e këtillë?

Dhe a thua kjo do të ishte e dëshirueshme? Më në fund, kjo do të mund të ishte një marrëveshje e keqe që shprehitë tona të vjetra, të njohura ideore të ndërrohen për të huajat, të panjohurat.

Mirëpo, a thua, vallë, vërtet jemi të përjashtuar nga ajo botë? Nuk mendoj ashtu. Ndjenja jonë e përjashtueshmërisë kryesisht qëndron në gabimin e të jashtëzakonshmes për mënyrën e të menduarit tonë përrëndimor; jemi mësuar ta nënçmojmë vlerën kreative të asaj që nuk është

e zakonshme dhe përherë provojmë që ta dhunojmë, ta përvetësojmë, ta marrim, në mënyrën tonë vetjake, në botën tonë vetjake intelektuale. Më duket se, megjithatë, koha jonë e trazirave nuk lejon më prova të tilla mburrëse; shumë prej nesh fillojnë ta kuptojnë se dallimi kulturor mundet, dhe duhet, të kapërcehet me mjete të tjera e jo me anë të grabitjes intelektuale; ndoshta mund të mbizotërohet duke ia lëshuar asaj kulture shqisat tona.

Meqë kjo botë e pazakonshme aq themelësisht tjetërfare nga e gjithë ajo që dini te shtëpia; Pasi ofron aq shumë agresivitet ndaj të panjohurës në fotografi dhe zë, ndonjëherë ju rrëmben, po qe se vetes i lejon të bëheni i kujdesshëm, me anë të përkujtimit momental të gjërave kaherë të ditura dhe moti të harruara, të atyre realiteteve të pakapshme të jetës suaj individuale. Kurse kur ju rrëmben kjo frymë e përkujtimit në anën tjetër të gremi-nës e cila e ndanë botën tuaj prej asaj tjetrës, asaj të pazakonshmes, i shtroni pyetje vetes a thua ndoshta në të - dhe vetëm në të - qëndron domethënia e të gjitha bredhjeve poshtë-lart: të bëhesh i vetëdijshëm për pazakonshmerinë e botës që ju rrethon dhe kështu sërish ta zgjosh realitetin tënd personal, të harruar..."

Pasi Elza në mënyrë intuitive e kuptonte atë që unë mundohesha t'ia përcjellë në mënyrë joadekuate, sikur dikush që vendnumëron në terr, me këtë bëlbëzim, qartë e ndjeja se ajo, dhe vetëm ajo, ka mund ta kuptojë çka dëshiroj dhe të më ndihmojë në hulumtimet e mia...

## - 2 -

Edhe një ditë bredhjesh lart-poshtë kaloi. Në vete ndjej qetësi, por e qetë është edhe nata rreth meje. Era rrëshqet butë nëpër dina dhe krijon valë të imta ranore në shpatiet e tyre. Në rrethin e ngushtë të dritës rreth zjarrit e

shoh figurën e Zejdit të dëfryer rreth kusiave dhe tavave, hejbet tona aty ku i kemi hedhur kur qemë ndalur të kalojmë natën edhe shalat tona me mollëzat e tyre të larta prej drurit. Menjëherë pas kësaj, tashmë duke u futur në terr, trupat e mbledhur të të dy deveve tona, të lodhura pas marshimit të gjatë, me qafa të zgjatura në rërë; kurse ende më larg, mezi e perceptueshme nën dritën e yjeve, por aq afër sikur rrahjet e zemrës sonë, shkretëtira e zbrazët.

Në botë ka shumë peizazhe të bukura, por, mendoj, asnjë që mund ta formësojë shpirtin njerëzor në një mënyrë kaq sovrane. Në koprracinë dhe varfërinë e vet, shkretëtira e privon jetën prej të gjitha arsyeve, prej të gjitha llojeve të lajthitjeve me të cilat ndonjë natyrë më bujare mund ta mashtrojë shpirtin njerëzor dhe ta shtyjë t'i përcjellë halucionet e tij individuale në botë rreth vetes. Shkretëtira është lakurige dhe e pastër dhe nuk njih kompromise. Ajo i fshinë prej zemrës së njeriut të gjitha fantazmat e bukura që do të mund të shërbenin si maskë për mendimin lakmues dhe në këtë mënyrë e bën të lirë që t'i dorëzohet Absolutit që nuk ka të ngjashëm; I Cili është më larg nga e gjithë ajo që është larg, kurse më afër nga e gjithë ajo që është afër.

Prej kur njeriu ka filluar të mendojë, shkretëtira ka qenë djepi i të gjitha besimeve në Një Zot. Vërtet, madje edhe në rrethinën e këndshme dhe në klimën e pëlqyeshme njerëzit kanë pasur, në të shumtën e rasteve, njëfarë parandjenje të ekzistimit dhe vetëmsisë së Tij, për shembull, në nocionin e vjetër grek të Moirës, me fuqi të pakufishme pas dhe mbi zotat olimpikë; megjithatë, konceptet e tilla asnjëherë nuk kanë qenë më tepër se ndonjë ndjenjë e paqartë - derisa njohuria nuk u ka ardhur, me vërtetësinë shkëlqyese, njerëzve të shkretëtirës dhe prej shkretëtirës. Nga shkurrja gjembore përvëluese në shkretëtirën Midian u dëgjua zëri i Zotit drejtuar Moi-

siut; në shkretinë e shkretëtirës judaike Jezu Krishti e pranoi porosinë për Mbretërinë e Zotit; kurse pikërisht në Shpellën Hira, në kodrinat shkretënore në afërsi të Mekës, i erdhi edhe thirrja e parë Muhammedit nga Arabia.

I erdhi në atë grykë të ngushtë, të thatë ndërmjet kodrinave gurore, asaj lugine lakuriqe të përcëlluar në diellin shkretënor - universalja Po jetës, edhe asaj shpirtërore edhe asaj trupore; thirrja të cilës i ishte shkruar t'i japë formë dhe qëllim masës amorfe fisnore kurse, me anë të saj, për disa dhjetëvjeçarë të zgjerohet si flaka dhe premtimi, në Perëndim madje deri te Oqeani Atlantik kurse në Lindje deri te muri i lartë kinez; i ishte shkruar të mbetet fuqi e madhe shpirtërore deri në ditët e sotme, më tepër se trembëdhjetë shekuj, duke mbijetuar çdo shkatërrim, duke mbijetuar madje edhe qytetërimin e madh që e krijoi; thirrja e cila i erdhi Pejgamberit nga Arabia...

Fle dhe zgjohem. Mendoj për ditët që kanë kaluar e prapëseprapë ende nuk janë të vdekura. Sërish fle dhe ëndërroj; sërish zgjohem dhe qëndroj ulur; ëndrra dhe kujtimet rrjedhin butë së bashku në gjysmëdritën e zgjuarjes sime.

Natës po i afrohet fundi. Zjarri plotësisht është fikur. Zejdi fle i pështjellur në batanien e vet; devetë tona rrinë shtrirë të palëvizshme, si dy mogila toke. Yjet ende janë të dukshëm dhe do të mund të mendonit se ka ende kohë për të fjetur; por posht në qiellin lindor paraqitet, paqartë e lindur nga errësira, dritëza e zbehtë mbi rripin tjetër, më të errët i cili qëndron mbi horizont: kasnecët bineqë të agimit, kohës së lutjes së mëngjesit.

Pjerrtas mbi veten time e shoh yllin e mëngjesit, të cilin arabët e quajnë edhe-Dhuhra, "Drita". Po qe se i pyetni për të, do të thonë se Drita dikur ka qenë grua...

Dikur kanë qenë dy melekë, Haruti dhe Maruti, të cilët kanë harruar të bëhen të dëgjueshëm, ashtu siç iu ka

hije melekëve, kështu që janë lëvduar me pastërtinë e tyre të paarritshme: "Ne jemi të krijuar prej dritës; ne jemi mbi të gjitha dëshirat dhe mëkatet, të dalluar prej bijve të dobët të njeriut, bijve të barkut të errët të gruas". Por, ata kanë harruar se virgjëria e tyre nuk ka dalë nga fuqia e tyre vetjake, sepse kanë qenë të pastër vetëm pse nuk i kanë njohur dëshirat dhe kurrë nuk kanë qenë të thirrur t'i kundërshtojnë. Mendjemadhësia e tyre nuk i pëlqeu Zotit dhe Ai u tha: "Zbritni në tokë dhe durojeni sprovën tuaj aty". Melekët mburravecë zbritën në tokë dhe u endën poshtë-lart, në trupin njerëzor, në mesin e njerëzve. Pikërisht natën e parë e takuan një grua e cila ishte mjaft e bukur prandaj njerëzit e thirrnin Dritë. Kur dy melekët e panë atë me sytë e njeriut dhe me ndjenjat të cilat tash i kishin, ata u habitën dhe, pikërisht sikur të jenë bijë të njeriut, tek ata u zgjua dëshira që ajo të bëhet e tyre. Secili prej tyre i tha asaj: "Bëhu e imja"; por Drita u përgjigj: "Unë i takoj tjetërkujt; po qe se më dëshironi, duhet të më rrëmbeni prej tij". "Ata e mbytën njeriun dhe, me duar ende të përgjakura nga gjaku i derdhur me padrejtësi, e kënaqën ephsin e vet të zgjuar për grua. Por, sapo u liruan nga dëshira, dy ish-melekët u vetëdijësuan se në natën e parë të tyre në tokë bënë dy gabime - vrasje dhe kurvëri - dhe se mburrja e tyre nuk kishte më kurrfarë kuptimi... Kurse Zoti u tha: "Vendosni a do ta merrni dënimin në këtë apo në botën e ardhshme". Melekët e rënë, në pendimin e tyre të hidhur, e zgjodhën dënimin në këtë botë dhe Zoti urdhëroi të varen në zinxhirë midis tokës dhe qiellit dhe ashtu të varur të qëndrojnë deri në Ditën e Gjykimit, si vërejtje melekëve dhe njerëzve se çdo virtyt e shkatërron vetveten po qe se e humb modestinë. Por Pasi syri i njeriut nuk mund t'i shohë melekët, Zoti e shndërroi Dritën në yll në qiezzll në mënyrë që njerëzit përherë të mund ta shohin dhe,

duke përkujtuar rrëfimin e saj, të përkujtojnë edhe fatin e Harutit dhe Marutit. Skica e legjendës është shumë më e vjetër se Islami; duket se prejardhjen e ka prej miteve të cilët Semitët e vjetër i kanë trilluar rreth perëndeshës së vet Ishtar, Afroditës greke të ditëve të mëvonshme, kurse të dyja barazohen me planetin të cilin sot e quajmë Venerë. Megjithatë, rrëfimi mbi Harutin dhe Marutin, në formën në të cilën unë e kam dëgjuar, është prodhim tipik i frymës muslimane, ilustrim i idesë se pastërtia abstrakte, ose liria prej mëkateve, nuk mund të ketë vlerë morale përderisa themelohet pastër në mungesë të motiveve dhe dëshirave; a nuk është vazhdimisht shquarja e nevojave që të zgjedhet midis të drejtës dhe të shtrembtës supozim i çdo moraliteti?

Të mjerët Haruti dhe Maruti këtë nuk e ditën. Për shkak se, si melekë, kurrë nuk kanë qenë të vënë në sprovë, ata veten e kanë konsideruar të pastër dhe moralisht shumë larg njerëzve, duke mos e kuptuar se heqja dorë prej "legjitimitetit" të pasioneve trupore tërthorazi nënkupton heqjen dorë prej çdo vlere morale të përpjekjeve njerëzore: vetëm prania e motivit, sprovave dhe ndeshjeve - mundësia e zgjedhjes - e shndërron njeriun, dhe vetëm atë, në qenie morale, qenie e dhuruar me shpirt.

Pikërisht në bazë të këtij konceptimi, Islami, i vetmi në mesin e shumë religjioneve, shpirtin e njeriut e konsideron fotografi të "personalitetit" të tij e jo fenomen të pavarur. Sipas kësaj, për muslimanët, rritja shpirtërore e njeriut është i lidhur në mënyrë të pandashme me të gjitha format tjera të natyrës së tij. Pasionet fizike janë pjesë përbërëse e kësaj natyre; jo rezultat i ndonjë "mëkati të parë" - nocion i huaj për etikën islame - por i fuqive pozitive, të dhëna nga Zoti, që të jenë të pranuar dhe si të tillë të shfrytëzohen me mend; nga kjo, për njeriun nuk është problem si t'i shtyjë nevojat e trupit të tij

por si t'i harmonizojë me nevojat e shpirtit të tij në atë mënyrë që jeta të bëhet e plotë dhe e drejtë.

Rrënja e kësaj jete gati të vërtetuar moniste, ndodhet në të konceptuarit islam se natyra burimore e njeriut në thelb është e mirë. Përkundrajt idesë kristiane se njeriu u lind mëkatar, ose mësimëve hinduse se ai në pikënisje është i ulët, i papastër dhe duhet me mundime të kalojë nëpër një sërë inkarnimesh të gjata drejt cakut përfundimtar të përsosurisë, në Kur'an thuhet: "Me të vërtetë e kemi krijuar njeriun në formën më të përsosur", - gjendje e pastërtisë që mund të priset vetëm me sjellje të këqija - "e pastaj e kemi shpënë në një shkallë më të ulët, përveç atyre që besojnë në Zotin dhe bëjnë vepra të mira".

### - 3 -

Kopshtet e palmave të Hailit shtrihen para nesh.

Ndalemi pranë një pyrgu të vjetër, të prishur rojesh që të përgatitemi për të hyrë në qytet; zakoni i vjetër arab, i cili përherë kujdeset për pamjen vetjake, kërkon prej udhëtarit që të hyjë në qytet i veshur me teshat më të mira, i freskët dhe i pastër sikur sapo i ka hipur deveve të vet. Kështu që e shfrytëzojmë ujin tonë që na ka mbetur, i lajmë duart dhe fytyrën, i shkurtojmë mjekrat e lëshuara dhe i nxjerrim pelerinat më të bardha prej hejbeve. E shkundim pluhurin e shkretëtirës prej abajave dhe prerjeve pitoreske të hejbeve tona, i mbulojmë deve të me zbukurimet e tyre më të mira dhe jemi të gatshëm që të paraqitemi në Hail.

Ky qytet ka shumë më tepër elemente arabe se sa, të themi, Bagdadi ose Medina; ai nuk ka kurrfarë elemente prej popujve dhe vendeve joarabe; ai është i pastër dhe autentik sikur kavanozi me tëmbël të posamjelur. Kurrfarë teshash të huaja nuk mund të shihen në bazar; ve-

tëm abaja të gjera arabe, kufija dhe igale. Rrugët janë shumë më të pastra se në cilindo qytet tjetër në Nexhd, i cili është i njohur me pastërtinë e vet jolindore (me siguri për atë se populli i këtij vendi, për shkak se ishte përherë i lirë, ka ruajtur masën e vetërespektimit më shumë se kudo tjetër në Lindje). Shtëpitë, të ndërtuara prej shtresave horizontale të baltës së ngjeshur, janë në gjendje të mirë përveç mureve të rrënuara të qytetit që dëshmojnë për luftën e fundit midis Ibn Saudit dhe familjes së Ibn Rashidit dhe pushtimin e Ibn Saudit të qytetit në vitin 1921.

Çekanët e kujunxhinjve formësojnë të gjitha llojet e enëve, sharrat e zdrukthëtarëve me fishkëllimë depërtojnë në dru, këpucëtarët i mbërthejnë shollat e sandalleve. Devet e ngarkuara me karburante dhe rrësheqë plot tëlyer e çajnë turmën; devetë e tjera, që beduinët i kishin sjellë për shitje, e përmbushin ajrin me palljet e tyre. Duart e përvujtura i prekin duqet e pikturuara prej El-Hasës. Ankandët, në mënyrë të pashmangshme të pranishëm në çdo qytet arab, shkojnë poshtë e lart nëpër bazar dhe, duke thirrë me zë, e ofrojnë mallin e tyre për shitje. Aty-këtu mund të shihni sokolë gjahtarë se si kërcëjnë lart-poshtë në traversat e drunjve, të lidhur me rripa të hollë lëkure. Zagarët saluki, ngjyrë mjalti, në mënyrë përtacore i shtrijnë ekstremitetet e tyre të harmonishme në diell. Beduinët shtathedhur në abajat e vjetëruara, shërbëtorë të veshur mirë dhe truprojet e Emirët - gati të gjithë prej zonave jugore - përzihen me tregtarët prej Bagdadi, Basre dhe Kuvajti dhe me nikoqirët prej Haili. Këta nikoqirë - do të thotë burrat, sepse prej grave mezi mund të shihni diçka me përjashtim të abajës së zezë e cila e mbulon kokën dhe trupin - i takojnë njëres prej racave më të bukura në botë. I gjithë gracioziteti i shfaqjeve dhe lëvizjeve që ka arritur populli arab sikur është

mishëruar në këtë fisin Shamar, për të cilin poetët e paraislamit kanë kënduar: "Në rrafshnalta jetojnë burra të regjur të shpatës dhe gra të ndershme e krenare".

Arritëm deri te oborri i Emirit, ku mendojmë t'i kalojmë dy ditët vijuese, dhe e takojmë nikoqirin tonë si gjykon para derës hyrëse. Emir ibn Musaadi i takon degës Xhilu të familjes Ibn Saud dhe është kunat i mbretit. Njëri prej mëkëmbësve më të fuqishëm mbretërorë e ka marrë emrin "Emiri i Veriut" për shkak se e mbanë jo vetëm krahinën Xhebeli Shamar por tërë Nexhdin Verior deri te kufiri me Sirinë dhe Irakun - krahinë e madhe gati sikur Franca.

Emiri (miku im i vjetër) dhe disa beduinë sheikë prej stepe rrinë ulur në bankën e gjatë, të ngushtë të ndërtuar prej tullave përgjatë murit të oborrit. Në rendin e dytë, në fund të këmbëve të tyre, rrinë galuç raxhaxhilët e Ibn Musaadit, kalorësit me pushkë dhe shpata lakore në këllëfet prej argjendi, të cilët i mbajnë me vete tërë ditën, jo aq për mbrojtje sa për prestigj; pranë tyre zbutësit e fajkonjve me zogjtë në duar me dorëza, shërbëtorët, beduinët, shumë përcjellës, të mëdhenj e të vegjël, deri te kujdestarët e kuajve - të gjithë ndjehen të barabartë si njerëz përkundër dallimeve në pozitat e tyre. E si mund të ishte ndryshe në këtë vend ku askujt nuk i drejtoheni me "zotëri" përveç Zotit në lutje? Të kthyer me fytyrë kah ata, rrinë galuç në gjysmërreth të gjerë beduinët dhe qytetarët të cilët ia shtrojnë ankesat dhe rekomandimet e tyre Emirit për t'i sheshuar.

"Ehlen ve sehlen - Zoti u dhashtë jetë!"

E putha Emirin në majë të hundës dhe në ballë, kurse ai mua në të dy faqet dhe më uli në bankë pranë vetes. Zejdi u vendos në mesin e raxhaxhilëve.

Ibn Musaadi më prezentoi para musafirëve të tij të tjerë; disa fytyra më duken të reja e disa të njohura prej vi-

teve të mëparshme. Në mesin e tyre është Gadban ibn Remali, kryeshejhu i Sanxharëve Shamarë - ai luftëtar i vjetër i mrekullueshëm të cilin përherë e quaj "dajë". Askush nuk do të thoshte se ai, sipas pamjes së tij gati të plakur, është njëri prej prijësve më të fuqishëm në veri, kurse aq e ka zbukuruar gruan e tij të re me ar dhe stoli të çmuara saqë, sipas mendimit të përgjithshëm, dy shërbëtore duhet t'i ndihmojnë kur të dëshirojë të dalë prej tendës së saj të madhe të ngritur në gjashtëmbëdhjetë shtylla. Ma luan syrin derisa më përqafoi dhe më pëshpëriti në vesh:

"Ende nuk ke grua të re?", - në çka unë mund t'i përgjigjesha vetëm me buzëqeshje dhe me mbledhjen e supeve.

Emiri Ibn Musaad duhej ta kishte dëgjuar këtë ngacmim sepse u qesh me zë dhe tha:

"Kafe!". Atë e përsëriti shërbëtori që ishte më afër Emirit; ai në skaj të rendit e pranoi thirrjen "kafe!" - dhe kështu derisa më në fund urdhri ceremonial nuk arriti derën e oborrit dhe përgjigjen prej brenda. Pas pak kohësh u paraqit shërbëtori duke bartur enën tradicionale të bakrit për kafe në dorën e majtë dhe disa filxhanë të vegjël në të djathtën, së pari ia mbushi Emirit, pastaj mua, e pastaj i shërbeu musafirët tjerë sipas gradës së tyre. Filxhani mbushet një ose dy herë kurse kur musafiri tregon se e ka mjaft, sërish mbushet dhe i jepet tjetrit me radhë.

Shihet qartë se Emiri është kureshtar t'i dijë rezultatet e udhëtimit tim deri në kufirin e Irakut, por ai e zbuloi interesimin e tij vetëm me pyetje të shkurtëra rreth asaj se ç'më ka ndodhur në rrugë, duke lënë hulumtimin e plotë për çastin kur do të mbetemi vetëm. Pastaj vazhdoi hetimi gjyqësor të cilin ardhja ime e ndërpreu.

Një gjykim i tillë joformal do të ishte i papërfytyrueshëm në Perëndim. Emiri, si sundues dhe gjykues, natyrisht gëzon çdo respekt - por nuk ka as gjurmë poltroni-

teti në sjelljen e bediunit ndaj tij. Çdo akuzues dhe i akuzuar me krenari mbetet i vetëdijshëm për personalitetin e tij të lirë; ata me gjestet e tyre nuk lëkunden, zëri i tyre është shpesh më i ngritur dhe i sigurt kurse secili i drejtohet Emirrit sikur vëllait më të madh duke e thirrë atë - siç është adet i beduinve edhe në raport me vetë mbretin - me emrin e tij e jo me titullin e tij. Nuk ka as gjurmë fodullëku në sjelljen e Ibn Musaadit. Fytyra e tij e bukur, me mjekër të shkurtër, të zezë, shtati i tij mesatar, figura ngapakëz e rrastë flet për vetpërmbajtjen e pastudiuar dhe dinjitetin spontan të cilat në Arabi aq shpesh shkojnë në dorë për dore me forcën e madhe. Ai është serioz dhe i fortë. Me fjalët autoritative menjëherë i zgjidhë rastet më të thjeshta, kurse ato të ndërlikuarat, që kërkojnë gjykatës profesional i udhëzon te kadiu i qarkut.

Nuk është lehtë të jesh autoritet suprem në krahinën e madhe beduinase. Njohja e thellë e fiseve të ndryshme, marrëdhënieve familjare, personaliteteve udhëheqëse, kullotave fisnore, ndodhive të kaluara dhe reagimeve të tashme është e domosdoshme që të arrihet deri te një zgjidhje e drejtë në ngatërresën e shqetësuar të ankesës beduinase. Kujdesi në sjellje është po ashtu i rëndësishëm sikur edhe mprehtësia e të gjykuarit, kurse të dyja duhet vepruar harmonishëm me saktësinë e jashtëzakonshme në mënyrë që t'i iket gabimit; sepse, beduinët siç nuk e harrojnë kurrë shërbimin që iu bëhet, ata kurrë nuk e harrojnë as vendimin e gjyqit të cilin e konsiderojnë të padrejtë. Nga ana tjetër, vendimin e drejtë gati përherë e pranojnë vullnetarisht, bile edhe ata kundër të cilëve është drejtuar. Ibn Musaadi matë në pajtim me të gjitha këto kushte me siguri më mirë se cilido emir tjetër i Ibn Saudëve; ai është aq i matur, aq i qetë dhe aq pa kundërthënie të brendshme saqë instinkti i tij gati gjithmonë ia tregon rrugën e drejtë kurdo kur arsyeja e tij vjen

në qorrsoak. Ai noton në jetë; ai lejon ta udhëheqin, ta bartin dhe të sundojnë me të duke iu përshtatur atyre.

Pikërisht dy beduinë zhelanë e prezentojnë grindjen e tyre para tij me fjalë dhe lëvizje shqetësuese. Sipas rregullit, me bediunët është vështirë të dilet në skaj; gjithmonë ka diçka të paparashikueshme në ta, ndjeshmëri shqetësuese që nuk njeh kompromis - gjithmonë qielli dhe ferri drejtpërdrejt njëri pranë tjetrit. Tash mund të shoh se si Ibn Musaadi i shkoqitë pasionet e tyre gjaknxeha dhe i qetëson ato me fjalë të buta. Do të mund të mendohej se njërin do ta urdhërojë të heshtë derisa tjetri e prezenton atë çka konsideron se është e drejtë e tij; por jo - ai i lejon të flasin që të dytë në të njëjtën kohë, t'i bërtasin njëri - tjetrit kurse vetëm herë-herë iu ndërhyjnë me ndonjë fjalë ose pyetje - kështu që menjëherë vërshohet me argumentet e tyre të flakta; ai lëshon dhe duket se tërhiqet dhe ndërhyjnë sërish vetëm pak më vonë me vërejtjen gjegjëse. Kjo është skenë mallëngjyese, ky adaptim i frymës vetjake të gjykatësit ndaj realitetit të cilin e komentojnë dy njerëz të zemëruar; jo aq gjurmim pas të vërtetës në



Emir Ibn Musaadi dhe autori

kuptimin juridik, se sa zbulim i ngadalshëm i realitetit të fshehur objektiv. Emiri i afrohet këtij qëllimi shkallërisht, e nxjerr të vërtetën, si me ndihmën e penit të hollë, ngadalë dhe me durim, gati në mënyrë të pahetueshme edhe për paditësin edhe për të paditurin - përderisa ata papritmas nuk ndalen, të hutuar e shikojnë njëri - tjetrin dhe kuptojnë: vendimi është shqiptuar - vendimi aq qartë i drejtë saqë nuk kërkon kurrfarë shpjegimi të mëtejshëm... Në atë rast njëri prej tyre çohet duke u lëkundur, e rregullon abajën e vet dhe e tërheq kundërshtarin e vet të deritanishëm për mënge gati në mënyrë miqësore: "Eja" - dhe që të dytë tërhiqen, ende ngapak të hutuar dhe në të njëjtën kohë të lehtësuar, duke pëshpëritur uratën për Emirin.

Shfaqja është vepër e jashtëzakonshme, vepër e vërtetë artistike: prototip, më duket, i atij bashkëpunimi të frytshëm midis autoritetit gjyqësor dhe drejtësisë e cila në kuvendet dhe gjyqet perëndimore ende është në pekena, kurse këtu paraqitet në përsosurinë e vet të plotë në sheshin e pluhurosur para oborrit të një emiri arab...

Ibn Musaadi, duke u mbështetur pa kokëçarje për muri, e mori rastin tjetër. Fytyra e tij, e fuqishme, e rrudhur, me sytë e vendosur thellë që ngrohën dhe depërtojnë, është fytyrë e prijësit të vërtetë njerëzor, përfaqësues i vërtetë i vetive më të larta të racës së vet: me zemër dhe arsye të shëndoshë.

Disa nga të pranishmit qartë e ndjejnë të njëjtin admirim. Njëri prej tyre që rri ulur në tokë para meje - ai është beduin prej fisit Harb dhe njëri prej rojave të Emirrit - e lakon qafën e vet nga unë me fytyrë të qeshur.

"A nuk është sikur ai sulltani për të cilin Mutenebi thotë:

E takova atë, shpata shkëlqyese i ndodhej në veprim,  
E pashë atë kur me shpatën e përgjakur vërsulej,

Dhe përherë prej të gjithë neve më i miri tregohet,  
Por më e mira e të gjithave i është arsyeja fisnike..."

Nuk më duket e pabesueshme ta dëgjoj beduinin analfabet se si citon vargjet e poetit të madh arab i cili ka jetuar në shekullin e dhjetë - gjithqysh jo aq e pabesueshme siç do të ishte të dëgjosh fshatarin bavarez ta citojë Goethean ose punëtorin anglez të skeles ta citojë Villiam Blakean ose Shellyan. Sepse, përkundër shtrirjes së arsimimit të përgjithshëm në Perëndim, të arriturat kulminante të kulturës perëndimore në të vërtetë nuk i ndanë evropiani ose amerikan mesatar - përderisa, nga ana tjetër, një shtresë mjaft e gjerë e të paarsimuarve e diku madje edhe e muslimanëve analfabetë me të vërtetë, në jetën e përditshme, i ndajnë të arriturat e të kaluarës së vet. Pikërisht sikur ky beduin që ishte i aftë t'i kujtojë vargjet gjegjëse të Mutenebiut që ta ilustrojë situatën në të cilën prezentonte si dëshmitar, shumë zhelanë dhe të pashkolluar persianë - ujëbartësi, hamalli në bazar, ushtari në ndonjë vend të izoluar kufitar - mbajnë në kujtesën e tyre vargje të shumta të Hafizit ose të Xhamiut ose të Firdevsit dhe i inkuadrojnë me kënaqësi të posaçme në bisdatat e tyre të përditshme. Edhe pse në një masë të madhe e kanë humbur atë fuqinë krijuese e cila thesarin e tyre kulturor e ka bërë aq kolosal, këta popuj muslimanë kanë edhe tash kontakt të drejtpërdrejtë, të gjallë me kolosët e tyre.

Ende më kujtohet dita kur e kam zbuluar këtë në bazar në Damask. E mbaja në dorë takëmin, një shtambë të madhe prej balte të pjekur. Kishte një formë të çuditshme madhështore: e madhe dhe e rrubullakët, ngjashëm sikur topi i sheshuar gati në proporcione muzikore. Nga forma e rrumbullakët e faqeve të saj, e cila në vete kishte njomësinë e fytyrës së gruas, dilnin dy dorëza të lakuara në harqe të përsosur të cilët do të mund të ishin në nder të amforës greke. Ishin të formësuara me

dorë; ende mund t'i njihja shenjat e gishtave të vorbëtarit modest në argjilë. Përreth brenda buzës së lakuar të shtambës e kishte gdhendur me lëvizje të butë, të sigurt të penës arabeskën e hajthshme si paralajmërimi i trëndafilave në çelje. Ka punuar shpejt, gati pa kokëçarje derisa e ka krijuar këtë thjeshtësi madhështore e cila na e përkujton tërë lavdinë e vorbërisë selxhuke dhe persiane që aq shumë e admirojmë në muzeumet Evropiane; kurse ai nuk ka pasur për qëllim të krijojë vepër artistike. E gjithë ajo çka ka bërë ka qenë vorbë për të zier - asgjë tjetër përveçse aso vorbe të cilën cilido felah ose beduin ka mund ta blejë në bazar cilëndo ditë qoftë për ca para të imta...

E kam ditur se grekët kanë krijuar përsosuri të ngjashme ose më të mëdha, ndoshta po ashtu edhe vorba për zierje; sepse edhe ata - ujëbartës, hamaj në bazar, ushtarë dhe vorbëtarë - kanë marrë pjesë realisht në kulturën e cila nuk ka filluar vetëm në entuziazmin krjues të disa njerëzve të zgjedhur, në disa maja që mund t'i arrijnë vetëm njerëzit gjenialë, por ka qenë e përbashkët për të gjithë. Mburrja e tyre me gjërat e bukura, të cilat kanë qenë pjesë e asaj kulture, ka qenë pjesë përbërëse edhe e punës së tyre të përditshme; pjesëmarrje e pandërprerë në posedimin e gjallë, të përbashkët.

Derisa e mbajta këtë enë në duart e mia e kam ditur se: të bekuar janë njerëzit të cilët në vorbat e tilla e ziejnë ushqimin e tyre të përditshëm; të bekuar janë ata, e drejta e të cilëve në thesarin kulturor është më e madhe se sa mburrja e zbrazët.

- 4 -

A nuk do të ma plotësosh dëshirën të drekosh me mua, Muhamed?" Zëri i Emirit Ibn Musaad i ndërpreu ëndërrimet e mia. Shikoj - kurse Damasku po tërhiqet në

të kaluarën, të cilës edhe i takon, e unë ulem sërish në bankë pranë "Emirit nga Veriu". Seanca gjyqësore me siguri kishte mbaruar; një nga një shkonin paditësit. Ibn Musaadi u ngrit kurse me të edhe musafirët dhe përcjellësit e tij. Grupi i raxhaxhilëve hapi rrugë për të kaluar. Ashtu si kalonim ne nëpër derë, rendet e tyre mbylleshin dhe na ndiqnin neve në oborrin e pallatit.

Pak më vonë, Emiri, Gadban ibn Rimali dhe unë së bashku qëndronim ulur në drekë e cila përbëhej prej një pjate të madhe orizi me tërë qengjin e pjekur në të. Përveç nesh në dhomë ishin vetëm edhe dy përcjellësit e Emirit dhe një çift i zagarëve të artë "saluki".

Gadbani plak e vuri dorën në supet e mia dhe tha: "Ende nuk më je përgjigjur në pyetjen time - ende nuk ke grua të re?"

Qeshem në këmbëngulësinë e tij: "E kam një grua në Medinë, siç e din. Pse të marr tjetër?"

"Pse? Zoti më ruajt! Një grua - kurse ti je ende i ri! Ta dish, kur unë i kisha vitet tua..."

"Kam dëgjuar se", - ndërhyri Emir ibn Musaadi, - "ti madje edhe tash nuk qëndron ashtu keq, sheik Gadban".

"Unë jam cifël e vjetëruar, Emir, Zoti të dhashtë jetë; por ndonjëherë më duhet trup i ri që t'i ngrohë këto eshtra të plakura të mia... Por më thuaj", - m'u kthye sërish mua, - "ç'u bë me atë mutajrianen, vjazën me të cilën u martove para dy vjetësh? Ç'ke bërë me të?"

"Asgjë, pra; për atë pikërisht edhe bëhet fjalë" iu përgjigja.

"Asgjë...?", - e përsëriti plaku duke i hapur sytë. "A thua ka qenë aq shumë e keqe?"

"Jo, përkundrazi, ka qenë shumë e bukur..."

"Për çka është fjala?", - pyeti Ibën Musaadi. - "Për cilën vajzë mutajriane bisedoni ju dy? Më shpjego, Muhamed".

Kështu ia shpjegova këtë martesë e cila nuk solli gjë.

Kam jetuar në Medinë, i pamartuar dhe i vetmuar. Një beduin prej fisit Mutajr, me emrin Fahad, kalonte orë të tëra çdo ditë në kafehanen time duke më argëtuar me rrëfime fantastike për heroizmat e tij nën Lavrencin gjatë kohës së luftës botërore. Një ditë ai më tha: "Nuk është mirë për njeriun të jetojë vetë sikur ti sepse gjaku do të ngjizet në damarë; duhet të martohesh". Kur në shaka kërkova prej tij që të ma gjejë nusen e ardhshme, ai m'u përgjigj: "Ajo është lehtë. Vajza e dhëndrit tim Mutriku ka arritur pikërisht moshën për martesë, e unë, si vëllai i nënës së saj, mund të të them se është jashtëzakonisht e bukur". Edhe më tej i disponuar për lojë, i thash të interesohet se këtë a do ta pëlqejë babai i saj. Dhe ja, ditën e nesërme Mutriku vetë erdhi deri tek unë, qartë i hutuar. Pas pierjes disa filxhana kafe dhe pas një ngurrimi të gjatë, ai më në fund më tha se Fahadi i ka treguar për gjoja dëshirën time të martohem me vajzën e tij. "Do të ishte nder për mua të bëhesh dhëndri im, por Rukija është ende fëmijë - ajo sapo i ka mbushur të njëmbëdhjetat..."

Fahadi u tranua kur dëgjoi për vizitën e Mutrikut. "Hajni, hajni rrenacak! Vajza ka pesëmbëdhjetë vjet. Nuk i pëlqen ta martojë për ndonjë jo-arab, por nga ana tjetër, ai di se ti je i afërt me Ibn Saudin dhe nuk dëshiron të të ofendojë me refuzimin haptas; prandaj rrejshëm pohon se ajo ende është fëmijë. Por mund të të them, ajo është tamam vajzë për martesë, - "m'u si shega e pjekur për ta këputur".

Sytë e plakut Gadban shkëlqyen në përshkrimin e këtillë: "Pesëmbëdhjetë vjet, e bukur dhe virgjëreshë... e pastaj, ai tha, asgjë! Çka do të mund të dëshiroje më tepër se kjo?"

"Prit, pra, derisa ta mbaroj rrëfimin... Patjetër të pranoj se fillova çdoherë e më tepër të interesohej, e ndoshta pak i ngacmuar edhe me këmbëngulësinë e Mutriku. Ia dhurova Fahadit dhjetë monedha ari dhe ai bëri gjithë çka ishte e mundshme që t'i bindë prindërit e saj ta martojnë për mua; një dhuratë e ngjashme iu dhurua edhe nënës së saj, motrës së Fahadit. Në realitet çfarë ndodhur në shtëpinë e tyre nuk di; e gjithë ajo çka di është se Mutriku më në fund e pranoi martesën..."

"Ky Fahadi", - tha Ibn Musaadi, - "si duket paska qenë dinak. Ai dhe motra e tij shihet qartë se kanë pritur prej teje dhurata edhe më të mëdha. E çka ndodhi pastaj?"

E vazhdova rrëfimin tim se si martesë u bë në mënyrë solemne pas disa ditësh pa prezentimin e nuses, të cilën, në pajtim me traditat, e përfaqësonte babai i saj si përfaqësues juridik i saj dhe bartës i pëlqimit të saj të cilin e vërtetojnë dy dëshmitarë. Rezultoi dasma me salltanet, me dhuratat e zakonshme për nusen (të cilën ende nuk e kisha parë), për prindërit e saj dhe për disa të tjerë të afërm të saj - në mesin e të cilëve, natyrisht, Fahadi ishte më i njohuri. Të njëjtën natë nusen në shtëpinë time e sollë nëna e saj dhe disa gra tjera me perçe, perde- risa prej kulmeve të shtëpive fqinje vashat këndonin këngë dasme në përcjellje të dajreve.

Në kohën e caktuar hyra në dhomën në të cilën më pritte nusja ime me nënën e saj. Nuk isha në gjendje ta dalloj njërin prej tjetrës, sepse të dyjat kanë qenë të mbuluara me perçe të zeza; kur i kam shqiptuar fjalët që kërkohej sipas traditës: "tash mund të tërhiqesh", njëra prej dy zonjushave të habitura u ngrit dhe qetë e lëshoi dhomën; kështu e kam ditur se ajo që ka ngelur ka qenë gruaja ime.

"E pastaj, biro, ç'ndodhi pastaj?", - më ngacmoi Ibn Rimali kur u ndala aty gjatë rrëfimit tim; Emiri shikon në mua djallëzisht.

"Pastaj... Rrinte aty, vajza e mjerë, sigurisht tejet e frikësuar Pasi në këtë mënyrë ia kishin dërguar njeriut të panjohur. Kurse kur kërkova prej saj, sa më butë që dija, ta zbulojë fytyrën, ajo vetëm edhe më fortë e shtrëngoi abajën rreth vetes".

"Ato përherë veprojnë ashtu!", - thirri Ibn Rimali. - "Ato përherë janë të frikësuar natën e parë të martesës; e, krahas kësaj, vashës së re i ka hije të jetë e turpshme. Por më vonë ato zakonisht janë të gëzuara - a thua, vallë, e ytja nuk ka qenë?"

"Pa, jo plotësisht. M'u dasht patjetër t'ia largoj perçen nga fytyra, e kur ia largova e pashë një vajzë jashtë-zakonisht të bukur, me fytyrë vezake ngjyrë gruri të pjekur, me sy të mëdhej dhe bishta të gjatë që vareshin deri te jëstuku në të cilin qëndronte ulur; por ajo vërtet ishte fytyrë fëmije - nuk ka mund të jetë më tepër se njëmbëdhjetë vjeçe, m'u ashtu si thoshte babai i saj... Makutëria i ka shtyrë Fahadin dhe motrën e tij që të ma tregojnë se gjoja është për martesë, përderisa Mutriku i mjerë ishte plotësisht i pafajshëm".

"Ani çka?", - pyeti Ibn Rimali, qartë duke mos kuptuar se çka mendoj. "Çka pengon njëmbëdhjetë vjeçe? Vajza rritet, apo jo? Ajo rritet më shpejt në shtratin e burrit..."

Emir ibn Musaadi tha: "Jo, sheik Gadban; ai nuk është prej Nexhdi sikur ti. Ai ka më tepër mend në kokën e tij". Duke qeshur i kthyer nga unë, ai vazhdoi: "Mos e dëgjo Gadbanin, Muhamed. Ai është prej Nexhdi, kurse shumica prej nesh i kemi mendtë jo këtu", - tregoi kokën e tij - "por këtu" - tregoi krejtësisht vendin tjetër të trupit të tij.

Të gjithë qesheshim kurse Gadbani pëshpëriste në mjekrën e tij: "Atëherë unë me të vërtetë kam më tepër mend se ti, Emir".

Në nxitjen e tyre, e vazhdova rrëfimin dhe iu thashë se, pa marrë parasysh botëkuptimet e Gadbanit plak në lidhje me këtë, mosha mjaft e re e nuses sime - mosha fëmijërore për mua nuk paraqitte kurrfarë dhurate të veçantë. Mund të ndjeja vetëm keqardhje për vashën e cila kishte rënë sakrificë e dinakërisë së ulët të dajës së saj. Me të jam sjellur sikur me fëmijën, duke e bindur se nuk duhet të më frikësohet; ajo nuk nxori asnjë fjalë, kurse dridhjet e zbulonin frikën e saj. Duke kontrolluar nëpër raft, gjeta një copë çokolatë të cilën ia ofrova; por ajo, Pasi kurrë në jetë nuk kishte parë çokolatë, e refuzoi me tundjen e shpejt të kokës. U përpoqa që ta qetësoj duke i rrëfyer rrëfim argëtues prej "Një mijë e një natë", por ajo si duket as që e kuptoi, e jo më ta konsiderojë qesharake. Më në fund i foli fjalët e para: "Më dhemb koka..." Mora një tabletë aspirine dhe ia dhash atë me një gotë me ujë. Megjithatë, kjo shkaktoi vetëm droje edhe më të madhe (më vonë e kam kuptuar se disa shoqe të saj i kanë thënë se të huajt prej shteteve tjera ndonjëherë u japin drogë grave të tyre natën e parë të martesës në mënyrë që t'i përfitojnë më lehtë).

Pas disa orësh arrita që ta bind se nuk kam qëllime agresive. Më në fund e mori gjumi si fëmijë çka edhe ishte, kurse për vete e rregullova shtratin në qilim në skaj të dhomës.

Të nesërmen në mëngjes i kam dërguar fjalë nënës së saj që vajzën ta marrë me vete në shtëpi. Gruaja ishte e tmerruar. Kurrë nuk kishte dëgjuar se burri ka refuzuar një copë të tillë të zgjedhur - virgjëreshën njëmbëdhjetëvjeçe - dhe duhet të ketë menduar se me mua vërtet nuk është diçka seriozisht në rregull.

"E pastaj?", - pyeti Gadbani.

"Asgjë - u shkurorëzova me të, duke e lënë po në atë gjendje siç më erdhi. Kjo nuk ka qenë punë e keqe për familjen e cila e mbajti edhe vajzën edhe mirazin, bashkë me të gjitha dhuratat e shumta. Sa më përket mua, flitej përreth se nuk kam cilësi burrërore kurse disa njerëz shpirtmirë përpiqeshin të më bindin se dikush më ka bërë magji, ndoshta gruaja ime, kurse mund të lirohem prej saj vetëm me kundër-magji".

"Kur mendoj në martesën tënde të ardhshme në Medine, Muhamed, dhe në djalin tënd", - thotë Emiri duke qeshur, - "jam i sigurt se ke fituar kundër-magji të forta".

## - 5 -

Më vonë gjatë natës, derisa përgatitesha për të fjetur në dhomën që ma kishin dhënë, e gjej Zejdin më të heshtur se zakonisht. Qëndron pranë derës dukshëm i humbur në mendime të thella, me mjekrën në gjoks dhe sytë e ngulitur në medalionin e kaltër dhe të myshqgjelbër në qilimin e Horosanit i cili e mbulonte dyshe-menë.

"Si ndihesh, Zejd, mbasi sërish gjendesh në qytetin e rinisë tënde pas atë vitësh?" - sepse më parë përherë refuzonte të hyjë në Hail kurdoherë kur kam pasur rast të shkoj atje.

"Nuk jam i sigurt, dajo", - u përgjigj ngadalë. "Njëmbëdhjetë vjet u bënë prej atëherë kur kam qenë për herë të fundit këtu. Ti e di se zemra nuk më ka lejuar që këtu të vij më herët dhe ta shikoj popullin e Jugut si sundon në oborrin e Ibn Rashidit. Mirëpo kohëve të fundit ia përkujtoj vetes fjalët e Librit:

Thuaj: "O All-llah, Sundues i çdo sendi! Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do dhe e përlu atë që do, e lartëson atë që do. Çdo e mirë është në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!"

S'ka dyshim, Zoti ia ka dhënë pushtetin familjes Ibn Rashid, por ata nuk kanë ditur ta shfrytëzojnë drejt. Kanë qenë bujarë ndaj njerëzve të vet por të ngurtë ndaj të afërmeve të vet dhe të panjerëzishëm në mendjemadhësinë e vet; kanë derdhur gjak, duke vrarë vëllai - vëllanë; kështu që Zoti ua mori pushtetin dhe ia dorëzoi Ibn Saudit. Mendoj se më nuk duhet ta vajtoj - a nuk është e shkruar në Libër: "Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është dëm për ju".

Ka njëfarë qetësie të ëmbël në zërin e Zejdit, qetësi e cila përmban vetëm pranimin e diçkaje që tashmë ka ndodhur dhe për atë shkak nuk mund të ndryshohet. Pikërisht këtë dorëzim të shpirtit musliman para pandryshueshmërisë së të kaluarës - njohjen se e gjithë ajo që ka ndodhur është dashur mu ashtu të ndodh dhe se nuk ka mund të ndodh ndryshe - shpeshherë perëndimorët e kanë marrë gabimisht si "fatalizëm" karakteristik i botë-kuptimit islam. Megjithatë, dorëzimi musliman fatit ka të bëjë vetëm me të kaluarën e jo edhe me të ardhshmen; ky nuk është refuzim i të vepruarit, të shpresuarit dhe të përmirësuarit, por refuzim i asaj që realiteti i së kaluarës të konsiderohet vepër e diçkaje tjetër e jo vepër e Zotit.

"Kurse përveç kësaj", - vazhdoi Zejdi, - "Ibn Saudi nuk sillel keq ndaj Shamarëve. Ata këtë e dinë; por a nuk e kanë përkrahur me shpata para tre vjetësh kur ai qeni Ed-Davish u çua kundër tij".

Me të vërtetë po, me zemërgjerësinë e të ngadhënjerëve e cila është mjaft karakteristike për arabët e vërtetë. Atë vit të kobshëm më 1929, kur lëkundeshin themelet e mbretërisë së Ibn Saudit nga goditjet e kryengritjes së madhe beduinase të cilën e udhëhoqi Fejsal Ed-Davishi, të gjitha fiset shamariane që jetonin në Nexhd e harruan armiqësinë e tyre të dikurshme ndaj mbretit, i ngjeshën

radhët rreth tij dhe në një masë të madhe i kontribuan fitores së tij kundër kryengritësve. Ky pajtim ka qenë vërtet i jashtëzakonshëm, sepse disa vjet para kësaj Ibn Saudi e pat pushtuar me forcë Hailin dhe në këtë mënyrë sërish e pat vënë supremacinë e Jugut ndaj Veriut. Kjo është aq më e rëndësishme në dritën e mosmarrëveshjeve shekullore në mes veti - e cila është më e thellë se lufta e dinastive për pushtet - midis fiseve shamariene dhe popullit të Nexhdit Jugor nga i cili e ka prejardhjen Ibn Saudi. Kjo mosmarrëveshje (të cilën edhe pajtimi i paradokohshëm madje nuk e ka çrënjësuar plotësisht), në një masë të madhe është shprehje e rivaliteteve tradicionale midis Veriut dhe Jugut që vazhdojnë gjatë tërë historisë arabe kurse gjendja e ngjashme është edhe te shumë kombe të tjera. Shpesh ndodh që dallimi i vogël në ritmin e brendshëm jetësor të shkaktojë më tepër armiqësi midis fiseve me lidhje të ngushtë gjaku se sa ekstravaganca racore midis kombeve fqinje krejtësisht tjetërfare.

Krahas rivalitetit politik, edhe një faktor ka luajtur rol me rëndësi në mospajtimet emocionale të Veriut dhe Jugut arab. Pikërisht në jug të Nexhdit, në afërsi të Rijadit, para gati dyqind vjetësh, reformatori puritan, Muhamed ibn Abdulvehhabi, u ngrit dhe i nxitu fiset - atëherë muslimanë vetëm me emër - në entuziazmin e rifetar. Pikërisht atëherë në shtëpinë e parëndësishme të Ibn Saudit, te prijësi i krahinës së vogël Daria, reformatori pranoi armën e cila i dha fuqi aksioni fjalës së tij frymëzuese dhe pas disa dhjetëveçarësh e përfshiu pjesën më të madhe të Siujdhesës me atë lëvizje fetare entuziazmuese të pakompromis, të njohur si vehabizëm. Në të gjitha luftërat dhe fitoret vehabite gjatë njëqind e pesëdhjetë vjetëshit të fundit, pikërisht populli nga Jugu e çoi lartë flamurin e puritanizmit, përderisa Veriu vetëm shkonte pas tyre i painteresuar; edhe pse Shamarët në

teori i përvetësonin mësimet vehabite, zemrat e tyre mbetën larg nga bindja e flaktë, intransigjente religjioze e Jugut. Duke jetuar afër vendeve kufitare të Sirisë dhe Irakut, kurse përherë të lidhur me ta me anë të tregtisë, Shamarët gjatë shekujve arritën butë të lëshojnë pe në botëkuptime dhe të përgatiten për kompromise krejtësisht të panjohura për jugorët e izoluar. Njerëzit e Jugut dinin vetëm për ekstreme, kurse në njëqind e pesëdhjetë vjetëshin e fundit kanë ditur vetëm për ëndërrime mbi xhihadin - njerëz krenarë, lëvdues të cilët veten e konsideronin përfaqësues të vetëm të vërtetë të Islamit kurse krejt muslimanët e tjerë i konsideronin heretikë.

Megjithatë vehabitët nuk janë sekt i veçantë. "Sekteja" do të supozonte ekzistimin e disa doktrinaeve të veçanta që pjesëtarët e saj do t'i dallonte nga masa e gjerë e të gjithë pjesëtarëve tjerë të të njëjtës fe. Mirëpo, në vehabizëm nuk ka doktrina të veçanta - përkundrazi, kjo lëvizje ka bërë përpjekje t'i eliminojë të gjitha risitë dhe doktrinën që gjatë shumë shekujsh janë akumuluar rreth mësimëve burimore të Islamit dhe t'i kthehet Porosisë së dikurshme të Pejgamberit. Në qartësinë e vet të pakompromis, kjo gjithqysh ka qenë provë e madhe, e cila gjatë kohës ka mund të shpjerë deri te lirimi i plotë i Islamit nga të gjitha paragjykimet që e errësuan Porosinë. Në të vërtetë, të gjitha lëvizjet rilindase në Islamin modern - lëvizja e ehli-hadithit në Indi, lëvizja senusite në Afrikën Veriore, veprimtaria e Xhemaludin Afganit dhe egjiptianit Muhamed Abduhu - mund të lidhen drejtpërdrejt me impulsin shpirtëror që në shekullin e tetëmbëdhjetë ua dha Muhammed ibn Abdulvehhabi. Megjithatë, zhvillimi i mësimëve të tij në Nexhd ka dy mangësi që vehabitët i penguan të bëhen fuqi vendimtare shpirtërore. Njëra prej këtyre mangësive është pengueshmëria me të cilën lëvizja ka bërë përpjekje ta kufizojë gati çdo energji reli-

gjoze në aplikimin tekstual të dispozitave, duke paraparë nevojën për të depërtuar në përmbajtjen e tyre shpirtërore. Mangësia tjetër është rrënjosur në vetë karakterin arab - në atë orientimin e ndjenjave fantastike të virtytshme të cilat askujt nuk i japin të drejtë të bëhet tjetërfare; qëndrim aq karakteristik për semitin e vërtetë sa kundërtënia e tij diametrale - pakujdesi e plotë në gjërat e Fesë. Kjo ka qenë cilësi tragjike e arabëve që përherë doemos të oscillojnë midis dy gjinive dhe asnjëherë nuk kanë mundur ta gjejnë rrugën e mesme. Dikur - mezi para dy shekujsh - arabët prej Nexhdi kanë qenë në thelb më larg se çdo grup tjetër prej Islamit në botën muslimane; që nga ardhja e Muhammed ibn Abdulvehhabit ata veten e konsiderojnë jo vetëm mbrojtës të Fesë por, thuajse, bartës të vetëm të saj.

Konceptimi shpirtëror i vehabizmit - synimi për përtëritjen e brendshme shoqërore - ka qenë i bastarduar gati në të njëjtin moment kur edhe qëllimi i jashtëm - mbërritja e fuqisë shoqërore dhe politike - ka qenë realizur me rivendosjen e Mbretërisë Saudite nga mbarimi i shekullit tetëmbëdhjetë, dhe me zgjerimin e saj në pjesën më të madhe të Arabisë në fillimin e shekullit nëntëmbëdhjetë. Në çastin kur e morën pushtetin ithtarët e Muhammed ibn Abdulvehhabit, ideja e tij u paralizua; sepse shpirti nuk mund të jetë shërbëtor i pushtetit - kurse pushteti nuk don të bëhet shërbëtor i shpirtit.

Historia e Nexhdit vehabit është histori e idesë religjioze e cila së pari u ngrit në krahët e entuziazmit dhe dëshirës së madhe, e pastaj u lëshua në ultësirat e fuqisë hipokrite të egoizmit vetjak. Çdo virtyt e shkatërron vetveten pikërisht në momentin kur heq dorë të bëhet dëshirë e madhe dhe modesti.

## VI. Ëndërrimet

- 1 -

Nëse jeni shok dhe musafir i Emirit të famshëm arab, atëherë ajo do të thotë se ai do t'ju konsiderojë shok dhe musafir dhe ashtu do të sillen me ju të gjithë shërbëtorët e tij, raxhaxhilët e tij, pronarët e dyqaneve në kryeqytetin e tij, madje, edhe beduinët e shkretinës në sundimin e tij. Musafiri sapo të arrijë të përmendë ndonjë dëshirë ajo menjëherë i plotësohet, kurdoherë kur ka mundësi; nga ora në orë e mbulon mirësia e ngrohtë, jokuresshtare e cila e përshtjellë në tregun e qytetit jo më pak se sa në korridoret dhe hajatat e gjera të oborrit.

Ashtu sikur shumë herë më parë, kjo më ndodh edhe gjatë këtyre dy ditëve në Hail. Kur dëshiroj kafe, zëri i melodishëm i havanit të bronzitë menjëherë cingëron në dhomën time private të pritjes. Po qe se, në mëngjes, rastësisht i përmendi Zejdit, në prani të ndonjë shërbëtori të Emirit, shalën e bukur që sapo e kam parë në bazar, pasdite s'kalon shumë dhe ma kanë sjellë dhuratë. Disa herë në ditë arrinin dhuratat: këmisha e gjatë prej leshit të Kashmirit e zbukuruar me mostrën e mangoas, ose kufia e qëndisur, ose lëkura e bardhë e deleve të Bagdadit për shalë, ose kama e lakuar prej Nexhdi me dorëz të argjend-të... Kurse unë, Pasi udhëtoj me pajisje të lehta, nuk jam në gjendje t'i ofroj Ibn Musaadit për kundërshtëpërblim

asgjë tjetër përpos hartës angleze të Arabisë, në të cilën, në një masë të madhe, për të plotësuar dëshirën e tij, me kujdes i kam shënuar emrat arabë të vendeve.

Shpirtmirësia e Ibn Musaadit ngjason mjaft në atë të mbretit Ibn Saud që, mbi të gjitha, edhe nuk është gjë e çuditshme kur të merren parasysh lidhjet e tyre të afërta. Jo vetëm që janë kushërinj por, po ashtu, që prej kohës kur Ibn Saudi ishte i ri kurse Ibn Musaadi ende çun, i kanë ndarë shumicën e vështirësive, të ligave dhe ëndërri-meve të sundimit të mëparshëm mbretëror.

Edhe pse shumë syrësh ishin shokë të tij, vetëm një numër i vogël i të zgjedhurve arriti të vëzhgojë aspektin më intim dhe, ndoshta, më të rëndësishëm të natyrës së Ibn Saudit, aftësinë e tij të madhe për dashuri, e cila ka mund, sikur t'i ishte lejuar që të zhvillohet dhe të vazhdojë, ta ngritë në lartësitë më të larta nga ato që i ka arritur. Aq shumë është theksuar se ai është martuar dhe shkurorëzuar me shumë gra, saqë shumë të paudhëzuar e konsiderojnë sikur ndonjë njeri i pamoralshëm i preokupuar me vrapimin e paskajshëm pas kënaqësive fizike; vetëm rrallë janë prej atyre që janë të vetëdijshëm se gati çdo martesë e Ibn Saudit - veç atyre të diktuarra për shkaqe politike - ka qenë pasojë e dëshirës së paqartë, të paepur që rishtazi ta kapë gjurmën e dashurisë së humbur.

Xhevahirja, nëna e djemve të tij, Muhammedit dhe Halidit, ka qenë e dashura e Ibn Saudit; bile edhe tash, pas trembëdhjetë vjetëve që ka vdekur, mbreti kurdoherë kur bisedon për të, fjala i lidhet në fyt.

Ajo patjetër duhet të kishte qenë grua e mrekullueshme - jo vetëm e bukur (sepse Ibn Saudi ka njohur dhe ka pasur shumë gra të bukura në karrierën e tij jashtëzakonisht të pasur martesore), por gjithashtu e talentuar me mençurinë instinktive të gruas e cila e lidhë dallandinë shpirtërore me atë trupore. Ibn Saudi nuk u lejon shpesh

emocioneve të veta që të ndikojnë thellë në marrëdhëniet e tij me gratë dhe kjo, ndoshta, e shpjegon lehtësinë me të cilën martohej dhe shkurorezohej. Megjithatë, me Xhevahiren, si duket, ka gjetur përmbushjen e cila më kurrë nuk i është përsëritur. Ndonëse, madje edhe gjatë jetës së saj, ka pasur gra tjera, dashuria e tij e vërtetë ka qenë e rezervuar për të në mënyrë aq të veçantë sikur ajo të ishte gruaja e vetme e tij. I ka shkruar letra dashurie, kurse në një moment më të veçuar të tij më tha: "Kurdoherë kur bota rreth meje bëhej e errët dhe nuk shihja rrugëdalje nga rreziku dhe vështirësia që më shtrëngonin, ulesha dhe i shkruaja ode Xhevahires; kur i përfundoja, bota papritmas ndriçohej dhe atëherë dija se çka të veproj".

Xhevahirja ka vdekur gjatë epidemisë së madhe të gripit më 1919, e cila e mori me vete edhe djalin e paralindur dhe më të dashur të Ibn Saudit Turkiun; kjo humbje e dyfishtë pat lënë gjurmë të pashërueshme në jetën e tij.

Nuk kanë qenë vetëm gruaja dhe djali të cilëve ka mund t'ua hapë zemrën e vet plotësisht; e ka dashur babanë e vet ashtu siç i duan baballarët e tyre njerëzit e rrallë. Babai, Abdurrahmani, të cilin e kam njoftuar ditët e para në Rijad, ndonëse njeri i dashur dhe i devotshëm, gjithqysh nuk ka qenë personalitet i shquar sikur djali i tij dhe nuk ka lozur kurrfarë roli të veçantë gjatë jetës së tij të gjatë. Prapëseprapë, bile edhe pasi e pat marrë Ibn Saudi mbretërinë me mundin e vet individual dhe pasi u bë sundimtar i pakontestueshëm i vendit, ai sillej ndaj babait të vet me aq dëgjueshmëri saqë kurrë nuk do të pajtohej të paraqitet në dhomën e pallatit po qe se Abdurrahmani do të ndodhej në dhomën e poshtme - "sepse, do të thoshte, si mund t'i lejoj vetes të ecë mbi kokën e babit tim?" Asnjëherë nuk do të ulej në prani të plakut po qe se nuk do të thirrej qartë ta bëjë atë. Ende

më kujtohet pakëndshmëria të cilën e kam përjetuar për shkak të kësaj përkulshmërie mbretërore një ditë në Rijad (mendoj se kjo ka ngjarë në dhjetor të vitit 1927). Kam qenë në vizitë të zakonshme te babai i Mbretit në banesën e tij në oborrin mbretëror; rrinim ulur në shiltet e shtruara në dysheme, zotëriu plak zbërthente një prej temave të tij fetare që i pëlqenin. Befasisht hyri në dhomë shërbëtori dhe lajmëroi: "Vjen Sheiku". Pas pak kohësh Ibn Saudi qëndronte në derë. Natyrisht, dashta të çohem, por plaku Abdurrahman më kapi për mënge dhe më tërhoqi poshtë, sikur të thoshte: "Ti je musafiri im". Kam qenë i hutuar sa s'mund të përshkruhet duke qëndruar ashtu ulur, derisa Mbreti, Pasi prej së largu e përshëndeti babain, mbeti në këmbë te dera, me siguri duke pritur leje që të hyjë në dhomë. Patjetër do të ketë qenë i mësuar në teket e ngjashme të babait të vet sepse ma bëri me sy, duke buzëqeshur, që të më qetësojë. Në ndërkohë, Abdurrahmani e vazhdoi bisedën sikur s'kish-te pasur asfarë ndërprerjeje. Mbas disa minutash ai shikoi lart, i dha shenjë me kokë djalit të vet dhe tha: "Eja, biri im, dhe ulu". Mbreti në atë kohë kishte katërdhjetë e shtatë ose katërdhjetë e tetë vjet.

Disa muaj më vonë - në atë kohë kemi qenë në Mekë - Mbretit i erdhi lajmi se i ka vdekur babai në Rijad. Kurrë nuk do ta harroj shikimin e shtangur në mënyrë të pakuptueshme me të cilin disa çaste e vështroi lajmëtarin dhe pikëllimin që ngadalë dhe dukshëm ia errësoi vijat e fytyrës të cilat përndryshe ishin të kthjellta dhe të qeta; si kërceu me klithmën tmerruese: "Babai im ka vdekur!", dhe me hapa të mëdhej doli me vrap prej dhomë derisa abaja i shkante zvarrë pas tij; si u ngjit me vrap shkallëve, kaloi pranë fytyrave të frikësuara të rojave të veta, duke mos e ditur edhe vetë se ku po shkon dhe pse, duke bërëtitur: "Babai im ka vdekur! Babai im ka

vdekur!" Dy ditë pas kësaj nuk ka pranuar askënd në dhomën e tij, as ka ngrënë as ka pirë dhe natë e ditë ka bërë ibadet.

Sa djelmosha të moshës mesatare, sa mbretër të cilët e kanë fituar mbretërinë e vet me forcën e vet, e kanë vajtuar aq shumë vdekjen e babait të vet që ka vdekur rehat në pleqëri të thellë?

## - 2 -

Abdulaziz ibn Saudi e fitoi mbretërinë e vet të gjerë vetëm me përpjekjet e tij. Qysh kur ishte fëmijë, familja e tij tashmë e kishte humbur edhe pjesën e fundit të pushtetit të vet në Arabinë Qendrore, kurse atë e trashëguan vasalët e tyre të dikurshëm, dinastia Ibn Rashid prej Haili. Ato kanë qenë ditë të hidhura për Abdulazizin. Djaloshi krenar dhe i përmbajtur u dasht patjetër ta shikojë emirin e huaj se si qeverisë me qytetin e babait të tij, Rijadin në emër të Ibn Rashidit; sepse tash familja Ibn Saud - e cila dikur e ka sunduar gati tërë Arabinë - ka jetuar prej ndihmës së familjes Ibn Rashid e cila vetëm i ka duruar, por më nuk u është frikësuar. Më në fund, kjo u bë e padurueshme madje edhe për babain e tij paqedashës Abdurrahmanin dhe ai e lëshoi Rijadin me tërë familjen, me shpresë që ditët e mbetura t'i kalojë te shoku i tij i vjetër, sundimtari i Kuvajtit. Mirëpo, ai nuk e ka ditur se çka bartë ardhmëria, sepse nuk e ka parandjerë çka ka në zemrën e djali të tij.

Prej të gjithë anëtarëve të familjes vetëm një ka pasur parandjenjë çka ndodh në këtë zemër të zjarrtë: halla më e re e tij. Nuk di shumë për të; vetëm e di se Mbreti, kurdoherë kur i përkujtonte ditët e rinisë së vet, gjithmonë e përmendte me respekt të veçantë.

"Ajo, mendoj, bile më ka dashur më tepër se fëmijët e vet. Kur kemi qenë vetëm, ajo do të më merrte në krah dhe do të më fliste për gjërat e mëdha që do të duhej bërë kur të rritem: "Ti duhet patjetër ta ngjallësh famën e familjes Ibn Saud", ma përsëriste përherë prej fillimit, kurse fjalët e saj kanë qenë si përkëdhelje. "Por dua ta dish, Azajiz se"<sup>4</sup>, - do të thoshte, - "bile as fama e familjes Ibn Saud nuk guxon të jetë fundi i synimeve tua. Ti duhet patjetër të orvatesh për famën e Islamit. Popullit tënd i duhet udhëheqës që do t'i prijë drejt rrugës së Pejgamberit, kurse ti do të jesh ai udhëheqës". Këto fjalë përherë kanë mbetur të gjalla në zemrën time".

A thua, vallë, vërtet?

Ibn Saudi tërë jetën e tij ka pasur dëshirë të flasë për Islamit sikur për misionin që iu pat besuar; madje edhe më vonë, kur tashmë ka herë u bë e qartë se pushteti mbretëror i vlenë më shumë se ndërmjetësimi i dikurshëm i tij për ideal, oratoria e tij e madhe shpeshherë ka arritur të bindë shumë njerëz - ndoshta madje edhe vetë atë - se ky ideal ende është qëllimi i tij.

Kujtimet e tilla nga fëmijëria shpeshherë ngjallehin gjatë tubimeve intime në Rijad, të cilat zakonisht janë organizuar pas namazit të jacisë. Sapo të mbaronte namazi në xhaminë e pallatit, do të mblidheshim rreth Mbretit në njërën prej dhomave më të vogla dhe do të dëgjoni afër një orë leximin e haditheve të Pejgamberit ose komentimeve të Kur'anit. Pas kësaj Mbreti do të thirrte dy ose tre vet prej nesh që ta përcillnim deri te dhoma e tij në banesën e tij private. Një natë, më kujtohet, derisa e lëshonim tubimin duke e përcjellë Mbretin, edhe një herë kam qenë i befusuar me shtatin e tij madhështor me të cilin larg i kapërcente ata që e rrethonin. Mbase e kapi shikimin tim admirues sepse buzëqeshi me atë sharmin e vet të papërshkruar, më mori përdore dhe më pyeti:

"Pse më shikon ashtu, Muhammed?"

"Mendova, Shkëlqesi, se çdokush mund ta njohë në ty mbretin sapo ta shohë kokën tënde aq lart mbi kokat e turmës".

Ibn Saudi filloi të qeshet dhe, ende duke më udhëhequr përdore gjatë ecjes së ngadalshme nëpër korridor, tha: "Po, mirë është të jesh kaq i lartë. Por ka pasur momente kur lartësia ime më ka shkaktuar vetëm hidhërimi. Kjo ka ndodhur para shumë vitesh, kur isha i ri dhe kur jetoja në pallatin e Sheik Mubarekut në Kuvajt. Kam qenë shtathedhur dhe jashtëzakonisht i lartë, shumë më tepër se sa u përgjigjej viteve të mia dhe djelmoshave tjerë në pallat - ata të familjes së sheikut, po bile edhe ata të familjes sime - më patën vënë në nishan të shakave të tyre sikur të isha përbindësh. Kjo shumë më pikëllonte, kurse ndonjëherë edhe unë mendoja se jam vërtetë përbindësh. Aq shumë më ka ardhur turp prej lartësisë sime sa që do ta futja kokën në shpatulla në mënyrë që të dukesh më i ulët kur të kaloja nëpër dhomat e pallatit dhe rrugëve të Kuvajtit".

Në atë moment tashmë arritëm te banesa e Mbretit. Djali i tij më i madh, trashëgimtar i fronit Saud, tashmë aty e pritte babain e tij. Ishte moshatar i imi dhe, ndonëse jo aq i lartë sikur babai i tij, plotësisht figurë imponante. Vijat e fytyrës së tij ishin shumë më të errëta se të Mbretit dhe s'e kishin lëvizshmërinë dhe gjallërinë e tij. Mirëpo ai ishte njeri i dashur dhe për të njerëzit kishin mendim të mirë.

Mbreti u ul në shilte të shtruar përgjatë mureve dhe na ofroi edhe neve të ulemi. Pastaj urdhëroi: "Kafe!" Shërbëtori i armatosur në derë menjëherë thirri në korridor "Kafe!", - kështu që këtë thirrje tradicionale e pranuan dhe e përsëritën shpejt njëri pas tjetrit shërbëtorët tjerë nëpër tërë korridorin "Kafe!" - "Kafe!" - në ceremoni-

alin e mrekullueshëm të përsëritjeve, derisa nuk arriti te kuzhina mbretërore e çajit disa dhoma më tej; sa çel e mbyll sytë shërbëtori me kamën e artë të ngjeshur për brezi paraqitet duke bartur xhezven e bronztë në njërën, kurse filxhanët e vegjël në dorën tjetër. Mbreti e pranoi filxhanin e parë, kurse të tjerët i pranuan musafirët me radhë ashtu si rrinin ulur. Në rastet e tilla joformale, Ibn Saudi do të bisedonte lirisht për çkado qoftë që do t'i binte në mend - për atë çka ngjante në vendet e largëta të botës, për zbulimet e reja të çuditshme për të cilat ia kanë tërhequr vëmendjen, për njerëzit, zakonet dhe institucionet; por mbi të gjitha, kishte dëshirë të flasë për përvojat e tij personale, kurse do t'i motivonte edhe të tjerët të marrin pjesë në bisedë. Pikërisht atë natë Emiri Saud e filloi bisedën kur m'u drejtua mua duke qeshur:

"Dikush sot, Muhammed, më ka shprehur dyshim për ty. Më ka thënë se s'është plotësisht i sigurt se ti nuk je spiun anglez nën maskën e muslimanit... Por mos u mërzhit, kam qenë në gjendje ta bindi se ti me të vërtetë je musliman".

I pamundshëm që t'ia kthej me buzëqeshje, iu përgjigja: "Ky është një gjest tejet i njerëzishëm prej teje, o Emir, Zoti të dhashtë jetë të gjatë. Por si mund të jeni i sigurt në atë? A nuk është Zoti i vetmi Ai që e di ç'ka në zemrën e njeriut?"

"Ajo është e vërtetë", - ma ktheu Emiri Saud, - "por në këtë rast më është treguar një shenjë e veçantë. Një ëndërr javën e kaluar ma ka dhënë këtë shenjë... Qëndroja para një xhamie duke shikuar në minare. Befasisht në sherifin e minares u paraqit një njeri, i drejtoi shuplakat e veta para gojës dhe filloi të thërrasë për namaz: "Zoti është më i madhi, vetëm Zoti është më i madhi" dhe vazhdoi deri në fund "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut" - e kur e shikova më përsëafërimi, kam parë se ai

njeri je ti. Kur u zgjova, e kam ditur sigurisht se, ndonëse kurrë nuk kam dyshuar në atë, ti je musliman i sinqer-të, sepse ëndrra në të cilën përmendet dhe lëvdohet emri i Zotit nuk mund të jetë mashtrim".

Qeshë mjaft i ngashëryer me këtë argumentim të pakërkuar të sinqeritetit tim nga ana e djalit të Mbretit dhe me seriozitetin e tundjes së kokës me të cilin Mbreti e vërtetoi rrëfimin e befasueshëm të Emirrit Saud. Me të marrë fjalën, Ibn Saudi vazhdoi:

"Vërtetë shpesh ndodh që Zoti t'i ndriçojë zemrat tona me anë të ëndrrave të cilat ndonjëherë e parashohin ardhmërinë, e ndonjëherë e shpjegojnë tanishmërinë. A ke përjetuar ti, Muhamed, ndonjëherë ëndërr të tillë?"

"Me të vërtetë po, o imam, edhe atë qysh moti, shumë më parë seç kam menduar se do të bëhem musliman - bile para se të kisha hyrë ndonjëherë në vendin musliman. Atëherë duhet t'i kisha pasur rreth nëntëmbëdhjetë vjet dhe kam jetuar me babain tim në Vjenë. Kam qenë thellë i interesuar për shkencën mbi jetën e brendshme të njeriut (gjë që ka qenë definicioni më i afërt i psikoanalizës që kam mund t'ia jap Mbretit) dhe e kisha bërë zakon që pranë shtratit të mbaj letër dhe laps në mënyrë që t'i regjistroj ëndrrat e mia kur të zgjohesha. Duke vepruar kështu, e kam kuptuar se jam në gjendje t'i kujtoj përherë ëndrrat, bile edhe nëse nuk i kam ruajtur përherë në kujtesë. Në një ëndërr të tillë, gjendesha në Berlin, duke udhëtuar me hekurudhën nëntokësore që ata e kanë - me trenin i cili ndonjëherë shkon nëpër tunel nën tokë kurse ndonjëherë mbi ura lart mbi rrugë. Kupeja ka qenë përplot me njerëz kështu që nuk kishte vend për t'u ulur dhe të gjithë qëndronin në këmbë të ngjeshur, nuk kishin mundësi të lëviznin; ka qenë vetëm një dritë e dobët e një shisheje të vetme elektrike. Pas një kohe treni doli prej tuneli; nuk erdhi në asnjë urë prej atyre të lartave por doli jashtë në rrafshinën e

gjerë, të shkretë prej balte, rrotat e trenit u zhytën në baltë dhe treni u ndal, duke mos mundur të lëvizë as para as mbas.

Të gjithë udhëtarët, kurse edhe unë me ta, e lëshuan trenin dhe filluan të shikojnë rreth vetes. Rrafshina përreth nesh ishte e pafund, e zbrazët dhe lakuriqe - në të nuk kishte as kaçube as shtëpi, bile as gurë - dhe ankthi i kaploi zemrat e njerëzve; tash kur ndodhemi këtu pa ndihmë, si do ta gjejmë rrugën të kthehemi prap atje ku jetojnë njerëzit e tjerë? Muzgu i murrme shtrihet përtej rrafshirës së madhe, sikur në kohën e agimit të hershëm.

Mirëpo, në një mënyrë unë nuk kam ndier ankth sikur të tjerët. Kam depërtuar nëpër turmë dhe kam hetuar, në largësi ndoshta prej dhjetë hapash, devenë e shaluar - m'u ashtu siç i kam parë të shaluara në vendin tënd - kurse në shalë rrinte ulur një njeri i veshur në abajën mëngëshkurtër dhe me vija të bardha e ngjyrë gëshenje. Kufia e tij ka qenë e tërhequr lartë mbi fytyrën e tij ashtu që nuk kam mund t'i dalloj vijat e tij. Në shpirt menjëherë e kam ditur se deveja më pret mua, kurse kalorësi i panjohur do të duhej të jetë udhëheqësi im; kështu, pa fjalë, kam hipur në shpinën e devesë pas shalës, ashtu sikur kalëron në vendet arabe rafidi (kalorësi-bashkudhëtar). Në çastin tjetër deveja u ngrit dhe u nis përpara me hapa të lehtë, të gjatë, kurse unë e ndjeva se si në mua rritej lumturia e paemër. Udhëtonim me hapa të tillë të lehtë, ashtu siç më dukej në fillim, me orë të tëra, pastaj me ditë, pastaj me muaj, derisa nuk e humba çdo masë kohore; në çdo hap të devesë lumturia ime rritej, derisa nuk e ndjeva se si notoje nëpër ajër. Më në fund, horizonti në anën tonë të djathtë filloi të skuqej nën rrezet e diellit i cili tashmë sapo s'kishte dalur. Por larg në horizont para nesh unë e pashë një dritë tjetër; kishte vajtur pas derës së madhe të hapur e cila pushonte

në dy shtylla - dritë e bardhë verbëruese, jo e kuqe sikur drita e diellit në lindje në anën tonë të djathtë - dritë e ftohtë e cila përherë bëhej gjithë e më e ndritshme sa më afër që i afroheshim, kurse lumturinë në mua e zmadhonte mbi gjithë atë çka mund të përshkruhej me fjalë. Kur u afruam më afër derës dhe dritës së saj, dëgjova një zë se si prej diku lajmëroi: "Ky është qyteti më perëndimor" - dhe unë u zgjova".

"Subhanallah - lavdërimi i qoftë Zotit!" - bërtiti Ibn Saudi kur unë e përfundova. - "Vallë, a nuk të ka treguar kjo ëndërr se je i përcaktuar për Islam?"

E tunda kokën: "Jo, Shkëlqesi, si kam mundur ta dijë këtë? Kurrë nuk kam menduar mbi Islamin, e bile kurrë nuk kam njohur ndonjë musliman... Tashmë shtatë vjet më vonë, gjatë kohë pasi e kam harruar këtë ëndërr, e kam pranuar Islamin. Më është kujtuar pak kohë më parë, kur e kam gjetur në mesin e letrave të mia, mu ashtu sikur e pata regjistruar atë natë pas zgjimit".

"Ani kjo ka qenë lumturia yte e parë të cilën Zoti ta ka treguar në atë ëndërr, biro! A nuk e ke njohur qartë? Ardhja e shumë njerëzve, kurse ti në mesin e tyre, në absurditetin e shkretë dhe konfuzioni i tyre: a nuk është kjo gjendje e atyre të cilët sureja hyrëse e Kur'anit i përshkruan sikur "ata të cilët e kanë humbur rrugën?" Kurse deveja e cila, me kalorësin e vet, të ka pritur ty: a nuk është ai "udhëzimi i drejtë" për cilin Kur'ani shpesh bën fjalë? Kurse kalorësi i heshtur fytyrën e të cilit nuk ke mundur ta shohësh: kush ka mund të jetë tjetërkush nëse jo Pejgamberi, paqja e Zotit qoftë mbi të? Ai me gjithë dëshirë ka bartur gunë krahskurtër... A nuk na e bëjnë të ditur shumë libra se, kurdoherë kur ai iu lajmërohet në ëndrra jo-muslimanëve ose atyre që ende nuk janë muslimanë, fytyra e tij përherë është e mbuluar? Pastaj ajo drita e bardhë, e ftohtë në horizont para

teje: çka ka mund të jetë përveç premtimit të dritës së besimit e cila ndriçon pa e nderur? Ti atë nuk e ke arritur në ëndrrën tënde për shkak se shumë vjet më vonë, siç na e bëre të ditur, e ke njohur Islamit si realitet të vërtetë..."

"Ti mund të kesh të drejtë, Shkëlqesi... Por ç'është puna me "qytetin më perëndimor" ku do të duhej të më shpjerë dera në horizont? Sepse, më në fund, pranimi im i Islamit nuk më ka shpënë në Perëndim: kjo më parë më ka shpënë më tej Perëndimit".

Ibn Saudi për një çast heshti dhe mendoi; pastaj e ngriti kokën dhe, me atë buzëqeshjen e ëmbël që më pëlqente, tha: "A thua, Muhammed, me të ka dashur të thotë se arritja yte e Islamit do të jetë pika "më perëndimore" në jetën tënde, kurse pas kësaj jeta yte perëndimore më nuk do të jetë e ytja...?"

Pas një kohe Mbreti përsëri foli: "Vetë Zoti e di ardhmërinë. Mirëpo ndonjëherë Ai vendos që, në ëndërr, të na paralajmërojë për atë çka do të na ndodhë në të ardhmen. Edhe unë kam parë ëndrra të tilla dy-tre herë dhe më kanë dalë të vërteta. Njëra prej tyre, në realitet, më ka bërë atë që jam... Atëherë kam pasur shtatëmbëdhjetë vjet. Kemi jetuar si emigrantë në Kuvajt, por nuk kam mund ta marr me mend që atdheun tim ta sundojnë Ibn Rashidët. Shpesh i lutesha babait, Zoti e mëshiroftë atë: "Babë lufto dhe dëboi Ibn Rashidët! Askush nuk ka më shumë të drejtë se sa ti ta marrësh fronin në Rijad!" Mirëpo, babai im i refuzonte lutjet e mia të frikshme si fantazmë dhe më përkujtonte se Muhammed ibn Rashidi ishte sundimtari më i fuqishëm në tokat arabe dhe sundonte mbretërinë e cila shtrihej prej shkretëtirës së Sirisë në Veri e deri te zalli i krahinës së zbrazët në Jug, andaj të gjitha fiset beduinase dridheshin para grushtit të tij të hekurt. Megjithatë, kam parë një ëndërr te çuditshme. E kam parë veten hipur në kalë natën në shkretëtirën e

vetmuar, kurse para meje, po ashtu hipur në kalë, ka qenë plaku Muhammed ibn Rashidi, uzurpues i mbretërisë së familjes sime. Të dytë kemi qenë të paarmatosur, por Ibn Rashidi e mbante në dorën e vet lart një llambë të madhe shkëlqyese. Kur e pa su unë po i afrohem, më diktoi se jam armiku i tij, u kthye dhe e shtyri kalin me vrap të ikë; por unë u lëshova pas tij, e kapa skajin e gunës së tij, pastaj dorën e tij dhe në fund llambën - dhe e fika llambën. Kur u zgjova, e kam ditur sigurisht se jam i përcaktuar ta marrë pushtetin prej familjes Ibn Rashid..."

Në vitin e kësaj ëndrre, 1897, vdiq Muhamed ibn Rashidi. Ky çast Abdulaziz ibn Saudit iu duk si çast i vulltshëm për të sulmuar; por Abdurrahmani, babai i tij, nuk ishte i gatshëm ta rrezikojë jetën e qetë në Kuvajt, në një ndërmarrje të tillë të dyshimtë. Megjithatë, dëshira e madhe e djalit ishte shumë më e fuqishme se sa plogështia e babait, kështu që babai më në fund lëshoi pe. Me ndihmën e shokut të vet, Sheik Mubarekut prej Kuvajti, ai i ngriti disa fise beduinase që i kishin qëndruar besnikë familjes së tij, e filloi luftën kundër Ibn Rashidit në stilin e vjetër arab, me deve, kuaj dhe flamuj fisnorë, mirëpo shpejt e humbi luftën prej forcave më të mëdha armike dhe - në shpirt me siguri më me lehtësim se sa hidhërim - u kthye në Kuvajt, i vendosur që kurrë më të mos i turbullojë netët e jetës së tij me aventura luftarake.

Por djali nuk u dorëzua aq lehtë. Përherë i kujtohej ëndrra ngadhënjyese e tij mbi Muhammed ibn Rashidin; kur babai i tij hoqi dorë prej të gjitha të drejtave në mbretërinë e Nexhdit, pikërisht ajo ëndërr e motivi Abdulazizin e ri të ndërmarrë tentativën e vet të papeshuar mirë dhe ta kthejë pushtetin. Depërtoi deri te disa shokë - në mesin e tyre deri te të afërmit e tij Abdullah ibn Xhiluvi dhe Ibn Musaadi - i mbloodhi disa beduinë guximtarë, derisa numri i tyre nuk arriti katërdhjetë. U

nisën prej Kuvajti hipur në kuaj si hajdutë tinëzisht, pa flamuj, daulle e këngë; duke iu ikur rrugëve që kalonin shpesh karvanet dhe, duke u fshehur ditën, arritën në afërsi të Rijadit dhe e kaluan natën në një luginë të shkretë. Të njëjtën ditë, Abdulazizi i zgjodhi pesë veta prej të katërdhjetëve dhe iu drejtua me këto fjalë:

"Ne të gjashtë fatin tonë tash e dorëzojmë në dorë të Zotit. Ne shkojmë në Rijad - ta pushtojmë ose ta humbim përgjithmonë. Nëse dëgjoni zëra lufte nga qyteti, ejani të na ndihmoni; por nëse deri nesër në perëndim të dielli nuk dëgjoni asgjë, atëherë ta dini se jemi të vdekur dhe Zoti le t'i pranojë shpirtat tanë. Nëse kjo ndodh, ju të tjerët kthehuni tinëzisht, sa më shpejtë të jetë e mundshme në Kuvajt".

Kështu të gjashtë burrat u nisën në këmbë. Kur u errësua, arritën te qyteti dhe hynë brenda në të nëpër një shteg të cilin para disa vjetësh e kishte hapur Muhammed ibn Rashidi në muret e qytetit të ngadhënjyer për t'i nënçmuar banorët e tij. Me armët e fshehura nën guna, shkuan drejt te shtëpia e emirit rashidian. Kishte qenë e mbyllur, sepse emiri, duke u frikësuar nga popullata armike, e kishte bërë zakon netët t'i kalonte në fortifikatën përballë shtëpisë. Abdulazizi dhe përcjellësit e tij trokitën në derë; derën e hapi një shërbëtor të cilin menjëherë e kapën, e lidhën dhe ia mbyllën gojën; e njëjta gjë ndodhi edhe me banorët e tjerë të shtëpisë - në atë kohë ndodheshin vetëm disa shërbëtorë dhe gra. Të gjashtë aventuristët u gostitën me hurme nga çarraniku i emirit dhe e kaluan natën duke lexuar vazhdimisht Kur'an.

Të nesërmen në mëngjes u hapën dyert e fortifikatës dhe doli emiri, i rrethuar me rojat e armatosura trupore dhe robërit. Duke bërëtitur "O Zot, Ibn Saudi është në duart tuaja!" Abdulazizi dhe të pesë shokët e tij u sulën me shpatat e zhveshura drejt armikut të befasuar. Abdu-

llah ibn Xhiluvi e gjuajti shigjetën e tij të shkurtër drejt në emirin; megjithatë, ai me kohë u shmang dhe shigjeta u ngul në murin e fortifikatës - aty edhe sot e kësaj dite mund të shihet. Emirin e kapi paniku dhe u tërhoq në fortifikatë; derisa Abdullahu e ndoqi pa ndihmën e askujt në brendësinë e fortifikatës, Abdulazizi dhe të katër shokët e tjerë e sulmuan rojen trupore e cila, ndonëse më e shumtë në numër, ishte shumë e hutuar që të mund të mbrohej me sukses. Pak më vonë emiri u paraqit në rrafshin e çatisë, duke e lutur Abdullah ibn Xhiluvin për mëshirë, gjë që ky nuk ia fali; kur ai ra në rrethojën e çatisë dhe kur e pranoi goditjen vendimtare me shpatë, Abdulazizi prej poshtë thirri: "Ejani, qytetarë të Rijadit! Këtu jam unë, Abdulazizi, i biri i Abdurrahmanit nga familja Ibn Saud, sundimtari juaj ligjor!" Qytetarët e Rijadit, të cilët i urrenin shtypësit e tyre veriorë, me vrap arritën me armë në dorë që t'i ndihmojnë princit të tyre; në deve arritën me të katra tredhjet e pesë shokët e tjerë të tij nëpër dyert e qytetit, duke thyer çdo qëndresë para vetes si vërshimi. Në afat prej një ore Abdulaziz ibn Saudi u bë sundimtar i pakontestueshëm i qytetit.

Kjo ka ndodhur në vitin 1901. Ka qenë njëzetënjëvjeçar. Mosha e tij e re kishte arritur pjekurinë, ai kishte hyrë në periudhën e dytë të jetës së tij, në jetën e njeriut dhe sundimtarit të pjekur.

Hap pas hapi, provincë pas province, Ibn Saudi e shkëputi Nexhdin prej familjes Ibn Rashid, duke i shtyrë ata mbrapa në drejtim të atdheut të tyre, Xhebeli Shamarit dhe kryeqytetit Hail. Ky ekspansion ka qenë ashtu i llogaritur sikur të kishte qenë projektuar në shtabin suprem me hartë gjeografike, sipas parimeve të njohurisë ushtarake dhe analizave gjeopolitike - edhe pse Ibn Saudi nuk kishte shtab suprem, e me siguri asnjëherë edhe nuk ka parë hartë gjeografike. Pushtime e tij kanë vazh-

duar në formë spirale, me Rijadin si qendër të fortë; kurse hapi tjetër kurrë nuk është ndërmarrë përderisa krahina e pushtuar më parë nuk ka qenë themelësisht e nënshtruar dhe rregulluar. Më parë i ka përvetësuar zonat lindore dhe veriore prej Rijadit, pastaj e ka zgjeruar mbretërinë e vet në shkretëtirat lindore. Në drejtim të Veriut kanë përparuar shkallërisht, sepse Ibn Rashidët ende kanë pasur forca të konsiderueshme kurse, krahas kësaj, edhe turqit u kanë ndihmuar, me të cilët në dhjetëvjetëshat e kaluar kanë pasur bashkëpunim të ngushtë. Ibn Saudi po ashtu ka qenë i penguar edhe me varfërinë e vet; zonat jugore të Nexhdit nuk kanë mund t'i ofrojnë të ardhura të mjaftueshme për furnizimin e grupeve më të mëdha të luftëtarëve për një kohë më të gjatë.

"Në një kohë", - më tha ai një herë, - "kam qenë aq i varfër saqë kam qenë i detyruar të lë peng te një hebraik në Kuvajt shpatën e zbukuruar me gur të çmuar të cilën ma kishte dhuruar Sheik Mubareku. Nuk kam mund të blej as qilim për shalë - por thasët e zbrazët nën lëkurët e deleve kanë qenë po ashtu të mira".

Ka qenë edhe një problem i cili shumë e ka rënduar karrierën e hershme të Ibn Saudit: qëndrimi i fiseve beduine.

Arabia Qendrore, edhe me gjithë qytetet dhe fshatrat e veta, para së gjithash, ka qenë tokë beduinase. Pikërisht përkrahja ose rezistenca e tyre ka qenë vendimtare në rezultatin e ndeshjes midis Ibn Saudit dhe Ibn Rashidit në gati çdo fazë. Ata kanë qenë të luhatshëm dhe të ndryshueshëm dhe zakonisht i janë adaptuar asaj ane e cila në moment ka qenë më e suksesshme ose ka ofruar shpresë në plaçkën më të madhe. Në lojën e tillë të dyfishtë më i shkathët ka qenë Fejsal Ed-Davishi, kryepari suprem i fisit të fuqishëm Mutair, lojaliteti i të cilit përherë ka qenë vendimtar në favor të njërit ose

tjetrës dinasti rivale. Do të vinte në Hail që të ngarkohej me dhuratat e Ibn Rashidit; do ta lëshonte Ibn Rashidin dhe do të vinte në Rijad që t'ia japë besën Ibn Saudit - që një muaj më vonë ta tradhtonte; ka qenë i pabesueshëm për të gjithë, trim dhe dinak dhe i xhindosur me lakminë tmerruese për pushtet; shumë net të zemëruara ka kaluar Ibn Saudi për shkak të tij.

I shtrënguar nga vështirësitë e tilla, Ibn Saudi e mendoj planin - në fillim sigurisht vetëm si manovër politike, por i përcaktuar të zhvillohet në një ide të shkëlqyeshme, të aftë ta ndërrojë pamjen e tërë Siujdhesës: planin për popullzimin e fiseve nomade. Ka qenë e qartë se beduinët, sapo të vendoseshin diku, e lëshonin lojën e tyre të dyfishtë midis palëve ndërluftuese. Derisa kanë jetuar si nomadë, e kanë pasur lehtë që në çdo çast t'i mbledhin tendat dhe me kopetë e tyre të shkonin kudo që të jetë, prej një vendi në vendin tjetër, megjithatë, mënyra stabile e jetesës një gjë të tillë e bënte të pamundshme sepse lojaliteti i ofruar armikut do të sillte me vete rrezik që t'i humbnin shtëpitë dhe të mbjellat e tyre, kurse për beduinin asgjë nuk ka qenë ashtu e dashur sikur pasuria e tij.

Ibn Saudi popullzimin e beduinëve e vuri si pikën më me rëndësi në programin e tij. Në këtë drejtim shumë i kanë ndihmuar mësimet islame, të cilat përherë e kanë theksuar epërsinë e jetës stabile në vendbanime mbi mënyrën e jetesës nomade. Mbreti ka dërguar mësues fetarë të cilët ua kanë mësuar beduinëve fenë dhe kanë predikur idenë e re me sukses të jashtëzakonshëm. Organizata e ihvanëve (vëllezërve) - siç filluan të quhen beduinët e vendosur - pranoi formën e vet. Vendbanimi i parë i ihvanëve ka qenë pikërisht Alva-Mutairi, farefis i Ed-Davishit; vendbanimi i tyre, Artavia, për disa vjet u

rrit e u bë qytet prej rreth tridhjetë mijë banorësh. Shumë fise tjera e ndoqën rrugën e tyre.

Entuziazmi fetar i ihvanëve dhe potenciali i tyre luftarak u bënë instrument i fuqishëm në duart e Ibn Saudit. Që atëherë e këndej luftërat e tij pranuan formën e re: të lindura në dëshirën e zjarrtë të ihvanëve, ata e kapërcyen karakterin e tyre fillestar të luftës dinastike për pushtet dhe u bënë luftëra fetare. Për ihvanët së paku lindja e sërishme e fesë së tyre ka qenë më tepër se shquarje individuale. Ihvanët, pa dyshim, në lojalitetin e tyre të pakompromis mësimeve të reformatorit të madh nga shekulli i tetëmbëdhjetë, Muhammed ibn Abdulvehhabit (i cili ka synuar përtëritjen e Islamit rreptësisht në pastërtinë e tij origjinale dhe i ka hedhur të gjitha risitë e mëvonshme), shpeshherë kanë qenë të përmbushur me dëshirën e tepruar të virtytit individual, por ajo që shumica e tyre ka dëshiruar, mbi të gjitha, ka qenë jo vetëm respekti personal por vendosja e një shoqërie të re e cila me plot të drejtë do të mund të quhej shoqëri islame. Vërtet, shumë ide të tyre kanë qenë primitive, kurse dëshira e tyre e zjarrtë shpesh ka qenë e kufizuar me fanatizmin; me një udhëheqje dhe edukim të drejtë, lojaliteti i tyre i thellë fetar ka mund t'iu mundësojë zgjerimin e shikimit të tyre dhe gjatë kohës të bëhen thelb i shoqërisë së vërtetë dhe rilindjes shpirtërore në tërë Arabinë. Fatkeqësisht, Ibn Saudi nuk arriti ta kuptojë rëndësinë e jashtëzakonshme të zhvillimit të tillë dhe i mjaftoi që ihvanëve t'u japë vetëm baza lakuriqe të edukatës fetare dhe profane - në të vërtetë, vetëm aq sa ka qenë e nevojshme ta mbajë zellin e tyre të zjarrtë. Me fjalë të tjera, Ibn Saud në lëvizjen e ihvanëve ka shikuar vetëm instrumentin e pushtetit. Më vonë ky dështim i tij i ka kthyer grushtin politikës së tij dhe në të njëjtin moment e ka rrezikuar edhe vetë ekzistencën e mbretërisë që e krijoi;

ai ndoshta ka qenë edhe indikacioni i mëhershëm se i ka munguar ajo madhështia e brendshme që populli i tij e ka pritur prej tij. Por, dëshpërimi i ihvanëve me mbretin dhe i mbretit me ihvanët ka ardhur shkallërisht...

Më 1913, Ibn Saudi, me fuqinë e tmerrshme sulmuese të ihvanëve që e kishte në disponim, përfundimisht e ndjeu veten mjaft të fuqishëm të provojë pushtimin e krahinës El-Hasë në Gjirin Persik, e cila dikur ka qenë pjesë përbërëse e Nexhdit, por turqit e patën okupuar para pesëdhjetë vjetësh.

Luftimi kundër turqve aspak nuk ka qenë përvojë e re për Ibn Saudin; aty-këtu ai ka hasur në njësitë turke, posaçërisht artilerinë polake, në armatat e Ibn Rashidit. Megjithatë, sulmi në El-Hasë, me të cilën drejtpërdrejt kanë qeverisur turqit, ka qenë krejtësisht ndërmarrje tjetër; kjo do ta shtynte në konflikt të drejtpërdrejtë me një fuqi të madhe. Ibn Saudi nuk ka pasur zgjidhje tjetër. Po qe se nuk do ta vente El-Hasën dhe limanët e saj nën kontrollin e vet, përherë do të mbetej i ndarë nga bota e jashtme, i pamundshëm që t'i pranojë dërgesat e domosdoshme me armatim, municion dhe gjësende tjera të nevojshme për jetë. Nevoja e ka arsyetuar rrezikun; por rreziku ka qenë aq i madh sa që Ibn Saudi gjatë kohë e ka zvarritur para ndërmarrjes së sulmit në El-Hasë dhe kryeqytetin e saj El-Hufuf. Edhe sot e kësaj dite ai me plot dëshirë rrëfen për rrethanat nën të cilat e mori vendimin përfundimtar:

"Ishim tashmë në dukje të El-Hufufit. Nga dina rano, në të cilën isha ulur, qartë kam mund t'i shoh muret e fortifikatës së fuqishme që dominonte mbi qytetin. Më pëlçiste zemra prej pavendosmërisë derisa peshoja përparësitë dhe rreziqet e kësaj ndërmarrjeje. Ndjehesha i lodhur; më kishte marrë malli për qetësinë dhe shtëpinë; në momentin kur mendoja për shtëpinë, fytyra e gruas sime, Xhevahires, më doli para syve. Fillova të

mendoj për vargjet që do të mund t'ia recitoja sikur të ishte pranë meje - dhe para se ta kisha kuptuar këtë, kam qenë i preokupuar me thurjen e këngës dedikuar asaj, duke harruar plotësisht ku jam dhe çfarë vendimi të rëndë duhej të marr. Sapo kënga u bë gati në mendime, e shkrova, e mbylla në zarf, e thirra njërin prej korrierëve të mi dhe e urdhërova: "Merri dy devet më të shpejta, shko hipur deri në Rijad pa u ndalur kund dhe dorëzoja këtë nënës së Muhammedit". Përderisa korrieri zhdukej në mjegullën e pluhurit ranor, befasisht e kuptova se shpirti im tashmë kishte marrë vendim në aspektin e luftës: do ta sulmoj Hufufin dhe Zoti do të më prijë në fitore".

Bindja e tij u tregua e arsyeshme. Në sulmin e guximshëm, luftëtarët e tij e pushtuan fortifikatën; trupat turke u dorëzuan dhe atyre iu dha leja që të tërhiqeshin me armët dhe pajisjet e tyre deri në breg ku do të hipnin në anijen për në Basër. Qeveria osmane, megjithatë, nuk ishte e gatshme që aq lehtë ta lëshojë pronën e vet. Në Stamboll u vendos që të dërgohej ekspedita ndëshkuese kundër Ibn Saudit. Por para se të mund të ndërmerrej një ekspeditë e tillë, shpërtheu lufta botërore, e cila e detyroi Turqinë që të gjitha forcat ushtarake t'i angazhojë tjetërkund; kurse kur përfundoi lufta, Perandoria Osmane më nuk ekzistonte.

Ibn Rashidi, i privuar nga përkrahja turke dhe i rrethuar nga Veriu me territoret që tash i qeverisnin Britania dhe Franca, nuk ka mund më t'u bëjë rezistencë në mënyrë të suksesshme. Forcat mbretërore, të udhëhequra nga Fejsal Ed-Davishi - tash njëri prej njerëzve më trima të Ibn Saudit - e pushtuan Hailin më 1921, kurse familja Ibn Rashid e humbi pikëmbështetjen e saj të fundit.

Ekspansioni i Ibn Saudit e arriti kulmin në vitin 1924-1925, kur e nënshtroi Hixhazin, duke përfshirë aty Mekën, Medinën dhe Xhiden, dhe kur e dëboi dinastinë

sherifiane e cila atje kishte ardhur në pushtet pas kryengritjes së Sherif Huseinit të cilin e kishin ndihmuar britanikët kundër turqve më 1916. Pikërisht me këtë nënshttrim të Vendit të Shenjtë islam Ibn Saudi, tash katërdhjetepesëvjeçar, plotësisht doli në shesh në botën e jashtme.

Përpjeta e tij e padëgjuar në pushtet në kohën kur pjesa më e madhe e Lindjes së Mesme i ishte shtruar depërtimit të Perëndimit, i dha shpresë botës arabe se përfundimisht është paraqitur prijësi i cili tërë kombin arab do ta lirojë nga robërimi; shumë grupe tjera muslimane në përjashtim të arabëve kanë pritur prej tij të sjellë rilindjen e idesë islame në kuptimin e saj të plotë me rregullimin shtetëror, në të cilin në mënyrë superiore do të sundojë fryma kur'anore. Mirëpo këto shpresa mbetën të papërmbushura. Ashtu si rritej dhe forcohej pushteti i tij, bëhej gjithë e më e qartë se Ibn Saudi është vetëm mbret i cili nuk synon asgjë më tepër se shumë sundimtarë tjerë autokratë të Lindjes para tij.

Ibn Saudi, i mirë dhe i drejtë në punët e tij individuale, lojal ndaj shokëve dhe simpatizuesve të vet, kurse zemërgjerë ndaj armiqve të vet, intelektualisht i ngritur lart mbi nivelin e shumicës së shokëve të tij, prapëseprapë nuk e shprehu gjerësinë e vizionit dhe udhëheqjes frymëzuese gjë e cila pritej prej tij. Vërtet, ai i vendosi kushtet e sigurimit publik në mbretërinë e tij të gjerë të cilat s'mund të haseshin në vendet arabe, prej kohës së hershme të hilafetit para një mijë vjetësh; por, për dallim nga halifët e parë, ai këtë e arriti me ndihmën e ligjeve rigorozë dhe masave ndëshkuese e jo duke mbjellur bindjen e përgjegjësisë qytetare në popull. Ai dërgoi në botën e jashtëm një grup të vogël të rinjsh që ta studiojnë mjekësinë dhe telegrafinë pa tel, por nuk bëri asgjë që të mbjellë në popullin e vet si tërësi dëshirën për arsimim dhe në këtë mënyrë ta nxjerrë nga injoranca në të cilën

me shekuj ka çaluar. Ai përherë flet - me të gjitha shenjat e jashtme të bindjes - për madhështinë e mënyrës islame të jetesës, por asgjë nuk bëri që të formojë shoqëri të barabartë, përparimtare, në të cilën kjo mënyrë e jetesës do të mund të gjente shprehjen e vet kulturore.

Ai është i thjeshtë, modest dhe punëtor i vyeshëm, por ai në të njëjtën kohë i lejon vetes, kurse edhe atyre përreth vetes, luksin e pakuptimtë dhe më ekstravagant. Ai posedon bindje të thella religjioze dhe e kryen rregullisht çdo dispozitë formale të drejtësisë islame, por si duket rrallë mendon në qenien shpirtërore dhe qëllimin e këtyre dispozitave. Ai i kryen pesë namazet e obliguara ditore në mënyrë mjaft të rregullt dhe kalon orë të tëra natën i thelluar në ibadet, por sikur asnjëherë të mos i kishte shkuar në mend se lutja është vetëm mjet, e jo qëllim për vetveten. Ai me gjithë qejf flet për përgjegjësinë e sunduesve ndaj ithtarëve të tyre dhe shpesh e përmend thënien e Pejgamberit: "Secili njeri është bari dhe do të përgjigjet për kopenë e vet". Sidoqoftë, ai e injoroi edukimin madje edhe të bijve të vet dhe në këtë mënyrë i la keq të përgatitur për punët që i pritnin. Kur e pyetën një herë pse nuk bën përpjekje ta organizojë shtetin e vet jo në bazë personale, kështu që djemt e tij të mund ta trashëgonin strukturën e organizuar të pushtetit, ai u përgjigj:

"Unë mbretërinë time e kam fituar me shpatën time dhe me përpjekjet e mia personale; djemtë e mi le ta japin mundin e tyre individual pas meje".

Më kujtohet një bisedë me Mbretin në të cilën plotësisht u tregua mungesa e vizionit qeverisës dhe mendjelehtësia e tij. Kjo ka ndodhur në Mekë, nga fundi i vitit 1928, kur udhëheqësi i famshëm i lëvizjes siriane për pavarësi Emir Shekib Arslani e vizitoi Mbretin. Ibn Saudi më prezantoi me këto fjalë: "Ky është Muhammed Asa-

di, biri ynë. Pikërisht është kthyer nga krahinat jugore. Ai me gjithë dëshirë shkon në mesin e beduinëve të mi".

Emir Shekibi, i cili ka qenë jo vetëm udhëheqës politik por edhe njeri me njohuri të gjithanshme dhe shkencëtar me arsimim të lartë, menjëherë u tregua kurrështar që të dëgjojë përshtypjet e mia sapo kuptoi se unë jam evropian që e ka pranuar Islam. Ia përshkrova disa forma të udhëtimit tim në Jug, e posaçërisht përvojën time në Vadi Bishi, të cilin më parë kurrë nuk e ka vizituar asnjë evropian. Mundësitë e mëdha agrikulturore të kësaj krahine, pasuria e saj në ujë dhe toka pjellore më ranë në sy sikur premtuese të jashtëzakonshme; gjatë rrëfimit, u ktheva nga Mbreti dhe i thash:

"Jam i sigurt, prijës, se Vadi Bishi lehtë mund të bëhet grunishtë që do ta furnizonte me grurë tërë Hixhazin nëse në mënyrë shkencore planifikohet dhe zhvillohet".

Mbreti i hapi veshët sepse importimi i grurit për provincën e Hixhazit ka harxhuar shumë të ardhura të vendit - kurse mungesa e të ardhurave gjithmonë ka qenë brenga më e madhe e Ibn Saudit.

"Sa kohë do të duhej", - më pyeti ai, - "që Vadi Bishi të zhvillohet në një mënyrë të tillë?"

Pasi nuk jam ekspert, nuk kam mund t'i japë kurrfarë përgjigje të qartë; i sugjerova se komisioni i ekspertëve të huaj teknikë do të duhej ta analizojë krahinën dhe të propozojë plane konkrete për zhvillimin e saj. Mora guxim t'i them se do të duhej më tepër pesë deri më dhjetë vjet që e tërë krahina të realizojë prodhimtarinë e plotë.

"Dhjetë vjet!" - bërtiti Ibn Saudi. - "Dhjetë vjet është kohë shumë e gjatë. Ne beduinët dimë vetëm një gjë: atë çka e kemi në duart tona e çojmë në gojë dhe e hamë. Të planifikohet dhjetë vjet më parë është tepër gjatë për ne".

Me të dëgjuar këtë deklaratë të çuditshme, Emir Shekibi më shikoi gojëhapur, sikur të mos iu besonte veshëve të vet. Unë kam mund vetëm t'ia kthej në të njëjtën mënyrë...

Pikërisht atëherë kam filluar të pyetem: a thua Ibn Saudi është njeri i madh të cilin komoditeti dhe mbretëria e kanë kthyer nga rruga e madhësisë - ose është vetëm njeri me trimëri dhe mendjemprehtësi të madhe i cili kurrë nuk ka synuar diç më tepër me përjashtim të pushtetit vetjak?

Deri më sot nuk mund të përgjigjem në një mënyrë të kënaqshme në këtë pyetje; sepse, edhe pse e njoh vite me radhë, dhe e njoh mirë, një pjesë e natyrës së Ibn Saudit më ka mbetur e pashpjegueshme. S'mund të thuhet se ai në cilëndo mënyrë qoftë është i fshehtë; ai lirisht flet për vetveten dhe shpesh i prezanton përvojat e veta, por karakteri i tij ka pasur tepër shumë anë që të mund të kuptohet lehtë, kurse pamja e thjeshtësisë së tij të jashtme e ka fshehur zemrën e shqetësuar sikur deti, kurse po aq të pasur në disponimet dhe kundërthëniet e brendshme.

Autoriteti i tij personal është shumë i madh, por ai nuk fillon aq shumë në fuqinë reale se sa në forcën sugjeshive të karakterit të tij. Ai është jashtëzakonisht modest në fjalë dhe në sjellje. Shpirti i tij vërtet demokratik i mundëson të bisedojë me beduinët të cilët i vijnë të veshur me tesha të ndyta, të grisura, sikur të ishte njëri prej tyre dhe t'iu lejojë ta thirrnin në emrin e tij - Abdulaziz. Nga ana tjetër, ai di të jetë i vrazhdë dhe plot urrejtje ndaj nëpunësve të lartë kurdoherë kur te ta zbulon servilitet. Ai e urren çdo snobizëm. Më kujtohet një rast në Mekë kur, gjatë kohës së darkës në pallatin mbretëror, kryepari i një familjeje më autoritative mekkase i mrroli vetullat në "pajjekurinë beduinase" të disa beduinëve nga Nexhdi

të cilët me kënaqësi e hanin orizin me shuplaka; në mënyrë që të tregojë pastërtinë personale, aristokrati mekkas me kujdes e përdori hajen e vet me maje të gishtave - kur papritmas ulëriu zëri i mbretit:

"Ju njerëzit elegantë që e shikoni hajen tuaj aq me kujdes; a e bëni atë për shkak se jeni mësuar të gërmoni me gishtat tuaj nëpër ndytësi? Ne prej Nexhdit nuk ju frikësohemi duarve tona; ato janë të pastra dhe për atë arsye hamë shijshëm me shuplakën plot!"

Ndonjëherë, kur ndodhet plotësisht i rehatshëm, buzëqeshja e lehtë fluturon mbi gojën e Ibn Saudit dhe i jep gati cilësi spirituale bukurisë së fytyrës së tij. Jam i sigurt, po që se muzika nuk do të konsiderohej e qortuar me ligjin e ashpër vehabit, ai në të do të shprehej; por Pasi është ashtu, ai e shfaq prirjen e tij për muzikë vetëm në këngët e veta të vogla, me përshkruarjen pitoreske të përjetimeve të veta dhe me këngët e tij të dashurisë dhe trimërisë që janë përhapur në mbarë Nexhdin kurse i këndojnë njerëzit derisa udhëtojnë me deve nëpër shkretëtirë, dhe gratë në vetminë e dhomave të tyre. Ajo zbulohet në mënyrën në të cilën jeta e tij e përditshme e ndjek ritmin e drejtë, elastik të përshtatur kërkesave të obligimit të tij mbretëror. Sikur Jul Qesari, ai posedon, në një shkallë të lartë, aftësi që t'i ndjekë disa kahe mendimesh në të njëjtën kohë, aspak duke mos e zvogëluar intensitetin me të cilin e sulmon çdo problem veç e veç; pikërisht ky talent i jashtëzakonshëm i jep të drejtë që vetë t'i drejtojë të gjitha punët e mbretërisë së vet të gjerë, duke mos rënë në atë rast në konfuzion as duke u thyer prej punës së tepruar, dhe ende të gjejë kohë dhe disponim që aq bollshëm t'i kushtojë kujdes shoqërisë së grave. Mprehtësia e konceptimit të tij është shpeshëherë e habitshme. Ka aftësi instinktive depërtuese, gati të pagabueshme, në motivet e njerëzve me të cilët vepron. Jorra-

llë - siç kam pasur edhe vetë rast të shoh - ai është në gjendje t'i lexojë mendimet e njerëzve para se ata të shprehen dhe sikur e ndjen qëndrimin e njeriut ndaj tij në atë moment kur hyn në dhomë. Pikërisht kjo aftësi i ka mundësuar Ibn Saudit t'i pengojë disa prova të jashtëzakonshme të përgatitura për ta likuiduar dhe në vendin e ngjarjes të marrë shumë vendime të qëlluara për çështjet politike.

Shkurt, Ibn Saudi shihet se posedon shumë veti të cilat do të mund ta bënin njeri të madh, por ai kurrë nuk ka bërë vërtet përpjekje ta arrijë madhërinë. Sipas temperamentit të vet ai nuk është i prirur ta sodisë vetveten, kurse krahas saj është shumë i talentuar për racionalizim, ta bindë vetveten se ka të drejtë në lidhje me lëshimet më të qarta, kurse lehtë i ikë çdo vetëkontrolli. Ata që e rrethojnë - oborrtarët dhe çanaklëpirësit e tij të shumtë që jetojnë nga zemërgjerësia e tij - nuk bëjnë asgjë që ta luftojnë këtë tendencë të pafatshme.

Duke hequr dorë nga premtimi shkëlqyes i ditëve të tij djaloshare, kur dukej se ëndërron ëndrra mallëngjyese, ai e shkatërroi - ndoshta edhe vetë duke mos e kuptuar atë - shpirtin e një kombi të shqetësuar i cili ka qenë i gatshëm ta pranojë me dëshirë si udhëheqësin që Zoti e dërgon. Ata prej tij kanë pritur shumë që me gjakftohtësi ta durojnë dëshpërimin në pritjet e tyre; disa prej më të mirëve nga Nexhdi flasin me zemërim për atë që ata e konsiderojnë tradhti të besnikërisë së tyre.

Kurrë nuk do ta harroj shprehjen e dhimbjes dhe dëshpërimit në fytyrën e një shoku prej Nexhdi - njeriut i cili dikur besonte në mënyrën më të zjarrtë në udhëheqjen e Ibn Saudit dhe e ndoqi nëpër ujë e flakë në vitet më të vështira të karrierës së tij mbretërore - kur, duke folur për mbretin, një ditë më tha:

"Kur kemi kalëruar me Ibn Saudin kundër Ibn Rashidit në ato ditët e para, dhe kur kemi kalëruar me të

nën flamurin në të cilin shkruante "La ilahe il-lall-llah" - "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut" - kundër atij tradhtarit të Islamit, Huseinit, kemi menduar se Ibn Saudi është Moisiu i ri, i caktuar ta nxjerrë popullin e vet prej robërimt të injorancës dhe prapambeturisë në tokën e premtuar islame. Mirëpo, kur u ul në komforin dhe luksin e vet të ripushtuar, duke harruar popullin e vet dhe ardhmërinë e tij, kemi zbuluar, për fat të keq, se ai është faraon..."

Shoku im, natyrisht, ka qenë shumë i ashpër, madje edhe i padrejtë në gjykimin e tij për Ibn Saudin, sepse ai nuk është as faraon as tiran; ai është një njeri i dashur dhe aspak nuk dyshoj se e don popullin e vet. Por ai nuk është as Moisiu. Gabimi i tij qëndron më tepër në atë se ai lëshoi rastin të bëhet aq i madh saqë mendonin njerëzit se është - e, ndoshta, aq sa ka mund ta kishte ndjekur thirrjen e djalërisë së vet. Ai është petrit i cili, në realitet, kurrë nuk ka fluturuar.

Ai thjesht mbeti udhëheqës dashamir i fisit në përmasa mjaft të zmadhuara...<sup>5</sup>

### - 3 -

Atë mëngjes kur e kam lëshuar Hailin më zgjoi një muzikë e zëshme e cila depërtonte nëpër dritaren e hapur të dhomës sime në oborr; këndimi, çurlikimi, rrapëllima, sikur një mijë violina dhe instrumente teneqesh harmonizoheshin para ekzekutimit solemn të operës së madhe: ajo polifoni e shkapërderdhur goditjesh të shkurtër, joharmonike të cilat, për shkak se ishin aq shumë dhe aq të ngulfatura, sikur po shkriheshin në fshehtësinë, gati fantazmatike, të tingullit unitar... Por ky me të vërtetë duhej të jetë orkestër famoz, sepse shumë ishin të fuqishme valët e tingujve që ai prodhonte.

Kur iu afrova dritares dhe shikova në përhimtësinë e mëngjesit, përtej pas tregut të zbrazët, pas shtëpive të qytetit prej dheu, drejt bregoreve ku rriteshin tamariskët dhe drunjtë e palmave - e dallova atë: ajo ishte muzika e pusit me kovat e vogla për të nxjerrë ujë në pemishte, të cilat pikërisht e fillonin punën e tyre ditore, në qindra puse. Në thasët e mëdhenj prej lëkure tërheqnin ujë devet; litarët për tërheqje kalonin përmbi çekrikët e përpunuar vrazhdë prej drurit, kurse secili çekrik rrotullohej në boshtin e drunjtë dhe këndonte, fishkëllonte, kërcëllonte dhe rënkonte në tingujt e shumtë të lartë dhe të thellë derisa litari nuk shpëstjellohej dhe çekriku nuk ndalej; kjo lëshonte një zë si britmë, kurse ai shkallërisht zhdukej në akordet e ngritura, tash më fuqishëm të përçjella me përplasjen e ujit në koritën e drunjtë; pastaj deveja kthehej dhe shkonte ngadalë mbrapsht drejt pusit - kurse çekriku përsëri krijonte muzikë derisa litari mbështillej në të e thesi i lëkurës zhytej në pus.

Pasi kishte aq shumë puse, këndimi nuk pushonte asnjë çast; tingujt herë shkriheshin në akorde, e herë ndaheshin; disa prej tyre fillonin me fishkëllimën e re përderisa të tjer qetësoheshin. Tërë zurkamat me ritme të pakapshme rrjidhnin bashkë dhe ndaheshin njëra prej tjetrës - duke ushëtuar, kërcëlluar, fishkëlluar, kënduar - çfarë orkestre madhështore! Ajo nuk ishte i udhëhequr nga dora e njeriut dhe për atë arsye gati mbërrinte madhëstsinë natyrore, dëshira e së cilës ishte e pakapshme.



## VII. Në gjysmë të rrugës

- 1 -

E kemi lëshuar Hailin dhe udhëtojmë drejt Medines, tash jemi tre udhëtarë me deve, sepse njëri prej njerëzve të Ibn Musaadit, Mensur el-Asaf, na përcjell një pjesë të rrugës si kasnec i emirit.

Mensuri është aq i këndshëm saqë, të gjitha gratë do të ktheheshin për ta shikuar sikur të paraqitej në rrugë të ndonjë qyteti në Perëndim. Ai është mjaft i gjatë, me fytyrë të fuqishme, burrërore dhe çuditërisht me vija të drejta të fytyrës. Lëkura e tij është e bardhë në të zeshkët - shenjë e pagabueshme e gjinisë së mirë ndër arabët - kurse dy sy të zinj shikojnë depërtueshëm në botë nën vetullat bukur të formësuara. Në të nuk ka asgjë prej butësisë së Zejdit ose tërheqshmërisë së qetë të Zejdit; vijat e fytyrës së tij flasin për pasionet e furishme ndonëse të kontrolluara dhe i japin paraqitjes së tij përshtypjen e sëndisjes, krejtësisht tjetërfare nga serioziteti i kthjellët i mikut tim shamaras. Por Mensuri, sikur edhe Zejdi, ka parë shumë njerëz dhe paraqet bashkudhëtar të përshtatshëm.

Në tokën e përhimtë të verdhë, zhurore që tash e ka ndërruar rërën e Nufudit mund ta kuptojmë botën e varfër shtazore që e përmbushin: lizzardët e imtë të përhimtë fluturojnë ndërmjet këmbëve të deveve tona me shpejtësi të jashtëzakonshme, fshehen nën shkurret therruese

dhe na shikojnë me sy të shkëlqyeshëm; minjtë e vegjël të përhimtë të fushës me bishta të zbukuruar ngjasojnë në ketrat; e kushërinjtë e tyre, marmotët, mishin e të cilëve lart e çmojnë beduinët nga Nexhdi dhe vërtet është njëra prej bonjërive më të shijshme që ndonjëherë e kam shijuar. Ka, po ashtu, edhe hardhuca që hahen, rreth një shputë të gjatë të quajtur "dab" që jetojnë në rrënjët e bimëve, kurse e kanë shijen ndërmjet mishit të pulës dhe peshkut. Insektet e zeza katërkëmbëshe të madhësisë së vesë së vogël të pulës mund të shihen se si me durim prekës e rrotullojnë baglën e thatë të deves; duke e shtyrë prapa me këmbët e fuqishme të prapme derisa trupi mbështetet në të parat, ata e rrotullojnë barrën e çmueshme me mundim drejt shtëpive të tyre, bier në shpinë nëse zhuri ua pengon rrugën, me vështirësi kthehen në këmbët e veta, e rrotullojnë pronën e vet një çik më tej, rrëzohen sërish, ngrihen dhe punojnë palodhshëm... Nganjëherë lepuri i përhimtë kërcen me kërcime të gjata nën shkurret e përhimta. I shohim edhe gazelat, por tepër larg që të gjuajmë në to; ato zhduken në hijet e kaltra të përhimta ndërmjet dy sukeve.

"Më thuaj, o Muhamed", - pyeti Mensuri, - "si ka ndodhur që ke ardhur të jetosh ndër arabët? Dhe si e ke përqaftuar Islamin?"

"Unë do të them se si ka ndodhur kjo", - ndërhyri Zejdi. "Ai së pari i ka dashuruar arabët, e pastaj fenë e tyre. A nuk është kështu, dajo?"

"E vërtetë është kjo që thotë Zejdi, Mensur. Para shumë vitesh, kur për herë të parë kam ardhur në vendet arabe, më ka tërhequr mënyra e jetës suaj. Kur kam filluar të pyes çka mendoni dhe në çka besoni, e kam njohur Islamin".

"A e ke zbuluar, Muhammed, menjëherë se Islami është fjala e mirëfilltë e Zotit?"

"E, jo, kjo nuk ka ndodhur aq shpejt. E para, unë atëherë nuk kam besuar se Zoti kurdoherë drejtpërdrejt i ka folur njeriut apo se librat për të cilët njerëzit pohojnë se janë fjalë e Tij janë çkado tjetër pos vepër e njerëzve të urtë..."

Mensuri shikonte në mua me skepsë të madhe: "Si ka mund të jetë kjo, o Muhammed? A nuk ke besuar madje as në shkresat e shenjta që i ka sjellë Moisiu apo në Ungjillin e Jezusit? Unë gjithëherë kam menduar që popujt e Perëndimit besojnë së paku në ato?"

"Disa po, Mensur, e të tjerët jo. Unë kam qenë ndër këta të tjerët..."

I sqarova se shumë njerëz në Perëndim tashmë ka-herë librat e shenjta - as të tyre e as të huajat - nuk i konsiderojnë si shpallje të mirëfillta të Zotit, por më shumë në to shohin historinë e zhvillimit të synimeve religjioze të njeriut gjatë shekujve.

"Kjo pikëpamje e imja që tronditur sapo mësova diç për Islamit", - shtova. - "Kjo ka ndodhur kur kam zbuluar që muslimanët jetojnë krejtësisht ndryshe nga ajo që evropianët mendojnë se duhet; çdoherë kur kam mësuar diç më shumë për mësimin e Islamit, më dukej sikur po zbuloj diç që gjithëherë e kam ditur edhe duke mos e ditur..."

Dhe kështu vazhdova, duke i rrëfyer Mensurit për udhëtimin tim të parë në Lindjen e Mesme - se si në shkretëtirën e Sinait i kam fituar përshtypjet e para për arabët; për atë çka kam parë dhe ndier në Palestinë, Egjipt, Transjordani dhe Siri; për atë se si në Damask kam pasur parandjenjen e parë se njëfarë rruge e re, deri atëherë e marrë me mend ngadalë, po zbulohet para meje; dhe si, pas vizitës së Turqisë, jam kthyer në Evropë dhe kam zbuluar se e kam vështirë sërish të jetoj në botën perëndimore, sepse, nga një anë, kam dëshiruar të arrijë përpjekje më të thellë të paretatisë së çuditshme që

tek unë ka nxitur njohjen time të parë me arabët dhe me kulturën e tyre, duke shpresuar se kjo do të më ndihmojë që më mirë të kuptoj, çka pres unë vetë nga jeta, kurse, nga ana tjetër, pata ardhur deri te pika ku më bëhej e qartë se më kurrë nuk do të jem në gjendje që të identifikohem me synimet e shoqërisë perëndimore.

Në pranverë të 1924, Frankfurter Zeitungu më dërgoi në udhëtimin tim të gjatë në Lindjen e Mesme. Libri që i përshkruan udhëtimet e mia të mëhershme përfundimisht qe mbaruar. (Është botuar disa muaj pas shkuarjes sime, me titullin "Lindja joromantike", me çka kam dëshiruar të them se ky nuk është libër për pamjen e jashtme romantike, ekzotike të Lindjes muslimane, por më tepër përpjekje që të depërtohet në realitetin e saj të përditshëm. Edhe pse qëndrimi i tij anticionist dhe simpatitë jo të rëndomta ndaj arabëve nxitën njëfarë turbullimi në shtypin gjerman, mendoj se nuk është shitur mirë).

Edhe njëherë e kam kaluar Mesdheun dhe e shikova bregun egjiptian para vetes. Udhëtimi me hekurudhë prej Port Saidit deri në Kajro ka qenë si palosje e faqeve të librit të njohur. Ndërmjet kanalit të Suezit dhe liqenit të Manzalesë shtrihej pasditja egjiptiane. Patat e egra notonin nëpër ujë, kurse tamariskat tundnin degët e veta bukur të prera. Fshatrat janë rritur nga rrafshet, që në fillim kanë qenë ranore dhe të mbuluara me vegjetacion të varfër. Buajt e zi, shpesh të shtyrë në zgjedhë së bashku me devetë, tërhiqnin plugjet me këmbë përtace nëpër tokën pranverore. Si u kthyem në perëndim prej kanalit të Suezit, na mbuloi gjelbërimi egjiptian. Kur përsëri i kam shikuar gratë me trup të hedhur e të gjatë se si në ritmin e papërshkruar lëkundën, duke hapuar nëpër fusha dhe lirisht duke bartur vorbat e dheut në kokë, kam menduar: Asgjë në tërë botën - as automobili më i përkryer, as ura më krenare, as libri më i mençur - nuk

mund të zëvendësojë këtë magjepsje që në Perëndim është humbur, kurse tashmë është rrezikuar edhe në Lindje - këtë magjepsje që është vetëm shprehje e harmonisë magjike ndërmjet Unit të qenies njerëzore dhe botës që e rrethon...

Këtë herë kam udhëtuar me klasën e parë. Në kabinën e trenit, pos meje, kanë qenë edhe dy udhëtarë: greku nga Aleksandria, njeri afarist që me lehtësi aq karakteristike për të gjithë levantinët, së shpejti më futi në bisedë të gjallë me vërejtjet mendjemprehte në çdo gjë që kemi parë, dhe umdeja egjiptian, kryepar fshati, i cili - duke gjykuar sipas kaftanit të tij të shtrenjtë të mëndafshhtë dhe zinxhirit të trashë të artë për orën që i zgjatej pas belit - qartë ka qenë i pasur por sikur është kënaqur të mbetet plotësisht i paarsimuar. Në realitet, sapo iu bashkangjiti bisedës sonë, menjëherë ka pranuar se nuk di as të lexojë e as të shkruajë, megjithatë, edhe ai manifestonte mendjemprehtësi të shëndoshë dhe shpesh i kundërvihet grekut.

Kemi folur, më kujtohet, për disa parimeve shoqërore në Islam që në atë kohë fort e kanë preokupuar mendimin tim. Bashkudhëtari im, greku, nuk pajtohej plotësisht me admirimin tim ndaj barabarësisë shoqërore në ligjin islam.

"Nuk është kjo aq e drejtë, o mik, si mendoni ju", - dhe, duke kaluar nga frëngjishtja, në të cilën patëm rënë, sërish në arabishte për shkak të bashkudhëtarit tonë egjiptian, tash i drejtohet atij: "Ju thoni se feja juaj është aq e drejtë. A mundesh atëherë ndoshta të më thuash përse Islami i lejon muslimanët që të martohen me kristianen ose hebraiken, por nuk u lejon vashave dhe motrave tuaja që të martohen për kristianin ose hebraikun? A e quan këtë drejtësi?"

"Gjithsesi", - u përgjigj umdeja i pashëm pa kurrfarë ngurrimi, - "e unë do të them përse ligji ynë fetar kështu e ka përcaktuar. Ne muslimanët nuk besojmë se Jezusi - paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të - është bir i Zotit; por e konsiderojmë, sikur që e konsiderojmë Moisiun dhe Abrahamin dhe të gjithë pejgamberët biblikë të tjerë, pejgamber të mirëfilltë të Zotit, të gjithë ata i janë dërguar njerëzisë në po atë mënyrë sikur edhe pejgambëri i fundit, Muhammedi - paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të; kështu, nëse hebraikja ose e kristiania martohet për muslimanin, ajo mund të jetë e sigurt se për asnjë person që është i shenjtë kurrë nuk do të flitet pa respekt në familjen e saj të re; nga ana tjetër, nëse muslimanja martohet për jomuslimanin, është e sigurt se atë që e konsideron ajo pejgamber të Zotit nuk do të respektohet... Ndoshta madje as fëmijët e saj; a nuk e ndjekin fëmijët rëndom fenë e babait të vet? A mendon se do të ishte korrekte t'i ekspozohet ajo dhembjes dhe fyerjes së tillë?"

Greku nuk kishte përgjigje tjetër në këtë pos që me habitet mblodhi supet; mua më dukej se ky umdeja (kryeparë fshati) i thjeshtë, analfabet, me atë mendjen e shëndoshë ashtu karakteristike racës së tij, ka prekur bërthamën e pyetjes shumë të rëndësishme. Edhe njëherë, sikur me atë haxhiun e vjetër ne Jerusalem, kam ndier se po më hapen dyert e reja drejt Islamit.

Në pajtim me rrethanat e mia të ndërruara financiare, kam qenë në gjendje që tash të jetoj në Kajro me stilin që s'mund të merrej me mend disa muaj më parë. Më nuk më është dashur t'i numëroj paratë. Ditët kur jam detyruar, gjatë kohës së qëndrimit tim të parë në këtë qytet, të jetoj me bukë, ullinj e qumësht, qenë harruar. Në një pikëpamje i kam mbetur besnik "traditës" së të kaluarës sime; në vend që të banoj në ndonjë prej kuarteve moderne të Kajros, kam marrë me qira dhomat në shtëpinë e mike-

shës sime të vjetër, asaj gruas së trashë nga Triesta, që më pranoi duarhapur dhe me puthje nëne në të dy faqet.

Ditën e tretë pas ardhjes sime, në perëndimin e die-llit, kam dëgjuar zërin e ngjirur të topit nga kështjella. Në të njëjtën kohë dritat u ndezën në galeritë<sup>6</sup> më të larta të dy minareve në këndet e xhamisë së kështjellës; të gjitha minaret e të gjitha xhamive në qytet e morën iluminimin dhe e përsëritën: në çdo minare kurorë e ngjashme e drita-ve. Nëpër Kajron e vjetër kaloi gjallëria e çuditshme; hapi i njerëzve u bë më i shpejtë dhe në të njëjtën kohë më i hareshëm, zhurma polifone nëpër rrugë u bë më e zësh-me; keni mundur të ndieni dhe pothuaj të dëgjoni tendos-jen e re se si vezullon në të gjitha këndet.

Tërë kjo ka ndodhur për shkak se hëna e re paralaj-mëron muajin e ri (sepse kalendari musliman është lu-nar), kurse ky muaj është Ramazani, muaji më solemn në vitin islam. Ai përkujton në kohën, më shumë se trem-bëdhjetë shekuj, kur, sipas traditës, Muhammedi e pra-noi shpalljen e parë të Kur'anit. Muslimanëve në këtë muaj, meshkujve dhe femrave, pos atyre që janë të së-murë, u është e ndaluar të hanë e pinë (madje edhe të pinë duhan) prej çastit kur vija e parë e dritës në hori-zontin lindor e paralajmëron agimin, deri në perëndimin e diellit, tridhjetë ditë. Gjatë kohës së këtyre tridhjetë di-tëve banorët e Kajros ecin me sy të flakëruar, sikur janë ngritur në vise të shenjta. Ato tridhjetë net keni dëgjuar kërsitjen e topit, këndim dhe britmat e haresë, derisa të gjitha xhamitë kanë shkëlqyer me dritë deri në agim.

Kam mësuar se qëllimi i këtij muaji të agjërimit është i dyfishtë. Abstenohet nga haja e pija që në trupin të ndjehet çka ndien i varfëri dhe i urituri; kështu mbillet përgjegjësia shoqërore në vetëdijen njerëzore si supozim religjioz. Qëllimi i dytë i agjërimit gjatë kohës së Rama-zanit është vetëdisiplina - aspekt i moralitetit individual

fort i theksuar në të gjitha mësimet islame (sikur, për shembull, ndalimi i plotë i të gjitha mjeteve dehëse, që Islami i konsideron ikje shumë të lehtë nga vetëdija dhe përgjegjësia). Në këto dy elemente - në vëllazërinë e njerëzve dhe vetëdisiplinën individuale - kam filluar të vërej konturat e pikëpamjes etike islame.

Në përpjekjet e mia që të fitoj fotografi më të plotë për atë çka vërtet do të thotë dhe paraqet Islami, dobi të madhe kam pasur nga shpjegimet që kanë mund të m'i ofrojnë disa nga miqtë e mi muslimanë të Kajros. Veçan i dalluar në mesin e tyre ka qenë Shejh Mustafa el-Meragi, njëri prej dijetarëve më të rëndësishëm islamë të asaj kohe, kurse pa dyshim më i shkëlqyeshmi në mesin e ulemave të Universitetit El-Ez'her (disa vjet më vonë u bë rektor). Në atë kohë duhej të ishte i viteve të dyzeta, por trupi i tij i ngjeshur, muskolor ka pasur rreptësinë dhe gjallërinë e njëzetvjeçarit. Përkundër arsimimit dhe seriozitetit të tij, prirja për humor kurrë nuk e ka lëshuar. Nxënës i reformatorit të madh egjiptian Muhammed Abduhusë, e Pasi në rininë e tij ka pasur lidhje me atë pishtarin entuziast, Xhemaludin el-Afganiun, Shejh el-Meragi edhe vetë ka qenë mendimtar i thellë dhe kritik. Kurrë nuk e ka lëshuar rastin të ma cekë se muslimanëve të sotshëm njëmend u mungojnë idetë e fesë së tyre dhe asgjë nuk do të ishte aq e gabueshme sikur të maten mundësitë e porosisë së Muhammedit me jetën dhe mendimet e muslimanëve të sotshëm.

"Pikërisht sikur që", - tha ai, - "do të ishte e gabueshme në mirësjelljen kristiane të disa ndaj disave pa dashuri të shikohet përgënjeshtrimi i porosisë së dashurisë së Krishtit..."

Me këtë paralajmërim, Shejh el-Meragi më futi në El-Ez'her.

Nga rrëmuja e rrugës Muski, qendrës më të vjetër tregtare të Kajros, arritëm në sheshin e vogël, të lënë pasdore, një anë të së cilës e zë fytyra e gjerë, e rrafshhtë e xhamisë ez'herite. Nëpër portën e dyfishtë dhe korridorin e hijësuar kemi hyrë në oborrin e vetë xhamisë, katrorin e gjerë të rrethuar me harqe të vjetra. Studentët të veshur në xhubet e gjata, të mbyllura dhe me turbanët e bardhë janë ulur në hasure dhe lehtë lexojnë librat dhe dorëshkrimet. Ligjëratat mbaheshin në sallën e madhe, të mbuluar të xhamisë pas oborrit. Disa profesorë janë ulur, po ashtu në hasure, nën shtylla që e kanë ndërprerë sallën në rende të gjata, kurse në gjysmërreth para çdo profesori ulej grupi i studentëve. Ligjëruesi kurrë nuk e ngre zërin, ashtu që qartë kërkon vëmendje të madhe dhe përqëndrim që mos të kalojë ndonjë fjalë e tij. Do të mund të mendohej se vëmendja e tillë është e nevojshme për dijetarin e vërtetë, por Shejh el-Meragi së shpejti i rrënoi iluzionet e mia.

"A po i sheh ata 'dijetarë' atje?", - më pyeti. - "Ata janë sikur ato lopët e shenjta në Indi që, si më thanë, e hanë çdo letër të shtypur që e gjejnë në rrugë... Po, ata i gëlltisnin të gjitha faqet e shtypura nga librat që janë të shkruar para disa shekujve, por ata nuk i bluajnë. Ata më nuk mendojnë me kokën e vet; ata lexojnë dhe përsërisin, lexojnë dhe përsërisin, kurse studentët që i dëgjojnë mësojnë vetëm të lexojnë dhe përsërisin, brez pas brezi".

"Por, Shejh Mustafa", - ndërhyra unë, - "El-Ez'heri, megjithatë, është seli qendrore e mësimin islam dhe universiteti më i vjetër në botë! Emri i tij ndeshet gati në çdo faqe të historisë kulturore muslimane. Ç'është me tërë ata mendimtarë, teologë, historianë, filozofë, matematikanë të mëdhenj që ai i ka dhënë gjatë dhjetë shekujve të fundit?"

"Ai ka pushuar t'i japë ata para disa shekujsh", - u përgjigj ai pikëllueshëm. - "Po, mbase jo krejtësisht; aty - këtu, nganjëherë, mendimtari i pavarur do të arrinte disi të mugullojë nga El-Ez'heri, madje edhe në kohën e sotme. Por në tërësi, El-Ez'heri ka rënë në sterilitet nga çka po pëson e tërë bota muslimane, kurse motivimi i tij i vjetër është fikur. Ata mendimtarët e vjetër islamë që i ceke, kurrë as nuk do të ëndërronin që pas aq shekujsh të mendimit të tyre, në vend që të vazhdohen e zhvillohen, vetëm përsëriten pa fund, sikur këto janë të vërteta përfundimtare e të pagabueshme. Nëse çkado qoftë duhet të ndryshohet për të mirë, duhet trimëruar mendimin, në vend të imitimit të tanishëm të mendimit..."

Karakterizimi i rreptë i El-Ez'herit nga Shejh el-Meragiu më ka ndihmuar të kuptoj njërin prej shkaqeve më të thella të rënies kulturore që është e dukshme kudo në botën muslimane. A nuk është manifestuar gurëzimi skollistik i këtij universiteti të vjetër në shkallë të ndryshme, në sterilitetin shoqëror të aktualitetit musliman? Vallë, a nuk mund t'i gjendet shtojca gjegjëse këtij stagnimi intelektual në pranimin pasiv, pothuaj mospërfillës nga ana e shumë muslimanëve të varfërisë së panevojshme në të cilën jetojnë, pësimi të nemitur të shumë padrejtësive shoqërore të cilave u janë nështruar?

A thua është e çuditshme, pyetësja, që në Perëndim, me përshtypjen e dëshmimeve ashtu të prekshme të rënies muslimane, të dominojnë pikëpamjet aq të shumta për vetë Islamin? Këto pikëpamje popullarizuese do të mund të shpreheshin kështu: rënia e muslimanëve mund t'i përshkruhet kryesisht Islamit, i cili, larg asaj që të jetë ideologji religjioze krahasuese me kristianizmin ose judaizmin, më tepër është përzierje e pafe e fanatizmit shkretinor, e sensualitetit të vrazhdë, besëtytnisë dhe fatalizmit të topitur që pengon ithtarët e tij të marrin pjesë

në përparimin e njerëzisë drejt formave më të larta shoqërore; në vend që ta çlirojë frymën njerëzore nga prangat e errësirës, Islami edhe më i shtrëngon; në pajtim me këtë, sa më parë që popujt muslimanë të çlirohen nga nënshtrueshmëria e tyre besimeve islame dhe praktikës shoqërore dhe të nxiten në pranimin e mënyrës perëndimore të jetesës, aq më mirë për ta dhe për botën tjetër...

Kundrimi im vetjak deri atëherë tashmë më pat bindur që perëndimori mesatar ka pasqyrë tmerrisht të shtrembëruar për Islamin. Atë që e kam parë në faqet e Kur'anit nuk ka qenë pikëpamje "e vrazhdë materialiste" mbi botën, por përkundrazi, vetëdije intensive për Zotin që manifestohet në pranimin racional të tërë natyrës që e ka krijuar Zoti; krahasueshmëria harmonike e shtytjeve intelektuale e ndijore, e nevojave shpirtërore dhe kërkesave shoqërore. E kam pasur të qartë që rënia e muslimanëve nuk është pasojë e asnjë mangësie të Islamit, por pikërisht lëshimi i tyre që të jetojnë sipas tij.

Sepse, vërtet, pikërisht Islami i ka shpënë muslimanët e parë deri te ngritjet kolosale kulturore, duke e orientuar energjinë e tyre drejt mendimit të vetëdijshëm si mjet i vetëm për të kuptuarit e natyrës së krijimit të Zotit dhe, në pajtim me këtë, vullnetit të Tij. Prej tyre nuk kërkohet të besojnë në dogmat të cilat është rëndë ose madje e pamundur të kuptohen; në realitet, kurrfarë dogme nuk mund të gjendet në shpalljen e Pejgamberit dhe, në pajtim me këtë, etja për dije me të cilën është karakterizuar historia e hershme muslimane nuk është dashur, si tjetërkund në botë, të zhvillojë luftë të mundimshme kundër fesë tradicionale. Përkundrazi, ajo mbinte pikërisht nga ajo fe. Pejgamberi arab ka shpallur se "kërkimi i diturisë është detyra më e shenjtë e çdo muslimani dhe muslimaneje", kurse ithtarët e tij kanë kuptuar se vetëm me arritjen e dijes mund plotësisht t'i shërbejnë

Zotit. Duke menduar për thënien e Pejgamberit që "Zoti nuk e ka krijuar sëmundjen e që nuk e ka krijuar edhe ilaçin kundër saj", ata kanë kuptuar se me kërkimin e ilaçeve të panjohura do t'i kontribuojnë përmbushjes së vullnetit të Zotit në Tokë; kështu ka lindur hulumtimi mjekësor si detyrë e shenjtë fetare. Në Kur'an kanë lexuar ajetin "Kemi krijuar çdo gjë të gjallë nga uji" - kurse në përpjekjen e vet që të depërtojnë në domethënien e këtyre fjalëve, ata kanë filluar të studiojnë organizmat e gjallë dhe ligjet e zhvillimit të tyre dhe kështu e kanë themeluar biologjinë. Kur'ani ka dhënë shenjë në harmoninë e yjeve dhe lëvizjet e tyre si dëshmitarë të lavdisë së Krijuesit të tyre, kurse muslimanët e kanë përvetësuar astronominë dhe matematikën me zjarr që në religjionet e tjera është rezervuar vetëm për lutje. Sistemi i Kopernikut që e konstaton rrotullimin e Tokës rreth boshtit të vet dhe lëvizjen e planetëve rreth Diellit, është zhvilluar në Evropë në fillim të shekullit gjashtëmbëdhjetë (i pritur me tërbim nga ana e etërve kristianë), që në këtë kanë parë kundërthënie me komentimin tekstual të mësimin të Biblës); themelet e këtij sistemi, në të vërtetë, janë shtruar gjashtë shekuj më herët në vendet muslimane - sepse tashmë në shekullin e nëntë dhe të dhjetë astronomët muslimanë kanë ardhur në përfundim se Toka është e rumbullakët dhe se sillet rreth boshtit të vet, kanë nxjerr llogari të sakta të gjatësive dhe gjerësive gjeografike, kurse shumica prej tyre kanë konstatuar - e që kurrë nuk janë akuzuar për herezi - që Toka rrotullohet rreth Diellit. Në mënyrën e njëjtë ata kanë përvetësuar kiminë, fizikën dhe fiziologjinë, sikur edhe të gjitha dituritë tjera në të cilat gjeniu musliman ka vënë përmendoren e vet më të vazhdueshme. Te ndërtimi i kësaj përmendoreje ata atje vetëm kanë ndjekur këshillën e Pejgamberit të vet se "çdokujt që niset në kërkim për

dituri Zoti do t'ia lehtësojë rrugën për në parajsë; që dije-tarët të shkojnë rrugës së Zotit; se epërsia e dijetarit ndaj atij që është vetëm i devotshëm është sikur epërsia e Hënës së plotë ndaj të gjithë yjeve tjerë; se ngjyra e dijetarit është më e vlefshme se gjaku i dëshmorit".

Nëpër tërë periudhën krijuese të historisë muslimane - do të thotë gjatë kohës së pesë shekujve të parë pas kohës së Pejgamberit - shkenca dhe mësimi nuk kanë pasur mbrojtës më të madh se qytetërimi islam, as shtëpi më të sigurt nga vendet në të cilat ka dominuar Islami.

Jeta shoqërore, gjithashtu ka qenë nën ndikimin e mësimin të Kur'anit. Në kohën kur në Europën kristiane epidemia është konsideruar qortim i Zotit, të cilës njeriu duhet vetëm që përunjësisht t'i nënshtrohet - në atë kohë, dhe ka herë para kësaj, muslimanët kanë ndjekur rekomandimin e Pejgamberit të vet që i ka udhëzuar që të luftojnë kundër epidemive me izolimin e qyteteve dhe viseve të infektuara. Në kohën kur madje edhe mbretërit edhe bujarët e Perëndimit pastrimin e kanë konsideruar pothuaj si luks të panjerëzishëm, madje edhe shtëpia më e varfër muslimane e ka pasur së paku një banjo, derisa banjot e përsosura publike kanë qenë shfaqje normale në çdo qytet të muslimanëve (për shembull, në shekullin e nëntë Kordova ka pasur treqind), kurse e tërë kjo si thirrje në mësimin e Pejgamberit se "pastërtia është pjesë e fesë". Muslimani nuk vinte në konflikt me kërkesat e jetës shpirtërore nëse do të kënaqej në gjërat e bukura të jetës materiale, sepse sipas mësimin të Pejgamberit "Zoti dëshiron të shohë te robërit e vet dëshmitë e bujarisë së vet".

Shkurtimisht, Islami u ka dhënë motivim të madh arritjeve kulturore që paraqesin njërin prej faqeve më krenare të historisë njerëzore; ai këtë motivim e ka dhënë duke e konfirmuar arsyen, e duke e mohuar errësirën, duke e konfirmuar aksionin, e duke refuzuar qetësinë në

përsiatjen e devotshme, duke e pranuar jetën, e duke e refuzuar asketizmin. Nuk është atëherë kurrfarë çudie që Islami, sapo doli jashtë kufijve të Arabisë, fitonte ithtarë të ri me shpejtësi të madhe. Të lindur e të edukuar në kristianizmin e Palit e të Augustinit, banorët e Sirisë dhe të Afrikës Veriore, e diç më vonë edhe të Spanjës vizigote, u gjetën papritmas të ballafaquar me mësimin që e mohon dogmën e Mëkatit të parë dhe thekson dinjitetin natyror të jetës tokësore; kështu ato në numrin gjithnjë në rritje hynin në besimin e ri që u ka mundësuar të kuptojnë se njeriu është mëkëmbës i Zotit në Tokë. Kjo, e jo "kthimi me shpatë" legjendar, është shpjegim i triumfit mahnitës të Islamit në mëngjesin e hovshëm të historisë së tij.

Nuk e kanë bërë muslimanët të madh Islamit; përkundrazi, Islami i ka bërë të mëdhenj ata. Por, sapo feja e tyre u bë shprehi, e ka pushuar të jetë program jetësor, të cilin duhet aplikuar vetëdijshëm, shtytja krijuese që qëndron në themel të qytetërimit të tyre është zhdukur dhe gradualisht ia ka lëshuar vendin indolencës, sterilitetit dhe rënies kulturore.

Njohuria e re deri te e cila kam ardhur dhe përparimi që e kam bërë në gjuhën arabe (jam marrë vesh që një student në El-Ez'her të më mësojë çdo ditë) kanë dhënë të kuptohet që tash përfundimisht kam diçka të ngjashme me çelësin për frymën muslimane. Më nuk kam qenë aq i sigurt që evropiani "nuk mundet kurrë vetëdijshëm ta fitojë pasqyrën e plotë", si pata shkruar në librin tim vetëm disa muaj më parë; tash kjo botë muslimane më nuk dukej aq tepër e huaj për asociacionet perëndimore. Më ka rënë në mend që, nëse dikush do të ishte në gjendje që të arrijë shkallë të caktuar të ndarjes nga shprehitë vetjake të kaluara të mendimeve dhe të lejojë mundësinë që, mbase, ata nuk janë të vet-

mit të vlefshëm, dikur bota muslimane e çuditshme njëmend do të mund të bëhej e kuptueshme...

Edhe pse kam gjetur shumë sosh që më tërhiqte arsyen time sikur edhe institucionet e mia, nuk e kam konsideruar të arsyeshme që njeriu inteligjent ta harmonizojë gjithë mendimin e vet dhe tërë pikëpamjen e vet ndaj jetës me sistemin të cilin nuk e ka sajuar ai vetë.

"Më thuaj, o Shejh Mustafa", - e pyeta me një rast mikun tim të ditur el-Meragiu, - "përse do të duhej të kufizohemi në ndonjë mësim të caktuar dhe në ndonjë sistem të caktuar të rregullave? A nuk do të ishte më mirë t'i lihen të gjitha frymëzimet etike zërit tonë të brendshëm?"

"Ajo që ti po e pyet, o vëllai im i ri, është se pse pajtjetër duhet të ekzistojë çfarëdo religjioni institucional? Përgjigjja është e thjeshtë. Vetëm pak njerëz - vetëm pejgamberët - vërtet janë në gjendje ta kuptojnë zërin e brendshëm që u flet. Shumica jemi ngatërruar me interesat dhe dëshirat tona personale - e kur secili do të duhej të ndjek vetëm dëshirat e zemrës së vet, do të kishim kaos të plotë moral dhe kurrë nuk do të mund të pajtoheshim për asnjë mënyrë të mirësjelljes. Natyrisht, do të mund të pyesja a ekziston çfarëdo përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm - njerëzit e arsimuar që ndiejnë se askush nuk duhet t'i udhëheqë në atë që ata e konsiderojnë se është e drejtë ose e shtrembër; por atëherë, të pyes, a nuk do ta kërkonin shumë, shumë njerëz këtë të drejtë të jashtëzakonshme për vete? E çfarë do të ishte rezultati?"

Tashmë kam qenë në Kajro pothuaj gjashtë javë kur e fitova sërisht malarien, të cilën për herë të parë e kam pasur në Palestinë vitin paraprak. Filloi me kokëdhembje, marramendje dhe dhembje në të gjitha gjymtyrët; nga fundi i asaj dite isha shtrirë në shpinë, i paaftë, pa forcë edhe dorën ta ngre. Zonja Viteli, zonja e shtëpisë,

ngarendte rreth meje sikur kënaqej në pafuqinë time; por kujdesi i saj ishte i singertë. Më dha qumësht të ngrohtë dhe më vënte fasha të ftohta në kokë - por kur propozova se ndoshta do të duhej ftuar mjekun, ajo u përgjigj me zemërim:

"Doktorin - uh! Ç'dinë ata kasapë për malarien! Di për të më shumë se cilido prej tyre. Burri im i dytë i ndjerë vdiq nga ajo në Shqipëri. Kemi jetuar në Durrës disa vite dhe ai, i mjeri, shpesh ka vuajtur prej dhembjeve më të forta se që janë tuajat, por gjithnjë ka pasur besim në mua..."

Kam qenë tepër i dobët që të grindem dhe e kam lëshuar që të më dend me përzierjen e fortë të verës së fortë greke dhe kininës, jo me ato hapet e ëmbëlsuara, por me qullin e vërtetë që me idhëtinë e vet më dridhte pothuaj më shumë se edhe vetë ethet. Por, në njëfarë mënyre, është e çuditshme kjo të thuhet, kam pasur plot besim në zonjën Viteli, përkundër përkujtimit të saj kobndjellës me "burrin" e vet "të ndjerë".

Atë natë, derisa trupi më digjej në ethe, befaz dëgjo-va muzikën e ëmbël, të gjallë nga rruga: zëri i orgës. Nuk ishin ato orgët e zakonshme me gjyrykët krikëllues dhe kavallët kërcitës, por diç që më shumë ju përkujton në pianokordet e brishta, të vjetra të cilat, Pasi ishin së tepërmi të buta dhe së tepërmi të kufizuara në nuanca, në Evropë tashmë ka herë kanë qenë të lëna pas dore. Kam parë edhe më herët orgë të tilla në Kajro: njeriu bartë një kuti në shpinë, kurse djaloshi e përcjell dhe e lëviz dorë-zën dhe tingujt bier një nga një, të shkurtër e të pastër, sikur shtizat që e godasin cakun e vet, sikur cingërima e xhamit, me largësi ndërmjet tyre. Pasi kanë qenë ashtu të papërzier dhe ashtu të ndarë njeri prej tjetrit, këta tinguj nuk i kanë lejuar lexuesit ta kapë tërë melodinë, por në vend të asaj e kanë tërhequr, në lëvizje, nëpër taktet e

ëmbla, të tendosura. Ata kanë qenë sikur fshehtësia që përpiqeni ta zbuloni, por nuk mundeni; ata ju kanë mundur me përsëritjen e amshueshme në kokën tuaj, gjithherë rishtazi gjatë natës, si rreth i vorbëlluar nga i cili nuk ka ikje, si vallja xhirore e dervishëve që i keni parë në Skutar - a ka qenë kjo para disa muajve, para disa viteve? - Pasi keni kaluar nëpër pyllin më të dendur të selvive në botë...

Ka qenë ky pylli më i pazakonshëm, ato varreza turke në Skutar, pikërisht matanë Bosforit prej Stambollit: aletë dhe shtigjet ndërmjet selvive të shumta e nën ta nishanet mbi varreza të shumta pingule të shtrira me mbishkrimet e vjetruara arabe (nga dhëmbi i kohës). Varrezat tashmë kaherë kanë pushuar të shfrytëzohen, të vdekurit e tzre kanë qenë tashmë fort gjatë të vdekur. Nga trupat e tyre janë rritur trungje të mëdha, njëzet deri tridhjetë metra të gjatë, duke u rritur në kohë të ndryshueshme dhe në qetësi të thellë që në atë prozhëm është aq e madhe sa që nuk ka vend për dëshpërim. Askund aq fort nuk ndjehet sikur këtu që të vdekurit flenë. Këta janë të vdekurit e botës që u ka lejuar të gjallëve të vet të jetojnë në qetësi; të vdekurit e njerëzisë që nuk i ngutë.

Pas bredhjes së shkurtër nëpër varre, pastaj rrugicave të ngushta, bregore të Skutarit, hasa në xhaminë e vogël që mu zbulua me arabeskat e shkëlqyeshme ornamentale mbi dyer. Meqë dyert ishin të hapura, hyra dhe u gjeta në lokalin e errët midis të cilit ishin ulur disa figura në qilim në rreth, rreth një njeriu mjaft të vjetër. Të gjithë bartnin guja të gjata dhe kapela të larta, të mbyllura plisi pa rreth. Imami i vjetër recitoi një fragment nga Kur'ani me zë monoton. Përgjatë një muri ishin ulur disa muzikantë: lodërtarë, flautistë dhe muzikantë që i bien kamanxhës, instrument i ngjashëm me violinën me qafë të gjatë.

Më ra ndër mend se këtë tubim të çuditshëm duhej ta përbënin "dervishët rrotullues" për të cilët kam dëgjuar aq shumë; rendi mistik që ka për qëllim që, me anë të disa lëvizjeve ritmike të përsëritura e të forcuara, të bie në trans ekstatik për të cilin të udhëzuarit thanë se u mundëson ta arrijnë përjetimin e drejtpërdrejtë dhe personal të Zotit.

Qetësinë që kishte pasuar pas recitimit të imamit papritmas e ndërpreu zëri i hollë, lart i përshtatur i flautës dhe filloi muzika monotone, pothuaj pikëlluese. Si një u ngrihën dervishët, i hodhën nga vetja gunat dhe mbetën në tunikat e bardha, valëvitëse që u mbërrinin deri në nyje të këmbëve, kurse në bel ishin të lidhur me shalle në nyje. Pastaj secili prej tyre bëri gjysmëlëvizje, ashtu që, duke qëndruar në rreth, në çifte, qenë të kthyer njëri - tjetrit, atëherë i kryquan duart në kraharor dhe thellë iu përulën njëri - tjetrit (është dashur të mendoj në menuetin e vjetër dhe në kalorësit që në palltot e qëndisura se si përulen para zonjave të veta). Në çastin e ardhshëm të gjithë dervishët i zgjatën duart e veta anash, me shuplakën e djathtë të kthyer poshtë, e të majtën lartë. Si kënga pëshpëritëse, fjala Huve - "Ai" (do të thotë Zoti) jehon nga buzët e tyre. Me këtë zë të ulët në buzë, secili fillon lehtë të lëvizë rreth vetes, duke u lëkundur në ritmin e muzikës që sikur vinte nga largësia e madhe. I qitën kokat prapa duke i mbyllur sytë, kurse serioziteti i lehtë i përshkoi fytyrat e tyre. Gjithnjë shpejt e më shpejtë bëhej lëvizja xhirore; tunikat e gjera u ngritën dhe formuan rrathë të gjera rreth figurave rrotulluese, që ngjasojnë me vorbullat në det; fytyrat e tyre tregonin thellim të madh... Xhirimi u bë rrotullim vorbull, mallëngjimi dhe dalldia u rritën dukshëm në secilin prej tyre. Në përsëritjen e panumërt, buzët e tyre gjysmë të hapura shqiptonin fjalën Huve... Huve... Huu-ve...; trupat e tyre rrotulloheshin dhe rrotulloheshin, gjithnjë në rreth, kurse muzika

sikur i fuste në akordet e veta të ngjirura, vorbulluese, monotone, monotonisht duke u rritur - ndërsa ju ndieni sikur edhe juve pashmangshëm ju tërheq në vorbullën në rritje, në shkallët e rrëpishme, spirale marramendëse, më shumë, më shumë, gjithherë më shumë, gjithnjë shkallët e njëjta por gjithnjë më shumë, në spiralët gjithnjë në rritje, drejt një visi të paarrtshëm, të pakuptueshëm... derisa dora e madhe, miqësore e zonjës Viteli e vënë në ballë nuk e qetëson vorbullimin dhe e ndërpret magjinë marramendëse dhe duke ju kthyer nga Skutari në freskinë e dhomës të shtruar me pllaka guri në Kajro...

Megjithatë zonja Viteli ka pasur të drejtë. Shërimi i saj më ka ndihmuar që ta mposhti sulmin e malaries, nëse jo më parë, atëherë së paku aq shpejt sa do ta bënte këtë çdonjëri mjek profesional. Për dy ditë gati u lirova nga ethet, kurse ditën e tretë krevatin kam mundur ta ndërroj me karrige komode. Megjithatë kam qenë tepër i rraskapitur që të mund të dalë, kurse koha ngadalë kalonte. Një apo dy herë mësuesi im - studenti nga El-Ez'heri më vizitoi dhe mi sollli disa libra.

Kujtimi im i paradokohshëm i dervishëve nga Skutari, i nxitur nga ethet, më ka mallëngjyer. Ai papritmas ka fituar domethënie enigmatike që nuk ka qenë evidente te përvoja origjinale. Ritualizmi ezoterik i këtij rendi religjioz - njërit prej shumë sosh që i kam takuar në vendet e ndryshme muslimane - nuk dukej se pajtohej në fotografinë e Islamit që lehtë formësohej në shpirtin tim. Kam kërkuar nga miku im nga El-Ez'heri që të m'i sjellë disa vepra orientale për këtë lëndë; nëpërmjet tyre, dyshimi im instinktiv se ezoterizmi i këtij lloji është futur në botën e muslimanëve nga burimet joislame, u konfirmua. Spekulumet e sufive, si quhen këta mistikë muslimanë, kanë zbuluar ndikime gnostike, induse, e nganjë-

herë madje edhe kristiane që kanë fituar koncepte dhe praktikë asketike plotësisht të huaja porosisë së Pejgamberit arab. Në porosinë e tij arsyeja është theksuar si rru- ga e vetme reale drejt fesë. Ndonëse vlefshmëria e për- vojës mistike nuk është përjashtuar detyrimisht nga kjo qasje, Islami në mënyrë parësore është ndërmarrje intelektuale, e jo emocionale. Edhe pse, krejtësisht e natyrshme, ka krijuar përkushtueshmërinë e fuqishme emocionale të ithtarët e vet, mësimi i Muhamedit nuk i ka dhënë emocionit si të tillë çfarëdo roli të pavarur në botëkuptimet religjioze, sepse emocionet, sado të thella, janë shumë më tepër të shtruara ndikimit të dëshirave subjektive dhe drojes se sa që kurdoherë mund të jetë arsyeja, përkundër gabueshmërisë së vet.

"Kështu, Mensur, Islami ngapak më zbulohet: një fije këtu, një shkëlqim atje, me anë të bisedës, librave, vështrimit - ngadalë, pothuaj që nuk kam qenë as i vetëdijshëm për këtë..."

## - 2 -

Kur u ndalëm të bisedojmë, Zejdi filloi të pjekë bukë. Ai e përziu brumin nga mielli i trashë i grurit, me ujë e kripë, dhe e formësoi në bukë të vogël shpatuke, të rrumbullakët të trashë rreth tre centimetra. Pastaj hapi gropë në rërë, e mbushi me degë të thata dhe i ndezi; kur flaka, pas gufimit të papritur, u ul, ai e vuri bukën e vogël në prush, e mbuloi me hi të nxehtë dhe ndezi turmën e re të degëve mbi të. Pas një kohe ai e nxori bukën, e ktheu, e mbuloi sikur herën e parë dhe ndezi zjarr të ri mbi të. Pas edhe nja një ore buka nxirret nga hiri dhe shkundet me shkop që të hiqen hiri dhe rëra që kanë mbetur. E hamë me gjalpë e hurma. Nuk ka bukë më të ëmbël as më të shijshme se kjo.

Uria e Mensurit, sikur edhe Zejdit dhe e imja është shuajtur, por kureshtja e tij nuk u plotësua. Derisa jemi të shtrirë rreth zjarrit, ai edhe më tej më shtron pyetje për atë se si më në fund jam bërë musliman - dhe derisa përpiqesha që këtë t'ia sqaroj, më ra ndër mend, si diç e ngjashme me çuditjen, sa rëndë është me fjalë të përkruhet rruga ime e gjatë në Islam.

"Sepse, Mensur, Islami më ka ardhë si musafir i paftuar që natën hyn në shtëpi, fshehurazi, pa zhurmë e britmë; me qëllim që të mbetet përgjithnjë. Megjithatë më është dashur me vite ta zbuloj se duhet të jem musliman..."

Duke menduar tash për ato ditë të udhëtimit tim të dytë në Lindjen e Mesme - kur Islami krejtësisht me seriozitet filloi ta përfshijë frymën time - më duket se madje edhe atëherë kam qenë i vetëdijshëm se ky udhëtim ka qenë zbulim. Çdo ditë vinin përshtypje të reja, çdo ditë paraqiteshin tek unë pyetjet e reja dhe përgjigjet e reja. Ata e kanë zbuluar jehonën e diçkaje që ka qenë e fshehur diku në prapavijë të shpirtit tim, e pasi kam përparuar në njohjen time të Islamit, kam ndier, çdoherë rishtazi, se njëfarë e vërtete që gjithherë e kam ditur e që nuk kam qenë as i vetëdijshëm për këtë, shkallërisht po zbulohet dhe konfirmohet.

Në fillim të verës 1924 u nisa prej Kajros në udhëtimin e gjatë që gati ka zgjatur dy vjet. Tërë këtë kohë kam lëvizur ngadalë nëpër vendet e vjetra me urtësi të traditës së vet, por përherë të freskëta me manifestimin e tyre në shpirtin tim. Kam udhëtuar pa nguti, me pushime të gjata. Sërisht e kam vizituar Transjordaninë dhe kam kaluar disa ditë me emir Abdullahun duke u kënaqur në urtësinë e ngrohtë të vendit beduinaz që ende nuk qe detyruar që t'ua adaptojë karakterin e vet ndikimeve perëndimore. Pasi këtë herë vizën ma siguroi Frankfurter Zeitungu, kam mundur prap ta shohë Sirinë. Damasku

erdhi e shkoi. Gjallëria levantinase e Bejrutit më përqafoi pak kohë që së shpejti të harrohet në ëndërrinë e lënë pas dore të Tripolit me pamjen e tij të lumturisë së qetë. Vaporët e vegjël, të demoduar lëkundeshin në skelen e vet në limanin e hapur, kurse katartët e tyre latinë lehtas kërcitnin. Në karrige të ulëta para kafenesë në kej ishin ulur qytetarët e Tripolit, duke u kënaqur në filxhanin e kafesë dhe me nargjilë në diellin e pasditës. Gjithkund qetësi dhe kënaqësi dhe qartë bollëk ushqimi; madje edhe lypsarët dukej se kënaqen në diellin e ngrohtë sikur thonë: "Oh, sa mirë është të jesh lypës në Tripoli!"

Kam ardhur në Halep. Rugët dhe ndërtesat e tij më përkujtonin në Jerusalemin dhe shtëpitë e vjetra gurore, të cilat sikur janë rritur nga trolli, kalimet e errëta, të qemeruara, sheshet dhe oborret e qeta, dritaret e gdhendura. Mirëpo, jeta e brendshme e Halepit ka qenë krejt tjetërfare nga ajo në Jerusalem. Disponimi dominues i Jerusalemit ka qenë krahasimi i rrymimeve të konfrontuara nacionale, si shtangim i dhembshëm, kompleks; drejtpërdrejt krahas botës së mendimeve dhe mallëngjimit të thellë religjioz është rritur, sikur vrëra helmuese, një urrejtje pothuaj mistike mbi njerëzit dhe gjësendet. Halepi, ndërkaq - edhe pse përzierje e arabes dhe levantines, dhe me tregjet e Turqisë së afërt - ka qenë harmonik dhe i kthjellët. Shtëpitë me fasada gurore dhe ballkone drunjsh kanë qenë të gjalla madje edhe në qetësinë e tyre. Zelli i qetë i zejtarëve të bazarit të vjetër; oborret e shumë karvan-sarajeve të vjetra me arkadat dhe loxhat e tyre me plot mall; kursimi së bashku me makutërinë e hareshme, kurse të dyjat të lira nga xhelozia; mungesa e çfarëdo nxitimi, mirëqenia që e përshkon të huajin dhe nxitë tek ai dëshirën që jeta e tij të rrënojset në mirëqenie: tërë kjo ka rrjedhë bashkërisht në melodinë e fuqishme, tërheqëse.

Nga Halepi me veturë kam shkuar në Dajr ez-Zor, qytezë në veriun skajor të Sirisë, prej nga kam mësyre të vazhdoj rrugës së vjetër karvanase paralelisht Euftratit; pikërisht në këtë udhëtim për herë të parë e kam takuar Zejdin.

Për dallim prej rrugës Damask - Bagdad, nëpër të cilën veturat kanë kaluar tashmë disa vjet, rruga përgjatë Euftratit ka qenë pak e njohur; në realitet, vetëm një veturë nëpër të ka kaluar disa muaj para meje. Shoferi im, ermenas, as vetë kurrë nuk ka shkuar më tej prej Dajr ez-Zorasë, por ka qenë i bindur se mundet disi ta gjejë rrugën. Megjithatë, ka ndier nevojën për informata më të afërta; kështu së bashku kemi shkuar në bazar duke i kërkuar ata.

Rruga e bazarit shkonte me tërë gjatësinë e Dajr ez-Zorasë, i cili ishte një hibrid ndërmjet qytetit sirian provincial dhe metropolitës beduinase, me theks në këtë të dytën. Botët këtu takoheshin në intimitet të çuditshëm. Në një shitore shiteshin panoramat moderne, dobët të shtypura, e drejtpërdrejtë përbri saj disa beduinë flitnin për rënien e shiut në shkretëtirë dhe për armiqësitë e paradokohshme ndërmjet fisit sirian Bishër-Anazit dhe Shamar të Irakut; njëri prej tyre e ceku sulmin e guximshëm që, në Irakun Jugor, para pak kohe, e ka kryer kryepari beduinas nga Nexhdi, Fejsal ed-Davishi; shpesh e ka përmendur emrin e njeriut të madh nga Arabia, Ibn Saudin. Pushkët e vjetra breshanë me tyta të gjata dhe kundakë të dekoruar me argjend - pushkë të cilat më askush nuk i blente, për shkak se ato moderne ishin shumë më efikase - ëndërrisht dhe zymshëm jetonin ndërmjet uniformave të përdorura nga tri kontinentet, shalët për deve nga Nexhdi, Goodyear, gomat për automjetet, fenerët nga Lajpcigu dhe gunat e zeza beduinase nga El-Xhevfa. Mirëpo, malli përëndimor nuk dukej si

ndërfutës në mesin e të vjetrës; vlefshmëria e tij i ka dhënë vendin e vet natyror. Me domethënien e vet të gjerë për realitetin, beduinët duket se lehtë i pranojnë të gjitha këto gjëra të reja, të cilat qysh dje kanë qenë jashtë horizontit të tyre, dhe i bëjnë të vetat duke mos i tradhtuar të vjetrat e veta. Ky stabilitet i brendshëm, kam menduar, duhet patjetër t'u jap forcë ta bartin hovin e kohës së re dhe që, mbase, mos të nënshtrohen - sepse ajo i afrohej këtij populli që deri para pak kohësh ka qenë aq i tërhequr dhe aq i fshehur; por kjo kurrsesi nuk ka qenë trokitje armiqësore në dyert e tyre; ata i kanë pranuar të gjitha ato risi me kureshtje virgjërore dhe, të thash ashtu, i kanë prekur nga të gjitha anët, duke përsiatuar për dobinë e tyre të mundshme. Pasi pak kam kuptuar atëherë çka "gazetat" perëndimore mund t'u bëjnë beduinëve modestë analfabetë...

Derisa shoferi im ermen pyeste te grupi i beduinëve, ndjeva se dikush po më tërheq për mëngë. U ktheva. Para meje qëndronte arabi serioz, i pashëm i viteve të tridhjeta.

"Nëse lejon, efendi", - tha ai me zë të qetë, të ngjirur. "Po dëgjoj se po shkoni me automjet në Bagdad dhe nuk e di rrugën. Më lejo të vij me ty; mund të të ndihmoj".

Më pëlqeu menjëherë dhe e pyeta kush është ai.

"Unë jam Zejd ibn Ghanimi", - u përgjigj ai, - "shërbej si agajl në Irak".

Vetëm atëherë vërejtja ngjyrën e përhimtë të verdhë të kaftjanit të tij dhe yllin shtatërremësh, emblemën e policisë shkretinore irakiane në igallon e tij të zi. Ky lloj i trupave, ndër arabët të quajtur agajlë, ka ekzistuar tashmë në kohën e turqve: korpuset e vullnetarëve të regrutuar përjashtimisht nga Arabia Qendrore - njerëzit për të cilët shkretëtira është shtëpi kurse devja mik. Gjaku i tyre avanturier i ka tërhequr nga vendlindja e tyre koprrace

në botën në të cilën ka më shumë para, më shumë lëvizje, më shumë ndryshime ndërmjet sot dhe nesër.

Zejdi më tha se ka ardhur në Dajr ez-Zor me njërin prej oficerëve të vet në lidhje me kontrollin e kufirit siriano-irakian. Derisa oficeri tashmë është kthyer në Irak, Zejdi ka mbetur t'i kryejë disa punë private; tash më me dëshirë do të kthehej me mua se sa të shkojë rrugës së zakonshme ose rreth e rrotull nëpërmjet Damaskut. Singërisht pranoi se kurrë nuk ka udhëtuar përgjatë Euftratit, por e ka ditur sikur edhe unë se për shkak të pengesave dhe kthesave të saj të shumta nuk mund gjithnjë të mbëshetemi në lumin që të na udhëheq - "por", - shtoi ai, - "shkretëtira është shkretëtirë, dielli dhe yjet janë të njëjtë dhe ne, insha Allah, do ta gjejmë rrugën". Më pëlqeu vetëmohimi i tij serioz dhe me dëshirë pranova të niset me mua.

Mëngjesin vijues e kemi lëshuar Dajr ez-Zorin. Shkretëtira e madhe e Hamadit shtrihet në rrotat e "fordit" tonë të modelit T: rrafshi i paskaj i rërës, nganjëherë e lëmuar dhe e rrafshët si asfalt, e nganjëherë valëzore prej horizontit në horizont. Nganjëherë Euftrati paraqitet nga ana jonë e djathtë, baltik, i qetë, me brigje të ulta; do të mendonit: liqe i qetë, derisa shikimin tuaj nuk e tërheq copa e drurit ose barka me lëvizje të shpejtë dhe nuk e zbulon rrymën e fuqishme. Ishte ky lumë i gjerë, mbretëror, nuk jepte zë, nuk ishte i mbrapshtë, nuk vërsulej, nuk stërpikte. Shkonte, rrëshqiste, shiriti i shtrirë për së gjati e për së gjeri, i pangatërruar, duke zgjedhur rrugën e vet të pavarur në kthesat e panumërta përgjatë pjerrtësisë së pavërejtur të shkretëtirës, i barabartë me të barabartin me veten, krenar në krenarinë, sepse shkretëtira ishte po ashtu e shtrirë, e fuqishme dhe e qetë sikur edhe lumi.

Bashkudhëtari ynë i ri, Zejdi, ulej pranë shoferit me gjunj të tërhequr lart dhe dhe me një këmbë që varej

përtej dyerve; në këmbët e tij shkëlqenin çizmet e reja nga lëkura e kuqe marokiene që i kishte blerë ditën para-prake në bazarin në Dajr ez-Zor.

Nganjëherë i takonim udhëtarët me deve që shfaqeshin prej askund midis shkretëtirës, pushonin në çast dhe shikonin në veturë, e pastaj sërish u grahnin kafshëve të veta dhe zhdukeshin. Ata ishin barinj; dielli i kishte djegur fytyrat e tyre të cilat janë bronzë e mbyllur. Pushimet e shkurtëra në karvan-sarajet e vetmuara, të harxhuara ndërroheshin në horizontet e pafund të shkretëtirës. Eufрати ka humbur pas horizontit. Rëra e rrahur me erën e rreptë, rrafshet e gjera të zhurit, aty-këtu ndonjë bulluke bari dhe shkurret therrore. Nga ana e djathtë e jonë rritet papritmas zinxhiri i kodrave të ulëta, të zhveshura e të pëlçitura, duke u grimcuar nën diellin e rreptë, dhe e ndërprejnë paskajin e shkretëtirës. "Ç'do të mund të kishte pas atij vargu të ngushtë të kodrave?", - pyetet njeriu në habi. Edhe pse kemi ditur që rrafshi i njëjtë ose shkretëtira bregore shtrihet pas tyre, rëra e njëjtë dhe zhuri i njëjtë i fortë i ofron fortësinë e vet virgjërore diellit, fryma e fshehtësisë së pashpjegueshme ka qenë në ajër: "Ç'do të mund të kishte atje?" Atmosfera ka qenë pa përgjigje ose jehonë, heshtja vezulluese e pasditës dinte vetëm për ushtimën e motorit tonë dhe zhurmën e gomave mbi zhurë. A mos ka rënë skaji i botës atje në humnerën e pafillim? Për shkak se nuk dija, e paditura ka qenë atje, e për atë që ndoshta kurrë nuk do të dijë, kjo ka qenë e pakuptueshme, e panjohur.

Pasdite shoferi ynë zbuloi se në karvan-sarajin e fundit ka harruar të marrë ujë për motor. Lumi ka qenë larg; nuk kishte pus me milje përreth; gjithkund rreth nesh, deri në horizontin valëvitës, shtrihej rrafshina përcëlluese, sikur shkumësi i bardhë. Era e butë, e nxehtë, fryente mbi

të, duke ardhur prej askund dhe duke shkuar askund, pa fillim dhe fund, zhurma e ngjirur nga vetë amshia.

Shoferi, indiferent sikur të gjithë levantinasit (veti që e kam çmuar tek ata - por jo pikërisht atëherë), tha: "Ah, madje edhe kështu do të arrijmë deri te karvan-saraji tjetër".

Por, dukej se nuk mund të arrijmë "madje edhe kështu". Dielli përvëlonte, kurse uji në motor vlonte sikur në çajnik. Sërish i takuam barinj të. Ujë? Jo, askund ujë në pesëmbëdhjetë orë ecje të deves.

"E ç'pini ju?" - pyeti në dëshpërim ermenasi.

Ata u qeshën. "Pijmë qumështin e deves". Është dashur të qeshen në vete me këta njerëz qesharake në qerren lëvizëse të shpejtë të djallit, të cilët pyesin për ujin - kur çdo fëmijë beduinas ka mundur t'iu thotë se në atë vis nuk ka ujë.

Pamje të pakëndshme: të mbetesh këtu në shkretëtirë me motorin e prishur, pa ujë dhe ushqim dhe të presësh derisa të vijë ndonjë qerre tjetër - ndoshta nesër ose pasnesër - ose ndoshta muajin vijues...

Pas pak kohësh shoferi e humbi mosbregosjen e vet të hareshme. Ai e ndali qerren dhe e ngriti kapakun e radiatorit; fiskaja e bardhë e dendur e avullit shpërtheu në ajër. Kisha pak ujë në termosik dhe e flijova për të mirën e motorit. Ermenasi i qiti pak vaj dhe "fordi" i guximshëm na barti një kohë.

"Mendoj se do të mund të gjenim ujë atje djathtas", - tha optimisti. - "Ato brigje duken aq të gjelbër - duket se atje ka bar të njomë, e atje ku rritet bari në këtë kohë të vitit, kur nuk ka shi, duhet patjetër të ketë ujë. Nëse atje ka ujë, përse mos të shkojmë për të?"

Në logjikë gjithëherë ka diç të pashmangshme; kishte madje edhe këtu, edhe pse logjika e ermenasit sikur shkonte në kukëza. E lëshuam rrugën dhe u vërsulëm disa

milje drejt brigjeve: nuk ka ujë... Shpatijet nuk qenë të mbuluara me bar, por me shkëmbinj të gjelbër.

Dëgjohej fërshëllima në motor, pistonët rrahnin shurdhueshëm, tymi si mjegulla të përhimta gufonte nën kapakun e motorit. Edhe disa minuta dhe diçka do të pëlciste: do të thyhej leva e makinës ose ndonjë cikërrimë e ngjashme. Por tashmë ishim larg prej rrugës së karvaneve; nëse diçka ndodhte tash, do të mbeteshim pa ndihmë në këtë shkretëtirë. Gati tërë rezerva jonë e vajit shkoi në radiator. Ermenasi u bë histerik; ai "kërkonte ujë", voziste majtas, pastaj djathtas, duke bërë tetëshe sikur në arenën e cirkëve, por uji me këmbëngulje refuzonte që të shfaqej. Shishja e konjakut të cilën me ofshamë e dhash, nuk i ndihmoi shumë radiatorit të nxehtë, pos që na përshkoi me avullin e alkoolit si mjegull nga e cila Zejdi (i cili, natyrisht, kurrë nuk ka pirë) përpak që nuk vulli.

Ky eksperiment i fundit e zgjoi nga letargjia e shtan-gur në të cilën kaheërë pat rënë. Me lëvizje zemëruese e tërhoqi kufinë e vet më poshtë në sy, u zgjat përtej skajit përvëlues të qerres dhe filloi ta shikojë rrafshinën e shkretë - duke shikuar me atë përqëndrimin preciz, të kujdesshëm aq karakteristik për njerëzit që shumë jetojnë kryesisht në natyrë dhe të mësuar që të mbështeten në shqisat e veta. Kemi pritur të brengosur, pa shumë shpresa - sepse, ashtu siç na ka thënë më herët, ai kurrë më parë nuk ka qenë në këtë pjesë të vendit. Por ai tregoi me dorë kah veriu dhe tha: "Atje".

Fjala erdhi sikur urdhëresë; shoferi, i lumtur se ka dikush që do ta lirojë nga përgjegjësia, menjëherë u nënshtrua. Udhëtuam drejt veriut, me motorin që rëndë rraptonte. Por papritmas Zejdi pak u ngrit, vuri dorën e vet në supet e shoferit dhe i tha të ndalet. U ul një kohë me kokën e lëshuar përpara, sikur qeni që dihat; rreth

buzëve të tij të shtrënguara pezullonte tendosja e vogël, mezi e hetueshme.

"Jo, - drejto andej!" - briti ai dhe dëftoi drejt verilindjes. "Shpejt!" Shoferi dëgjoi përsëri pa fjalë. Pas disa minutave, "Ndal!" dhe Zejdi lehtë kërceu nga qerrja, e mbloodhi gujën e tij të gjatë me të dy duart dhe ngarendi drejt përpara, u ndal, u kthye disa herë sikur kërkon ose tendosshëm përgjon - gjatë kohë e harrova motorin dhe problemin tonë, aq kam qenë i tërhequr me pamjen e njeriut që i curron të gjitha nervat e veta që të orientohet në natyrë... Papritmas ai vrapoi me hapa të shpejtë dhe u zhduk thellë ndërmjet dy sukave. Pas pak kohe, pas kësaj u shfaq koka e tij dhe ai bënte me dorë:

"Uj!"

Ngarendëm deri tek ai - dhe ishte atje: në zgavrën të mbrojtur prej diellit, të mbuluar me shkëmbinj, shkëlqente llogaçja e vogël me ujë, që ka mbetur nga shirat e fundit të dimrit, i verdhemët në të zi, baltor, por megjithatë ujë, ujë! Njëfarë instinkti i pashpjegueshëm shkretinor ia zbuloi praninë e tij njeriut nga Nexhdi...

Derisa ermenasi dhe unë i kapëm kutitë e zbrazëta të teneqesë dhe i bartnim deri te motori rëndë i keqpërdoruar, Zejdi, heroi i qetë, me buzëqeshje endej rreth qerres.

Në mesditë të ditës së tretë arritëm deri te fshati i parë irakian, Ana në Eufrat - dhe kemi kalëruar me orë ndërmjet palmishteve të tij dhe mureve prej dheut. Atje kishte shumë agajlë, shumica prej tyre, si na tha Zejdi, janë nga fisi i tij. Në hijen e palmave ata shëtitnin ndër kuajt që shkëlqenin, në të cilët shkëlqente drita e gjelbër: mbretërit plot graciozitet dhe njerëzishmëri. Disave prej tyre Zejdi në kalim ua tundte kokën kurse flokët e tij të gjata të zeza përplaseshin në të dy anët e fytyrës së tij. Përkundër jetës së vet të rëndë në shkretëtirë dhe ngroh-

tësisë përcëlluese, ai ishte aq i ndijshëm që gjatë kalimit tonë të shpejtë rrugëve të fshatit e pështolli gujën e vet rreth gojës në mënyrë që të mbrohet nga pluhuri - pluhuri që nuk na pengonte as neve qytetarëve të llastuar. Kur përsëri hasëm në zhur dhe më nuk kishte pluhur, ai e hoqi kufinë e vet me lëvizjen e vet me plot pothuaj graciozitet vashëror; papritmas hapi gojën dhe këndoi, me papritshmërinë e bedenit malor që mbinë në rrafsh. Kjo ishte kaside nga Nexhdi, një lloj ode - tundje e melodive të zgjatura në ritmin e pandryshueshëm, duke rrjedhur si erë shkretinore, prej askund, askund.

Në fshatin vijues ai kërkoi nga vozitësi të ndalet, kërceu nga vetura, m'u falënderua për udhëtimin, e qiti pushkën e vet mbi supe dhe humbi në mesin e palmave; në veturë mbeti aroma që nuk ka emër - aroma e figurës së njeriut të rrumbullakuar në vetvete, përkujtim vezullues në virgjërinë kaherë harruese kurse të paharruar të shpirtit.

Atë ditë në Ana nuk kam menduar se kurdoherë sërisht do ta shoh Zejdin; por kjo ndodhi në mënyrën tjetër.

Ditën vijuese arrita në Hit, qytezë në Euftrat, në vendin ku rruga e vjetër e karvaneve prej Damaskut në Bagdad mbinë nga shkretëtira. Si kurorë e majës së kodrës me muret dhe bastionet e veta, qyteti ngjasonte në kështjellën e vjetër, gjysmë të harruar. Kurrfarë jete nuk ishte e dukshme as në të, as rreth tij. Shtëpitë e jashtme sikur janë rritur në mure; në to nuk kishte dritare, vetëm disa vrima të ngushta, si frëngji. Minareja ngrihej nga brendia e qytetit.

U ndala të buj në njëfarë karvan-saraji afër bregut të lumit. Derisa për vozitësin dhe për mua e përgatisnin darkën, shkova në oborr që në pus t'i laj duart dhe fytyrën. Derisa isha i ulur, dikush e mori ibrikun me ujë që e pata lënë në tokë dhe me kujdes qiti ujë mbi duart e mia. Shikova lart dhe pashë para vetes njeriun ashtmadh, zeshkan me kapelë gëzofi në kokë; pa kërkesë më ndih-

moi tek larja. Qartë, nuk ishte arab. Kur e pyeta kush është, ai u përgjigj në gjuhën e dobët arabe: "Unë jam tatar, nga Azerbajxhani." Kishte sy të ngrohtë kurse bluza e tij, dikur ushtarake, ishte pothuaj e leckosur.

Fillova me të bisedën, pak në arabishte e pak duke belbëzuar në persishte nga e cila nga diçka kam kapur nga një student iranian në Kajro. U dëftua se tatarit e ka emrin Ibrahim. Pjesën më të madhe të jetës së vet - tash kishte afër dyzet vjet - e ka kaluar në rrugët iraniane; me vite ka përcjellë qerret transportuese nga Tabrizi në Teheran, nga Meshhedi në Bixhand, nga Teherani në Isfahan dhe Shiraz, kurse një kohë i ka pasur edhe kuajt e vet; ka shërbyer si kalorës në gjandarmërinë iraniane, si truproje personale e kryeparit turkmen dhe si ruajtës i kuajve në karvan-sarajet në Isfahan; tash, duke ardhur në Irak si grahës i mushkës në karvanin e haxhinjve iranianë drej Qerbelasë, e kishte humbur punën pas llafosjes me udhëheqësin e karvanit dhe kishte mbetur i pandihmë në tokën e huaj.

Më vonë, atë natë jam shtrirë në bangën e drurit të flej në oborrin e dekoruar me palma të karvan-sarajit. Ngrohtësia e padurueshme dhe retë e mushkajave, të rënda e të trasha nga thithja e gjakut të njeriut. Disa drita kanë hedhur dritën e vet të pikëllueshme, të turbullt në errësi. Disa kuaj, që mbase ishin të pronarit, qenë të lidhur pranë një muri. Ibrahim, tatar, e krehte njërin prej tyre; sipas mënyrës në të cilën ai këtë e ka bërë, mund të shihej se ai jo vetëm që i njej kuajt por edhe i don; gishtat e tij e kanë përkëdhelur jetën e shprishur sikur që dashnori do ta përkëdhelte të dashurën e vet.

Papritmas më erdhi ideja. Isha në rrugë për Iran dhe muajt e gjatë të udhëtimit në kalë kanë qenë para meje. Përse mos ta marrë këtë njeri me vete? Dukej i mirë dhe i qetë, kurse mua pa dyshim më duhet dikush sikur ai, që

e njej gati çdo rrugë në Iran dhe në çdo karvan-saraj është sikur në shtëpi. Kur në mëngjesin vijues i propozova që ta marrë për shërbëtor timin, gati sa sqau prej falënderimit dhe më tha në persishte:

"Hazret, për këtë kurrë nuk do të pendoheni..."

Ishte mesdita e ditës së pestë të udhëtimit me veturë nga Halepi kur për herë të parë e pashë oazën e gjerë të Bagdadit. Ndërmjet kurorave të palmave të shumta shkëlqente kubeja e praruar e xhamisë dhe minaresë së lartë. Në të dy anët e rrugës shtriheshin varrezat e gjera, të stërvjetra me gurët e thyer mbivarror, të përhimtë, të mjerë e të lënë pasdore. Pluhuri i mirë, i përhimtë palëvizshëm shtrihet mbi ta, kurse në dritën përcëlluese të mesditës kjo e përhimtë e pluhurosur ishte si perde e vogël me argjend e qëndisur - kufiri i paqartë ndërmjet botës së vdekur të kaluarës dhe tanishmërisë së gjallë. Kështu duhet të jetë gjithnjë, mendova në vete, kur i afroheni qytetit e kaluara e të cilit aq shumë ndryshon nga e tanishmja e tij që mendimi nuk mund ta vërejë dallimin...

Atëherë u fundosëm midis palmave - kilometra e kilometra të drunjve të mëdhenj dhe fierit të shtrirë - derisa papritmas zabeli i palmave u zhduk në brigjet e Tigrisit. Ky lumë nuk ishte sikur Eufрати: baltik në të gjelbër, i rëndë dhe gurgullues - sikur i huaji ekzotik pas rrjedhës së qetë mbretërore të atij lumit tjetër. Kur kaluam përtej urës pontone, na përshkoi nxhtësia përvëluese e Gjirit Persik.

Asgjë në Bagdad nuk ka mbetur nga madhështia dhe shkëlqimi i tij i dikurshëm. Invadimi mongol në Mesjetë e ka rrënuar qytetin aq rrënjësisht sa nuk ka mbetur asgjë që do të na përkujtonte në kryeqendrën e lashtë të Harun 'urr-Rreshidit. Ajo që ka mbetur ka qenë qytet i pikëllueshëm i godinave pa plan të ndërtuara prej qerpiqëve - organizimi i përkohshëm, gati do të thuhej, në pritje të ndryshimit të pritur. Vërtet, ndryshimi i tillë

tashmë ishte në rrjedhë në formë të realitetit të ri politik. Qyteti ka filluar të përzihet, shfaqeshin ndërtesat e reja; nga qendra e përgjumur provinciale turke ngadalë rritej metropola arabe.

Nxehtësia e madhe vuri shenjën e vet në çdo dukuri dhe të gjitha lëvizjet i bëri të ngathta. Njerëzit ngadalë ecnin rrugëve. Dukej se gjaku u është i rëndë, pa kthjelltësi dhe graciozitet. Fytyrat u dukeshin të errëta dhe armiqtësore nën kufitë bardh e zi kutia-kutia, mbulesat për kokë; kurdo që do të shihni fytyrën e bukur arabe me shprehjen e krenarisë, dinjitetit vetëkënaqës, gati pa përjashtim ishte mbi të kufia e kuqe ose kuq e bardhë - që do të thotë se ai njeri nuk është prej aty, por nga veriu, nga shkretëtira siriane ose nga Arabia Qendrore.

Megjithatë fuqia e madhe ka qenë evidente te këta njerëz, edhe fuqia e urrejtjes - urrejtjes në sundimin e huaj që pengon lirinë e tyre. Populli i Bagdadit gjithnjë ka qenë i magjepsur me mallëngjimin për liri si me xhindin. Ndoshta pikërisht ky ka qenë ai xhind që aq terrueshëm i ka hijesuar fytyrat e tyre. Ndoshta këto fytyra do ti kishin pasur krejtësisht pamje tjetër sikur t'i takonin të afërmit e tyre në sokaqet e ngushta dhe oborret me mure të rrethuara në qytet. Sepse, nëse do t'i shikonit pak më afër, ata nuk janë pa kurrfarë sharmi. Qesheshin herëherë siç bëjnë edhe arabët tjerë. Ata nganjëherë, sikur edhe arabët tjerë, i tërhiqnin skajet e gunave të veta me neglizhencën aristokrate nëpër pluhur pas vetes, sikur po shëtisnin rrugëve në gunat prej brokati në mënyrë pitoreske të ngjyrosura; gra të shkëlqyeshme, të pështjellura në të zezë - në të kuqe, të kaltër argjendi dhe të mbyllur të kuqe - grupe figurash në brokatë që kalojnë me hapa të pazëshëm...

Disa javë pas ardhjes sime në Bagdad, derisa kam bredhur nëpër Bazarin e madh, jehoi klithma nga një ka-

lim i terrshëm, i zbuluar. Pas këndit vrapoi një njeri; pas-taj tjetri, e i treti. Njerëzit në bazar filluan të ngarendin sikur janë përshkuar me frikën së cilës ia dinin shkakun, por unë nuk e kam ditur. Çukurmimi i patkonjve të kuaj-ve; kalorësi me fytyrë të frikësuar gallopoi deri në turmë që u ça para tij. Edhe shumë njerëz ngarendnin, të gjithë duke ardhur nga drejtimi i njëjtë dhe duke tërhequr me vete blerësit në bazar. Duke u shtyrë e ndeshur, turma e tërë filloi të shtyhet përpara. Tregtarët në nxitim ethesh vënin kapakët e drunjtë në dyqanet e veta. Askush nuk fliste asgjë. Askush nuk e ka ftuar askënd. Vetëm aty-këtu mund të dëgjoreshin britmat e njerëzve që kanë rënë; një fëmijë qante prekshëm...

Ç'ka ndodhur? Kurrfarë përgjigje. Gjithkund vetëm fytyra të zbehta. Qerrja e rëndë transportuese, ende në gjysmë e ngarkuar, pa ngarendës, galopon nëpër rrugën e ngushtë. Diku në largësi u rrënuar grumbulli i enëve prej dheut dhe qartë kam mund të dëgjoj rrotullimin e tyre nëpër tokë. Pos këtyre zhurmave të veçuara dhe ecjes së pasigurt dhe dihatjes së njerëzve, ka zotëruar qetësi e thellë, e nderë, çfarë nganjëherë krijohet në fillim të tërmetit. Vetëm përplasia e këmbëve që ngarendin; nganjëherë klithmë e femrës ose fëmijës del nga masa që shtyhet dhe rrjedh. Prap disa kalorës. Panikë, ikje e qetësi. Rrëmuja e marrë në udhëkryqet e rrugëve të zëna.

I kapur në turmë në njërin prej këtyre udhëkryqeve, nuk mundesha as para as prapa, e në realitet as nuk e dija ku të shkoj. Në atë çast ndjeva se dikush më kapi për dore; ishte ky Zejdi që më tërhiqte kah vetja pas vargut të fuqive ndërmjet dy dyqaneve.

"Mos lëviz", - pëshpëriti ai.

Diç fërfëlloi pranë meje - fishek pushke? E pamundur...

Nga larg, diku larg nga bazari, arritën britmat e ngjirura të shumë zërave. Përsëri fërfëllloi diç dhe qëllloi, por këtë herë nuk kishte dyshim: ky ishte fishek... Në largësi zë i paqartë, kërcitës, sikur dikush po derdh fasule të thatë në dysheme të fortë. Shkallërisht afrohej dhe forcohej kjo kërsitje e rregullt, e përsëritur; atëherë e njoha: mitralozi...

Edhe njëherë, si shumë herë më parë, Bagdadi është ngritur në kryengritje. Ditën paraprake, më 29 maj të vitit 1924, parlamenti irakian ka ratifikuar, plotësisht kundër vullnetit të popullit, kontratën për miqësi me Britaninë e Madhe; kombi tash në dhembje përpiqej që të mbrohej kundër miqësisë së fuqisë së madhe Evropiane...

Siç mësova më vonë, trupat britaneze i patën bllokuar të gjitha hyrjet në bazar në mënyrë që t'i thyejnë demonstratat dhe shumë njerëz janë mbytur atë ditë me shtirjen e paskrupull në bazar. Sikur mos të ishte Zejdi, sigurisht do të vrapoja pikërisht në zjarrin e mitralozit.

Ky ishte fillimi i vërtetë i miqësisë sonë. Burrëria e theksuar, e heshtur e Zejdit fort më ka pëlqyer; atij përsëri qartë i pëlqen evropiani i ri që kishte aq pak paragjykime ndaj arabëve dhe mënyrës së tyre të jetesës. Ma rrëfen tregimin e thjeshtë për jetën e vet; se si, sikur edhe babai i tij para tij, është rritur në shërbim të sunduesit nga Haili, dinastisë shamarite Ibn Rashidit; Pasi, kur më 1921 Ibn Saudi e pushtoi Hailin dhe kur emiri i fundit i shtëpisë së Ibn Rashidit u bë rob i Ibn Saudit, shumë meshkuj të fisit Shamar, edhe Zejdi në mesin e tyre, i lëshuan shtëpitë e tyre, duke pranuar më me dëshirë ardhmërinë e pasigurt se sa nënshtrimin ndaj sunduesit të ri. Tash ishte këtu, duke bartur yllin shtatërrëmësh irakian dhe igallin dhe duke u mallëngjyer me tokën e rinisë së vet.

Për disa javë të qëndrimit tim në Irak jemi njoftuar mirë dhe kemi mbetur në kontakt gjatë viteve që vinin. I

shkruaja nganjëherë, kurse një herë ose dy herë në vit ia dërgoja ndonjë dhuratë të vogël të blerë në ndonjë bazar iranian ose afganistanez; çdoherë ai përgjigjej me dorë-shkrimin e vet të ngathtë, pothuaj të palexueshëm, duke i kujtuar ditët që i kemi kaluar së bashku duke kalëruar përgjatë brigjeve të Eufratit ose duke i vizituar luajtë me krahë në gërmadhat e Babilonit. Më në fund, kur më 1927 erdha në Arabi, e luta që të më bashkohet, gjë që edhe e bëri vitin vijues. Prej atëherë ka qenë përcjellës i imi, më shumë shok se shërbëtor.

Në fillim të viteve njëzetë automobilat ende ishin relativisht të rrallë në Iran dhe vetëm disa vetura shërbenin për huazim ndërmjet qendrave kryesore. Nëse keni dëshiruar të dilni nga ato tri-katër rrugët kryesore, jeni detyruar të mbështeteni në qerret mbrejtëse; madje as ato nuk kanë mundur të shkojnë kudo, sepse ka pasur shumë pjesë të Iranit ku fare nuk ka pasur rrugë. Për mua, i zjarrtë t'i takoj njerëzit nga ai vend në kushtet e tyre burimore jetësore, udhëtimi me kalë ka qenë i vetmi i mundur. Kështu, gjatë javës sime të fundit në Bagdad, me ndihmën e Ibrahimit, e kam vizituar çdo mëngjes tregun për kuaj jashtë qytetit. Pas pazarllëkut shumëditor, e kam blerë një kalë për vete dhe një mushkë për Ibrahimin. Kali im kalërues ka qenë hajgër i shkëlqyeshëm ngjyrë gështenje i racës jugirane, derisa mushka - kafsha e gjallë, kokëfortë, me muskujt si litar çeliku nën lëkurën e përhimtë kadifi - qartë rridhte nga Turqia; ka mundur, si në shaka, pas kalorësit të vet, të bartë edhe thasët e mëdhenj në të cilët i kam pasur të gjitha gjësendet e mia personale.

Duke kalëruar kalin tim dhe duke e kapur mushkën për frerë, Ibrahimin u nis një ditë drejt Kanikinit, qytetit të fundit irakian në kufirin iranian dhe stacionit skajor të

degës së hekurudhës së Bagdadit; unë jam nisur dy ditë më vonë me tren, në mënyrë që atje të takohem me të.

E lamë Kanikinin dhe botën arabe pas vetes. Para nesh qëndronin brigjet e verdha, sikur roje drejt maleve të larta; malet e rrafshlartës iraniane, bota e re që pret. Stacioni kufitar ka qenë ndërtesa e vetmuar e vogël dhe në të flamuri, i gjelbër - i bardhë - i kuq me simbolin e luanit me shpatën dhe diellin duke lindur. Disa nëpunës të doganës në uniforma të pangjyrë dhe me papuçe të bardha në këmbë, me flokë të zeza dhe lëkurë të bardhë, e kontrolluan valixhen time të varfër me nënçmim miqësor. Njëri prej tyre m'u drejtua:

"Çdo gjë është në rregull, xhanabi-ali. Dhëshuria juaj është mbi shkretëtirat tona. A do të na nderoni me njerëzishmëri dhe ta pini një gotë çaj me ne?"

Derisa ende i çuditësia mirësjelljes së çuditshme, të demoduar të këtyre frazave, më ra në mend se si gjuha persiane, përkundër shumësisë së fjalëve arabe, është tjetërfare prej arabishtes. Kishte në të harmoni melodike, të kultivuar, kurse njëfarë intonacioni i hapur i zanoreve të saj jehonte çuditërisht "në mënyrë perëndimore" pas gjuhës së theksuar të bashkëtingëlloreve të arabëve.

Ne nuk jemi udhëtarët e vetëm; disa qerre të rënda të mbuluara me pëlhurë tende, në të cilat qenë të lidhur nga katër kuaj, qëndronin para doganës, kurse karvani i mushkave që kampuar në afërsi. Njerëzit kanë zier ushqimin në zjarret e hapura të kampit. Dukej se e kanë lëshuar çdo mendim të shkojnë para sepse tek ishte pasdite e hershme prandaj edhe ne, nuk e di përse, vendosëm ta punojmë të njëjtën. E kaluam natën duke fjetur jashtë, duke fjetur në tokë në mbulesat tona.

Në agimin e hershëm të gjitha qerret dhe karvanet filluan të lëvizin drejt kodrave të zhveshura; ne kemi kalëruar me ta. Pasi rruga gjithnjë ngjitej, së shpejti i arri-

tëm qerret e ngadalshme dhe udhëtuam vetëm, gjithnjë thellë e më thellë në tokën kodrinore të Kurdëve, tokën e barinjve të lartë, blondë.

Të parin prej tyre e kam parë kur, në një kthesë të rrugës, doli nga kasollja e punuar prej thuprave dhe duke na ofruar, pa fjalë, sahanin e drunjtë përplot dhallë. Ishte ky djalosh i viteve të shtatëmbëdhjeta, i z bathur, i leckosur, i palarë, me mbeturinat e kësulës së plisit në kokën e shpupuritur. Derisa pija qumështin e rrallë, lehtë të kriposur dhe shkëlqyeshëm të freskët, kam parë përtej skajit të sahanit sytë e kaltër që shikonin në mua. Kishte në to diç mjegullësi të brishtë, të lagshtë - të ëmbël që pezullon mbi kafshët sapo të lindura - kotjes zanafillore, ende të pandërprerë...

Pasdite arritëm deri te një fshat kurd të formuar prej tendave që shtriheshin qetësisht të ngjeshura ndërmjet shpatijeve bregore. Tendat ngjasonin në ato të gjysmënomadëve beduinat në Siri ose Irak; pëlhura e vrazhdë e zezë prej qimeve të dhisë e shtrirë mbi disa shtylla, me muret prej hasures. Në afërsi rridhte përroi i vogël, brigjet e të cilit ishin të hijesuar me pyll të plepave të bardhë; në shkëmb, nga ana tjetër e ujit, familja e lejlekëve rrahnin me sqepa dhe rrapëllonin me krahë. Një mashkull me bluzë indigo të kaltër ka hapëruar me hapa të gjatë të lehtë drejt tendave; nga lëvizjet e tij, për tokë të lidhura, por megjithatë mjaft të lira, fliste gjaku i vjetër nomad. Një femër, në fustanin e gjatë purpur të kuqe, me vorbë të gjatë prej dheut në supe, ngadalë i është afruar përroit; kërdhokullat e saj qartë vizatoheshin nën pëlhurën e fustanit të saj; kanë qenë të gjata e të ngrehura sikur telat e violinës. Ajo u gjunjëzua përbri bregut dhe u zgjat të kapë ujë në vorbë, flokët e saj, të formuara në formë turbani, u shpërndanë dhe, sikur fiskaja e kuqe e gjakut, prekën sipërfaqen e shkëlqyeshme të ujit - por vetëm për

një çast që të ngrihen dhe sërish të pështillen rreth kresë me një lëvizje të vetme të harmonishme që i ka takuar gjunjëzimit të saj dhe ka qenë pjesë e lëvizjes së njëjtë.

Diç më vonë jam ulur në breg në shoqëri të një plaku dhe katër grave të reja. Që të katërtat kanë qenë plot sharm të natyralitetit të përkryer që ka buruar nga jeta në liri: bukuria që ka qenë e vetëdijshme për veten por megjithatë e dëlirë; krenaria që nuk fshihej e megjithatë mezi ka mundur të dallojë nga turpi dhe modestia. Më e bukura prej tyre kishte emrin cicërrues Tu-Tu (me zanoret të shqiptuara sikur në gjuhën frëngjishte). Tërë balli i saj ishte i mbuluar, deri te vetullat e njoma, me shallin ngjyrë kuqe të ndritshme; qerpikët kanë qenë të ngjyrosura me surmë, kurse nën shall zgjateshin kaçurelat e kuqërremta gështenje me zinxhirët e vegjël të argjendtë të gërshetuar në të; te çdo lëvizje e kokës ata kanë cingërruar për qafën e butë, ovale.

Të gjithë kënaqeshim në kuvendim edhe pse persishtja ime ende ishte e pamjaftueshme. (Kurdët posedojnë gjuhën e tyre, por shumica e tyre e kupton edhe persishten.) Ato ishin mendjemprehta, këto gra të vogla që kurrë nuk e kanë lëshuar midisin e fisit të vet dhe, natyrisht, nuk kanë ditur as të shkruajnë as të lexojnë; ato me lehtësi kuptonin shprehjet e mia të cinguara dhe shpesh e gjenin fjalën që e kërkoja dhe ma vënin, me plot siguri, në gojë. I kam pyetur për atë çka punojnë, kurse ato më përgjigjeshin duke numëruar shumësi gjërash të imta e megjithatë aq të mëdha që përmbushin ditën e gruas nomade, bluarja e drithit ndërmjet pllakave shpatuke gurore, pjekja e bukës në hirin përvëlues, mjeljen e deleve, tundjen e qumështit në rrëshekat prej lëkure derisa nuk nxirret tëlyeni, tjerrija e leshit të deles në boshtat e dorës, endjen e qilimave me lara të vjetra gati sa edhe raca e tyre, bartja e fëmijëve, afrimi i prekjes dhe dashurisë burrave të tyre...

Jetë e pandryshueshme: dje, sot dhe nesër. Për këta barinj koha nuk ekziston, pos ndërrimit të ditës, natës dhe stinëve vjetore. Nata është bërë e errët për gjumë; dita është e ndritshme për nevojat jetësore; dimri zbulohet me rritjen e ftohtësisë dhe me rrallimin e kullotave në male: atëherë ata shkojnë me kopetë dhe tendat e veta poshtë në rrafshet e ngrohta, në Mesopotami, deri në Tigris; më vonë, kur të kalojë vera me erërat e veta të ufma e përcëlluese, prapa në male, qoftë këtu, qoftë në ndonjë vend tjetër në vendet tradicionale të fisit.

"A kurrë nuk dëshironi të jetoni në shtëpitë prej guri?" - e pyeta plakun, që mezi e foli edhe një fjalë dhe duke u buzëqeshur e dëgjoi bisedën tonë. - "A thua ju kurrë nuk dëshironi t'i keni fushat tuaja vetjake?"

Plaku ngadalë e tundi kokën: "Jo... Nëse uji qëndron i palëvizshëm në moçal, bëhet i amulltë, baltor e i ndytë; vetëm kur lëviz dhe rrjedh, ai mbetet i kthjellët..."

Gjatë kohës Kurdistani ka humbur në të kaluarën. Gati tetëmbëdhjetë muaj jam endur për së gjati e për së gjeri në vendin më të çuditshëm prej të gjithëve, në Iran. E kam njohur popullin që në vete ka kombinuar urtësinë e kulturës së vjetër 30 shekuj dhe paparapashmërinë çap-këne të fëmijëve; populli që mund me ironinë përtace të shikojë në vetvete dhe në çdo gjë që ndodh rreth tij - kurse një çast më vonë mund të dridhet prej epsheve të egra, vullkanore. Jam kënaqur në ngathtësinë kulturore të qyteteve dhe në erërat gazmore shkretinore; kam fjetur në pallatet e guvernatorëve provinciale, me shumësi shërbëtorësh në disponim, kurse edhe në karvan-sarajet gjysmë të rrënuara në të cilët natën duhej kujdesur që të mbyten akrepët para se ata t'ju mashtrojnë juve. Gostitesha në hell me dele të pjekur si musafir i fisit Bahtiar dhe Kashgar dhe me pulë deti të mbushur me kajsi në tryezën e tregtarëve të pasur; kam shikuar shfrenimin dhe

entuziazmin e të kremtes së Muharremit dhe kam dëgjuar vargjet e Hafidhit që në përcjellje i kanë kënduar trashëgimtarët e lavdisë së vjetër të Iranit. Jam endur në plepat e Isfahanit dhe u admirohesha mbeturinave shekullore, fasadave të shkëlqyeshme farfurite dhe kubeve të praruara të xhamive të tij të mëdha. Gjuha persish-te m'u bë pothuaj po ashtu e afërt sikur edhe arabishtja. Kam diskutuar me njerëzit e arsimuar në qytete, me ushtarë dhe nomadë, tregtarë në bazar, me ministra dhe prijës fetarë, dervishë endacakë dhe kalimthi me thithës të urtë të opiumit në pijetore. Kam qëndruar nëpër qytete dhe fshatra, kam udhëtuar nëpër shkretëtira dhe në moçalet e njelmta vdekjeprurëse dhe plotësisht kam humbur në rrezet jashtëkohore të atij vendi të çuditshëm të harxhuar. E kam njoftuar popullin iranian, jetën e tij dhe mendimet e tij gati sikur të isha lindur në mesin e tyre; por ky vend dhe kjo jetë, kompleks dhe magjepës si ndonjë margaritar i vjetër që zbehtë ndriçon në fasetat e shumta, kurrë nuk është bërë aq i afërt për zemrën time sikur bota si kristali e pastër e arabëve.

Gjatë më shumë se gjashtë muajve kam kalëruar nëpër male dhe stepe të egra të Afganistanit; gjashtë muaj në botën ku arma që e barti çdo mashkull nuk i destinohet dekorit dhe ku duhet pasur kujdes në çdo fjalë dhe në çdo hap nëse nuk dëshironi që fisheku të fërshëllojë nëpër ajër. Nganjëherë Ibrahim, unë dhe bashkudhëtarët tanë të rastit është dashur t'i mbrojmë jetët tona nga cubat, që atëherë në Afganistan ishin përplot; por, nëse qëllonte të jetë e premtë, banditët nuk kërcënonin, sepse konsideronin të turpshme të plaçkisnin dhe mbysin në ditën e caktuar për lavdi të Krijuesit. Me një rast, në Kandahar, përpak nuk më mbytën për shkak se jo qëllimisht e kam shikuar fytyrën e zbuluar të fshatares së bukur që punonte në fushë, derisa në mesin e

fshatarëve mongolë, në grykat e larta të Hindukushit - pasardhësve të luftëtarit, Xhingis Kanit - nuk konsiderohej e pakëndshme të fleshë në dysHEME të kolibes njëdhomëshe drejtpërdrejt pranë gruas së re të shtëpiakut dhe motrave të tij. Me javë kam qenë musafir i Amanullah Hanit, mbretit të Afganistanit, në kryeqytetin e tij Kabul; gjatë netëve të gjata kam diskutuar me dijetarët e tij diturinë e Kur'anit; gjatë kohës së netëve të gjata kam diskutuar me patankanët në tendat e tyre të zeza se si më së miri t'u shmangem territoreve të përfshira me konfliktet ndërfisnore.

Çdo ditë të atyre dy vjetëve të kaluara në Iran dhe Afganistan tek unë rritej siguria se po i afrohem një përgjigjeje përfundimtare.

"Kështu ndodhi; Mensur, që të kuptuarit e mënyrës së jetës së muslimanëve më shpiente çdo ditë më afër të kuptuarit më të mirë të Islamit. Islamini gjithnjë e kam pasur para së gjithash në mendje..."

"Është koha e jacisë", - tha Zejdi duke shikuar në qiellin e natës.

U rreshtuam për namazin e fundit ditor, që të tretë të kthyer drejt Mekës; Zejdi dhe Mensuri qëndrojnë njëri pranë tjetrit, kurse unë përpara, duke e udhëhequr namazin e përbashkët (sepse Pejgamberi a.s. e ka përsëkruar çdo tubim prej dy apo më shumë njerëzve si xhemaat). I ngrita duart dhe fillova: Allahu ekber - "Zoti është më i madhi" - e pastaj recitova, sikur që muslimanët këtë gjithherë e bëjnë, suren hyrëse nga Kur'ani:

"Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Ty, Allahun, Krijuesin e botëve, e lavdërojmë,

Të Gjithëmëshirshmin, Mëshirëplotin,

Sunduesin e Ditës së Gjykimit.

Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë!

Na përudhë në rrugë të drejtë,  
në rrugën e atyre që mëshirën T'ënde ua ke dhuruar,  
e jo në rrugën e atyre që kundër vetes kanë nxitur hi-  
dhërimin,

as të atyre që kanë humbur!"

Vazhdova me suren e 112-të:

"Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirë-  
plotit!

Thuaj: "Ai Allahu është një!

Allahu është strehim për të gjithë!

Nuk ka lindur as është i lindur,

Dhe askush s'është i barabartë me Të!"

Pak gjëra ekzistojnë që e afrojnë njeriun pranë njëri -  
tjetrit sikur namazi i përbashkët. Kjo është, besoj, e vërte-  
të për çdo religjion, por sidomos për Islamën që zë fill në  
besimin se kurrfarë ndërmjetësi nuk ka nevojë, as që rea-  
lisht është i mundur, ndërmjet njeriut dhe Zotit. Mungesa  
e çdo priftërie, kleri, e madje edhe e "kishës" së organizuar  
bën që çdo musliman të ndiej se si realisht merr pjesë, e jo  
vetëm që prezenton, në aktin e përbashkët të namazit kur  
lutet në grup. Pasi në Islam nuk ka kurrfarë sakramentesh,  
çdo musliman i rritur e i shëndoshë mund ta kryejë çdo  
funktion fetar, qoftë kjo edhe është kryerja e lutjes së për-  
bashkët, kryerja e ceremonisë martesore ose shërbimit të  
varrimit. Askush nuk duhet të jetë "i rreshtuar" për shër-  
bimin e Zotit, edhe mësuesit religjiozë edhe liderët e bash-  
kësisë muslimane thjeshtë janë njerëz që gëzojnë autorite-  
tin (herë-herë të merituar, e herë- herë, jo) për shkak të  
njohjes së teologjisë dhe të drejtës fetare.

- 3 -

Zgjothem në agim, por kapakët e syve të mi janë të  
rëndë prej gjumit. Nëpër fytyrën time era rrëshqet me

zërin e butë murmurues nga nata që humbi në ditën që tek lindet.

Ngrihem që ta laj gjumin nga fytyra ime. Uji i ftohtë është sikur prekja e viseve të largëta - maleve të mbuluara me gjelbërim të mbyllur dhe përroit që lëvizin dhe rrjedhin dhe gjithnjë mbesin të kthjellët... Ulem dhe e hedh kokën prapa në mënyrë që fytyra të më mbetet gjatë kohë e lagët; era e përkëdhel lagështinë e tij, e godet me përkujtimin e njomë në ditët e freskëta, ditët kaherë të harruara të dimrit... në malet dhe ujërat që rrjedhin... në kalërimin nëpër borë dhe bardhësinë shkëlqyese... bardhësinë e asaj dite para shumë vjetësh kur kam kalëruar mbi horizontet me barë të mbuluara të maleve iraniane duke ecur ngadalë përpara, çdo hap i kalit - futje në borë, kurse duke ndjekur nxjerrjen e mundimshme nga bora...

Në mesditë të asaj dite, më kujtohet, jemi ndalur në fshatin e banuar me popull të çuditshëm që ngjason në Romë. Dhjetë apo dymbëdhjetë vrima në tokë, të mbuluara me qemere të ulta prej shkurreve dhe dheut, i kanë dhënë vendbanimit të izoluar pamjen e qytetit urith. Ka qenë kjo në Iranin Juglindor, në krahinën Kirman. Si qeniet nëntokësore nga përrallëzat, njerëzit zvarriteshin nga vrimat e errëta që të çuditen me të huajt e rrallë. Në maje të një qemeri prej dheu ishte ulur një grua e re dhe kreh-te flokët e saj të gjata, të zeza, të shpupuritura; fytyra e saj ngjyrë ulliri në të zezë me sy të mbyllur ishte e kthyer kah dielli i zbehtë i mesditës, kurse ajo këndonte me zë të qetë në një gjuhë të çuditshme. Bylyzyket e saj të ngushtë e të fortë prej metali, si te kafshët e egra të pyellit të lashtë, cingërronin rreth nyjeve.

Që t'i nxejë gjymtyrët e mia të shtanguara, pija mjaft çaj dhe arak me gjandarin që më përcillte mua dhe Ibrahimin. Kur sërish i hipa kalit dhe u nisa në galop, tërë bota papritmas u hap gjerë dhe tejdashëm para syve të

mi si kurrë më parë; i pashë format e saj të brendshme dhe ndieja të rrahurit e pulsit të saj në vetminë e bardhë dhe pashë çdo gjë që e kisha të fshehur vetëm disa çaste më herët; e dija se të gjitha pyetjet na presin neve; derisa ne, të marrët e mjerë, pyesim dhe presim në fshehtësitë e Zotit që të na hapen, ato tërë kohën presin që ne të hapemi ndaj tyre...

Rrafshlarta hapej para nesh dhe unë e nxita kalin dhe fluturova sikur fantazmë nëpër dritën e kristaltë, kurse bara, e tollovitur me thundrat e kalit tim, ngrihej pas meje sikur gujë prej xixëllonjave; thundrat e kalit tim gjëmonin mbi përronjtë e akullit...

Mendoj se pikërisht atëherë kam përjetuar, edhe duke mos e kuptuar këtë ende tërësisht, hapjen e mëshirës - atë mëshirë për të cilën ka herë më ka folur at-Feliksi kur nisesha për rrugë të cilë duhej ta ndërrojë tërë jetën time, shpalljen e mëshirës që u thotë se pikërisht ju jeni ai i prituri... Më shumë se një vit është dashur të kalojë ndërmjet atij kalërimit të marrë mbi akull e borë dhe kalimit tim në Islam; por madje edhe atëherë kam kalëruar duke mos e ditur këtë, drejt si shtizë drejt Mekës.

Tash fytyrën e kam të terur, kurse kjo ditë dimërore iraniane para më shumë se shtatë vjet bën pjesë në të kaluarën. Ai bën pjesë mbrapa - por jo që të humbet, sepse kjo e kaluar është pjesë e kësaj të tashmeje.

Flladit i freskët, fryma e mëngjesit që vjen, nxit dridhjen e shkurreve. Yjet fillojnë të zbehën. Zejd, Mensur! Ngrihuni, ngrihuni! Ta ndezim zjarrin e ta pjekim kafënë; atëherë do t'i shalojmë devetë e do të udhëtojmë edhe një ditë, nëpër shkretëtirë që na pretë neve me duar të hapura.

## VIII. Xhinët

- 1 -

Dielli qe pikërisht në perëndim kur gjarpri i madh, i zi papritmas rrëshqiti nëpër rrugën tonë; i trashë ishte sikur dora e fëmijës kurse i gjatë rreth një metër. U ndal dhe e ngriti kokën e vet drejt nesh. Gati me lëvizjen refleksive, lëshohem nga shala, e hoqa pushkën time, u gju-njézova dhe mora shenjë - në çastin e njëjtë e dëgjova zërin e Mensurit pas vetes:

"Mos qit - mos...!" - por, tashmë e kam ngrehur këmbëzën; gjarpri u pështoll, u mblodh - dhe tashmë ishte i cofur.

Fytyra e Mensurit në shenjë proteste erdhi mbi mua. "Nuk u dashtë ta mbytësh... Gjithsesi jo së paku kur Dielli perëndon, sepse kjo është koha kur nga nëntoka dalin xhinët dhe shpesh marrin formën e gjarprit..."

U qesha dhe iu përgjigja: "Mensur, a beson në ato tregimet e grave të vjetra për xhinët në formë gjarpri?"

"Natyrisht se besoj në xhinët. A nuk i përmend libri i Zotit? Sa i përket formës në të cilën nganjëherë na dëftohen - nuk e di... Kam dëgjuar se mund të marrin formën më të çuditshme e më së paku të pritur..."

Ti do të mund të keshë të drejtë, Mensur, mendoj në vete, sepse, vërtet, a do të ishte e tepruar të supozohet që, pos qenieve që shqisat tona mund t'i vërejnë, ka

edhe të tjera që i ikin vrojtimit tonë? A nuk është kjo njëlloj arrogance intelektuale që njeriun modern e shtynë që ta refuzojë mundësinë e formave jetësore tjetërfare nga ato që ai mund t'i vërejë dhe vlerësojë? Ekzistimi i xhinëve, pa marrë parasysh çka mund të jenë ata, nuk mund të argumentohet me mjete shkencore. Por, po ashtu, shkencën nuk mund ta përgënjështrijë mundësinë e ekzistimit të qenieve të gjalla, ligjet biologjike të cilave mund të jenë aq tjetërfare nga të tanët, shqisat tona të jashtme mund të vënë kontakt me ta vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. A nuk është e mundur që kryqëzimi i tillë i rastit i shtigjeve ndërmjet këtyre botëve të panjohura dhe botës sonë ka shpënë deri te dukuritë e çuditshme që imagjinata primitive i ka shpjeguar me shpirtra, demonë dhe me dukuri të ngjashme të tjera "mbinatyrore"?

Derisa përsëri ngjitem në deve, duke i përzier këto pyetje më gjysmëqeshje të mosbesimit të njeriut të cilin edukimi e ka bërë lëkurëtrashë shumë më tepër se që janë njerëzit të cilët gjithnjë kanë jetuar më afër natyrës, Zejdi me shprehjen serioze të fytyrës kthehet drejt meje:

"Mensuri ka të drejtë, dajo. Nuk është dashur të mbytet ky gjarpër. Me një rast, para shumë viteve kur e pata lëshuar Hailin Pasi Ibn Saudi e pushtoi qytetin - e pata mbytur në rrugë për Irak një gjarpër si ky. Ka ngjarë kjo po ashtu gjatë perëndimit të Diellit. Së shpejti pas kësaj, kur u ndalëm ta falim akshamin, papritmas ndjeva peshën e plumbtë në këmbë dhe zjarrin në kokë; në kokë filloi të më buçet si ujëvarës, kurse gjymtyrët m'u kallën ashtu që më shumë nuk kam mundur të qëndrojë por rash në tokë si thes i thatë, kurse çdo gjë rreth meje u bë terr. Nuk e di sa gjatë kam ndejtur në atë terr, por më kujtohet se më në fund prap jam ngritur. Një njeri i panjohur ka qëndruar nga ana ime e djathtë, kurse tjetri nga e majta, kurse ata më futën në një korridor të madh,

të errët plotë njerëz të cilët mallëngjyeshëm shëtisnin aty-këtu dhe bisedonin. Së shpejti u bëra i vetëdijshëm se këta janë dy parti të ndryshme si para gjyqit të drejtësisë. Një plak i imtë qëndronte i ulur në podiumin e ngritur në prapavijë; u duk se ai është gjyqtar ose kryepar ose diç e ngjashme. Papritmas kuptova se unë jam i akuzuari.

Dikush tha: "E ka mbytur pikërisht para perëndimit të Diellit me qitje nga pushka jote. Është fajtor". Njëri nga ana e kundërt u përgjigj: "Por ai nuk e ka ditur kënd po e mbyti; Pas kësaj e ka përmendur emrin e Zotit kur e ka tërhequr këmbëzën", Ata nga ana e akuzës britën: "Nuk e ka përmendur!" në çka ana tjetër përsëriti, të gjithë në kor: "Po, vërtet e ka lavduar emrin e Zotit!" Kështu kjo vazhdoi një kohë, akuza dhe mbrojtja, derisa më në fund nuk dukej se mbrojtja ngadhënjeu dhe gjyqtari në prapavijë vendosi: "Ai nuk e ka ditur kënd e mbytë, kurse e përmendi emrin e Zotit. Çojeni mbrapa!"

"Dy prej atyre që më patën sjellë në sallën e gjyqit më morën përsëri për dore, më morën prapa rrugës së njëjtë në terrin e madh nga i cili pata ardhë dhe më shtruan për toke. I hapa sytë - dhe e gjeta veten të shtrirë ndërmjet disa thasëve të drithit që ishin të paluar nga të dy anët e mia; mbi ta që e shtrirë një copë pëlhurë ten-deje që të më mbrojë nga rrezet e diellit. Duket se ka qenë paradite e hershme, kurse bashkudhëtarët e mi qartë qenë kampuar. Në largësi kam mund t'i shohë devet tona se si kullosin në shpatije të bregoreve. Kam dëshiruar ta ngrejë dorën, por gjymtyrët i kam pasur mjaft të lodhura. Kur njëri prej bashkudhëtarëve të mi u kërrus mbi mua, unë thashë: "Kafe..." - sepse në afërsi kam dëgjuar zërin e havanit për kafe. Miku im kërcëu: "Ai po flet, ai po flet! Erdhi në vetë!", - dhe ata më sollën kafe të freskët, të valë. I pyeta a kam qenë në pavetëdije tërë natën. Ata u përgjigjën: "Tërë natën? Plot katër ditë nuk

ke lëvizur! Gjithnjë të kemi ngarkuar si thes në deve, kurse natën përsëri të hiqnim; kemi menduar se do të detyrohemi këtu të të varrosim. Lavdia qoftë mbi Atë që jep dhe merr jetën, të Gjallit, që kurrë nuk vdes..."

"Ja, po sheh, dajo, nuk duhet mbytur gjarprin në perëndim të diellit".

Ndonëse gjysma e vetëdijes sime ka vazhduar të qeshet në tregimin e Zejdit, gjysma tjetër sikur ndiente thurjen e fuqive të padukshme që binte në muzg, njëfarë lëvizje misterioze e zërave aq të bukur që veshi mezi mund t'i hetojë, kurse në ajër sikur po pezullon fryma e armiqësisë; kam ndjenjë të paqartë të pendimit që e kam mbytur gjarprin në perëndim të diellit...

## - 2 -

Pasdite të ditës së tretë të shkuarjes sonë nga Haili u ndalëm që t'u japim ujë deveve në pusët e Arxhes, në fushëgropën pothuaj rrethore të mbyllur ndërmjet sukave të ulëta. Dy puse, të mëdhenj e plot ujë të ëmbël, shtrihen midis fushëgropës dhe të dytë janë pronësi e përbashkët e fiseve - perëndimori i përket Harbit, kurse lindori Mutajrit. Toka rreth tyre është e zhveshur si shuplaka, sepse nga dreka i sjellin qindra deve dhe dele nga kullotat e largëta që aty të pinë ujë, e ato çdo barishte edhe më të voglën që mbinë nga toka e kullosin madje para se edhe të marrë frymë.

Kur arritëm, fushëgropa tashmë ishte përplot shtazë, kurse të gjitha kopetë e tufat e reja shfaqeshin ndërmjet sukave të shkëlqyera nga dielli. Rreth puseve është rrëmujë dhe përzierje e madhe, sepse nuk është lehtë të shuhet etja e aq kafshëve. Barinjtë nxjerrin ujin në kovat prej lëkure me litarë të gjatë dhe punën e vet e përcjellin me këngë në mënyrë që të harmonizohen lëvizjet e shu-

mëfishta; sepse kovat janë shumë të mëdha, kurse kur janë të mbushura me ujë, janë aq të rënda saqë duhen shumë duar që t'i nxjerrin nga thellësia. Nga pusi që e kemi më afër - ai që i takon fisit Mutajr - depërton kënga kushtuar deveve:

Pini dhe mos e kurseni ujin,

Pusi është plot mëshirë dhe nuk ka fund!

Gjysma e njerëzve e këndon vargun e parë, kurse gjysma tjetër të dytin, duke e përsëritur disa herë në ritëm të shpejtë derisa kova nuk shfaqet në skaj të pusit; atëherë e marrin gratë dhe e derdhin ujin në koritat e lëkurës. Numër i madh i deveve shtyhet përpara, duke pallur e turfulluar, duke fërgëlluar nga mallëngjimi, duke u shtyrë rreth koritave, e që dukshëm nuk i qetësojnë britmat e njerëzve: Hu-ojh,... huu-ojh! Herë njëra, herë tjetra zgjatë qafën e vet të gjatë, të gjallë përpara, ndërmjet apo mbi të tjerat, në mënyrë që sa më parë ta shuajë etjen e vet; kjo është lëkundje dhe shtyrje, fërfëllitje dhe shtypje trupave të zi të çelë dhe të zi të mshelë, të verdhë në të bardhë dhe të zezë gështenjë dhe sikur mjalti të verdhë, kurse kundërmimi i rreptë, therës i djersës dhe urinës së kafshës ndihet në ajër. Në ndërkohë kova përsëri është mbushur dhe barinj të e nxjerrin me përcjelljen e shpejtë të kupletit të dytë:

Asgjë nuk mund ta fikë etjen e devesë

Pos mëshirës së Zotit dhe angazhimit të bariut!

- kurse pamja e derdhjes së ujit, pirjes, ftuarjes dhe këndimit fillon përsëri.

Një plak që është i ulur në skaj të pusit ngrit duart drejt nesh dhe na thirrë:

"Zoti ju ruajt, udhëtarë! Pranojeni bujarinë tonë!", - në çka disa njerëz tjerë ndahen nga turma rreth pusit dhe ngarendin drejt nesh. Njëri prej tyre i mbanë frerët e devesë sime dhe e shtriri në gjunj në mënyrë që lehtë të

mund të zbres. Shpejtë u hap rruga për kafshët tona kah korita, kurse gratë derdhin ujë për to; ne jemi udhëtarë prandaj edhe kemi përparësi.

"A nuk është mirë të shihet", - përsiat Zejdi - "se si Harbi dhe Mutajri tash e mbajnë paqen, kurse para pak kohësh kanë luftuar njëri kundër tjetrit?" (Sepse tek kanë kaluar tre vjet prej kur fisi Mutajr ka qenë në kryengritje kundër Mbretit, derisa Harbi ka qenë ndër ndihmësit më besnikë të tij.) "A të kujtohet, dajo, kur për herë të fundit kemi qenë këtu? Se si e kemi vizituar Arxhën në harkun e gjerë të natës, duke mos guxuar t'u afrohemi puseve - duke mos ditur a janë atje miqtë apo armiqtë...?"

Zejdi përkujton në kryengritjen e madhe beduinase 1928 - 1929. - kulmin e dramës politike që i ka tundur edhe vetë themelet e mbretërisë së Ibn Saudit kurse, për një kohë, më ka ngërthyer edhe mua në këtë.

Në fillim të 1927, paqja sundonte në mbretërinë e gjerë të Arabisë Saudite. Lufta e Ibn Saudit për pushtet pat kaluar. Pushtetin e tij në Nexhd më nuk e ka kontestuar asnjë dinasti rivale. Të tizat kanë qenë krahinat Hail dhe Shamar, kurse i tij, po ashtu, ka qenë edhe Hixhazi Pasi në vitin 1925 e përndoqi dinastinë e Sherifit. Ndër luftëtarët e Mbretit u dallua ai prijësi i njëjtë i tmerrshëm beduinas, Fejsal ad-Davishi, që më herët i pat shkaktuar aq shumë kokëçarje. Ed-Davishi veçan është dalluar në shërbimin e Mbretit dhe gjithnjë rishtazi ka dëshmuar lojalitetin e vet: më 1921 e pushtoi Hailin për Mbretin; më 1924 ka udhëhequr sulmin e guximshëm në Irak prej nga familja e Sherifit, nën mbrojtjen e britanikëve, ka intriguar kundër Ibn Saudit; më 1925 ai e pushtoi Medinën dhe luajti rolin vendimtar në pushtimin e Xhides. Tash, në verë të 1927 pushonte në dafinat në ihvan - vendstrehimin e vet të Artavisë, jo larg prej kufirit të Irakut.

Gjatë shumë viteve ky kufi ka qenë skenë pothuaj e sulmeve të vazhdueshme beduinase për shkak të shpërnguljeve fisnore duke kërkuar kullota dhe ujë; në një varg marrëveshesh ndërmjet Ibën Saudit dhe britanikëve - të cilët ishin përgjegjës për Irakun si fuqi mandatore - janë pajtuar që kurrfarë pengesash nuk duhet vënë shpërnguljeve të tilla të domosdoshme, kurse kurrfarë fortifikatash nuk guxojnë të ngrihen në asnjërën anë të kufirit ndërmjet Nexhdit dhe Irakut. Mirëpo, në verë të 1927 qeveria irakiane ndërtoi dhe zптоi fortifikatën në afërsi të puseve kufitare të Bisasë dhe zyrtarisht paralajmëroi qëllimin të ndërtojë edhe fortifikata tjera përgjatë kufirit. Vala e shqetësimit kaloi nëpër fiset e Nexhdit verior. Ata kanë ndier se është rrezikuar edhe vetë ekzistimi i tyre dhe se këtu do të pengohen nga pusët nga të cilët varen plotësisht. Ibn Saudi protestoi kundër kësaj thyerjeje të hapur të marrëveshjes, por pranoi - pas disa muajve - vetëm përgjigje negative nga komisar i lartë britanik në Irak.

Fejsal ed-Davishi, njeriu gjithnjë i gatshëm për aksion, i tha vetvetes: "Mbase nuk është e favorshme për Mbretin ta fillojë konfliktin me britanikët - por unë për këtë marr guxim". Ditëve të fundit të tetorit të 1927, ai u nis në krye të ihvanëve të vetë, sulmoi dhe e rrënoi fortifikatën Bisaja, duke mos e kursyer as garnizonin e saj irakian. Aeroplanët britanezë u shfaqën në skenë, e vëzhguan gjendjen dhe u tërhoqën - jashtë traditës së vet - duke mos e hedhur asnjë bombë të vetme. E kanë pasur lehtë ta zbrapsin sulmin (aksionin për të cilin kanë qenë të autorizuar sipas marrëveshjeve me Ibn Saudin), e pastaj ta zgjidhin çështjen e fortifikatave me bisedime diplomatike. Por a thua qeveria britaniko-irakiane vërtet ka qenë e interesuar për zgjidhjen e shpejtë, të qetë të kontekstit?

Delegacionet e fiseve nga Nexhdi verior u paraqitën tek Ibn Saudi dhe kërkojnë fushatë kundër Irakut. Ibn

Saudi energjikisht i refuzoi të gjitha këto kërkesa, e shpalli Ed-Davishin kundërvajtës dhe i urdhëroi emirit të Hailit që me vigjilencë t'i mbikëqyrë territoret kufitare. Ndhimën financiare që Mbreti ua jepte shumicës së ihvanëve përkohësisht ua ndërpreu fiseve nën kontrollin e Ed-Davishit; atij i është urdhëruar të mbetet në Artavi dhe atje ta presë vendimin e Mbretit. Qeveria irakiane zyrtarisht është njoftuar për të gjitha këto masa dhe është paralajmëruar se Ed-Davishi do të dënohet rigorozisht. Mirëpo, në të njëjtën kohë, Ibn Saudi ka kërkuar që Iraku në të ardhmen më shumë t'i respektojë marrëveshjet kufitare.

Në pajtim me këtë, ky konflikt i ri ka mund lehtë të rafinohet. Por kur gjërat erdhën deri te kjo pikë, komandantët britanikë e njoftoi Ibn Saudin se e dërgon skuadriljen ajrore t'i ndëshkojë ihvanët e Ed-Davishit - (të cilët tashmë kaqerë qenë kthyer në vendlindjet e tyre) dhe t'i detyrojë në nënshtrim mbretit të tyre. Meqë në atë kohë në Rijad nuk kishte telegraf, Ibn Saudi urgjentisht e dërgoi korrierin në Bahrejn, prej nga u dërgua telegrami në Bagdad me protestë kundër masave të propozuara dhe me përkujtimin në përgjigjet që i ndalojnë cilësdos palë që t'i ndjekë kundërvajtësit përtej kufirit. Ai ka cekur se nuk i nevojitet "ndihma" britanike në imponimin e autoritetit të tij Ed-Davishit; më në fund, ai ka tërhequr vërejtjen se aksionet e tilla britanike në territor të Nexhdit mund të kenë pasojat të rrezikshme tek ihvanët të cilët tashmë mjaft janë shqetësuar.

Paralajmërimi mbeti i pajehonë. Në fund të janarit 1928. - tre muaj pas konfliktit në Bisajë - skuadrilja britanike fluturoi përtej kufirit, i bombardoi territoret e Nexhdit, duke shkaktuar shkretime në kampet e beduinëve Mutajri dhe paskrupull duke mbytur meshkujt, gratë, fëmijët dhe bagëtinë. Të gjithë ihvanët veriore filluan

të përgatiten për fushatë hakmarrjeje kundër Irakut; duke iu falënderuar vetëm autoritetit të madh të Ibn Saudit te të gjitha fiset, lëvizja me kohë u ndal dhe u kufizua në disa përlëshje më të vogla kufitare.

Në ndërkohë, britanikët qetësisht përsëri e ndërjuan fortifikatën e shkatërruar të Bisajit dhe edhe dy fortifikata të reja u ngritën në anën irakiane të kufirit.

Fejsal ed-Davishi, i ftuar në Rijad, refuzoi të vijë dhe e arsyetoj aksionin që, sipas mendimit të tij, që ndërmarre në interesin personal të Mbretit. Mllefë është shtuar në zemërimin e tij. Ai, Fejsal Ed-Davishi, që i ka shërbyer Mbretit aq me besnikëri dhe aq mirë, ka qenë vetëm emir i Artavisë - që, edhe përveç numrit të madh të banorëve të vet, ka qenë vetëm fshat i rritur. Udhëheqja e tij ka qenë vendimtare në pushtimin e Hailit - por kushëriri i Mbretit, Ibn Musaadi, e jo ai, ka qenë i emëruar për emir në Hail. Gjatë kohës së fushatës në Hixhaz, pikërisht ai, Ed-Davishi, e ka rrethuar Medinen me muaj dhe përfundimisht e ka detyruar të dorëzohet - por ai nuk është caktuar për emir të saj. I ka thënë vetes: "Ibn Saudi i përkret fisit Anaza, kurse unë fisit Mutajr. Ne jemi të barabartë me njëri - tjetrin në fisnikërinë e prejardhjes sonë. Përse unë do të duhej pranuar epërsinë e Ibn Saudit?"

Mënyra e tillë e të menduarit gjithnjë ka qenë fatkeqësi në historinë arabe: askush nuk dëshiron të pranojë se tjetri është më i mirë se ai.

Një nga një, krerët tjerë të pakënaqur të ihvanëve filluan të harrojnë sa shumë i kanë borxh Ibn Saudit. Ndërta ishte Sulltan ibn Baxhadi, sheik i fisit të fuqishëm Atajba dhe emir i Gatgatit, njëri nga vendbanimet më të mëdha të ihvanëve në Nexhd, fitues në betejën në Tarabë më 1918 kundër forcave të Sherif Huseinit, pushtues i Taifes dhe Mekës më 1924. Përse ai do të mund të jetë i kënaqur të jetë vetëm emir i Gatgatës? Përse ai, por një prej bijëve

të Mbretit, ka qenë i emëruar emir i Mekës? Përse, përfundimisht, ai nuk është emëruar emir i Taifit? Ai, sikur Fejsal Ed-Davishi, ka menduar se është mashtruar në atë që ka menduar për të drejtë të tij; e pasi ishte dhëndër i Ed-Davishit, dukej krejtësisht e logjikshme që bashkërisht të luftojnë për çështjen e njëjtë kundër Ibn Saudit.

Në vjeshtë të 1928, Ibn Saudi e thirri tubimin e kre-rëve dhe të ulemasë në Rijad me qëllim që t'i zgjidhë të gjitha këto konteste. Në të vërtetë, gati të gjithë prijësit fisnorë erdhën pos Ibni Baxhadit dhe Ed-Davishit. Këmbëngulës në opozitën e tyre, ata të dytë e proklamuan Ibn Saudin për heretik - a nuk i ka lidhur marrëveshjet me pabesimtarët dhe ka kyçur në tokat arabe instrumentet e tilla djallëzore siç janë veturat motorike, telefonat, radioaparartet dhe avionët? Ulemaja e tubuar në Rijad unanimisht deklaroi që risitë e tilla teknike jo vetëm që janë të lejuara por madje janë mjaft të preferuara nga aspekti fetar, pasi ato e rrisin dijen dhe fuqinë e muslimanëve, e sipas Pejgamberit të Islamit, kontratat me fuqitë jomuslimane janë po ashtu të preferueshme nëse u sjellin paqen dhe lirinë muslimanëve.

Por dy prijësit kryengritës vazhduan protestat e veta dhe hasën në përgjigje të gatshme të shumë ihvanëve të paarsimuar, të cilët nuk kishin mjaft dituri të shohin asgjë tjetër pos ndikimit të djallit në aksionet e Ibn Saudit. Dështimi i tij më i hershëm t'u japë arsimin ihvanëve dhe që zjarrin e tyre fetar ta orientojë drejt, filloi të sjellë frytet e veta tragjike...

Në stepet e Nexhdit tash zukatet sikur në koshere. Kasnecët misteriozë udhëtonin në deve të shpejta prej fisit në fis. Takimet e fshehta të krerëve mbaheshin përrreth puseve të larguara. Më në fund, intrigat kundër Mbretit shpërthyen në revoltë të hapur, duke tërhequr shumë fise tjera pos Mutajrit dhe Atajbes. Mbreti që i

durueshëm. Tentoi të tregojë mirëkuptim. I dërgoi kasnecët te prijësit kryeneqë fisnorë dhe u përpoq t'i pajtojë, por e kotë. Arabia Qendrore dhe Veriore u bënë fushëbetejë e luftës së shtrirë guerile nga larg dhe gjerë; pothuaj siguria proverbiale publike e vendit është zhdukur dhe dominonte kaosi i plotë në Nexhd; grupet e ihvanëve të rebeluar bënëin kërdi në të gjitha drejtimet duke i sulmuar fshatrat, karvanet dhe fiset që i kanë mbetur besnikë Mbretit.

Pas përleshjeve të shumta lokale ndërmjet fiseve rebeluese dhe lojale mbretit, beteja vendimtare u zhvillua në fushëgropën e Sibilit, në Nexhdin qendror, në pranverë të vitit 1929.

Në një anë ishte Mbreti me forca të mëdha; në anën tjetër Mutajri dhe Atajbe, të ndihmuar me aleancën e fiseve tjera. Mbreti që ngadhënjyes. Ibni Baxhadi u dorëzua pakusht dhe u dërgua me zinxhir në Rijad. Ed-Davishi që rëndë i lënduar dhe që lajmëruar se po vdes. Ibn Saudi, mbreti më i butë prej të gjithë mbretërve arabë, ia dërgoi mjekun e vet personal që ta shërojë - kurse ky mjek, siriani i ri, konstatoi lëndimin serioz në mëlçi, duke vlerësuar se Ed-Davishi mund të jetojë më së shumti edhe një javë ditë. Mbreti në këtë vendosi: "Do ta lëshojmë të vdesë në qetësi; e pranoi dënimin prej Zotit". Ai urdhëroi që armiku i lënduar të dërgohet prap te familja e tij në Artavi.

Por Ed-Davishi ishte larg nga vdekja. Lëndimi i tij nuk që as përafërsisht aq i rrezikshëm siç kishte supozuar mjeku i ri; pas disa javëve tashmë u shërua mjaft që të ikë nga Artavia, më shumë se kurdoherë i gatshëm në hakmarrje.

Ikja e Ed-Davishit nga Artavia i dha impuls të ri kryengritjes. Flitej se ai personalisht vetë gjendet diku në afërsi të kufirit kuvajtian duke tubuar aleatë të ri fisnorë krahas atyre vetjak, edhe më tej forcave të rëndësishme

të Mutajrit. Ndër të parët që i janë bashkangjitur ka qenë fisi i vogël por i guximshëm Axhman që jeton në krahinën El-Hasa afër Gjirit Persik; sheiku i tyre, Ibn Hadlajni, ka qenë dajë sipas nënës së Fajsal Ed-Davishit. Pos kësaj nuk kishte dashuri ndërmjet Ibn Saudit dhe axhmanëve. Para shumë vjetësh ata e kishin mbytur vëllain më të ri të mbretit Saadin dhe, duke iu frikësuar hakmarrjes së tij, emigruan në Kuvajt. Ibn Saudi këtë më vonë ua fali dhe u lejoi që të kthehen në viset e veta stërgjyshore, por urrejtja e vjetër edhe më tej digjej. Ajo shpërtheu në armiqësi të hapur kur, gjatë bisedimeve rreth pajtimit, kryepari i axhmanëve me disa përcjellës të vet që mbytur tradhtisht në kampin e kushëririt të Ibn Saudit, djalit më të vjetër të emirit El-Hasa.

Aleanca e axhmanëve me Mutajrët nxiti flakë të re ndër fiset e Atajbës në Nexhdin qendror. Pas robërimit të emirit të tyre, Ibn Baxhadit, ata sërish u tubuan nën prijësin e ri; tash përsëri u ngritën kundër Mbretit duke e detyruar që t'i orientojë forcat e veta nga Nexhdi verior në atë qendror. Lufta që e rreptë, por shkallërisht Ibn Saudi ngadhënjeu. Atajbe i ngadhënjeu grup pas grupi derisa, më në fund, nuk e ofruan dorëzimin. Në fshat në gjysmë të rrugës ndërmjet Rijadit dhe Mekës sheikët e tyre iu betuan Mbretit për lojalitet dhe Mbreti përsëri ua fali, duke shpresuar se më në fund do t'i ketë duart e lira kundër Ed-Davishit dhe rebelëve tjerë në veri. Por mezi që u kthye në Rijad, Atajbe për herë të dytë e shkeli betimin dhe i përtërinë luftërat. Tash kjo ishte luftë deri në fund. Për së treti herë Atajbe qenë të ngadhënjyer dhe gati të dhjetuar, kurse me rrënimin e plotë të vendbanimit të ihvanëve Gatgata, qytetit më të madh se Rijadi, sundimi i Mbretit përsëri u vendos në Nexhdin qendror.

Në ndërkohë, lufta në veri është vazhduar. Fejsal Ed-Davishi dhe aleatët e tij tash kanë qenë mirë të forti-

fikuar në afërsi të kufirit .Ibn Musaadi, emiri i Hailit, vazhdimisht i sulmonte në emër të Mbretit. Dy herë ësh-të lajmëruar se Ed-Davishi është mbytur; të dy herët u tregua se lajmet ishin të rrejshme. Ai vazhdoi të jetojë, kokëfortësisht dhe pakompromis. I biri i tij më i vjetër dhe shtatëqind luftëtarë të tij ranë në luftime; por ai luf-tonte edhe më tej. Shtrohej pyetja prej Ed-Davishi pra-noi paratë të cilat madje edhe Arabisë i nevojiteshin për të zhvilluar luftën. Prej nga armët dhe municioni atij?

Gjithnjë e më të shpeshta kanë qenë raportet që rebe-luesi, dikur kritiku aq i pezmatuar i raporteve kontraktuese të Ibn Saudit me "jobesimtarët", tash edhe vetë bën ma-rrëveshje me britanikët. Flitej se shpesh e viziton Kuvaj-tin; a do të mund të punojë ky kështu, pyeteshin njerëzit, pa dijen e pushtetit anglez? A nuk ka qenë, përkundrazi, e mundur që trazirat në vendet e Ibn Saudit tepër mirë t'i kenë shërbyer cakut të tyre vetjak?

Një mbremje në Rijad, në verë të vitit 1929, u nisa më herët në gjumë dhe, para se të fle, argëtohesha me një libër të vjetër për dinastitë omanase, kur Zejdi befas hyri në dhomën time:

"Këtu është një njeri prej Sheikut. Dëshiron të të shohë menjëherë".

Me nxitim u mbatha dhe u nisa në pallat. Ibn Saudi më priste në banesën e vet private, duke ndenjtur ulur me këmbë të kryqëzuara në divan me një turmë gazetash arabe rreth vetes, kurse në dorë me një prej atyre të Kaj-ros. Ai u përgjigj shkurt në përshendetjen time dhe, duke mos e ndërprerë leximin, ma tregoi vendin pranë vetes në divan. Pas një kohe e ngriti shikimin, shikoi në shër-bëtorin që ishte pranë dyerve dhe me lëvizjen e dorës i tregoi se dëshiron që të na lërë vetëm. Sapo shërbëtori i mbylli dyert pas vetes, Mbreti i lëshoi gazetat dhe më shikoi për një çast pas syzeve të shkëlqyeshme sikur nuk

më kishte parë gjatë kohë (edhe pse i kam kaluar disa orë me të pikërisht atë mëngjes).

"I zënë me shkrime?"

"Jo, Jetëgjatë, me javë nuk kam shkruar asgjë."

"Ata kanë qenë artikuj interesantë që i ke shkruar për problemet tona kufitare me Irakun".

Qartë ka menduar për një varg shkresash që i kam shkruar për gazetat Evropiane dy muaj më herët; disa prej tyre janë publikuar edhe në gazetatat e Kajros ku, ta lavdoj veten, kanë ndihmuar që të sqarohet situata mjaft e ngatërruar. Duke e njohur Mbretin, kam qenë i sigurt se nuk flet me hamendje por ka diç të caktuar në mendje; për këtë arsye kam heshtur duke pritur të vazhdojë. Ai vazhdoi:

"Mbase do të dëshiroje të shkruash diç më shumë për atë çka po ndodh në Nexhd - për këtë kryengritje dhe për atë çka ajo paralajmëron". Në zërin e tij kishte mallëngjim kur shtoi: "Familja e Sherifit më urren. Ata bijtë e Huseinit që tash sundojnë në Irak dhe Transjordani gjithërë do të më urrejnë, sepse ata nuk mund të harrojnë që ua kam marrë Hixhazin. Ata do të dëshirojnë që mbretëria ime të thyhet sepse atëherë do të mund të ktheheshin në Hixhaz... kurse miqve të tyre të cilët shtiren se janë edhe miqtë e mi, ndoshta kjo edhe do t'u pëlqente... Ata nuk i kanë ndërtuar ato fortifikata së koti; ata dëshirojnë të më bëjnë pengesa dhe që të më largojnë nga kufijt e mi..."

Pas fjalëve të Ibn Saudit kam mund të dëgjoj zëra të ngatërruar, skandalozë - rrukullisjen dhe ngarendjen e trenave hekurudhorë të cilët, edhe pse ende vetëm të menduar, do të mundeshin nesër të bëhen njëmendësi; pamja e hekurudhës britanike prej Haifes deri në Basra. Thashethemat për planin e tillë përhapeshin me vite. Ka qenë mirë e ditur se britanikëve shumë u patë mbetur

deri te "rruga në të thatë deri në Indi" kurse kjo, në realitet, edhe ka qenë domethënia e mandateve të tyre në Palestinë, Transjordani dhe Irak. Hekurudha prej Mesdheut deri te Gjiri Persik do të formonte jo vetëm lidhjen e re, të vlefshme në komunikimet imperiale britanike, por po ashtu do t'i ofronte mbrojtje më të madhe naftësjellësit që do të duhej të vendosej prej Irakut nëpër shkretëtirën siriane deri në Haife. Nga ana tjetër, lidhja direkte hekurudhore ndërmjet Haifes dhe Basrës, do t'i shkëpuste krahinat më veriore të Ibn Saudit - kurse Mbreti kurrë nuk do t'i përkrahte propozimet e tilla. A nuk ka qenë e mundur që ndërtimi i fortifikatës përgjatë kufirit Irak - Nexhd, në kundërshti të qartë me të gjitha marrëveshjet ekzistuese, të paraqesë shkallën e parë në planin me kujdes të planifikuar që të krijojë mjaft trazira në atë territor kritik që të "arsyetohet" krijimi i shtetit të vogël, gjysmë të pavarur tampon të nënshtruar britanikëve? Fajsal Ed-Davishi do të mund të shërbente për këtë qëllim po ashtu mirë, ose madje edhe më mirë, se sa ndonjë anëtar i familjes së Sherifit, sepse ai edhe vetë ka qenë prej Nexhdit dhe ka pasur ithtarë të fortë ndër ihvanët. Se fanatizmi i tij fetar devocionues ishte vetëm maskë ka qenë e qartë për çdokend kush e ka njohur të kaluarën e tij; ajo që ai vërtet e ka dëshiruar ka qenë vetëm sundimi. Nuk ka pasur dyshim që ai, i lënë vetvetes, nuk do të mund të qëndronte aq gjatë kundër Ibn Saudit. Por, a i është lënë vetvetes?

Pas pauzës së gjatë, Mbreti vazhdoi: "Kam menduar, sikur edhe çdokush tjetër, për furnizimin me armë e municion që Ed-Davishi si duket e ka në dispozicion. Ka mjaft - e ka mjaft edhe para, si jam njoftuar. Pyes a do të dëshiroje ti të shkruash për këto gjëra - mendoj, për ato burimet sekrete të furnizimit të Ed-Davishit. Unë kam dyshimet e mia vetjake për to; mbase madje më shumë se

dyshim - por do të dëshiroja që ti vetë të hulumtosh çkado që mundesh, sepse unë mbase s'kam të drejtë".

Pra, kjo ka qenë kjo. Ndonëse Mbreti ka folur gati me indiferencë, me ton të rëndomtë, ka qenë e qartë se e ka peshuar çdo fjalë para se ta ketë shqiptuar. E shikova fortë. Fytyrën e tij, aq serioze vetëm një çast më parë, e shkëlqeu buzëqeshja e gjerë. E vuri dorën në gjurin tim dhe e tundi:

"Dëshiroj që ti, biro, ta gjesh vetë - po përsëris, vetëm për veten - prej nga Ed-Davishi i merr pushkët e veta, municionin dhe paratë që i shpenzon aq shkapërderdhshëm. Mezi që ka fare pak dyshim në mendimet e mia, por dëshiroj që dikush si ti, kush nuk është direkt i kyçur, t'i thotë botës për të vërtetën e shtrembëruar pas kryengritjes së Ed-Davishit... Mendoj se ti do të jesh në gjendje ta gjeshë të vërtetën".

Ibn Saudi e dinte çka punon. Gjithherë e ka ditur se e dua. Ndonëse shpesh nuk jam pajtuar me politikën e tij, kurse kurrë nuk kam fshehur mospajtimin tim, ai kurrë nuk e ka humbur besimin e vet në mua dhe shpesh më ka pyetur për këshillë. Ai ka besim në mua aq më parë që, besoj, është i vetëdijshëm që nuk pres kurrfarë fitimi personal prej tij dhe madje nuk do të pranoja as vendin në qeverinë e tij, sepse dëshiroj të mbetem i lirë. Dhe kështu, atë mbrëmje të paharrueshme në verë të 1929, ai në qetësi më propozoi se duhet të shkoj e të hulumtoj rrjetin e intrigave politike pas kryengritjes së ihvanëve - mision që sigurisht kyç rrezikun personal dhe gjithsesi mund të kryhet me çmim të përpjekjeve skajore.

Por Sheiku nuk qe dëshpëruar nga reagimet e mia. Pos simpatisë sime ndaj tij dhe vendit të tij, puna që tash më është besuar duket se ka premtuar përjetime mallëngjyese. E të mos flas për senzacionin e mundshëm gazetaresk.

"Urdhri yt, Jetëgjatë, le t'i udhëheqë sytë e mi dhe mendimin tim", - u përgjigja menjëherë. - "Gjithsesi do të bëj atë që mundem".

"Në këtë, Muhammed, nuk ka dyshim; pres që detyra jote të jetë sekrete. Do të mund të kishte rrezik në këtë - ç'është me gruan tënde?"

Gruaja ishte nga Rijadi, vasha me të cilën qeshë martuar vitin paraprak; por në këtë pikëpamje isha në gjendje ta qetësoj Mbretin.

"Ajo nuk do të qajë, o Imam; pikërisht sot kam menduar që me te të shkurorëzohem. Ne duket se nuk i përgjigjemi njëri-tjetrit".

Ibn Saudi me mjeshtri u qesh, sepse ndarja me gruan për të nuk ka qenë gjë e panjohur. "Por ç'është me të tjerët me fafesisin tënd?"

"S'ka askush, mendoj, kush do të më dhembsej po të më ndodhë diç - pos, natyrisht, Zejdit; por ai gjithsesi do të më ndjek dhe ajo që do të më ndodhë mua do t'i ndodhë edhe atij".

"Kjo është krejt mirë", u përgjigj Mbreti. - "Dhe, që, para se të harroj: do të nevojiten pak mjete për ndër-marrjen", - dhe e futi dorën nën jastëk pas vetes, e nxori qesen dhe ma shtyri në dorë; sipas peshës menjëherë ia kam qëlluar se është plot monedha ari. Më kujtohet se si kam menduar në vete: sa i sigurt është dashur të jetë ai, madje edhe para se të më pyeste, se do ta pranoj propozimin e tij...!

Pas kthimit në shtëpi e ftova Zejdin, i cili priste në ardhjen time.

"Nëse do të kërkoja, Zejd, të më përcjellësh në një aksion që do të mund të paraqiste rrezik - a do të shkoje me mua?"

Zejdi u përgjigj: "Po a mendon, dajo, se do të të lërë vetëm, çfarëdo të jetë rreziku? Por ku po shkojmë?"

"Shkojmë të hulumtojmë prej nga Ed-Davishi i merr armët e veta dhe paratë. Por Mbreti dëshiron që askush asgjë mos të dijë për atë çka punojmë derisa nuk kryhet; për këtë arsye duhet të jesh i kujdesshëm!"

Zejdi madje as nuk është përpjekur as të më qetësojë, por në vend të kësaj kaloi në pyetjen më praktike:

"Ne gjithsesi nuk mund ta pyesim Ed-Davishin ose njerëzit e tij. Si do ta fillojmë këtë atëherë?"

Duke u kthyer nga pallati tashmë për këtë problem fillova të përsias. Më dukej se pika më e mirë nismëtare do të ishte njëri prej qyteteve të Nexhdit qendror, ku kishte mjaft tregtarë që kishin lidhje të ngushta me Irakun dhe Kuvajtin. Përfundimisht u ndala në Shakri, kryeqytetin e krahinës Vashm, rreth tri ditë udhëtimi prej Rijadit, ku miku im Abdurrahman es-Sibai do të mund të ishte në gjendje që të më ndihmojë.

Dita vijuese që përplot me përgatitje për ekspeditën tonë. Pasi nuk kam dashur të tërheq tepër vëmendje në lëvizjen time, e kam ftuar Zejdin që gjësende mos të marrë, siç e kishim zakon, nga depoja e Mbretit, por që çdo gjë që na duhet ta blejë në treg. Deri në mbrëmje Zejdi pat tubuar zgjedhjen e nevojshme të ushqimit: nja dhjetë kilogramë oriz, përafërsisht sasinë e njëjtë të miellit për bukë, rrëshekun e vogël të tëlyenit, hurma, kafe dhe kripë. Ka blerë po ashtu dy rrësheka të reja për ujë, kovën prej lëkure dhe litarin prej qimeve të dhisë mjaft të gjatë për pusët mjaft të thella. Tashmë ishim mirë të furnizuar me armë dhe municion. Në thasë i vendosëm nga dy komplete teshash, kurse secili prej nesh mbante abanë e rëndë e cila, së bashku me mbulesat mbi shalat tona, do të na shërbejë si mbulesë në netët e errëta. Devet tona që disa javë i kishin kaluar në kullota, ishin në gjendje të shkëlqyeshme; ajo të cilën para do kohe ia pata dhënë Zejdit ka qenë vrapuese jashtëzakonisht e shpejtë

nga Omani, derisa unë udhëtoja me racën e bukur të vjetër gjakëpastër "veriore" që dikur i ka takuar emirit të fundit rashidian të Hailit, dhuratë e Ibn Saudit.

Kur ra nata, udhëtuam nga Rijadi. Para agimit arritëm deri në Vadi Hanife, te shtrati i thellë, i zhveshur i lumit ndërmjet brigjeve të rrëpishme - vendit të betejës vendimtare që ka ndodhur para më shumë se trembëdhjetë shekuj ndërmjet forcave të Ebu Bekrit, trashëgimtarit të Pejgamberit dhe halifit të parë të Islamit, dhe atyre "të profetit të rrejshëm", Musejlimes, i cili disa vjet u është kundërvënë muslimanëve. Beteja ka qenë fitorja përfundimtare e Islamit në Arabinë Qendrore. Shumë prej shokëve të parë të Pejgamberit ranë në të, kurse varret e tyre janë të dukshëm deri sot në shpatijet gurore të fushëgropës.

Gjatë kohës së paraditës i kaluam gjërmadhat e qytetit Ajajnë, dikur vendbanim i gjerë i banuar, që shtrihej përgjatë dy brigjeve të Vadi Hanifes. Ndërmjet vargjeve të tamariskave shtrihen mbeturinat e të kaluarës; muret e rrënuara të shtëpive, shtyllat e rrëzuara të xhamisë ose gjërmadhat e ndërtesës luksoze ngrihen aty - këtu duke folur për stilin më të lartë, gracioz arkitektonik se që janë ato ndërtesat e thjeshta prej dheut që tash shihen në Nexhd. Rrëfëhet se deri para njëqind e pesëdhjetë ose dyqind vjetësh tërë rrjedha e Vadi Hanifes prej Darijes (kryeqyteti burimor i dinastisë së Ibn Saudit) deri në Ajajne - largësia prej mbi tetëdhjetë kilometra - ka qenë një i vetmi qytet, dhe se lajmin për lindjen e djalit të emirit të Darijes e kanë përcjellë gratë prej kulmit të shtëpisë në kulm për disa minuta deri në skajin më të largët të Ajajnes. Rrëfimi për shkatërimin e Ajajnes aq është i megjulluar me legjenda sa është rëndë të dallohen të vërtetat historike. Është më se e sigurt se qytetin e ka rrënuar sunduesi i parë saudit kur refuzoi të pranojë më-

simin e Muhammed ibn Abdulvehhabit, por legjenda vehabite thotë se, si shenjë e dënimit të Zotit, të gjitha pu-  
set e Ajajnes janë tharë për një të vetmen natë duke i  
detyruar njerëzit që ta lëshojnë qytetin.

Në mesditë të ditës së tretë i pamë muret prej dheu,  
bastionet e Shakres dhe palmat e larta që tejkalojnë shtë-  
pitë e saj. Kemi udhëtuar ndërmjet pemishteve të zbra-  
zëta dhe nëpër rrugë të shkreta; vetëm atëherë u kujtuam  
se është e premtë dhe se të gjithë janë në xhami. Aty-kë-  
tu takonim ndonjë grua të veshur fund e krye në abajë të  
zezë; ajo tërhoqej në paraqitjen e të huajt dhe e qitte ve-  
lin e vet mbi fytyrë me lëvizje të shpejtë turpëruese. Aty-  
këtu luanin fëmijët, në hije të shtëpive; ngrohtësia e rën-  
dë pezullonte mbi kurorat e palmave.

U nisëm së pari drejt shtëpisë së mikut tim të mirë  
Abdurrahman es-Sebait, i cili atëherë ishte i obliguar me  
Bejtul malin, do të thotë arkën e krahinës. Zbritëm para  
portës së hapur, kurse Zejdi briti në oborr: "Ja veled!" -  
(o djalosh!) - dhe derisa shërbëtori duke ngarendur dilte  
nga shtëpia, Zejdi paralajmëroi: "Keni musafirë!"

Derisa Zejdi dhe djaloshi ua hiqnin shalat deveve në  
oborr, unë jam vendosur në kafenenë e Abdurrahmanit,  
ku një tjetër menjëherë e ndezi zjarrin në enët e bakrit  
për kafe në oxhak. Posa e piva gllënkën e parë, u dëgju-  
an zërat nga oborri - pyetjet dhe përgjigjet: zotëriu i  
shtëpisë që kthyer. Tashmë nga shkallët, ende i paduk-  
shëm, i bëzante përshëndetjet e mirëseardhjes, dhe pas-  
taj u paraqit në dyer me duar të hapura; njeri i njomë i  
vogël me mjekër të shkurtër, të ndritshme të zezë dhe  
me sy thellë të ngulitur, të hareshëm në fytyrën e buzë-  
qeshur. Përkundër ngrohtësisë bartte gunën e gjatë gëzo-  
fi nën abajën e vet. Kjo gujë gëzofi ka qenë nga më të  
çmueshmet që ka pasur. Kurrë s'e ka pasur vështirë që  
gjithnjë t'i rrëfejë atij kush nuk e di historinë e tij se di-

kur i ka takuar ish - mbretit të Hixhazit, Sherif Huseinit, dhe se ka rënë në duart e tij, të Abdurrahmanit, gjatë pushtimit të Mekës më 1924. Nuk më kujtohet se e kam parë ndonjëherë pa atë gunë.

Ai më përqafoi ngrohtë dhe, duke u ngritur në gishta, më puthi në të dy faqet: "Ehlen ve sehlen ve merhaba! Mirë se erdhe në këtë shtëpi modeste, vëllai im! Është e bekuar ora që të sollti këtu!"

Tash erdhën pyetjet e rëndomta: prej nga, ku, si është Mbreti, a kishte shi gjatë rrugës - ose a ke dëgjuar së paku për shirat? - të tëra këmbimi tradicional i lajmeve arabe. I thashë se Anajza, në Nexhdin qendror, është caku im - që nuk ishte e vërteta e plotë, por po ashtu edhe ka mundur të jetë.

Më herët Abdurrahmani intensivisht është marrë me tregti ndërmjet Nexhdit dhe Irakut dhe mirë i ka njohur edhe Basrën edhe Kuvajtin. Nuk ka qenë vështirë të fillojë të flasë për këto vende dhe njerëz të cilët mbase para do kohe kanë arritur prej andej, sepse më dukej se, pasi lajmërojnë se Fejsal Ed-Davishi është aq afër kufirit të Kuvajtit, ky vend dhe Basra do të mund të ofronin disa indikacione për burimin e tij të furnizimit. Mora vesh se një anëtar i familjes së njohur El-Basam nga Anajzi - i njohuri im i moçëm - para do kohe ka qenë në Kuvajt në kthim prej Basre dhe, duke mos dëshiruar t'u ekspozohet rreziqeve të udhëtimit nëpër territoret e përfshira me trazira, u kthye në Nexhd nëpër Bahrejn. Tash ka qenë në Shakra dhe nëse dëshiroj, Abdurrahmani do ta dërgojë dikënd tek ai; sipas traditës së vjetër arabe, vizitohet ai kush ka udhëtuar, e ai rëndom nuk i viziton të tjerët. Së shpejti pas kësaj El-Basami na u bashkua në kafenenë e Abdurrahmanit.

Abdullahu, edhe pse i ka takuar ndoshta familjes më të rëndësishme të njerëzve afaristë në tërë Nexhdin, vetë

nuk ka qenë i pasur. Jeta e tij ka qenë përplot ngritje dhe rënie - kryesisht rënie - të përjetuara jo vetëm në Nexhd por po ashtu edhe në Kajro, Bagdad, Basra, Kuvajt, Bahrein dhe Bombaj. E njihnte secilin që çkado ishte me rëndësi në ato vende dhe barte në kokën e tij mendje-prehtë depo të tërë të informatave për çkado që ndodh në vendet arabe. I thashë se një firmë gjermane më ka obliguar t'i shohë mundësitë e importimit të makinave bujqësore në Kuvajt dhe Basra; pasi më është ofruar provizion i mirë, dëshirova të dija se cili nga tregtarët e vendit në këto qytete ka gjasa ta pranojë propozimin e tillë. El-Basami përmendi disa emra, e pastaj shtoi:

"Jam i sigurt se disa kuvajtianë do të jenë të interesuar për planin tënd. Ata gjithnjë importojnë mallra të ndryshme, kurse këto ditë tregtia duket veçan e gjallë - aq e gjallë saqë dërgesat e mëdha të rijalëve të argjendit arrijnë çdo ditë drejtpërdrejt nga vendprerja e parave në Triestë."

Përmendja e rijalëve të argjendit më xigëloi. Ky lloj i veçantë i rijalëve, monedha e Marie Terezës, ka paraqitur, krahas parasë zyrtare arabe, mjetin kryesor të pagesës në tërë Siujdhesën. Është farkuar në Triestë dhe u është shitur sipas vlerës së vet të argjendit, me një pagesë të vogël për shkrirjen, qeverive të ndryshme, e po ashtu edhe disa tregtarëve të dalluar me lidhje të mëdha tregtare me beduinët, sepse beduinët nuk i pranojnë monedhat prej letre dhe marrin vetëm arin dhe argjendin - më me dëshirë monedhat e Marie Terezës. Importimi i madh i këtyre parave nga ana e tregtarëve kuvajtianë duket se ka dëftuar në punët e pasura ndërmjet tyre dhe beduinëve.

"Përse", - e pyeta El-Basamin, - "tregtarët kuvajtianë pikërisht tash i kanë importuar rijalët?"

"Nuk di", - përgjigjet ai me një fije hutimi në zë. - "Ata flasin për blerjen e deveve për therje nga beduinët afër Kuvajtit për shitje në Irak, ku çmimet tash janë të lar-

ta; edhe pse nuk e kanë të qartë krejtësisht ku mendojnë të gjejnë aq deve në stepe rreth Kuvajtit në këto kohë jo të qeta... Mendoj", - shtoi me buzëqeshje, - "se do të ishte më profitabile të blehen devetë për udhëtim në Irak dhe t'i shiten Ed-Davishit dhe njerëzve të tij - por, natyrisht, Ed-Davishi nuk do të kishte para që t'i paguajë..."

A thua, vërtet?

Atë natë, para se të shkoj në gjumë në dhomën që shtëpiaku na e ndau, e tërhoqa Zejdin në kënd dhe i thashë.

"Po shkoj në Kuvajt".

"Kjo nuk do të jetë aq lehtë, dajo", - u përgjigj Zejdi, por shkëlqimi në sytë e tij fliste më shkoqitur se fjalët e tij për gatishmërinë e tij që të lëshohet në diçka që jo vetëm që nuk është e lehtë, por është edhe tepër e rrezikshme. Do të ishte, natyrisht, lojë fëmijësh të udhëtohet nëpër territoret që i kontrollojnë forcat dhe fiset lojale Mbretit, por së paku njëqind e pesëdhjetë kilometra para se të arrihet deri te kufiri i Kuvajtit do t'i lëshohemi plotësisht vetvetes midis territoreve armiqësore nëpër të cilat enden pjesëtarët e fiseve rebeluese Mutajr dhe Axhman. Do të mundeshim, natyrisht, të udhëtojmë në Kuvajt edhe nëpër det kah Bahreini, por për këtë do të duhej leja e pushtetit britanik dhe kjo do t'i nënshtronte të gjitha lëvizjet tona kontrollit më të rreptë. Një-të mund të thuhet edhe për udhëtimin kah El-Xhavfa dhe shkretëtira siriane në Irak, e prej aty në Kuvajt, sepse do të ishte tepër optimiste të supozohet se do të mund t'u iknim pikave të shumta kontrolluese në Irak. Kështu mbeti vetëm rruga më e drejtpërdrejtë tokësore në Kuvajt. Si të depërtohet në qytet pa u zbuluar nuk mundej lehtë të përgjigjej; këtë e kemi lënë për ardhmëri, duke u mbështetur në fatin tonë dhe duke shpresuar në mundësitë e paparashikuara.

Abdurrahman es-Sibai ka dëshiruar të mbetën tek ai disa ditë, por kur e cekta urgjencën e punës, na lëshoi të shkojmë mëngjesin vijues pasi na i shtoi rezervat tona të ushqimit me mish të thatë të devesë - shtojcë e shijshme ushqimit mjaft monoton që na pret. Po ashtu ka insistuar se duhet ta vizitoj në kthim, në çka vërtet kam mund t'i përgjigjem vetëm: "InshaAllah!"- (nëse don Zoti).

Nga Shakra kemi udhëtuar katër ditë drejt verilindjes duke mos takuar asgjë të parëndomtë. Me një rast na ndali aradha e beduinëve, Avazinë lojalë që u përkisnin forcave të emirit Ibn Musaadit, por letra ime e hapur prej Mbretit menjëherë i qetësoi dhe, pas këmbimit të lajmeve të rëndomta të shkretëtirës, vazhduam rrugën tonë.

Para agimit të ditës së pestë iu afruam territorit në të cilin më nuk shtrihej dora e Ibn Saudit. Prej atje udhëtimi ditor më nuk vinte në konsiderim; siguria jonë e vetme ka qenë në terr dhe fshehtësi.

U vendosëm në grykën e përshtatshme jo larg nga rrjedha kryesore e Vadi er-Rumit, shtratit të vjetër, të thatë të lumit që e ndërpret Arabinë Veriore drejt majes së Gjirit Persik. Gryka ka qenë dendur e mbuluar me shkurret e arfaxhës, që na ofronte njëfarë mbrojtje derisa t'i mbahemi drejtpërdrejt përbri gati bregut vertikal. Ua lëshuam këmbët deveve, i ushqyem me përzierjen e miellit të elbit të trashë dhe gëzhjojave të hurmeve - kështu duke iu shmangur nevojës që t'i lëshojmë në kullotë - dhe u vendosëm ta presim natën. Nuk guxuam të ndezim zjarr sepse tymi madje edhe ditën do të mund të na zbulonte; kështu u detyruam të kënaqemi me ushqimin prej hurmave dhe ujit.

Sa ka qenë kujdesi ynë me vend, u bë e qartë më vonë pasdite kur papritmas deri te ne depërtuan zërat e këngës së beduinëve udhëtarë. Ua kapëm turinjtë deveve

tona që mos të turfullojnë e pallin, kurse ne u ngjitëm, me pushkë në duar, murit mbrojtës të grykës.

Të kënduarit bëhej më i zëshëm si afroheshin udhëtarët e panjohur; tashmë mund t'i dallonim fjalët: La ilahe il-lall-llah, la ilahe il-lall-llah - Nuk ka zot tjetër veç Allahut. Nuk ka zot tjetër veç Allahut, - shtesa e rëndomtë e ihvanëve për këngët laike të rrugës së beduinëve "të joreformuar". Nuk kishte kurrfarë dyshimi se këta janë ihvanë, kurse në këtë territor ata mund të jenë vetëm ihvanë armiqësorë. Së shpejti u dukën mbi majen e kodrës, pikërisht mbi brigjet e grykës - grupi prej tetë ose dhjetë kalorësve në deve ngadalë të cilët po lëvizin në një varg rigorozisht të skicuar në qiellin pasditor, secili prej tyre duke bartur turban të bardhë të ihvanëve mbi kufinë me kutia kuq e bardh, dy rrethatorë mbi kraharor dhe pushkën të varur për shalë pas vetes: rreshti i errët e i rrezikshëm i kalorësve që lëkunden para - prapa, para - prapa në ritëm të hapave të devesë dhe fjalëve të mëdha, tash aq të keqpërdorura, La ilahe il-lallah... Pamja ishte impresive dhe në të njëjtën kohë patetike. Këta ishin njerëzit për të cilët feja e tyre kishte domethënie më shumë se çdo gjë tjetër në jetë; kanë menduar se po luftojnë për pastërtinë e saj dhe për lavdinë më të madhe të Zotit, duke mos e ditur se zjarri i tyre dhe mallëngjimi i tyre kanë qenë të drejtuar në ambiciet e liderit të paskrupull në kërkim për fuqi personale...

Ata kanë qenë në anën "e drejtë" të grykës sa na përket neve, sepse po të udhëtonin në anën tjetër, ata do të na shihnin aq qartë sikur që ne ata kemi mundur t'i shohim tash nën shkurren të vënë mbrojtëse. Kur me këngën në gojë, u zhdukën nga horizonti përgjatë bregut, me lehtësi psherëtimë.

"Ata janë sikur xhinët", - pëshpërtiti Zejdi. - "Po, sikur xhinët që nuk dinë as haretë jetësore as frikën nga

vdekja... Ata janë të guximshëm dhe të fortë në fe, këtë askush nuk mund ta mohojë - por e vetmja për çka ata ëndërrojnë janë gjaku, vdekja dhe parajsja..."

Përkundër puritanizmit të errshëm të ihvanëve, ai filloi të këndojë, me gjysmë zëri, këngën krejtësisht laike siriane të dashurisë: "Oj, vasho lëkurë ari në të zezë..."

Posa u errësua krejtësisht, vazhduam rrugën e fshehtë në drejtim të Kuvajtit të largët.

"Shiko, dajo!" - befas briti Zejdi. "Zjarrri!"

Ka qenë ky zjarr tepër i vogël për kampin e beduinëve; ndoshta bari i vetmuar? Por cili bari do të merrte guxim ta ndezë zjarrin këtu pos nëse nuk u takon rebeluesve? Megjithatë, do të ishte më mirë të hulumtohet. Nëse ky është vetëm një njeri, mundemi lehtë për të të kujdesemi, e po ashtu, ndoshta të tubojmë informata të çmueshme për lëvizjen e armikut në atë territor.

Dheu ishte rënor dhe thundrat e deveve tona nuk bënëin gati kurrfarë zhurme derisa me kujdes i jemi afruar zjarrit. Në dritën e tij kemi mundur ta dallojmë figurën e kruspullosur të bedunit të vetmuar. Dukej se nxiton në terr drejt nesh, e pastaj, sikur është i kënaqur me atë çka ka parë, u ngrit pa nxitim, i kryqoi duart në gjoks - ndoshta të tregojë se nuk është i armatosur - dhe qetësisht, edhe pa frikën më të vogël, e priste ardhjen tonë.

"Kush je ti?" - briti rreptë Zejdi duke e drejtuar pushkën e vet në të huajin e leckosur.

Beduini ngadalë u buzëqesh dhe u përgjigj me zërin e thellë, të zëshëm: "Unë, unë Sulubi..."

Shkaku për qetësinë e tij tash u bë i qartë. E çuditshme, fisi (ose më mirë të themi grupi i fiseve) që u ngjasojnë evgjitëve (romëve) të cilëve ai u përkiste, kurrë nuk kanë marrë pjesë në thujse konfliktet e pandërprera beduinase në Arabi; nuk janë armiq të askujt as dikush i sulmon.

Sulubi kanë mbetur deri më sot enigmë për të gjithë hulumtuesit. Askush vërtet nuk e ka ditur prejardhjen e tyre. Se ata nuk janë arabë kjo është e sigurt: sytë e tyre të kaltër dhe flokët e ndritshme të zeza nuk pajtohen me lëkurën e tyre me diell të djegur dhe përkujtojnë në viset veriore. Historianët e vjetër arabë na thanë se ata janë pasardhës të kryqtarëve që i pat robëruar Salahuddini dhe i sollë në Arabi, ku më vonë janë bërë muslimanë; dhe vërtet, emri Sulubi ka po atë rrënjë sikur edhe fjala salib, do të thotë "kryq", kurse salibi do të thotë "kryqtar". A është ky shpjegim i saktë, është vështirë të thuhet. Sidoqoftë, beduinët sulubë nuk konsiderohen arabë dhe sillen me ta me një lloj përbuzjeje tolerante. Ata e shpjegojnë këtë përbuzje, që është në kundërti të rreptë me përndryshe prirjen mjaft të theksuar të arabëve për barazinë njerëzore, me pohimin se këta njerëz nuk janë njëmend muslimanë nga bindja dhe se nuk jetojnë si muslimanë. Ata cekin se sulubët nuk martohen por jetojnë në "përbashkësi sikur qentë", duke mos pasur kujdes madje as në afërsinë e afërt të gjakut, dhe se i hanë coftirat që muslimanët i konsiderojnë të papastra. Kjo, ndërkaq, do të mund të jetë edhe racionalizmi i më pastajshëm. Unë më tepër anoj nga mendimi se vetëdija për parëndomësinë racore i ka shtyrë beduinët skajërisht në aspektin racor të vetëdijshëm që ta tërheqin rrethin magjik të përbuzjes rreth tyre - mbrojtja instiktive kundër përzierjes së gjakut, që është dashur të jetë mjaft joshëse në rastin e sulubëve; sepse ata janë, gati pa përjashtim, popull i bukur, më të lartë se shumica e arabëve dhe me tipare (vija fytyre) mjaft të drejta; femrat janë veçan mjaft të dashura, plot graciozitet tërheqës të trupit dhe lëvizjeve.

Por çfarëdo qoftë të jetë shkaku, përbuzja beduinase e sulubëve ua ka bërë jetën të sigurt; çdokush që i sulmon ose u shkakton dëm atyre, bashkëfistarët e tij shi-

kojnë sikur e ka humbur nderin e vet. Pos kësaj, të gjithë banorët e shkretirës lart i çmojnë sulubët si veterinarë, shalaxhi, kazanxhi dhe farkëtarë.

Puna e dorës, edhe pse beduini e urrenë tepër që të merret me të, megjithatë i nevojitet. Ata janë edhe barinj të suksesshëm, dhe, mbi të gjitha, mjeshtër të pakontestueshëm të shkathtësisë së gjuetisë. Shkathtësia e tyre t'i përcjellin gjurmët është gati legjendare dhe të vetmit që në këtë aspekt mund të krahasohen me ta janë beduinët El-Mura, në skajet veriore të viseve të zbrazëta.

I qetësuar me njohjen se miku ynë i ri është sulubi, i thashë haptazi se ne jemi njerëz të Ibn Saudit - që ishte plotësisht e sigurt në raport me respektin që këta njerëz e kanë ndaj pushtetit - dhe kërkova ta fikë zjarrin. Pasi kjo është bërë, u ulëm në troll dhe e filluam bisedën e gjatë.

Nuk ka mundur të na thotë shumë për organizimin e trupave të Ed-Davishit, "sepse", - tha ai, - "ata janë gjithnjë në lëvizje, si xhinët, kurrë nuk qetësohen gjatë në një vend". U tregua, ndërkaq, se kurrfarë grupesh më të mëdha të ihvanëve armiq nuk ka në afërsinë tonë të drejtpërdrejtë pikërisht tash, edhe pse grupet e vogla vazhdimisht lëvizin nëpër shkretëtirë në të gjitha drejtimet.

Papritmas më ra në mend mendimi: a do të mund ta shfrytëzojmë instinktin prej gjuetari dhe kërkuesi të këtij sulubi që të na shpie në Kuvajt?

"A ke qenë ndonjëherë në Kuvajt?" - e pyeta.

Sulubi u qesh: "Shumë herë. Kam shitur atje lëkura të gazelës, yndyrë dhe lesh të devesë. Po, tek janë dhjetë ditë prej kur jam kthyer prej andej".

"Atëherë ndoshta ti do të mund të na çoje deri në Kuvajt? - Mendoj, të na çosh neve në mënyrën e atillë që t'u shmangemi në rrugë takimeve me ihvanët?"

Disa çaste sulubi mendoj për këtë pyetje, e pastaj, duke hezituuar, u përgjigj: "Do të mundesha, por do të

ishte e rrezikshme për mua nëse do të më zinin ihvanët me ty. Megjithatë do të mundesha, por... por kjo do të kushtonte shumë".

"Sa?"

"Po..." - kam mund ta dalloj dridhjen e lakmisë në zërin e tij - "po, zotëri, nëse do t'mi jepje njëqind rijalë, do të mund të të çoja ty dhe mikun tënd në Kuvajt në atë mënyrë që do të mund të na shihnin vetëm shpendët nga qielli".

Njëqind rijalë i përgjigjej shumë prej dhjetë funta ari - shumë qesharake e vogël në krahasim me atë ç'do të thoshte kjo për ne; por sulubi sigurisht kurrë në jetë nuk ka pasur aq shumë para të gatshme në duar.

"Do t'i jap njëqind rijalë - njëzet tash, e pjesën tjetër kur të arrijmë në Kuvajt".

Udhëheqësi ynë i ardhshëm nuk ka pritur se kërkesa e tij do të pranohet aq gatshëm. Ndoshta është ankuar që nuk ka kërkuar çmim më të lartë sepse, si përsiatje plotësuese, ai shtoi:

"Por, ç'do të bëhet me devenë time? Nëse udhëtoj me ju deri në Kuvajt, e pastaj mbrapa, kafsha e gjorë krejtësisht do të rraskapitet, kurse unë e kam vetëm një..."

Duke mos dëshiruar që t'i zgjasë pazarllëqet, i gatshëm u përgjigja: "Do ta blej deven tënde. Ti do t'i hipësh deri në Kuvajt, kurse atje do ta fali ty - por duhet të na kthesh edhe mbrapa".

Kjo është më shumë se që ai ka mund të shpresojë. Me elan të madh ai u ngrit, humbi në terr dhe përsëri u shfaq pas disa minutave duke e marrë kafshën e vjetër, por të bukur dhe qartë të fuqishme. Pas pazarllëkut u dakorduam për njëqind e pesëdhjetë rijalë, me kusht që tash t'ia paguaj pesëdhjetë kurse pjesën tjetër, së bashku me shpërblimin e tij, në Kuvajt. Zejdi e morin qesen të mbushur me rijalë nga njëri prej thasëve tanë në shalë

dhe unë fillova t'i numëroj të hollat në prehër të sulubiut. Nga thellësia e tunikës së vet të ndytë ai nxori një copë leckë në të cilën ka qenë e lidhur tërë paraja e tij; pasi filloi t'ia shtojë rijalët e mi kursimit të vet, shkëlqimi i parasë së re e tërhoqi shikimin tim.

"Prit!" - brita, duke e vënë dorën time në të tijën. - "Ta shoh atë rijalin tënd të shkëlqyeshëm".

Duke hezituar, sikur frikësohej se mos po plaçkitez, sulubi e qiti me kujdes paranë në shuplakë të dorës sime. Ishte me skaj të mprehtë, si i ri, por për të qenë i sigurt, e ndeza një fije shkrepëse dhe e shikova përafërsisht. Ishte kjo vërtet monedhë e re e Marie Terezës - e re sikur sapo ka dalë nga parapresësja. Derisa e mbaja fijën e shkrepësës mbi pjesën tjetër të parave të sulubiut, zbulova edhe pesë apo gjashtë para po ashtu shkëlqyeshëm të reja.

"Ku i ke marrë këta rijalë?"

"I kam fituar me nderë, zotëri, të betohem... Nuk i kam vjedhë. Njëfarë Mutajri m'i ka dhënë para disa javësh afër Kuvajtit. E ka blerë prej meje shalën e re sepse e tija ishte e thyer..."

"Njëfarë Mutajri? A je i sigurt?"

"Jam i sigurt, zotëriu im, dhe Zoti më vraftë nëse gënjej... Ai ka qenë njeri i Ed-Davishit, njëri prej grupit që para do kohe ka luftuar kundër emirit nga Haili. Gjithsesi nuk kam gabuar që i kam marrë paratë për shalën...: Po nuk kam mundur t'i refuzoj e jam i sigurt se Sheiku, Zoti e ruajt, këtë do ta kuptojë..."

E binda se mbreti nuk do të zemërohet në të dhe jo-rehatia e tij u ul. Duke e pyetur më tej, kuptova se shumë sulubi kanë marrë rijalë ti këtillë të ri nga ithtarët e ndryshëm të Ed-Davishit për ndërrim për mall ose shërbime të vogla.

Sulubi ynë njëmend u tregua udhëheqës i shkëlqyeshëm. Tre net ai na ka udhëhequr rrugëve pa rrugë

nëpër territorin kryengritës, nëpër vende pa shtegdalje që madje as Zejdi, i cili mirë e njeh këtë vend, kurrë më parë nuk i ka parë. Ditët i kemi kaluar në strehimore; sulubi vërtet ka qenë ekspert të gjejë vende të shkëlqyeshme për strehim. Me një rast na solli deri te pusi i cili, si na tha, është i panjohur madje edhe për beduinët nga ajo trevë; uji i tij bajat dhe i mbyllur e fiku etjen e deveve tona dhe na mundësoi t'i mbushim rrësheqet tona. Vetëm dy herë i kemi parë grupet e ihvanëve në largësi, por asnjëherë nuk kanë patur rast të na shohin.

Mëngjesin e katërt pas takimit tonë me sulubin arritëm ta shohim qytetin e Kuvajt. Nuk iu afruam nga jugperëndimi, si do të vepronin udhëtarët nga Nexhdi, por nga perëndimi, përgjatë rrugës nga Basra, ashtu që çdokush që do të na takonte do të mendonte se jemi tregtarë irakianë.

Kur arritëm në Kuvajt, u vendosëm te tregtari që Zejdi e njihnte nga koha kur ishte në policinë irakiane.

Nxehtësia e lagshtë, e rëndë pezullonte mbi rrugët ranore dhe shtëpitë e ndërтуara nga qerpiqtë e tharë në diell; i mësuar në stepet e hapura të Nexhdit, së shpejti kam qenë i tëri i lagur nga djersët. Por nuk kishte kohë për pushim. Duke e lënë sulubin që të kujdeset për devetë - me vërejtjen e rreptë që askujt mos t'i përmend prej nga kemi ardhur - Zejdi dhe unë u nisëm në çarshi t'i kryejmë vëzhgimet e para.

Pasi nuk kam qenë i njohur me Kuvajtin, e duke mos dëshiruar që Zejdin ta bëj më të dyshimtë me praninë e vet, kam mbetur gati një orë vetëm në kafene, duke pirë kafe dhe duke thithur nargjilën. Kur Zejdi më në fund u kthye, në fytyrën e tij që i qartë ngazëllimi se ka gjetur diç të rëndësishme.

"Të shkojmë jashtë, dajo! Më lehtë është të flasësh në treg që mos të na dëgjojë askush. Eja, kam sjell diç për ty - e po ashtu edhe për vete" - dhe nën abajën e vet

nxori dy igallo prej leshit të trashë, të shkundur, të thurur të murrmë. "Kjo prej nesh do të bëjë irakianë".

Me hulumtimin diskret Zejdi ka mësuar që partneri i tij i mëhershëm - shoku nga ditët e tij më të hershme të kontrabandimit në Gjirin Persik - tash jeton në Kuvajt, qartë ende është duke u marrë me tregtinë e rëndomtë.

"Nëse ka dikush që do të mund të na thotë diç për tregtinë me pushkë në këtë qytet, ky është Bandari. Ai është Shamar sikur edhe unë - një prej atyre budallenjve kryeneqë që kurrë nuk do të mund të pajtohen me sundimin e Ibn Saudit. Nuk guxon të mësojë që punojmë për sheikun - dhe, mendoj, madje as prej nga kemi ardhur, sepse Bandari njëmend nuk është i marrë. Ai është njeri mjaft dinak - në të vërtetë, ai më ka mashtruar shumë shpesh në të kaluarën që të guxoj të kem besim në të tash".

Më në fund e gjetëm në shtëpi në rrugëzën e ngushtë krejtësisht afër bazarit kryesor. Ka qenë i lartë dhe i dobët, i vjetër ndoshta dyzet vjet, me sytë e vënë ngushtë dhe fytyrë tharët, jo të disponuar, por fytyra e tij sinqerisht u kthjellua kur e pa Zejdin. Për shkak të lëkurës si me të bardhë, jam prezentuar si turk i vendosur në Bagdad dhe i punësuar rreth eksportit të kuajve arabë nga Basra në Bombaj. "Por tash nuk paguhet të eksportohen kuajt në Bombaj", shtoi Zejdi. "Ata tregtarët nga Anajza dhe Burajdi plotësisht e kanë asfiksuar tregun këtu".

"E di", - u përgjigj Bandari, - "ata jugorët e ndyrë të Ibn Saudit nuk janë të kënaqur me atë që na kanë marrë tokën; ata fuqishëm kanë vendosur që të na marrin edhe bukën tonë të përditshme..."

"E si qëndron puna me qarkullimin e pushkëve, Bandar?" pyeti Zejdi. "Do të duhej të ketë mjaft punë këtu me të gjithë ata Mutajrë dhe Axhmanë të dëshirueshëm t'ia thejmë qafën Ibn Saudit? Eh!"

"Ka pasur mjaft qarkullim", - u përgjigj Bandari, duke mbledhur supet. - "Deri para disa muajve mjaft mirë kam fituar duke blerë pushkë në Transjordani, kurse duke ua shitur njerëzve të Ed-Davishit. Por tash krejt kjo u krye, krejtësisht u krye. Tash nuk do të mund ta shitnit as një të vetmen pushkë".

"Si kjo? Unë do të mendoja që Ed-Davishit i duhen më shumë se kurdoherë më parë".

"Po", - ia ktheu Bandari, - "gjithsesi se duhet. Por ai po i merr sipas çmimit sipas të cilit dikush sikur ti dhe unë kurrë nuk do të mund t'i shitnim... Ai i merr në sënduqe, nëpër det - pushkët angleze, pothuaj të reja - kurse paguan dhjetë rijalë për pushkën me dyqind fishekë".

"Lavdi Zotit!" - briti Zejdi me habi të sinqertë. - "Dhjetë rijalë për pothuaj pushkën e re me dyqind fishekë! Por kjo është e pamundur...!"

Vërtet dukej e pamundur, sepse në atë kohë pushkët e përdorura Lee-Enfield kushtonin në Nexhd rreth tredhjetë deri katërdhjetë e pesë rijalë, pa municion; madje nëse merret parasysh se çmimet në Kuvajt kanë mund të jenë më të ulta se në Nexhd, dallimi i madh ende ka qenë i pashpjegueshëm.

Bandari u qesh me ironi: "Po, duket se Ed-Davishi ka miq të fuqishëm. Miq mjaft të fuqishëm... Disa thonë se ai një ditë do të bëhet emir i pavarur në Nexhdin verior".

"Këtë që po e thua, Bandar", - ndërhyra unë, - "është krejtësisht e mirë. Ndoshta Ed-Davishi do të bëhet i pavarur nga Ibn Saudi. Por ai nuk ka para, kurse pa para madje as Aleksandri i Madh nuk ka mund ta ndërtojë mbretërinë".

Bandari shpërtheu në qeshje të zëshme: "Para? Ed-Davishi ka me shumicë - plotë rijalë të ri, që i vijnë në sënduqe, si pushkët, nëpër det".

"Sënduqet me rijalë? Por kjo është shumë e çuditshme. Prej nga beduini do të mund t'i merrte sënduqet me rijalë të ri?"

"Këtë nuk e di", - u përgjigj Bandari. - "Por vërtet e di se gati çdo ditë dikush nga njerëzit e tij pranon rijalët e ri që u vijnë me anë të tregtarëve të ndryshëm në qytet. Po, jo, dje e kam parë Farhan ibn Mashhurin në liman se si e mbikëqyrë zbarkimin e sënduqeve të tillë".

Këto vërtet ishin risi. Mirë e kam njohur Farhanin. Ai ka qenë i biri i nipit të atij princit të njohur beduin sirian, Nuri esh-Shalanit, që dikur ka luftuar me Lorensin kundër turqve. Për herë të parë e kam takuar Farhanin e ri më 1924 në Damask, ku ka qenë i njohur me dehjet e veta në të gjitha vendet e dyshimta për dëfrim. Pas një kohe ai është hidhëruar me dajën e vet, ka emigruar me grupin e fisit të vet Ruvala në Nexhd, ku befasisht u bë "i devotshëm" dhe iu bashkangjiti lëvizjes së ihvanëve. Sërish e kam takuar më 1927 në pallatin e Ibn Musaadit në Haili. Atëherë tashmë e ka pasur në kokë turbanin e madh të bardhë të ihvanëve si simbol të fesë së vet të zbuluar rishtas dhe gëzonte bujarinë e Mbretit; kur e kam përkujtuar në takimet tona më të hershme në Damask, ai shpejtë e ndërroi bisedën në lëndën tjetër. I marrë dhe ambicioz çfarë ka qenë, ai në trazirën e Ed-Davishit ka pasur rastin të fitojë emiratin e pavarur për vete në Al-Javfa, oazën në veri prej Nufudit të Madh, sepse në Arabi, sikur edhe tjetërkund, rebeluesit ndjekin praktikën e lashtë që ta ndajnë lëkurën e luanit para se luani të mbytet.

"Kjo do të thotë se Farhani është këtu në Kuvajt?" - e pyeta Bandarin.

"Natyrisht. Ai vjen këtu po ashtu shpesh sikur edhe Ed-Davishi dhe shkon lirisht në pallat të sheikut. Sheikut, thonë, ai i pëlqen shumë".

"Por a thua britanikët nuk i kundërvihen ardhjes së Ed-Davishit dhe Farhanit në Kuvajt? Më duket, më kujtohet se para disa muajve kanë deklaruar se nuk do t'u lejojnë Ed-Davishit dhe njerëzve të tij që të vijnë në këtë territor..."

Bandari sërish u shkul së qeshuri. "Po edhe po, po edhe po. Por, të kam thënë: Ed-Davishi ka miq të fuqishëm... Nuk jam i sigurt a është ai pikërisht në qytet; por Farhani po. Ata shkojnë çdo natë në Xhami të Madhe për aksham; mund ta shohësh atje me sytë e t'u nëse nuk më beson..."

Dhe njëmend e kemi parë. Kur, duke ndjekur vërejtjen e Bandarit, Zejdi dhe unë në parambrëmje të hershme shëtitëm në afërsi të Xhamisë së Madhe, gati se u ndeshëm me grupin e beduinëve, sipas veshjes pa dyshim nga Nexhdi, që dolën pas këndit të rrugës. Në ballë të tyre ka qenë njeriu i viteve të tridhjeta, diç më i ulët prej beduinëve të lartë që e kanë rrethuar dhe përcjellë, me fytyrë të bukur, të rrethuar me mjekër të shkurtër, të zezë. Menjëherë e kam njohur. As sot nuk e di a më ka njohur ai mua; sytë e ti për një çast i kanë takuar sytë e mi, kaluan nëpër mua me shprehje të hutuar, sikur ka tentuar t'i kujtohet diçka, e pastaj u kthye; një çast më vonë ai dhe përcjellja e tij u humbën në turmën e njerëzve që shkonin drejt xhamisë.

Vendosëm që qëndrimin tonë të fshehtë në Kuvajt mos ta zgjasim panevojshëm duke pritur rastin ta shohim edhe Ed-Davishin. Zbulimet e Bandarit qenë konfirmuar me hulumtimin e shkathhtë të Zejdit të njohurve tjerë në qytet. Furnizimi misterioz i Ed-Davishit me pushkë Lee-Enfield - vetëm sipërfaqësisht të maskuara si "furnizime" - qartë çonte deri te një tregtar kuvajtian që gjithnjë ka qenë i dalluar si importues i armëve; sasia e madhe e parave të reja Maria Terezë drejtpërdrejt nga

shkriticorja që qarkullonin në bazaret e Kuvajtit gati në çdo rast shpienin deri te Ed-Davishi dhe njerëzit rreth tij. Duke mos pasur mundësi t'i shohim depotë dhe fle-tëdërgesat e tij - që mezi ka qenë në kufijtë e të mundshmes - kemi pasur mjaft dëshmi t'i konfirmojmë dyshimet e Mbretit që i ka shprehur gjatë bisedës me mua.

Detyra ime që mbaruar dhe natën vijuese dhe ne e lëshuam Kuvajtin fshehurazi sikur që edhe kemi ardhur.

Derisa unë dhe Zejdi kemi hulumtuar në bazare, sulubi ynë ka mësuar se momentalisht nuk ka grupe kryengritëse në jug të Kuvajtit. Kështu ne u nisëm në jug - drejt krahinës El-Hasa, e cila ka qenë fort nën kontrollin e Mbretit. Pas dy marsheve të mundimshme të natës, e takuam, jo larg prej bregdetit, repartin e beduinëve Benu Haxhar, që i patë dërguar emiri i El-Hasasë t'i vërtetojnë pozicionet e fundit të rebeluesve; në shoqërinë e tyre së-rish hymë në territorin lojal. Kur tashmë ishim të sigurt në territorin e Ibn Saudit, u ndamë me sulubin tonë udhëheqës i cili, i kënaqur duke e vënë në xhep shpërbli-min mirë të fituar, udhëtoi drejt perëndimit në deve që ia kam "dhuruar", derisa ne vazhduam drejt jugut në drejtim të Rijadit.

Një varg artikujsh që pas kësaj i kam shkruar për he-rë të parë qartë kanë dëftuar se rebeluesit i ndihmon një fuqi e madhe Evropiane. Në ta është theksuar se caku kryesor i këtyre intrigave ka qenë që t'i shtyjnë kufijtë e Ibn Saudit nga jugu, dhe më në fund, t'i shndërrojnë kra-hinat e tij më veriore në principatë "të pavarur" ndërmjet Arabisë Saudite dhe Irakut, që do t'u lejonte britanikëve të ndërtojnë hekurudhën nëpër territorin e saj. Veç kësaj, kryengritja e Ed-Davishit ka ofruar ndihmë të mi-rëseardhur që në mbretërinë e Ibn Saudit të krijohet aq rrëmujë që ai mos të jetë në gjendje që t'u kundërvihet më, siç ka bërë deri tash, kërkesave britanike për dy kon-

cesione të rëndësishme: njëri prej tyre ka qenë që t'ua huazojë limanin Rabigh në Detin e Kuq, në veri të Xhides, ku britanikët ka herë kanë dëshiruar ta vënë bazën detare, dhe koncesioni tjetër, kontrolli i atij sektori të hekurudhës Damask - Medinë që kalon nëpër territorin saudit. Humbja e Ibn Saudit në luftë me Ed-Davishin do t'ua shtonte këtyre planeve mundësinë e realizimit të tyre.

Publikimi i artikujve të mi në shtypin evropian dhe arab (kryesisht egjiptian) ka qenë senzacion; ndoshta pikërisht ky zbulim i parakohshëm i planeve të fshehta diç i ka kontribuar pengimit të tyre. Sidoqoftë, plani për hekurudhën britanike prej Haifes deri në Basra u la të qitet në harrësë përkundër sasive të mëdha të parave që, si duket, janë shpenzuar në matjet përgatitore dhe për të më kurrë nuk është dëgjuar.

Ajo që ka ndodhur pas kësaj është çështje e historisë: po atë vjeshtë të vitit 1929 Ibn Saudi ka protestuar te britanikët kundër lirisë së dhënë Ed-Davishit që të furnizohet me armë dhe municion në Kuvajt. Pasi ai nuk kishte "dëshmi" të prekshme që këto armë i dërgon ndonjë fuqi e huaj, Mbreti ka mundur të protestojë vetëm kundër vetë shitjes. Pushteti Britanik u përgjigj se tregtarët nga Kuvajti i furnizojnë me armë rebeluesit, dhe se Britania nuk mund të bëjë asgjë që ta pengojë këtë, Pasi me marrëveshjen në Xhide prej 1927 është hequr ndalesa në importimin e armëve në Arabi. Nëse Ibn Saudi dëshiron, thanë ata, edhe ai mund të importojë armë nëpërmjet Kuvajtit... Kur Ibn Saudi kundërshtoi se po kjo marrëveshje e obligon edhe Britaninë edhe Arabinë Saudite që në territorin e vet t'i pengojnë të gjitha aktivitetet të drejtuara kundër sigurisë së palës tjetër, mori përgjigjen se Kuvajti nuk mund të konsiderohet "territor britanik" pasi ai është sheikat i pavarur që me Britaninë ka vetëm marrëdhënie kontraktuese...

Dhe kështu lufta qytetare ka vazhduar. Vonë në vjeshtë të vitit 1929 Ibn Saudi personalisht udhëhoqi luftën, këtë herë i vendosur që ta ndjek Ed-Davishin madje edhe në Kuvajt nëse ky territor - sikur që gjithherë në të kaluarën ka qenë rast - mbetet i hapur për rebeluesit si strehimore dhe bazë për operacione të mëtejme. Të ballafaquar me këtë qëndrim vendimtar, për të cilin Ibn Saudi është kujdesur që t'i kumtohet sundimit britanik, ata qartë kuptuan se vazhdimi i mëtejme i lojës do të ishte tejet i rrezikshëm. Avionët britanikë dhe automjetet blinduese janë dërguar ta pengojnë Ed-Davishin në tërheqjen e sërishme në territorin e Kuvajtit. Rebeluesi e kuptoi se çështja e tij humbi; ai kurrë nuk do të ketë fuqi t'i kundërvihet Mbretit në betejë të hapur dhe kështu filloi të bisedojë. Kushtet e Mbretit qenë të rrepta e të qarta: fiset e rebeluara duhet të dorëzohen; armët, kuajt dhe devetë do t'u merren; jeta Ed-Davishit do t'i kursehet, por pjesën e mbetur të jetës do të duhet ta kalojë në Rijad. Ed-Davishi, gjithherë aq aktiv dhe plot lëvizje, nuk ka mundur ta gjykojë veten në joaktivitet dhe palëvizshmëri; ia refuzoi ofertën. Duke luftuar me shpresa të humbura me format superiore mbretërore, rebeluesit qenë thyer tërësisht. Ed-Davishi dhe disa liderë të tjerë ndër ta Farhan ibn Mashhuri dhe Naif ibn Kilabi, kryepar i Axhmanëve, ikën në Irak.

Ibn Saudi kërkoi ekstradimin e Ed-Davishit. Një kohë dukej se Mbreti irakian, Fejsali, do ta refuzojë kërkesën e tij duke u thirrur në ligjin e vjetër arab të mikpritjes dhe strehimit, por më në fund lëshoi pe. Në fillim të vitit 1930 Ed-Davishi, seriozisht i sëmurë, iu patë dorëzuar Mbretit dhe u soll në Rijad. Kur pas disa javësh u bë e qartë se këtë herë vërtet po vdes, Ibn Saudi, me bujarinë e vet tradicionale, urdhëroi që t'ia kthejnë familjes së tij në Artavi, ku mori fund jeta e tij.

Edhe një herë përsëri mbretëroi paqeja në mbretërinë e Ibn Saudit...

Dhe edhe një herë përsëri mbretëron paqe rreth pu-seve të Arxhes.

"Le t'ju ruaj Zoti, udhëtarë! Pranojeni bujarinë tonë!" - briti beduini i vjetër Mutajri, kurse njerëzit e tij na ndihmojnë t'u japim ujë deveve tona. Të gjitha urrejtjet dhe armiqësitë e të kaluarës aq të afërt dukeshin se janë harruar sikur kurrë nuk kanë qenë. Sepse beduinët janë racë e çuditshme: të gatshëm të gufojnë me epshe të pakontrolluara madje edhe në provokimin e imagjinuar, e pikërisht po ashtu të gatshëm që shpejt të kthehen në ritmin e përhershëm të jetës në të cilën dominojnë maturia dhe njerëzshmëria: gjithnjë parajsja dhe skëterra në afërsi të drejtpërdrejtë.

Dhe derisa e nxjerrin ujin për devetë tona në kovat e veta të mëdha prej lëkure, barinjte Mutajri këndojnë në kor:

Pi dhe mos vajto ujin,

Pusi është plot mëshirë dhe nuk ka fund...

Natën e pestë të shkuarjes sonë nga Haili hyjmë në fushëgropën e Medines dhe shohim vijat e errëta të kodrës Uhud. Devetë lëvizin me hapa rraskapitës; kemi marsh të gjatë pas nesh, prej mëngjesit të hershëm deri thellë në natë. Zejdi dhe Mensuri janë të heshtur, kurse edhe unë po heshti. Në dritën e hënës para nesh paraqitet qyteti i rrethuar me mur me frangji dhe minarja e gjatë e drejtë e Xhamisë së Pejgamberit.

Arritëm deri te porta e cila, pasi shikon drejt veriut, është quajtur porta siriane. Devetë frikësohen para hijeve të bastioneve të saj të rënda dhe duhet t'i përdorim shkopinjte që t'i detyrojmë të hyjnë në portë.

Tash jam përsëri në qytetin e Pejgamberit, në shtëpi pas udhëtimit të gjatë, sepse ky qytet ka qenë shtëpia ime

disa vite. Heshtja e thellë, intime dominon në rrugët e fjetura, të zbrazëta. Aty - këtu ndonjë qen përtacisht ngritet para këmbëve të devesë. Një djalosh kalon duke kënduar; zëri i tij tundet në ritmin e butë dhe humbet në një rrugë anësore. Lloxhat dhe ballkonët e mbyllur të shtëpive shtrihen, të errshëm e të heshtur mbi ne. Me dritë hëne të shkëlqyer, ajri është i vakët si qumështi i freskët.

Ja edhe shtëpia ime.

Mensuri po përshëndetet që të shkojë te disa miq, derisa ne të dytë i shtrijmë devetë tona para dyerve. Zejdi pa fjalë i lidhi dhe filloi t'i shkarkojë thasët. Trokita në derë. Pas një kohe dëgjoj nga brenda zërat dhe hapat. U paraqit drita e poçit në dritare mbi derë, u hoqën shulat dhe shërbëtorja ime e vjetër e shtëpisë, sudanezja Emira, briti e gëzuar:

"Oh, zotëriu im u kthye në shtëpi!"



## IX. Letra persiane

- 1 -

Është pasdite. Jam i ulur me mikun në kopshtin e tij të palmave menjëherë pas portës jugore të Medines. Shumë trungje të palmave në kopsht derdhen në muzgun e murrmë të gjelbër të thellësisë së tij duke e bërë të duket i pafund. Trupat janë ende të ri e të ulët; drita e diellit vallëzon mbi trungje dhe harqe të mprehta të fierit. Gjëlberimi i tyre diçka është i pluhurosur për shkak të shtrëngatave ranore që paraqiten pothuaj çdo ditë në këtë kohë të vitit. Vetëm qilimi i trashë i tërfojës nën palma është i shkëlqyeshëm, i gjelbër, i pastër.

Jo larg para meje ngrihen muret e qytetit, të vjetra, të përhimta, të ndërtuara prej gurit dhe tullës, me bastionet aty - këtu të qitura përpara. Pas murit shihen palmat luksoze të një kopshti tjetër në qytet dhe shtëpitë me kapakët e nxirë të dritareve dhe ballkonet e mbyllura; disa prej tyre janë futur në murin e qytetit dhe janë bërë pjesë e tij. Në largësi i shoh pesë minare të xhamisë së Pejgamberit, të larta e shtatholla si zëri i flautës, qemerin e madh të gjelbër që e tejkalon dhe fsheh shtëpinë e vogël të Pejgamberit - shtëpinë e tij derisa ka jetuar kurse varrin e tij kur ka vdekur - e edhe më tej, pas qytetit, zinxhiri guror i kodrës Uhud; prapavija ngjyrë gështënjë e kuqe për minaret e bardha të xhamisë së shenjtë, kurorat e palmave dhe shumësi shtëpish qyteti.

Qielli, verbërisht i ndriçuar me diellin e pasditës, shtrihet i pastër si kristali mbi retë e dobësua, kurse qyteti lahet në vijat e kaltra dhe të arta të gjelbra të dritës. Në lartësi era luan me retë e buta, që në Arabi mund të jenë aq mashtruese. Këtu kurrë nuk mund të thoni: "Tash është vrerët; së shpejti do të bie shi", sepse madje edhe nëse grumbullohen retë e rënda, sikur po kërcënohen me shtrëngatë, shpesh ndodh që nga shkretëtira papritmas frynë era dhe i shpërndanë; fytyrat e njerëzve që pritnin shi kthehen në resignacion të qetë dhe murmurimë:

"Askush nuk ka forcë as fuqi pos Zoti", - derisa qielli prap shkëlqen me kthjelltësinë e ndritshme të kaltër pa mëshirë.

Përshëndetem me mikun tim dhe shkoj prapa drejt portës së qytetit. Një njeri kalon duke u grahur dy gomarëve të ngarkuar me tërfojë, kurse vetë duke i hipur të tretit. Ai e ngriti shkopin e vet për përshëndetje dhe thotë. "Selamun alejkum! - Paqja e shpëtimi qoftë mbi ju", kurse unë përgjigjem me fjalët e njëjta. Pastaj erdhi be- duinja e re; fustani i zi i saj tërhiqet pas saj, kurse pjesa e poshtme e fytyrës i është i mbuluar me vel. Sytë e saj të shkëlqyeshëm janë aq të zinj saqë bebëzat dhe iridat e syrit shkrihen në një, kurse hapi i saj ka diç prej tendosjes së pavendosur ritmike të shtazëve të reja stepike.

Hyj në qytet dhe kaloj nëpër skuerin e madh, të hapur El-Menaka deri te muri i brendshëm i qytetit; nën harkun e rëndë të portës egjiptiane, nën të cilën ulen këmbyesit duke cingëruar me paratë e veta të arit dhe argjendit, hyj në bazarin kryesor - në rrugën të gjerë mezi katër metra, ngushtë të ngjeshur me dyqane rreth të cilave rrahë ritmi i vogël, por i rreptë jetësor.

Shitësit e lavdërojnë mallin e vet me këngë të hare-shme. Mbulesat e gjalla për kreun, shallat e mëndafshtë dhe fustanet nga leshi i pikturuar kashmiras tërheqin shi-

kimet e kalimtarëve. Argjendarët ulen pas kutive të vogla të qelqit me stolitë beduinase - hallka për dorë, bylyzykë, xherdanë dhe vathë. Shitësit e aromave i ekspozojnë enët plot henë, bucelat e vogla të kuqe të antimonit për ngjyrimin e qerpikëve, bucelat e larme të vajit dhe parfumit dhe grumbujt e mëlmesave. Tregtarët nga Nexhdi shesin përgatitjen beduinase, shala për deve dhe thasë të kaltër dhe të kuq për shala nga Arabia Lindore, të stolisura me theke të gjata. Një shitës vrapon rrugëve, duke bërë titur nga gjithë zëri, me qilimin persian dhe abajën nga qimet e devesë mbi supe kurse me samovarin e bakërt nën dorë. Lumë njerëzish në të dy drejtëmet, njerëzit nga Medina dhe mbarë Arabia dhe - Pasi haxhi vetëm para do kohe është mbaruar - nga të gjitha vendet ndërmjet stepeve të Senegalit dhe Kirgizisë, ndërmjet Indisë Lindore dhe Oqeanit Atlantik, ndërmjet Astrahanit dhe Zanzibarit; por përkundër shumësisë së njerëzve dhe rrugëve të ngushta, këtu nuk ka nxitim të marrë, as shtyrje dhe rrëmujë: në Medine koha nuk kalëron në krahët e ngarendjes afariste.

Por ajo që do të mund të bëhet madje edhe më e çuditshme është që edhe përveç llojlojshmërisë së madhe të tipeve të njerëzve dhe kostumeve që i mbushin rrugët e Medines, në ta nuk ka asgjë nga përzierja "ekzotike"; llojlojshmëria e jashtësisë i zbulohet vetëm syrit të vendosur të analizojë. Duket se të gjithë njerëzit që jetojnë në këtë qytet, ose madje përkohësisht në të qëndrojnë, së shpejti bien në diç që do të mund të quhej bashkësi e disponimit dhe në pajtim me këtë edhe e mirësjelljes dhe, gati, madje edhe të çehres; sepse të gjithë bijnë nën magjepsjen e Pejgamberit, qyteti i të cilit ka qenë njëherë dhe musafirë të të cilit ata janë tash...

Madje edhe pas trembëdhjetë shekujsh prania e tij shpirtërore këtu është po ashtu e gjallë thuhet sikur që

ka qenë atëherë. Vetëm për atë grupi i shkapërderdhur i fshatrave, që dikur quheshin Jethrib, është bërë qytet të cilin e duan muslimanët deri më sot, sikur që asnjë qytet askund në botë nuk ka qenë i dashur. Ai madje nuk ka as emrin e vet personal; më shumë se trembëdhjetë shekuj është quajtur Medinetu 'n-Nebij ("Qyteti i Pejgamberit"). Për më shumë se trembëdhjetë shekuj, aq shumë dashuri është tubuar këtu saqë të gjitha format dhe të gjitha lëvizjet e kanë arritur një lloj të ngjashmërisë së afërt, kurse të gjitha dallimet e jashtësisë në kalimet tonike derdhen në harmoni unike.

Kjo është lumturi që këtu gjithnjë ndjehet - ky unitet unjësues. Edhe pse jeta në Medine sot ka vetëm lidhjen formale, të largët me atë çka ka synuar Pejgamberi, edhe pse vetëdija shpirtërore për Islamën këtu është dobësuar, sikur edhe në shumë pjesë tjera të botës muslimane, një lidhje e papërshtetshme emocionale me të kaluarën e tij të madhe shpirtërore ka mbetur e gjallë. Kurrë asnjë qytet nuk ka qenë aq i dashur për shkak të një të vetmit person; kurrë asnjë njeri, i vdekur tashmë mbi trembëdhjetë shekuj nuk ka qenë i dashur personalisht dhe prej numrit aq shumë të madh, sikur ai që është i vdekur nën qemerrin e madh të gjelbër.

E megjithatë, ai kurrë nuk ka pretenduar më tepër se është çkado tjetër pos njeri i rëndomtë, kurse as muslimanët kurrë nuk i kanë përshkruar cilësi hyjnore, sikur që ihtarët e shumtë të pejgamberëve tjerë kanë vepruar pas vdekjes së tyre. Në realitet, Kur`ani është përplot pohime që e theksojnë natyrën njerëzore të Muhammedit: "Muhammedi nuk është tjetër pos i dërguar, të gjithë të dërguarit para tij kanë vdekur; nëse ai vdesë ose mbytet, vallë do të ktheheni?" (Ali Imran, 144). Parëndësia e tij e plotë para madhësisë së Zotit kështu është shprehur në Kur`an: "Thuaj (o Muhammed): Unë nuk kam kurrë

farë fuqie që t`ju lejoj të mirën ose të keqen... Unë madje nuk kam kurrfarë fuqie që as vetes t`i ofroj ndonjë privilegj ose t`ju bëjë ndonjë dëm, pos si dëshiron këtë Zoti; e sikur ta dija të Panjohshmen, do të arrija shumë të mira, kurse asnjë e keqe kurrë nuk do të më kaplonte. Unë vetëm qortoq dhe sjell lajme të gëzueshme për ata që besojnë në Zotin...".

Pikërisht për atë që ai ka qenë vetëm njeri, për atë që ka jetuar sikur edhe njerëzit tjerë duke shfrytëzuar harrenë dhe duke pësuar të keqen e ekzistimit të njeriut, kanë mundur ata rreth tij ta rrethojnë me dashurinë e vet.

Kjo dashuri e ka mbijetuar vdekjen e tij dhe edhe më tej jeton në zemrat e ithtarëve të tij si lajtmotiv i melodisë së ndërtuar prej tingujve të shumtë. Ajo jeton në Medinë. Ajo ju flet nga çdo gurë i qytetit të lashtë. Mundeni pothuaj ta prekni me duart tuaja, por nuk mund ta shprehni me fjalë...

## - 2 -

Derisa kaloj bazarit në drejtim të Xhamisë së madhe, shumë shokë të vjetër më përshëndesin. I paraqitem këtij apo atij tregtari dhe përfundimisht lëshoj pe para insistimit të mikut tim Ez-Zugajbiut që të ulem me të në qepëngën e vogël në të cilën u shet pelhurë beduinëve.

"Kur je kthyer Muhammed, dhe prej kah? Tashmë me muaj nuk ke qenë këtu!"

"Vij nga Haili dhe nga Nufudi."

"A nuk do të qëndrosh në shtëpi një kohë?"

"Jo, vëlla, shkoj në Mekë pasnesër".

Ez-Zugajbi e ftoi djaloshin nga kafeneja përtej rrugës dhe pas pak kohe filxhanët e vegjël cingërojnë para nesh.

"Por përse, Muhammed, tash shkon në Mekë? Koha e haxhit ka kaluar..."

"Nuk është dëshira për haxh ajo që më çon në Mekë. Më në fund, a nuk jam haxhi tashmë pesë herë? Por disi kam ndjenjën se nuk do të mbetem gjatë në Arabi dhe dua edhe njëherë ta shoh qytetin në të cilin ka filluar jeta ime në këtë vend..." E pastaj shtova me buzëqeshje: "E, vëlla - të ta themë të vërtetën, unë as vetë s`e di përse shkoj në Mekë, por e di se duhet patjetër..."

Ez-Zugajbi tundi kokën në habi: "Ti do ta lëshoje këtë vend dhe vëllezërit t'u? Si mundesh kështu të flasësh?"

Figura e njohur kalon me hapa të gjatë, të shpejtë; ky është Zejdi, qartë e kërkon dikënd.

"O, Zejd, ku?"

Ai shpejt u kthye drejt meje, me fytyrë serioze;

"Ty të kërkoj, dajo; ka qenë një tufë letrash në postë që priste kthimin tënd. Ja ato. Selamun alejkum? ("Paqja e shpëtimiti qoftë mbi ju") shejh Ez-Zugajbi!"

Duke ndenjtur ulur këmbëkryq para dyqanit të Ez-Zugajbiut, po kontrolloj tufën e letrave; ka disa letra nga shokët në Mekë; një nga redaktori i Neue Züricher Zeitungut nga Zvicra, korrespondent i së cilës kam qenë gjatë gjashtë viteve të fundit; një nga India me ftesë të shkoj atje e të njoftohem me bashkësinë më të madhe muslimane në botë; disa letra nga pjesët e ndryshme të Lindjes së Afërt; një me pullë postare nga Teherani - nga miku im i mirë Ali-aga, nga i cili s`kam pasur lajme më shumë se një vit. E hapa dhe po kaloj nëpër faqet e mbuluara me dorëshkrimin elegant persian të Ali-agës:

"Mikut dhe vëllait tonë të dashur, dritës së zemrës sonë, të respektuarit Asad-agës, Zoti ia zgjattë jetën dhe e ruajt në rrugën e tij. Amin.

Me ju qoftë gjithherë paqja dhe mëshira e Zotit. E lusim Zotin që t`ju falë shëndet dhe lumturi, duke e di-

tur se do t`ju gëzojë të dëgjoni se edhe ne jemi me shëndet të mirë, lavdi Zotit.

Nuk ju kemi shkruar gjatë kohë për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme në jetën tonë muajve të fundit. Babai ynë, Zoti e mëshiroftë, vdiq para një viti dhe ne, si djali më i moshuar, u dasht të kalojmë mjaft kohë, dhe kemi pasur mjaft brengosje rreth rregullimit të çështjeve familjare. Po ashtu, ka qenë vullneti i Zotit që punët e shërbëtorit të tij modest të përparojnë mbi të priturën, Pasi qeveria e ka ngritur në gradën e nënkolonelit. Krahas kësaj shpresojmë se së shpejti do të martohemi me zonjën e dashur e të bukur, me kushërirën tonë të largët Shirinin - dhe në këtë mënyrë ditëve tona të çrregulluara të vjetra do t`u vijë fundi. Siç i është mirë e njohur zemrës suaj miqësore, ne nuk kemi qenë pa mëkate e gabime në të kaluarën tonë - por a nuk ka thënë Hafidhi:

"O Zot, ke hedhur dërrasën midis detit -

Vallë, mos ke dëshiruar të mbetet e thatë?"

Kështu, Ali-aga i vjetër më në fund do të qetësohet dhe do të bëhet i nderuar dhe autoritativ: Ai nuk ka qenë aq i respektuar kur e kam takuar herën e parë, para diç më shumë se shtatë vjet, në qytetin Bam, në të cilin qe "internuar". Edhe pse atëherë ka pasur vetëm njëzet e gjashtë vjet, e kaluara e tij ka qenë përplot aktivitete dhe tronditje; ka marrë pjesë në trazirat politike pas të cilave sundimin e ka marrë Riza-kani dhe ka mundur të luajë rol të konsiderueshëm në Teheran sikur të mos kishte jetuar pak tepër i shfrenuar. Praninë e tij në Bamin periferik në këndin juglindor të Iranit e pati kurditur babai i tij i kujdesshëm dhe ndikues, me shpresë se i biri do të rregullohet nëse do të largohet nga dëfrimi në Teheran. Mirëpo, Ali-aga si duket ka gjetur kompensim madje edhe në Bam - femrat, araku dhe helmi i ëmbël-opiumi, të cilave u qe dhënë. Në atë kohë, në vitin 1925, ai ka qenë

komandant i gjandarmërisë në gradën e togerit. Pasi pikërisht përgatitesha të nisem nëpër shkretëtirën e madhe Dashti-Lut, e kam kërkuar rekomandimin prej guvernatorit të krahinës Kirman - që prap ishte bazuar në letërën prej Riza-kanit, kryetarit të qeverisë dhe diktatorit. E gjeta Ali-agën në kopshtin me hije të portokajve, olean-derëve dhe palmave nëpër kurorat e të cilave depërtonin rrezet e diellit. Ishte në këmishë. Në barë ishte i shtruar qilimi, në të cilin ishin enët me ushqimin e mbetur dhe bucelat gjysmë të zbrazëta të arakut. Ali-aga kërkoj falje: "Është e pamundur të gjendet verë në këtë vrimë të mallkuar," dhe më detyronte të pijë arakun shtëpiak - pije e tmerrshme që pamëshirshëm godiste në kokë. Me sytë e përplotur të persianit verior e shikoi letrën nga Kirmani, e vuri dhe tha: "Madje sikur të kishit ardhur edhe pa rekomandim, unë do t'ju përcillja në rrugë nëpër Dashti-Lut. Ju jeni musafiri im. Kurrë nuk do t'ju lëshoja që vetëm të kalëroni nëpër shkretëtirën Baluçi".

Dikush që deri atëherë ishte i ulur gjysmë i fshehur në hije të drurit ngadalë u ngrit: gruaja e re në fustan deri në gjunj nga mëndafshi i kaltër i ndritshëm dhe me pantallona të gjera, të bardha Balluçi. Kishte fytyrë sensuale që sikur nga brenda digjej, buzët e mëdha të kuqe dhe sytë e bukur, por për çudi të turbullt; qerpikët i kishte të bërë me surmë.

"Ajo është e verbër", më pëshpëriti Ali-aga në frëngjishte, "kurse shkëlqyeshëm këndon".

I jam admiruar butësisë dhe respektit të madh me të cilin i drejtohej vashës që, si këngëtare publike, i përket kategorisë që në Iran, pak a shumë, barazohet me kurtizanet, nuk ka mundur të sillet më mirë ndaj cilësdo zonjë të madhe nga Teherani.

U ulëm, që të tretë, në qilim dhe, derisa Ali-aga merrj me gacën dhe llullën për opium, bisedova me vashën

Balluçi. Përkundër verbërisë, mund të qeshej si munden vetëm ata që jetojnë thellë në gëzim të brendshëm; bëri vërejtje mendjeprehta e spirituoze të cilave nuk do t' u turpërohej asnjë zonjë nga shoqëria e lartë. Kur Ali-aga e përgatiti llullën e vet, e mori me kujdes për dore dhe tha:

"Ky i huaj, ky austriak, gjithsesi me dëshirë do të dëgjonte ndonjë prej këngëve t'ua; ai ende kurrë nuk ka dëgjuar këngë të Balluçëve".

Në fytyrën e saj të verbër pezullonte fati i largët, ëndërrues derisa e merrte lahutën që ia afroi Ali-aga. Filloi të kalojë nëpër tela. Këndonte me zë të thellë, të ngjirur këngën Balluçi që nga buzët e saj të ngrohta jehonte si jehon jeta nën tendë...

Po i kthehem letrës:

"Pyetëm se a u kujtohet ende, vëlla dhe mik i respektuar, kur ato ditë së bashku udhëtuam nëpër Dashti-Lut dhe se si jemi detyruar të luftojmë për jetat tona me ata rebeluesit Balluçi...?"

A më kujtohet? Në vete qeshem në pyetjen e panevojshme të Ali-agës dhe shihem me të në Dashti-Lutin e shkretë, "shkretëtirën e zhveshur", e cila zbrazëtinë e vet të madhe e shtrinë prej Baluxhistanit thellë në zemër të Iranit. Pikërisht duhej ta kalojë që të arrijë deri në Seistan, krahinën më lindore të Iranit e prej aty të vazhdojë deri në Afganistan; pasi kam ardhur nga Kirmani, nuk kishte rrugë tjetër.

Jemi ndalur, së bashku me përcjelljen tonë të gjandarëve Balluçi, në oazën e gjelbër në skaj të shkretëtirës që të huazojmë deve dhe të blejmë gjësende për rrugën e gjatë që na priste. Vendosi jonë e përkohshme ka qenë në ndërtesën e telegrafit indo-evropian. Drejtuesi i stacionit, njeri i gjatë, ashtmadh, symprehtë, gati nuk më lëshonte prej shikimit dhe sikur më vlerësonte me pikëpamjet e veta.

"Ruajuni nga ky njeri", - më pëshpëriti Ali-aga, - "ai është bandit. E di dhe ai e di që e njoh. Deri para disa vitesh ai ka qenë cub i vërtetë, por tash tashmë ka kursyer mjaft para dhe u bë autoritativ - kurse fiton edhe duke i furnizuar me armë ish-kolegët e vet. Pres vetëm çastin e volitshëm që në këtë ta kapi. Por ai është dinak dhe është vështirë të dëshmohet çka do. Pasi ka dëgjuar që jeni austriak, është tepër i tronditur. Gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore disa agjentë austriakë dhe gjermanë kanë tentuar që në këto vise t'i rebelojnë fiset kundër britanikëve; kanë marrë thasët me monedha ari e miku ynë mendon se çdo gjerman ose austriak është i përgatitur ngjashëm".

Por dinakëria e drejtuesit të stacionit na ndihmoi sepse ishte në gjendje të m'i gjejë dy devetë më të mira për udhëtim në atë vis. Pjesa tjetër e ditës kaloi në pazarllëk rreth rrësheqeve për ujë, litarëve prej qimeve të deveve, orizit, gjalpës dhe shumë cikërrimave tjera të nevojshme për udhëtim nëpër shkretëtirë.

U nisëm pasdite ditën vijuese. Ali-aga ka vendosur të niset më herët me katër gjandarë që ta përgatisë bujtinën tonë, dhe vija e tërhequr e deveve të tyre së shpejti u humb pas horizontit. Ne të tjerët - Ibrahim, unë dhe gjandari i pestë - i ndoqëm me hapa më të ngadalshëm.

Tundeshim (pasi atëherë kjo ka qenë e re për mua!) me ritmin e çuditshëm të ecjes trok të deveve këmbëholla, më së pari nëpër grehinat ranore, të verdha, rrallë të shënuara me plisimin e barit, pastaj thellë e më thellë në rrafshirë - në rrafshirën e pafund, të shurdhër, të përhimtë, të rrafshët e të zbrazët - ashtu të zbrazët sa që dukej jo që nuk po rrjedh por po bie drejt horizontit, sepse sytë tu nuk mund të gjejnë asgjë në çka do të ndaleshin, as hulli në tokë, as gurë, as shkurre, madje as barishte. Kurrfarë zëri shtazor, kurrfarë cicërime të zogjve as zukamë të insekteve nuk e ndërprente atë qetësi të gjerë, e

madje edhe era, e privuar nga të gjitha pengesat, fshinte poshtë, pa zë, mbi zbrazëti - jo, binte në të, sikur guri që bie në greminë... Kjo nuk ishte heshtja e vdekjes, por më shumë heshtja e diç të palindur, të asaj që ende kurrë nuk është gjallëruar, heshtja para fjalës së Parë.

E atëherë kjo ndodhi. Heshtja ndërprehet. Zëri njerëzor doli ëmbël, cicërueshëm, në ajër, dhe sikur mbeti atje duke pezulluar; ju dukej sikur mundeni jo vetëm të dëgjoni por edhe të shihni, se si vetmueshëm dhe fshehtazi pezullon mbi fushëgropën e thatë. Ishte ky ushtari jonë Balluçi. Këndonte këngën e ditëve të veta nomade, rapso-dinë gjysmë të kënduar e gjysmë të shqiptuar, rrjedhën e shpejtë të fjalëve të rrepta e të ëmbla që s'mund ta kuptoja. Zëri i tij cingëronte në vetëm disa tone, në një të vetmin nivel, me këmbëngulësinë që shkallërisht kalonte në diç të ngjashme me madhësinë derisa e ka plotësuar melodinë e brishtë në lojë të shurdhër të toneve të fytyrës dhe, me përsëritjen e pastër dhe me ndryshimin e temës së njëjtë, zhvillonte pasuri të pakontestueshme në tonet e veta të rrafshta - të rrafshta e të pafund si vendi në të cilën qe lindur...

Pjesa e shkretëtirës në të cilën tash kemi udhëtuar quhej "Shkretëtira e zileve të Ahmedit". Para shumë viteve, karvani që e udhëhiqte njëfarë Ahmedi, u humb këtu dhe të gjithë, njerëzit dhe shtazët, vdiqën nga etja; deri më sot, si thonë, nganjëherë i dëgjojnë zilet që i kanë bartur devetë e Ahmedit rreth qafës - zërat skandalozë, të pikëllueshëm që i mashtrojnë të pakujdesshmit nga rruga dhe i shpiejnë në vdekjen shkretinore.

Menjëherë pas perëndimit të diellit e arritëm Ali-agën dhe parapranken dhe u vendosëm midis njëfarë shkurreje të varfër - të fundit që kemi mundur ta shohim. Zjarrin e ndezëm nga degët e thata dhe përgatitëm çajin e pashmangshëm - derisa Ali-aga e pinte llullën e vet me opium. Devetë i kemi ushqyer me qullë nga elbi i

bluar trashë dhe i shtrimë rreth nesh në rreth. Tre gjandarë janë vënë në roje në grehinat e shtrira ranore sepse territori në të cilin jemi gjetur, në atë kohë, ka qenë fushëbetejë i sulmeve të rrepta të djajve shkretinorë, kalorësve fisnorë Balluçi nga jugu.

Ali-aga e pat thithur llullën e vet, piu çajin dhe edhe arakun e piu vetëm, sepse unë nuk isha i disponuar, kur ja, krismat e pushkëve ndërprejnë qetësinë e natës. Krisma e dytë e njërit prej rojtarëve tanë që iu përgjigj, e pastaj u dëgjua britmë diku në terr. Ibrahimimi, me praninë e madhe të shpirtit, menjëherë e mbuloi me rërë zjarrin. U dëgjua krisma në të gjitha anët. Rojtarët më nuk i kemi parë, vetëm mund të dëgjohej se si e thërrisnin njëri - tjetrin. Nuk e dinim sa sulmues janë sepse ishin pakëndshëm të heshtur. Vetëm herë-herë shkëlqimi i dobët i dritës nga pushka e zbulonte praninë e tyre; një apo dy herë kam mundur të vërej figura të veshura në të bardhë se si lëvizin në terr. Disa fishekë poshtë të kërshitur na fërfëlluan mbi kokat tona, por asnjë nuk na qëlloi. Rrëmuja dalëngadalë u qetësua, edhe disa predha i gëlltiti nata dhe kalorësit, qartë të hutuar me vigjilencën tonë, u zhdrukën pazëshëm sikur që patën ardhë.

Ali-aga ftoi rojat dhe mbajtëm një konsultim të shkurtër. Në fillim kishim për qëllim që natën ta kalojmë këtu; por pasi nuk kishim dije për fuqinë e sulmuesit, as a do të kthehet me përforcim, vendosëm që menjëherë ta ndërpresim kampimin e të nisemi.

Nata ishte e errët; retë e rënda e të ulta i fshihnin Hënën dhe yjet. Verës, sipas rregullit më mirë është të udhëtohet natën; por në rrethanat normale nuk do të ekspozoheshim rrezikut të ecim nëpër terrin e tillë, e të humbemi, sepse zhuri i fortë i Dashti-Lutit nuk mban kurrfarë gjurmash. Në kohët e lashta mbretërit iranianë i kanë shënuar rrugët e karvaneve në shkretëtirat e tilla me

shtylla të muratosura, por sikur edhe shumë gjëra të tjera të mira nga kohët e lashta, këto shenja tashmë kaheër qenë zhdukur. Në të vërtetë, ata tashmë kaheër nuk nevojiteshin; telat e telegrafit indo-evropian, që i kanë vënë britanikët në fillim të shekullit prej kufirit indus nëpër Dashi-Lut deri në Kirman, kanë shërbyer po ashtu mirë, apo madje edhe më mirë, si shenjëtregues; por natën, siç është kjo, as telat as shtyllat telegrafike nuk shihen.

Këtë e kemi zbuluar për tmerrin tonë kur pas përfërsisht gjysmë ore gjandari u ndal dhe turpshëm i lajmëron Ali-agës:

"Hazret, nuk mundem më ta shoh telin..."

Për një çasti të gjithë kemi mbetur pa fjalë. Kishte përse, e kemi ditur, vetëm përgjatë rrugës së shënuar me vijën telegrafike, e madje edhe këto kanë qenë në largësi të mëdha. Të humbesh këtu, do të thoshte të zhdukesh si karvani legjendar i Ahmedit...

Papritmas Ali-aga foli në mënyrën krejtësisht tjetërfare prej të zakonshmes; mundej lirisht të supozohej se araki dhe opiumi për këtë janë përgjegjës. Ai nxori pistoletën dhe ulëroi:

"Ku është teli? Përse e humbe telin, bir qeni? Ah, e di - ti je në marrëveshje me ata cubat dhe po përpiqesh që të na mashtrosh në mënyrë që të vdesim nga etja dhe kështu të bëhemi pre e lehtë!"

Kjo vërejtje gjithsesi ishte e padrejtë, sepse Balluçi kurrë nuk do ta tradhtonte njeriun me të cilin ka ngrënë bukë e kripë. Xhandarët tanë, qart të ofenduar me akuzën e togerit të tyre, na bindnin në pafajësinë e vet, por Ali-aga ndërhyri:

"Qetësi! Gjejeni menjëherë telin ose të gjithëve do t'ju mbys, bijtë e baballarëve të tërbuar!"

Nuk kam mundur t'i shoh fytyrat e tyre në terr, por kam mundur ta ndiej se si thellë ata, Balluçët e lirë, e

ndiejnë këtë fyerje; madje as nuk janë përpjekur të përgjigjen. Atëherë papritmas njëri prej tyre - deri para pak kohësh udhëheqësi ynë u nda prej grupit, e goditi deven me kamxhik dhe në galop u zhduk në terr.

"Ku?" - briti Ali-aga, por si përgjigje mori disa fjalë të pashkoqitura. Disa çaste mund të dëgjohej çukurmimi i butë i hapave të devesë, e pastaj zërat u fundosën në natë.

Përkundër bindjes sime, një çast më herët, për pafajësinë e gjandarëve Balluçi mendimi i pavendosur u fut në vetëdijen time: tash u shkoi cubave; Ali-aga megjithatë kishte të drejtë... E dëgjova se si Ali-aga shpengoi pistoletën e vet, kurse unë e bëra po atë. Ibrahim i ngadalë e hoqi karabinën e vet. Ishim të palëvizshëm në shala. Një nga devetë qetazi fërfëlloi, si duket kondaku i pushkës së ndonjë gjandari goditi për shalë. Kaluan minuta të gjata. Pothuajse mund të dëgjohej frymëmarrja e njerëzve. Pastaj, papritmas, depërtoi britma nga largësia e madhe. Mua m'u duk vetëm si "Ooo", por Balluçët sikur këtë e kuptuan dhe njëri prej tyre, duke i mbledhur shuplakat e tij para gojës, hutueshëm ia ktheu njëfarë britme në gjuhën brahmi. Prap ajo britma e largët. Njëri prej gjandarëve u kthye drejt Ali-agës dhe tha në persishte:

"Teli, hazret! E ka gjetur telin!"

Tendosi lëshoi. Me lehtësi, ndoqëm zërin e vëzhguesit të padukshëm që kohë pas kohe na orientonte. Kur erdhën deri tek ai, ai u drejtua në shalë dhe tregoi në terr:

"Ja teli."

Dhe vërtet, pas disa çastesh gati u ndeshëm me shtyllën telegrafike.

Gjëja e parë që Ali-aga e bëri ka qenë mjaft karakteristike për të. Ai e rrëmbeu ushtarin për brezi, e tërhoqi kah vetja dhe, duke u zgjatur përtej shalës, e puthi në të dy faqet:

"Unë, e jo ti, i biri qenit, vëllai im. Më fal..."

Mësuam se Balluçi, fëmijë i shkretëtirës, ka kalëruar sipas vijës zik-zake derisa nga largësia prej gjysmë miljes nuk e ka dëgjuar zukamën e telit në erë; zukamë që madje edhe tash, kur kam kaluar nën të, ka qenë pothuaj e pahetueshme për veshët e mi Evropianët...

Vazhduam ngadalë, me kujdes nëpër natën e errët, prej njëres deri te tjetra shtyllë telegrafike, njëri prej gjandarëve gjithnjë duke kalëruar përpara dhe duke britur çdoherë kur me dorë e prekte shtyllën. E gjetëm rrugën tonë dhe qemë të vendosur që më mos ta humbim.

Zgjohem nga ëndërrimi dhe i kthehem letrës si Ali-agës:

"Me avancimin për nënkolonel, ky personalitet modest është vendosur në gjeneral shtab; kjo, mik e vëlla i dashur, na pëlqen më shumë se sa jeta në garnizon në qytetin provincial..."

Jam i sigurt në këtë; Ali-aga gjithherë kishte prirje për jetë në kryeqytet dhe për intrigat e tij - veçan për intrigat politike. Dhe njëmend, në letrën e vet ai përshkruan atmosferën politike të Teheranit, ato përleshjet e pafund nën sipërfaqe, ato manovra të ngatërruara që fuqitë e huaja arrijnë me to aq gjatë ta mbajnë Iranin në gjendjen e shqetësimit që nuk i jep kombit të çuditshëm, të talentuar që të qëndrojnë në këmbë të veta.

"Pikërisht tash kemi kokëçarje me kompaninë angleze të naftës; bëhet trysni e madhe në qeverinë tuaj që ta vazhdojë kontratën për koncesion dhe kështu ta vazhdojë robërinë tonë. Bazarët janë të shqetësuar dhe vetë Zoti e di ku do të shpie tërë kjo..."

Bazari gjithnjë e ka luajtur rolin më të rëndësishëm në jetën politike të vendeve lindore; kjo veçan vlen për bazarin teheranas në të cilin zemra e fshehur e Iranit rrahë me këmbëngulësi që i kundërvihet çdo fatkeqësie kombëtare dhe tërë kalueshmërisë së kohës. Ndërmjet

rreshtave të letrës së Ali-agës ky bazar i madh, gati qytet vetë për vete, përsëri paraqitet para syve të mi aq gjallë sikur tek dje e kam parë: labirinti i errët gjerë i shpërndarë e korridoreve dhe kalimeve të mbuluara me qemer me harqe të thepisura. Në rrugën kryesore, mu krahas qepengave të vogla, të errëta përplot gjësende të lira, gjenden portiçet e mbuluara me dritare në tavan, dyqanet në të cilat shiten mëndafshet më të shtrenjta Evropiane dhe aziatike; përbri punëtorisë së litarpunuesit bokset e qelquara përplot punë të rafinuar filigrani; tekstili i larëm nga Buhara dhe India i përzier me qilimët e rrallë persianë - qilimët e gjahtarëve me figurat e kalorësve në kuaj, luajt, leopardat, pavodët dhe antilopat; gjerdanët nga margaritarët e qelqtë dhe ndezësi automatik pranë makinave qepëse; ombrellat e vrazhda të zeza menjëherë pranë fustanit të qëndisur nga lëkura e deleve nga Horosani: të gjitha të grumbulluara në këtë korridor jashtëzakonisht të gjatë sikur në ndonjë vitrinë të madhe dhe jo krejtësisht me kujdes të aranzhuar.

Në rrugicat e shumta dytësore të kësaj pune të ngatërruar dore dhe tregtie, dyqanet janë të grupëzuara sipas zejeve. Këtu shihni rendin e gjatë të shalaxhinjve dhe punëtorët e lëkurës, ngjyra dominuese është e kuqe, kurse era e tharët e lëkurës së ngjyrosur e përshkon ajrin. Këtu janë rrobaqepësit; nga çdo nishë (separe) - sepse shumica e duqaneve përbëhet prej një të vetmes nishë me rreth tre ose katër metra katrorë sipërfaqe - dëgjohet zukama e makinave qepëse; halitë e gjata janë varur për shitje, gjithnjë të njëjtat hali - ashtu që derisa shëtisim nganjëherë mendoni se nuk po lëvizni. Përshtypje të njëjtë kemi edhe në shumë pjesë tjera të bazarit; megjithatë, shumësia e njëllojësisë në secilin vend të veçantë nuk ka asgjë të përbashkët me monotoninë; kjo e helmon të huajin dhe e përmbushë me ndjenjën e pakënd-

shme të kënaqësisë. Madje nëse e vizitoni bazarin edhe të njëmijtënherë, ju gjithnjë gjeni rreth vetes disponimin e njëjtë, në dukje të pandryshueshmë - por ky është ai mosndryshimi pashtershëm, vezullues i valës së detit që gjithherë e ndryshon formën e vet, por e ruan thelbin e vet të pandërruar.

Bazari i argjendarëve: ky është orkestër i zileve të bronzës, çekanëve të vrullshëm që nga bakri, bronza e mesingu rrahin format më të llojlojshme, duke i shndërruar pllakat e paforma metalike në enë, vorba e kupa. Çfarë sigurie akustike në këtë trokitje me temp të ndryshueshmë përgjatë tërë bazarit - çdo njeri i përshtatet ritmit të të tjerëve kështu që nuk guxon të ketë kurrfarë disonance në vesh: njëqind punëtorë godasin në objektet e ndryshme në dyqane të ndryshme - por në tërë rrugën e bazarit vetëm një melodi... Në këtë dëshirë të thellë, më tepër se vetëm muzikore, pothuaj shoqërore për harmoni paraqitet dashuria e fshehtë e shpirtit iranian.

Bazari i erurinave: aletë e heshtura të kohës së sheqerit të bardhë, thasëve të orizit, grumbulli i bademeve dhe xhinave, lejthijave dhe farave, enët përplotë kajsia dhe xhenxhefilë të tharë, tepsi prej mesingu përplot kanella, kari, piperë, safranë dhe farë hashishi, përplot enë të vogla me farë anasoni, vanile, bishtadhelpse, karanfila dhe barëra e rrënjë të çuditshme të shumta që i lëshon aroma e rëndë, dehëse. Pas peshoreve të shkëlqyeshme prej mesingu janë të ulur, këmbëmbledhur, sunduesit e kësaj çudie, si të marrë, kohë pas kohe thirrin me gjysmëzëri kalimtarët duke pyetur për dëshirat e tyre. Mbarë kuvendimi këtu është vetëm pëshpëritja; nuk mund të jesh i zëshëm atje ku sheqeri ngadalë derdhet nga thesi në enë në peshojë dhe nuk mund të jesh i zëshëm atje ku peshohet fara e trumzës dhe anasonit... Ky është po ai adaptim i njëjtë i karaktereve të materialeve

që i mundëson iranianit që të thurë qilima të çmueshëm prej peyzave të panumërt të ngjyrosur prej leshi - pe pas peri, një pjesë e centimetrit pas pjesës së centimetrit - derisa i tëri nuk paraqitet në përsosurinë e vet joshëse. Nuk është e rastit që qilimët persianë nuk kanë të barabartë me veten në botë. Ku mund të gjendet kjo qetësi e thellë, ky kujdes dhe thellësi në punën e vet? - ku tjetërkund thellësitë e tilla të errëta të syve për të cilët koha dhe kalimi i kohës kanë domethënie aq të paktë?

Në separe, diç më të mëdha se rëndom, janë të ulur piktorët e heshtur të miniaturave. Ata i kopjojnë miniaturat e vjetra nga librat e shkruar me dorë të cilët tashmë kaheerë janë të grisur, duke vizatuar jashtëzakonisht me vija dhe ngjyra të rafinuara gjëra të mëdha të jetës: luftërat dhe gjuetinë, dashurinë, fatin dhe dëshpërimin. Brushat e tyre janë të bukura e të holla sikur pejëza; ngjyrat nuk u dorëzohen enëzave të pajetë por përzihen në shuplakën e gjallë të piktorit dhe i klasifikojnë në kohët dhe pikëzat e imta në gishtat e dorës së majtë. Në faqet e reja, të bardha e pa njolla, miniaturat e vjetra përjetojnë lindje të re, potez pas potezi, hije pas hije. Paralelisht me prapavitë e arta të origjinalit që qërohen mbijnë kopjet e shkëlqyeshme. Trupat e zvenitur të portokajve në kopshtin mbretëror sërish lulëzojnë në pranverën e re; femrat e njoma në mëndafsh dhe gëzofa edhe një herë i përsërisin lëvizjet e veta të dashura; sërish lindet Dielli mbi lojën e vjetër kalorsiake polo... Veprim pas veprimi, hije pas hije këta njerëz të heshtur ndjekin përjetimin krijues të artistit të vdekur, kurse tek ata ka po aq dashuri sa ka pasur mallëngjim në të; kjo dashuri ju detyron që gati ta harroni mospërkryeshmërinë e kopjeve...

Koha kalon, kurse miniaturistët janë të ulur mbi punën e vet, duke mos e hetuar ditën. Koha kalon; në rrugët e bazarit depërton malli i pavlerë perëndimor, de-

përton në dyqane me shkallërinë këmbëngulëse; llambat e gazit nga Çikago, pëlhura e shtypur e pambukut nga Mançesteri dhe çajnikët nga Çekosllovakia përparojnë triumfalisht; por miniaturistët rrinë ulur me këmbë të mbledhura në hasurat e rrjepura të kashtës duke u thelluar me sytë e ëmbël dhe me majet e gishtërinjve në haretë e vjetra dhe u japin ngadhënjimeve të tyre gjahtarë mbretërore dhe dashnorëve të entuziazmuar zgjim të ri, ditë për ditë...

Ka shumë popull në bazar: zotërinjtë e lartë me kravatat Evropiane dhe shpesh duke e tërhequr abajën arabe mbi rrobat Evropiane ose gjysëmEvropiane, qytetarët konservativë në kaftanë të gjatë dhe brezat e mëndafshhtë, fshatarët dhe zejtarët me pallto të kaltra ose të gështenjtë të përhimtë. Dervishët që këndojnë - lypësit aristokratë të Iranit - në rroba të bardha, valëvitëse, nganjëherë me lëkurën e leopardit mbi shpinë, me flokë të gjata dhe në të shumtën mirë të zhvilluar. Femrat e klasës së mesme, në pajtim me mundësitë e veta, janë të veshura me mëndafsh ose pambuk, por gjithnjë në të zezë, me velin tradicional të shkurtë teheranas që vrazhdë qëndron para fytyrave të tyre; më të varfërat bartin guna të pambukta të ngjyrave të çela me lule. Mullatë e vjetër udhëtojnë të hipur në gomarët dhe mushkat madhërisht të dekoruara dhe në të huajin e drejtojnë shikimin fanatik sikur e pyesin: "Ç`punon ti këtu? A je ti një nga ata që punojnë në rrënimin e vendit tonë?"

Përvoja e gjatë iraniane me intrigat perëndimore e ka bërë popullin të dyshimtë. Asnjë iranian njëmend nuk pret kurrfarë të mirë që do t'i vinte vendit të tij nga të huajt. Mirëpo, Ali-aga sikur nuk ishte pesimist i tepruar:

"Irani është i vjetër - por assesi ende nuk është i gatshëm të vdesë. Shpesh na kanë shtypur. Shumë popuj na kanë shkelur dhe të gjithë ata janë zhdukur, kurse ne

kemi mbetur të gjallë. Të varfër e të shfrytëzuar, në padije dhe terr, por mbesim të gjallë. Kjo është për atë që ne iranianët gjithnjë shkojmë rrugës sonë vetjake. Sa herë bota e jashtme ka tentuar që të na imponojë mënyrën e re të jetesës - por kurrë nuk ka pasur sukses. Ne nuk u kundërvihemi fuqive të jashtme me dhunë dhe për këtë nganjëherë mund të duket sikur jemi dorëzuar. Por ne jemi fis i murenëve - atij bubreccit të vogël, të parëndësishëm që jeton nën mure. Ju, dritë e zemrës sime dikur në Iran keni parë se si shtëpitë mirë të ndërtuara me mure të forta befaz rrënohen pa ndonjë shkak të qartë. Ç'është shkak i kësaj? Vetëm ata buburrecat e imtë që me vite, me zellin e pazvogëluar, kanë hapur vrimat, kalimet dhe vrimat në themele, gjithnjë duke përparuar vetëm për një trashësi të qimes, ngadalë durueshëm, në të gjitha drejtëmet - derisa më në fund muret nuk e humbin baraspeshën dhe rrënohen. Ne iranianët jemi buburreca të tillë. Ne nuk u kundërvihemi fuqive botërore me dhunën e zëshme e të padobishme, por u lejojmë të punojnë më së keqi që munden, kurse në heshtje i gropojmë kalimet dhe vrimat tona derisa një ditë ndërtesa e tyre befasisht nuk rrënohet...

A keni parë ç'po ndodh kur e hedhni gurin në ujë? Guri fundoset, disa rrathë paraqiten në sipërfaqe, zgjerohen dhe shkallërisht humben derisa uji të qetësohet sikur edhe më parë. Ne iranianët jemi uji i tillë.

Shahu, Zoti e ruajt, duhet të bartë barrë të rëndë, me anglezët nga një anë, dhe me rusët nga ana tjetër. Por ne nuk dyshojmë që, me mëshirën e Zotit, do ta gjejë rrugën ta shpëtojë Iranin..."

Besimi i verbër i Ali-agës në Riza-shahun nuk duket, në shikim të parë, i pavend. Ai është, pa dyshim, njëri prej personaliteteve më dinamike që kurdoherë i kam ta-

kuar në botën muslimane, kurse nga të gjithë mbretërit që i njoh, vetëm Ibn Saudi mund të krahasohet me të.

Tregimi për ngjitjen e Riza-shahut në pushtet ngjason në përrallëzën fantastike, të mundur vetëm në Lindje ku guximi personal dhe fuqia e vullnetit mund nganjëherë ta ngrejë njeriun nga anonimiteti skajor deri në kulm të udhëheqjes. Kur e kam njoftuar gjatë kohës së qëndrimit tim të parë në Teheran në verë të 1924, ai ka qenë kryetar qeverie dhe diktator i pakontestueshëm i Iranit, por njerëzit ende nuk e kishin ngadhënjyer krejtësisht frikën duke e parë se si po lajmërohet aq befasisht, aq papritur në krye të punëve shtetërore. Ende më kujtohet habia me të cilën një iranian i vjetër, nëpunës në ambasadën gjermane në Teheran, njëherë më ka thënë: "A e dini se vetëm dhjetë vjet më parë ky kryetari ynë i qeverisë ka ruajtur rojen si ushtar i thjeshtë para dyerve pikërisht të kësaj ambasade? Dhe se edhe vetë nganjëherë ia kam dhënë letrën që t'ia dorëzojë ministrit të punëve të jashtme dhe e kam qortuar. Ngutu, biri qenit, dhe mos u sorollat nëpër bazar...!"

Po, nuk ka qenë kaherë kur Riza - ushtar ka shërbyer si roje para ambasadave dhe ndërtesave publike të Teheranit. Mund ta mendojë se si qëndron atje në uniformë të vjetruar të brigadës kalorsiake iraniane, duke u mbështetur në pushkën e vet dhe duke vrojtuar në jetë në rrugët rreth vetes. I shikoja persianët se si zvarriten rrugëve si hije ëndërruese ose ulen në freskinë e parambrëmjes përgjatë kanalit për ujitje sikur që edhe unë i kam shikuar. Nga banka angleze pas tij e dëgjoja goditjen e makinës së shkrimit, vërsuljen e njerëzve afaristë, gjithë ajo përzjerje e zëshme që Evropa e largët i ka sjellë në atë ndërtesën teheranase me fasadën e saj në pllakat e kaltra të qeramikës. Ka mundur kjo të jetë atëherë që përherë të parë të paraqitet (këtë askush s'ma ka thënë por disi mendoj se kjo është dashur të jetë kështu) në

kohën e pashkolluar të ushtarit Riza mendimi me habi në pyetjen: "A duhet të jetë kjo kështu...? A duhet të jetë që njerëzit e kombeve tjera të punojnë e përpiqen, derisa jeta jonë rrjedh sikur ëndërr?"

Mbase mu në këtë çast dëshira për ndryshim - lëvizës i të gjitha veprave, zbulimeve dhe revolucioneve të mëdha - ka filluar të shkëlqejë në trurin e tij, që në mënyrë memece të kërkojë shprehje...

Me një rast tjetër ai ka mundur ta ruajë rojen para portës së kopshtit të ndonjë ambasade të madhe Evropiane. Kurorë e drurit mirë të kultivuar i lëkundte era, kurse shtigjet e shtruara me zhur krikëllonin nën këmbët e shërbëtorëve të veshur në të bardhë. Në atë shtëpi midis parkut sikur qëndronte ndonjë forcë misterioze; ajo do të frikësonte çdo iranian që do të kalonte nëpër portë dhe e detyronte që, në kokëçarje, t'i rregullojë petkat e veta dhe që në hutueshmërinë e ngathtë, mos të dijë ç'ka në duart e veta. Nganjëherë karrocet elegante afroshin, kurse politikanët iranianë dilnin nga ato. Ushtari Riza njihnte shumë prej tyre nga pamja: ky është ministër i punëve të jashtme, ai është ministër i financave. Gati gjithnjë i kanë pasur fytyrat e tendosura, të brengosura kur dilnin në portë dhe ishte argëtuese të kundroheshet çehreja e tyre kur e lëshonin ambasadën: herë-herë të zbehtë e të dekurajuar, sikur pikërisht iu qe shqiptuar vendimi për vdekje. Ushtari Riza pyetej: "A duhet medoemos kjo të jetë kështu...?"

Nganjëherë nëpunësi iranian do të ngaredte nga ndërtesa para së cilës Riza mbante roje, ia shtynte letrën në dorë dhe i thoshte: "Çoje shpejt këtu e këtu. Por ngutu, bir qeni, sepse përndryshe ambasadori do të zemërohet!", Riza që mësuar që ashtu t'i drejtohen, sepse as oficerët e tij vetjakë nuk kanë qenë fare të kujdesshëm në epitete. Por sigurisht - jo, fjalët "bir qeni" i ka ndier si

shpim të nënçmimit, sepse e ka ditur: ai nuk ka qenë bir qeni por bir i kombit të madh që dinte emrat sikur që janë Rrustem, Darius, Nashirvan, Kej Kosru, Shah Abas, Nadir-shah. Por ç`kanë ditur ata brenda për këtë? Ç`kanë ditur ata për fuqitë që lëvizin si rrjedha e errët, memece në kraharorin e ushtarit dyzetvjeçar dhe nganjëherë i kërcënohen që t`ia thyejnë brinjët dhe ta detyrojnë që t`i kafshojë grushtat e vet në dëshpërimin e pandihmë. "Oh, sikur vetëm të mundja...?"

Dëshira për vetëkonfirmim që me rënkim e përshkon çdo iranian nganjëherë ngrihet me rreptësinë e dhembshme, të papritur në ushtarin Riza, e kthjellon mendjen e tij dhe i zbulon forma të çuditshme në çdo gjë çka sheh...

Lufta e madhe ka mbaruar. Pas revolucionit bolshevik, trupat ruse, që më herët e patën okupuar Iranin Vërior, janë tërhequr; por menjëherë pas kësaj shpërthen kryengritja komuniste në krahinën iraniane Gilan në Detin Kaspik, të udhëhequr me Kuçuk-kanin influencues dhe të ndihmuar me njësitet e rregullta ruse në tokë dhe det. Qeveria i dërgoi trupat kundër kryengritësve, por ushtarët e padisiplinuar dhe dobët të përgatitur iranianë pësonin humbje pas humbjes; as batalioni në të cilin ishte kapterri Riza, atëherë gati pesëdhjetëvjeçar, nuk bënte përjashtim. Por, njëherë, kur njësi i tij që detyruar në ikje pas një përlëshjeje të pafatshme, Riza më nuk mund të përmbahet. Ai doli në radhët e thyera dhe briti në mënyrë që të gjithë të mund ta dëgjojnë: "Përse ikni, o iranianë - o iranianë!" Duhet të ketë ndier njëjtë çka edhe Karlo XII suedez kur ishte shtrirë i plagosur në fushë në vendin Palltave dhe i shihte ushtarët e vet se si pakrye ikin dhe i ka ftuar me zë dekurajues: "Përse ikni, suedezë - o suedezë!" Por dallimi është në atë që mbreti Karlo derdhte gjak nga shumë varrë dhe nuk dispononte

me asgjë pos zërit të vet, derisa ushtari Riza ishte i palënduar dhe e kishte në dorë pistoletën mauzer të mbushur - kurse zëri i tij ishte i fuqishëm dhe kërcënues derisa i qortonte shokët e vet: "Kushdo që dëshiron të ikë, do ta mbysë - qoftë edhe vëllai im!"

Paraqitja e tillë ishte diç e re për trupat iraniane. Konfuzionin e tyre e ndërroi çuditja. U bënë kureshtarë: ç`do të mund të kishte në mendje ky njeri? Disa oficerë protestuan duke dëftuar në pashpresën e pozitës së tyre; njëri prej tyre u përqesh: "Mos, mbase, ti do të na udhëheqësh në fitore?" Në atë çast ndoshta Riza u çlirua nga të gjitha dëshpërimet e viteve të veta të mëhershme, kurse të gjitha shpresat e tij të fshehta papritmas shkëlqyen. E shihte skajin e litarit magjik para vetes dhe e kapì. "E pranoj!" - briti dhe u kthye para ushtarëve: "A më pranoi për udhëheqës tuajin?"

Në asnjë komb kulti i heroit nuk është i rrënjosur aq thellë sikur në atë iranian, kurse ky njeriu këtu dukej hero. Ushtarët harruan frikën dhe ikjen e vet dhe me mallëngjim britën: "Ti do të jesh udhëheqësi ynë!" - "Ashtu qoftë", - u përgjigj Riza, "unë do t'u udhëheqi dhe do ta vrasë çdonjërin kush tenton të ikë!" Por askush më nuk mendonte për ikjen. Ata i hodhën strajcat e papërshtatshme, i ngjitën bajonetat në pushkët e veta dhe nën udhëheqjen e Rizës tërë batalioni u kthye dhe në sulmin e befasishtëm e robëroi baterinë ruse, i tërhoqi njësitet tjera iraniane me vete, e shkeli armikun - ashtu që beteja pas disa orëve qe vendosur në dobi të iranianëve.

Disa ditë pas kësaj telegrami nga Teherani e ngriti Rizën në gradë kapiteni, ashtu që tash ka mundur pranë emrit të vet ta shtojë titullin kan.

Ai e pat kapur skajin e litarit dhe me të ngjitej. Emri i tij papritmas u bë i dëgjuar. Në rrjedhën e shpejtë ai u bë major, kolonel, brigadier. Në vitin 1921, së bashku

me gazetarin e ri Zijau'd-Dinin dhe tre oficerë, bëri grusht shtet, e burgosi kabinetin e korrumpuar dhe, me ndihmën e brigadës së vet besnike, e detyroi Shah Ahmedin e ri të dobët e të butë që ta emërojë kabinetin e ri: Zijau'd-Dini u bë kryetar qeverie, kurse Riza-kani ministër luftime. Nuk dinte as të lexojë as të shkruajë. Por ai ka qenë si xhind në fushatën e vet për pushtet. U bë idhull i armatës dhe popullit, që tash, për herë të parë pas shekujve, e shihte njeriun para vetes: udhëheqësin.

Në historinë politike të Iranit skenat ndryshojnë shpejt. Zijau'd-Dini zhduket nga skena dhe paraqitet si refugjatë në Evropë. Riza-kani mbetet - si kryetar qeverie. Flitej ato ditë në Teheran se Riza-kani, Zijau'd-Dini dhe vëllai më i ri i Shahut, trashëgimtari i fronit, hartuan intrigën ta heqin shahun nga froni; pëshpëritej se - askush deri sot s'ë di a është kjo e saktë - në çastin e fundit Riza-kani i ka tradhtuar miqtë e vet te Shahu që mos ta rrezikojë ardhmërinë e vet në ndërrmarrjen aq të dyshimtë. Por sidoqoftë, kjo është e vërtetë ose jo, së shpejti pas kësaj kryetari i qeverisë Riza-kani e ka këshilluar shokun e ri Ahmedin të udhëtojë në Evropë. E ka përcjellë me pompozitet të madh me automobila deri te kufiri i Irakut dhe tregohet se i ka thënë: "Nëse ekselencja Juaj kurdoherë kthehet në Iran, do të mund të thoni që Riza-kani nuk kupton asgjë nga kjo botë".

Nuk ka dashur ta ndajë pushtetin me askë; ka qenë real ndonëse i pazgjedhur, zotëriu i vetëm i Iranit. Si ujk u uritur u hodh në punë. Mbarë Iranin duhej reformuar prej kreut deri në fund. Deri atëherë administrata e plogshhtë është centralizuar; sistemi i vjetër i qiradhënies së krahinave të tëra ofertdhënësit më të favorshëm me qëllim të tubimit të të ardhurave, është hequr; guvernatorët pushuan të jenë mëkëmbës dhe u bënë nëpunës. Armata, sugari i diktatorit, është riorganizuar sipas mo-

deleve perëndimore. Riza-kani ka filluar fushatën kundër kryeparëve arbitrare fisnore të cilët më herët janë konsideruar mbretër të vegjël dhe shpesh kanë refuzuar që t'i nënshtrohen qeverisë në Teheran; ka qeruar hesapet vendosmërisht me cubat që me dhjetëvjeçarë të tërë kanë terrorizuar popullatën jashtë qyteteve. Është vendosur njëfarë rendi në financat shtetërore me ndihmën e një këshilltari amerikan; të ardhurat nga tatimi dhe dogana kanë filluar rregullisht të arrijnë. U lind rendi nga kaosi. Si jehonë e lëvizjes turke kemaliste, në Iran u paraqit ideja republikane, së pari si pëshpëritje, pastaj si kërkesë e elementeve përparimtare të popullsisë dhe, më në fund, si synim i hapur i vetë diktatorit. Por këtu, si duket, Riza-kani gaboi në vlerësim; u paraqit protestë e fuqishme e masave iraniane.

Kundërshtimi i popullit ndaj synimeve republikane nuk ishte pasojë e çfarëdo dashurie ndaj shtëpisë sunduese, sepse askush në Iran nuk ka ndier shumë ndaj dinastisë Kaxhar që gjithnjë - për shkak të prejardhjes së vet turkmene - është konsideruar e "huaj"; nuk ishte kjo as pasojë e çfarëdo prirjeje sentimentale ndaj fytyrës së rrumbullakët, fëmijërore të Shah Ahmedit. Ka qenë kjo diç krejtësisht tjetërfare: frika e popullit që mos ta humbë fenë e vet ashtu siç e humbën turqit fenë e tyre në revolucionin e Ataturkut. Në mosdijen e vet, iranianët nuk e kuptuan menjëherë që forma republikane e sundimit shumë më tepër do t'i përgjigjej botëkuptimit islam se sa monarkia; të udhëhequr me konservatorizmin e liderëve të vet fetarë - e ndoshta me arsye të frikësuar me admirimin e hapur të Riza-kanit ndaj Kemal Ataturkut - iranianët në propozimin e tij kanë ndier kërcënim për Islamin si forcë kryesore në vend.

Hutia e madhe ka kapluar popullatën qytetare, sidomos në Teheran. Turma e tërbuar, e armatosur me

shkopinj e gurë, u tubua para ndërtesës në të cilën ishte zyra e Riza-kanit dhe filloi ta shajë dhe t'i kërcënohet diktatorit që deri dje ka qenë gjysmëzot. Ndihmësit e Riza-kanit e kanë këshilluar që të mos dalë para se të ulet shqetësimi, por ai kaloi mbi këtë dhe, i përcjellë vetëm nga një ushtar, plotësisht i paarmatosur e lëshoi zyrën në karrocën e mbyllur. Posa karroca u paraqit në portë, turma i grabiti frerët dhe i ndali kuajt. Disa i hapën dyert e karrocës. "Nxirre, nxirre këtu në rrugë!" Por ai tashmë vetë kishte dalë, me fytyrë të përhimtë prej tërbimit dhe filloi t'i godasë nëpër koka e supe ata rreth vetes me kamxhikun e vet. "Bijtë e qenit", shporruni që këtej! Si keni guxim! Unë jam Riza-kani! Shkoni te gratë e juaja dhe shtretërit e juaj!" Dhe turma e tërbuar, që vetëm para disa minutave i është kërcënuar me vdekje dhe rrënim, u hesht në takimin me guximin personal; të gjithë u tërhoqën, u shpërndanë, një nga një, dhe u humbën në rrugët skajore. Edhe një herë udhëheqësi i madh i foli popullit të vet; ai ka folur me zemërim dhe populli u frikësua. Ndoshta pikërisht në atë çast ndenja e urrejtjes e ka thyer dashurinë e Riza-kanit për popullin e vet dhe përgjithmonë e ka errësuar.

Edhe përkundër suksesit të Riza-kanit, republika nuk është sendërtuar. Thyerja e planit të tij qartë ka dëftuar që fuqia ushtarake vetvetiu nuk mund të sjellë deri te "lëvizja reformatore" kundër rezistencës së popullit. Kjo nuk do të thotë se iranianët ishin kundër reformës si të tillë, por ata instinktivisht kanë ndier se doktrina politike e importuar perëndimore, do të thoshte fund i të gjitha shpresave se kurdoherë do të arrihet zhvillim i shëndoshë në kontekst të kulturës dhe religjionit të tyre vetjak.

Riza-kani këtë nuk e kuptonte, as atëherë as kurdoherë, dhe për këtë arsye është tëhuajësuar nga populli i vet. Dashuria e tij ndaj tij u zhduk dhe dalëngadalë e zë-

vendësoi urrejtja përplot frikë. Filluan të pyesin: ç'ka bërë, në realitet, ky hero për vendin e vet? I kanë numëruar të arriturat e Riza-kanit: riorganizimi i armatës - por me çmimin e shpenzimeve të tmerrshme që kanë kaluar si barrë e padurueshme e tatimit në popullin tashmë të varfëruar; janë thyer trazirat fisnore - por janë thyer edhe patriotët; aktiviteti i dukshëm ndërtimor në Teheran - por edhe mjerimi gjithnjë në rritje ndër fshatarët. Populli ka filluar të kujtohet se vetëm disa vjet më parë Riza-kani ka qenë ushtar i thjeshtë - tash ishte njeriu më i pasur në Iran, me juta të panumërta të tokës në pronësi të vet. A janë ato "reformat" për të cilat aq ka folur? A mos disa ndërtesa të shkëlqyeshme zyrtare në Teheran dhe hotelet luksoze që janë paraqitur aty - këtu nën ndikimin e diktatorit vërtet kanë paraqitur çfarëdo përmirësimi të fatit të popullit?

Pikërisht në këtë çast të karrierës së tij e kam njohur Riza-kanin. Çfarëdo të jenë thashethemet për ambiciet e tij personale dhe gjoja egoizmin, nuk kam mund që të mos e pranoj madhërinë e njeriut nga çasti kur për herë të parë më pranoi në zyren e tij të ministrit të luftës. Kjo ka qenë ndoshta zyra më e thjeshtë që e ka pasur ndonjë kryetar qeverie kudo dhe kurdo. Tavolina, sofa e mbuluar me pëlhurë të lyer me dyllë, disa karrige, rafti i vogël me libra, qilimi i bukur por modest në dyshe me ishte krejt çka përmbante ajo dhomë; njeriu i lartë fuqishëm i zhvilluar i viteve të pesëdhjeta që u ngrit pas tavolinës që i veshur në uniformë të thjeshtë të përhimtë të gjelbër, pa kurrfarë medalionesh, kordelesh ose shenjash të gradës së vet.

Më prezentoj ambasadori gjerman, konti fon Shulenbergu (sepse edhe pse isha austriak, e përfaqësoja gazetën e madhe gjermane). Madje edhe gjatë kohës së asaj bisede të parë formale u bëra i vetëdijshëm për dinamizi-

min e errët të natyrës së Riza-kanit. Nën vetullat e thijnjura, të forta më shikonte çifti i syve të rreptë, gështenjë - sy persianë që rëndom i mbulojnë vetullat e rënda: përzierje e çuditshme e melankolisë dhe rreptësisë. Rreth hundës dhe gojës së tij ishin tiparet e hidhura, por shprehja e fytyrës së fortë, të ashtë ofronte forcën e jashtëzakonshme të vullnetit që buzët i mbante të mbyllura, kurse nofullën të fryrë. Kur e dëgjoni zërin e tij të thellë, mirë të modular - zërin e njeriut të mësuar të flasë fjalë të rëndësishme dhe ta peshojë secilën prej tyre në gjuhë para se t'i lejojë të artikullohet - do të mendoni se po e dëgjoni njeriun me tridhjetë vjet përvojë të oficerit të shtabit dhe me prejardhje të dinjitetit të lartë; mezi do të besoni se vetëm para gjashtë vjetësh Riza-kani ka qenë kapterr dhe se ka mësuar të lexojë e të shkruajë vetëm tre vjet më parë.

Është dashur ta ketë ndier interesimin tim për të - e ndoshta edhe simpatinë time ndaj popullit të tij - sepse ka insistuar që kjo intervistë mos të jetë e fundit dhe më ftoi, sikur edhe Shulenbergun, në çaj javën e ardhshme në rezidencën e vet verore Sherman, midis kopshteve të shkëlqyeshme, disa kilometra jashtë Teheranit.

U mora vesh me Shulenbergun që së pari të vijë tek ai (si shumica e përfaqësuesve të huaj ai verën e ka kaluar në Sherman) dhe që së bashku të shkojmë në rezidencën e kryetarit të qeverisë. Por, ndodhi që nuk arrita të shkoj në kohë. Disa ditë më parë pata blerë karrocën e vogël për gjah në katër rrota me dy kuaj të gjallë. Sa të gjallë kanë qenë u bë plotësisht e qartë disa kilometra jashtë Teheranit kur ata, duke ndjekur njëfarë tabiati të keq, refuzuan të ecin përpara dhe gjithnjë përpiqeshin që të kthehen në shtëpi. Rreth njëzet minuta u përpoqa me ta, më në fund, e lashë Ibrahimin t'i dërgojë kuajt dhe karrocën në shtëpi, kurse u nisa në këmbë duke kërkuar

ndonjë mjet tjetër për transport. Ecja në këmbë prej tre kilometrash më solli deri te një fshat ku për fat gjeta një qerre me dy rrota, por kur arrita në ambasadën gjermane, tashmë kishte kaluar më shumë se një orë e gjysmë nga koha e caktuar. E gjeta Shulenbergun se si hapëron lart-poshtë nëpër zyrën e vet si tigër i çartur, pa dashamirësinë e vet të rëndomtë; për ndjenjën e tij prusiake të ambasadorit të disiplinës, cenimi i tillë i saktësisë ka qenë sakrilegj i vërtetë. Në shfaqjen time shpërtheu me zemërim:

"Nuk mundeni - ju nuk guxoni këtë t'ia bëni një kryetari qeverie! A keni harruar se Riza-kani është diktator dhe se, sikur edhe të gjithë diktatorët, është mjaft i ndijshëm?"

"Kuajt e m'i si duket e kanë parashikuar këtë rrethanë të rëndësishme, kont Shulenberg", - ishte përgjigjja ime e vetme. - "Madje kjo, sikur të kishte të bënte edhe me mbretin kinez, nuk do të isha në gjendje të arrijë fare më herët".

Në këtë grofit iu kthye prireja e tij për humor dhe plasi në qeshje të zëshme:

"Për Zotin, diç kësisoj kurrë nuk më ka ndodhur më parë! Të shkojmë tash - dhe të shpresojmë se nuk do të na i përplasë dyert para hundës..."

Dhe nuk i përplasi. Kur arritëm në pallatin e Riza-kanit, koha e çajit tashmë ka herë pat kaluar dhe të gjithë musafirët patën shkuar, por nuk dukej se diktatori fare është fyer me thyerjen time të protokollit. Pasi i dëgjoi arsyet për vonesën time, ai briti:

"Po, unë do të dëshiroja t'i shoh ata kuajt tu! Mendoj se ata duhet t'i takojnë partisë opozicionale. Nuk e di a do të ishte e urtë t'i mbyll në burg!"

Vonesa ime më shumë i ndihmoi se sa vështirësoi vënies së lidhjeve të lehta, joformale ndërmjet kryetarit të plotfuqishëm të qeverisë së Iranit dhe gazetarit të ri,

që më vonë më ka mundësuar që nëpër vend të lëvizë me liri më të madhe se që i është ofruar shumicës së të huajve të tjerë.

Mirëpo, letra e Ali-agës nuk ka të bëjë me Riza-kanin e atyre ditëve të hershme, njeriun që ka jetuar gati me thjeshtësinë e pabesueshme në Iran ku aq dëshirohet shkapërderdhja ajo ka të bëjë me Riza Shah Pahllavin, që e trashëgoi fronin në vitin 1925; ajo ka të bëjë me mbretin që ka hequr dorë nga çdo rrenë e modestisë dhe tash dëshiron që të shëmbëllet në Kemal Atatürkun në ndërtimin e fasadës së pavlerë perëndimore në vendin e vjetër lindor...

Vij në fund të letrës:

"Edhe pse, mik i dashur, tash jeni në Qytetin e shejtit të Pejgamberit, besojmë se nuk e keni harruar as që kurrë do ta harroni mikun tuaj të pavlefshëm dhe vendin e tij..."

O, Ali-aga, mik i ditëve të rinisë sime - "dritë e zemrës sime", siç do ta thoshte këtë ai vetë - letra jote më ka dehur me kujtime: i dehur me Persinë çfarë kam qenë kur kam filluar ta njoh vendin tënd, ai margaritari i vjetër, i errët i vënë në kornizë të arit të vjetër dhe mermerit të pëlcitur, pluhrave dhe hijeve - hijeve të të gjitha ditëve dhe netëve të vendit tënd melankolik dhe syve të mbyllur, të përgjumshëm të popullit tënd...

Ende më kujtohet Kirmanshahi, qyteti i parë iranian që e kam parë Pasi i kam lëshuar malet e Kurdistanit. Atmosfera e çuditshme e zbehur, e patejdukshme shtrihet rreth tij, e asfiksuar, e zbutur - të mos them e mjerë. Pa dyshim, në çdo qytet lindor varfëria gjendet krejtësisht në sipërfaqe, shumë më pashëm se në cilindo qytet evropian - por në këtë tashmë kam qenë mësuar. Nuk ka qenë kjo vetëm varfëri në aspektin ekonomik që më ka goditur, sepse Kirmanshahu ka qenë, thonë, qytet përpa-

rimtar. Ka qenë ky një lloj dekurajimi që e shtyp popullin, diç që ka qenë drejtpërdrejt e lidhur me të dhe duket se mezi ka çkado me rrethanat ekonomike.

Të gjithë këta njerëz kanë sy të mëdhenj, të zinj, të shtrënguar me kapakë të rëndë syri sikur me vel, nën vetulla të dendura, të zeza që shpesh bashkohen në hundë. Shumica e meshkujve janë shtathollë (mezi më kujtohet se në Iran kam parë njeri të trashë); kurrë nuk qeshen zëshëm, kurse në buzëqeshjen e tyre të heshtur fshehet ironia e lehtë që sikur më shumë fshehë se që zbulon. Kurrfarë lëvizshmërie e vijave të fytyrës, kurrfarë gjestikulacioni, vetëm elementet e qeta të matura: sikur bartin maska.

Sikur në të gjitha qytetet lindore, jeta në qytet është përqëndruar në bazar. Ai i është zbuluar të huajit sikur përzierja e ngulfatur e ngjyrëgështenjës, artëgështenjës, dhe sikur qilim të kuq, me pllaka dhe enë të bakërta të shkëlqyeshme aty këtu dhe ndoshta me figurat e porcelanit mbi dyert e karvan-sarajit, me figurat e kalorësve sykuqë dhe dragojve me krahë. Nëse do t'i shikonit më me kujdes, do të mund të zbulonit në këtë bazar të gjitha ngjyrat e botës - por asnjëra nga këto ngjyrat e larme kurrë nuk do të mund e vetme të theksohet në hijet e bashkuara të qemerëve që e mbulojnë bazarin dhe tërheqin të gjitha së bashku në muzgun ëndërrues. Harqet e thepisura të kulmit të qemeruar kanë qenë në largësi të rregullta të vrimëzuara me vrima të vogla që e lëshojnë dritën e ditës. Nëpër këto vrima rrezet e diellit bier brenda; në ajrin aromatik të këtyre hapësirave ato fitojnë cilësinë e substancës dhe ngjasojnë në shtyllat e patejdukshme, të pjerrëta të dritës; dhe jo që njerëzit të kalojnë nëpër to, por ato, shtyllat e shkëlqyeshme, sikur po kalojnë nëpër njerëz në formë hijesh...

Sepse njerëzit në këtë bazar ishin të butë dhe të qetë sikur hijet. Nëse tregtari do t'i ftonte kalimtarët, ai këtë do ta bënte me zë të ulët; asnjëri prej tyre nuk e lavdëronte mallin e vet me britma e këngë, siç është rasti në bazarët arabë. Jeta këtu kalonte në qetësi. Ata ishin të njerëzishëm - me stërhollimin që sikur anonte kah ju, por në realitet u mbante në distancë. Ata qartë kanë qenë mendjemprehtë dhe nuk refuzonin të fillojnë bisedën me të huajin - por vetëm buzët e tyre flisnin. Shpirti i tyre qëndronte diku në prapavijë, duke pritur, duke matur, indiferent...

Në një çajtoje disa punëtorë qëndrojnë të ulur në hasure - ndoshta zejtarë, punëtorë fizikë, përcjellës të karvaneve - të strukur rreth tagarit të metaltë plot thëngjill me gaca. Dy llulla porcelani me dorëza të gjata shkojnë prej njerit te tjetri. Aroma e ëmbël e opiumit në ajër. Ata thithin pa fjalë; secili prej tyre thithë vetëm disa shtëllunga tymi thellë, duke ia dhënë pas kësaj lullën fqijut të vet. Edhe atëherë kam parë atë që më herët nuk e kam vërejtur: shumë, shumë tepër njerëz e përdornin opiumin, disa më shumë e disa më pak botërisht. Tregtari në nishën e vet, i papunë nën portën e qemeruar të karvan-sarajit, kujunxhiu në punëtorinë e vet në kohën e pushimit: të gjithë thithnin me fytyrën e njëjtë të humbur, ngapak të lodhur, duke vrotuar me sy të sëndisur në zbrazëti...

Hashishin e gjelbër të freskët me sythat e trashë i shëtitnin shitësit kudo nëpër bazar dhe qartë në këtë mënyrë, në mënyrë më të butë e përdornin opiumin. Madje edhe fëmijët hanin bërthama në kalime dhe në vende të fshehta. Dy-tre prej tyre e ndanin midis tyre kënaqësinë me tolerancë shëmbëllyese të njerit ndaj tjetrit, pa egoizmin fëmijëror - por po ashtu edhe pa kënaqësinë dhe gjallërinë fëmijërore. Por si ata edhe mund të jenë tjetërfare? Në fillim të jetës së tyre ua jepnin pijen e rëndë nga bërthama e hashishit ta pinë kurdo që qanin dhe u pen-

gonin prindërve të tyre. Kur janë rritur dhe filluan të ecin rrugëve, karakteristikat themelore të inferioritetit dhe këndshmërisë tashmë ishin të pranishme tek ata.

Atëherë kam mësuar çka më ka prekur aq fuqishëm kur për herë të parë i kam parë sytë melankolikë të iranianëve: shenja e fatit tragjik në ato. Kam ndier që opiumi u përket atyre në po atë mënyrë sikur që qeshja vujtarake i përket fytyrës së të vuajturit; ai i përkiste butësisë së tyre, indiferentizmit të tyre të brendshëm - ai i ka përkatur madje edhe varfërisë së tyre të madhe dhe kursimit të madh. Ai, si duket, nuk ka qenë aq i keq sa shprehja - edhe ndoshta po ashtu ndihmë. Ndhimë kundër kujt? Vend i pyetjeve të çuditshme...

Mendimi im aq gjatë ruhet në përshtypjet e mia nga Kirmanshahu, qytetin e parë iranian që e kam njohur, për atë se ato përshtypje kanë vazhduar në forma të ndryshme, por gjithnjë të pandryshueshme në thelb, gjatë tërë një vit e gjysmë, sa kam ndejtur në Iran. Melankolia e butë, joshëse ka qenë nata dominante kudo. Ka qenë e dukshme në fshatra dhe qytete, në punët e përditshme të njerëzve dhe në manifestimet e tyre të shumta fetare. Njëmend, edhe vetë ndjenja e tyre fetare, aq tjetër fare nga ajo arabe, mbante gjurmë të forta të dëshpërimit dhe pikëllimit: vajtimi mbi ndodhitë tragjike prej para trembëdhjetë shekujsh - vajtim për vdekjen e Aliut, dhëndrit të Pejgamberit, dhe dy bijve të Aliut, Hasanit dhe Huseinit - duket se është më e rëndësishme për ta se sa shqyrtimi i asaj çka synon Islami dhe si dëshiron ta orientojë jetën e njerëzve...

Shumë mbrëmje, në shumë qytete, mund të shihni grupe njerëzish dhe grashë në rrugë të tubuar rreth der Vishit endacak, lypësit religjioz të veshur në të bardhë, me lëkurë panteri mbi shpinë, me sëpatën e gjatë, të kapur në dorën e djathtë dhe me enën e lypësit të thelluar

në arën e kokosit në të majtën. Ai reciton, në gjysmë duke e kënduar, në gjysmë duke e folur baladën për luftërat për trashëgiminë e hilafetit deri te të cilat erdhi pas vdekjes së Pejgamberit në shekullin e shtatë - tregimin pikëllues për fenë, gjakun dhe vdekjen - kurse gjithnjë shkon disi kështu:

"Dëgjoni, o popull, ç`ju ka ndodhur të zgjedhurve të Zotit dhe se si nëpër tokë është derdhur gjaku i pasardhësve të Pejgamberit.

Ka qenë njëherë Pejgamberi të cilin Zoti e ka krahasuar me Qytetin e Diturisë, kurse porta e atij Qyteti ka qenë më besniku dhe më i guximshmi prej ithtarëve të tij, dhëndri i tij Aliu, Drita e Botës, pjesëmarrës në shpalljen e Pejgamberit, i quajtur Lua i Zotit.

Kur Pejgamberi ndërroi jetë, Luani i Zotit ka qenë trashëgimtari i tij ligjor. Por njerëzit e këqij kanë grabitur të drejtën e Luanit, të dhënë nga Zoti, dhe e vendosën trashëgimtarin tjetër të Pejgamberit; pas vdekjes së uzurpatorit të parë, tjetri, i llojit të njëjtë të keq, e trashëgoi, e pas tij edhe një.

Vetëm pasi u mbyt edhe uzurpatori i tretë, vullneti i Zotit u manifestua dhe Luani i Zotit e arriti vendin ligjor si Komandant i besimtarëve.

Por armiqtë e Aliut dhe Zotit kanë qenë të shumënumërt dhe një ditë, kur ishte në sexhde para Krijuesit të tij, shpata e dorasit e dërgoi në vdekje. Toka u dridh nga dhembja për shkak të veprave heretike, kurse malet qanin dhe shkëmbinjtë qitnin lotë.

Oh, mallkimi i Zotit i mbërriftë kriminelët dhe dënimi i amshueshëm i shkatërroftë!

Sërish uzurpatori i keq e mori udhëheqjen dhe ua mohoi bijve të Luanit të Zotit, Hasanit dhe Huseinit, bijve të Fatimes së bekuar, të drejtën e tyre të trashëgimisë së fronit të Pejgamberit. Hasanin në mënyrë të vrazhdë e

helmuan e kur Huseini u ngrit në mbrojtje të fesë, jeta e tij e shkëlqyeshme u fik në fushën e Qerbelasë derisa u gjunjëzua tek uji ta shuajë etjen pas betejës.

Ah, mallkimi i Zotit i mbërriftë kriminelët dhe lotët engjëllorë gjithëherë le ta ujisin dheun e shenjtë të Qerbelasë!

Kokën e Huseinit - kokën të cilën Pejgamberi dikur e ka dashur - shtazarisht e prenë dhe trupi e tij pa kokë është sjellë deri te tenda ku fëmijët e tij duke qarë pritnin kthimin e babait të vet.

Prej atëherë besimtarët thërrasin mallkimin e Zotit ndaj kundërvajtësve dhe qajnë për vdekjen e Aliut, Hasanit e Huseinit; e ju, o besimtarë, çojeni zërin tuaj dhe vajtone vdekjen e tyre - sepse Zoti e falë mëkatin e atyre që qajnë për pasardhësit e Pejgamberit..."

Edhe balada do të nxiste dëneseje të zjarrra të femrave që dëgjojnë, derisa lotët e qeta rrokulliseshin fytyrës së njerëzve me mjekra...

"Vajtimit" e tilla të tepruara pa dyshim janë larg nga fotografia e vërtetë, historike e atyre ndodhive të hershme që kanë sjellë deri te çarja kurrë e shëruar në botën islame: ndarja e bashkësisë muslimane në sunnitë, që formojnë shumicën e popujve muslimanë dhe qëndrojnë fuqishëm në parimet e hilafetit zgjedhor, dhe në shiitë, që konsiderojnë se Pejgamberi e ka përcaktuar Aliun, dhëndrin e vet, si pasardhës ligjor dhe trashëgimtar. Mirëpo, në realitet, Pejgamberi vdiq, e që nuk emëroi kurrfarë trashëgimtari, pas së cilës njëri prej shokëve të tij më të vjetër e më besnikë, Ebu Bekri, qe zgjedhur për halif me shumicë të madhe të bashkësisë. Ebu Bekrin e ka trashëguar Omeri, e atë Osmani; vetëm pas vdekjes së Osmanit Aliu është zgjedhur për halif. Nuk kishte asgjë të keqe as të gabueshme, sikur që mirë e kam ditur madje edhe atëherë në Iran, në aspekt të tre pararendësve të Aliut. Ata pa dyshim kanë

qenë personalitetet më të mëdha dhe më fisnike në historinë islame pas Pejgamberit dhe kanë qenë gjatë shumë viteve ndër shokët e tij më të afërt: ata pa dyshim nuk kanë qenë "uzurpues" aq më parë që populli i ka zgjedhur, duke manifestuar të drejtën e lirë që ua jep Islami. Nuk ka qenë kjo përvetësim i tyre i pushtetit por më tepër mosprirje e Aliut dhe ithtarëve të tij që sinqerisht t'i pranojnë rezultatet e zgjedhjeve popullore, që solli deri te lufta për pushtet, deri te vdekja e Aliut dhe deri te shndërrimi - nën halifin e pestë të Muaviut - i formës origjinale, republikane të shtetit islam në mbretëri trashëguese dhe, më në fund, deri në vdekjen e Huseinit në Qerbela.

Po e kam ditur këtë krejt para se kam ardhur në Iran, por këtu kam qenë i magjepsur nga emocionet e pafund që tregimi i vjetër, tragjik prej para trembëdhjetë shekuj edhe më mund të nxisë te populli iranian kurdo që përmenden emrat e Aliut, Hasanit ose Huseinit. Kam filluar të pyes veten: a ka qenë kjo melankoli e lindur e iranianëve dhe prirja e tyre për dramatizim që i ka shtyer ta pranojnë doktrinën e shiitëve? - ose kjo ka qenë vija tragjike e fillimit të saj që ka sjellë deri te kjo melankoli intensive iraniane?

Shkallërisht, gjatë disa muajve përgjigjja mahnitëse ka filluar të formohet në frymën time.

Kur, nga mesi i shekullit të shtatë, armatat e halifit Omer e nënshtuan Mbretërinë sasanidase, duke e sjellë me vete Islamin, kulti iranian i Zaratustrës ishte tashmë i shpënë në formalizmin rigoroz dhe për këtë nuk ka pasur mundësi që në mënyrë efikase t'i kundërvihet idesë së re dinamike që ka ardhë nga Arabia. Por në kohën kur arabët e kanë pushtuar Iranin, ai ka kaluar nëpër periudhën e zierjeve shoqërore dhe intelektuale që sikur ka premtuar përtëritjen kombëtare. Kjo shpresë e rilindjes së brendshme, organike ka qenë shkatërruar me invadi-

min arab, kurse iranianët, duke e lëshuar vijën e tyre vet-jake historike të zhvillimit, prej atëherë u janë adaptuar koncepteve kulturore dhe etike që janë sjellë nga jashtë.

Ardhja e Islamit ka paraqitur në Iran, sikur edhe në shumë vende të tjera, përparim të madh shoqëror; ai ka rrënuar sistemin e vjetër kastik iranian dhe ka sjellë deri te krijimi i bashkësisë së re të njerëzve të lirë, të barabartë; ka hapur rrugë të reja për energji kulturore që gjatë kohë kanë qenë të përgjumura e të pashprehura. Por megjithëkëtë pasardhësit dinjitozë të Dariut dhe Kserksit kurrë nuk kanë mund të harrojnë se kontinuiteti historik i jetës së tyre kombëtare, ka qenë lidhja organike ndërmjet dje dhe sot të tyre, papritmas ka qenë ndërprerë. Populli, karakteri më i fshehur i të cilit pat gjetur shprehjen e vet në dualizmin e jashtëzakonshëm të zend religjionit dhe adhurimit të saj pothuaj panteist të katër elementeve - ajrit, ujit, zjarrit dhe tokës - ka qenë tash i ballafaquar me monoteizmin rigoroz, të pakompromis të Islamit dhe synimit të tij drejt absolutes. Kalimi ka qenë tepër i rreptë dhe i dhembshëm që t`u lejojë iranianëve që vetëdijen e vet thellë të rrënjosur kombëtare t`ia nënshtrijë konceptit mbinacional të Islamit. Përkundër pranimit të tyre të shpejtë dhe qartë vullnetar të fesë së re, ata nënvetëdijshtëm e kanë barazuar fitoren e idesë islame me humbjen kombëtare iraniene, kurse ndjenja se janë humbur dhe parevokueshëm janë shkukur nga konteksti i trashëgimisë së tyre të vjetër kulturore - ndjenje fuqishëm dëshpëruese përkundër tërë mjegullsisë së vet, - është dashur ta rrënojë vetëmohimin kombëtar në shekujt që vinin. Për dallim nga aq shumë kombe të cilëve pranimiti i Islamit u ka dhënë pothuaj menjëherë impulsin më pozitiv për zhvillimin e mëtejshëm kulturor, reagimi i mirëfilltë iranian - dhe, në njëfarë mënyre, më i përher-

shëm në këtë ka qenë ndjenja e nënçmimit të thellë dhe pakënaqësisë së shtyrë.

Kjo ndjenjë është dashur të jetë shtyrë dhe zbutur në krahun e errët të ndërdijes, sepse në ndërkohë Islami është bërë fe edhe e vetë Iranit. Por në urrejtjen e tyre ndaj fitores arabe, iranianët instinktivisht i ikën asaj që psikoanaliza e përshkruan si "prekompensim": ata kanë filluar ta konsiderojnë fenë që na sollën pushtuesit arabë si diç që është ekskluzivisht e tyre, vetjake. Ata këtë e kanë arritur duke e shndërruar shkallërisht lajmin racional, jomistik për Zotin e arabëve në kundërshtinë e saj: fanatizmin mistik dhe emocionet e errëta. Feja që për arabët ka qenë prani, realitet dhe burim i rehatisë dhe lirisë, në shpirtin iranian u shndërrua në mallëngjimin e errët për mbinatyroren dhe simboliken. Parimi islam i transcendencës së pakuptueshme të Zotit u shndërrua në doktrinën mistike (për të cilën ka pasur mjaft shembuj në Iranin paraislamik) të manifestimit fizik të Zotit në të vdekurit veçan të zgjedhur, që do t'ua sjellin këtë qenësi hyjnore pasardhësve të vet. Synimit të tillë, pajtimi me doktrinën e shiitëve ka ofruar rrugën më të favorshme; sepse nuk ka mund të ketë dyshim që respekti shiit, pothuaj adhurimi i Aliut dhe pasardhësve të tij, fsheh farën e idesë së inkarnimit të Zotit dhe riinkarnimit të pandërprerë - idesë plotësisht të huaj për Islamin, por mjaft të afërt zemrës iraniane.

Nuk ishte e rastit që Pejgamberi Muhammed a.s. vdiq e që nuk e emëroi trashëgimtarin dhe, në realitet, ka refuzuar ta emërojë kur kjo i është propozuar para vdekjes së tij. Ai me këtë veprim ka synuar të kumtojë, e para, se cilësia shpirtërore i pejgamberisë nuk është asgjë që mund "të trashëgohet" dhe, e dyta, që udhëheqja e ardhshme e bashkësisë duhet patjetër të dalë nga zgjedhja e lirë e vetë popullit e jo me "caktimin" e Pejgamberit (që,

natyrisht, do të implikohej me përcaktimin e tij të trashëgimtarit); për këtë ai qëllimisht ka hedhur poshtë ide-në që udhëheqja e bashkësisë të jetë kurdoherë çkado tjetër pos botërore, në pajtim me këtë kurrfarë "trashëgimie apostolike". Por kjo ka qenë pikërisht ajo çka ka synuar doktrina shiite. Ajo jo vetëm që ka insistuar - në kundërshtim të qartë me frymën e Islamit - në parimin e trashëgimisë apostolike, por edhe e ka rezervuar këtë trashëgimi vetëm për "pasardhësit e Pejgamberit" - don të thotë, për kushëririn dhe dhëndrin e tij Aliun dhe pasardhësit e tij të drejtpërdrejtë.

Kjo ka qenë plotësisht në pajtim me prirjet mistike të iranianëve. Por, kur ata mallëngjyeshëm iu afruan taborrin të atyre që kanë konsideruar që qenësia shpirtërore e Muhamedit vazhdon të jetojë në Aliun dhe pasardhësit e tij, iranianët nuk e kanë plotësuar vetëm një dëshirë mistike; ka qenë edhe një tjetër, motivimi i ndërvetëdjshëm për zgjedhjen e tyre. Nëse Aliu është pasardhës dhe trashëgimtar i Pejgamberit, tre halifët që i kanë paraprirë është dashtur qartë të jenë uzurpues e ndër ta ka qenë edhe Omeri, po ai Omer që e nënshtroi Iranin! Urrejta kombëtare ndaj ngadhënjësit të Mbretërisë Sasanidase ka mundur tash të racionalizohet me anë të religjionit - religjionit që është bërë vetjak iranian; Omeri e ka "privuar" Aliun dhe bijtë e tij Hasanin dhe Huseinin nga e drejta e tyre e dhënë hyjnore e trashëgimit të hila-fetit në Islam dhe në këtë mënyrë i është kundërvënë vullnetit të Zotit; në pajtim me këtë, duke iu nënshtuar vullnetit të Zotit, duhet ndihmuar partinë e Aliut. Nga antagonizmi kombëtar u lind doktrina religjioze.

Në vendosjen iraniante të doktrinës shiite kam dalluar protestën latente kundër pushtimit arab të Iranit. Tash kam kuptuar përse iranianët e mallkojnë Omerin me urrejtjen shumë më të madhe nga ajo që është rezervuar

për dy "uzurpuesit" tjerë, Ebu Bekrin dhe Osmanin; nga pikëpamja doktrinale, halifi i parë, Ebu Bekri, do të duhej të konsiderohej delikuenti kryesor - por Omeri e ka ngadhënjyer Iranin...

Ky, në pajtim me këtë, ka qenë shkak për intensitetin e çuditshëm me të cilin respektohet familja e Aliut në Iran. Ky kult paraqet akt simbolik të hakmarrjes iraniane islamit arab (i cili aq pakompromis kundërshton çdo adhurim të cilësdo qenie njerëzore duke e kyçur edhe personalitetin e Muhammedit). E vërteta, doktrina shiite nuk është krijuar në Iran. Ka pasur grupe shiite edhe në vendet tjera muslimane, por askund tjetër nuk ka dominuar ajo aq plot me ndjenjat dhe imagjinatën e popullit. Kur iranianët me pasion shfryhen për pikëllimin e vet për shkak të vdekjes së Aliut, Hasanit dhe Huseinit, ata nuk qajnë vetëm për shkatërrimin e familjes së Aliut por po ashtu edhe për vetveten dhe humbjen e lavdisë së vet të vjetër.

Iranianët janë popull melankolik. Melankolia e tyre është ruajtur madje edhe në peizazhin iranian - në rrafshirat e pafund të tokës së kuqërremtë të verdhë, në shtigjet e vetmuara malore dhe rrugët kryesore, fshatrat rralle të shpërndara me shtëpitë prej baltinës, tufat e dheneve që në parambrëmje në kolonat ngjyrë gështenjë të përhimtë u grahin në pus. Në qytete jeta pikonte me pika të ngadalshme, të pandërprera, pa nxitim dhe hare; çdo gjë dukej sikur është mbuluar me velin ëndërrues, kurse çdo fytyrë ka pasur shprehje të pritjes indiferente. Kurrë nuk është dëgjuar muzika nëpër rrugë. Nëse në mbrëmje ndonjë ruajtës i kuajve, tatar, do të këndonte papritmas në karvan-saraj, njeriu edhe me qëllim do të i curronte veshët në habi. Botërisht kanë kënduar vetëm dërvishët e shumtë, kurse ata gjithnjë i këndonin baladat e njëjta të vjetra, tragjike për Aliun, Hasanin dhe Huseinin. Vdekja dhe lotët i përshkonin ato këngë dhe godit-

nin sikur verë e rëndë në kokë të dëgjuesve. Dëshpërimi i tmerrshëm, por vullnetar, pothuaj dëshpërimi i pranuar me pasion, sikur i ka shtrënguar këta njerëz.

Në parambrëmjet verore në Teheran keni mundur të shihni meshkujt dhe femrat se si palëvizshëm këndojnë pranë ujit, nga të dy anët e rrugës që rrjedh në hijen e vidthave të mëdhenj. Ata qëndronin ulur dhe zgurdullonin në ujin lëvizës. Nuk flitnin ndërmjet veti. Ata vetëm dëgjonin gurgullimën e ujit dhe lejonin që degët shushuritëse të lëkundën mbi kokat e tyre. Kurdo që i kam parë, është dashur të mendoj në psalmin e Davudit: Pranë lumenjve babilonas, atje jemi ulur, një mend, dhe kemi qarë...

Ata rrinin ulur pranë rrjedhës së ujit si zogj të mëdhenj, memecë, të errshëm, të humbur në vështrimin e heshtur të ujit lëvizës. A kanë menduar ata për diçka kaheerë të harruar që u përket atyre dhe vetëm atyre? A kanë pritur ata?

...Në çka?

Kurse Davudi ka kënduar: i kemi varur harfat tona për shelgjet midis shelgjishtes...

### - 3 -

"Eja, o Zejd, të shkojmë" - e vë letrën e Ali-agës në xhep dhe ngrihem që të përshëndetem me Ez-Zugajbi-un. Por ai tundi kokën: "Jo, vëlla, le të mbetet Zejdi këtu një kohë me mua. Nëse ti je tepër koprrac që të më thua ç` të ka ndodhur gjatë kohës së muajve të kaluar, le të ma thotë ai rrëfimën në vend tëndin. Apo, ndoshta mendon që miqtë t'u më nuk kujdesen për atë çka po të ndodhë?"



## X. Dexhkhalli

- 1 -

Hyjë rrugëve gjarpërore të pjesës më të vjetër të Medines; muret e shtëpisë prej guri në hije, logjat e qelquara dhe ballkonët pezullohen mbi rrugë që ngjasojnë në gryka dhe vende - vende janë aq të ngushta saqë dy veta mezi mund të kalojnë njëri pranë tjetrit; vij para fasadës së përhimtë të gurit të bibliotekës të cilën para njëqind vjetësh e ka ndërtuar një dijetar turk. Në oborrin e saj, pas grillës së bronztë të portës, qetësi joshëse. Kaloj nëpër oborrin e shtruar me pllaka guri, pranë drurit të vetmuar që me degët e veta të palëvizshme qëndron midis tij dhe hyj në sallën e qemeruar me rafte për libra - mijëra libra të shkruara me dorë; ndër ta disa dorëshkrime më të rralla për të cilët dihet në botën islame. Pikërisht librat sikur këto, i kanë dhënë lavdi kulturës islame, lavdisë që ka fërshëlluar sikur era e mbrëmshme.

Derisa i shikoj këta libra me lidhje lëkure, joharmonia ndërmjet muslimanëve të djeshëm dhe të sotëm më godet si goditja e dhembshme...

"Ç` të mundon, biro? Përse ajo çehre e hidhur në fytyrën tënde?"

Kthehem pas zërit - dhe shih, i ulur në qilim në një dritare, me libër mbi gjunj, figura e imtë e mikut tim të vjetër, sheik Abdullah ibn Bulejhidit. Sytë e tij të rreptë,

ironik më përshëndesin me shkëlqim të ngrohtë deri sa e puthi ballin e tij dhe ulem pranë. Ai është më i madhi në mesin e ulemasë në Nexhd dhe, përkundër ngushtësisë së caktuar doktrinale karakteristike pikëpamjeve vehabite, është njëri prej mendjeve më të thella që i kam takuar në vendet muslimane. Miqësia e tij ndaj meje shumë ka kontribuar që jeta në Arabi të më jetë e lehtë dhe e këndshme, sepse në mbretërinë e Ibn Saudit fjala e tij respektohet më shumë se e secilit pos e Mbretit. Ai e mbylli librin e vet dhe më tërhoqi kah vetja duke më shikuar me sy hulumtues.

"Mendova, o Sheik, se sa ne muslimanët jemi larguar nga kjo", - dhe unë dëftova drejt librave në rafte - "dhe erdhëm deri te mjerimi dhe degradimi ynë i tanishëm".

"Djali im", - u përgjigj plakë, - "ne vetëm po korrim atë që e kemi mbjellur. Dikur kemi qenë të mëdhenj, e Islami na ka bërë të këtillë. Kemi qenë bartës të Shpalljes. Derisa kemi qenë besnikë ndaj kësaj Shpalljeje, zemrat tona kanë qenë të inspiruara kurse mendjet tona të ndritura; por posa harruam se për çfarë qëllimi i Gjithmundshmi na ka furnizuar, kemi rënë. Shumë jemi larguar nga kjo" - dhe Sheiku përsëriti lëvizjen time të dorës drejt librave. - "Për këtë se jemi larguar nga ajo që na mësoi Pejgamberi - bekimi dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të - para trembëdhjetë shekujsh..."

"E si të shkon puna ty?", - më pyet ai pas heshtjes, sepse e di se merrem me studime në lidhje me historinë e hershme islame.

"Duhet pranuar, Sheik, jo fort mirë. Nuk mund të gjej qetësi në zemrën time, e nuk e di përse. Kështu përsëri jam dhënë pas endjeve shkretëtirës".

Ibn Bulejhidi shikon në mua me sy të qeshur - me atë shikimin e urtë, depërtues - dhe e përdredh mjekrën

e vet të shtrembëruar: "Shpirti duhet ta ketë të veten... Ti duhet patjetër të martohesh".

Unë, natyrisht, e di se martesë në Nexhd konsiderohet zgjidhje pothuaj për të gjitha kokëçarjet dhe kështu nuk mund të përmbahem nga të qeshurit:

"Por, Sheik, ti mirë e di se përsëri jam martuar vetëm para dy vjetësh dhe se këtë vit më ka lindur djalë".

Plaku mblodhi supet: "Nëse zemra e mashkullit është në paqe me gruan e tij, ai mbetet në shtëpi sado që mundet. Ti nuk je shumë në shtëpi... E, pas kësaj, ende kurrë mashkulli nuk është lënduar nëse është martuar me grua tjetër". (Ai vetë, përkundër shtatëdhjetë viteve të veta, i ka tash tri, e thonë se më e reja, me të cilën është martuar vetëm para disa muajve, ka mezi gjashtëmbëdhjetë vjet.)

"Mbase kjo", - shtova, - "nuk e fyen mashkullin ta marrë gruan tjetër, por ç'është me gruan e parë? A nuk e fyen kjo atë?"

"Djali im, nëse gruaja e mbanë tërë zemrën e mashkullit, ai nuk do të mendojë për martesë tjetër, as që i nevojitet kjo. Por nëse zemra e tij nuk është e plotë me të - a do të fitojë ajo çkado qoftë duke e mbajtur ashtu me gjysmë zemër vetëm për vete?"

Në këtë sigurisht nuk ka përgjigje. Islami rekomandon, pa dyshim, monogaminë, por lejon që mashkulli të marrë deri në katër gra në rrethana të jashtëzakonshme. Do të mund të pyeteshim përse liria e tillë nuk i është dhënë edhe femrës, por përgjigja është e thjeshtë. Përkundër faktit spiritual të dashurisë që ka hyrë në jetën njerëzore gjatë zhvillimit të njeriut, shkaku themelor biologjik për instinktin seksual, te të dy gjinitë, është lindja; derisa femra mund, në të njëjtën kohë, ta zërë fëmijën vetëm prej një mashkulli dhe duhet ta bartë nëntë muaj para se të jetë në gjendje ta zërë tjetrin, mashkulli është i

zhvilluar ashtu që mund të nisë fëmijë çdoherë kur të ketë marrëdhënie me femrën. Së këndejmi, derisa natyra do të ishte vetëm shkapërderdhëse nëse do t'i jepte instinkt poligamik femrës, prirja e pakontestueshme poligamike e mashkullit, nga pikëpamja e natyrës, biologjikisht është e arsyeshme. Natyrisht, është e qartë se faktori biologjik është vetëm një - dhe assesi gjithëherë më i rëndësishmi - aspekti i dashurisë; megjithatë, ai është faktori themelor dhe, për këtë, vendimtari në konstitucionin shoqëror të martesës si të tillë. Me urtësinë e cila gjithnjë plotësisht e merr në llogari natyrën njerëzore, ligji islam vetëm e mbron funksionin shoqëror-biologjik të martesës (çka, natyrisht, e kyç edhe kujdesin për pasardhësit), duke lejuar që mashkulli të ketë më shumë se një grua e duke mos i lejuar femrës që të ketë më shumë se një burrë njëkohësisht; problemi spiritual i martesës, pasi nuk mund të matet, është jashtë dispozitave të ligjit dhe i është lënë gjykimit të partnerëve. Kurdo që dashuria është e plotë dhe e përplotë, pyetja e martesës së dytë natyrisht se nuk paraqitet te asnjëri prej tyre; sa herë që burri nuk e don gruan e vet me gjithë zemër, por jo edhe që të dëshirojë ta humbë, ai mund ta marrë gruan tjetër, me kusht që e para të pajtohet me ndarjen e këtillë të ndjenjave; nëse ajo nuk mund të pajtohet me këtë, mund ta bëjë divorcin dhe është e lirë që përsëri të martohet. Sidoqoftë - pasi martesë në Islam nuk është sakrament por kontratë qytetare - animi kah divorci gjithnjë është i hapur për cilindo partner martesor, për më tepër që turp, i cili në vendet tjera me intensitet më të madh apo më të vogël lidhet me divorcin, nuk ka në shoqërinë muslimane (me mundësinë e përjashtimit të muslimanëve indusë, te të cilët në këtë aspekt ka ndikuar kontakti shekullor me shoqërinë hinduse ku divorci është plotësisht i ndaluar). Liria që ligji islam i lejon edhe

maskullit edhe femrës që ta lidhë apo ta prish martesën, shpjegon përse kurvëria konsiderohet një prej veprave të këqija më neveritëse, sepse për lirinë e tillë kurrfarë epilogu emocional as sensual kurrë nuk mund të shërbejë si arsytim. Është e saktë se gjatë shekujve të ngecjes së muslimanëve traditat shoqërore shpesh ia kanë vështirësuar gruas që ta realizojë të drejtën e saj të divorcit ashtu lirisht si e ka pasur këtë për qëllim ligdhënësi; për këtë, ndërkaq, nuk duhet fajësuar Islamin por traditat - pikërisht sikur që traditat, e jo të drejtën islame, duhet fajësuar për izolimin në të cilin gjendet femra aq gjatë në shumë vende muslimane, sepse as Kur`ani as shembulli jetësor i Pejgamberit nuk ofron kurrfarë baze për këtë praktikë, që më vonë e ka gjetur rrugën e vet në shoqërinë muslimane nga Bizanti.

Sheik ibn Bulejhidi e ndërpreu persiatjen time mjeshtrisht: "S`ke nevojë të ngutesh me vendimin. Ai do të vijë, djalo, kurdo që do të nevojitet të vijë".

## - 2 -

Biblioteka është e qetë; sheiku i moçëm dhe unë jemi vetëm në sallën e qemeruar. Nga xhamia e vogël në afërsi e dëgjojmë thirrjen për namazin e akshamit, e vetëm një çast më vonë thirrja e njëjtë jehon nga pesë minaret e xhamisë së Pejgamberit e cila, tash për ne e padukshme, dominon aq solemnisht dhe me aq plot krenari harmonizuese mbi kubën e gjelbër. Muezini në një minare fillon thirrjen e vet: All-llahu ekber... në shkallën e thellë, të errët mol, ngadalë duke e ngritur dhe lëshuar në harqe të gjata të zërit: Zoti është më i madhi, Zoti është më i madhi... Para se ta përfundojë thënien e vet të parë, muezini në minaren e dytë më afër nesh, ndërhy, me ton diç më të lartë... më i madhi, Zoti është më i madhi! Dhe derisa në minaren e tretë thirrja e njëjtë ngadalë

rritet, muezini i parë tashmë e ka përfunduar vargun e parë dhe fillon - tash i përcjellë me zërat e largët kontrapunktive të thënies së parë nga minareja e katërt dhe e pestë - vargun e dytë: Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut!, - derisa zërat nga minareja e dytë e pastaj nga e treta lëshohen me krahë të butë... dhe dëshmoj se Muhammedi është i dërguar i Zotit! Në mënyrën e njëjtë, derisa secili nga muezinët e përsërit vargun dy herë, thirrja vazhdon: Ejani në namaz, ejani në namaz! Nxitoni në lumturinë e amshueshme! Secili zë sikur i zgjon të tjerët dhe i tërheq më afër veta, vetëm që ai vetë ta tërheq dhe ta marrë melodinë në vendin tjetër, duke e bartë kështu deri te vargu përfundimtar: Zoti është më i madhi, Zoti është më i madhi! S'ka Zot tjetër veç Allahut!

"Eja", thotë sheik Ibn Bulejhidi, - "eja në xhami në namazin e akshamit!"

Haremi, ose Xhamia e Shenjtë, në Medinë është sjellë në gjendjen e vet të tashme nga mesi i shekullit të kaluar, por pjesët e saj janë më të vjetra - disa madje nga koha e dinastisë mameluke egjiptiane, e disa edhe më të vjetra. Salla qendrore, në të cilën gjendet varri i Pejgamberit, përfshinë saktë trollin e njëjtë sikur ndërtesa që e ka ngritur halifi i tretë, Osmani, në shekullin e shtatë. Mbi të ngrihet kubeja e madhe e gjelbër, e dekoruar nga ana e brendshme me ornamente të ngjyrave luksoze. Rreshtat e shumtë të shtyllave të rënda të mermerit bartin kulmin dhe harmonikisht e ndajnë brendinë. Dyshe-meja prej mermeri është e mbuluar me qilima të shtrenjtë. Kandilabrët e bronzë shkëlqyeshëm të formësuar i dekorojnë të tri mihrabet, nishat gjysmëqarkore të drejtuar drejt Mekës dhe të dekoruara me pllakëzat e bukurra të qeramikes në të kaltër dhe në të bardhë: njëri prej tre mihrabëve gjithnjë është vendi për imamin që e udhëheq xhemaatin në lutje. Në zinxhirët e gjatë prej

mesingu disa qindra topa të qelqtë e të kristaltë; natën ata janë të ndriçuar nga brenda me anë të llambave të vogla me vaj ulliri dhe përhapin dritën e lehtë nëpër radhët e njerëzve në namaz. Gjatë ditës muzgu i gjelbër e përmbush xhaminë dhe e bënë të ngjashme me fundin e ndonjë liqeni: sikur nëpër ujë figurat njerëzore lëvizin me këmbë të zbathura nëpër qilima dhe pllaka mermeri; sikur i ndarë me murin e ujit, zëri i imamit zëron gjatë kohës së namazit nga skaji i sallës së gjerë, i zbutur dhe pa jehonë.

Vetë varri i Pejgamberit nuk shihet, sepse është i mbuluar me perde të rënda brokati dhe i mbyllur me grilën prej bronzë të cilën në shekullin e pesëmbëdhjetë e ka dhuruar sulltani mamelukas egjiptian Kait-beu. Në realitet, edhe nuk ka kurrfarë strukture varri, sepse I Dërguari është varrosur nën dyshtemenë prej dheu në vetë dhomën e shtëpisë së vogël në të cilën ka jetuar dhe vdekur. Më vonë është ndërtuar një mur pa dyer rreth shtëpisë, duke e mbyllur kështu prej botës së jashtme. Derisa Pejgamberi ishte i gjallë, xhamia ka qenë drejtpërdrejt përmbri shtëpisë së tij; gjatë shekujve, ndërkaq, ajo është zgjeruar mbi dhe pas varrit.

Radhët e gjatë të cergave janë vënë mbi zhur të drejtkëndëshit të hapur në xhami; vargjet e njerëzve ulen në ta duke lexuar Kur'an, duke biseduar ndërmjet veti, duke përsiatur ose thjesht duke pushuar në pritje të namazit të akshamit. Ibn Bulejhidi sikur është humbur në lutjen e qetë.

Nga largësia vjen zëri që reciton, si rëndom para namazit të akshamit, fragment nga Libri i shenjtë. Sot kjo është sureja e nëntëdhjetë e gjashtë - e para e shpallur Muhammedit - që fillon me fjalët: "Lexo, në emër të Krijuesit tënd që krijon... Me këto fjalë thirrja e Zotit i erdhi për herë të parë Muhammedit në shpellën Hira afër Mekës.

Ai lutej i vetmuar, sikur edhe shpesh më parë, ka lutur për dritën e të vërtetën, kur befasisht para tij u paraqit meleku dhe urdhëroi: "Lexo!" Kurse Muhammedi, i cili, si shumica e njerëzve nga mjedisi i tij, kurrë nuk ka mësuar të lexojë dhe, mbi të gjitha, nuk ka ditur çka priret prej tij të lexojë, u përgjigj: "Unë nuk di të lexoj". Në këtë meleku e mori, e shtrëngoi kah vetja ashtu që Muhammedi ka ndier që tërë fuqia po e lëshon; atëherë e lëshoi dhe e përsëriti urdhërin e vet: "Lexo!" Sërisht Muhammedi u përgjigj: "Unë nuk di të lexoj". Atëherë meleku sërisht e shtrëngoi derisa nuk u molis dhe mendoi se do të vdesë; edhe një herë erdhi zëri bumbullues: "Lexo!" E kur, për herë të tretë, Muhammedi pëshpëriti në frikë: "Unë nuk di të lexoj...", meleku e lëshoi dhe foli:

"Lexo, në emër të Krijuesit tënd që krijon, e krijon njeriun nga gjaku i ngjizur i varur! Lexo, dhe Krijuesi yt është bujar, që mëson përdorimin e lapsit, e mëson njeriun atë që nuk e di..."

Dhe kështu me aludimin në arsyen, vetëdijen dhe dijen e njeriut, filloi shpallja e Kur'anit, që do të vazhdojë gjatë njizet e tre viteve deri në vdekjen e Pejgamberit në Medinë në vitin e tij të gjashtëdhjetetretë.

Ky rrëfim për përjetimin e parë të tij të shpalljes përkujton, në njëfarë mënyre në pehliuanllëkun e Jakobit me engjëllin si është përshkruar në Librin e Zanafillës. Por derisa Jakobi rezistonte, Muhammedi iu dorëzua përqaqimit engjëllor me frikë dhe shqetësim derisa "tërë fuqia nuk e ka lëshuar" dhe në të nuk ka mbetur asgjë pos aftësisë që ta dëgjojë zërin për të cilin më shumë nuk mund të thuhej se a po vinte nga jashtë apo nga brenda. Ai ende nuk e dinte se prej atëherë do të duhej të jetë plot dhe i zbrazët në të njëjtën kohë: qenia njerëzore me synimet dhe dëshirat njerëzore dhe me vetëdijen për jetën vetjake - kurse, në të njëjtën kohë, instru-

ment pasiv për pranimin e shpalljes. Libri i papashëm i të vërtetës amshuese - e cila e vetmja u jep domethënie të gjitha gjërave dhe ndodhive të perceptueshme - është hapur para zemrës së tij, duke pritur që të kuptohet; kurse iu pat thënë t'i lexojë "botës nga ajo në mënyrë që njerëzit tjerë të mund të kuptojnë atë që nuk dinë dhe, vërtet, nuk mund ta dinë".

Pasojat e mëdha të këtij vizioni e ngadhënjyen Muhammedin: ai, sikur Musa para shkurrës së ndezur, është konsideruar i padenjë për pozitën e lartësuar të pejgamberisë dhe është dridhur gjatë mendimit se Zoti ka mundur ta zgjedhë atë. Thonë si është kthyer në qytet në shtëpinë e vet dhe e ftoi gruan e tij Hatixhen: "Më mbulo, më mbulo!" - sepse dridhej sikur dega në shtrëngatë. Ajo e pështolli në mbulesë dhe dridhja e tij dalëngadalë u qetësua. Atëherë ai i tregoi çka i ka ndodhur dhe tha: "Vërtet, po frikësohem për veten". Por Hatixheja, me mendjemprehtësinë që vetëm dashuria mund ta japë, e ka ditur menjëherë se ka frikë nga madhësia e detyrës që është para tij, dhe atëherë u përgjigj: "Jo, për Zotin! Kurrë Ai nuk do të obligojë me detyrën që nuk je në gjendje ta kryesh dhe kurrë Ai nuk do të të nënçmojë! Sepse, po sheh, ti je njeri i mirë; po i plotëson detyrat tua ndaj gjinisë tënde, po i ndihmon të dobët, i dhuron të varfërit, je bujar ndaj musafirëve dhe po u ndihmon atyre në fatkeqësi të vërtetë". Që ta ngushëllojë, ajo e sollti burrin e vet deri te Vereka, kushëriri i vet i ditur që tashmë shumë vite ishte kristian dhe, në pajtim me traditën, e ka lexuar Biblën në hebraishte; në atë kohë ai tashmë ka qenë plak dhe i verbër. Hatixheja tha: "O biri i dajës sim, dëgjoje këtë kushëririn tënd!". Kur Muhammedi rrëfeu ç'kish përjetuar, Vereka i ngriti duart e veta me frikërespekt dhe tha: "Ky ka qenë Engjëlli i shpalljes, atë që Zoti ua ka dërguar pejgamberëve të vet më të her-

shëm. Oh, sikur të isha i ri! Sikur ta prisja dhe të isha në gjendje të të ndihmoj kur populli yt të të përndjekë!"

Në këtë Muhammedi pyeti me habi: "Përse ata do të më persekutojnë?"

Vereka i urtë u përgjigj: "Po, do të persekutojnë. Kurrë ende nuk i ka ardhë popullit të vet njeriu me porosinë që i ngjason tëndes e që nuk është persekutuar".

Dhe njëmend e kanë persekutuar, gjatë trembëdhjetë vjetëve, derisa nuk e ka lëshuar Mekën dhe nuk shkoi në Medinë. Mekkasit gjithnjë kanë qenë zemërngurtë...

Por, më në fund, a është aq vështirë të kuptohet vrazhdësia e zemrës së shumicës së mekkasve që e kanë manifestuar kur për herë të parë e dëgjuan thirrjen e Muhammedit? Të privuar nga të gjitha nevojat shpirtërore, ata kanë ditur vetëm për synimet praktike, sepse kanë besuar se jeta mund të përmirësohet vetëm me rritjen e mjeteve me anë të të cilave mund të realizohet komoditeti i jashtëm. Përfytyrimi se duhet pa kompromis t'i dorëzohen kërkesës morale - sepse Islami, tekstualisht, do të thotë "vetëdorëzim Zotit" - popullit të tillë ka mundur t'i duket krejtësisht e padurueshme. Krahas kësaj, mësimi i Muhammedit e ka rrezikuar rendin tradicional të gjërave dhe traditat fisnore aq të dashura për mekkasit. Kur ai ka filluar ta predikojë vetëmsinë e Zotit dhe e shpalli adhurimin e idhullit për mëkatin më të rëndë, ata në këtë kanë parë jo vetëm sulm në besimet e veta tradicionale, por po ashtu edhe përpjekje të rrënimimit të pasqyrës shoqërore të jetës së tyre. Sidomos nuk ju ka pëlqyer përzierja e Islamit në atë që ata i kanë konsideruar objekte të pastra "botërore" jashtë suazave të religjionit - sikur ekonomia, çështjet e barazisë shoqërore dhe mirësjelljes së njerëzve përgjithësisht - sepse kjo përzierje nuk është pajtuar krejtësisht me shprehitë e tyre afariste, me shfreninë e tyre dhe pikëpamjet e tyre mbi dobinë

fisnore. Për ata, religjioni ka qenë çështje personale - më tepër çështje e qëndrimit se sa e mirësjelljes.

Kjo ka qenë pikërisht e kundërta nga ajo që Pejgamberi arab e ka pasur në mend kur ka folur për religjionin. Sipas mendimit të tij, traditat dhe institucionet shoqërore gjithsesi hyjnë në sferën e religjionit, e ai sigurisht fort do të çuditej nëse dikush do t'i thoshte se religjioni është çështje e ndërgjegjies personale dhe se s'ka asgjë me mirësjelljen shoqërore. Pikërisht kjo veti e shpalljes së tij, më shumë se çkado tjetër, e ka bërë aq të padëshirueshëm për mekkasit paganë. Sikur mos të ishte përzierja e tij në problemet shoqërore, Pejgamberi do të ishte sigurisht më pak i refuzuar. Pa dyshim, Islami do t'u pengonte për më tepër që thelbi i tij ndeshet me pikëpamjet e tyre vetjake fetare, por ata më së sigurti do të duronin pas murmurimit të vogël fillestar pikërisht sikur që i kanë duruar, pak më herët, predikimet sporadike të kristianizmit - vetëm që Pejgamberi të kishte ndjekur shembullin e priftërinjve kristanë dhe të ishte kufizuar në atë që njerëzit t'i përudhë të besojnë në Zotin, që t'i luten për shpëtim dhe që në mënyrë korrekte të sillen në aspektin personal. Por ai nuk ka ndjekur shembullin kristian dhe nuk është kufizuar në pyetjet e besimit, moralit ritual dhe personal. Si ka mundur? A nuk i ka urdhëruar Zoti të lusë: Krijuesi ynë, na jep të mirën në këtë botë dhe të mirën në atë botën tjetër që do të vijë?

Në vetë strukturën e fjalisë kur'anore "e mira në këtë botë" i paraprinë "të mirës në botën tjetër që do të vijë"; e para, për shkak se njeriu është ndërtuar asisoj që së pari duhet të kërkojë plotësimin e nevojave të veta fizike, botërore, që të mund të dëgjojë thirrjen e shpirtit dhe të kërkojë të mirën në botën tjetër. Shpallja e Muhammedit nuk e ka vënë spiritualitetin si diç të ndarë apo të kundërshtuar me jetën fizike; ajo ka zënë fill plo-

tësisht në botëkuptimin se shpirti dhe trupi janë vetëm aspekte të ndryshme të një të vetmit realitet - jetës njerëzore. Sipas natyrës së gjërave, ai nuk ka mund të plotësohet vetëm me kujdesin për qëndrimin moral të individit, por është dashur të synojë që këtë qëndrim ta përcjellë në formën e caktuar shoqërore që do t'i sigurojë çdo anëtar të bashkësisë masën më të madhe të mundur të mirëqenies fizike dhe materiale dhe, kështu, rastin më të madh për rritjen spirituale.

Ai ka filluar duke i folur popullit se aksioni është pjesë e fesë, sepse Zotit nuk i intereson vetëm çka dikush beson por edhe çka bën - sidomos nëse kjo u përket edhe të tjerëve, e jo vetëm Atij. Ai ka predikuar, në paraqitjet më të gjalla figurative që Zoti ia ka vënë në dispozitim, kundër eksploatimit të dobtëve nga ana e të fortëve. Ai e shtoi tezën e padëgjuar se meshkujt dhe femrat janë të barabartë para Zotit dhe se të gjitha detyrat dhe shpresat fetare aplikohen barabartë mbi ta; ai madje ka shkuar aq larg të deklarojë, për tmerr të të gjithë mekikasve paganë, se femra është personalitet vetëm për veti, e jo vetëm nëpërmjet të raportit të vet me mashkullin si nënë, motër, bashkëshorte ose vajzë, dhe se për këtë është e autorizuar që të posedojë pronësi të veten, t'i zhvillojë punët për llogarinë e vet dhe të disponojë me personalitetin e vet me rastin e martesës! Ai i gjykoj të gjitha lojërat e bixhozit dhe të gjitha format e dehjes, sepse, sipas fjalëve të Kur'anit, e keqe e madhe është edhe diç të mira në to, por e keqja është më e madhe se të mirat. Mbi të gjitha, ai u ngrit kundër shfrytëzimit tradicional të disave nga disa të tjerë, kundër profitit që e sjellin kamatat në hua, pa marrë parasysh shkallën kamatore, kundër monopolit privat dhe shantazhit, kundër keqpërdorimit me nevojat e njerëzve tjerë - atë që ne sot e quajmë spekulim, kundër vlerësimit nën ndikimin e

ndjenjave grupore fisnore - në gjuhën moderne, "nacionalizmit". Në të vërtetë, ai ka mohuar çfarëdo të drejte morale ndjenjave dhe konsideratave fisnore. Në sytë e tij, motivi i vetëm ligjor, do të thotë i lejuar etik për grupëzimin lokal, nuk është rastësia e prejardhjes së përbashkët por pranimi i lirë, i vetëdijshëm i pikëpamjes së përbashkët për jetën dhe kriteri i përbashkët i vlerave morale.

Në realitet, Pejgamberi ka kërkuar revidimin e themeltë gati të të gjitha pikëpamjeve shoqërore që deri atëherë janë konsideruar të pandryshueshme dhe për këtë, si do të thuhet sot, ai "e ka kyçur religjionin në politikë"; risi krejtësisht revolucionare në atë kohë.

Drejtuesit e Mekës pagane kanë qenë të bindur se traditat shoqërore, shprehite, mendimet dhe marrëveshjet në të cilat janë edukuar janë më të mirat që mund të merren me mend. Natyrisht, për këtë kanë refuzuar përpjekjen e Pejgamberit që ta fusë religjionin në politikë, do të thotë që vetëdijen për Zotin ta bëjë pikë nismëtare të ndryshimit shoqëror - dhe e gjyquan si të pamoralshëm, rebelues dhe "në kundërshti me të gjitha ligjet e mirësjelljes". Dhe kur u bë e qartë se ai nuk është vetëm ëndërrues porse di si t'i nxisë njerëzit në aksion, mbrojtësit e rendit të konstituar mësynë kundërshtimin e rreptë dhe filluan ta ndjekin atë dhe ithtarët e tij...

Në këtë apo në atë mënyrë, të gjithë pejgamberët e kanë përgënjeshtuar "rendin e konstituuar" të kohës së vet, dhe nuk është befasuese se pothuaj të gjithë ata qenë persekutuar dhe përqeshur nga bashkëkombasit e tyre - e që të fundin prej tyre, Muhammedin, në Perëndim e përqeshin edhe sot!

### - 3 -

Menjëherë pas namazit të akshamit, sheiku Ibn Bulejhidi bëhet qendër e rrethit të kujdesshëm të beduinëve

nga Nexhdi dhe qytetarëve, me dëshirë që të shfrytëzohenë diç nga dija dhe urtësia e tij, derisa ai vetë gjithnjë ka dëshirë të dëgjojë çka do t'i thonë për përjetimet dhe udhëtimet e veta nëpër viset e largëta. Udhëtimet e gjata nuk janë aspak të çuditshme ndër nexhdasit; ata veten e quajnë "ehl 'ush-shidad", njerëzit në shalën e devesë, dhe secilit prej tyre shala u është më afër se sa shtrati në shtëpi. Ajo pa dyshim duhet t'i jetë më afër edhe beduinut të ri Harbit; i cili pikërisht i rrëfen Sheikut ç'i ka ndodhur në udhëtimin e paradokohshëm në Irak, ku, për herë të parë ka parë faranxhin - do të thotë evropianin (që për këtë emërtim mund t'u falënderohen francezëve me të cilët arabët kanë ardhur në kontakt gjatë kohës së luftërave kryqtare).

"Më thuaj, sheik, përse faranxhët gjithnjë bartin kapelë (sheshir) që i hijeson sytë e tyre? Si munden atëherë ta shohin qiellin?"

"Kjo është pikërisht ajo çka ata nuk duan ta shohin", - i përgjigjet Sheiku, duke ma shkelur syrin mua. "Ndoshta frikësohen që shikimi në qiell mos t'i përkujtojë në Zotin, kurse ata nuk duan që gjatë ditëve të punës t'i përkujtojë në Zotin..."

Të gjithë qeshemi, por beduini i ri është këmbëngulës në kërkimin e vet të dijes. "E përse atëherë Zoti është aq bujar ndaj tyre dhe u jep pasuri që ua mungon besimtarëve?"

"Eh, kjo është e thjeshtë, djalo. Ata adhurojnë arin dhe kështu hyjnia e tyre është në xhepat e tyre. "Por ky mi-ku im" - dhe ai vuri dorën në gjurin tim - "di më shumë për faranxhët se unë, sepse ai rrjedh prej tyre; Zoti - qoftë i lavdëruar emri i Tij - e ka nxjerrë nga terri në dritën e Islamit".

"A është kjo kështu, vëlla?", - më pyeti beduini i ri kurreshtar. "A është e vërtetë se ti ke qenë faranxhi?" - dhe

kur unë tunda kokën, ai pëshpëriti: "Qoftë i lavduar Zoti, qoftë i lavduar Zoti, që e udhëheq atë që dëshiron Ai ... Më thuaj, vëlla, përse faranxhët aq pak e nderojnë Zotin?"

"Ky është rrëfim i gjatë", - u përgjigja, - "dhe nuk mund shkurtimisht të shpjegohet. Krejt çka mundem tash të të them është se bota e faranxhëve është bërë bota e Dexhxhallit, të shndritshëm, mashtrues. A ke dëgjuar ndonjëherë për paradëftimin e Pejgamberit tonë se në ndonjë kohë më vonë shumica e popujve në botë do ta ndjekin Dexhxhallin duke besuar se ai është Zot?"

Dhe derisa ai, me pyetjen në sy, shikon në mua, unë flas, me pajtimin e dukshëm të sheik Ibn Bulejhidit, paradëftimin për shfaqjen e asaj qenie apokaliptike, Dexhxhallit, i cili do ta ketë një sy, por do të jetë i talentuar me forcën misterioze që Zoti do t'ia dhurojë. Ai do të dëgjojë çka flitet në skajin më të largët të Tokës, kurse me atë syrin do t'ia shohë gjërat që do të ndodhin në largësitë e pafund; ai do të fluturojë rreth Tokës me ditë, do të arrijë që thesarët e arit dhe argjendit befasisht do të paraqiten nën tokë, shiu do të bie dhe bimët do të rriten sipas urdhëresës së tij, do të vrasin dhe sërish do t'ia ngjallin, ashtu që të gjithë ata, feja e të cilëve është e dobët, do të besojnë se ai vetë është Zoti dhe do t'ia përkulen në idhujtari. Por, ai, feja e të cilit është e fortë, do të lexojë atë që është e shkruar me shkronja të zjarra në ballin e Dexhxhallit: Mohues i Zotit - dhe kështu do të dinë se ai është vetëm mashtrues që besimi i njeriut të vihet në provë...

Derisa miku im beduin shikon në mua me sy gjerë të hapur dhe murmurit "Kërkoj mbrojtjen e Zotit", unë i kthehem Ibn Bulejhidit:

"Kjo parabolë, sheik, a nuk është përshkrim i përshatshëm për qytetërimin modern tehnik? Ai është "me një sy". Do të thotë e kundron vetëm një anë të jetës - përparimin material - kurse nuk është i vetëdijshëm për

anën e tij shpirtërore. Me anë të çudivave të veta mekanike ai i mundëson njeriut të shohë e të dëgjojë larg mbi pikë-arritjen e vet natyrore dhe t'i mbulojë largësitë e pafund me shpejtësi të pamendueshme. Njohuritë e tij shkencore "mundësojnë rënien e shiut dhe rritjen e bimëve" dhe zbulojnë pasuri të papritura nën tokë. Mjekësiat e tij u sjell jetë atyre që tashmë janë të gjykuar në vdekje, derisa luftërat e tij dhe tmerret shkencore e rrënojnë jetën. Përparimi i tij material është aq i fuqishëm dhe aq i shkëlqyeshëm që ata me besim të dobët fillojnë të besojnë se ai është hyjni e pavarur, por ata që kanë mbetur të vetëdijshëm për Krijuesin e vet, qartë dallojnë se të adhurohet Dexhxhalli do të thotë të mohohet Zoti..."

"Ke të drejtë, Muhammed, ke të drejtë" - briti Ibn Bulejhidi, mallëngjyeshëm duke më goditur për gjuri. "Kurrë nuk më ka rënë në mend që në paradëftimin për Dexhxhallin të shikoj në atë dritë, por t'i ke të drejtë! Në vend që ta kuptojmë se përparimi i njeriut dhe rritja e pasurisë është bujari e Krijuesit tonë, gjithëherë e më shumë njerëz në marrëzinë e tyre fillojnë të mendojnë se ky është qëllim vetvetiu dhe i denjë për adhurim".

Po, mendoj në vete, perëndimori njëmend i është dorëzuar adhurimit të Dexhxhallit. Ai tashmë ka herë e ka humbur çdo virgjëri, çdo integritet të brendshëm me natyrën. Jeta i është bërë enigmë. Ai është skeptik prandaj edhe i izoluar nga vëllai i vet, i vetmuar. Që mos të shkatërrohet në këtë vetmi, ai duhet të përpiqet që me mjetet e jashtme të dominojë me jetën. Fakti se është i gjallë nuk mund më vetvetiu t'i ofrojë siguri të brendshme; ai gjithnjë është dashur të luftojë mundimshëm për të, prej çastit në çast. Pasi e ka humbur çdo orientim metafizik dhe ka vendosur të jetojë pa të, ai gjithëherë duhet të gjejë për vete aleatë mekanikë; së këndejmi vërsulja e tërbuar, dëshpëruese e teknikës së tij. Ai çdo ditë

zbulon makina të reja dhe secilës prej tyre i jep diçka nga shpirti i vet që ato të luftojnë për ekzistencën e tij. Ato vërtet këtë e bëjnë, por në të njëjtën kohë ato krijojnë për të nevoja të reja, rreziqe të reja, frika të reja dhe etjen e pashueshme për aleatë të ri, megjithatë artificiale. Shpirti i tij humbet në punën gjithnjë e më të guximshme, më fantastike, më të fuqishme të makinës krijuese, kurse makina humb qëllimin e vet të vërtetë - që ta ruajë e ta pasurojë jetën njerëzore - dhe zhvillohet në hyjni vetëm për vete, në Molohun përbindësh të çelikutë. Priftërinjtë dhe predikuesit e kësaj hyjnie të pangishme duket se nuk janë të vetëdijshëm se shpejtësia e përparimit modern teknik është rezultat jo vetëm i rritjes pozitive të dijes, por po ashtu edhe i dëshpërimit shpirtëror dhe se të arriturat e mëdha materiale në dritën e të cilave perëndimori e proklamoi vullnetin e vet që të zotërojë me natyrën janë, në thelb, të karakterit defansiv; pas fasadës së tyre të shkëlqyeshme përgjon frikën nga e Panjohura.

Qytetërimi perëndimor nuk ka qenë në gjendje që ta vërë baraspeshën ndërmjet nevojave trupore dhe shoqërore të njeriut dhe synimeve të tij shpirtërore; ai e ka lëshuar etikën e tij zanafillore e që gjatë kësaj nuk ka qenë në gjendje vetë të ndërtojë çfarëdo sistemi tjetër moral, qoftë teoretikisht, që do t'i imponohej arsyes. Përkundër të gjitha të arriturave të veta në arsim, ai ka qenë në gjendje që ta ngadhënjë gatishmërinë naive të njeriut që të jetë pre e lehtë e çfarëdo parrulle, sado absurde, që demagogët e kujdesshëm mund ta mendojnë. Ai e ka ngritur teknikën e "organizimit" deri te niveli i artit të bukur - e megjithatë kombet e Perëndimit për çdo ditë shprehin paaftësinë e vet skajore që t'i kontrollojnë forcat që dijetarët e tyre i lirojnë, dhe tashmë kanë arritur pikën ku qartë mundësitë e pakufizuara shkencore shkojnë dorë për dorë me kaosin gjërë të shtrirë. Pa ndonjë orientim të mirëfilltë

religjioz, përndimori nuk mund të ketë dobi morale nga drita e dijes që shkenca e tij - pa dyshim e madhe - e rrezaton. Në të mund të aplikohen fjalët e Kur'anit:

"U ngjasojnë atyre që e ndezin zjarrin, e kur ai ta ndriçojë rrethin e tyre, Allahu ua merr dritën dhe i lë në terr, dhe ata fare nuk shohin! Të shurdhër, memecë e të verbër janë, kursesi që të vetëdijesohen".

E megjithatë, në vrazhdësinë e verbërisë së vet, përndimorët janë të bindur se pikërisht qytetërimi i tyre botës do t'ia sjellë dritën dhe fatin ... Në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë ata kanë menduar ta përhapin Ungjilloren e kristianizmit nëpër tërë botën; por tash kur zjarri i tyre religjioz është ftohur aq sa religjionin e konsiderojnë vetëm shtresë qetësuese muzikore - të cilës i është lejuar ta përcjellë por jo edhe të ketë ndikim në jetën "e mirëfilltë", - ata kanë filluar në vend të kësaj ta përhapin Ungjilloren materialiste të "mënyrës përndimore të jetesës", besimi se të gjitha problemet njerëzore mund të zgjidhen në fabrika, laboratorë dhe nëpër tavolinat statistikore.

Kështu Dexhkhalli erdhi në shprehje...

#### - 4 -

Heshtje e gjatë. Atëherë përsëri foli Sheiku: "Djalo, të kuptuarit ç'do të thotë Dexhkhall, a të ka shtyrë ta përqafosh Islamin?"

"Në njëfarë mënyre, mendoj se kjo është dashur të jetë, por ky ka qenë vetëm hapi i fundit".

"Hapi i fundit... Po, ti njëherë më ke treguar për rrugën tënde në Islam - por kur dhe si, në realitet, tu bë e qartë se Islami do të mund të bëhej caku yt?"

"Kur? Të kujtohem... Mendoj se kjo ka qenë një ditë dimri në Afganistan, ku kali ma humbi patkoin e më duhej të kërkoj farkëtar në një fshat jashtë rrugës sime; atje

më tha një njeri: "Po ti je musliman, por ti këtë vetë ende nuk e di..." Ka qenë kjo tetë muaj para se e kam pranuar Islamin... Kam qenë në rrugë prej Heratit në Kabul..."

Kam qenë në rrugë prej Heratit për në Kabul dhe kam kalëruar, në përcjellje të Ibrahimit dhe një kalorësi afganistanez, nëpër fushëgropën me barë të bezdisshme malore dhe kalimet e Hindukushit, në Afganistanin Qendror. Ishte ftohtë dhe bora shkëlqente, kurse nga të gjitha anët ngriheshin malet e rrëpinjta, të zeza e të bardha.

Kam qenë i pikëlluar dhe, në të njëjtën kohë, çuditërisht i lumtur atë ditë. Kam qenë i pikëlluar për atë se njerëzit me të cilët kam jetuar gjatë disa muajve të fundit janë dukur të ndarë me velat e patejdukshëm të dritës dhe forcës që feja e tyre ka mundur t'ua japë; kam qenë i lumtur për shkak se drita dhe forca e fesë kanë qenë aq afër syve të mi sikur malet e bardha e të zeza - gati që me duar mund të preken.

Kali im filloi të shqepojë dhe diç cingëroi në thundrën e tij, patkoi i hekurt ishte liruar dhe mbahej vetëm në dy gozhda.

"A ka diku në afërsi fshat ku do të mund ta gjenim farkëtarin?", - e pyeta përcjellësin tonë afganistanez.

"Fshati Deh-Zangi është mezi disa kilometra prej këtu. Atje ka farkëtar kurse Hakim Hazraxhata e ka kullën e vet atje".

Dhe ashtu kalëruam në Deh-Zangi mbi borën e shkëlqyeshme, ngadalë që mos ta lodhim kalin tim. Hakimi, guvernatori i krahinës, ishte njeri i ri me trup të vogël dhe fytyrë të hareshme - njeri i këndshëm që ishte i gëzueshëm të ketë musafirë të huaj në vetminë e kullës së vet modeste. Edhe pse kushëri i afërt i mbretit Amanullahit, ai ka qenë njëri prej njerëzve më modestë që i kam takuar në Afganistan. Më detyroi të mbeten tek ai dy ditë.

Në mbrëmjen e ditës së dytë jemi ulur sikur edhe rëndom për darkë të pasur, kurse pas kësaj një njeri nga fshati na ka argëtuar me balada që i këndonte në përcjellje të lahutës me tre tela. Këndonte në gjuhën pashta - gjuhë që s'ë kuptoja - por disa fjalë persishte që i përdorte gjallë janë theksuar në dhomën e ngrohtë, të shtruar me qilima dhe në shkëlqimin e ftohtë të borës që depërtonte nëpër dritare. Ai ka kënduar, më kujtohet, për luftën e Davudit me Goliatin - për luftën kundër forcës së vrazhdë - dhe edhe pse nuk kam mundur plotësisht t'i përcjell fjalët e këngës, tema më ishte e qartë; fillonte në përulshmëri, pastaj ngrihej në ngjitje të furishme të pasioneve deri te britma përfundimtare, triumfale.

Kur balada përfundoi, Hakimi vërejti: "Davudi është i vogël, por besimi i tij ka qenë i madh..."

Nuk munda të përmbahem që mos të shtoj: "Kurse ju jeni shumë. Por besimi i juaj është i vogël".

Mikpritësi im më shikoi me habi dhe, i hutuar me atë që gati makinalisht e thashë, filloi të arsyetohet. Shpjegimi im mori formën e rrebeshit të pyetjeve:

"Si ka ndodhur që ju, muslimanët, e keni humbur vetëbesimin që dikur ju ka mundësuar që ta përhapni fenë tuaj, për më pak se njëqind vjet, prej Arabisë në Perëndim deri në Atlantik dhe në lindje thellë në Kinë - e tash po u dorëzoheni aq lehtë, aq pafuqishëm, mendimeve dhe traditave të Perëndimit? Përse nuk mundeni ju, të parët e të cilëve e kanë ndriçuar botën me dituri dhe art në kohën kur Evropa ka qenë në terrë, në barbarizëm dhe padije të thellë, të mblidhni aq guxim që t'i ktheheni fesë suaj, të shkëlqyeshme? Si kjo që ai Ataturku, ai maskarai i parëndësishëm që po i refuzon të gjitha vlerat e Islamit, të bëhet për ju muslimanët simbol i "rilindjes muslimane?"

Mikpritësi im mbeti pa fjalë. Jashtë filloi të binte borë. Sërish ndjeva atë valën e pikëllimit dhe lumturisë së përzier që e kam ndier duke iu afruar Deh-Zangut. Kam ndier lavdinë e kaluar dhe turpin e tanishëm që i përshkonte të gjithë bijtë e mëvonshëm të një qytetërimi të madh.

"Më thuaj - si erdhi deri tek ajo që feja e Pejgamberit tuaj dhe tërë qartësia dhe thjeshtësia e tij është varrosur nën rrëmujën e të filozofuarit dhe të cikrimuarit javash të skolasikëve tuaj? Si ka ndodhur që princat tuaj dhe makropronarët e tokës të kënaqen në pasuri dhe luks derisa aq shumë vëllezër të tyre muslimanë pësojnë varfëri dhe ndytësi të patheksueshme - edhe pse Pejgamberi juaj ka mësuar që "askush nuk mundet veten ta quajë besimtarë nëse ha me bollëk, kurse fqiu i tij mbetet i uritur?" A mund të më shpjegoni përse e keni shtyrë femrën në prapavijë të jetës së saj - edhe pse gratë rreth Pejgamberit dhe rreth as`habëve të tij kanë pasur rol aq të madh në jetën e burrave të vet? Si erdhi deri tek ajo që shumë prej jush muslimanëve të jenë të paditur, e numri aq i vogël di mezi të lexojë e shkruajë - edhe pse Pejgamberi juaj ka shpallur se "synimi kah dituria është detyra më e shenjtë për çdo musliman e muslimane" dhe se "epërsia e dijetarit ndaj atij që është vetëm i devotshëm është sikur epërsia e Hënës së plotë ndaj yjeve tjerë?"

Edhe më mikpritësi im zgurdullonte në mua pa fjalë dhe unë fillova të mendoj se sjellja ime thellë e ka prekur. Njeriu me lahutë, duke mos e kuptuar sa duhet persishten që të mund të më përcjellë, e shikonte me habi të huajin që me aq afsh i flet Hakimit. Më në fund, Hakimi e mblodhi pranë vetes gujën e vet të gjerë, të verdhë nga gëzofi i deles, sikur po i vinte të ftohtë, dhe pëshpëriti:

"Po - ju jeni musliman..."

Unë u qesha dhe u përgjigja: "Jo, unë nuk jam musliman, por kam parë aq shumë bukuri në Islam që nganjë-

herë më zemëron kur ju shikoj se si e shkapërderdhni... Më falni nëse kam folur rreptë. Nuk kam folur si armik".

Por mikpritësi im tundi kokën. "Jo, ashtu është si kam thënë! Ju jeni musliman, vetëm ju këtë as vetë nuk e dini ... Përse nuk e shqiptoni, tash e këtu: "Eshhedu en la ilahe il-lall-llah, ve eshedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu - Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij" dhe të bëheni musliman njëmend, sikur që tashmë jeni në zemrën tuaj? Thuani këtë, vëlla, thuani këtë tash, dhe unë nesër do të shkoj me ju në Kabul e do t`ju shpie tek emiri, e ai do t`ju pranojë duarhapur si njërin prej tanëve. Ai do t`u japë shtëpi, kopshte dhe bagëti, kurse ne do t`ju duam. Thuani këtë, vëlla..."

"Nëse këtë kurdoherë njëmend e shqiptoj, kjo do të jetë për shkak të qetësisë së shpirtit tim, e jo për dashuri të shtëpive dhe kopshteve të emirit".

"Por", - insistonte ai, - "ju tashmë dini shumë më tepër për Islamin se shumica jonë! Ç`është ajo që ju ende nuk e keni kuptuar?"

"Kjo nuk është çështje e të kuptuarit. Kjo është më tepër çështje e bindjes; bindjes se Kur`ani është njëmend fjalë e Zotit, e jo vetëm krijesë e shkëlqyeshme e mendjes së madhe njerëzore..."

Por fjalët e mikut tim afganistanez kurrë plotësisht nuk më kanë lëshuar në muajt e ardhshëm.

Nga Kabuli kam kalëruar me javë nëpër Afganistanin Jugor - nëpër qytetin e vjetër Gazna, nga i cili para pothuaj një mijë vjet Muhammedi i madh është nisur në pushtimin e vet të Indisë; nëpër Kandaharin ekzotik, ku keni mundur të shihni luftëtarët më të rreptë në tërë botën; nëpër shkretëtirat e territorit jugperëndimor afganistanez, mbropa deri në Herat, ku ka filluar udhëtimi im afganistanez.

Ka qenë viti 1926, nga fundi i dimrit, kur e kam lëshuar Heratin në hapin e parë të udhëtimit tim të dytë në shtëpi, i cili do të duhej të më sjellë me tren prej kufirit afganistanez deri në Marv në Turkestanin rus, deri në Samarkand, Buharë dhe Tashkent, e prej këtu nëpër stepet turkmene deri në Ural dhe Moskë.

Përshtypja ime e parë (dhe më e përhershme) nga Rusia Sovjetike - në stacionin hekurudhor Marv - ka qenë pllakati i madh, bukur i zbatuar që dëfton proletarin e ri në petkun e kaltër të punës se si me këmbë shtynë njëfarë zotëriu qesharak mjekërbardhë, i veshur me tesha fërfëlitëse, nga qielli me re të mbuluar. Në legjendën, në rusishte, nën panonë shkruante: "Kështu punëtorët e Unionit Sovjetik e kanë larguar zotin nga qielli i tij! Botim i Shoqatës së të pafeve të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike".

Kështu propaganda antireligjioze zyrtarisht e sanksionuar theksohej kudo; në ndërtesat publike, në rrugë e sidomos, në afërsi të faltoreve. Në Turkestan, këtë, natyrisht, në të shumtën kanë qenë xhamitë. Edhe pse lutjet e përbashkëta nuk kanë qenë shprehimisht të ndaluara, pushteti ka bërë çdo gjë që t'i kthejë nga pjesëmarrja në to. Shpesh më kanë folur, sidomos në Buharë dhe Tashkent, që agjentët policorë i shkruajnë emrat e të gjithëve që hyjnë në xhami; ekzemplarët e Kur'anit konfiskohen dhe shkatërrohen, kurse argëtimi i dashur i të pafeve të ri është të hedhin koka derri në xhami; vërtet traditë mahnitëse.

Me ndjenjën e lehtësisë e kalova kufirin polak pas disa javë udhëtimi nëpër Rusinë aziatike e Evropiane. Kam shkuar drejt në Frankfurt dhe u paraqita në mjedisin tashmë të afërt për mua të gazetës sime. Nuk më është dashur shumë të konstatoj që gjatë kohës së mungesës sime emri im ishte bërë i njohur dhe se tash më kanë konsideruar njërin prej korrespondentëve më të da-

lluar të Evropës Qendrore. Disa nga artikujt e mi, sidomos ata në lidhje me psikologjinë e ngatërruar religjioze të iranianëve, kanë zgjuar vëmendjen e orientalistëve të dalluar dhe morën më shumë se notë kaluese. Në bazë të këtyre arritjeve qesh ftuar të mbaj një varg ligjëratash në Akademinë Gjeopolitike të Berlinit, ku më thanë se kurrrë më parë nuk ka ndodhur që njeriut të moshës sime (nuk i kam pasur as njëzet e gjashtë vjet) t'i ofrohet nder i tillë. Artikujt tjerë me interes të përgjithshëm qenë botuar, me lejen e Frankfurter Zeitungut, në shumë gazeta; një artikull, mësova, qe botuar pothuaj tridhjetë herë. Shkurt, endjet e mia iraniane kanë qenë jashtëzakonisht frytdhënëse.

Në atë kohë jam martuar me Elzën. Dy vjet të mungesës sime nga Evropa nuk e kanë dobësuar dashurinë tonë por madje e kanë forcuar dhe me lumturinë që kurrrë më parë nuk e kam ndier kam refuzuar frikën e saj për dallimin e madh në vitet tona.

"Por si do të martohesh me mua?", - përpëlitej ajo. "Nuk i ke ende as njëzet e gjashtë, kurse unë i kam mbi dyzet vjet. Mendo për këtë: kur ti do t'i kesh tridhjetë, unë do t'i kam dyzet e pesë, e kur ti t'i kesh dyzet, unë do të jam grua e vjetër..."

Kam qeshur: "Ç`pengon kjo? Unë nuk mund ta mendoj ardhmërinë pa ty".

Më në fund lëshoi pe.

Nuk e kam tepruar kur kam thënë se nuk mund ta mendoj ardhmërinë pa Elzën. Bukuria e saj dhe dashuria e saj instiktive aq shumë më kanë tërhequr sa nuk kam mundur madje të shikoj asnjë femër tjetër, kurse të kuptuarit e saj ndijor të asaj që po e kërkoi nga jeta i ndriçonte shpresat dhe dëshirën time vetjake dhe i bënte më reale dhe më të kapshme se që do t'i bënte kurdoherë ato mendimi im personal.

Me një rast - do të ketë qenë kjo të jetë disa ditë pasi jemi martuar - ajo vërejt: "Sa e çuditshme është që ti e nënçmon misticizmin në religjion... Ti vetë je mistik - lloj sensual i mistikut, i ofron gishtat tu drejt jetës rreth vetes, i sheh format e ngatërruara, mistike në gjërat e përditshme - në shumë gjëra që njerëzve të tjerë u duken krejtësisht të rëndomta... Por atë çast ku i kthehesh religjionit, ti je vetë truri. Te shumica e njerëzve kjo është pikërisht e kundërt..."

Por Elza nuk ka qenë njëmend e hutuar. Ajo e dinte për çka synoj kur i kam folur për Islamin, dhe ndonëse ajo, mbase, nuk ka ndier nevojën e njëjtë sikur unë, dashuria e saj e ka shtyrë të marrë pjesë në hulumtimin tim.

Shpesh e lexonim Kur'anin së bashku dhe diskutonim për idetë e tij; Elza, sikur edhe unë, ka qenë gjithnjë e më shumë e impresionuar me lidhshmërinë e brendshme të mësimave të tij morale dhe udhëzimeve praktike. Sipas Kur'anit, Zoti nuk e ka ftuar njeriun në nënshtrim të verbër por më tepër i është drejtuar arsyes së tij; Ai nuk ka qëndruar anash fatit të njeriut por ka qenë "më afër se arteria juaj në qafë"; Ai nuk ka tërhequr kurrfarë vije ndarëse ndërmjet fesë dhe mirësjelljes shoqërore kurse Ai, që ndoshta ka qenë më e rëndësishme, nuk ka filluar me aksionin se jeta është e ngarkuar me konfliktin ndërmjetë materies dhe shpirtit dhe se rruga drejt Dritës kërkon lirim të shpirtit nga prangat e trupit. Çdo formë e mohimit të jetës dhe vetëfikjes së epsheve me mundimin e trupit, Pejgamberi e ka gjykuar në thëniet sikur: "Asketizmi nuk është për ju" dhe "Nuk ka murgëri në Islam". Dëshira njerëzore të jetojë jo vetëm që është e pranuar si instinkt pozitiv, i dobishëm, por po ashtu është dhuruar me dritën e postullatit etik. Njeriu, në realitet, mësohet: Ti jo vetëm që mundesh plotësisht ta shfrytëzosh jetën tënde, por je i obliguar ta bësh këtë.

Fotografia e tërësishme e Islamit paraqitej me përfundimësinë dhe vendimtaritetin e tillë që nganjëherë më ka magjepsur. Ajo ka marrë formën me ndonjë proces që pothuaj ka mund të përshkruhet si një lloj i osmozës shpirtërore - do të thotë, pa kurrfarë përpjekjesh të mia të hartoj dhe "sistematizoj" shumë fragmente të dijes në të cilat kam hasur gjatë kohës së katër viteve të kaluara. Kam parë para vetes diç si vepër e përkryer arkitektonike, me të gjitha elementet e tij harmonikisht të menduara që plotësojnë dhe ndihmojnë njëri - tjetrin, pa asgjë të tepërt, pa kurrfarë mungese - baraspesha dhe qetësia që u jep ndjenjë se çdo gjë në botëkuptimet dhe pikëpamjet e Islamit është "në vendin e vet të vërtetë".

Para trembëdhjetë shekujsh një njeri është ngritur dhe ka thënë: Unë jam vetëm njeri; por Ai që e ka krijuar gjithësinë më ka urdhëruar që t'ua sjell Shpalljen e Tij. Që të mund të jetoni në pajtim me planin e krijimit të Tij, Ai më ka urdhëruar që t'ju përkujtoj në ekzistimin, gjithëfuqinë dhe gjithëdijen e Tij dhe t'u ofroj programin e mirësjelljes. Nëse e pranoni këtë përkujtim dhe këtë program, më ndiqni. Ky ka qenë thelbi i misionit pejgamberik të Muhammedit.

Skema shoqërore që ai e ka shtruar është e thjeshtësisë së tillë që shkon së bashku vetëm me madhështinë reale. Ajo fillon nga postullati se njerëzit janë qenie biologjike, me nevoja biologjike, dhe se Krijuesi i ka kushtëzuar ashtu që duhet patjetër të jetojnë në grupe që të mund plotësisht t'i plotësojnë kërkesat e veta psikike, morale dhe intelektuale; shkurtimisht, ata janë të varur njëri prej tjetrit. Përhershmeria e ngritjes së rritjes shpirtërore të personalitetit (synimi themelor i çdo religjioni) varet nga ajo a e ndihmojnë, kurajojnë dhe mbrojnë njerëzit rreth tij që, natyrisht, presin bashkëpunimin e njëjtë prej tij. Kjo ndërvarshmëri njerëzore ka qenë arsye për çka në

Islam religjioni nuk ka mund të jetë i ndarë nga ekonomia dhe politika. T'i rregullojë raportet praktike njerëzore në mënyrën e atillë që secili të gjejë sa më pak pengesa e sa më shumë përkrahje në zhvillimin e personalitetit të vet - ky dhe asgjë tjetër është koncepti islam i funksionit të mirëfilltë të shoqërisë. Kështu ka qenë vetëm natyrore që sistemi që e ka proklamuar Pejgamberi Muhammed në njëzet e tre vitet e pejgamberisë së tij ka të bëjë jo vetëm me gjërat shpirtërore, por ofron edhe kornizë për të gjitha aktivitetet individuale dhe shoqërore. Ai ofron koncept jo vetëm të respektit individual, por po ashtu edhe të shoqërisë së baraspeshuar që duhet të nxisë respekt të tillë. Ai ofron vijat themelore të bashkësisë politike - vetëm konturat, Pasi hollësisht e nevojave politike të njeriut janë të kushtëzuara kohësisht dhe prandaj të ndryshueshme - sikur edhe skemën e të drejtave personale dhe detyrave shoqërore të cilat fakti i evolucionit historik si duhet është paraparë. Në jetë dhe në të gjitha pikëpamjet e tij, morale dhe fizike, individuale dhe të përbashkëta; problemet e trupit dhe shpirtit, seksit dhe ekonomisë kanë, së bashku me problemet e teologjisë dhe adhurimit, vendin e vet legjitim në mësimet e Pejgamberit dhe asgjë që ka të bëjë me jetën nuk duket e parëndësishme e që mos të futet në sferën e mendimit fetar - madje jo as pyetjet e tilla "profane" siç janë tregtia, trashëgimia, e drejta e pronësisë ose e posedimit të tokës.

Të gjitha dizpozitat e të drejtës islame janë të koncipuara me qëllim të dobisë së barabartë për të gjithë anëtarët e bashkësisë, pa marrë parasysh në lindjen, racën, gjininë ose përkatësinë më të hershme shoqërore. Kurrfarë të drejtash të veçanta nuk janë rezervuar për themelesit e bashkësisë ose pasardhësit e saj. Më të lartë dhe më të ulët janë, në kuptimin shoqëror, shprehje joekz-

tuese, e as që ekziston koncepti i klasës. Të gjitha të drejtat, detyrat dhe mundësitë aplikohen njëjtë mbi të gjithë që i përkasin Islamit. Nuk ka nevojë për prift që të ndërmjetësojë ndërmjet njeriut dhe Zotit sepse "Ai di çka kanë haptazi në duart e tyre sikur edhe atë çka fshehin pas shpinave të veta". Nuk pranohet lojalitet tjetër veç lojaliteti Zotit, Pejgamberit të Tij; prindërve dhe bashkësisë që ka për qëllim konstituimin e mëshirës së Zotit në Tokë; kjo e përjashton atë lloj të lojalitetit që thotë "qoftë e drejtë, qoftë e shtrembër, vendi im" ose "kombi im". Që ta shpjegojë këtë parim, Pejgamberi mjaft qartë ka thënë në disa raste: "Nuk na takon neve ai që thërret në përkatësinë fisnore (ekstremizëm, asabije, N. I.), nuk na takon neve ai që lufton për çështjen e përkatësisë fisnore; nuk na takon neve ai që vdes për dashuri të përkatësisë fisnore".<sup>7</sup>

Para Islamit, të gjitha organizatat politike - madje edhe ato në bazën teokratike ose gjysmëteokratike - kanë qenë të kufizuara me koncepte të ngushta fisnore ose homogjenitetit fisnor. Së këndejmi mbretërit hyjnorë të Egjiptit të vjetër nuk kanë menduar asgjë jashtë horizontit të luginës së Nilit dhe banorëve të saj, kurse në shtetin e hershëm teokratik të hebrenjve, kur qe menduar që Zoti të sundojë, pashmangshëm ky ka qenë zoti i Bijëve të Izraelit. Në strukturën e mendimit kur'anor, nga ana tjetër, për shqyrtimin e prejardhjes dhe përkatësisë fisnore nuk ka pasur vend. Islami ka presupozuar bashkësinë e tërësishme politike që rrënon ndarjet konvencionale në themel të gjinisë, fisit ose racës. Në këtë pikëpamje, Islami dhe kristianizmi, do të mund të thuhej, kanë pasur qëllimin e njëjtë: e përfaqësojnë bashkësinë ndërkombe-tare të njerëzve të bashkuar me përkatësinë e tyre idealit të përbashkët; mirëpo, derisa Kristianizmi është kënaqur vetëm me përfaqësimin moral të këtij parimi dhe, duke

iu këshilluar ithtarëve të vet që mbretit t'ia japin të tijën, e ka kufizuar thirrjen e vet universale në sferën shpirtërore, Islami e ka nxjerrë para botës vizionin e organizimit politik në të cilin vetëdija për Zotin ka qenë burimi kryesor i mirësjelljes praktike të njeriut dhe themeli i vetëm i të gjitha institucioneve shoqërore. Për këtë - duke e përmbushur atë që Kristianizmi nuk e ka përmbushur - Islami ka hapur kaptinë të re në zhvillimin e njeriut: rasti i parë i shoqërisë së hapur, ideologjike, përkundër shoqërive të mbyllura, racore dhe gjeografikisht të kufizuara të të kaluarës.

Mesazhi i Islamit e ka konceptuar dhe sendërtuar në praktikë qytetërimin në të cilin nuk ka pasur kurrfarë vendi për nacionalizmin, kurrfarë interesash të veçanta, kurrfarë ndarje të klasave, kurrfarë kishe, kurrfarë priftërie, kurrfarë aristokracie trashëguese, në realitet, kurrfarë funksionesh trashëguese përgjithësisht. Qëllimi ka qenë konstituimi i teokracisë në raport me Zotin dhe demokracisë ndërmjet njeriut dhe njeriut. Cilësia më e rëndësishme e këtij qytetërimi të ri - cilësia që e dallon nga të gjitha lëvizjet tjera në historinë njerëzore - ka qenë fakti se ai është koncipuar me anë të pranimit vullnetar dhe është rritur në pranimin vullnetar të njerëzve të interesuar. Këtu përparimi shoqëror nuk ka qenë, sikur në të gjitha bashkësitë dhe qytetërimet tjera të njohura në histori, rezultat i shtypjes dhe kundërshtypjes së interesave të konfrontuara, por pjesë përbërëse e "kushtetutës" burimore. Me fjalë të tjera, kontrata e sinqertë shoqërore qëndron në rrënjë të gjërave; jo si frazë e të folurit që e kanë formuluar brezat e mëvonshëm të pushtetmbajtësve në mbrojtje të privilegjeve të veta, por burim real, historik i qytetërimit islam. Kur`ani thotë: "Shih, Zoti ka blerë prej besimtarëve personalitetet dhe pasurinë e tyre, duke iu ofruar parajsën si kundërvlerë... Gëzohuni, për

këtë, për dakordimin që e keni bërë, sepse kjo është fitore e shkëlqyeshme".

E kam ditur se kjo "fitore e shkëlqyeshme" - shembulli i vetëm i kontratës së vërtetë shoqërore i shënuar në histori - ka qenë sendërtuar vetëm gjatë kohës së periudhës mjaft të shkurtër, ose, thënë më mirë, vetëm gjatë kohës mjaft të shkurtër është bërë përpjekje e gjerë që kjo të realizohet. Më pak se një shekull pas vdekjes së Pejgamberit, forma politike e Islamit të dikurshëm ka filluar të prishet dhe, në shekujt vijues, programi original shkallërisht është shtyrë në prapavijë. Kanë filluar luftërat fisnore për pushtet në vend në kontratës së lirë të meshkujve dhe femrave të lira; mbretëria trashëguese, aq e kundërt me konceptin politik të Islamit sa edhe politeizmi konceptit të tij teologjik së shpejti u paraqit - kurse me të luftërat dhe intrigat dinastike, privilegjet fisnore dhe përndjekjet dhe degradimi i rëndomtë i religjionit në statusin e shërbëtores së pushtetit politik; shkurt, mendimtarët e mëdhenj islamë kanë tentuar ta mbajnë ideologjinë e tij të vërtetë të lartësuar e të pastër, por ata që kanë ardhur pas tyre kanë qenë me vlera më të vogla dhe kanë filluar të zhyten, pas dy-tre shekujve, në moçalin e konvencioneve intelektuale, kanë pushuar të mendojnë pavarësisht dhe janë kënaqur me përsëritjen e frazave të vdekura të brezave të mëhershëm - duke harruar se çdo mendim njerëzor kohësisht është i kushtëzuar, i gabuar, prandaj edhe i nevojitet përtëritje e përhershme. Fuqia zanafillore lëvizëse e Islamit, aq e madhe në fillimin e vet, ka mjaftuar për një kohë që ta bartë bashkësinë muslimane të popujve deri te lartësitë e mëdha kulturore - deri te ai nivel madhështor i të arriturave shkencore, letrare dhe artistike që historiaët e përshkruajnë si shekulli i artë i Islamit; por gjatë edhe disa shekujve kjo fuqi lëvizëse është fikur për shkak të mungesës së ushqimit

shpirtëror, dhe qytetërimi musliman gjithnjë e më shumë ka stagnuar e privuar nga fuqia krijuese.

Nuk kam pasur kurrfarë iluzionesh në aspekt të gjendjes së tanishme të gjërave në botën muslimane. Katër vjet që i kam kaluar në ato vende më kanë dëftuar që, derisa Islami është ende gjallë, i dukshëm në aspektin e botës së pjesëtarëve të vet dhe në pranimin e heshtur të postulateve të tij etike, ata vetë janë si njerëz të paralizuar, të paaftë që besimet e veta t'i kthejnë në aksion frytdhënës. Por ajo që më përkiste më shumë se sukses i muslimanëve të sotshëm që ta aplikojnë sistemin e Islamit, kanë qenë mundësitë e vetë këtij sistemi. Për mua ka mjaftuar të dijë se për një kohë të shkurtër, m'u në fillim të historisë islame, është bërë përpjekje e suksesshme që ky sistem të aplikohet në praktikë dhe çka është dukur e mundur njëherë, mund realisht të bëhet e mundur sërish. A ka qenë me rëndësi, i thashë vetes, që muslimanët kanë lajthuar nga mësimi zanafillor dhe kanë rënë në indolencë dhe padije? A është me rëndësi që ata nuk jetojnë sipas idealit që ua afroi Pejgamberi arab para trembëdhjetë shekuj - nëse vetë ideali ende qëndron i përshtatshëm për të gjithë që dëshirojnë ta dëgjojnë Shpalljen e tij?

Është krejtësisht e mundur, kam menduar, se neve, që vijmë më vonë, kjo shpallje shumë më tepër na nevojitet se njerëzve nga koha e Muhammedit. Ata kanë jetuar në një rreth shumë më të thjeshtë se që është yni, dhe se problemet dhe vështirësitë e tyre ka qenë shumë më lehtë të zgjidhen. Bota në të cilën kam jetuar unë - tërë ajo botë - lëkundej për shkak të mungesës së çfarëdo marrëveshjeje për atë se çka është shpirtërisht e mirë dhe e keqe dhe, për këtë, shoqërisht dhe ekonomikisht po ashtu. Nuk kam besuar se njeriut individ i duket shpëtim. Më shumë se kurdoherë më parë, kam ndier

me vërtetësinë në rritje, që koha jonë ka nevojë për bazë ideologjike për pajtım të ri shoqëror: ajo ka nevojë për fenë që do të na mundësonte ta kuptojmë zbrazëtinë e përparimit material vetëm për atë përparim - e që gjatë kësaj megjithatë t'i japë jetës në këtë botë atë që i takon; kjo do të na tregonte si ta vëmë baraspeshën ndërmjet kërkesave shpirtërore dhe fizike dhe kështu të na shpëtojë nga shkatërrimi në të cilin hutueshëm po futemi.

Nuk do të ishte e tepërt të thuhet se në atë periudhë të jetës sime problemi i Islamit - sepse kjo për mua ka qenë problem - ka përshkuar shpirtin tim në atë masë sa që i ka shtyrë të gjithë të tjerët. Preokupimi im tashmë atëherë e pat kaluar shkallën fillestare, kur ka qenë interesimi intelektual për ideologjinë dhe kulturën e çuditshme, edhe pse tërheqëse; ishte bërë kërkesë e pasionuar të të vërtetës. Në krahasim me këtë hulumtim, madje edhe mallëngjimet aventuriere të dy viteve të kaluara të udhëtimeve janë zbehur deri në parëndësi, aq sa e kam pasur vështirë të përqëndrohem në të shkruarit e librit të ri që botuesi Frankfurter Zeitungu me të drejtë e ka pritur nga unë.

Në fillim dr. Simoni me tolerancë ka shikuar në ngurrimin tim të qartë që ta vazhdoj punën në atë libër. Më në fund, pikërisht u pata kthyer nga udhëtimi i gjatë dhe e kam merituar një lloj të pushimit; martesë ime e paradokshme duket se po ashtu edhe e ka arsyetuar shtyrjen e të shkruarit. Por kur pushimi dhe shtyrja filluan që të shtyhen mbi atë që dr. Simoni e ka konsideruar të arsyeshme, ai më përkujtoi se do të ishte koha që të lëshohem në tokë.

Kur tash kujtohem, më duket se ai ka qenë mjaft i arsyeshëm, por kjo nuk më është dukur ashtu në atë kohë. Të pyeturit e tij të shpeshtë e këmbëngulës për përparimin me "libra" kishte efektin e kundërt nga ajo që kishte për qëllim; ndihesha i mashtruar dhe fillova të

ndiej neveri edhe në vetë mendimin në libër. Më shumë më ka mbetur për atë që ende duhet ta zbuloj se sa te përshkrimi i asaj që deri tash e pata gjetur.

Më në fund, dr. Simoni i zemëruar vërejti: "Nuk mendoj se ju kurdoherë do ta shkruani atë libër. Atë për çka ju lëngoni është horror libri". Ngapak i ngacmuar, u përgjigja: "Ndoshta sëmundja ime është madje edhe më serioze se kjo. Ndoshta lëngoju prej horror sribendi".

"Po, nëse lëngoni nga kjo", - ma ktheu ai rreptë, - "a mendoni se Frankfurter Zeitungu është vend i mirëfilltë për ju?"

Një fjalë e nxiste tjetrën dhe mospajtimi jonë u rrit në konflikt. Po atë ditë i kam dhënë dorëheqje Frankfurter Zeitungut dhe pas një jave udhëtova me Elzën në Berlin.

Natyrisht, nuk kam synuar ta lëshoj zhurnalizmin sepse, pos jetës komode dhe kënaqësisë (përkohësisht të prishur me "libër") që ma ofronte shkrimi, ai më ka ofruar mënyrën e vetme që t'i kthehem botës muslimane, kurse në botën muslimane kam dashur të kthehem me çdo kusht. Me autoritetin që e kam arritur gjatë katër viteve të fundit nuk ishte rëndë të bie në kontakt me shtypin. Së shpejti pas shkëputjes sime me Frankfurtin, kam lidhur kontrata mjaft të favorshme me tri gazeta të tjera: Neue Züricher Zeitungu nga Cyrihi, Telegrafi nga Amsterdami dhe Kölnische Zeitungu nga Këlni. Që atëherë artikujt e mi për Lindjen e Mesme është dashur të paraqiten në këto tri gazeta që - ndonëse ndoshta të pakrahasueshme me Frankfurter Zeitungun - kanë qenë ndër më të rëndësishmet në Evropë.

Për një kohë Elza dhe unë u vendosëm në Berlin, ku kam pasur për qëllim të përfundoj serinë e ligjëratave në Akademinë Gjeopolitike, kurse t'i vazhdoj studimet e mia islame.

Miqtë e mi të vjetër letrarë qenë gëzuar që jam kthyer, por kurrsesi nuk ishte lehtë të lidhen penjtë e lidhjeve tona të hershme atje ku qenë këputur kur kam shkuar në Lindjen e Mesme. Qemë tëhuajësuar; më nuk kemi folur me gjuhën e njëjtë intelektuale. Veçan te asnjëri nga miqtë e mi nuk kam mund të nxisë çkado ngjasuese në mirëkuptim për preokupimin tim me Islamin. Gati të gjithë deri në një tundnin kokën të habitur kur përpiqesha që t'ju shpjegoj se Islami, si koncept intelektual dhe shoqëror, mund favorshëm të krahasohet me cilëndo ideologji tjetër. Ndonëse nganjëherë edhe e lejonin arsyeshmërinë e këtij apo atij propozimi islam, shumica ishin të mendimit se religjionet e vjetra janë çështje e të kaluarës dhe se koha jonë kërkon qasje të re, "humaniste". Por madje as ata që nuk e kanë mohuar aq këmbëngulshëm çdo vlerë të religjionit institucional, fare nuk kanë pasur dëshirë ta lëshojnë botëkuptimin popullarizues përëndimor që Islamit, meqë kryesisht merret me gjëra botërore, i mungon "mistika" që me të drejtë e presim prej religjionit.

Sidomos më ka befasuar kur kam zbuluar se pikërisht ai aspekt i Islamit që në shikim të parë më ka tërhequr - mungesa e ndarjes së realitetit në pjesën fizike dhe shpirtërore dhe theksi në arsye si rrugë në fe - aq pak i tërheq intelektualët që përndryshe i përshkruajnë arsyet rolin dominant në jetë; pikërisht vetëm në sferën religjioze instinktivisht kanë hequr dorë nga pozicioni aq i rëndomtë "racional" dhe "realist". Në këtë aspekt nuk kam mund të vërej kurrfarë dallimi ndërmjet numrit të vogël të atyre miqve të mi që kanë prirje religjioze dhe atyre të shumtëve për të cilët religjioni ka pushuar të jetë çkado qoftë më tepër prej konvencionit të demoduar.

Gjatë kohës, ndërkaq, kam kuptuar ku qëndron vështirësia e tyre. Kam filluar të vrojtoj që në sytë e njerëzve të edukuar në territorin e mendimit kristian - me

theksin në "mbinatyroren", që gjoja është karakteristike për çdo përvojë religjioze të mirëfilltë - qasja kryesisht racionale duket se largon nga vlera shpirtërore religjioze. Ky qëndrim nuk ka qenë asses i kufizuar në kristianët besimtarë. Për shkak të lidhshmërisë së gjatë, pothuaj ekskluzive të Evropës me kristianizmin, madje edhe Evropianët agnostikë ndërrijshëm kanë mësuar të shikojnë në çdo përvojë religjioze nëpër thjerrën e botë-kuptimeve kristiane dhe e kanë konsideruar të "vlefshme" vetëm nëse është përcjellë me mallëngjimin e respektit të thellë misterioz para gjërave të fshehura dhe jashtë të kuptuarit intelektual. Islami nuk e plotësonte këtë kërkesë; ai ka cekur bashkëpunimin e formave fizike dhe shpirtërore të jetës në shkallën natyrore të përkryer. Në realitet, shikimi i tij mbi botën ka qenë aq i ndryshëm nga ai kristian, në të cilin shumica e koncepteve etike perëndimore kanë qenë të bazuara, që pranimi i vlefshmërisë së njerit pashmangshëm ka shpënë deri te kontestimi i vlefshmërisë së tjetrit.

Sa më përket mua, tash e kam ditur se anoj nga Islami, por ngurrimi skajor e shtynte hapin përfundimtar, të parevokueshëm. Mendimi për pranimin e Islamit më dukej si aventura nëpër urë mbi humnerën ndërmjet dy botëve tjetërfare; urës aq të gjatë saqë duhet të arrihet pika nga e cila s'ka kthim para se skaji tjetër të bëhet i pashëm. Kam qenë krejtësisht i vetëdijshëm se, nëse bëhem musliman, më duhet medoemos që të kthehem nga bota në të cilën jam rritur. Kurrfarë shtegdalje tjetër nuk ishte e mundur. Vërtet nuk mund të ndiqet thirrja e Muhammedit e njëkohësisht të mbahen lidhjet e mia të brendshme me shoqërinë në të cilën sundojnë koncepte diametralisht të kundërta. Por - a është njëmend Islami shpallje e Zotit apo vetëm urtësi e njeriut të madh, por megjithatë - njeri...?

Një ditë - ka qenë shtator 1926 - Elza dhe unë u gjetëm në hekurudhën nëntokësore berlinase. Ishte kupe e klasit të lartë. Shikimi im rastësisht u fokusua te njeriu mirë i veshur përballë meje, qartë njeri i pasur afarist, me çantë të shkëlqyeshme prej lëkure mbi gjunjë dhe me unazë të madhe diamanti në dorë. Sorollatshëm mendova se figura e pashme e këtij njeriu mirë po pajtohet në fotografinë e prosperitetit që takohej kudo në Evropën Qendrore ato ditë; prosperitetit që për më tepër bie në sy që ka ardhur pas viteve të inflacionit, kur tërë jeta ekonomike ka qenë, sipas rregullit, rrëmujë dhe mjerim i plotë. Shumica e njerëzve tash kanë qenë mirë të veshur e të ushqyer, kurse njeriu përballë meje nuk ka qenë për këtë kurrfarë përjashtimi. Por kur kam shikuar në fytyrën e tij, nuk më dukej se shikoja personin e lumtur. Dukej i brengosur, por jo vetëm i brengosur por fort i palumtur, me sytë që zgurdullojnë në zbrazëti dhe skajet e buzëve të lëshuara sikur në dhembje - por jo dhembje trupore. Duke mos dashur të jem i panjerëzishëm, i ktheva sytë dhe pashë pranë tij një zonjë elegante. Edhe ajo kishte çuditërisht çehre jo të lumtur të fytyrës sikur po kalon apo po përjeton diç që po i shkakton dhembje; megjithatë, buzët e saj qenë të shtrënguara në diç që ngjason në qeshje e cila, jam i sigurt, është dashur të jetë artificiale. Atëherë fillova të shikoj përreth në të gjitha fytyrat tjera në kupe - fytyra të njerëzve pa përjashtim mirë të veshur dhe mirë të ushqyer dhe pothuaj në secilin prej tyre kam mundur të vrojtoj çehre të vuajtjes së fshehtë, ashtu të fshehtë që pronari i fytyrës sikur nuk ka qenë as i vetëdijshëm për këtë.

Kjo njëmend ishte e çuditshme. Kurrë më parë nuk kam parë aq shumë fytyra jo të lumtura rreth vetes; ose ndoshta kurrë më parë nuk kam kërkuar atë që tash aq zëshëm fliste prej tyre? Përshtypja ka qenë aq e fuqishme

që këtë ia ceka Elzës; edhe ajo filloi të shikojë rreth vetes me syrin e kujdesshëm të piktorit kompetent për studimin e tipareve të fytyrave njerëzore. Atëherë m'u kthye mua, e mahnitur, dhe tha: "Ke të drejtë. Ata të gjithë duken sikur po lëngojnë mundime të tmerrshme... Pyetem a e dinë ata vetë ç'po ndodh me ata?"

E kam ditur se nuk e dinë - sepse përndryshe nuk do të mund ta shpenzojnë jetën e vet siç po e bëjnë këtë, pa kurrfarë besimi në të vërtetat të cilat obligojnë, pa kurrfarë caku pos dëshirës që ta ngrisin "standardin jetësor" të tyre vetjak, pa kurrfarë shprese pos të sigurojnë më shumë përparësi materiale, më shumë gjëra dhe mbase më shumë fuqi...

Kur u kthyem në shtëpi, rastësisht shikova në tavolinën time në të cilën ishte Kur`ani i hapur të cilin më herët kam qenë duke e lexuar. Mekanikisht e mora librin që ta vë në raft, por pikërisht kur dëshirova ta mbyllja vështrimi më ra në faqen e hapur dhe lexova:

"Jeni të verbuar nga makutëria për shumë e më shumë derisa do të shkoni në varr:

Por, ju do të mësoni!

Por, do të mësoni!

Po, sikur këtë vetëm ta dinit sigurisht,  
ju pa dyshim do të shihnit skëterrën  
ku keni rënë.

Në kohën e vet, pa dyshim, ju  
do të shihni sigurisht me sytë tuaj:  
atë Ditë do të pyeteni ç'keni bërë  
me begatinë e jetës".

Për një çast kam mbetur pa frymë. Mendoj se libri m'u dridh në duar. Atëherë ia zgjata Elzës: "Lexoje këtë. A nuk është kjo përgjigje në atë që e kemi parë në hekurdhën nëntokësore?"

Kjo ishte përgjigjja; aq vendimtare sa të gjitha dyshimet befasisht u zhdukën. Tash e kam ditur, jashtë çdo dyshimi, se Zoti e ka inspiruar këtë libër që e mbaj në dorë; sepse edhe pse i është ofruar njeriut para trembëdhjetë shekujsh, ajo qartë ka paraparë diç që mund të bëhet e vërtetë vetëm në këtë shekullin tonë të komplikuar, të mekanizuar që dobësitë e kanë ngujuar.

Në çdo kohë njerëzit e kanë njohur makutërinë; por kurrë para kësaj makutëria nuk e pat kaluar lakminë e thjeshtë që të arrihet diç dhe të bëhet obsesion që e mje-gullon shikimin për çdo gjë tjetër, lakmia joshëse që të fitohet, të punohet, sendërtohet gjithnjë shumë e më shumë - më shumë sot se dje dhe më shumë nesër se sot, xhindi që kalëron në qafë të njerëzve dhe i kamxhikon zemrat e tyre përpara drejt caqeve që në mënyrë nxitëse shkëlqejnë në largësi por treten në hiçgjë të vlefshme për përbuzje sapo t'i arrijnë, gjithnjë duke ofruar premtim të caqeve të reja përpara - caqeve edhe më të shkëlqyeshme, provokuese gjithnjë derisa janë në horizont, por të përcaktuara të zhduken në hiçgjënë e re sapo të vijnë për t'i kapur; kurse ajo uri, ajo uri e pangishme për caqe gjithnjë të reja që e kanë shpirtin njerëzor: "Po, sikur këtë vetëm ta dinit, do të shihnit skëterrën në të cilën jeni..."

Kjo, kam parë, nuk ishte vetëm urtësia njerëzore e njeriut nga e kaluara e largët në Arabinë e largët. Sado që ai ka mund të jetë i urtë, njeriu i tillë nuk ka mund t'i parashohë vetë kokëçarjet aq karakteristike për shekullin e njëzet. Nga Kur`ani ka folur zëri më i madh nga zëri i Muhammedit...

## - 5 -

Terri e pat pështjellur oborrin e xhamisë së Pejgamberit dhe e kanë zbutur vetëm llambat prej vajit të varura në zinxhirët e gjatë ndërmjet shtyllave të arkadave. Sheik

Abdullah ibn Bulejhidi është i ulur me kokë të ulur e sy të mbyllur. Kush nuk e njeh do të mund të mendonte se ka fjetur; por unë e di se të folurit tim e ka dëgjuar me vëmendje të posaçme duke u përpjekur ta pajtojë me përvojën e vet të gjerë për njerëzit dhe sytë e tyre. Pas pushimit të gjatë ai e ngriti kokën dhe i hapi sytë:

"E pastaj? Ç'ke vepruar më vonë?"

"Gjënë e qartë, Sheik. E kërkoja një mik musliman nga India që atë kohë ishte në ballë të bashkësisë së vogël muslimane në Berlin dhe i thash se dëshiroj ta përqafoj Islamin. Ai e zgjati dorën e djathtë drejt meje dhe unë e kapa dhe në prani të dy dëshmitarëve deklarova: "Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij".<sup>8</sup> Disa javë më vonë këtë e bëri edhe gruaja ime.

"E ç'të thanë tutë në këtë?"

"Po, kjo nuk u pëlqeu. Kur e njoftova babain tim se jam bërë musliman, ai madje as është përgjigjur në letrën time. Pas disa muajve motra më ka shkruar se më konsideron të vdekur... Në këtë ia kam shkruar letrën e dytë, duke e bindur se pranimi im i Islamit nuk ndërron asgjë në sjelljen time ose në dashurinë time ndaj saj; po, përkundrazi, Islami kërkon që t'i dua e t'i nderoj prindërit e mi më shumë se të gjithë njerëzit tjerë... Edhe kjo letër mbeti pa përgjigje".

"Babai yt vërtet është dashur të jetë fort besnik ndaj religjionit të tij".

"Jo, Sheik, nuk ka qenë, dhe kjo është ana më e çuditshme e tregimit. Ai, mendoj, më konsideron rebel, jo aq nga feja e tij (sepse ai kurrë atë nuk e ka mbështetur fortë) sa nga bashkësia në të cilën është rritur dhe nga kultura së cilës i është lojal".

"Dhe kurrë prej atëherë më nuk e ke parë?"

"Jo, së shpejti pas ndërrimit të fesë gruaja ime dhe unë e kemi lëshuar Evropën; nuk kemi mundur të durojmë që atje të mbesim më gjatë. Kurse unë kurrë nuk jam kthyer..."<sup>9</sup>

## XI. Xhiahadi

- 1 -

Ndërsa dilja nga Xhamia e Pejgamberit, dikush më kapi për dore; kthehem dhe i takoj sytë e Sidi Muhammed ez-Zuvaït, Senusiut.

"O, djalo, sa i kënaqur jam që të shoh sërish pas aq muajve. Zoti të bekoftë në këtë Qytet të bekuar të Pejgamberit".

Dorë për dore, shëtisim ngadalë rrugës së shtruar me kalldrëm që shpie prej xhamisë deri te pazari kryesor. Në *burnusin* e tij të bardhë afrikanoverior, Sidi Muhamedi është dukuri e njohur në Medinë, ku jeton tashmë me vite dhe shumë njerëz e ndërpresin shëtitjen tonë që ta përshëndesin me respekt jo vetëm për shkak të shtatëdhjetëvjetëshit të tij, por edhe për shkak të famës për të si njërit prej liderëve të luftës heroike libiase për pavarësi.

"Dua të të them, djalo, se Seid Ahmedi është në Medinë. Nuk është krejtësisht i shëndoshë dhe do të kënaqej pa masë të të shohë. Sa kohë do të mbesësh këtu?"

"Vetëm deri pasnesër", - u përgjigja, - "por gjithsesi nuk do të largohem pa e takuar Seid Ahmedin. Të shkojmë tash tek ai".

Në tërë Arabinë nuk ka tjetërkush që ta dua më shumë sesa Seid Ahmedin, sepse s'ka askush që ka sakrifikuar aq shumë dhe aq sinqerisht për ndonjë ideal.

Dijetar dhe luftëtar, ai ia ka kushtuar tërë jetën e vet përtëritjes shpirtërore të bashkësisë muslimane dhe luftës së saj për pavarësi politike, duke e ditur mirë se njëra pa tjetrën nuk mundën.

Sa mirë më kujtohet takimi im i parë me Seid Ahmedin, para shumë viteve, në Mekë...

Në veri të Qytetit të Shenjtë ngrihet kodra Ebu Kubajs, qendër e shumë legjendave dhe gojëdhënave të vjetra. Nga maja e saj, të kurorëzuar me xhaminë e vogël, të gëlqerosur në të bardhë me dy minare të ulta, afrohet shikimi i shkëlqyeshëm poshtë, në fushëgropën e Mekës ku në sheshin e saj shihet Ka`ba dhe amfiteatri piktoresk i shtëpive të shpërndara pa plan që ngjiten shpatijeve të zhveshura, shkëmbore, në të gjitha anët. Pak nën majën e kodrës Ebu Kubajs, kompleksi i ndërtesave gurore pezullon mbi tarracat e dendura si kalavesh i strofullave të shqiponjave, rezidenca mekase e vëllazërisë së senusitëve. Plakun që e takova atje - i përndjekur, të cilit të gjitha rrugët deri në shtëpinë e tij në Cirenaikë i janë të mbyllura pas luftës tridhjetëvjeçare dhe odisesë së tij shtatëvjeçare ndërmjet Detit të Zi dhe maleve jemenase - kishte emrin të njohur në tërë botën muslimane: Seid Ahmed, Senusiu i Madh. Asnjë emër tjetër nuk u ka sjellë shumë net të tërbuara sundesve kolonialë të Afrikës Veriore, madje as emri i Abdulkadirit të madh nga Algjeria në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ose Abdulkerimit maroken që u ka shkaktuar aq kokëçarje francezëve diç më vonë. Këta emra, sado të paharruar nga muslimanët, kishin vetëm rëndësi politike - derisa Ahmed dhe rendi i tij kanë qenë gjatë shumë viteve edhe forcë e madhe shpirtërore.

Na njoftoi miku im javanos haxhi Agos Salimi, i cili ishte në krye të luftës indoneziane për emancipimin politik dhe pati ardhur në Mekë në haxhillëk. Kur Seid Ah-

medi kishte dëgjuar se para do kohe e kam pranuar Islamin, ai e zgjati dorën drejt meje dhe tha ëmbël:

"Mirë se erdhe në mesin e vëllezërve të t'u, vëllai im i ri..."

Vuajtja ishte e vulosur në fytyrën e bukur të luftëtarit të plakur për fenë dhe lirinë. Fytyra e tij, me mjekrën e vogël të thinjur dhe me buzët e vijëzuara sensuale ndërmjet tipareve të dhembshme, ishte e lodhur; kapakët e syve rëndë binin mbi sy dhe u jepnin pamjen e përgjymësisë; timbri i zërit të tij ka qenë e butë dhe e përshtuar me pikëllim. Por nganjëherë në ta shfaqej shkëlqimi. Sytë pranonin rreptësinë shkëlqyese, zëri bëhej më i qartë, kurse nga palët e *burnusit* të tij të bardhë ngrihej dora si krahu i shqiponjës.

Trashëgimtari i idesë dhe misionit që, sikur ta kishte arritur sendërtimin e vet, do të kisha mundur të sillte rilindjen e Islamit modern; madje as në pamundësi, pleqëri dhe sëmundje, dhe në thyerjen e veprës së vet jetësore, heroit afrikanoverior nuk e pat humbur zjarrin e vet. Kishte të drejtë që nuk dekurajohej; e dinte se synimi për rilindjen religjioze dhe politike në frymën e vërtetë islame - për çka angazhohej lëvizja senusite - kurrë nuk mund të fshihet nga zemra e popujve muslimanë.

Gjyshi i Seid Ahmedit, dijetari i madh algjerian Muhammed ibn Ali es-Senusi (ashtu i quajtur sipas fisit Benu Senus të cilit i përkiste) ishte ai që në pjesën e parë të shekullit kishte shtruar idenë e vëllazërisë islame që do të mund të hapte rrugën për themelimin e Komonuelltit të mirëfilltë islam. Pas shumë vitesh udhëtimi dhe studimi në shumë vende arabe, Muhamed ibn Aliu e themeloi vendin, apo kampin e parë të rendit senusit në kodrën Ebu Kubajs, në Mekë, dhe shpejt fitoi përkrahjen e fortë ndër beduinët e Hixhazit. Mirëpo, ai nuk mbeti në Mekë, por u kthye në Afrikën Veriore, që më në fund të

vendoset në Xhagbub, oaz në shkretëtirën ndërmjet Cirenaikes dhe Egjiptit, prej nga mesazhi i tij është përhapur nëpër tërë Libinë dhe larg jashtë saj. Kur ka vdekur më 1859, senusitët (si janë quajtur të gjithë anëtarët e rendit) kanë zotëruar me shtetin e gjerë prej brigjeve të Mesdheut thellë në Afrikën ekuatoriale dhe në territorin Tuareg në Saharën algjeriane.

Termi "shteti" nuk e përshkruan saktë këtë krijim unik, sepse Senusiu i Madh kurrë nuk ka pasur për qëllim konstituimin e pushtetit, qoftë të vetin, qoftë të trashëgimtarëve të vet; ajo që ai ka dëshiruar ka qenë dëshira për të përgatitur bazën organizative për rilindjen morale, shoqërore dhe politike të Islamit. Në pajtim me këtë qëllim ai nuk ka bërë asgjë që ta çrregullojë strukturën tradicionale fisnore të atij territori, as që e ka kontestuar pushtetin nominal suprem të sulltanit turk mbi Libinë - të cilin ai edhe më tej e ka njohur si halif - tashmë të gjitha përpjekjet e veta ia ka kushtuar edukimit të beduinëve në shkencën e Islamit, nga i cili u patën larguar në të kaluarën, dhe zgjimit të vetëdijes tek ata mbi vëllazërinë që është e paraparë me Kur'an, por ka qenë konsiderueshëm e rrënuar me armiqësitë shekullore fisnore. Nga shumë *zavi* që kanë mugulluar nëpër Afrikën Veriore, senusitët kanë përcjellë porosinë e vet deri te fiset më të largëta dhe brenda disa dhjetëvjeçarëve sollën ndryshime të mrekullueshme arabët e po ashtu edhe ndër berberët. Anarkia e vjetër ndër fisnore gradualisht është zvogëluar dhe dikur luftëtarët e shfrenuar shkretinorë janë përshkuar me frymën deri atëherë të panjohur të bashkëpunimit.

Fëmijët e tyre nëpër *zavi* kanë arritur të arsimohen - jo vetëm në mësimet e Islamit, por në shumë shkathtësi dhe zeje praktike që më herët i kanë përbuzur nomadët luftëtarë. Kanë qenë të ngacmuar të shpojnë më shumë puse të mira në territorret që me shekuj kanë qenë të

shtrira, e nën udhëheqjen e senusitëve kanë filluar që në shkretëtirë të paraqiten plantacione përparimtare. Është ndihmuar tregtia dhe paqja, që senusitët e kanë sjellë, ka mundësuar udhëtimin në territoret ku në kohët e kaluara kurrfarë karvani nuk ka mundur të kalojë i pashqetësuar. Shkurt, ndikimi i rendit ka qenë nxitje e fuqishme për qytetërimin dhe përparimin, derisa ortodoksizmi i tij strikt i ka ngritur normat morale të bashkësisë së re larg mbi të gjitha që ajo pjesë e botës kurdoherë i ka shijuar. Gati deri te i fundit, fiset dhe kryeparët e tyre, me vullnet të mirë kanë pranuar udhëheqjen shpirtërore të Senusisë së Madh; madje edhe pushteti turk në qytetet bregdetare libiase ka konstatuar se autoriteti moral i rendit konsiderueshëm i ka lehtësuar marrëdhëniet me fiset beduinase dikur aq "kokëfortë".

Për këtë, ndonëse rendi i ka orientuar përpjekjet e veta në rilindjen përparuese të popullatës vendase, ndikimi i tij gati nuk ka mundur të dallohet nga fuqia e vërtetë drejtuese. Kjo fuqi zinte fill në aftësinë e rendit për t'i ngritur beduinët e thjeshtë dhe Tuaregët e Afrikës Veriore nga formalizmi i tyre i deriatëhershëm shterpë në gjërat fetare, që t'i mbushë me dëshirën që mirëfilli të jetojnë në frymën e Islamit dhe t'u japë ndjenjën që të gjithë të punojnë për liri, dinjitet njerëzor dhe vëllazëri. Kurrë nga koha e Pejgamberit nuk ka pasur askund në botën muslimane lëvizje masive aq të afërt me mënyrën islame të jetës siç është lëvizja e senusitëve.

Kjo periudhë e qetë që ndërprerë në çerekun e fundit të shekullit nëntëmbëdhjetë, kur Franca kishte filluar të përparonte në jug të Algjerisë në Afrikën ekuatoriale dhe të pushtonte, hap pas hapi, territoret që më herët kanë qenë të pavarura nën udhëheqjen shpirtërore të rendit. Në mbrojtje të lirisë së vet, i biri i themeluesit dhe trashëgimtari, Muhamed el-Mehdiu, që detyruar që të rrëmbejë

shpatën dhe kurrë më nuk ka qenë në gjendje ta lërë atë. Kjo luftë e gjatë ka qenë xihadi i mirëfilltë islam - luftë vetëmbrojtjeje, e përkufizuar kësisoj në Kur'an:

*"Luftoni në rrugën e Zotit kundër atyre që luftojnë kundër jush, por ju vetë mos u bëni agresorë; sepse, njëmend, Zoti nuk i don agresorët... Luftoni kundër tyre derisa të mos ketë më shtypje dhe të gjithë njerëzit të jenë të lirë të adhurojnë Zotin. Por, nëse ata heqin dorë, të gjitha armiqtë të duhet të pushojnë..."*

Por, francezët nuk hoqën dorë; ata bartnin trengjyrëshen e tyre në bajonetat e veta gjithnjë thellë e më thellë në vendet muslimane.

Kur Muhammed el Mehdiu vdiq më 1902, nipi i tij Seid Ahmedi e mori udhëheqjen e rendit. Që kur ishte nëntëmbëdhjetë vjeç, gjatë kohës së jetës së dajës së tij dhe më vonë kur ai vetë është bërë Senusi i Madh, ai ka qenë në luftë kundër depërtimit francez në territoret që tash quhen Afrika Ekuatoriale franceze. Kur italianët detyrimisht e përvetësuan Tripolitaninë dhe Cirenaiken më 1911, u gjet në luftë në dy fronte; kjo shtypje më e re dhe e drejtpërdrejtë e detyroi që vëmendjen e vet kryesore ta orientojë në veri. Krahu për krahu me turqit, e pasi këta e lëshuan Libinë, vetë Seid Ahmedi dhe muxhahidët e tij senusitë - si e kanë quajtur veten e vet këta luftëtarë për liri - kanë zhvilluar luftë kundër pushtuesit me atë sukses, sa që italianët, përkundër armatimit dhe numrit të vet më superior, mezi kanë mundur t'i mbajnë vetëm bazat e pasigurta në disa qytete bregdetare.

Britanikët, atëherë të fortifikuar në mënyrë solide në Egjipt dhe krejtësisht të pakënaqur se si italianët po zgjeroheshin në brendi të Afrikës Veriore, nuk kanë qenë armiqtë e disponuar ndaj senusive. Qëndrimi i tyre neutral ka qenë me rëndësi qenësore për rendin, pasi tërë furnizimi i muxhahidëve vinte nga Egjipti, ku kanë gëzuar simpatinë praktikisht të tërë popullsisë. Është

plotësisht e sigurt që ky neutralitet britanik në kohëzgjatje më të madhe do t'u mundësonte senusive që t'i largonin plotësisht italianët nga Cirenaika. Por më 1915 Turqia hyri në luftë në anën e Gjermanisë, kurse sulltani Osman, si halif i Islamit, e ftoi Senusinë e Madh t'u ndihmojë turqve duke sulmuar britanikët në Egjipt. Britanikët, natyrisht, më shumë se kurdoherë me dëshirë që ta ruajnë praparojën e pronës së vet egjiptiane, i rekomandonin Seid Ahmedit që të mbetet neutral. Si zëvendësim për neutralitetin e vet, ishin të gatshëm t'i ofrojnë pranim politik të rendit Senusi në Libi dhe madje t'ia lëshonin disa oaze egjiptiane në Shkretëtirën Perëndimore.

Sikur Seid Ahmedi ta kishte pranuar këtë ofertë, ai vetëm do të ndiqte atë që logjikisht duhet ta kërkojë një mendje e shëndoshë. Ai nuk u ka pasur borxh kurrfarë besnikërie të veçantë turqve, të cilët hoqën dorë nga Libia në llogari të italianëve disa vjet para kësaj, duke i lënë senusitë që të luftojnë vetëm; britanikët nuk manifestuan kurrfarë veprimi armiqësor kundër senusive por, përkundrazi, u kanë lejuar që të furnizohen prej Egjiptit - kurse Egjipti ishte burimi i tyre i vetëm i furnizimit. Për më tepër, "xhihadi" që e shpalli sulltani Osman nën ndikimin e Berlinit, fare nuk i ka plotësuar kushtet që i ka vendosur Kur`ani; turqit nuk luftonin në vetëmbrojtje por u janë bashkuar fuqive jomuslimane në luftë agresive. Për këtë edhe shqyrtimi religjioz edhe politik e udhëzonte vetëm në një rrugë Senusiun e Madh - të mos hynte në një luftë që nuk ishte e tija. Disa nga udhëheqësit më me ndikim senusitë - ndër ta ishte edhe miku im Sidi Muhammed ez-Zuvaji - e këshillonin Seid Ahmedin që të mbetet neutral. Por prirja e tij ekzotike për trimëri ndaj halifit të Islamit më në fund anoi ndaj kërkesave të arsyes dhe e shtyri të merrte vendim të gabuar; u deklarua për turqit dhe i sulmoi britanikët në Shkretëtirën Perëndimore.

Ky konflikt i ndërgegjes dhe rezultati i tij përfundimtar kanë qenë aq më tepër tragjik, që në rastin e Seid Ahmedit kjo nuk ka qenë vetëm çështje e humbjes ose fitimit personal por, po ashtu, sigurisht edhe shkaktimi i dëmit të pakompensueshëm çështjes së madhe së cilës i qe kushtuar tërë jeta e tij dhe jeta e dy brezave para tij. Kush e njeh aq mirë sikur unë, nuk mund të ketë fare dyshim se ai ka qenë i nxitur me motivin krejtësisht jovejtjak - me dëshirën që ta ruajë unitetin e botës muslimane; por unë po ashtu pak dyshoj se, nga aspekti politik, vendimi i tij ka qenë më i keqi që kurdoherë e ka marrë. Duke zhvilluar luftë kundër britanikëve, ai ka flijuar, duke mos e kuptuar këtë plotësisht në atë kohë, tërë ardhmërinë e rendit senusit.

Që atëherë ka qenë i detyruar të luftojë në tre fronte: në veri kundër italianëve, në jugperëndim kundër francezëve dhe në lindje kundër britanikëve. Britanikët, rëndë të shtrënguar me përparimin gjermano-turk drejt kanalit të Suezit, u evakuan në bazën e Shkretëtirës Perëndimore, që menjëherë i pushtoi Seid Ahmedit. Kolonat shumë lëvizëse të senusive në deve, të udhëhequra nga Muhammed ez-Zuvaji (që në mençurinë e vet aq rreptë iu kundërvu këtij aksioni), depërtuan deri afër Kajros. Mirëpo, në atë çast fati luftarak papritmas u kthye; përparimi i shpejtë i armatave gjermano-turke që ndalur në Gadishullin e Sinajit dhe u shndërrua në tërheqje. Menjëherë pas kësaj britanikët ndërmoren kundërsulm në senusitë në Shkretëtirën Perëndimore, sërish i pushtuan oazet kufitare dhe pusët dhe kështu e ndërprejnë rrugën e vetme të furnizimit të muxhahidëve. Brendia e Cirenaikes nuk ka mundur ta ushqejë vetë popullsinë në luftë për jetë dhe vdekje, kurse disa nëndetëse gjermane dhe austriake, që fshehurazi zbarkuan armë dhe municion, sollën vetëm ndihmë simbolike.

Në vitin 1917 këshilltarët turq i rekomanduan Seid Ahmedit që me nëndetëse të shkojë në Stamboll dhe atje të sigurojë ndihmë më efikase. Para këtij udhëtimit, udhëheqjen e rendit në Cirenaikë ia besoi kushëririt të vet, Seid Muhammed el-Idrisit.<sup>10</sup> duke qenë me prirje më paqedashëse se Seid Ahmedi, Idrisi pothuaj menjëherë tentoi që të merret vesh me britanikët dhe italianët. Britanikët - të cilëve prej vetë fillimit nuk u ka pëlqyer konflikti me senusitë - lehtë pranuan pagën; ata iu bënë presion italianëve që të veprojnë njëllëj. Shpejt pas kësaj, qeveria italiane zyrtarisht e pranoi Seid Idrisin për "emir të senusive" dhe ai ishte në gjendje ta mbajë ta quajmë pavarësinë e pasigurt në brendi të Cirenaikes deri në vitin 1922. Kur u bë e qartë që italianët nuk kanë menduar njëmend që t'i përmbahen marrëveshjes, por kanë qenë të vendosur që tërë vendin t'ia nënshtrojnë pushtetit të vet, Seid Idrisi në shenjë proteste shkoi në Egjipt në fillim të vitit 1923, duke ia dorëzuar udhëheqjen e senusive ithtarit të vjetër besnik Umer el-Muhtarit. Ndërprerja e prituri e marrëveshjes nga ana e italianëve pasoi gati menjëherë pas kësaj dhe lufta në Cirenaikë filloi sërish.

Ndërkohë Seid Ahmedi në Turqi përjetonte dëshpërim pas dëshpërimit. Qëllimi i tij ishte që të kthehej në Cirenaikë sapo t'ia arrinte qëllimit të; por qëllimin kurrë nuk e arriti. Sepse, derisa ishte në Stamboll, intrigat e çuditshme e detyruan që ta shtynte kthimin e vet nga java në javë, nga muaji në muaj. Gati dukej se ata rreth sulltanit nuk kanë dëshiruar njëmend që senusitë të kenë sukses. Turqit gjithnjë kanë patur frikë se mos një ditë arabët, që përsëri po zgjohen, mund të marrnin udhëheqjen e botës muslimane; fitorja e senusitëve domosdoshmërisht do ta paralajmëronte zgjimin e tillë të sërishëm të arabëve dhe do të sillte deri tek ajo që Senusiu i Madh, lavdia e të cilit ka qenë gati legendare madje edhe në

Turqi, të bëhet trashëgimtari i qartë i hilafetit. Ajo që ai vetë nuk kishte ambicie të tilla, nuk e hiqte dyshimin e Portës së lartë, dhe edhe pse ndaj tij sillëshin me respekt më të madh dhe me të gjitha nderimet që i takojnë pozitës së tij, Seid Ahmedi qartë por në mënyrë efikase është mbajtur në Turqi. Thyerja osmane më 1918 dhe pushtimi i Stambollit nga ana e aleatëve e paralajmëruan fundin e shpresave të tij të dështuara - kurse në të njëjtën kohë i kanë mbyllur të gjitha rrugët e kthimit në Cirenaikë.

Por dëshira që të punojë për çështjen e umetit musliman nuk i lejonte Seid Ahmedit të mbetet joaktiv. Ndërsa trupat aleate zbarkuan në Stamboll, ai kaloi në Azi të Vogël që t'i bashkohet Kemal Ataturkut - atëherë ende të njohur si Mustafa Kemali - që pikërisht pati filluar ta organizojë rezistencën turke në brendi të Anadollit.

Duhet përkujtuar se, në fillim, lufta heroike e Turqisë së Kemalit ka qenë në shenjë të Islamit dhe se pikërisht entuziazmi religjioz i pat dhënë kombit turk, në ato ditë të errëta, forcën që të luftojë kundër fuqisë superiore të grekëve, të cilët aleatët i kanë ndihmuar me të gjitha burimet disponuese.

Duke e vënë autoritetin e vet të madh shpirtëror dhe moral në shërbim të çështjes turke, Seid Ahmedi palodhshëm ka udhëtuar nëpër qytete e fshatra të Anadollit, duke e ftuar popullin që t'i ndihmojë "Gaziut", ose "Mbrojtësit të fesë", Mustafa Kemalit. Përpyekjet e Senusisë së Madh dhe autoriteti i emrit të tij i kanë kontribuar konsiderueshëm suksesit të lëvizjes kemaliste ndër fshatarët e thjeshtë të Anadollit, për të cilët parullat nacionaliste s'kanë pasur fare domethënie, por të cilët brez pas brezi konsideronin privilegj që ta japin jetën e tyre për Islam.

Por këtu sërish Senusiu i Madh bëri gabim në vlerësim - jo në lidhje me popullin turk të cilin zjarri religjioz njëmend e shpuri në fitore kundër armikut shumëfish

më të fortë, por në raport me qëllimet e udhëheqësit të tyre, sepse vetëm sa "Gaziu" e arriti fitoren, u bë e qartë se qëllimet e tyre dallonin qartë nga ajo çka populli ishte orientuar të priste. Në vend që revolucionin e vet shoqëror ta bazojë në Islamin e përtëritur e të forcuar, Ataturku e lëshoi forcën e religjionit (e cila e vetmja e solli deri në fitore) dhe, krejtësisht panevojshëm, hedhjen e të gjitha vlerave islame i merr për themel të reformave të veta. Panevojshëm madje edhe nga pikëpamja e Ataturkut, sepse lehtë ka mundur ta shfrytëzojë entuziazmin e madh religjioz të popullit të vet si nxitje pozitive për përparim, duke mos e cunguar nga ajo që e ka formësuar kulturën e tij dhe e ka bërë racë të madhe.

Rëndë i dëshpëruar me reformat kundërislame të Ataturkut, Seid Ahmedi plotësisht qe tërhequr nga çdo aktivitet politik në Turqi, dhe përfundimisht, në vitin 1923, shkon në Damask. Atje, përkundër kundërshtimit të vetë politikës së brendshme të Ataturkut, ka tentuar t'i shërbejë çështjes së unitetit të muslimanëve duke u përpjekur t'i bindë sirianët që të bashkohen me Turqinë. Drejtimi mandator francez e ka shikuar, natyrisht, me mosbesim të skajshëm, dhe kur miqtë e tij, nga fundi i vitit 1924, mësuuan se menjëherë do të burgoset, ai ka ikur me veturë nëpër shkretëtirë deri në kufi të Nexhdit, e prej këtu ka vazhduar në Mekë ku ngrohtësisht e ka pranuar mbreti Ibn Saudi.

## - 2 -

"Si po shkojnë muxhahidët, Sidi Muhammed?" - pyes, pasi gati një viti nuk kam pasur risi nga Cirenaika.

Fytyra e rrumbullakët, e kornizuar me mjekër të bardhë e Sidi Muhammedi ez-Zuvajit errësohet: "Lajmet janë të këqija, djalo. Luftërat kanë përfunduar para një muaji. Muxhahidët janë thyer, fisheku i fundit është har-

xhuar. Tash është vetëm mëshira e Zotit ndërmjet popullit tonë të pafatshëm dhe hakmarrjes së shtypësve të tij..."

"E ç`po ndodh me Seid Idrisin?"

"Seid Idrisi", - u përgjigj Sidi Muhammedi me pshe-rëtimë, - "Seid Idrisi ende është në Egjipt, i paaftë - duke pritur - e për çka? Ai është njeri i mirë, Zoti e bekoftë, por kurrfarë luftëtari. Ai jeton me librat e vet, kurse shpata nuk qëndron fuqishëm në dorën e tij..."

"Por Umer el-Muhtari - ai gjithsesi nuk është dorë-zuar? A ka ikur në Egjipt?"

Sidi Muhammedi u ndal dhe më vështroi me habi: "Umeri...? Po ti, as për këtë s`ke dëgjuar?"

"Çfarë të dëgjoja?"

"Djali im", - thotë ai qetësisht, - "Sidi Umeri, Zoti e mëshiroftë, ka vdekur tashmë një vit..."

Umer el-Muhtari i vdekur... Ky luan i Cirenaikes, të cilin shtatëdhjetë vjetët e tij nuk e kanë penguar që të luftojë deri në frymën e fundit për lirinë e vendit të vet, i vdekur... Dhjetë vjet të gjata, të vrazhda ai ka qenë shpirti i rezistencës së popullit të tij kundër epërsisë tepër të madhe, kundër armatave italiane dhjetë herë më të mëdha se armata e tij, armatave të përgatitura me armët më moderne, automjete të blinduara, avionë dhe artilieri, derisa Umeri dhe muxhahidët e tij përgjysmë të uritur s'kanë pasur asgjë pos pushkëve dhe disa kuaj që të zhvillojnë luftë guerrile shpresëhumbur në vendin që qe shndërruar në një kamp të madh përqëndrimi...

Mezi i besoj zërit tim teksa flas: "Gjatë një vit e gjysmë, prej kur jam kthyer nga Cirenaika, kam ditur se ai dhe njerëzit e tij janë gjykuar. Sa jam përpjekur ta bind të tërhiqet në Egjipt me muxhehidët e tij të mbetur, në mënyrë që të mund të mbetet i gjallë për popullin e vet... e me sa qetësi ai i ka evituar të gjitha përpjekjet e mia për ta bindur, duke e ditur mirë se vetëm vdekja, dhe asgjë

tjetër veç vdekjes, e pret në Cirenaikë; edhe tash, pas njëqind betejash, ajo vdekja ka herë e pritur më në fund e arriti... Por, më thuaj, kur ka rënë ai?"

Muhammed ez-Zuvaji ngadalë tundi kokën dhe derisa dalim nga rruga e ngushtë e pazarit në sheshin e hapur, të errët të El-Menakas, ai tha:

"Nuk ra në luftë. Qe plagosur dhe i gjallë qe kapur. E atëherë si një vjedhës të rëndomtë..."

"Po si kanë mundur!" - brita. - "Madje as Graciani nuk do të merrte guxim ta bëjë një gjë të tillë të tmerrshme!"

"Por ai po, po", - u përgjigj me qeshje të hidhur: "Pikërisht gjeneral Graciani ka urdhëruar që ta varin. Sidi Umeri dhe grupi i njerëzve të tij kanë qenë thellë në territor që e mbanin italianët kur vendosën që ta vizitojnë varrin e Sidi Rafiut, shokun e Pejgamberit, që ishte në afërsi. Italianët disi mësuan për praninë e tij dhe e mbyllën fushëgropën me shumë ushtarë në të dy anët. Nuk kishte kurrfarë dalje për ikje. Sidi Umeri dhe muxhahidët janë mbrojtur derisa nuk mbetën gjallë vetëm ai dhe dy të tjerë. Më në fund nën të u vra kali dhe, duke u rrëzuar, e shtypi për dheu. Por luani i vjetër vazhdoi të qëllojë derisa fisheku ia copëtoi njëren dorë, e atëherë vazhdoi të qëllojë me dorën tjetër derisa iu harxhua municioni. Atëherë e kapën dhe e sollën, të lidhur, në Suluk. Atje e nxorën para gjeneral Gracianit, i cili e pyeti: "Ç'do të thoshe ti nëse qeveria italiane, nga mirësia e saj e madhe, do të të lejonte të jetosh? A do të ishe i gatshëm të premtosh se pjesën tjetër të jetës do ta kalosh në paqe?" Por Sidi Umeri u përgjigj: "Nuk do të pushoj të luftoj kundër teje dhe popullit tënd derisa ju nuk e lëshoni vendin tim ose unë jetën time. Dhe të betohem për Atë që e di çka ka në zemrat e njerëzve, që vetëm duart mos t'i kisha të lidhura, se do të luftoja me ty duarbosh, sado që jam i vjetër e i thyer..." pas kësaj gjeneral Graciani qe-

shi dhe urdhëroi që Sidi Umeri të varet në shesh në Suluk, gjë që edhe e bënë. Dhe ata sollën me mijëra muslimanë dhe muslimane nga kampet në të cilët qenë burgosur, dhe i detyronin që të jenë dëshmitarë të varjes së udhëheqësit të tyre... "11

### - 3 -

Ende dorë për dore, Muhammed ez-Zuvaji dhe unë shkojmë në drejtim të zavisë senusite. Terri e përshkonte sheshin e gjerë, kurse zhurma e pazarit mbeti pas nesh. Rëra krikëllon nën sandallet tona. Aty - këtu mund të dallohen devetë ngarkuese se si flenë dhe varg shtëpish në skajin e largët sheshit se si dallohen jo shumë qartë në qiellin e vrenjtur të natës. Kjo më përkujton skajin e pyllit të largët. Si ato malet me pisha në rrafshlartën e Cirenaikes, ku për herë të parë kam takuar Sidi Umer el-Muhtarin; edhe kujtimi në atë udhëtim të kotë më lëndoi me tërë shijen e vet tragjike të fshehtësisë, rrezikut dhe vdekjes. E shoh fytyrën e mrrolur të Sidi Umerit mbi zjarrin e vogël vezullues dhe dëgjoj zërin e tij të fuqishëm, solemn: "Ne duhet të luftojmë për fenë dhe lirinë tonë derisa t'i largojmë pushtuesit ose të vdesim... Ne nuk kemi zgjidhje tjetër..."

Ka qenë ky mision i çuditshëm që më ka sjellë në Cirenaikë nga fundi i janarit të vitit 1931. Disa muaj më herët - saktë në vjeshtë të 1930-ës - Sensusiu i Madh erdhi në Medine. Kalova disa orë në shoqërinë e tij dhe me Muhammed ez-Zuvajin, duke diskutuar për vështirësitë shkurajuese të muxhahidëve që zhvillojnë luftën në Cirenaikë nën udhëheqjen e Umer el-Muhtarit. Ishte e qartë që nëse nuk marrin ndihmë të shpejtë dhe efikase nga jashtë, nuk do të jenë në gjendje që të qëndrojnë për një kohë të gjatë.

Gjendja në Cirenaikë ka qenë kryesisht kjo: të gjitha qytetet në bregdet dhe disa pika në pjesën veriore të Xhebel Akbarit - "Maleve të mëdha" të Cirenaikes Qendrore - i kanë mbajtur fort italianët. Ndërmjet këtyre pikave të fortifikuara ata kanë mbajtur patrulla të përherëshme me automjete blinduese dhe këmbësori të shumtë, shumica ushtarë eritreas, të ndihmuar me skuadrile ajrore që kryenin sulme të shpeshta në brendësi. Beduinët (që përbënin thelbin e rezistencës senusite) nuk kanë mundur të lëvizin, e që mos të hetohen shpejtë e të sulmohen nga ajri. Shpesh ka ndodhur që avioni vëzhgues të lajmërojë për praninë e kampit fisnor në stacionin më të afërt; dhe derisa mitralozët nga avionët pengonin njerëzit që të shpërndahen, do të vinin disa automjete blinduese, duke drejtuar drejt nëpër tenda, nëpër deve e njerëz, pamëshirshëm duke mbytur çdokënd që e kapnin - njerëzit, femrat, fëmijët dhe bagëtinë; ata që nga njerëzit dhe kafshët mbijetonin do të tuboheshin dhe largoheshin në veri në kampet e mëdha, të rrethuara me tela me gjemba që italianët i patën ngritur përgjatë bregdetit. Në atë kohë, nga fundi i vitit 1930, rreth tetëdhjetë mijë beduinë, së bashku me disa qindra mijëra kokë kafshësh, qenë larguar së bashku në territorin që nuk afronte ushqim të mjaftueshëm as për çerekun e atij numri. E pasoja - vdekshmëria në mesin e njerëzve dhe kafshëve ka qenë e tmerrshme. Veç kësaj italianët kanë ngritur rrethojë prej telash me gjemba përgjatë kufirit egjiptian prej bregut drejt jugut deri në Xhagbub, në mënyrë që të pengojnë çdo furnizim të guerrilasve nga Egjipti.

Fisi i guximshëm Magaribe nën udhëheqjen e shkathët të El-Atajoishit - dora e djathtë e Umer el-Muhtarit - ende ofronte rezistencë të gjatë afër bregut perëndimor të Cirenaikes, por shumica e fiseve tashmë ishte e ngadhënjyer me numrin dhe përgatitjen superiore të italianë-

ve. Thellë në jug fisi Zuvaja, i udhëhequr nga nëntëdhjetëvjeçari Ebu Karajimin, ende shpresëhumbur luftonin përkundër humbjes së qendrës së vet fisnore, oazit Xhalu. Uria dhe sëmundjet po e dhejtonin popullatën beuine në brendësi.

Të gjitha forcat luftarake që Sidi Umeri ka mundur t'i përdorë në të njëjtën kohë, mezi kanë numëruar diç më shumë se një mijë njerëz. Kjo, ndërkaq, nuk ka qenë vetëm pasojë e mungesës së njerëzve. Lloji i luftës guerriale që kanë zhvilluar muxhahidët nuk ka mundësuar tubime të mëdha të luftëtarëve, por më shumë varej nga shpejtësia dhe lëvizshmëria e grupeve të vogla sulmuese, të cilat befasisht shfaqeshin prej askund, sulmonin kolonat italiane ose stacionet e skajuara, rrëmbenin armët e tyre dhe zhdukeshin pa gjurmë në pyjet e dendura të pishave dhe në grykat e rrafshnaltës së Cirenaikes. Ishte e qartë që grupet e vogla të tilla, sado të guximshme dhe plot urrejtje ndaj vdekjes, kurrë nuk mund ta arrijnë fitoren vendimtare mbi armikun që disponon pothuaj me numër të pakufizuar të njerëzve dhe armatimit. Pyetja për këtë ka qenë si të rritet fuqia e muxhahidëve në mënyrë që të jenë në gjendje jo vetëm t'u shkaktojnë humbje sporadike pushtuesve, por që edhe prej tyre t'i marrin pozitat në të cilat ata janë të fortifikuar dhe që t'i ruajnë dhe t'i mbrojnë nga sulmet e reja armiqësore.

Rritja e tillë e fuqisë së senusitëve varej nga disa faktorë: furnizimi i rregullt me ushqimin e domosdoshëm nga Egjipti dhe me armë me anë të të cilave mund t'u kundërvihen masakrave nga avionët dhe automjetet e blinduara, sidomos me pushkë kundratank dhe me mitralozë të rëndë, personeli teknik i aftësuar t'i përdorë ato armë dhe t'i aftësojë muxhahidët në përdorimin e tyre, dhe, më në fund, prej konstituimit të lidhjes së sigurt bazike ndërmjet grupeve të ndryshme të muxhahidëve

në Cirenaikë dhe depove të fshehta për furnizim në territorin egjiptian.

Gati tërë javën, natë pas nate, Senusiu i Madh, Sidi Muhammedi dhe unë kemi diskutuar për atë çka do të mund të punohej. Sidi Muhammedi mendonte se forci mi i përshtatshëm i muxhahidëve në Cirenaikë nuk do ta zgjidhte problemin. Bindja e tij ishte që oazi Kufra, larg në jug në shkretëtirën libiase, që ishte rezidenca kryesore e rendit senusitë nën Seid Ahmedin, përsëri duhet bërë qendër e të gjitha ndërmarrjeve të ardhshme luftarake; sepse Kufra ende ishte larg suazave të trupave italiane. Pos kësaj, ajo shtrihet në rrugën e drejtpërdrejtë, ndonëse mjaft të gjatë e të rëndë të karvaneve deri te oaze egjiptiane Bahrija dhe Farafra dhe për këtë ka mundur të furnizohet në mënyrë më efikase se cilado pikë tjetër në vend. Ajo, po ashtu, do të mund të shndërrohet në vendtubim për mijëra refugjatët nga Cirenaika që kanë jetuar në kampe në Egjipt dhe kështu të formohet rezervuari i përhershëm i njerëzve për forcat guerrile të Sidi Umerit në veri. Mirë e fortifikuar dhe e përgatitur me armatim modern, Kufra do të mund t'i dëbonte sulmet me mitralozë të avionëve që fluturojnë poshtë, derisa bombardimi nga lartësia e madhe nuk do t'i rrezikonte realisht grupet gjerë të shpërndara të vendbanimeve.

Senusiu i Madh propozoi, nëse riorganizimi i tillë i luftës do të ishte i mundur, që edhe vetë të kthehet në Kufër dhe prej aty të udhëhiqte me operacionet vijuese. Unë, nga ana ime, kam këmbëngulur që për suksesin e planit të tillë është e domosdoshme që Seid Ahmedi sërisht t'i vendosë lidhjet e mira me britanikët, me të cilët pat ardhur në armiqësi aq të rrepta kurse aq të panevojshme me sulmin e vet në ta në vitin 1915. Përmirësimi i tillë i marrëdhënieve nuk dukej të ishte krejt i pamundur, sepse britanikët nuk kanë qenë fare të entuziazmuar me veprimtarinë eks-

pansioniste italiane, sidomos tash kur Musolini i trumbetonte tërë botës për qëllimet e veta mbi "konstituimin e sërishëm të Perandorisë Romake" në të dy brigjet e Mesdheut dhe hidhte edhe vështrime lakmuese drejt Egjiptit.

Interesi im i thellë për fatin e senusive nuk ka qenë vetëm pasojë e admirimit tim për heroizmin e skajshëm në çështjen e drejtë; ajo që më ka interesuar edhe më shumë ishte në kanë qenë të mundshme pasojat e fitores së senusive për tërë botën arabe. Sikur edhe shumë muslimanë të tjerë, me vite jam mallëngjyer me shpresën se Ibn Saudi do të mund të ishte udhëheqës i rilindjes islame; tash, kur këto shpresa dolën shterpe, kam mundur në tërë botën muslimane të shohë një lëvizje që sinqerisht synonte përmbushjen e idealit të shoqërisë islame: lëvizja senusite që zhvillonte betejën e fundit për ekzistencë.

Pikërisht për atë Seid Ahmedi e dinte se si kam qenë fuqishëm emocionalisht i lidhur me çështjen e senusitëve, ai m'u kthye mua dhe, duke më shikuar drejt në sy, më pyeti:

"A do të shkoje ti, Muhammed, në emrin tonë në Cirenaikë dhe të hulumtosh ç'mund të bëhet për muxhahidët? Ndoshta ti do të jesh në gjendje t'i shohësh gjërat më qartë nga sa munden njerëzit e mi...?"

E pashë ngultas dhe tunda kokën pa fjalë. Ndonëse kam qenë i vetëdijshëm për besimin e tij tek unë, dhe për këtë jo plotësisht i befasuar me propozimin e tij, kjo megjithatë ma zuri frymën. Pamja në përjetimin e llojit të tillë më kënaqi përtej të gjithë kufijve; por ajo që më mallëngjente edhe më, ishte ideja se do të jem në gjendje që t'i kontribuoj diç çështjes për të cilën shumë të tjerë kanë dhënë jetën.

Seid Ahmedi e shtriu dorën drejt raftit mbi kokën e vet dhe e mori Kur'anin të mbështjellë në pëlhurë mëndaf-

shi. Duke e vënë në gjunjtë e vet, ai e kapi dorën time të djathtë në mesin e dy duarve të veta dhe e vuri mbi Libër:

"Betohu, o Muhammed, për Atë që di çfarë ka në zemrat njerëzore, se gjithnjë do të jesh besnik ndaj mu-xhahidëve..." "

U betova dhe kurrë në jetën time nuk kam qenë më i sigurt në premtimin tim sikundër atë çast.

Misioni që më besoi Seid Ahmedi kërkonte fshehtësi të skajshme. Pasi marrëdhëniet e mia me Senusiun e Madh kanë qenë të mirënjohura dhe nuk kanë mundur t'i shmangen vëmendjes së misioneve të huaja në Xhide, nuk ishte e preferueshme të udhëtohet haptazi në Egjipt dhe t'i ekspozohem rrezikut që atje të zbulohem. Zbulimi im i paradokohshëm i intrigave nga rebelimi i Fejsal ed-Davishit, pa dyshim nuk e ka përmirësuar pozitën time te britanikët dhe ka qenë krejtësisht e sigurt se do të më përcjellin me vigjilencë nga çasti kur të hyj në trollin egjiptian. Prandaj kemi vendosur që madje edhe udhëtimi im në Egjipt të kryhet në fshehtësi të plotë. Do ta kaloj Detin e Kuq në njërën prej velanijeve arabe dhe do të zbarkohem fshehurazi, pa pasaportë dhe vizë, në ndonjë vend të skajshëm në bregun e Egjiptit Verior. Në Egjipt do të isha në gjendje që të lëviz lirisht i shndërruar në tregtar nga Hixhazi, sepse shumë banorë të Mekës e Medines që vijnë atje për shkak të tregtisë ose duke kërkuar pelegrinë të mundshëm, kanë qenë shfaqje krejtësisht e zakonshme në qytetet dhe fshatrat egjiptiane - e pasi e flisja mjaft rrjedhshëm dialektin e Hixhazit, kam mundur të kaloj kudo si ndokush prej njërit nga këto dy qytete të shenjta. Disa javë ishin të nevojshme që të kryhen të gjitha përgatitjet që kyçte këmbimin e fshehtë të shkresave me Sidi Umerin në Cirenaike sikur edhe me senusitë në Egjipt; kështu vetëm në javën e parë të muajit janar 1931 Zejdi dhe unë u nisëm nga vendi liman hixhazian Janbu

në vendin frekuentues të dobët të bregut. Ka qenë natë pa dritë hëne, kurse ecja rrugës jo të rrafshhtë ka qenë mjaft e pakëndshme. Njëherë, kur zura në thua, dorëza e pistoletës sime të fshehur nën kaftanin tim hixhazian, më goditi në brinjë; kjo për së gjalli më solli sërish ndërmend rrezikun e aventurës që po ndërmerrja.

Kam qenë aty, duke i shkuar në takim një kapiteni të fshehur arab, i cili duhej të më barte nëpër det me anijen e tij të vogël me vela e të më zbarkojë diku në bregun egjiptian. Me vete nuk kam pasur kurrfarë dokumentesh që do të mund të ma zbulojnë identitetin dhe ashtu, nëse do të zbulohesha në Egjipt, nuk do të ishte lehtë të dëshmohet kush jam unë. Por madje edhe rreziku që t'i kaloj disa javë në bregun egjiptian nuk është asgjë në krahasim me rreziqet që më prisnin më tej. Do të jetë e nevojshme që të kaloj përgjatë tërë gjerësisë së shkretëtirës perëndimore, duke iu shmangur që të më zbulojnë avionët vëzhgues italianë, e mbase edhe patrullat e automjeteve blinduese, në zemrën e vendit ku flet vetëm arma. Përse e bëja këtë? - pyetja veten.

Edhe pse rreziku nuk ka qenë i huaj, megjithatë kurrë nuk kam kërkuar për shkak të mallëngjimit të mundshëm. Kurdo që jam futur në të, kjo gjithnjë ka qenë si përgjigje në ndonjë nxitje, i vetëdijshëm ose i pavetëdijshëm, i lidhur në mënyrë krejtësisht të veçantë me jetën time vetjake. E ç'është pra me këtë ndërmarrjen e tanishme? A kam besuar njëmend që ndërhyrja ime mund ta kthejë rrjedhën e gjërave në dobi të muxhahidëve? Kam dëshiruar që këtë ta besoj, por intimisht e kam ditur se po nisem drejt një aventure prej donkishoti. E përse atëherë, për emër të Zotit, po vija në rrezik jetën time si kundër kurrë më parë, e me aq pak shanse për sukses?

Por përgjigjja ekzistonte, madje para se pyetja të ishte formuluar në ndërgjegjen time.

Kur e kam njohur Islamin dhe e pranova si rrugën time të jetës, kam menduar se për të gjitha pyetjet dhe kërkesat e mia ka ardhur fundi. Vetëm shkallërisht, mjaft shkallërisht, bëhesha i vetëdijshëm se ky nuk është fundi, sepse të pranohet rruga jetësore që na detyron ka qenë, së paku për mua, e lidhur pandashëm me dëshirën që ta ndjek atë rrugë me njerëzit e mendimit të njëjtë - jo vetëm që ta ndjek në kuptimin personal por edhe të punoj për jetesën e tij shoqërore në bashkësinë që zgjedh. Për mua, Islami ishte rrugë, e jo fund - kurse guerrilët e dëshpëruar të Umer el-Muhtarit kanë luftuar me mish e me shpirt me jetat e veta për lirinë që të shkojnë asaj rruge, pikërisht siç kanë punuar shokët e Pejgamberit para trembëdhjetë shekujsh. T'u jem në ndihmë në luftën e tyre të vështirë e të rëndë, sado i pasigurt të jetë rezultati, personalisht kam pasur po aq nevojë sa edhe për lutjen...

Kurse aty ishte bregu. Në valët e lehta, që stërpiknin zhurin, luhatej barka me lopata që duhet të na sjellë deri te anija e spirancuar në largësinë e errët. Derisa lundërtari i vetmuar i drejtonte lopatat në barkë, unë u ktheva kah Zejdi:

"Zejd, vëlla, ti e di se shkojmë në aventurën që mund të dalë më e rrezikshme edhe për ty edhe për mua nga të gjitha të ihvanëve të ed-Davishit së bashku? A nuk e sheh me mallëngjim qetësinë në Medine dhe miqtë e tu?"

"Rruga jote është rruga ime, xhaxh" - u përgjigj ai. - "A nuk më ke thënë ti vetë që uji që është i palëvizshëm bëhet bajat dhe kuntërbonjë? Shkojmë, le të ecë uji derisa të bëhet i kthjellët..."

Anija ishte njëra prej atyre të mëdhave, të papërshtatshme, që lundrojnë kudo rreth brigjeve të Arabisë; të ndërtuara krejtësisht prej druri, kundërmojnë era peshk të terur dhe leshterik, me kiç të lartë, dy direkë la-

tinë me kabinë të madhe dhe me tavan të ulët ndërmjet tyre. Reisi (kapiteni) ka qenë arabi i dobët i vjetër nga Muskati. Sytë e vegjël, të shkëlqyeshëm që më shikonin me kërshtëri nën rrudhat e turbanit të madh, të larëm, jepnin çehren e kujdesit që flet për vitet e gjata të kaluara në aksionet e palejuara dhe aventura; thika e shtrembër, me argjend e dekoruar e ngjeshur pas brezi nuk dukej të ishte aty vetëm për dekor.

"Merhaba, merhaba, miq!" - briti ai ndërsa ngjiteshim në anije. - "Ky është çast i shenjave të mira!"

Sa herë, kam menduar, ai u ka ofruar mirëseardhjen e njëjtë të përzemërt haxhinjve të varfër që fshehurazi i ka ngarkuar në anije në Egjipt dhe, pa kurrfarë kujdesi të mëtejshëm për ta, i ka zbarkuar në brigjet e Hixhazit, në mënyrë që t'u shmangen pagesave të tatimeve të mëdha të haxhinjve që qeveria saudite kanë vënë për ata që dëshirojnë ta vizitojnë shtëpinë e Zotit? E sa herë ua ka drejtuar fjalët plotësisht të njëjta tregtarëve me robër të cilët, rëndë duke shkelur ligjin islam, i kanë zënë disa etio-pianë të pafat që t'i shesin në tregjet e robërve në Jemen? Por atëherë, ngushëllohesha, përvojën që *reisi* ynë është dashur ta ketë arritur - pa marrë parasysh sa e dyshimtë të jetë prejardhja e tij - ka mundur të na ofrojë përparësi, sepse ai vetë e ka njohur rrugën nëpër Detin e Kuq si pak marinarë të tjerë dhe mund të mbështetesh në të që do të na zbarkojë në breg të sigurt.

Dhe njëmend, katër netë Pasi ishim nisur, u ndalëm sërish në barkën e vogël me lopata, në veri të limanit Kusajr në bregun e Egjiptit të epërm. Për habinë tonë, *reisi* refuzoi të marrë pagën, "sepse", tha me buzëqeshje, "Zotërinjtë e mi më kanë paguar. Zoti ju përcjelltë".

Siç kam pritur, nuk e kemi vështirë e të mos bien në sy në Kusajr, sepse qyteti ishte mësuar të shohë njerëz në petkun e Hixhazit. Mëngjesin vijues pas ardhjes kemi

rezervuar ulëset në autobusin e labërguar që udhëton për Es-Sijut në Nil; dhe kështu, të ndrydhur ndërmjet një femre tmerrisht të trashë që në krahun e vet të gjerë mbante shportën plot zogëtha dhe një felahu të vjetër i cili menjëherë, pasi vërejti teshat tona, filloi ta përkujojë haxhin që e ka kryer para dhjetë vjetësh, Zejdi dhe unë filluam udhëtimin tonë afrikan.

Perherë kam menduar se gjithkush që lëshohet në aksion të fshehtë e të rrezikshëm duhet të ndihet sikur është i dyshimtë për secilin që e takon dhe se maska e tij mund të hetohet lehtë. Por, për çudi, këtë ndjenjë tash nuk e kisha. Gjatë kohës së viteve të kaluara në Arabi kam hyrë aq thellë në jetën e popullit të saj sa që nuk më ka ndodhur ta konsideroj veten ndryshe veç pjesë e tyre. Edhe pse kurrë nuk kam marrë pjesë në interesat afariste të mekkasve dhe medinasve, tash në masë aq të madhe jam familjarizuar në rolin e propaganduesit të haxhit, sa që pa ngurrim jam kyçur në pothuaj diskutimin "profesional" me disa udhëtarë të tjerë për virtytet e kryerjes së haxhit. Zejdi pranoi lojën me kënaqësi të madhe dhe kështu orët e para të udhëtimit tonë kaluan në bisedë të gjallë.

Pas kalimit në tren Es-Sujut, më në fund arritëm në qytetin Beni Seuf dhe shkuam drejt në shtëpinë e lidhjes sonë senusite, Ismail ed-Dibit - njeriut shkurtalëq, të fuqishëm, me çehre të hareshme të fytyrës, që flet me gjuhën arabe të zëshme të Egjiptit të epërm. Meqë ishte vetëm tregtar modest shajaku, nuk ishte person veçan autoritativ në qytet, por besnikëria e tij ndaj rendit senusit që dëshmuar në shumë raste kurse lojaliteti i tij vetjak për Seid Ahmedin e bënte dyfish besnik. Edhe pse ishte vonë, ai e zgjoi shërbëtorin që të na përgatisë darkën dhe teksa prisnim atë, ai tregoi për përgatitjet që kishte kryer.

E para, menjëherë pasi e pranoi mesazhin prej Seid Ahmedit, ka ra në lidhje me anëtarin e njohur të familjes

mbretërore egjiptiane që me vite ka qenë ithtar i zjarrtë e aktiv i çështjes së senuisive. Princi ka qenë plotësisht i lajmëruar për qëllimin e misionit tim; me gatishmëri ka pranuar që të më vihen në disponim mjetet e nevojshme në para sikur edhe të më sigurojë kafshët për hipje dhe dy udhëheqës të sigurt për udhëtim nëpër shkretëtirë deri në kufirin e Cirenaikes. Mikpritësi ynë na ka njoftuar se ata na presin në njërin prej kopshteve të palmave jashtë Beni Seufit.

Zejdi dhe unë e hodhëm veshjen tonë hixhaziane, që do të mund të nxisë kureshtjen e panevojshme në rrugën e shkretëtirës perëndimore. Në vend të saj morëm pantallonat dhe tunikat e pambukta të qepura në mënyrën afrikanoveriore sikur edhe burnuset prej leshi që i mbajnë në Egjiptin Perëndimor dhe në Libi. Nga përdhësja e shtëpisë së vet Ismaili solli dy pushkë të shkurtra kalorsiake të prodhimit italian - "sepse do të jetë më lehtë të furnizohen me municion për atë lloj pushke tek muxhahidët".

Natën vijuese, me ndihmën e mikpritësit tonë, u nisëm nga qyteti. Udhëheqësit tanë kanë qenë beduinë nga fisi egjiptian Evlad Ali, ndër të cilët senuisitët kanë pasur shumë ithtarë; një prej tyre, Abdullahu, ka qenë djalosh i gjallë që vitin paraprak ka luftuar në Cirenaikë dhe për këtë kishte mundësinë të na japë mjaft informata për atë çka mund të presim atje. Tjetri, emrin e të cilit e kam harruar, ishte i dobët, djalosh i sëndisur që fliste rrallë, por është dëftuar jo më pak i denjë për besnikëri nga Abdullahu më i njohur. Katër deve që i kishin me vete - deve të fuqishme, të shpejta të racës biskarinase - dukshëm kanë qenë veçan të zgjedhura; kanë pasur shalat jo shumë ndryshe nga ato me të cilat qeshë mësuar në Arabi. Kur duhej që të lëvizim shpejt, pa ndalje të gjata, zierja e ushqimit nuk vinte në shprehje në pjesën më të madhe

të rrugës; në pajtim me këtë, gjësendet tona ishin të thjeshta, thesi i madh plot hurma dhe thesi i vogël përplot miell gruri të vrazhdë dhe hurma; në tri devetë në shala kanë qenë të varura rrësheqet me ujë.

Pak para mesnate Ismaili na përqafoi dhe na dëshiroi bekim të Zotit në aksionin tonë. Kam mundur lehtë të vërej se ishte i prekur thellë. Nën udhëheqjen e Abdullahut e lëshuam kopshtin e palmave dhe së shpejti, nën dritën e hënës shkëlqyese, kemi ecur trok me hapa të rreptë nëpër rrafshirën rënore, të shkretë drejt veriperëndimit.

Pasi duhej patjetër t'i shmangeshim çdo takimi me organet kufitare egjiptiane rojtarët e të cilit, në vetura ose në deve, sipas asaj që kemi ditur, kanë mundur të patrollojnë në këtë pjesë të shkretëtirës perëndimore - jemi përpjekur që të mbahemi sa më larg nga rrugët kryesore të karvaneve; por pasi gati tërë qarkullimi ndërmjet Bahrijes dhe luginës së Nilit zhvillohej nëpërmjet Fajunit, larg në veri, rreziku nuk ka qenë tepër i madh.

Gjatë natës së parë kemi kaluar rreth pesëdhjetë kilometra dhe u ndalëm të pushojmë në zabelin e tamariskave; natën e dytë e të tretë kemi kaluar shumë më tepër, ashtu që para agimit të ditës së katërt kemi arritur në skajin e depresionit të thellë në të cilën shtrihet oazi Bahrije.

Derisa ishim të vendosur në hijen e shkëmbinjve jashtë oazit - që përbëhej prej disa vendbanimeve dhe plantacioneve të veçuara, nga të cilët kryesori është fshati Baviti - Abdullahu u nis në këmbë përgjatë shpatijes së rrëpinjtë, shkëmbore të mbuluar me palma, ta lidhë lidhjen me njeriun tonë në Baviti. Pasi nuk do të jetë në gjendje që të kthehet para natës, jemi shtrirë për të fjetur në hije nën shkëmbinj; pushim i këndshëm pas përpjekjeve dhe ftohtësisë së natës që e kemi kaluar në udhëtim. Megjithatë nuk kam fjetur gjatë sepse tepër shumë mendime e preokuponin mendjen time.

Duke menduar për planet tona, më dukej se nuk do të ishte vështirë të mbahet lidhja e përhershme e komunikimit ndërmjet Beni Suefit dhe Bahrijes; madje edhe karvanet e mëdha do të ishin në gjendje, kam qenë i sigurt, që mund të lëvizin ndërmjet këtyre dy pikave të pazbuluara nëse do të veprohej me kujdes të mjaftueshëm. Përkundër faktit se stacioni i organeve kufitare ka qenë i vendosur në Baviti (kemi mundur t'i shohim ndërtesat e tij të bardha nga strehimorja jonë mbi oaz), do të ishte e mundur të vihej transmetuesi i fshehtë pa tela në njërin prej shumë fshatrave të izoluar në jug të Bahrijes. Në këtë jam bindur disa orë më vonë në bisedë me Abdullahun dhe berberin e vjetër - që deri këtu kishin përcjellë lidhjen tonë. U tregua se qeveria e mbikqyrte oazin vetëm sipërfaqësisht kurse, që ishte edhe më me rëndësi, popullata kryesisht anon kah senusitët.

Edhe pesë net të udhëtimit të mundimshëm; së pari nëpër trollin zhuror e të plasaritur, e pastaj nëpër grehinat e rrafshita ranore: e kemi kaluar oazin e pabanuar Sitra dhe liqenin e saj të pajetë, të mbyllur të kaltër të njelmët, të rrethuar me kallam dhe dendurinë e palmave të egra: pastaj nëpër vendin ku ka fjetur dheu në Arxh me shkrepat e tij fantastikë, shkëmborë, gëlqerorë, të cilëve shkëlqimi i hënës u jepte pamje fantazme si nga ndonjë botë tjetër, kurse nga fundi i natës së pestë shikimi im i parë në oazin Siva...

Më vjet të tëra kam ushqyer shpresën se do ta vizitohet këtë oaz të largët i cili dikur ka qenë seli e tempullit dhe orakullit të Amonit të njohur në tërë botën e vjetër, por disi dëshira ime kurrë nuk ishte përmbushur. Tash qëndronte para meje në gdhirjen e agimit: pllaja e gjerë e maleve me palma që e rrethojnë bregun e vetmuar në të cilin shtëpitë e qytetit, të mbjella në shkëmb si banishte shpellash, ngrihen në vijë njëra mbi tjetrën drejt minares

së lartë konike që ngrihet mu në majë. I gjithë ky ishte një grumbull i çuditshëm i mureve gërmadha çfarë mund të shihen në ëndërr... Më përshkoi dëshira të hyj në kufijtë e tyre misteriozë dhe të bredh rrugëve që kanë qenë dëshmitare të kohës së faraonit, t'i shoh gërmadhat e tempullit në të cilin Krezi, mbreti i Libisë ka dëgjuar profecinë për fatin e vet, kurse Aleksandri i Maqedonisë bëri premtim për pushtimin e botës.

Edhe njëherë dëshira ime mbeti e paplotësuar. Edhe pse aq afër, qyteti Siva duhet të jetë i mbyllur për mua. Të vizitohet vendi aq larg nga lidhjet me botën e jashtme dhe aq të pamësuar në të huajt që asnjë fytyrë e re nuk do të mund të kalojë pa u hetuar, do të ishte njëmend guxim; sepse, e vendosur gati në kufirin libias; Siva ka qenë nën kontroll të veçantë, e po ashtu, jashtë çdo dyshimi, përplot spiunë të paguar italianë. Kështu, me keqardhje duke u ngushëlluar me mendimin se nuk më është shkruar ta shoh as këtë herë, e hoqa Sivanë nga mendimet e mia.

I shkuam përreth qytetit në hark të gjerë drejt jugut dhe më në fund u ndalëm në zabelin e palmave të egra. Duke mos i lejuar vetes pushim - sepse nuk kishim qëllim që të ndalemi aq afër kufirit më gjatë nga sa ishte e domosdoshme - Abdullahu menjëherë kalëroi deri në fshatin fqinj që ta gjejë njeriun të cilit Seid Ahmedi ia ka besuar që të na përcjellë përtej kufirit. Pas disa orëve ai u kthye me dy udhëheqës të rinj dhe me katër deve të pushuara të cilat duhet të na shërbejnë më tej. Udhëheqësit, beduinë Berasa nga Xhebel Ekberi, kanë qenë njerëz të Omer el Muhtarit, të cilët veçan i ka dërguar që të na udhëheqin nëpër grykë, ndërmjet oazieve Xhagbub dhe Xhalu që i mbajnë italianët, në rrafshlartë të Cirenaikes, ku duhej të takohesha me Omerin.

Abdullahu dhe shoku i tij u përshëndetën me ne që të ktheheshin në fshatin e vet në Egjipt; të udhëhequr

me dy muxhahidë, Halilin dhe Abdurrahmanin, u nisëm rrugës së gjatë një javë ditë nëpër rrafshin gati të paujë të shkretë i cili ngadalë lëshohej drejt Xhebel Ekberit. Ky ka qenë udhëtimi më i rëndë shkretinor që kurdoherë e kam përjetuar. Edhe pse nuk kishte shumë rreziqe që të na zbulojnë patrullat italiane nëse kujdesemi që gjatë ditës të fshihemi e të udhëtojmë vetëm natën, nevoja që të shkohet përreth puseve e shndërroi marshin e gjatë në ankth të vërtetë. Vetëm njëherë ishim në gjendje t'u japim ujë deveve dhe t'i mbushim rrësheqet me ujë nga pusi i lënë pas dore në Vadi el-Mra, kurse edhe kjo ka qenë thujtë shkatërrimi jonë.

Arritëm në pus më vonë nga sa patëm pritur - në realitet, pikërisht gdhiehej kur kemi filluar të marrim ujë për kafshët, kurse dielli tashmë kishte kërcyer kur e kemi kryer. Ende kemi pasur, si na tha Halidi, dy orë të plota ecje që të arrijmë deri te lugina gurore që do të duhej të ishte strehimore për atë ditë. Por sapo u nisëm kur zukama keqndjellëse e avionit e ndërpreu heshtjen shkretinore; pas disa minutash u shfaq mbi kokat tona monoplane i vogël, me shpejtësi u kthye dhe filloi të qarkullojë në spirale gjithnjë e më të ulëta. Nuk kishim ku të fshehemi dhe kështu kërcyem nga devetë dhe u shpërndamë. Në atë çast piloti hapi zjarr mbi ne nga arma e tij.

"Poshtë, shtrihuni!" - brita. - "Mos lëvizni, shtiruni se jeni të vdekur!" Por Halidi, i cili është dashur të ketë shijuar disa takime të tilla gjatë disa viteve të gjata me muxhahidët, nuk u "shtirë i vdekur". Ai u shtri në shpinë, e mbështeti kokën në shkëmb dhe, duke e vënë pushkën në gjurin e ngritur, filloi të qëllojë në avion që pikërisht vinte - jo së koti por me kujdes duke qëlluar sikur është në ushtrim të marrjes shenjë. Ishte kjo tepër e guximshme sepse avioni shkonte drejt në të në të rënët e lehtë pingul, duke qitur rërë me fishekë. Ndonjë prej

predhave të Halidit ka mundësi ta ketë qëlluar avionin sepse ai papritmas u kthye anash, u drejtua dhe filloi me nguti të ngjitet. Piloti sigurisht ka vendosur se nuk do të vlente të qëllojë në katër njerëz duke rrezikuar sigurinë e vet. Ai bëri edhe një apo dy xhiro mbi ne, e pastaj u zhduk drejt lindjes në drejtim të Xhagbubës.

"Ata bijtë e qenit italianë janë qyqarë", - tha heshtazi Halidi kur u tubuam. - "Ata duan të vrasin, por nuk duan ta ekspozojnë tepër atë lëkurën e vet". Askush nga ne nuk ishte i plagosur, por deveja e Abdurrahmanit ishte e cofur. I qitëm gjërat e tij në devenë e Zejdit dhe nga ky moment kemi udhëtuar së bashku me Zejdin.

Pas tre netëve arritëm deri te malet e pishave Xhebel Ekberit dhe dobishëm i ndërnuam devetë tona të rraskapitura me kuaj që na kanë pritur në vendin e fshehtë nën mbikëqyrjen e grupit të muxhahidëve. Prej tash shkretëtira shtrihej pas nesh; kemi kalëruar nëpër rrafshlartën kodrinore, shkëmbore të ndërprerë me shtratin e thatë të përroit dhe të laruar me pisha që vende vende kanë formuar pothuaj imshajtë të pakalueshme. Ky horizont i egër midis territorit nën pushtimin italian ka qenë vendgjaku i muxhahidëve.

Pas nja katër netësh arritëm deri në Vadi et-Taban - "Lugina e të Lodhurit", siç e kanë quajtur në mënyrë të përshtatshme - ku është dashur të gjendemi me Umer el-Muhtarin. Të fshehur sigurt në grykën dendur të pyllëzuar, me kuajt të skajuar pas shkrepave, kemi pritur ardhjen e Luanit të Xhebel Ekberit. Nata ka qenë e ftohtë, pa yje dhe e përmbushur me qetësinë e pyllit.

U desh të kalojnë edhe disa orë derisa të vinte Sidi Umeri, e pasi nata ishte plotësisht e errët dy beduinët tanë Bara'sa nuk e panë të arsyeshme që mos t'i mbushin rezervat tona me ujë nga pusi Bu Sfaja, disa kilometra kah Lindja. E vërteta, ka qenë në rreth gjysmëkilometri

nga Bu Sfaja fortifikata italiane - "por", - tha Halidi, - "ata të mallkuar nuk do të marrin guxim t'i lëshojnë muret e veta në një natë aq të errët".

Për këtë shkak Halidi në përcjellje të Zejdit, u drejtua me dy rrësheqe të zbrazëta në kuajt të cilëve parapra kisht me leckë u janë mbështjellë thundrat në mënyrë që të shmanget çdo shushuritje në trollin guror. Ata u humbën në terr derisa Abdurrahmani dhe unë u strukëm pas shkëmbit të ulët që të ngroheshim. Do të ishteme shumë rrezik të ndizje zjarr.

Pas përafërsisht një ore, disa degëza kërcasin në mesin e dëllinjave. Sandallja lehtas goditi në shkëmb. Përcjellësi im, menjëherë në përgatitje, u drejtua, me pushkën në duar dhe filloi të zgurdullonte sytë në terr. Thirrja e ngjirur, e ngjashme me ulërimën e çakallit, arriti nga pylli i dendur dhe Abdurrahmani, duke i mbledhur grushtat para gojës, iu përgjigj me zërin e ngjashëm. Para nesh u paraqitën dy njerëz. Ecnin në këmbë dhe mbanin pushkë. Kur u afruan më afër, njëri prej tyre tha: "Rruga e Zotit", kurse Abdurrahmani iu përgjigj, "Vetëm Atij i përket fuqia dhe pushteti" - që si duket ka qenë një lloj parulle.

Njëri prej dy të ardhurve rishtas - të dy kanë qenë të veshur në xharde të leckosura, teshat e beduinëve libianë - e njohu menjëherë Abdurrahmanin, sepse ai i kapi të dy duart e tij dhe u përshëndet me të përzemërsisht. Më prezentuan dhe të dy muxhahidët u kapën për dore me mua. Njëri prej tyre tha:

"Zoti të ruajt, Sidi Umeri po vjen".

Qëndronin duke përgjuar. Pas ndoshta dhjetë minutash, degëzat sërish kërcitën në shkurret e dëllinjave dhe edhe tre njerëz dolën nga terri, secili nga drejtimi tjetër duke ecur drejt nesh me pushkë të ngrehura. Kur u bindën se ne ishim vërtet ata që kishin menduar se do të takonin, ata menjëherë humbën në pyllin e dendur, sërish

në drejtime të ndryshme, qartë me qëllim që mirë të vijojnë mbi sigurinë e udhëheqësit të tyre.

Pastaj u paraqit ai, duke e kalëruar kalin e vogël thundrat e të cilit kanë qenë të mbështjella me lecka. Dy njerëz shkonin nga çdo anë, madje edhe disa prej tyre e kanë ndjekur. Kur erdhi deri te shkëmbi ku ishin duke pritur, njëri prej njerëzve të tij i ndihmoi të zbriste dhe unë vëreja se vështirë po lëvizja (më vonë mësova ishte plagosur para dhjetë ditësh në një konflikt). Në dritën e Hënës duke dalë tash mundesha ta dalloja qartë: njeri shtatmesëm, me eshtra të forta; mjekra e shkurtër e ndritur bardhë e ka rrethuar fytyrën e tij të mbyllur, thellë të rrudhur; sytë shtriheshin thellë në zgavra; sipas rrudhave rreth tyre mund të shihej se ato me dëshirë në rrethana tjetërfare munden edhe të qeshen, por tash në to kishte vetëm terr, vuajtje dhe trimëri.

I shkova në takim dhe ndjeva shtrëngimin e fuqishëm të dorës së tij të ashtë.

"Mirë se erdhe, djalo", - dhe derisa këtë e fliste, sytë e tij kaluan nëpër mua, thellësisht, duke vlerësuar; sytë e njeriut për të cilin rreziku është ushqim i përditshëm. Njëri prej njerëzve të tij e shtroi mbulesën në tokë dhe Sidi Umeri rëndë u lëshua në të. Abdurrahmani u përul t'i puthte dorën, e pastaj, pasi kërkoi leje nga udhëheqësi, filloi ta ndezë zjarrin e vogël në strehë nën shkrepat e zgjatur. Në shkëlqimin e dobët të zjarrit, Sidi Umeri e lexoi letrën prej Seid Ahmedit që e kisha sjell me vete. Ai e lexoi me kujdes, e pështolli, e mbajti për një çast mbi kokën e vet - gjest respekti dhe lojaliteti që thuhet kurrë nuk ndeshet në Arabi, por shpesh në Afrikën Veriore - e pastaj me buzëqeshje u kthye kah unë:

"Seid Ahmedi, Zoti e ruajt, flet për ty më së miri. Ti je i gatshëm të na ndihmosh. Por unë nuk e di prej kah do të mund të vinte ndihma pos prej Zotit, të Gjithëfu-

qishmit, Mëshiruesit. Ne vërtet jemi afër fundit që na është caktuar".

"Po ky plan që Seid Ahmedi e ka përgatitur a nuk do të mund të ishte fillim i ri? Nëse do të mund të sigurohej furnizimi i pandërprerë dhe Kufra të shndërrohet në bazë për operacionet e ardhshme, a nuk do të mund të ndaleshin italianët?"

Kurrë nuk kam parë qeshje aq të hidhur, aq të pashpresë sikur ajo me të cilën Sidi Umeri m'u përgjigj: "Kufra...! Kufra është humbur! Italianët e kanë pushtuar para dy javësh... "

Kjo risi më tmerroi. Gjatë gjithë muajve të kaluar Seid Ahmedi dhe unë kemi hartuar planet tona në supozimin që Kufra do të mund të shndërrohej në pikën nis-mëtare për rezistencë më të fortë. Me humbjen e Kufres senusitve nuk u ka mbetur asgjë pos një rrafshlartë e Xhebel Ekberit - asgjë pos ngushtimit të përhershëm të rrethit të okupimit italian, humbjes së një pikërezistence pas tjetrës, ngulfatjes së ngadalshme, të pashmangshme...

"Si ra Kufra? "

Me lëvizje të rraskapitur Sidi Umeri e ftoi njërin nga njerëzit e vet të afrohet më afër: "Le të të flasë ai... Ai është njëri nga të paktët që kanë ikur nga Kufra. Ka arritur tek dje".

Njeriu nga Kufra u ul me këmbë të mbledhura para meje dhe e tërhoqi *burnusin* e vet të leckosur rreth vetes. Fliste ngadalë, pa kurrfarë shqetësimi në zë, por fytyra e tij e thithur sikur i pasqyronte të gjitha tmerret që i ka përjetuar.

"Na kanë goditur në tri kolona, nga tri anë, me shumë automjete blinduese dhe topa të rëndë. Avionët e tyre fluturonin me fluturime të ulta dhe bombardonin shtëpitë, xhamitë dhe palmishtet. Kemi pasur vetëm disa qindra njerëz të aftë të bartin armë; pjesa tjetër kanë qe-

në femra, fëmijë dhe pleq. Kemi mbrojtur shtëpi pas shtëpie, por ata kanë qenë tepër të fortë për ne dhe më në fund na mbeti vetëm fshati El-Havari. Pushkët tona ishin të paafta kundër automjeteve të tyre blinduese dhe ata na ngadhënjën. Vetëm numër i vogël shpëtoi. Unë jam fshehur ndër palma duke pritur rastin që të depërtoj nëpër vijat italiane dhe tërë natën kam dëgjuar klithmat e femrave që i dhunonin ushtarët italianë dhe askerët eritrusë. Ditën vijuese një plakë erdhi në strehimoren time dhe më solli ujë dhe bukë. Ajo më tha se gjenerali italian i ka tubuar të gjithë të gjallët në varrin e Seid Muhammed el-Mehdiut, para syve të tyre e grisi Kur'anin, e hodhi në tokë dhe e shkeli me çizmenë e tij duke bërë titur: "Le t'ju ndihmojë tash profeti juaj beduinas, nëse mundet!" Pastaj ka urdhëruar që t'i presin të gjitha palmat në oaz, të rrënohen muret dhe të digjen të gjithë librat nga biblioteka e Seid Ahmedit. Ditën vijuese ka urdhëruar që disa prej pleqve dhe alimët t'i ngarkojnë në avion dhe t'i hedhin nga lartësia e madhe dhe kështu t'i mbysin... Tërë natën vijuese kam dëgjuar sërish nga strehimorja ime klithmat e grave tona dhe qeshjen e ushtarëve dhe kërcitjen e pushkëve të tyre... Më në fund u zvarrita deri në shkretëtirë nën mbrojtjen e natës, e gjeta një deve të humbur dhe udhëtova..."

Kur njeriu nga Kufra e mbaroi tregimin e vet rrëqethës, Sidi Umeri me butësi më tërhoqi kah vetja dhe përsëriti: "Kështu mund të shohësh djalo, se vërtet jemi në fund të kohës që na është caktuar". Dhe si përgjigje në pyetjen e pashqiptuar në sytë e mi, ai shtoi: "Ne luftojmë për shkak se duhet të luftojmë për fenë tonë dhe lirinë tonë derisa t'i kemi larguar kriminelët ose të kemi vdekur vetë më parë. Ne nuk kemi zgjidhje tjetër. Ne i takojmë Allahut dhe Atij i kthehem. I kemi dërguar gratë dhe fë-

mijët tanë në Egjipt, ashtu që nuk duhet të brengosemi për sigurinë e tyre kur Zoti të dëshirojë të vdesim".

Oshëtima e ngjirur u dëgjua diku në qiellin e errët. Thua jse me lëvizje refleksi njëri prej njerëzve të Sidi Umerit hodhi rërë në zjarr. Avioni, pothuaj hija e paqartë drejt reve të shkëlqyera me dritë hëne, kaloi mjaft poshtë mbi ne në fluturimin e tij drejt lindjes dhe zhurma e motorit të tij ngadalë u qetësua.

"Por, Sidi Umer", - i thashë, - "a nuk do të ishte më mirë që t'i dhe muxhahidët e tu të tërhiqeni në Egjipt përderisa rruga ende është e hapur? Në Egjipt ndoshta do të mund të tubonit shumë refugiatë nga Cirenaika dhe të organizoni fuqi më efikase. Luftën këtu përkohësisht do të duhej ndalur në mënyrë që populli të mund të grumbullojë fuqi... E di që britanikët në Egjipt nuk pajtohen lehtë me mendimin që të kenë pozicionin e fuqishëm italian në krahun e tyre; Zoti e di, ata ndoshta do të mund t'i shikojnë nëpër gishta përgatitjet tuaja nëse do të mund t'i bindni që nuk i konsideroni armiq..."

"Jo, djalo, është tepër vonë për këtë. Kjo për çka po flet ti ka qenë e mundur para pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë vjetësh, para se Seid Ahmedi, Zoti e ruajt, ta ndër marrë sulmin mbi britanikët që t'u jepte ndihmë turqve - ata që nuk na ndihmuan neve. Tash është tepër vonë. Britanikët nuk do të luajnë as gishtin që ta lehtësojnë fatin tonë, kurse italianët kanë vendosur që të na godasin dhe të thyejnë mundësinë e rezistencës së ardhshme. Nëse unë dhe ithtarët e mi do të shkonim tash në Egjipt, kurrë nuk do të jemi në gjendje që të kthehemi. E si do të mund ta lëmë popullin tonë pa udhëheqje, që ta shqyqejnë armiqët e Zotit?"

"Po Seid Idrisi ç'thotë? A ndan ai pikëpamjet tua, Sidi Omer?"

"Seid Idrisi është njeri i mirë, djal i mirë i babait të madh. Por Zoti nuk i ka dhënë zemër që ta përballojë këtë lloj lufte..."

Kishte njëmendësi të thellë por jo edhe dëshpërim në tonin e Sidi Umerit derisa ashtu me mua ka diskutuar rezultatin e pashmangshëm të kësaj lufte të gjatë për liri; ai e ka ditur se nuk e pret asgjë tjetër pos vdekja. Vdekja nuk e frikësonte; ai nuk e ka kërkuar, por as nuk ka tentuar që t'i shmanget. Kurse, jam i sigurt, madje edhe sikur ta kishte ditur çfarë vdekje e pret, nuk do të tentonte që t'i shmanget. Dukej se për të, për vdekjen, ishte i vetëdijshëm me tërë trupin dhe shpirtin e vet në vete, kudo të shkojë, çka do të bëjë.

Lëvizja e lehtë u dëgjua nga shkurrja, aq qetazi që do të kalonte pa u vërejtur në rrethanat e rëndomta; por këto nuk ishin rrethana të rëndomta. Në ankth të pritjes të çdo lloj rreziku nga ana e papritur, qartë kam mundur të dalloj shushuritjen e të afruarit duke u përvjedhur që shpejt pushonte, që më vonë përsëri të shfaqen pas disa çasteve. Shkurret u ndanë dhe dolën Zejdi dhe Halidi në përcjellje të dy rojtarëve; kuajt që i patën marrë qenë të ngarkuar me rrësheqet plotë ujë. Me të shikuar Sidi Umerin, Halidi nxitoi t'ia puthë dorën udhëheqësit, e pas kësaj unë e prezentova Zejdin. Sytë e mprehtë të Sidi Umerit u ndalën me kënaqësi të hapur në fytyrën serioze dhe në trupin shtathollë të Zejdit; duke e vënë dorën e vet mbi supet e Zejdit, ai tha.

"Mirë se erdhe, vëlla, nga vendi i të parëve të mi. Prej cilëve arabë je ti?" E kur Zejdi i tha se është nga fisi Shamar, Umeri, duke u qeshur tundi kokën, "Oh, ti atëhere je nga fisi Tajj të cilit i ka takuar edhe Hatimi, njëri prej njerëzve më shpirtgjerë..."<sup>12</sup>

Disa hurma të mbështjella në leckë i vuri para nesh njëri prej njerëzve të Sidi Umerit, dhe ai na ofroi atë ushqim të thjeshtë. Kur i hëngrëm, luftëtari i vjetër u ngrit.

"Koha është të nisemi, vëlla. Jemi tepër afër stacionit italian Bu Sfaja që të lejojmë që agimi të na takojë këtu!"

E lëshuam kampin tonë të improvizuar dhe kalëruam pas Sidi Umerit derisa pjesa tjetër e njerëzve të tij na ndiqte me këmbë. Sapo dolëm nga gryka, kam parë se përcjellja e Sidi Umerit është shumë më e madhe nga sa e kisha menduar; një nga një, hijet e errëta shfaqeshin pas shkëmbinjve dhe drunjve dhe i bashkangjiteshin kolonës sonë derisa të tjerët mbeteshin të shpërndarë majtas e djathtas prej nesh. Vëzhguesit sipërfaqësorë nuk do të mund as t'i shkonte mendja se rreth nesh kishte nja tridhjetë njerëz, sepse secili prej nesh lëvizte qetas dhe padëgjueshëm sikur vëzhguesit indianë.

Para agimit arritëm deri te kampi kryesor i çetës guerrile të Umer el-Muhtarit, që atëherë numëronte mezi diç më shumë se dyqind njerëz. Ishte e strehuar në grykën e thellë, të ngushtë dhe disa zjarre të vogla digjeshin nën shkëmbinjte e zgjatur. Disa flinin në tokë; të tjerët, hije të paqarta në të murrmen e agimit të hershëm, kanë qenë të preokupuar me punë të ndryshme, me pastrimin e armëve të veta, me bartjen e ujit, zierjen e ushqimit ose me kujdesin rreth kuajve të paktë të lidhur aty-këtu për druri. Thua jse të gjithë ishin të veshur në leckë dhe as atëherë as më vonë nuk kam parë as një të vetmin xhard ose burnus të tërë në mbarë grupin. Shumica prej tyre bartnin fasha që flitnin për takimet jo të hershme me armikun.

Për habinë time, i vërejtja dy femra në kamp - një më të vjetër dhe një më të re; ishin ulur pranë zjarrit, qartë të thelluara në arnimin e shalave me feme të vrazhdë.

"Këto dy motrat tona shkojnë me ne kudo që ecim", - tha Sidi Umeri si përgjigje në çuditjen time memece. -

"Kanë refuzuar të kërkojnë strehim në Egjipt me gratë dhe fëmijët tanë tjerë. Këto janë nëna dhe e bija. Të gjithë meshkujt e tyre kanë vdekur në luftë".

Gjatë dy ditëve dhe netëve - gjatë të cilave kampi lëviz i vend tjetër në malet dhe grykat e platosë - Sidi Umeri dhe unë i kemi shqyrtuar të gjitha mundësitë e sigurimit të furnizimit më të rregullt të muxhahidëve. Diçka e vogël ende arrinte nga Egjipti. Prej kur Seid Idrisi është marrë vesh me ta gjatë kohës së paqes me italianët, organet britanike, duket se, kanë qenë të gatshme që edhe një herë me tolerancë të caktuar të shikojnë në aktivitetin e senuitve në Egjipt derisa ato të jenë të kufizuara në lëvizje vendore. Kështu, për shembull, ata nuk kanë pasur parasysh grupet e vogla të luftëtarëve, të cilët herë pas here arrinin që të depërtojnë nëpër vijat italiane dhe vijnë në Sallum, qyteti më i afërt egjiptian në breg, që atje ta shesin prenë e vet të luftës - në të shumtën mushkat italiane - në shkëmbim të ushqimit aq të nevojshëm. Mirëpo, aksionet e tilla kanë qenë mjaft të rrezikshme për muxhahidët dhe shpesh kanë qenë të paralizueshme për më tepër që italianët shpejtë përparonin me vendosjen e telave gjemborë përgjatë kufirit egjiptian. Sidi Umeri u pajtua me mua se alternativa e vetme mund të jetë furnizimi përgjatë rrugës së cilës kam ardhur, me depotë sekrete në oazet egjiptiane të Bahrijes, Farafres dhe Sivasë, por fort dyshonte se kjo do të mund gjatë kohë t'i shmanget vëmendjes së italianëve. (Dyshimi i Umerit u tregua i arsyeshëm. Disa muaj më vonë një karvan i tillë vërtet arriti deri te muxhahidët por italianët e kanë vërejtur derisa ka kaluar nëpër "vrimë" ndërmjet Xhagbubit dhe Xhaluit. Së shpejti pas kësaj është vendosur stacioni i fortifikuar italian në Bir Tarfaf, në rreth gjysmë të rrugës ndërmjet dy oazeve dhe kjo,

krahas thujse patrullave të vazhdueshme ajrore, i bëri akcionet e mëtejshme të llojit të këtij tepër të rrezikshme).

Tash duhej të mendoja për kthimin tim. Pasi nuk kam qenë fortë i mallëngjyer që përsëri ta kaloj rrugën e gjatë, të mundimshme së cilës pata ardhur, pyeta te Sidi Umeri a ka mundësi për ndonjë rrugë më të shkurtër. Ekziston, më tha ai, por e rrezikshme: nëpër telin gjembor deri në Sallum. Meqë pikërisht grupi i muxhahidëve ishte i gatshëm të marrë guxim për një aksion të tillë, që të sjellë miell nga Sallumi, nëse dëshiroj mund t'u bashkangjitem. Vendosa të nisem kësaj rruge. Zejdi dhe unë u përshëndetëm prej Umer el-Muhtarit - që më kurrë mos ta shohim; diç më pak se tetë muaj më vonë italinët e kanë kapur dhe e kanë varë.

Pas shtatë ditë ecjeje, vetëm natën, nëpër territorin e vështirë dhe nëpër dendurinë e dëllinjave të Xhebel Ekberit lindor, grupi jonë prej nja njëzet vetash arriti deri te kufiri ndërmjet Egjiptit dhe Cirenaikes, afër pikës ku kemi menduar ta bëjmë depërtimin. Kjo pikë nuk është zgjedhur rastësisht. Ndonëse pengesa e telit gjembor tashmë mbulonte pjesën më të madhe të kufirit, atëherë ende nuk kishte përfunduar krejtësisht. Në disa vende, si këtu, kishte vetëm një mur i lartë rreth dy metra e gjysmë, kurse i gjerë rreth një metër e gjysmë, derisa në vendet tjera tashmë kanë qenë tre rende të veçantë të telit gjembor të gërshetuara në kthesa të vështira shumëfishe mbi shtyllat e forcuara në platformat e betonit. Vendin që e kemi zgjedhur ishte rreth gjysmë kilometri i larguar nga stacioni i fortifikuar në të cilin, e dinim, kanë qenë edhe automjetet e blinduara; por, duhej zgjedhur ndërmjet këtij sektorit të kufirit dhe ndonjë tjetri që mbase është më pak i fortifikuar, por i ruajtur me pengesës dyfishe ose madje edhe trefishe prej teli.

Qe vendosur që disa kilometra brenda territorit egjiptian të na presin ithtarët e senusive me kuajt për kalërim. Për këtë nuk ka qenë e nevojshme t'ia ekspozojmë rrezikut kuajt tanë; i kemi kthyer prapa në përcjellje të disa muhahidëve, derisa ne të tjerët rreth mesnatës jemi nisur drejt kufirit. Terri ishte mbrojtja jonë e vetme, sepse italianët i kanë prerë të gjithë drunjat dhe shkurret përgjatë kufirit.

Krahas pararojes së vendosur në disa qindra metra drejt veriut dhe drejt jugut, gjashtë njerëz tanë - të armatosur me dara dhe dorëza të trasha lëkure të konfiskuara në sulmet e përparshme në njësitë punuese italiane - janë zvarritur përpara katërkëmbësh; ne të tjerët i kemi mbuluar me pushkë të ngrehura. Ka qenë ky çast dramatik. Duke i curruar veshët në zërin më të dobët, kam mundur të dëgjoj vetëm krikëllimën e zhurit nën peshën e trupit që lëviznin përpara dhe britmën e kohëpaskohshme të zogut të natës. Atëherë arriti zëri e darave të para që e shtrënguan telin - tingëllonte sikur shpërthim në veshët e mi - e pastaj ka pasuar shkrapëllima e ndërprerë e fijeve metalike... shkrap, shkrap, shkrap... krikëllimë dhe shkrapëllimë gjithnjë thellë e më thellë në thurjen e telave...

Edhe një britmë e zogut e prishi natën, por këtë herë ky nuk ka qenë zogu por shenja që vinte nga pararoja nga veriu duke paralajmëruar afrimin e rrezikut... dhe thujse në të njëjtin çast dëgjuam zukamën e motorit që vinte drejt nesh. Projektori shkëlqeu pjerrtas në ajër. Si një trup u hodhëm për toke, pos prerësve të cilët vazhduan punën në ngutijen pikëlluese, duke mos u brengosur më që këtë ta bëjnë fshehtazi por duke prerë, duke goditur me duar dhe kondakë të pushkëve telat, si të tërbuar. Pas disa çasteve jehoi kërcitja! Rojtari ynë në veri! Ekuipazhi i automjetit të blinduar është dashur ta ketë vërejtur, sepse tufa e rrezeve të reflektorit me shpejtësi u kthye poshtë dhe e

dëgjuam kërstitjen kobsjellëse të mitralozit. Zukama e motorit u rrit dhe silueta e zezë u nis drejt nesh derisa rrezet e reflektorit na kapnin në tokë. Pasoï menjëherë rafalli prej mitralozit, por mitralozi qartë ka gjuajtur tepër lartë; kam mundur ta dëgjoj fërshëllimën dhe fishkëllimën e plumbit derisa fluturonin mbi kokat tona. Duke qenë të shtrirë barkazi, u përgjigëm me zjarr nga pushkët tona.

"Projektorin, projektorin!" - briti dikush. - "Qëllojeni projektorin!" - dhe projektori u fik, qartë i thyer nga fishekët e qitësve tanë. Automjetet e blinduara me shpejtësi u ndalën, por mitralozi vazhdoi të qëllojë qorrazi. Në atë çast u dëgjua bërtima para nesh duke lajmëruar se shpërthimi ishte kryer - dhe një nga një depërtuam nëpër vrimën e ngushtë duke i grisur teshat dhe trupin për telin gjëmbor. U dëgjuan hapat në vrap dhe dy figura të veshura në xhard u hodhën në vrimë ndërmjet telave gjëmborë; na u bashkangjit roja jonë. Italianët qartë nuk kishin dëshirë t'i lëshojnë automjetet dhe të hyjnë në luftë të hapur me ne ...

Dhe atëherë ishim në trollin egjiptian - ose, më mirë, vazhduam të vrapojmë të përcjellur edhe një kohë me qitje përtej kufirit, duke u fshehur pas shkëmbinjve, sukave ranore dhe ndonjë shkurreje.

Agimi na takoi thellë në territorin egjiptian dhe jash-të rrezikut. Prej njëzet njerëzve tanë pesë nuk ishin, sigurisht kanë vdekur, kurse katër janë plagosur edhe pse asnjë seriozisht.

"Zoti ishte i mëshirshëm ndaj nesh", - tha njëri prej muxhahidëve të plagosur. - "Nganjëherë e humbim gjysmën derisa kalojmë nëpër tela. Por natyrisht, nuk vdes askush nëse Zoti, qoftë i lavduar emri i Tij, ashtu nuk dëshiron... Dhe, a nuk thotë Libri i Shenjtë: "Mos fol për ata që janë mbytur në rrugë të Zotit se janë të vdekur, sepse ata jetojnë...?"

Pas dy javësh, duke u kthyer rrugës prej Mars Matruhit dhe Aleksandrisë deri në Egjiptin e Epërm, e prej aty, si është përgatitur më herët, me anije deri në Janbu, Zejdi dhe unë u gjetëm përsëri në Medine. Tërë aksioni ka zgjatur rreth dy muaj dhe mungesa jonë nga Hixhazi mezi ishte vërejtur.

Ndërsa po kaloja me Sidi Muhammed ez-Zuvajin nëpër zavinë modeste të senusive në Medine, ato kujtime në vdekje dhe pashpresë e përshkojnë shpirtin tim, e pastaj aroma e pishave, frika rreth zemrës në fishkëllimën e fishekut mbi kokën time dhe dhembje për shkak të gjurmimit të pashpresë; kujtimi në aksionin tim në Cirenaike po zvenitet, kurse mbetet vetëm dhembja.

#### - 4 -

Sërish qëndroj para Senusit të Madh dhe shikoj fytyrën e lodhur të luftëtarit të vjetër; përsëri e puth atë dorë që e ka mbajtur shpatën aq gjatë që më nuk mund ta mbajë.

"Zoti të bekoftë, djalo dhe ta forcoftë rrugën tënde... Tashmë kaloi një vit prej kur jemi takuar për herë të fundit, e pikërisht ky vit ka parë fundin e shpresave tona... Por lavdi i qoftë Zotit, çfarëdo të jetë vendimi i tij..."

Vërtet ky është dashur të jetë vit i pikëllueshëm për Seid Ahmedin; rrudhat rreth gojës së tij janë më të thella, kurse toni i tij më i qetë se kurrë më herët. Shqiponja e vjetër është thyer. Ai është ulur i strukur në qilim, me *burnusin* fortë të pështjellë rreth vetes sikur dëshiron që të ngrohet, duke shikuar pa fjalë në largësinë e pafund.

"Sikur së paku të kisha mund ta shpëtoja Umer el-Muhtarin", - pëshpëriti. - "Sikur të kishim mundur ta bindnim që të strehohet në Egjipt ndërsa kishte ende kohë..."

"Askush s'ka mundur ta shpëtojë Sidi Umerin", - e ngushëlloj atë. - "Ai s'ka dashur të shpëtojë. Më shumë ka

dashur të vdesë kur tashmë nuk mund të fitonte. E kam ditur këtë kur jam përshëndetur me të, Sidi Ahmed".

Seid Ahmedi ngadalë tund kokën: "Po, edhe unë e kam ditur këtë, edhe unë e kam ditur këtë... Tepër vonë e mësova. Nganjëherë më bie ndër mend se kam gabuar që i kam dërguar ftesë nga Stambolli, para shtatëmbëdhjetë vjetësh... A nuk ka qenë kjo mbase fillimi i vdekjes jo vetëm për Umerin por edhe për të gjithë senusitët?"

Nuk kam ndonjë përgjigje për këtë, sepse gjithherë kam menduar që vendimi i Seid Ahmedit për ta filluar luftën e vet të panevojshme kundër britanikëve ka qenë gabimi më fatal në jetën e tij.

"Por", - shton Seid Ahmedi, - "si kam mund të veproj ndryshe kur halifi musliman ka kërkuar ta ndihmoj? A kam pasur të drejtë ose kam qenë jointeligjent? Por kush, veç Zotit, mund të thotë se a është njeriu në të drejtë ose jo kur ndjek thirrjen e ndërgjegjes së vet?"

Vërtet, kush mund ta thotë këtë?

Koka e Senusiut të Madh luhatet ngadalë majtas e djathtas në hutim prej dhembjes. Vetullat e varura i mbulojnë sytë e tij dhe me sigurinë befasuese kuptova që ato kurrë më nuk do të shkëlqejnë me flakën e shpresës.<sup>13</sup>



## XII. Fundi i rrugës

- 1 -

E lëshojmë Medinen vonë natën, duke ndjekur rrugën "lindore" - atë së cilës ka ecur Pejgamberi në Haxhin e vet të Lamtumirës në Mekë, disa muaj para vdekjes së vet.

Kalërojmë në pjesën tjetër të natës dhe në agimin që po lindet. Pas pushimit të shkurtër për shkak të namazit të sabahut vazhdojmë nën vrerësinë e reve. Para mesditës filloi shiu dhe së shpejti ishim të lagur deri në lëkurë. Më në fund vërejmë kampin e vogël beduinas, larg nga ana e djathtë, dhe vendosëm që të strehohemi nën një-rën prej tendave të zeza.

Ky është kamp i vogël dhe i përket grupit të beduinëve Harb, që na presin me "Zoti ju ruajt, udhëtarë, mirë se erdhët" në mënyrë të zëshme. E shtrova mbulesën time mbi hasurën prej leshi dhije në tendën e sheikut, gruaja e të cilit - e mbuluar sikur edhe shumica e beduinëve në këtë territor - e përsëriti mirëseardhjen e dashur të burrit të saj. Pas natës së pagjumë, së shpejti më pushtoi gjumi nga bubullima e shiut nëpër kulmin e tendës. Shiu ende rigonte kur u zgjova pas disa orëve. Terri i natës shtrihet mbi mua - ah, jo, kjo nuk është nata por pël-hura e mbyllur e tendës; kurse ajo kundërmon në leshin e lagur. I shtriva duart dhe pikërisht e prek shalën e de-

vesë në tokë pas meje. Lëmueshmëria e drurit të vjetër është e këndshme kur preket; më pëlqen të luaj me gish-ta deri te molla e shalës derisa nuk hasin në lithkën e fortë të dëshiruar nga zorrët e devesë me të cilën është e bashkuar. S'ka askush në tendë; jam vetëm.

Së shpejti ngrihem dhe dal në zgavrën e tendës. Shiu bën vrima në rërë - vrima të panumërta të imta që befasisht paraqiten dhe po ashtu zhduken që të bëjnë vend për vrimëzat e reja - kurse shpërndahet në mjegullzë për guralecët e murrme të kaltër prej graniti nga ana ime e djathtë. Nuk ndodhet askush në afërsi sepse në këtë kohë të ditës meshkujt tashmë është dashur të shkojnë të kujdesen për devetë; tendat e shumta të zeza afër akacies, poshtë në fushëgropë janë në qetësi të pasditës me shi. Nga njëri prej tyre ngrihet ballukja e përhimtë e tymit - kasneci i darkës pa u vonuar shumë; tepër është e hollë dhe modeste që t'i kundërvihet shiut dhe u lakua anash, duke u dredhur pa ndihmë sikur flokët e femrës në erë. Pas velit lëvizës të shiritave të argjendtë të përhimtë me ujë bregoret sikur lëkundën; ajri është plot aromë uji, akacie të egër dhe tenda të lagura prej leshit.

Të stërpikurit dhe të riguarit e shkallërishtëm pushoi dhe retë filluan të ngrihen nën rrezet e diellit të mbrëmjes. Nisem drejt njërit nga shkëmbinjtë e ulët të granitit. Në të thellimi është i madh, sikur ena ku mund të rrijë tërë qengji i pjekur dhe orizi që u ofrohen musafirëve në rastet solemne; tash është e mbushur me ujë shiu. Kur i vë duart në të, ai arrin deri në bërryla, i vakët, çuditërisht ledhatues dhe derisa i lëviz duart në të, duket se lëkura ime e pi. Nga një tendë del gruaja me enën e madhe prej bakri në kokë, me qëllimin e qartë që ta mbushë me ujë nga njëra prej llogaçeve të shumta në shkëmbinj; ajo i mban duart e shtrira, duke i kapur anët e teshave të veta të gjera të kuqe sikur të ishin krahë dhe duke u lëkundur

lehtë derisa po afrohet. Ajo po lëkundet sikur uji kur ngadalë rrjedh përgjatë shkëmbit, mendova; ajo është e bukur si uji... Nga largësia dëgjoj bulurimën e deveve që kthehen; dhe ja këtu, shfaqen të shpërndara pas shkëmbinjve, solemnisht duke i tërhequr këmbët e lëshuara. Barinjët u grahin me britma të rrepta, të shkurtra drejt midisit të fushëgropës, e pastaj me thirrjet "Grr... grr..." I shtynjë të gjunjëzohen; dhe shumë shpina ngjyrë gështenje u lakuan drejt tokës në lëvizje valore. Në muzgun që tashmë po bie njerëzit ua lidhin këmbët e para deveve, e pastaj shpërndahen drejt tendave, secili në të vetën.

Ja edhe nata me terrin dhe freskinë e saj të butë. Para shumicës së tendave shkëlqejnë zjarret; gurgullima e tenxhereve dhe tavave dhe të qeshurit e grave përzihen me thirrjet e kohëpaskohshme të meshkujve dhe me pjesët e të folurit të tyre që era e sjell deri tek unë. Dhentë dhe dhitë që kanë ardhur pas deveve blegërojnë edhe një kohë dhe nganjëherë leh qeni - pikërisht ashtu si leh çdo natë në të gjitha kampet e tendave të Arabisë.

Zejdë askund në dukje; sigurisht ende flen nën ndonjë tendë. Ngadalë shëtis drejt deveve që pushojnë. Me trupat e tyre të mëdhenj i kanë grupuar vetes thellime në rërë dhe tash janë shtrirë këndshëm, disa prej tyre duke u përtypur, kurse të tjerat duke shtrirë qafat për tokë. Ndonjëra ngre kokën dhe fërfëllon kur kaloj pranë tyre dhe me çapkanllëk kafshon gungën e vet të trashë. Deveja krejtësisht e re ngushtë është afruar pranë nënës së vet; e frikësuar nga duart e mia, ajo kërcen derisa nëna e saj e kthen kokën kah unë dhe qetësisht hesht me gojë gjerë të hapur. E kapa devenë e vogël rreth qafës, e mbaj fort dhe e shtypi fytyrën time në leshin e ngrohtë të shpinës së saj; dhe përnjëherë, ajo u qetësua dhe sikur humbi çdo frikë. Ngrohtësia e kafshës së re e përshkoi fytyrën time dhe kraharorin tim, nën shuplakë ndiej se si rrah gjaku në arte-

rien e saj të qafës; kjo tretet me pulsën e gjakut tim dhe zgjon tek unë ndjenjë të pashmangshme të intimitetit me vetë jetën dhe mallëngjimin të humbur në tërësinë e tij.

## - 2 -

Udhëtojmë dhe çdo hap i deveve na çon më afër fundit të rrugës sonë. Udhëtojmë me ditë nëpër stepet e shkëlqyera me diell; flemë natën nën yje dhe zgjohemi në freskinë e agimit; ngadalë i afrohem fundit të rrugës sime.

Kurrë nuk ka pasur rrugë tjetër për mua; edhe pse këtë me vite nuk e kam ditur, Mekka gjithnjë ka qenë caku im. Më ka ftuar, shumë më herët se sa të më bëhej i vetëdijshëm shpirti për këtë, me zë të fuqishëm: "Mbretëria ime është në këtë botë sikur edhe në atë tjetrën. Mbretëria ime pret në trupin e njeriut sikur edhe në shpirtin e tij dhe shtrihet mbi çdo gjë që ai mendon, ndjen dhe punon - tregtinë e tij sikur edhe lutjen e tij, dhomën e tij të fjetjes sikur edhe politikën e tij; Mbretëria ime nuk di fund as kufij".

Dhe kur, pas një varg vjetësh krejt kjo m'u bë e qartë, e kam ditur ku bëj pjesë; e kam ditur se vëllazëria islame më priste mua qysh prej lindjes sime, dhe e pranova Islamin. Dëshira e rinisë sime të hershme që t'i përkas rrethit të caktuar të ideve, të bëhem pjesë e bashkësisë së vëllazërisë, më në fund qe përmbushur.

E çuditshme - por mbase edhe jo aq e çuditshme nëse merret parasysh ajo për çka angazhohet Islami - përvoja ime e parë si musliman në mesin e muslimanëve ka qenë përjetimi i vëllazërisë...

Ditëve të para të janarit të vitit 1927, u nisa përsëri, këtë herë në përcjellje të Elzës dhe djalit të saj, në Lindjen e Mesme dhe këtë herë, kam ndier, kjo do të jetë përgjithmonë.

Me ditë kemi udhëtuar nëpër Mesdhe, nëpër rrethin e shndritshëm të detit dhe qiellit, nganjëherë të përshëndetur me brigjet e largëta dhe me tymin e anijeve që rrëshqasin pranë nesh. Evropa mbeti larg pas nesh dhe thujse qe harruar.

Shpesh kam zbritur nga komoditeti i kuvertës sonë të kabinës në kuvertën e ndotur me radhët e grumbulluara të shtretërve të hekurt. Pasi anija lundronte drejt Lindjes së Largët, shumica e këtyre udhëtarëve kanë qenë kinezë, zejtarë të vegjël dhe tregtarë që kthehen në Mbretërinë e Mesme pas viteve të punës së rëndë në Evropë. Pas tyre ishte edhe grupi i vogël i arabëve nga Jemeni, që kishin hipur në Marsejë. Edhe ata ktheheshin në shtëpi. Zërat dhe aromat e limaneve perëndimore ende pezullonin rreth tyre; ende jetonin në ngjyrën e kuqe të përfundimit të ditës kur duart e tyre ngjyrë mbyllur e fusnin me lopata thëngjillin në kazanët e paraanijeve angleze, amerikane apo holandeze; ende flisnin për qytetet e huaja të çuditshme, Nju Jorkun, Buenos - Airesin, Hamburgun. Dikur, të kapluar me mallëngjimin e papritur për të shkëlqyeshmen, të panjohurën, qenë të huazuar në limanin e Adenit si fokistë dhe stivonjës të thëngjillit; patën shkuar jashtë botës së vet të rëndomtë dhe patën menduar se tejkalojnë veten e vet në përqaftim të pazakonshmërisë së pakuptueshme të botës, por së shpejti anija do të arrijë në Aden dhe ato kohëra do të fundosen në të kaluarën. Do ta ndërrojnë kapelën perëndimore me turban ose skufje, do ta ruajnë të djeshmen vetëm si kujtim dhe secili prej tyre do t'i kthehet shtëpisë së vet fshatare në Jemen. A do të kthehen të njëjtë sikur që janë nisur - ose të ndërruar? A i ka hapur Perëndimi shpirtat e tyre - apo vetëm i ka prekur shqisat e tyre?

Problemi i këtyre njerëzve thellohej në shpirtin tim në problem të domethënies më të gjerë.

Kurrë më parë, kam përsiatur, vendet e Islamit dhe Perëndimit nuk kanë ardhur aq afër njërit tjetrit sikundërse sot. Kjo afërsi është luftë, e dukshme dhe e padukshme. Nën trysnisë e ndikimeve kulturore perëndimore, shpirtat e shumë muslimanëve dhe muslimaneve ngadalë po shtangen. Ata lejojnë që të kthehen nga besimi i tyre burimor që përmirësimi i standardit jetësor duhet të jetë vetëm mjet për përparimin e të kuptuarit shpirtëror të njeriut; ata bien në adhurimin e njëjtë të "përparimit" në të cilin ka rënë bota perëndimore pasi e redukoi religjionin vetëm në cingërimën melodike diku në prapavijë të ndodhive; me këtë bëhen me shtat më të vegjël, e jo më të mëdhenj, sepse çdo imitim i kulturës, në kundërshtim me krijimin, pashmangshëm zvogëlon vlerën e popullit.

Nuk dua të them që muslimanët nuk do të mund të mësonin shumë prej Perëndimit, sidomos në fushën e diturisë dhe teknologjisë. Por, natyrisht, përvetësimi i nocioneve dhe metodave shkencore në realitet nuk është "imitim", e sidomos jo në rastin e popullit feja e të cilit urdhëron të kërkojnë diturinë kudo që mund ta gjejnë. Dituria nuk është as lindore as perëndimore, sepse të gjitha zbulimet shkencore janë vetëm hallka në zinxhirin e pafund të përpjekjes intelektuale që përfshinë njerëzinë si tërësi. Çdo dijetar ndërton në themelet që i kanë përgatitur pararendësit e tij, qofshin ata nga kombi i tij vetjak apo nga ndonjë tjetër; ky proces i ndërtimit, korrigjimit, përmirësimit vazhdohet prej njeriut te njeriu, nga shekulli në shekull, nga qytetërimi në qytetërim, në mënyrë që kurrë nuk mund të thuhet se arrijtet shkencore të epokës së caktuar ose qytetërimit "i përkasin" asaj epoke ose qytetërimi. Në një kohë një komb, më i fuqishëm se të tjerët, është në gjendje që më shumë t'i kontribuojë fondit të përgjithshëm të dijes, por në periudhat e gjata të gjithë me të drejtë marrin pjesë në të. Ka pasur

epoka kur qytetërimi i muslimanëve ka qenë më i fuqishëm se qytetërimi evropian. Ai i ka përcjellë Evropës zbulime të shumta teknologjike të natyrës revolucionare dhe edhe më shumë se kjo, vetë parimet "e metodës shkencore" në të cilën janë ndërtuar dituria dhe qytetërimi bashkëkohor. Megjithatë, zbulimet fundamentale të Xhabir ibn Hajjanit në kimi nuk e kanë bërë kiminë dituri "arabe", as që algjebra dhe trigonometria nuk mund të përshkruhen si dituri "muslimane", edhe pse njëri e ka zhvilluar El-Havarizmi, kurse tjetri El-Battani, të dy muslimanë, pikërisht sikundër që nuk mund të flitet për teorinë "angleze" të gravitacionit, edhe pse ai që e ka formuluar ka qenë anglez. Të gjitha të arriturat e tilla janë pronësi e përbashkët e gjinisë njerëzore. Për këtë, nëse muslimanët përvetësojnë, sikundër duhet patjetër t'i përvetësojnë metodat bashkëkohore në shkencë dhe teknologji, ata vetëm do të ndjekin instinktin evolucionues që i shtyn njerëzit që të shërbehen me përvojat e njerëzve të tjerë. Por, nëse ata përvetësojnë e për këtë nuk ka nevojë - format jetësore perëndimore, sjelljet, traditat dhe konceptet shoqërore perëndimore, ata me këtë nuk do të fitojnë asgjë, sepse atë që Perëndimi në këtë pikëpamje mund t'na japë nuk do të jetë më superiore se ajo që na ka dhënë kultura e tyre dhe në çka udhëzon feja e tyre.

Nëse muslimanët i ruajnë të kthjellta kokat e veta dhe e pranojnë përparimin si mjet, e jo si cak për vetveten, ata mund jo vetëm ta ruajnë lirinë e tyre vetjake të brendshme por, po ashtu, mbase, mund t'ua përcjellin perëndimorëve fshehtësinë e humbur të ëmbëlsisë jetësore...

Ndër jemenasit në anije ka qenë edhe një njeri thata-nik, i vogël me hundë shqiponje dhe me fytyrë aq ekspresive sikur po flakëron, por lëvizjet e tij kanë qenë të qeta e të matura. Kur mësoi se posa e kam pranuar Islamën, ka shprehur simpati të posaçme ndaj meje; me orë do të ulti-

shim së bashku në kuvertë derisa më fliste për fshatin e vet në kodrat jemenase. Quhej Muhammed Salih.

Një mbrëmje e kam vizituar në kuvertën e poshtme. Njëri prej miqve të tij ishte i shtrirë në ethe në shtratin e vet të metaltë dhe më thanë që mjeku i anijes nuk ka dëshiruar të zbresë në këtë kuvertë. Pasi u pashë se lëngonte prej malaries i dhashë kininë. Derisa angazhohesha rreth tij, jemenasit tjerë u mblodhën në kënd rreth Muhammed Salihut të vogël dhe, duke shikuar në mua, pëshpëritën mes veti. Në fund njëri prej tyre, njeri i lartë me fytyrë ngjyrë ulla gështenjë dhe me sy të ngrohtë të zi, m'u afrua dhe më afroi një lëmsh monedhash të tutluara:

"I tubuam këto ndërmjet veti. Për fat të keq, nuk ka shumë; për dashurinë tonë pranoi këto".

Unë ngurrova, i befasuar, dhe shpjegova se ilaçin për shokun e tyre nuk e ofrova për para.

"Jo, jo, e dimë këtë por megjithatë pranoi këto para. Kjo nuk është pagë, por dhuratë - dhuratë prej vëllezërve t'u. Ne jemi të lumtur për shkak tëndin dhe për këtë t'i ofrojmë paratë. Ti je musliman dhe vëlla yni, ti madje je më i mirë se ne, sepse ne jemi lindur muslimanë, baballarët tanë kanë qenë muslimanë sikur edhe gjyshërit tanë, kurse ti e ke pranuar Islamin me zemrën tënde vetjake... Pranoi paratë, vëlla, për hir të Pejgamberit të Zotit".

Kurse unë, ende i lidhur me traditat e mia Evropiane, jam mbrojtur: "Po, unë nuk mund ta pranoj dhuratën si kthim për shërbim shokut të sëmure... Pos kësaj, unë kam mjaft para; juve sigurisht u nevojiten më shumë se sa mua. Mirëpo, nëse pikërisht dëshironi që ta jepni, jepjani të varfërve në Port Said".

"Jo", - flisnin jemenasit, - "ti merre nga ne, e nëse nuk don ta mbashë, jepju të varfërve në emrin tënd".

Më bindën dhe, të prekur nga refuzimi im, më në fund u dëshpëruan dhe heshtën sikur i refuzova jo paratë

e tyre por zemrat e tyre. Unë papritmas kuptova: atje prej nga kam ardhur njerëzit janë mësuar të ndërtojnë mure ndërmjet Unë dhe Ju, kurse kjo është bashkësi pa mure...

"M'i jepni paratë vëllezër. I pranoj, u jam mirënjohës".

### - 3 -

"Nesër, insha'Allah, do të jemi në Mekë. Zjarrin që po e nder, Zejd, do të jetë i fundit; udhëtimin tonë po i afrohet fundi".

"Por sigurisht, xhaxh, do të ketë ende zjarre që duhet nderur dhe do të ketë edhe ndonjë udhëtim para nesh?"

"Mund të jetë edhe ashtu, Zejd, vëlla; por disi po ndiej se ato udhëtimet e tjera nuk do të jenë në këtë vend. Aq gjatë jam endur nëpër Arabi sa që kjo ka hyrë në gjak dhe frikohem që nëse nuk shkoj tash, nuk do të shkoj kurrë... Kurse unë duhet të shkoj patjetër, Zejd. A nuk të kujtohet thënia se uji duhet patjetër të lëvizë e rrjedhë që të mbetet i kthjellët? Dëshiroj, derisa jam ende i ri, të shoh si jetojnë vëllezërit tanë muslimanë në pjesët tjera të botës - në Indi, në Kinë, në Javë..."

"Por, dajo", u përgjigj Zejdi me shqetësim, "ti assesi nuk ke pushuar ta duash këtë vend arab?"

"Jo, Zejd, e dua po aq sa edhe më herët; ndoshta madje pak tepër - aq sa më dhemb kur mendoj në atë çka ardhmëria mund t'i sjellë. Kam dëgjuar që Mbreti ka për qëllim t'ua hapë vendin e vet të huajve në mënyrë që prej tyre të fitojë para; do t'u lejojë të hulumtojnë naftën në El-Hasa dhe arin në Hixhaz - kurse vetë Zoti e di çka krejt kjo do t'u sjellë beduinëve. Ky vend kurrë më nuk do të jetë i njëjti..."

Nga qetësia e natës shkretinore u dëgjua çukurmimi i devesë në galop. Një udhëtar i vetmuar ishte sulur nga terri në dritën e zjarrit tonë të kampit derisa i dredhën

vathat në shalë dhe fërfëllon abaja e tij; me shpejtësi e ndali devenë dhe, duke mos pritur që ajo të gjunjëzohet, kërcën nga shala. Pas "Es-selamu alejkum" të shkurtër ai filloi, duke mos folur më asnjë fjalë, t'ia heq shalën kafshës, t'i hedhë thasët te zjarri i kampit dhe u ul në tokë, ende i heshtur, duke kthyer fytyrën prej nesh.

"Zoti të ruajt, Ebu Seid", - thotë Zejdi, i cili qartë e njohu të panjohurin. Por ai mbetet i heshtur, në çka Zejdi kthehet drejt meje: "Ai është njëri prej raxhaxhilëve të Ibn Saudit, djall".

Ebu Seidi i bezdisshëm është mjaft i zi; buzët e tij të trasha dhe flokët kaçurela, kujdesshëm të zgjatura në dy gërsheta të gjata, jep paraardhësit afrikanë. Ai është mjaft bukur i veshur; thika për brezi - sigurisht dhuratë e Mbretit - i qarkuar me ar, kurse deveja e tij ka ngjyrë të shkëlqyeshme mjalti, "veriore", këmbë të holla, kokë të ngushtë, me shpatulla të fuqishme, kurse vithet sikur te kaprolli.

"Ç'ke, Ebu Seid? Përse nuk flet me shokët t'u? A të ka magjepsur xhindi?"

"Nura..." - pëshpëriti Ebu Seidi - dhe pas një kohe, kur kafeja e nxehtë ia zgjidhi gjuhën, na foli për Nurën, vashën nga vendi Er-Ras (ai përmendi emrin e babait të saj që rastësisht e kam njohur mirë). Ai fshehurazi e ka vështruar përtej murit të kopshtit derisa merrte ujë në përcjellje të grave tjera, - "dhe kam ndier sikur thëngjilli i zjarrtë ka rënë në zemrën time. E dua, por babai i saj, qen, nuk ma jep vajzën e vet që me te të martohem, i mjeri - dhe tha se ajo më frikohet. Kam ofruar shumë para si miraz të saj dhe edhe një pjesë të tokës; por ai gjithnjë ka refuzuar dhe më në fund e ka martuar për kushëririn e saj, Zoti dhashtë e qofshin të mallkuar, edhe ai edhe ajo!"

Fytyra e tij e fuqishme, e mbyllur është ndritur nga një anë me zjarrin e kampit, kurse hijet që vallëzojnë në-

për të janë sikur hijet e mundimeve të rënda. Nuk mund të durojë ulur gjatë kohë; i shtyrë nga paret e vet, kërceu, një kohë diç pështjell rreth shalës, i kthehet zjarrit dhe, papritmas u sul në natën e errët. E dëgjojmë se si në rrathë të gjerë vrapon rreth kampit tonë dhe bërtet:

"Zjarri i Nurës më djeg! Zjarri i Nurës flakëron në kraharonin tim!", - dhe sërish, me dënësje: "Nuro, Nuro!"

I afrohet zjarrit të kampit dhe vrapon në rreth rreth tij, kurse kaftani i tij fërfëllon sikur shpendi i natës, fantazmë në dritën dhe terrin e zjarrit vezullues.

A është i marrë? Nuk mendoj se është. Por mund të jetë që nga thellësitë e errëta të shpirtit të tij të ketë ndonjë emocion zanafillor, atavist - kujtimet stërgjyshore të pyllit të pashkelur afrikan, kujtesës së popullit që ka jetuar midis demonëve dhe mistereve mbitokësore, ende shumë afër kohës kur shkëndija hyjnore e vetëdijes e shndërroi shtazën në njeri, kurse shkëndija nuk është ende mjaft e fortë t'i lidhë instinktët e çliruara, dhe t'i kthejë në emocione më të larta... Për një çasti mu duk se veritet po e shoh zemrën e Ebu Seidit para vetes, copën e mishit e gjakut se si thithet në zjarrin e epsheve sikur në zjarrin e vërtetë - dhe disi më duket krejtësisht e natyrshme se duhet të qajë aq shumë, të qajë e ngarendë në xhiro si i marrë derisa devetë e hutuara, të frikuara, u ngritën në tri këmbë...

Atëherë përsëri na afrohet dhe hedhet në tokë. E kuptoj protestën në fytyrën e Zejdit gjatë shikimit në suljen e tillë të pashfrenueshme - sepse për karakterin aristokrat të arabit të vërtetë nuk ekziston asgjë që meriton përbuzje më të madhe se mosshfrenimi i tillë i emocioneve. Por zemra e mirë e Zejdit së shpejti dëftohet në dritë më të mirë. Ai e tërhoqi Ebu Seidin për mëngë dhe derisa ky e ngriti kokën dhe shikon në të me sy joshprehës, Zejdi me butësi e tërheq kah vetja:

"Ebu Seid, si mund të harrohesh kështu? Ti je luftëtar, Ebu Seid... Ti ke vrarë njerëz dhe shpesh ke patur rast të jesh i mbytur - e tash femra po të rrëzon? Ka edhe femra tjera në botë pos Nurës... Ebu Seid, o luftëtar, i marrë..."

Dhe derisa afrikani ngadalë rënkon dhe e mbulon fytyrën me duar, Zejdi vazhdon:

"Qetësohu, o Ebu Seid... Shiko lart! A po e sheh atë shteg të ndritshëm në qiell?"

Ebu Seidi shikoi lart i çuditur, kurse unë, edhe duke mos dashur, ndjek gishtin me të cilin Zejdi dëfton dhe ktheva shikimin në shtegun jo të rregullt të zbehtë që shkon nëpër qiell prej njërit horizont te tjetri. Do ta quanit rruga e qumështit, por beduinët në urtësinë e vet shkretinore dinë se kjo është vetëm gjurmë e dashit qiellor që i qe dërguar Ibrahimit kur, në nënshtrim Zotit dhe në dëshpërim të zemrës së vet, ngriti thikën ta flijojë të birin e vet të parë të lindur. Shtegu i dashit ka mbetur i dukshëm në qiej për kohë të amshueshme, simbol i mëshirës dhe bekimit, kujtimi në shpëtimin të dërguar për ta shmangur dhembjen e një zemre njerëzore - dhe ngushëllim atyre që do të vijnë më vonë; atyre që janë të vetmuar ose të humbur në shkretëtirë dhe atyre që zënë në thua të qajtur e të dëshpëruar, nëpër shkretëtirën e jetëve të veta.

Dhe Zejdi vazhdon me duart të shtrira drejt qiellit, duke folur solemnisht, por megjithatë joimponueshëm si vetëm arabi mund të flasë:

"Ky është shtegu i dashit të cilin Zoti ia dërgoi mësuesit tonë Ibrahimit kur pikërisht dëshiroi ta mbyisë të birin e vet të parë të lindur; kështu Zoti i ka dëftuar mëshirë robrit të Vet... A mendon se ty do të të harrojë?"

Nën ndikimin e fjalëve qetësuese të Zejdit fytyra e mbyllur e Ebu Seidit kthjellohet në habinë fëmijërore dhe bëhet dukshëm më e qetë; ai shikon me kujdes, sikur

nxënësi që përcjell mësuesin e vet, drejt qiellit, duke tentuar që në të të gjejë ngushëllim për dëshpërimin e vet.

- 4 -

Ibrahimi dhe dashi i tij qiellor; fotografitë e tilla lehtë bien në mendje në këtë vend. Është e çuditshme sa i gjallë është kujtimi në atë pejgamberin e ndershëm tek arabët - shumë më i gjallë se te kristianët në Perëndim, që, përndryshe, i bazojnë botëkuptimet e veta religjioze në rend të parë në Besëlidhjen e Vjetër se është fillim dhe fund i fjalës së Zotit njeriut. Prania shpirtërore e Ibrahimit gjithnjë ndiqet në Arabi, sikur edhe në tërë botën muslimane, jo vetëm në shpeshësinë që emri i tij u jepet fëmijëve muslimanë (Abraham - në trajtën arabe Ibrahim), por po ashtu edhe në përkujtimin përherë të përtëritur, si në Kur'an ashtu edhe në lutjet e përditshme të muslimanëve, në rolin e këtij pejgamberi si në predikuesin e parë të vetëdijshëm të Unitetit të Zotit. Kjo shpjegon edhe rëndësinë e madhe që Islami ia jep pelegrinazhit vjetor në Mekë, që prej kohëve më të lashta ngushtë është e lidhur me gojëdhënë për Ibrahimin. Atë - sikur që shumë perëndimorë gabimisht e supozojnë - në botën ideore arabe nuk e ka futur Muhammedi në tentim, thënë ashtu, që të "huazojë" elemente të traditës religjioze nga judaizmi, sepse historikisht është vërtetuar se personaliteti i Ibrahimit ka qenë i njohur për arabët kaherë para paraqitjes së Islamit. Çdo përmendje e këtij pejgamberi në vetë Kur'anin ashtu është shprehur që nuk lë kurrfarë dyshimi që ai ka zënë vend të dalluar në frymën arabe me shekuj para epokës së Muhammedit; emri i tij dhe përshkrimi i jetës së tij gjithherë janë përmendur pa kurrfarë hyrjeje ose shpjegimi - si diç që, madje edhe dëgjuesve më të hershëm të Kur'anit, është dashur t'u jetë mirë e njohur. Njëmend, qysh në epokën

paraislame Ibrahimimi ka pasur vend të dalluar në gjenealogjinë e arabëve si stërgjysh, nëpërmjet Ismailit, të birit të Haxheres, grumbullit "verior" arab që sot përfshin më shumë se gjysmën e kombit arab, kurse së cilës i përket edhe fisi i Muhammedit Kurejsh.

Vetëm fillimi i rrëfimit për Ismailin dhe nënën e tij është përmendur në Besëlidhjen e Vjetër sepse zhvillimi i saj i mëtejshëm nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në fatin e kombit arab, së cilës kryesisht i është kushtuar Besëlidhja e Vjetër; por tradita paraislame e arabëve ka shumë më tepër të thotë për këtë gjë.

Sipas kësaj tradite, Ibrahimimi, Haxheren dhe Ismailin e ka lënë në vendin ku është sot Mekka, që assesi nuk është e pabesueshme nëse kujtohemi që për nomadët në deve udhëtimi prej tridhjetë ose më tepër ditësh as nuk ka qenë, as sot nuk është diç e pazakonshme. Sidoqoftë, tradita arabe thotë se pikërisht këtu në këtë fushëgropë Ibrahimimi e ka sjellë Haxheren dhe djalin e vet - në këtë grykë ndërmjet kodrave të gurit, të zhveshura e të shkreta nën diellin arabik, kodrat që i rrahin erërat përvëluese shkretinore dhe të cilave madje edhe u ikin edhe shpendët grabitqare. Madje edhe sot, kur fushëgropa mekkase është përplot shtëpi, rrugë dhe njerëz plot gjuhë dhe raca, vetmia shkretinore vajton nga shpatijet e vdekura rreth saj, kurse mbi shumësi haxhinjsh që bien në sexhde para Ka'bes pezullojnë shpirtrat e atyre mijëvjeçarëve kaherë të kaluara në heshtjen e fushëgropës së zbrazët të privuar nga çdo jetë.

Ky ka qenë mjedis i mirëfilltë për dëshpërimin e asaj robëreshe egjiptiane që i ka lindur djal zotëriut të vet dhe kështu u bë objekt i urrejtjes së tillë te gruaja e zotëriut të vet që ajo dhe i biri i saj Ismaili qenë të detyruar të largohen. Stërgjyshi vërtet ka mundur të jetë mjaft i prekur kur është dashur ta bëjë këtë që ta qetësojë gruan e

vet të papajtueshme, por duhet të kujtohemi që ai, i cili ishte aq i afërt me Zotin, ka qenë i bindur se mëshira e Tij është pa kufij.

Na është thënë në Librin e krijimit se Zoti kështu e ka ngushëlluar: "Mos të ketë vajtim në të shikuarit tënd për shkak të fëmijës dhe robëreshës tënde... Nga djali i saj do të bëjë popull sepse ai është pasardhës yt". Dhe kështu Ibrahim i la gruan dhe fëmijën duke qarë në fushëgropë, duke ua lënë rreshekën me ujë dhe thesin e hurmeve dhe shkoi në veri nëpër Midian në vendin Kanan.

Në fushëgropë ka qenë druri i vetmuar i sarhës së egër. Në hijen e saj ishte ulur Haxherja me fëmijën në prehërin e saj. Rreth saj ka qenë ngrohtësia kapsallitëse, përcëlluese, drita verbuese në rërë dhe shpatijet shkëmbore. Sa e mirë ka qenë hija e drurit... Por qetësia, kjo qetësi e tmerrshme pa frymë të çfarëdo krijese të gjallë! Derisa dita kalonte ngadalë, Haxherja mendonte; sikur së paku diç e gjallë të vinte këtu, shpend, ndonjë shtazë, e madje edhe bishë e egër, çfarë gëzimi do të ishte! Por asgjë nuk erdhi pos nata, këndellëse sikur të gjitha netët shkretinore, duke e freskuar qemerin e territ dhe yjeve që e zbutë pezmatimin e pashpresës së saj. Haxherja ndjen guxim të ri. Ajo e ushqen fëmijën me hurma dhe të dytë pijnë ujë nga rrësheku.

Nata kaloi, dhe edhe një ditë dhe edhe një natë. Por kur erdhi dita e tretë me frymën përcëlluese, më nuk kishte ujë në rrëshekë, kurse dëshpërimi e kapërcen çdo forcë dhe shpresa shndërrohet në shtambë të thyer. Dhe derisa fëmija së koti ka qarë, me zë gjithnjë e më të dobët duke kërkuar ujë, Haxherja, jashtë vetes për shkak të vuajtjes së fëmijës së vet që po vdes, ka ngarendur me duar të ngritura atje - këtu nëpër fushëgropë gjithnjë shtegut të njëjtë ndërmjet dy bregoreve; pikërisht si kujtesë në dëshpërimin e saj haxhinjtë që vijnë tash në Me-

kë vrapojnë shtatë herë ndërmjet këtyre dy bregoreve, duke britur sikur që ajo dikur ka britur: "O Ti Bujarë, i cili je përplot mëshirë! Kush do të na mëshirohet nëse Ti nuk mëshirohesh!"

E atëherë erdhi përgjigjja: shih, shpërthen uji dhe filloi të rrjedhë nëpër rërë. Haxherja bërtiti prej gëzimit dhe e zbuti fytyrën e fëmijës me lëngun e çmueshëm që të pijë; edhe ajo ka pirë me të, duke bërtitur, duke përbe-tuar ndërmjet dënësjes "Zummi, zummi"- që është fjalë pa domethënie, përngjasim i thjeshtë i jehonës së ujit derisa buron nga toka, sikur dëshiron të thotë! "Rridhë, rridhë!" Që mos të derdhet dhe humbet në tokë, Haxherja e rrethoi burimin me rërë; në këtë uji pushoi që të derdhet dhe u bë pus që prej atëherë quhet gurrë, Zem-Zem dhe ekziston edhe sot e kësaj dite.

Që të dytë tash kanë qenë të shpëtuar prej etjes, kurse hurmat kanë zgjatur pak më gjatë. Pas disa ditësh grupi i beduinëve, që me familjet e veta dhe tërë pasurinë e patën lëshuar vendin e vet në Arabinë Jugore dhe duke kërkuar kullota të reja, rastësisht ka hasur pranë grykës së fushëgropës. Kur panë tufat e shpendëve se si qarkullojnë mbi të, konkluduan se atje patjetër duhet të ketë ujë. Disa prej tyre kalëruan në fushëgropë që ta hulumtojnë dhe gjetën gruan e vetmuar me fëmijën se si qëndron ulur pranë pusit plot ujë. Paqedashës çfarë kanë qenë, kërkuar prej Haxheres leje që të banojnë në fushëgropën e saj. Ajo këtë edhe ua lejoi me kusht që gurra e Zem - zemit gjithëherë të mbetet në pronësi të Ismailit dhe pasardhësve të tij.

Sa i përket Ibrahimit, gojëdhëna thotë se është kthyer në fushëgropë pas një kohe dhe e ka gjetur Haxheren dhe djalin e saj të gjallë, si i pat premtuar Zoti. Që atëherë shpesh i ka vizituar dhe priti që Ismaili të rritet dhe të martohet me vajzën nga fisi jugarab. Konsiderueshëm

më vonë në ëndërr i qe urdhëruar që në afërsi të gurrës Zem - zem ta ndërtojë tempullin për Krijuesin e vet; pas kësaj, me ndihmën e djalit të vet, ai e ka ndërtuar vendin e shenjtë që edhe sot ekziston në Mekë, kurse është i njohur me emrin Ka'ba. Derisa i gdhendnin shkëmbinjtë për atë që do të duhej të jetë tempulli i parë kurdoherë i ngritur për lavdi një Zotit, Ibrahim i kthen fytyrën e vet drejt qiejve dhe ka bërtitur: "Lebbejk, All-llahumme, lebbejk!" - "Për Ty jam i gatshëm, Zot, për Ty jam i gatshëm!"; për këtë gjatë kohës së pelegrinazhit Mekës - pelegrinazhit tempullit të parë Një Zotit - muslimanët bërtasin: "Lebbejk, All-llahumme, lebbejk!" kur i afrohen Qytetit të Shenjtë.

- 5 -

"LEBBEJK, ALL-LLAHUMME, LEBBEJK..."

Sa herë e kam dëgjuar këtë britmë gjatë kohës së pelegrineve të mia Mekës. Më duket sikur po e dëgjoj edhe tash derisa jam shtrirë pranë Zejdit dhe Ebu Seidit te zjarri.

I mbylla sytë dhe Hëna dhe yjet u zhdukën. E vë dorën mbi fytyrë e madje as drita e zjarrit nuk mund të depërtojë nëpër çëpallat e mi të syve; të gjithë zërat shkretinorë treten dhe dëgjoj vetëm atë zë "lebbejk" në shpirtin tim dhe rrahjen dhe oshëtimën e gjakut në veshë; godet edhe buçet edhe kumbon sikur goditja e valëve të detit për trupin e anijes edhe sikur rrapëllima e makinës. Dëgjoj rrapëllimën e makinave dhe ndiej dridhjen e bordove të anijes nën mua dhe aromën e tymit dhe vajit të saj dhe dëgjoj britmën "Lebbejk, All-llahumme, lebbejk" si jehonte nga mijëra fyta në anije që më ka bartur në haxhin tim të parë, para pothuaj gjashtë vjetësh, nga Egjipti në Arabi, nëpër detin që quhet i Kuq, kurse

askush nuk di përse. Sepse uji ishte i përhimtë derisa kemi lundruar nëpër Kanalën e Suezit, i mbyllur nga ana e djathtë me malet e Kontinentit afrikan, kurse nga e majta me malet e Siujdhesës së Sinajit - të dyja të zhveshura, zinxhirët gurorë pa vegetacion që derisa lundrojmë më tej, shkallërisht shpërndahen dhe humben në largësinë mjegulluese të paqartë të përhimtë, që ju shtynë që vendin më shumë ta ndieni se sa ta shihni. E kur, në pasditen e vonshme, kemi rrëshqitur në horizontin e hapur të Detit të Kuq, ai ka qenë i kaltër si Mesdheu nën goditjet e erës që përkëdhel.

Në anije kanë qenë vetëm pelegrinët, aq shumë sa mezi mund të qëndronin në anije. Kompania e anijeve, lakmuese për fitim nga sezoni i shkurtër i haxhit, me një fjalë e ka ngjeshur deri në krye duke mos u kujdesur për komoditetin e udhëtarëve. Në kuvertë, në kabina, në të gjitha korridorët, në çdo shtyllë, në restorantin e klasit të parë e të dytë, në të gjitha depot që ishin zbratur për këtë qëllim dhe të përgatitura me shkallët e përkohshme, në çdo hapësirë disponuese dhe në çdo kënd qeniet njerëzore kanë qenë pamëshirshëm të ngjeshura. Këta kanë qenë në të shumtën pelegrinët nga Egjipti dhe Afrika Veriore. Në modestinë e madhe, vetëm me cakun e udhëtimit para syve ata pa murmurimë i duronin të gjitha ato mundime të panevojshme. Kushdo që i ka parë se si ulen në kuverta, në turma të ngjeshura, meshkujt, gratë dhe fëmijët, dhe mezi arrijnë t'i plotësojnë nevojat e veta (sepse kompania nuk ka siguruar kurrfarë ushqimi); si furnizohen me ujë në kanistra metali e matare, kurse çdo lëvizje është mundim në këtë ngushti njerëzor; si tubohen pesë herë në ditë rreth musllukut me ujë - kurse kishte tepër pak për aq shumë njerëz - që të marrin abdest para namazit; si kanë duruar në ajrin e ndytë të depove të thella dy kate nën kuvertë, ku përndryshe udhë-

tojnë vetëm dengjet dhe sënduqet e mallit - kushdo që e ka parë këtë, ai duhet të pranojë fuqinë e besimit në këta pelegrinë. Sepse ata vërtet sikur as nuk kanë ndier ruajtjen e vet, aq kanë qenë të preokupuar me mendimet për Mekën. Kanë folur vetëm për haxhin, kurse mallëngjimin që e prisnin në të ardhmen e afërt u jepte fytyrave të tyre shkëlqim të ndritshëm. Gratë shpesh në kor këndonin këngën për Qytetin e Shenjtë dhe gjithnjë rishtazi depërtonte refreni:

"Lebbejk, All-llahumme, lebbejk!"

Rreth mesditës së ditës vijuese ra sirena e anijes; kjo ka qenë shenjë se kemi arritur përballë Rabigës, limanit të vogël në veri të Xhides ku, në pajtim me traditën e vjetër, pelegrinët që vijnë nga veriu i hedhin rrobat e veta të përditshme dhe e veshin ihramin, petkun e haxhillëkut. Ai përbëhet prej dy pjesëve jo të qepura të pëlhurës së bardhë prej leshi ose pambuku, derisa tjetri lirisht kalohet mbi një supe, gjatë së cilës koka mbetet e zbuluar. Shkaku për të veshurit e tillë, kurse kjo rrjedh qysh prej Pejgamberit, është sepse gjatë kohës së haxhit nuk guxon të ketë ndjenja të tëhuajësimit ndërmjet besimtarëve që tubohen nga të gjitha anët e botës që ta vizitojnë Shtëpinë e Zotit, kurrfarë dallimi ndërmjet racave dhe kombëtare, ndërmjet të pasurve dhe të varfërve, të lartëve dhe të ultëve, në mënyrë që të gjithë të dinë që janë vëllezër, të njëjtë para Zotit dhe njerëzve. Së shpejti në anijen tonë u zhdukën petkat laramane të meshkujve. Më nuk kanë mund të shihen tarbushët e kuq tunizianë, burnusët luksozë marokanezë ose galabitë pitoreske të felahëve egjiptianë; kudo rreth jush vetëm pëlhura e bardhë modeste, pa kurrfarë dekori, e pështjellë rreth trupore që tash lëviznin me dinjitet më të madh, qartë të shprehur me këtë kalim në gjendjen e haxhit. Pasi ihrami do të mbulonte tepër pak, pelegrinët mbesin në veshjen e tyre

të rëndomtë; mirëpo, pasi kjo veshje në anijen tonë ka qenë vetëm e bardhë ose e zezë-fustanët e zinj të egjiptianeve dhe të bardhë të verioafrikaneve - ajo nuk ka futur kurrfarë ngjyre në pamje.

Në gdhirjen e ditës së tretë anija lëshoi spirancën në bregun e Arabisë. Shumica qëndronim pranë rrethojës në kuvertë dhe shikonim drejt tokës që ngadalë dilte nga mjegulla e mëngjesit.

Në të gjitha anët kanë mund të shihen siluetat e anijeve tjera të pelegrinëve, kurse ndërmjet tyre dhe tokës vijat e zbehta të verdha dhe zymryde të gjelbra në ujë, gomat karole nënujore, pjesë e atij zinxhiri të gjatë, jomikpritës që shtrihet nën bregun e lindjes së Detit të Kuq. Pas tyre, drejt Lindjes, ka qenë diç si breg, i ulët dhe i mbyllur; por kur Dielli pas tij ngrihet, kjo papritmas pushon të jetë breg dhe shfaqet pranë detit qyteti që ngjitet prej këndit drejt qendrës me shtëpi gjithnjë e më të larta, struktura e vogël dhe e këndshme e gurit të trëndafiltë e të verdhë të përhimtë koral: qytet - limani Xhidja. Pakngapak keni mundur të dalloni dritaret e latuara me mushebakë dhe stenat e ballkonëve, të cilëve ajri i lagshhtë gjatë kohës u ka dhënë ngjyrën uniforme të përhimtë të gjelbër. Në mes është minarja e dalë përpara, e bardhë dhe e drejtë si gishti i shtrirë.

Sërish britma "Lebbejk, All-llahumme, lebbejk!" - thirrje e gëzueshme e vetë përparësisë dhe mallëngjimit që del prej haxhinjve të entuziazmuar, në të bardhë të veshur në anije, nëpër ujë, drejt vendit të shpresave të tyre më të mëdha.

Shpresave të tyre dhe të mia, sepse për mua shikimi në bregdetin e Arabisë ka qenë kulmin i viteve të hulumtimeve. Shikova në Elzën, gruan time, që ishte përcjellësi im në këtë haxh dhe lexova në sytë e saj ndjenjën e njëjtë...

Atëherë shikua shumësi krahësh të bardhë se si sulen drejt nesh nga toka: barkat bregdetare arabe. Me vela latine ato kanë rrëshqitur nëpër sipërfaqen e lëmuar të detit, butë dhe pa zhurmë duke gjetur rrugën në thellësi ndërmjet grumbujve të rërës nën ujë të padukshëm koralë - të deleguarit e parë të Arabisë të gatshëm të na pranojnë. Na janë afruar gjithnjë afër e më afër dhe, më në fund, të tubuar përbri anës së anijes, me direktet që lëkundën, i lëshuan velat e veta njëri pas tjetrit krahas zhurmës, fishkëllimës dhe krismës sikur tufa e gatave gjigante është lëshuar të hanë, kurse nga qetësia e paraparkohshme ngrihen klithma dhe britmat; ato kanë qenë britmat e atyre nga barkat që tash kërcenin nga barka në barkë dhe u sulën në anije që të marrin bagazhin e pelegrinëve, kurse pelegrinët kanë qenë aq të hutuar gjatë shikimit në vendin e shenjtë që çdo gjë kanë lëshuar edhe duke mos u mbrojtur.

Barkat ishin të rënda e të gjera; vazhdesia e konstruktit të tyre ka qenë në kundërshtim të çuditshëm me bukurinë dhe shtathollësinë e direktëve dhe velave të tyre të gjatë. Është dashur që në barkën e tillë, ose, ndoshta, në barkën diç më të madhe të llojit të njëjtë, të jetë nisur detari i guximshëm Sindbadi në aventura të padëshirueshme dhe u ndal në ndonjë ujdhesë që në realitet - çfarë tmerr! - ka qenë vetëm shpina e ndonjë balene... Kurse në anije të ngjashme kanë lundruar, kaherë para Sindbadi, fenikasit drejt jugut nëpër këtë Detin e Kuq, e nëpër Detin Arab, duke kërkuar mëlmesa, temjanë dhe thesarë të humbur...

E tash ne, pasardhësit e dobët të atyre udhëtarëve heroikë, kemi lundruar nëpër detin koral, duke iu shmangur shkëmbinjve nëntokësorë në harqe të mëdha; haxhinjtë në tesha të bardha, të ngjeshur ndërmjet bagazhit dhe bohçeve, shumësia memece që s'këllidiset në pritje.

Edhe unë isha plot pritje. Por si kam mundur të parashoh derisa isha ulur në biç të lundrës me dorën e gruas sime në dorën time, që ky aksion i thjeshtë i haxhit aq thellë, aq shumë do ta ndërrojë jetën tonë? Sërish jam detyruar të mendoj për Sindbadin. Kur i ka lëshuar brigjet e detit të atdheut të vet, ai - sikur as unë - nuk ka pasur lidhje për atë se ç'do të sjellë ardhmëria. Ai nuk i ka paraparë, as dëshiruar, të gjitha ato aventura të cilat duhet t'i përjetojë, por vetëm ka dëshiruar të tregtojë e të fitojë para; unë kam dëshiruar vetëm ta kryej haxhin, por kur ajo që do të duhej të na ndodhe njëmend ndodh, asnjëri prej nesh nuk ka qenë më në gjendje të shikojë në botë me sytë e tij të vjetër.

E vërteta, nuk kam takuar asgjë ashtu fantastike siç janë xhindët, vashat e magjepsura dhe shpendi gjigant Rok me të cilët është dashur të ndeshet detari nga Basra; por megjithatë, që shkruar që ky haxhi im i parë të skalitet më thellë në jetën time se sa që të gjitha udhëtimet e tij janë skalitur në jetën e tij. Sepse Elzën e priste vdekja, kurse asnjëri prej nesh nuk kishte kurrfarë parandjenje se sa afër ishte ajo. Sa më përket mua, e kam ditur se e kam lënë Perëndimin që të jetojë ndër muslimanët, por nuk e kam ditur që pas vetes po e lë tërë të kaluarën time. Pa kurrfarë paralajmërimi bota ime e vjetër përfundonte; bota e ideve dhe ndjenjave, synimeve dhe paraqitjeve përrëndimore. Dyert heshtazi janë mbyllur pas meje, aq heshtazi që për këtë nuk kam qenë as i vetëdijshëm; kam menduar se ky do të jetë udhëtim sikur edhe të gjitha më të hershmet, kur endet nëpër vende të huaja, që gjithnjë t'i kthehet të kaluarës së vet. Por, ditët është dashur të ndërrohen plotësisht, e me to edhe drejtimi i dëshirave të mia.

Deri atëherë tashmë pata vizituar shumë vende të Lindjes. E kam njohur Iranin dhe Egjiptin më mirë se cilindo vend në Evropë; Kabuli tashmë ka herë nuk ka

qenë i huaj për mua; bazaret e Damaskut dhe Isfahanit qenë të afërta për mua. Për këtë kam mundur të mendoj. Pa rëndësi! Kur për herë të parë kam kaluar nëpër bazar në Xhide dhe kam parë përzierjen e papërcaktuar dhe përsëritjen e paformë të asaj që tjetërkund në Lindje ka mund të shihet në përsosuri shumë më të madhe, bazari ka qenë i mbuluar me dërrasa dhe pëlhurë për thasë si mbrojtje prej ngrohtësisë zapulluese, nëpër vrima dhe të çara depërtonin rrezet e holla, të zbutura të diellit dhe e pranonin muzgun e kuzhinës së hapur para të cilave djelmoshat zezakë pjekin copat e vogla të mishit në shkoptat mbi thëngjill druri përvëlues; kafenetë me enët e vizëlluara prej mesingu dhe cikërimat dekoruese të punuara prej gjetheve të palmave; dyqane të paarsyeshme plot gjësende të pavlerë nga Evropa dhe Lindja. Kudo zabullinë dhe aroma e peshkut dhe pluhurit koral. Kudo grumbuj njerëzish - haxhinj të panumërt në të bardhë dhe qytetarë të veshur në mënyrë pitoreske të Xhides në fytyrat, teshat dhe sjelljen e të cilëve takohen të gjitha vendet e botës muslimane; ndoshta babai nga India, derisa babai i nënës - mbase vetë përzierja e malajasit dhe arabit - ka mundur të martohet me atë që ana e babait ka rrjedhë nga Uzbekët, kurse nga ana e nënës ndoshta nga Somalia; gjurmët e gjalla të shekujve të haxhit dhe mjedisit islam që nuk njih kufij sipas ngjyrës as dallimet ndërmjet racave. Krahas kësaj tollovie vendase dhe të pelegrinazhit, Xhidja atëherë (1927) ka qenë vendi i vetëm në Hixhaz ku ka qenë e lejuar të qëndrojnë jomuslimanët. Nganjëherë keni mundur të shihni mbi shkrime në duqane në latinishte dhe njerëzit në rroba të bardha tropike me helmetë tropike ose sheshirë në krye; mbi konsullata valëviteshin flamuj të huaj.

E gjithë kjo i ka takuar, thënë ashtu, jo aq tokës sa detit; zërave dhe aromave të limanit, anijeve të ndalura

pas vijave të zbehta korale, me barka peshkatarie me velat e bardha trekëndëshe - botës jo tepër tjetërfare prej Mesdheut. Megjithatë, shtëpitë ishin pak më ndryshe, të hapura flladit, me fasada pasurisht të trajtësuara, me kornizat e dritareve prej drurit të gdhendur dhe ballkonet e mbuluara, me mbrojet më të lehta prej drurit që u mundësojnë anëtarëve të familjes të shikojnë jashtë pa pengesë, por pengojnë kalimtarët ta shohin brendinë; të gjitha këto pjesë të drurit shtriheshin si dantellë e përhimtë e gjelbër në mure nga guri koral i trëndafiltë, i njomë dhe skajërisht harmonik. Ky më nuk ishte Mesdheu, por ende jo plotësisht as Arabia; ka qenë kjo bota bregdetare e Detit të Kuq, që ofron arkitekturë të ngjashme në të dy anët e veta.

Mirëpo, Arabia tashmë paralajmërohej me qiellin e çeliktë të përhimtë, me brigjet e zhveshura, gurore dhe ngrëhinave ranore drejt lindjes dhe në atë frymën e madhërisë dhe asaj varfërisë së dukshme që gjithnjë aq çuditërisht janë të përziera në peizazhin arab.

Pasdite ditën vijuese karvani ynë është nisur rrugës drejt Mekës, duke gjarpëruar nëpër turmat e pelegrinëve, beduinëve, deveve me tezza dhe pa to, deveve për udhëtim, gomarëve të mbuluar me mbulesa laramane, drejt portës lindore të qytetit. Herë - herë do të kalonte pranë nesh ndonjë veturë motorike - veturat e para në Arabinë Saudite - e ngarkuar me pelegrinë, duke trumbetuar zëshëm. Devetë sikur ndienin se këta përbindësh të rinj janë armiqtë e tyre, sepse çdoherë të zemëruara ngjiteshin për muret e shtëpive, duke tundur qafat e gjata andej - këndeje, të hutuara e të pandihmë. Kohët e reja duke kërcënuar patën përshkuar këto kafshë të gjata, të qëndrueshme, duke i mbushur me frikë dhe paralajmërimi misterioze.

Së shpejti muret e bardha të qytetit mbetën pas nesh dhë përnjëherë u gjetëm në shkretëtirë - në rrafshin e gjerë, të përhimtë gështenjë, të shkretë, të laruar me

shkurret therëse dhe njollat e barit stepik, me sukat e ulta, të izoluara që dalin nga ajo sikur ujdhesat në det, kurse të kufizuara në lindje me zinxhirët diç më të lartë, gurorë, të kaltër të përhimtë, të privuar nga çdo jetë. Kudo nëpër këtë rrafsh të rrezikshëm zvarriteshin karvanet, shumë prej tyre, në vargje të gjata - qindra e mijëra deve - kafshë pas kafshe në një të vetmin rend, të ngarkuara me tezga, pelegrinë dhe gjësende, herë - herë duke u zhdukur pas sukave e pastaj sërish duke u shfaqur. Shkallërisht shtigjet e tyre janë derdhur në një të vetmin, rru-ga ranore e krijuar nga gjurmat e karvanëve të ngjashëm gjatë shekujve të gjatë.

Në qetësinë e shkretëtirës, që më tepër e ka theksuar se sa ndërprerë zhurma e të ecurit të devesë, britma e kohëpaskohshme e beduinëve grahës dhe aty-këtu të kënduarit e ngjirur të ndonjë haxhiu, papritmas më përshkoi ndjenjë e çuditshme - ndjenjë aq joshëse saqë thuajse mund të quhet vizion: e kam parë veten në njëfarë ure të cilën e kalonte gremina e padukshme; ura aq e gjatë saqë skaji nga i cili kam ardhë tashmë është humbur në largësinë mjegulluese derisa tjetri mezi ka filluar të vërehet. Kam qëndruar në mes, kurse zemra ime shtrëngohej nga frika derisa shikohesha ashtu në gjysmë të rrugës ndërmjet dy skajeve të urës - tashmë tepër larg nga njëri, kurse jo mjaft afër tjetrit - dhe më dukej, në çastet e gjata, se gjithnjë do të duhej ashtu të mbetem ndërmjet dy skajeve, gjithnjë mbi greminën e tmerrshme - kur papritmas një egjiptiane në deve para meje briti me atë thënien e vjetër të haxhinjve "Lebbejk, All-llahumme, lebbejk!" - dhe ëndrra ime u prish.

Nga të gjitha anët keni mundur të dëgjoni njerëzit se si flasin dhe murmurojnë në gjuhë të ndryshme. Nganjëherë disa pelegrinë do të brohorisin në kor "Lebbejk, All-llahumme, lebbejk!" - ose ndonjë egjiptiane do të

këndonte këngën në lavdi të Pejgamberit, në çka ndonjë tjetër briste me "gatraf", me atë britmën e hareshme të grave arabe (që në Egjipt quhet "zagrut"), me triler të rreptë, mjaft të lartë që e lëshojnë gratë në të gjitha rastet solemne, siç janë martesat, lindja e fëmijës, synetimi, përcjelljet fetare të cilitdolloji dhe, natyrisht, haxhi. Në Arabinë kalorsiake të kohëve më të lashta, kur vajzat e krerëve e kishin të zakonshme të kalërojnë në luftë me meshkujt e fisit të vet që t'i nxisin në trimëri më të madhe (sepse konsiderohej turp i madh të lejohet që ndonjë nga këto vasha të vritet ose, edhe më keq, që armiku ta robërojë), gatrafa ka mundur shpesh të dëgjohet në fushëbetejë.

Shumica e haxhinjve kanë udhëtuar në tezga - nga dy në çdo deve - dhe lëkundja dhe tundja e vazhdueshme shkallërisht do t'i trulloste dhe nervozonte. Atë që, i rraskapitur, për një çast kotej, e zgjonte tronditja e papritur, që përsëri të flejë dhe përsëri të zgjohet.

Kohë pas kohe grahësit e deveve, që e përcillnin karvanin në këmbë, i thirnin kafshët e veta. Ndonjëri prej tyre ndonjëherë këndonte në ritëm me hapin e zvarritur të deveve.

Para mëngjesit kemi arritur në Bahra, ku karvani u ndal të pushojë sepse ngrohtësia ishte e tillë sa që udhëtimi ishte i mundshëm vetëm natën. Ky fshat - në realitet vetëm vargu i dyfishtë i shtëpizave, kafeneve, disa kasolleve prej gjethit të palmave dhe një xhami krejtësisht e vogël - ka qenë pushimore e rëndomtë për karvanet në gjysmë të rrugës ndërmjet Xhides dhe Mekës. Peizazhi ishte i njëjti sikur që ka qenë tërë rrugës prej kur e kemi lëshuar bregdetin: shkretëtira me sukat e vetmuara aty këtu dhe me malet e larta, të kaltra në lindje që e kanë ndarë vijën bregdetare nga platoja e Arabisë Qendrore. Tash kjo shkretëtirë rreth nesh ngjasonte në kampin e madh ushtarak me tundat e shumta, devetë, tezgat, van-

dakët dhe me tollovitë e gjuhëve të shumta - arabe, malaje, hinduse, persike, somaliase, turke, po ashtu, ambare dhe Zoti e di sa të tjera. Ky ka qenë takim i mirëfilltë i kombeve, pasi të gjithë e bartnin ihramin e njëjtë, dallimet në prejardhje kanë qenë mezi të dalluara dhe të gjitha racat e numërta dukeshin thuajse sikur një.

Haxhinjtë kanë qenë të lodhur pas marshit të natës, por vetëm numri i vogël mes tyre kanë ditur si ta shfrytëzojnë këtë kohë pushimi; për shumicën prej tyre udhëtimi ka mundur të jetë aksion krejtësisht jo i rëndomtë, kurse për shumicën prej tyre ky ka qenë udhëtimi i parë në jetë - dhe ky aso udhëtimi, ndaj qëllimit të tillë! Është dashur të jenë të shqetësuar, është dashur të sillen përrëth, duart e tyre kanë kërkuar të punojnë diçka, madje nëse asgjë tjetër atëherë së paku t'i hapin dhe sërish t'i lidhin thasët dhe vandakët e vet; përndryshe njeriu fillon të ndihet i humbur, plotësisht i humbur në lumturinë joto-kësore sikur në det...

Kjo i ka ndodhur, si duket, familjes në tendë drejt-përdrejt pranë times, qartë haxhinj nga ndonjë fshat bengallas. Mezi e flisnin ndonjë fjalë, uleshin këmbëmbledhur në tokë dhe zgurdullonin palëvizshëm drejt lindjes, në drejtim të Mekës, drejt shkretëtirës së përmbushur me ngrohtësi xixëlluese. Ishte qetësia e tillë ëndërruese në fytyrat e tyre saqë keni ndier se si ata tashmë janë para Shtëpisë së Zotit dhe thuajse në praninë e Tij. Njerëzit ishin jashtëzakonisht të bukur, të dobët, flok gjatë dhe me mjekra të shkëlqyeshme të zeza. Njëri prej tyre ishte shtrirë i sëmurë në shtrojen e leshtë; pranë tij ishin të ulura dy gra të reja, si zogëza pitoreske në pantallonat e veta të gjera të kuqe, të kaltra dhe me tunikat me argjend të qëndisura, me gërsheta të dendura të zeza që lëshoheshin poshtë shpinës; më e reja prej tyre e kishte unazën e hollë të artë në një vrimë hunde.

Pasdite i sëmuri vdiq. Gratë nuk vajtuan siç e bëjnë këtë shpesh në vendet e Lindjes, sepse ky njeri ka vdekur në haxhillëk, në tokën e shenjtë, dhe kështu i shenjtëruar. Meshkujt e pastruan trupin dhe e pështollën në pëlhurën e njëjtë të bardhë të cilën e ka bartur si veshjen e vet të fundit. Pas kësaj njëri prej tyre u ndal para tendës, i vuri duart e veta para gojës dhe e thirri ezanin: "Zoti është më i Madhi, Zoti është më i Madhi! Nuk ka Zot tjetër veç All-llahut, kurse Muhammedi është i Dërguari i All-llahut!... Namazi për të vdekurin! Të gjithë neve Zoti na mëshiroftë!" Dhe nga të gjitha anët u grumbulluan njerëzit e veshur në ihrame dhe u radhitën në radhë pas imamit sikur ushtarët e armatës së madhe. Pas namazit të xhenazes, e çelën varrin, një plak lexoi disa fragmente nga Kur'ani, kurse ata atëherë e mbuluan me rërë haxhiun e vdekur, i cili ishte i shtrirë anash, me fytyrë të kthyer drejt Mekës.

Para lindjes së diellit të mëngjesit të dytë rrafshi ranor filloi të ngushtohet, sukat u afruan; kaluam nëpër grykë dhe në dritën e zbehtë të agimit i pamë shtëpitë e para në Mekë; pastaj hymë në rrugët e Qytetit të Shenjtë derisa Dielli nuk u ngrit.

Shtëpitë u ngjasonin atyre në Xhide me dritare të skalitura me mushebakë dhe me ballkone të mbyllura, por guri nga i cili janë ndërtuar dukej më i rëndë, më masiv nga guri koral i ngjyrosur ndritshëm i Xhides. Ishte ende shumë herët në mëngjes, por tashmë pat filluar të bëjë presion vapa e rëndë. Para shumë shtëpive kanë qenë bangat në të cilat flenin njerëzit e rraskapitur. Gjithnjë e më të ngushta bëheshin rrugët e papllakosura nëpër të cilat, duke u lëkundur, depërtonte karvani ynë drejt qendrës së qytetit. Pasi vetëm disa ditë na ndanin nga solemniteti i haxhit, në rrugë kishte shumë popull. Haxhinjtë e shumtë në ihramë të bardhë dhe të tjerët të

cilët sërish përkohësisht kanë veshur veshjen e vet të përditshme - veshjen nga të gjitha viset e botës muslimane; bartësit e ujit të mbledhur nën rresheqet e rënda për një ose nën zgjedhën me dy kanistra të vjetra petrolei në vend të kovave; grahësit dhe hipësit e gomarëve me zilet e vogla të shkëlqyeshme dhe stolitë e gjalla; më në fund, që tollovia të jetë më e plotë, devetë që vijnë nga drejtimi i kundërt, të ngarkuara me tezgat e zbrazëta, kurse secili rrahë me zë tjetërfare. Ishte rrëmujë e atillë në rrugët e ngushta sa do të mund të mendohej se haxhi nuk është ndodhi që tashmë me shekuj përsëritet çdo vit, por njëfarë befasi për të cilën njerëzit nuk kanë qenë të gatshëm. Më në fund karvani ynë pushoi të jetë çfarëdo karvani dhe u shndërrua në rrëmujë të çrregullt të deveve, tezgave, gjësendeve, haxhinjve, grahësve të deveve dhe zhurmës.

Tashmë në Xhide e pata rregulluar të vendosemi në shtëpinë e udhëheqësit mirë të njohur të haxhinjve, me emrin Hasan Abid, por kishte pak gjasa që në atë kaos ta gjejë qoftë atë, qoftë shtëpinë e tij. Por papritmas dikush thirri: "Hasan Abidi! Ku janë haxhinjtë për Hasan Abidin?" - kurse, sikur fantazma nga poçi, një djalosh u paraqit para nesh dhe, me përujje të thellë, tha që ta ndjekim; e ka dërguar Hasan Abidi që të na shpie deri në shtëpinë e tij.

Pas mëngjesit të pasur me të cilin na qerrasi, dola në përcjellje të djaloshit të njëjtë që na pat pritur, dhe u nisa në drejtim të Xhamisë së Shenjtë. Kemi ecur nëpër tollovinë e rrugëve të zëshme, kaluam pranë mishtoreve me radhët e deveve të prera të varura para tyre; pranë shitoreve të perimeve me mallin e ekspozuar në hasure të shtrira në tokë; nëpër luzmat e mizave dhe erës së perimeve, pluhurit dhe avullimit; pastaj nëpër bazarin e ngushtë, të mbuluar në të cilin shitet vetëm pëlhura: festival i ngjyrave. Sikur edhe tjetërkund në bazare të Azisë Perëndimore dhe Afrikës Veriore, shitoret janë vetëm

nisha të vogla të ngritura rreth një metër mbi tokë, me pronarin e dyqanit që është i ulur me këmbë të mbledhura, i rrethuar me pjesët e pëlhurës të të gjitha llojeve dhe ngjyrave, derisa mbi të pezullojnë në radhë të gjitha llojet e veshjeve për të gjithë popujt e botës muslimane.

Dhe përsëri, këta janë njerëzit e të gjitha racave, veshjeve dhe shprehjeve, disa me turbanë, disa kokëzhveshur; disa që qetësisht ecin me kokë përdhe, ndoshta me tespihë në dorë, kurse të tjerët që lehtë vrapojnë duke depërtuar nëpër njerëz; trupat e ngjeshur, të zeshkët të somaliasve që shkëlqejnë sikur bakri ndërmjet palëve të teshave të tyre që i ngjason togës; arabët prej rrafshlarte nga brendia, me shtat të hollë, fytyrë të ngushtë, me qëndrim krenar; uzbekët e ngadalshëm, të ngathtë nga Buhara, të cilët madje edhe në këtë ngrohtësi mekkase i mbanin kaftanët e vet të pambuktë dhe çizmet e thella të lëkurës; vashat javanase të veshura në sarong me fytyra të çela dhe sy bademi; marokienët, me ecje të ngadalshme dhe dinjitozë në burnusët e vet të bardhë; mekkasit në tunikat e bardha, me kapelat e bardha qesharake të vogla të puthitura për koke; felahët egjiptianë me fytyra të ngazëlluara; hindusët e veshur në të bardhë që shikojnë nën turbanët e mëdhenj, të bardhë të ndritshëm dhe gratë e tyre të pështjella aq paarritshëm në burkasët e vet të bardhë që të duken si tenda lëvizëse; zezakët e mëdhenj nga Tîmbuktu ose Dahomeu në rrobat e kaltra vjollce dhe kapelat e kuqe, ngushtë të vëna; kinezet e njoma, sikur fluturat e qëndisura, kërcëjnë në putat e imta sikur gazelet. Përzierja shqetësuese e zëshme në të gjitha drejtimet ashtu që ndieni sikur jeni midis valëve që thyhen dhe nga të cilat mund t'i shikoni vetëm disa detaje por kurrë fotografinë në tërësi. Çdo gjë pezulloonte në zukamën e gjuhëve të shumta, lëvizjeve dhe

mallëngjimeve të gjalla - derisa papritmas nuk u gjetën para njëres prej portave të Haremit, Xhamisë së Shenjtë.

Ka qenë kjo porta me tre harqe dhe me shkallë prej guri që shpiejnë deri te ajo; në prag ulej lypësi gjysmëlakuriq hindus, duke e drejtuar dorën e vet të dobët drejt nesh. Dhe atëherë për herë të parë e shikova katrorin e brendshëm të vendit të shenjtë që shtrihet nën rrafshin e rrugës - shumë më poshtë se pragu - dhe kështu i hapet shikimit sikur ndonjë enë, katror i madh i rrethuar nga të gjitha anët me treme të formuara nga shtyllat e shumta me harqet gjysmërrethore, kurse në mesin e tyre kubi i lartë rreth pesëmbëdhjetë metra, i mbuluar me pëlhurë të zezë, me shiritin e gjerë të arit të qëndisur të vargjeve nga Kur'ani rreth pjesës së sipërme të mbuluesit: Ka'ba...

Kjo ishte ajo Ka'bja, synim i mallëngjimit të aq mili-ona njerëzve gjatë aq shekujve. Që ta arrijnë atë synim, haxhinjë e panumërt me vite kanë duruar flijime të rënda; shumë kanë vdekur në rrugë; shumë kanë arritur vetëm pas abstenimeve të mëdha; kurse për të gjithë ata kjo ndërtesë e vogël, katrore ka qenë kulmin i dëshirave të tyre, kurse të arrihet ajo don të thotë përmbushje e tyre.

Qëndronte atje, thujse kubi i përkryer (çka edhe është në arabishte emri i tij) plotësisht i mbuluar me brokat të zi, ujdhesë e qetë midis oborrit të gjerë katror të xhamisë, shumë më e qetë se çdo vepër tjetër arkitektonike kudo qoftë në botë. Duket sikur ai që i pari e ka ndërtuar Ka'ben - sepse nga koha e Ibrahimit godina origjinale disa herë përsëri është ndërtuar në formën e njëjtë - ka dëshiruar të krijojë parabollën e përlulshmërisë së njeriut para Zotit. Ndërtuesi e ka ditur se kurrfarë bukurie të ritmit arkitektonik, as përkryeshmëria e vijave, sado e madhe, nuk mund kurrë ta shprehë idenë mbi Zotin; kështu ai është kufizuar në formën më të thjeshtë tredimensionale që mund të mendohet - në kubin pllakor (guror).

Kam parë në vendet e ndryshme muslimane xhami që paraqesin vepra frymëzuese artistike nga dora e artistëve të mëdhenj. Kam parë xhami në Afrikën Veriore, faltore të shkëlqyeshme nga mermeri dhe albasteri i bardhë; kupolën në Shkëmb në Jerusalem, kupolën e fuqishme, të përkryer mbi strukturën e rafinuar, ëndrra e lehtësisë dhe barrës të unjësuar pa kontrast; godinat madhështore të Stambollit: Sulejmania, Jeni-Valide, Xhamia e Bajezidit; pastaj asaj në Bursë, në Azinë e Vogël; Xhaminë safavidase në Iran - harmonia mbretërore e gurit, pllakave të qeramikës të ngjyrave të llojlojshme, mozaqeve portale të mëdha stalaktiti mbi dyert me argjend të skalitura, minareve të gjata me sherefe prej albasteri dhe bruzi të kaltër, oborret katrore të shtruara me mermer me fontana dhe rrapët e stërlashtë; gërmadhat e mëdha të xhamive të Tamerlanit në Samarkand, të ndritshme madje edhe në shkatërrimin e tyre.

Tërë këtë e kam parë - por kurrë nuk kam ndier aq fuqishëm sikur tash, para Ka'bes, që dora e ndërtuesit ka ardhur aq afër konceptimit të tij religjioz. Në thjeshtësinë e përkryer të kubës, në mohimin e plotë të çdo bukurie të vijave dhe formave, fliste mendimi i tij. "Çfarëdo bukurie që njeriu është në gjendje ta krijojë me duart e veta, ajo vetëm do të jetë mashtrim i bindjes se është e denjë Zotit; për këtë ajo më e thjeshta që njeriu mund ta mendojë - më e madhja që mund ta bëjë është ta shprehë madhërinë e Zotit". Ndjenja e ngjashme është dashur të jetë shkak i thjeshtësisë matematikore të piramidave egjiptiane - edhe pse atje mendimi i njeriut ka gjetur shprehje në dimensionet e mëdha që u ka dhënë godinave të veta. Por këtu, në rastin e Ka'bes madje edhe madhëria ka folur për vetëmohimin dhe dorëzimin e njeriut, kurse modestia krenare e kësaj godine të vogël nuk ka të barbartë me veten në Tokë.

Ekziston vetëm një hyrje në Ka'be - dera e punuar me argjend në anën verilindore, rreth dy metra mbi tokë, ashtu që deri tek ajo mund të vihet me anë të shkallëve lëvizëse prej drurit që vihen para dyerve në disa ditë të vitit. Brendia, rëndom e mbyllur (e kam parë tek me një rast tjetër), është mjaft e thjeshtë: dysHEMEJA e mERMERTË me disa qILIMA, llAMBAT prej bronzi e ARGJENDI të varura në tAVAN të cilin e mbajnë trerët e rëndë prej druri. Në realitet, kjo brendi nuk ka rëndësi të veçantë vetvetiu, sepse shenjtëria e Ka'bes ka të bëjë me tërë godinën, që është Ka'be - d.m.th. orientim për lutje të tërë botës islame. Pikërisht drejt këtij simboli të Njëshmërisë së Zotit qindra miliona muslimanë përgjatë botës i kthejnë fytyrat e veta në namaz pesë herë në ditë.

Në këndin lindor të ndërtesës është vendosur dhe është lënë i pambuluar guri i ngjyrës së mbyllur i rrethuar me kornizë të gjerë të argjendtë. Ky gurë i zi, të cilin e kanë puthur shumë gjenerata haxhinjsh, shpesh ka qenë shkas për përçarje të jomuslimanët, të cilët mendojnë se ky është fetish që Muhammedi ua ka marrë si koncesion mekkasve paganë. Asgjë nuk mund të jetë më larg prej të vërtetës. Pikërisht sikur që Ka'ba është objekt i respektit e jo adhurimit, ashtu është edhe Guri i zi. Ai respekt si gjëja e vetme e mbetur e ndërtesës origjinale të Ibrahimit; për shkak se buzët e Muhammedit e kanë prekur me rastin e Haxhit të lamtumirës së tij, të gjithë haxhinjtë prej atëherë e bëjnë po këtë. Pejgamberi ishte plotësisht i vetëdijshtëm se të gjitha gjeneratat e mëvonshme të besimtarëve gjithherë do ta ndjekin shembullin e tij; kur e puthi gurin, e ka ditur se buzët e haxhinjve të ardhshëm për të gjitha kohët do ta takojnë kujtimin në buzët e tij në përqaftimin simbolik që ashtu tërë bashkësisë së vet i ka afruar, mbi kokë dhe mbi vdekjen. Kurse haxhinjtë, kur e puthin gurin e zi, ndiejnë se po e përqafojnë

Pejgamberin dhe të gjithë muslimanët tjerë që kanë qenë aty para tyre dhe atyre që do të vijnë pas tyre.

Asnjë musliman nuk mohon se Ka'ba ka ekzistuar kaherë para Pejgamberit Muhammed; njëmend, rëndësia e saj është pikërisht në këtë fakt. Pejgamberi kurrë nuk ka pretenduar se është themelues i fesë. Përkundrazi, dorëzimi Zotit - Islami - ka qenë, sipas Kur'anit, "prirja natyrore e njeriut" nga agimi i vetëdijes njerëzore; pikërisht këtë e kanë mësuar Ibrahim, Musai, Isai dhe të gjithë pejgamberët tjerë të Zotit, kurse porosia e Kur'anit është vetëm shpallja e fundit hyjnore. Asnjë musliman nuk do të mohojë se ky vend i shenjtë ka qenë përplot idhuj e fetishe para se Muhammedi t'i thyejë ata, pikërisht sikur Musai që e theu viçin e arit në Sinaj, sepse kaherë më parë para se idhujt të jenë futur në Ka'be, atje është adhuruar Zoti i vërtetë dhe kështu Muhammedi vetëm e ka kthyer tempullin e Ibrahimit në destinacionin e tij të parë.

Kam qëndruar këtu para tempullit të Ibrahimit dhe kam shikuar në çudi duke mos menduar (sepse mendimet dhe përsiatjet kanë ardhur shumë më vonë), kurse nga njëfarë bërthame të fshehtë, të kthjellët në mua, ngadalë është rritur entuziazmi sikur këngë.

Pllakat e lëmuara prej mermeri, me shkëlqimin diellor që luanin nëpër to, e mbulonin trollin në rrethin e gjerë rreth Ka'bes, kurse nëpër këto pllaka prej mermeri kanë ecur shumë popuj, meshkuj e femra, rreth shtëpisë së Zotit në të zezë të veshur. Në mesin e tyre ka pasur që ngadalë e kanë thirrë Zotin në lutjet e tyre, e të tjerë zëshëm, kurse shumë asosh që nuk kanë pasur më shumë as fjalë as lot dhe kanë mundur vetëm të ecin kokulur...

Pjesë e haxhit është ecja rreth Ka'bes shtatë herë; jo vetëm që t'i dëftohet respekt vendit të shenjtë kryesor të Islamit. Ka'ba është simbol e Njëjesisë së Zotit, kurse lëvizja trupore e haxhinjve rreth saj është shprehje sim-

bolike e aktivitetit njerëzor, duke nënkuptuar që jo vetëm mendimet dhe ndjenjat tona - çdo gjë që përfshinë "jetën e brendshme" - por po ashtu edhe jeta jonë aktive, e jashtme, veprat tona dhe përpjekjet praktike duhet ta kenë Zotin si qendër të veten.

Edhe unë, po ashtu, kam lëvizur ngadalë përpara dhe është bërë pjesë e ecjes rrethore rreth Ka'bes. Kohë pas kohe bëhesha i vetëdijshëm për mashkullin ose femrën pranë vetes; fotografitë e veçuara paraqiteshin kalimisht para syve të mi dhe zhdukeshin. Ka qenë një zezak i madh në ihramin e bardhë, me trespahun e drunjtë të varur si zinxhir rreth nyjes së fortë, të zezë të dorës. Një malajas i vjetër ka rrapëlluar një kohë pranë meje, kurse duart i lëviznin sikur në hutinë e pashpresë. Syri i përhimtë nën vetullat e dendura - kujt i takonte? - tash është humbur në grumbull. Në mesin e shumë njerëzve para gurit të zi hindusja e re, qartë e sëmurë; në fytyrën e saj të ngushtë, të njomë qëndronte mallëngjimi çuditërisht i shprehur, i dukshëm për syrin e kundruesve sikur jeta e peshqve dhe algave në thellësinë e hurdhës së peshqve si kristali të pastër. Duart e saj me shuplaka të zbehta, lart të drejtuara qenë të shtrira kah Ka'ba, kurse gishtat e saj janë dridhur sikur po e përcjellin lutjen pa fjalë...

Kam ecur më tej, minutat kalonin, kurse çdo gjë që ishte e vogël dhe e hidhur në zemrën time filloi të largohet nga ajo, jam bërë pjesë e ecjes rrethore - ah, a është kjo domethënia e gjithë asaj çka punojmë, të bëhemi të vetëdijshëm se jemi pjesë e lëvizjes në orbitë? A nuk është kjo, mbase, fundi i çdo pasigurie? Edhe minutat u tretën, vetë koha u ndal, dhe kjo ishte vatër e gjithësisë...

Pas nëntë dite Elza vdiq.

Vdiq papritmas, pas më pak se një javë sëmundjeje që në fillim dukej si mosdisponim për shkak të ngrohtësisë dhe ushqimit jo të rëndomtë, por së shpejti u shpreh

si një lëngatë e paqartë tropike para së cilës mjekët sirianë në spitalin në Mekë qëndronin të paaftë. Terri dhe pikëllimi i pashprehur janë ndërthurur rreth meje.

Është varrosur në varrezat ranore të Mekës. Mbi varrin e saj është vënë një gur. Në të nuk kam dëshiruar kurrfarë mbishkrimi, sepse të mendohet për mbishkrimin ishte sikur të mendosh për ardhmërinë, kurse unë tash nuk kam mundur të mendoj kurrfarë ardhmërie.

Djali i vogël i Elzës, Ahmedi, mbeti me mua më shumë se një vit dhe më përcillte në udhëtimet e mia të para në brendi të Arabisë - përcjellës i guximshëm dhjetëvjeçar. Por pas një kohe u detyrova të ndahem me të sepse familja e nënës së tij më në fund më bindi se duhet të dërgohet në shkollë në Evropë; atëherë nuk mbeti asgjë prej Elzës pos kujtimit për të, gurit në varrezat mekkase dhe territ që u shpërnda konsiderueshëm më vonë, gjatë kohë Pasi i jam dorëzuar përqaftimit pakohor të Arabisë.

## - 6 -

Nata tashmë mirë ka kaluar, kurse ne edhe më tej ulemi rreth zjarrit të kampit i cili ende digjej ngadalë. Epshi si shtrengatë i Ebu Seidit tashmë ishte ulur; sytë e tij janë të pikëlluar dhe disi të lodhur; na flet për Nurën në mënyrë sikur do të flitnim për ndonjë person të dashur që ka herë ka vdekur.

"Ajo, e dini, nuk ka qenë e bukur, por unë e kam dashur..."

Hëna mbi ne është e plotë me plotësinë e qenies së gjallë. Kurrfarë çudie që arabët paraislamikë kanë menduar se është vasha e hyjneshës - flokëgjatës El-Lat, hyjneshës së plleshmërisë për të cilën flitej se ia dërgon forcat e veta misterioze të lindjes tokës dhe kështu krijon jetë të re në njerëz dhe kafshë. Për lavdi të saj djelmoshat dhe vashat e Mekës dhe Taifit të dikurshëm kanë

celebruar netët e Hënës së plotë jashtë në gosti luksoze, dashuri të lirë dhe në gara poetike. Nga vorbat prej dheut dhe enëve prej lëkure rridhte vera e kuqe edhe për atë që ajo ka qenë aq e kuqe dhe aq plotë mallëngjime, poetët në panegjirizmat e veta të egra e kanë krahasuar me gjakun e grave. Kjo rini krenare dhe pasionuese e ka derdhur bollëkun e vet në prehërin e El-Latit "dashuria e së cilës është sikur shkëlqimi i Hënës së plotë dhe dinjiteti i së cilës është sikur fluturimi i gatave të zeza" - hyjneshës prej drurit, vashërore të fuqishme që i ka shtrirë krahët e vet prej Arabisë Jugore deri në veri dhe arriti madje Greqinë e largët në figurën e Letos, nënës së Apolonit.

Nga adhurimi i tretur i paqartë i natyrës në formë hyjnie të El-Latit dhe shumë hyjnive tjera të shumta deri te domethënia e lartësuar për një Zot në Kur'an, ka qenë rrugë e gjatë së cilës është dashur të kalojnë arabët. Por, në fund, njeriu gjithnjë ka dëshiruar të udhëtojë larg rrugëve të shpirtit të vet, këtu në Arabi jo më pak se në botën tjetër; ai këtë aq e ka dashur sa që tërë historia vërtet ka mundur të përshkruhet si histori e kërkimit të fesë.

Tek arabët ky kërkim gjithnjë ka synuar kah Absolutja. Madje edhe në kohët më të hershme, kur imagjinata e tyre e ka mbushur botën rreth tyre me shumësi zotash e demonësh, ata gjithnjë kanë qenë të vetëdijshëm për Njeriun i cili në lartësinë e vet ka qëndruar mbi të gjitha hyjnitë - i padukshmi, i pakuptueshmi, i Gjithmundshmi, larg jashtë të imagjinuarit njerëzor - shkaku Amshues i çdo gjëje. Hyjnesha El-Lat dhe motrat e saj hyjneshe Menat dhe Uza, kanë qenë vetëm "vasha të Zotit", ndërmjetëse ndërmjet Njërit të Pakuptueshmit dhe botës së dukshme, simbole të forcave të pakuptueshme që e kanë rrethuar fëmijërinë e njeriut; por thellë në prapavijë të mendimit arab njohja për Njërin gjithherë ka qenë e pranishme, gjithherë e gatshme që të shpërthejë në

besim të vetëdijshëm. Si ka mundur të jetë tjetërfare? Ata janë popull i rritur në qetësi dhe vetmi ndërmjet qiellit të egër dhe tokës së vrazhdë; e vështirë ka qenë jeta e tyre midis këtyre hapësirave të pakëndshme, të pafund; kështu nuk kanë mundur t'i shmangen mallëngjimit për Fuqi që do të përfshinte çdo gjë që ekziston me drejtësi dhe mirësi të pagabueshme, me rigozitet dhe urtësi: me Zotin Absolut. Ai gjendet në papërfundimësi dhe shtrihet në papërfundimësi - por për atë që ti je brenda krijimit të Tij, Ai është më afër se arteria jote...

Zjarri i kampit tashmë ishte fikur. Zejdi dhe Ebu Seidi kanë fjetur, kurse në afërsi janë të shtrira tri deve në rërën e ndritur me dritë hëne dhe përtypen me zërat e butë, kërcëllues, duke u qetësuar kohë pas kohe. Kafshë të mira... Nganjëherë ndonjëra prej tyre e ndërron pozitën dhe fërkon për toke sipërfaqen e brinjë të kraharorit të vet, e nganjëherë turfullon sikur merrë frymë. Kafshë të mira. Ato janë pa shprehje të caktuar, krejtësisht tjetërfare prej kalit, të cilët gjithnjë janë aq qartë të përcaktuar në karakterin e vet; po, tjetërfare nga të gjitha kafshët tjera që i përdorë njeriu - pikërisht siç është stepa shkretinore, të cilës i përkasin, tjetërfare nga të gjitha viset tjera: pa shprehje të caktuar, duke u hamendur ndërmjet kundërthënieve, e çuditshme por megjithatë paskajshëm modeste.

Nuk mund të fle dhe shëtise e ngjitem në njërin prej sukave të afërta. Hëna pezullon poshtë mbi horizontin perëndimor dhe i ndriçon sukate e ulta, gurorë që ngrihen si fantazmë nga rrafshi i vdekur. Prej këtu më tej fushëgropa bregdetare e Hixhazit lehtë ngjitet drejt Perëndimit; një varg luginash të ndërprera me shumë kthesa, shtretër të thatë lumenjsh, të privuar nga çdo jetë, pa fshatra, pa shtëpi, pa drunj - të vrazhdë në zhveshurinë e vet nën dritën e dritës së hënës: E megjithatë, nga kjo tokë e shkretë, e pajetë, nga këto lugina ranore dhe bri-

gje lakuriqe mugulloi ajo fe që më së shumti e vërteton jetën në tërë historinë njerëzore...

Nata është e ngrohtë dhe e qetë. Gjysëmdrita dhe largësia bëjnë që brigjet të mblidhen dhe lëkundën. Nën shkëlqimin e dritës së hënës shkëlqimi i zbehtë i kaltër vezullon, kurse nëpër këtë kaltëri të zbehtë rrëshqet një-farë gjurme e shkëlqyeshme opalle - paralajmërim, kujtim vegullues në të gjitha ngjyrat në Tokë; por kaltëria jotokësore të gjitha i zbutë, duke i bashkuar pa kalim në diçka që duhet të jetë horizont, kurse ngjason në thirrje të gjërave të pakuptueshme, të pakapshme.

Jo fort larg nga këtu, e fshehtë nga sytë e mi midis kësaj egërsie të pajetë të luginave dhe brigjeve, shtrihet lugina e Arafatit, në të cilën një herë në vit takohen të gjithë haxhinjtë që vijnë në Mekë si kujtim në Takimin e fundit kur njeriu do të duhet t'i përgjigjet Krijuesit të vet për çdo gjë që e ka bërë në jetë. Sa herë atje edhe vetë kam qëndruar, kryeshtruar, në veshjen e bardhë të haxhinjve, me shumicën e njerëzve të veshur në të bardhë, haxhinjve kryeshtruar nga të gjitha kontinentet, fytyrat të kthyer drejt Xhebel er-Rrahmes - "Malit të mëshirës" - që ngrihet nga rrafshira e gjerë; kam qëndruar e pritur që pasdite, duke përsiatur për atë Ditën e pashmangshme "kurdo t'i ekspozoheni shikimit dhe kurrfarë sekreti juaj nuk do të mbetet i fshehur..."

Dhe derisa qëndroj në maje të sukës dhe shikoj poshtë drejt rrafshit të pashikuar të Arefatit, kaltëria e ndritur me dritën e hënës të visit para meje, aq e vdekur pak më parë, papritmas ngjallet në rrjedhat e të gjitha jetëve njerëzore që kanë kaluar me të dhe mbushet me zërat misteriozë të miliona meshkujve dhe femrave që kanë ecur në këmbë ose kanë kalëruar ndërmjet Mekës dhe Arefatit në një mijë e treqind haxhillëqet gjatë trembëdhjetë shekujve të kaluar. Zërat dhe hapat e tyre, zërat

dhe hapat e kafshëve të tyre zgjohen dhe sërish jehojnë; i shoh se si ecin dhe kalërojnë e tubohen - numër i madh i haxhinjve të veshur në të bardhë; i dëgjoj zërat e ditëve të tyre të kaluara; krahët e fesë, që i ka bashkuar në këtë vend të shkëmbinjve, rërës dhe vdekurisë fanitëse sërish marrin hov me ngrohtësinë e jetës mbi harkun e shekullit, kurse hovi i fuqishëm i krahëve më tërheq edhe mua dhe ditët e mia të kaluara në tanishmëri dhe edhe një herë përsëri kalëroj mbi rrafshirë - kalëroj në galop shtrëngate nëpër fushëgropë, midis mijëra e mijëra beduinëve në ihamë, duke u kthyer nga Arefati në Mekë - pjesëza e imët e asaj vale të pamatshme, të pakundërshtueshme të deveve dhe njerëzve të shumtë në galop, nën të cilët toka dridhet, me flamujt e tyre fisnorë në shtizat e gjata, me flamuj që rrahin si daulla në erë dhe me britmat e tyre luftarake që avullojnë ajrin: "Ja Ravga, ja Ravga!", me të cilin ata nga fisi Atajba e thirrin emrin e të parit të vet, kurse përgjigjen me "Ja Avf, ja Avf!" ata nga Harbi, derisa thuajse provokativisht jehon "Ja Shamar, ja Shamar!" nga krahu i djathtë skajor i kolonës.

Udhëtojmë, duke u sulur, duke fluturuar nëpër rrafsh, kurse mua më duket se fluturojmë me erën, të dorëzuar fatit që nuk njih as kufij... kurse era këndon himnin e egër triumfues në veshët e mi: "Kurrë më, kurrë më, kurrë më nuk do të jesh i huaj!"

Vëllezërit e mi nga e djathta dhe vëllezërit e mi nga e majta, të gjithë të panjohur por asnjë i huaj; në ngazëllimin e shfrenuar të suljeve tona, ne jemi një trup në kërkim të një caku. E gjerë është bota para nesh kurse në zemrat tona shkëlqen shkëndija e flakës që ka flakëruar në zemrat e as'habëve të Pejgamberit. Ata e dinë, vëllezërit e mi nga e majta dhe vëllezërit e mi nga e djathta, se janë larg nga ajo që pritet prej tyre dhe se gjatë shekujve

zemrat e tyre janë bërë të vogla; e megjithatë, premtimi i përmbushjes nuk është tërhequr prej tyre... prej nesh...

Ndonjëri nga shumësia e turbulluar e lëshoi britmën fisnore dhe e ndërroi me britmën e fesë, "Ne jemi vëllezër të atij që i është dhënë Zotit!" - kurse tjetri ndërhyri me "All-llahu ekber!" - "Zoti është më i madhi! Vetëm Zoti është i madh!"

Dhe të gjitha grupet fisnore e pranorin këtë britmë të vetme. Ata më shumë nuk janë beduinë të Nexhdit që garojnë me krenarinë e vet fisnore; ata janë njerëz që dinë që fshehtësitë e Zotit vetëm presin tek ata... brenda nesh... Mbi çukurmimin e mijëra thundrave të deveve dhe fërfëllimin e qindra flamujve, britma e tyre rritet në murrmurinë triumfuese: "All-llahu ekber!"

Ajo rrjedh në valët e fuqishme mbi kokat e mijëra njerëzve në galop, mbi rrafshirën e gjerë, deri te të gjitha viset e vendit: "All-llahu ekber!" Këta njerëz janë rritur mbi jetët e vogla të veta vetjake dhe tash feja e tyre i bart përpara, në unitet, drejt disa pikëpamjeve të panjohura... Mallëngjimi nuk mund të jetë më i vogël, as i fshehtë, ai e ka gjetur vetëdijësimin e vet, dalja verbuese e diellit të përmbushjes. Në këtë përmbushje njeriu hedh hapa në tërë madhështinë e vet të dhënë nga Zoti; hapi i tij është kënaqësi, dija e tij liri, kurse bota e tij gjithësi pa kufij...

Aroma e trupave të deveve, frymëmarrja dhe turfullima e tyre, murrmurima e thundrave të tyre të shumta; thirrjet e njerëzve, goditjet e kondakëve të pushkëve në shala, pluhuri dhe djersa dhe fytyrat skajërisht të ngazëlluara rreth meje; dhe qetësi e papritur e gëzueshme në mua.

Kthehemi në shalë dhe shoh pas vetes valëvitjen, shumësia valëvitëse e mijëra kalorësve të bardhë, kurse pas tyre, ura nëpër të cilën kam ardhur; skaji i saj është menjëherë pas meje ndërsa fundi i saj tashmë humbet në mjegullën e largësisë.

(Fund)

## P. S. i përkthyesit!

Kur i përktheja faqet e fundit të jetëshkrimit shpirtëror të Muhammed Asadit, "Rruga për në Mekë" (The Road to Mecca), më arriti libri tjetër i M. Asadit "Islami në udhëkryq" (Islam on the crossroads), në botim të botuesit nga Zagrebi. Në fund të librit lexova se "njëri prej mendimtarëve më të shquar muslimanë të këtij shekulli, Muhammed Asadi, vdiq më 20. II. 1992, në vitin e 92 të jetës. Është varrosur në varrezat e vogla muslimane në Granadë..."

Me keqardhje e lexova këtë lajm të vonuar, për njeriun i cili vdekjen sa herë e kishte parë në sy dhe guximshëm kishte udhëtuar plot 92 vjet. Në njëfarë mënyre, gjatë leximit e përkthimit, edhe vetë kalova nëpër të gjitha labirintet jetësore të M. Asadit, vështirësitë jetësore për idealet më të larta, u mishërova në udhëtimet e tij, në misionet e tij të zbulimit, e të ngjashme...

Të shpresojmë se edhe veprat tjera të M. Asadit do të përkthehen në gjuhën shqipe, me ç'gjë, më së miri do t'i falënderohemi atij për gjithë atë që bëri për Islamin e muslimanët, për njeriun dhe njerëzinë.

Kërkoj ndjesë nga lexuesit nëse nuk kam arritur ta përcjell porosinë e M. Asadit në përkthimin shqip. Dëshira dhe përpjekja nuk kanë munguar!

*Më 30 Sheval 1416 / Më 20 mars 1996.*

*Burgu i Dubravës, Istog.*





E shoqja e autorit Elza (e cila ka vdekur në Mekë) dhe djali i tij Ahmedi

## **P. S. i mëvonshëm:**

I impresionuar nga jetëshkrimi i M. Asadit, Rruga për në Mekë, e përktheva edhe veprën tjetër të M. Asadit, Islami në udhëkryq, dhe arrita disi ta përcjell jashtë mureve të burgut të Dubravës. Mirëpo, ndërkohë, ndodhi shumëçka, burgu i Dubravës u transferua nëpër burgje të Serbisë, kurse unë në burgun e Zajëçarit. Kosova u boshatis, humba të gjitha shënimet dhe nuk më kujtohet kujt ia kam dhënë dorëshkrimin për ta dorëzuar te familja ime... Andaj, pas daljes nga burgu, u detyrova sërish ta përkthej këtë vepër të rëndësishme, e cila u botua në Prizren më 2002 të kuadër të SHB “Zëri islam”.

Po ashtu, duhet theksuar se gjatë përkthimit të vepërës “Rruga për në Mekë” nuk kemi respektuar disa norma drejtshkrimore, (p.sh. musliman/mysliman etj.), përkundër këmbënguljes së lektorit dhe recensentit. Përparësi i kemi dhënë përdorimit origjinal të fjalës, e jo huazimeve të bastarduara, ndonëse të kodifikuara në Drejtshkrim.

*Prizren, 13. 10. 2000.  
N. Ibrahim*

---

<sup>1</sup> (Dr. Xh. Llatiq është profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, autor e përkthyes i shumë shkrimeve fetare, politike e letrare dhe vepërimitar i shquar politik, i burgosur politik disavejeçar. Përkthyesi.

<sup>2</sup> Erë shkretëtire. Përkthyesi N. I.

<sup>3</sup> Bazar (fjalë persishte), (te ne pazar), qendër tradicionale ekonomike e qytetit lindoro-islam dhe rrethinës së tij, qendra më e rëndësishme organizative dhe tatimore. Bazari çdo ditë afaron në bërthamat e përhershme ndërtimore që shërbejnë ekskluzivisht për qëllime ekonomike. Bazari në kuptimin e plotë të fjalës është vepër e pavarur e mesjetës islame, pa ekuivalencë në qytetërimet tjera. (N. Smailagiq, Leksikonislama, Sarajevë, 1990, fq. 88). Për hir të origjinalitetit, këtë shprehje do ta përdorim në trajtën burimore bazar e jo në trajtën tonë pazar. Përkthyesi.

<sup>4</sup> Demunitiv prej Aziz

<sup>5</sup> Shpejt pas mbarimit të këtij libri (1953), mbreti Ibn Saud vdiq në moshën shtatëdhjetetreveqe të jetës së tij, kurse me vdekjen e tij mbaroi një epokë e historisë arabe. Kur e kam parë për herë të fundit në vjeshtë të vitit 1951 (me rastin e vizitës zyrtare Arabisë Saudite në emër të qeverisë pakistaneze), m'u duk se më në fund u bë i vetëdijshëm për shkatërrimin tragjik të jetës së tij. Fytyra e tij, dikur aq e gjallë dhe e fuqishme, ishte e dëshpëruar dhe e tërhequr; kur bënte fjalë për vete, dukej sikur bën fjalë për diçka që tashmë është e vdekur dhe e varrosur, pa revokim.

<sup>6</sup> Sherefet - Përkthyesi.

<sup>7</sup> Një version të ngjashm të këtij hadithi e transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij. Përkthyesi.

<sup>8</sup> Thënia e tillë është rituali i vetëm i nevojshëm që të bëhesh musliman. Në Islam shprehjet "i dërguar" dhe "profet" reciprokisht janë të ndërrueshme kur aplikohen në pejgamberët e mëdhenj që sjellin Shpalljen e re, si Muhammedi, Isai, Musai, Ibrahim.

<sup>9</sup> Lidhjet tona përsëri u vendosën më 1935, Pasi babai im më në fund kuptoi dhe i vlerësoi shkaqet e kalimit tim në Islam. Edhe pse më kurrë nuk jemi takuar, gjithnjë kemi korresponduar deri më 1942 kur atë dhe motrën time nazistët i deportuan nga Vjena në kampin përqëndruar, ku edhe kanë vdekur.

<sup>10</sup> Mbreti libias pas vitit 1952

<sup>11</sup> Ky akt i "heroizmit" italian ka ndodhur më 16. IX. 1931.

<sup>12</sup> Luftëtari dhe poeti paraislamik arab i njohur për bujarinë e vet të madhe. Emri i tij është bërë sinonim për këtë virtut të cilit arabët i kushtojnë rëndësinë më të madhe. Fisi Shamar të cilit i përket Zejdi mbanë prejardhjen e vet nga fisi Tajji i Hatimit.

<sup>13</sup> Seid Ahmedi vdiq në Medine vitin vijues (1933).



DITAN

Redaktor letrar: Ildir Azizi  
Redaktor gjuhësor: Fatmire Ajdini  
Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi  
Redaktor teknik & faqësës: Azem Zaimi

Mbikëqyrës gjatë procesit të shtypit: Kemal Ismaili  
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup  
Shtypi: Focus - Prishtinë

Boton: SHB "Logos-A"  
rr. II Mak. Brigada T.C. Treska XXI /1 1000 Shkup  
tel. +389 2 600-036; fax: +389 2 611-508  
[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)  
e-mail: [logos-a@mt.net.mk](mailto:logos-a@mt.net.mk)

# Rruga për në Mekë

